

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

LIB-110  
TK14

ISMAIL  
KADARE

**EMBLEMA  
E DIKURSHME**  
**TREGIME E NOVELA**

891.P.1.-32

## SEZONI DIMÉROR I KAFE «RIVIERËS»

**S**i zakonisht, zbrita nga autobusi urban duke u hedhur dhe kalova udhëkryqin plot me njerëz, pothuajse me vrap. Gjithmonë më pëlqen kur shoferi e hap derën pak më përpara se autobusi të ndalojë, kështu që ti ke mundësi të hidhesh në trotuar dhe pastaj, po me atë ritëm të shpejtë, të ecësh më tutje. Ora e madhe shënonë shtatë pa katër minuta. Njerëzit shpejtonin nga të gjitha anët nëpër stacionet e autobusëve. Unë ngrita jakën e pardës, së. Në ajër kishte shumë lagështirë dhe mjegulla ishte ulur gjer në nivelin e tarracave të apartamenteve. Duke kaluar udhëkryqin tjetër, unë përshëndeta me dorë, si zakonisht, policin, bëra dhjetë hapat e zakonshëm përbri dyqanit të remontit të frigoriferëve, katër hapa nga e majta, kthesë e fortë, stop, përpara meje kafe «Riviera», qendra ime e punës. Isha i gjëzuar. Ky ishte një gjëzim pa shkak, ishte thjesht gjëzimi që të shkakton mëngjesi. Një gjëzim i tillë të vjen nga një gjë e vogël dhe po aq shpejt të prishet nga një gjë e vogël. Ndoshta shkaktari i gjëzimit tim ishte ai shoferi, që e hapi derën e

autobusit tri sekonda përpara se të ndalonte. Sidoqoftë unë isha i gjëzuar dhe as që e mendoja se kjo ditë dhjetori, që po fillonte në mënyrë kaq normale, do të ishte për mua një ditë e jashtëzakonshme, plot tension dhe në mbarim të kësaj dite unë do të isha një i pa-punë, i cili shkon të sqarojë në Komitetin e Partisë shkakun e largimit të tij nga puna.

Shtyva derën prej xhami të kafes dhe u futa bren-da. Dy pastrueset po rregullonin ndenjëset dhe po vi-nin tavllat e duhanit nëpër tryeza. Radioja po jepte lajmet. Te banaku aparati i ekspresit që po nxehet, bënte një zhurmë të këndshme. Banakierja po numëron-te paqetat e cigarëve.

- Mirëmëngjes! — përshëndeta.
- Mirëmëngjes!

Në kuzhinë ishte ndezur drita. Vinte një erë bis-kotash të porsapjekura. Vura pëllëmbët e duarve mbi sipërfaqen e nikeluar të ekspresit dhe nisa të vërvshëlleja.

— Qenke në qejf, — tha banakierja.  
— Ç't'i bësh.  
— Rini, mo.

U hap dera dhe hyri si gjithnjë me nxitim kame-rierja tjetër, mbështjellë me fëshfëshe.

— Qyqja, sa kam vrapiuar. S'donte çuni ta çoja në çerdhe. Ma plasi shpirtin!

Ajo shkoi nga kuzhina të zhvishej. I hoqa duart nga ekspresi dhë shkova dhe unë pas saj.

— Mirëmëngjes, teto Naja! Mirëmëngjes, Diri!  
— Mirëmëngjes, bir!  
— Mirëmëngjes! — tha Diri.

Diri është më e reja dhe më simpatikja në kolek-tivin tonë. Porsa i ka mbushur të gjashtëmbëdhjetat, megjithatë bën kafe të mrekullueshme.

- Si ishte filmi mbrëmë? — pyeti ajo.
- Hata.
- Diri ka sy të bukur.
- Shkojmë sonte bashkë? — i thashë.

Diri qeshi. Kështu qesh gjithmonë kur i them ndonjë gjë të tillë.

— Mos e ngacmo gocën, shejtan! — tha teto Naja.

Kur kemi turnin e dytë, Dirin vjen e merr natën vëllai i madh ose nëna.

Vesha xhaketën e bardhë të shërbimit dhe dola te banaku. Kafeja hapej pas dhjetë minutash. Pastrueset po vendosnin tavllat e fundit. Ekspresi pothuajse që nxehur plotësisht. Radioja jepte muzikë të lehtë, të gëzueshme.

Zakonisht në këtë kohë më pëlqen të mbështet mjekrën në pëllëmbë dhe të vështroj ndenjëset e zbrazëta. Zbratzësia e tyre nuk të sh'akton boshllëk në shpirt. Përkundrazi. Kjo vjen ndoshta sepse e di që do të kalojë pak kohë dhe ato do të mbushen. Në to do të ulen gjithfarë njerëzish.

Tre muaj më parë, kur unë erdha për herë të parë këtu, jo më si klient i zakonshëm, por si një njeri që kërkon të punojë dhe ka me vete një vërtetim nga zyra e punës e Komitetit Ekzekutiv, më kujtohet se më bënë përshtypje karriget. Vetëm se ato ishin karrige verore. Përsa kishte filluar të binte një shi i imët dhe kamarieri bashkë me pastrueset po mblidhnin karriget dhe tryezat e vendosura përjashta, në trotuarin e gjerë përpara kafes. Ishte dita e fundit që shërbehej përjashta. Unë vështroja si mblidhnin karriget e lehta prej alumini dhe plastmasi, si i vendosnin njëra mbi tjetrën, të verdha, të kuqe, të kaltra, ngjyrë kreml. dhe pastaj i çonin diku, prapa perdes, prapa banakut.

— Ja, na erdhi dhe dimri, — tha kamerieri, kur më vuri re. Unë isha futur nën tendën verore prej doku, për t'u mbrojtur nga pikat e shiut. Ngrita supet, pa ditur ç't'i thosha. Te tenda u fut dikush me vrull.

— E, të zuri shiu? — tha kamerieri, që, siç duket, e njihte.

— Lëre, dreqin.

— Mos ta prishi gjë pikturën?

— Jo. E mbulova me kohë.

Tani vura re që i porsaardhuri mbante në njërën dorë kavaletin dhe në tjetrën një kuti, siç duket kutilë e bojërave.

— A ka ndonjë vend në kafe ku ta lë kavaletin?

— pyeti piktori.

— Po si s'ka? — tha kamerieri.

— Ndoshta hap koha nesër dhe vij e vazhdoj.

— Lëre sa të duash, — tha kamerieri, — te ne s'pëson gjë.

— Ç'pikturoni? — e pyeta piktorin.

— Udhëkryqin, — tha ai. — Në perspektivë pallatet e reja që po ndërtohen. Po të hapë koha ndonjë javë, mund ta mbaroj.

Piktori u fut brënda.

— Ka dhjetë ditë që pikturon këtë rrugën tonë, — tha kamerieri, duke hequr dy karriget e fundit. — Rri tek ai vendi, ja, atje, dhe punon, punon gjithë paraditen. As që i bëhet vonë se përbri kalojnë njerëz dhe të gjithë ndalojnë dhe e vështrojnë. Njeri i çuditshëm.

— A është përgjegjësi brenda? — pyeta unë.

— Përgjegjësi? Brënda është. Ç'e do?

— Dua të hyj në punë këtu.

— A, ti je ai kamerieri i ri që do na vijë?

Ai hapi sytë sikur të mos e besonte se unë isha ai kamerieri i ri «që do na vijë» dhe pastaj mblo-dhi buzët i habitur.

Ky gjest qe bërë pér mua i njojur. Që atë ditë, kur, pasi mbarova shkollën e mesme, unë shfaqa dë-shirën të punoja si kamerier në ndonjë kafe, gjersa të më dilte e drejta e studimit pér në universitet, ky gjest më ndiqte kudo. Vura re se këtë gjest njerëzit e bëjnë pak a shumë njëlloj, sikur t'uua ketë mësuar të gjithëve një regjisori. I pari e bëri atë gjest babai im.

Kamerier?! Secili e thoshte këtë fjalë me një nuancë të veçantë. Kamerier? Çudi! Kamerier? Ashtu? Interesant! Kamerier? Stop. Kamerier. Unë vendosa,

s'e luan as topi. Të them të drejtën, ndoshta nuk do të kisha vendosur sikur njerëzit të mos më bënin kaq shumë presion.

— Kamerier? — vazhdonte të thërriste babai si i xhindosur. — Domethënë prandaj luftuam ne, që të na bëhen djemtë kamerierë, kurse ca birbo borgjezësh qëllon që bëhen inxhinierë e doktorë. — (Babai, kur nxehet, e humbte logjikën.) — Domethënë që djali im t'u shërbejë atyre në tryezë, t'u çojë konjak, t'u çojë kafe, t'u çojë tooorta. Si e doni? Me shumë, me pak, ekspres, allaturka. Shërbeju, shërbeju borgjezëve.

— Unë do t'i shërbej popullit dhe jo borgjezëve, — thashë me një ton pompoz. — Puna është nder.

— Aha, paske mësuar dhe citate! Bravo! Bravo!

Që nga ajo ditë babai nuk shkeli më në kafe «Riviera». Kur dëgjon në bisedë e sipër që përmendet ajo, i prishet gjaku. Do që ta bësh me nerva, thuaj që në «Riviera» e bëjnë kafenë të mirë, ose që bleva cigare në «Riviera». Aq më keq po i the se dje pasdite u takova me një shok dhe bëra një copë muhabet në «Riviera». Atëherë e bëre armik.

Kurse mua, puna këtu më pëlqeu që në fillim. Kafe «Riviera» është pothuajse në qendër të qytetit. Klientët që vijnë këtu, janë nga më të ndryshmit. Nuk është si «Parku», ku zakonisht ndalojnë vetëm shofërët, duke lënë përjashta makinat me motor të ndezur, ose «Kafe familjare», ku venë gjithmonë ca gra nevrike që u bërtasin vazhdimisht fëmijëve, të cilët masakrojnë pa mëshirë tortat mbi mbulesën e tryezës, dhe ca burra të urtë që thonë vazhdimisht «të keqen babi», ose si «Bar Krimëja» ku mblidhen natën pijancët dhe dezhurnët e gazetave, ose «Bar Sahati» ku mblidhen pensionistët. Në kafen tonë hyn kushdo, duke filluar nga fshesaxhijtë, që kthejnë ndonjë gotë fërnet para fillimit të punës e gjer te vajzat e viteve të fundit të gjimnazit. Këtu vijnë punëtorë të të gjitha turneve, studentë me libra në duar, çifte të rinjsh dhe pleqsh, tifozë sporti, letrarë të rinj; anëtarë të Komite-

tit Qendror, fshatarë me qeleshe dhe brekushe, doktorë, policë, aktorë teatri dhe ndonjë ministër. Në këtë rast përgjegjësi ynë bëhet i heshtur, i menduar. Ç'është e vërteta, ai nuk është servil, por nuk ka qejf ta kritikosh pér asgjë. Koha gjatë së cilës ministri pi kafenë, atij i duket me siguri e gjatë, sa një shekull.

Kafeja është si deti, ka baticat dhe zbaticat e saj. Mua më pëlqen kur ajo është plot. Më pëlqen të rri te banaku, të vë dorën te mjekra dhe të dëgjoj zhumhurin e ngrrohtë të sallës, të përbërë nga zëra, tingujt e radios, tringëllim gotash, të qeshura të mbytura, fishkëllima të lehta të ekspresit. Xhamat e mëdhenj janë të veshur me avull. Prapa xhamave duket si i deformuar nga avulli udhëkryqi, dritat e mëdha të hotelit përballë, të kuqe dhe të gjelbra, që shuhën e ndizen vazhdimisht, tabela e dyqanit të remontit të frigoriferëve dhe tabloja gjigante e mapos industriale. Kalojnë me një zhurmë të butë veturat, taksitë dhe autobusët urbanë. Nganjëherë avulli në xhamë bëhet kaq i dendur, saqë hoteli, mapoja, udhëkryqi dhe makinat shkrihen si në një tablo të vetme, duke sajuar një pamje fantastike.

Por edhe mëngjeset kanë bukurinë e vet. Dashnoret vijnë zakonisht mëngjeseve. Ata zënë gjithmonë vendet më të thella prapa kthesës, dhe harrohen aty me orë të tërë. Kur ti u çon férnetin ose limonadën, gjithmonë vetëm njëri prej tyre ngre kokën, kurse tjetri e ul.

Më pëlqejnë mëngjeset e dimrit, kur nuk bie shi, por ka mjegull të bardhë mbi qytet. Në mëngjese të tillë nuk të pëlqen të flasësh shumë dhe aq më pak të pëlqen të grindesh.

Atë mëngjes nuk kisha aspak ndër mend të grindesha me njeri. Kafja u hap në orarin e caktuar. Ekspresi qe nxehur. Salla ishte në rregull. Në orën nëntë e gjysmë erdhi si zakonisht përgjegjësi. U përshtendetëm si zakonisht ftohtë. Ai erdhi rrrotull një copë herë, u fut nga kuzhina, pér një kohë të gjatë

u mor me ca formularë, pastaj, pa thënë asgjë iku.

Marrëdhëni e mia me përgjegjësin u acaruan këq një muaj më parë, kur unë kërkova që mbledhjen e kolektivit që të shqyrttonim çështjen e festimit të feje-save në kafenenë tonë.

Ditën e tretë që fillova punën në kafe, shërbëva për herë të parë në një fejesë.

Kur aty nga ora njëmbëdhjetë dikush porositi me telefon disa tryeza pér «një gëzim», unë që bisedoja në telefon me të panjohurin, nuk e kuptova mirë se ç'donte të thoshte dhe e pyeta: «Çfarë gëzim, mor shok?» Ai, siç duket, u hutua dhe, në vend që të më sqaronte, më ngatërrroi më keq. «Alo, përsërita unë, çfarë gëzim, mor shok». Sikur të mos qëllonte aty afér banakierja, do të ishim ngatërruar keq, po ajo e kup-toi menjëherë pér se bëhej fjalë dhe e mori telefonin vetë. Kur mbaroi së biseduari, m'u kthyte mua:

— Ka fejesë, — tha. — Nuk e kupton ç'domethënë gëzim?

— Gëzimi mund të jetë gjithfarësh, — thashë unë.

Ajo buzëqeshi, por mua nuk më pëlqente kjo grua. Në tonin e saj, në fjalët që thoshte, kishte gjithmonë dicka të hidhur, megjithëse ky hidhërim mezi dalohej.

— Ti qëllove të vish te ne në stinën e fejesave, — tha ajo. — Këtej e tutje fejesa do të kemi pothuaj cdo ditë.

— E si bëhen këto fejesa? — pyeta.

— Ja, do të shikosh, — tha ajo dhe buzëqeshi prapë, me një buzëqeshje që ia drejtonte më tepër banakut, sesa atij që bisedonte.

Pas një ore ata erdhën. I pari hyri një djalë i shkurtër, i shëndoshë, flokëkaçurrel, i veshur me pardësy prej stofi. Ai erdhi me hapa të shpejtë te banaku.

— Shoko, kemi porositur disa tryeza, një orë më parë, pér një... rast.

— Si urdhëron, — i thashë unë, — ja ku i keni.

Ai u bëri me shenjë të tjerëve që po hynin njëri pas tjetrit. Mua m'u ngjall ajo kureshtje e zakonshme që i ngjallet çdo njeriu në raste dasmash. Të shohim si do të jetë nusja. Si do të rrrijë në tryezë. Por ata hynë të gjithë dhe filluan të uteshin me zhurmë në-për ndenjëset dhe nuk e kuptova dot kush ishte nusja. Nja dy gra me buzë të kuqe nuk m'u dukën si nuse. Dy të tjerat ishin gra të shkuara në moshë.

— Ku është nusja? — pyeta unë banakieren.

Ajo qeshi.

— Zakonisht nusja dhe dhëndri nuk vijnë, — tha.

— Shpeshherë qëllon që vjen dhëndri, ka dhe raste kur vijnë të dy, por zakonisht nuk vijnë.

Unë bëra një gjest habie.

— Varet nga familjet, — tha ajo. — Për shembull, këta...

Ai kaçurreli i shkurtër, që unë në fillim e mora për dhëndrin, më bëri një shenjë. Unë shkova te tryezat dhe prita në këmbë porosinë e tyre.

— Katër liqere, gjashtë konjakë, torta për të gjithë, limonadë, në fund kafe për të gjithë.

Unë bëra një shenjë me kokë dhe u largova.

Që nga banaku fillova të vështroja me vërejtje atë grumbull njerëzish që atë ditë kishin bëre një mble-sëri dhe tanë po festonin mbarimin me sukses të saj. Ishte vështirë të dalloje njerëzit e burrit nga të nuses. Në krye të vendit kishin vënë një plak të dobët, me një qeleshe të vogël, të bardhë mbi kokë. Plaku nuk fliste fare dhe dukej sikur vazhdimi shi i vinte gjumë. Dy gratë me buzë të kuqe mbanin gjallë bisedën. Ato kishin zëra të ngjirur dhe nervozë. Kaçurreli, që, me sa dukej, ishte më i shkathëti midis tyre, u zgjaste herë pas here paqetën dy burrave të vrenjtur, veshur me kostume dopiolet, siç i qepnin shumë vite më parë. Një djalë flokëzbërdhulur punonte, siç dukej, në ndonjë fermë, sepse fytyrën edhe xhaketën kadife ia

kishte marrë dielli. Dy gra të shkuara në moshë, mjafthë trasha, me shami të bardha, ashtu siç i mbajnë tiranaset, rrinin si të ngrira, me një shprehje enigmatike në fytyrë, tamam si ato gratë indiane në skenat e fudit të filmit «Rroftë Zapata!» aty kur Zapatës i përgatititin kurthin për ta vrarë.

Nuk e di pse, por e gjithë dita më kaloi nën përshtypjen e trishtueshme të kësaj ngjarjeje të vogël, që, për të gjithë personelin e kafesë, ishte krejt e zakonshme.

Por ky ishte vetëm fillimi. Banakierja kishte të drejtë. Tani në kafen tonë pothuajse çdo ditë festohe-shin fejesa. Pamja ishte pothuajse e njëjtë. Kishte dicëka të përbashkët në mënyrën se si hynin këta njerëz, si uleshin në tryeza, si e bënин porosinë. Gjithmonë midis tyre do të ishte ndonjë plak, që dukej sikur i vinte gjumë, ca gra me fytyra të pakuptueshme, gjithmonë midis tyre gjendej ndonjëri që ishte më i shkathëti, ai që porosiste vendet me telefon, ai që zgjaste pa-qetën. Të dukej se të gjitha këto grupe s'ishin gjë tjetër veç trupa e një teatri të vogël, e cila lozta gjithmonë po atë spektakël të varfër, me të vëtmin ndryshim se aktorët ndërronin shpesh kostumet. Kishte dicëka të zymtë dhe të trishtueshme në pamjen e atij grumbulli, që ishin mbledhur të fejonin dy të panjohur. Mund të besoje që këta njerëz ishin mbledhur për çdo gjë, por veç për gjësim jo. Ata më tepër ngjanin si një tribunal. Njëherë kujtova se kështu më dukej mua, ngaqë i mora zët që herën e parë. Por s'ishte kështu. Edhe të tjerëve u bënин përshtypje. Klientët e tryezave të tjera kthenin vazhdimisht kokën në drejtim të tyre, sikur të shikonin një spektakël interesant. Disa shikonin me ironi, disa me keqardhje, të tjerët thjesht bënin sehir, sikur të kishin përpara ndonjë grup qyfyre-xhinjsh.

Dy elektricistë që u kthyen një ditë në kafe për të pirë nga një fërnet te banaku, kur i panë, qeshën.

— Paska dhe këtu të tillë, — tha njëri. — Ne kuj-

tonim se këto gjëra ndodhin vetëm nëpër zonat e prapambetura, po ja që paska dhe këtu!

— Ç'ti bësh, ja që ka, — thashë unë.

Ata morën telat dhe izolatorët e bardhë që i kishin lënë mbi banak dhe, tek po iknin, njëri tha:

— Ne po çojmë dritën elektrike në fshatra të thella. Të ndodhin atje gjëra të tilla, kuuptohet, por këtu... Turp, vallahi!

— Ç'ti bësh? — përsërita unë.

— Ç'ti bësh the? Futi, or babë, kontrollin punëtor, ja ç'ti bësh. Hajt, tungjatjeta!

Kaluan disa ditë dhe, për çudinë time, spektakli ndryshoi një mëngjes papritur. Ndryshimi ishte i plotë. Jo vetëm që festuesit ishin krejt të ndryshëm — këta ishin burra dhe gra, veshur me pardësyra moderne, me këmishë të ngrira dhe flokë të lyer, që flisnin dhe bënnin shakara plot gjallëri — jo vetëm që mungonte në krye të vendit ai plaku i hutuar me qeleshe dhe ato gratë si te filmi i Zapatës, por, për çudinë time më të madhe, midis tyre u shfaq më në fund nusja me dhëndrin. Vetëm një gjë nuk ndryshonte, porosia ishte krejtësisht e njëllojtë: liqere, tortë, konjak, limonadë, në fund kafetë.

Ishte me të vërtetë kënaqësi të shërbeje në festë të tillë. Por s'kaloi as një çerek ore dhe kënaqësia ime u zbeh. Duke shkuar e duke ardhur disa herë në tryezën e tyre, unë kuptova çdo gjë. Nuk ishte vetëm porosia e njëllojtë. E njëllojtë ishte gjithçka. Ndryshonin vetëm kostumet dhe të folurit e kulturuar. Kur çova tortat, më lindi dyshimi i parë, por, kur çova kafetë, u binda plotësisht: Vajza dhe djali nuk e njihnin njëritjetrin. Kjo dukej haptas. Pra, ata ishin fejuar me mblesëri të zakonshme, njëlloj si në zonat e prapambetura malore, njëlloj si tiranasit e vjetër. Ishin po ata, vetëm se burrat, në vend të qelesheve dhe xhaketave kadife, kishin vënë borsalinë dhe kostume terital dhe gratë, në vend të peceve të bardha, i kishin lyer flokët

me perhidrol. Ndjeva përbuzje të thellë për ta. Kur nё fund, pasi bёra llogarinё, ata deshёn të mё jepnin bakshish, unё e refuzova me arrogancё dhe atyre me siguri u bёri shumё pёrshtypje ndryshimi i papritur i sjelljes sime.

Ditёt e tjera vazhdoi po kjo histori. Ishte hera e parё qё gjendesha ballё pёr ballё me kanunin. Gjer atёherё kisha lexuar pёr tё nёpёr libra, gazeta, revista, kisha parё filma dhe kisha dёgjuar konferanca, sidomos pas Fjalimit tё 6 Shkurtit tё shokut Enver, por asnjёherё nuk e mendoja se do ta kisha kanunin kaq pranё. Mё dukej sikur zakonet e vjetra, sidomos kanuni, kishin lidhje gjithmonё me malёsitё dhe kullat e malёsorёve, shumё-shumё me tiranasit e prapambetur, por asnjёherё nuk e mendoja se kanuni do tё vinte tё na ulej kёmbёkryq nё kafe «Riviera», mu nё qendёr tё kryeqytetit tё Republikёs. Kёto fejesa ma prishnin krejt kёnaqёsinё e ditёs. Nuk mё bёnte pёrshtypje kur ato i bёnin familje borgjezёsh apo tё deklasuarish. (Ishte shumё e lehtё t'i njihje ata). Pёrkundrazi. Atёherё isha shumё i qetё. Ata kёshtu kishin bёrё gjithё jetёn dhe kёshtu do tё bёnin, gjersa ta ngrysni kёte jetё. Mё vinte plasje pёr njerёzit tanё.

Njё ditё erdhi njё grup mjaft i gjallё. Dy burra kishin vёnё medaljet, gratё dukeshin si nga Jugu, me ato fytyra tё mprehta, tё pikёlluara, nёn shamitё e zeza.

— Hajde me fund, tё na rrojё Partia! — tha njёri nga burrat dhe ngriti gotёn.

Unё rrija te banaku. Kur ai tha «tё na rrojё Partia!», unё tunda kokёn.

— Hajde ç'vete, — i thashё banakieres.

Banakierja m'i qepi sytё.

Hajde ç'vete, mendova. Kёta njerёz janё besnikё tё Partisё, janё gati tё hidhen nё zjarr pёr tё, por, duke ngritur dolli pёr Partinё as qё u shkon ndёr mend

se në këtë rast veprojnë në kundërshtim me vijën e saj.

Kalonin ditët dhe nuk po mësohesha dot me këto fejesa. Asnjëherë nuk ma merrte mendja se në Tiranë ka kaq shumë djem e vajza që martohen me mblesëri. Prite, po thosha me vete, kur të më vijë këtu ndonjë shoqe e gjimnazit.

Një muaj më parë, midis grupit që festonin fejësën, unë njoha një burrë që banonte në lagjen tonë. Edhe sot e kësaj dite nuk e di ku punon ky burrë. Di vetëm që në lagje është aktivist. Ndoshta punon në ndonjë ministri apo në ndonjë vend tjetër me përgjegjësi, sepse merr pjesë në të gjitha mbledhjet dhe shpesh mban konferenca në lagje. Para ca kohësh ky njeri kishte mbajtur në lagjen tonë një konferencë për emancipimin e gruas. Më kujtohet se ai fliste me zjarr kundër zakoneve prapanike, se përdorte me mjaft shkathësi citate të ndryshme dhe me dhjetëra herë përmendte Kongresin e Pestë të Partisë, Letrën e Haipur, Fjalimin e 6 Shkurtit, revolucionarizmin e shkollës. Ja pra, ky njeri na paskësh ardhur të pinte kafenë e një fejese. Ndoshta fejonte vajzën apo djalin e vet, ndoshta ishte vetëm i afërt i të porsafejuarve, ndoshta ishte mik i njërsës familje apo i tjetrës, këtë gjë nuk e di. Di vetëm që ai ishte atje, që rrufiste me qejf kafenë ekspres dhe as që i shkonte ndër mend të kërkonte, të protestonte, apo thjesht të pyeste përsë dy të fejuarit, shkaktarët e këtij gjëzimi, nuk ndodheshin midis tyre.

Atë ditë unë kërkova mbledhjen e kolektivit. Ngaqë isha bërë me nerva, i shpreha mendimet e mia më mënyrë të çrrregullt, por, sidoqoftë, esencën e thashë qartë: Si shpjegohet që në kohën kur në gjithë vendin tonë po «digjen me zjarr zakonet prapanike», këtu në kafe «Riviera», në qendër të Tiranës, kanuni e ndien veten si në kullën e vet?

Vura re se përgjegjësi më dëgjonte me një buzëqeshje ironike.

— E çfarë duhet bërë sipas jush? — pyeti ai, duke më ndërprerë.

— Unë nuk e di tamam q'duhet bërë, — thashë.

— Di vetëm që diçka duhet bërë. Patjetër duhet bërë diçka.

— Për shembull. — Toni i akullt i përgjegjësit më bënte më shumë nervoz.

— T'i ndalojmë këto gjëra, — thashë shpejt e shpejt, — të mos u shërbejmë. Të vendosim një tabelë, ku të shkruhet se në kafen tonë nuk pranohet festimi i feje-save me mblesëri. Ose...

— Hh, — ia bëri përgjegjësi, — e si t'i kuptojmë cilat janë fejesat me mblesëri dhe cilat pa mblesëri? Mos ka ndonjë barometër?

Dukej hapur që donte të tallej me mua. Më vinte inat që gjeti diçka ku mund të më kapte dhe unë nuk isha kaq gjakftohtë sa t'i përgjigjesha si duhej.

— Po ja, — thashë, — s'është vështirë t'i kuptosh. Domethënë duket menjëherë qartë, si ta them.

— Këto janë aventura, — tha përgjegjësi me një ton të ftohtë. — Nga ne kërkohet që të bëjmë çdo gjë pér t'i shërbyer më mirë popullit, kurse ky këtu po na propozon mënyra si ta mërzitim popullin. Ti do që pér një javë të dëbojmë gjysmën e klientelës. Po planin? Kush do ta realizojë planin? Mariika?

— Ta shikosh çështjen në këtë prizëm, do të thotë të biesh në ekonomizëm, — ndërhyra unë. Ç'është e vërteta, kuptimin e këtij termi porsa e kisha mësuar një ditë përpara nga dy shokë të mi që punonin në uzinën «Tirana» dhe që më tregonin rastësisht ç'u diskutua në një mbledhje të tyre.

Përgjegjësi tendosi qafën.

— A, gjer këtu, — tha ai. — Mos u mundo të më

futësh në kallëpe mua. S'di unë nga ato ekonomizma e impresionizma.

Një copë herë i hëngrëm me fjalë.

— Megjithatë, ja ku është kolektivi, — tha më në fund përgjegjësi. — Le të flasin shokët.

Ata po rrinin pérrethi të heshtur. Teto Naja me sy tē butë dukej sikur thoshte: «Ç'janë këto sherre, more bij!» Ajo, cdo njeri që fliste në mbledhje, e vështronë me dhëmshuri. Edhe kur dy veta grindeshin dhe kishin mendime krejt të kundërta, ajo tē dy i vështronë me dhëmshuri. Banakierja i mbante sytë ulur. Kamerieres tjetër dukej që as i interesonte fare kjo punë dhe mezi priste sa tē mbaronte mbledhja e të shkonte pér tē marrë çunin në çerdhe. Dy pastrueset rrinin si tē nemitura, në fund fare. Vetëm Diri më vështronë me ëmbëlsi dhe dukej që më jepte tē drejtë, por nuk kishte guxim tē fliste. Siç ma shpjegoi më vonë, ajo nuk kishte frikë nga përgjegjësi, por i dukej sikur do ta quanin vajzë tē shturur, në qoftë se do tē ngrihej kundër fejesave me mblesëri.

— Përgjegjësi ka tē drejtë, — tha banakierja. — Ne duhet t'i shërbejmë sa më mirë popullit dhe jo ta mërzitim atë. Në qoftë se ne do tē vinim tabela tē tillë, siç porositi shoku, do tē diskreditonim lokalin dhe vreten tonë.

— Tjetër, kush e do fjalën? — tha përgjegjësi.

Asnjieri nuk po fliste.

— Thoni mendimin tuaj, — tha përgjegjësi. — Cdo njeri mund tē shfaqë mendimin e vet. Kjo është mbledhje e kolektivit. Kolektivi vendos pér cdo gjë. Edhe në qoftë se shoku pati një mendim tē gabuar, kolektivi e ndreq. Apo jo? Si thua ti, teto Naja?

Teto Naja kishte vënë duart e buta e tē bardha mbi prehër.

— Më e mira u bëftë, — tha ajo me zë tē butë. — Të gjithë pér tē mirë përpinqeni, bijtë e nënës. Më e mira do bëhet, — dhe na pa tē dy me dhëmshuri.

— Po ju? — pyeti përgjegjësi pastrueset. A' sec lëvizën buzët, por nuk u dëgjua ç'thanë.

— Folni më fort, — tha përgjegjësi.

— Populli të kënaqet sa më shumë. T'i bëhen gjithë shërbimet. Ne, si pastruese, përpinqemi që populli të kënaqet. Ne marrim angazhim.

Me kaq mbledhja u mbyll. Mbledhje më të çuditshme s'kisha parë ndonjëherë në jetën time. Hoqa xhatetë e shërbimit, numërova paratë, vesha pardësynë dhe dola. Pas shirave të vazhdueshme, jashtë kishte dali dielli. Trotuaret ishin plot. Në stacionet kishte grumbuj të mëdhenj njerëzish që prisnin autobusët. Duke ecur me shpejtësi në trotuar, e ndieja që po qetësohenha.

— Me shumë vrap e ke marrë, — më foli dikush. Ktheva kokën. Ishte polici që rri pranë udhëkryqit. Shpesh qëllojmë që e kemi turnin e shërbimit bashkë.

— Për ku nxiton?

— Në shtëpi, — i thashë.

— E paskemi rrugën bashkë, — tha ai.

Si bëmë një copë rrugë, polici më tha duke buzëqeshur:

— Si shumë i menduar dukesh sot.

Në fillim nuk desha të flisja fare për mbledhjen, pastaj papritur desha të zbrazesha dhe ia thashë të gjitha politit. Ai më dëgjoi me shumë vëmendje. Sytë e tij bojë hiri u bënë seriozë. Megjithatë nuk kuptoja asgjë nga shprehja e tyre.

— Hë, si mendoni ti? — i thashë. — Unë këto gjëra nuk i duroj dot. Ta kisha në dorë unë, i ndaloja me ligj, me polici, apo, siç thuhet në marksizëm, me dhunë.

Polici ndaloi.

— Këtu gabove — tha me ton të thatë. — Shteti, mor djalë, ka rregulla. Policia është vënë të mbrojë rregullat e shtetit dhe jo të ndërhyjë në çështjet personale të qytetarëve, siç janë fejesat.

— Nejse, nuk e thashë me kuptimin direkt, ndër-

hyra unë. — Dua të them që për këto gjëra nuk duhet të rrimë duarkyq. Diçka duhet bërë. Apo jo?

— Çfarë ke ndër mend kur thua «diçka duhet bërë?», — më pyeti ai me një ton akoma më të thatë. — Skandale?

— Çfarë kam ndër mend? Po, sipas teje, është normale që në kafe «Riviera» në qendër të kryeqytetit të Republikës Popullore të Shqipërisë, vlon mblesëria si në kohë të Baba Qemos?

— Nuk thashë se është normale, — tha polici, — por shteti ka rregulla. A ka midis të fejuarve vajza që nuk kanë mbushur moshën ligjore përmartesë? A ka rrëmbime femrash, martesë me përdhunë, me kërcënim, siç parashikon kodi penal? Ka të tilla në kafen tuaj? Atëherë ti vrapo te ky babaxhani këtu, — (polici tregoi me gisht gjoksin), — dhe do shikosh se ç'do të bëj. Për të tjerat, mendohu mirë, para se të ndërmarrësh ndonjë hap të pamendar. Këto punë nuk zgjidhen me skandale.

Me sa duket, me policin nuk u morëm dot vesh. Ndoshata ai më keqkuptoi dhe kujtoi se unë përgatiteha të bëja ndonjë skandal. Ndoshata unë nuk i shpjegova dot mirë punën, ngaqë, duke treguar, u nevrikosa përsëri dhe, kur ai më përmendi dy-tri herë fjalën «skandal», unë nuk i kundërshtova.

Ditët e tjera as që e hapa më këtë bisedë me njëri. Në fund të fundit, ç'më duhet mua, mendova. Ndoshata unë e teproj pak.

Ato ditë që u hap koha, filloi të vinte përsëri ai piktori që e la atëherë kavaletin në kafe. Pasi pinte një kafe, e vendoste kavaletin mu në trotuar dhe pikturonte rrugën. Një ditë e zuri përsëri shiu dhe përsëri e solli kavaletin te ne. Piktura ishte në mbarim e sipër.

— Çdo të pikturosh, pasi të mbarosh këtë? — e pyeta.

Piktori ngriti supet.

— E di, — i thashë, — të të propozoj unë një temë? Është shumë interesante.

— Hë, — ia bëri ai duke rrufisur kafenë, — më duhet vërtet një temë për në ekspozitën e ardhshme.

— Dëgjo, — i thashë, — shpeshherë, këtu në kafen tonë, vijnë për të pirë «kafenë e fejesës» ata që fejojnë vajzat dhe djemtë me mblesëri. — Dalngadalë, duke folur mua m'u zgjua inati i parë dhe tanë po i flisja me pasion të madh. I thashë si mund t'i pikturonte ai fytyrat e tyre të mpira nga fanatzimi, si mund t'i vendoste njërin pas tjetrit varg, si një rresht i zi inkvizitorësh, apo korbash të botës së vjetër, apo sfinksash. I thashë se mund të bënte një tablo që do ta kishte zili dhe El Greko, po të ishte gjallë.

Ai më dëgjoi me indiferencë.

— Sështë aq e thjeshtë, — tha më në fund, kur unë mbarova së foluri.

— Pse? — pyeta. Gjithë entuziazmi im u ftoh pëpritur nga indiferenca e tij.

— Më jep një «Luks» blu, — tha ai, dhe një copë herë u mor me çakmakun që nuk po i ndizej. — Ti pyet «pse», — tha duke vërtitur cigaren nga njëra qoshe e buzëve në tjetren.

Unë po prisja ç'do të thoshte. Më në fund ai e ndezi cigaren dhe e thithi fort.

— Para se t'i përgjigjim pyetjes sate, po të bëj unë një pyetje, — tha pastaj. — Ja, ta zëmë se unë kompozova një tablo sipas idesë sate dhe ta zëmë se figurat dolën ashtu siç the ti, domethënë si një grumbull korbash apo sfinksash apo faraonësh, merre si ta duash. Pra, ta zëmë se unë i pikturova gjithë këto mbeturina të botës së vjetër, ashtu siç the ti dhe do ta paraqit tablonë në ekspozitë. Spektatori me të drejtë mund të pyesë: «Ku është këtu pozitivja, e reja që ka lindur dhe që i kundërvihet së vjetrës që po vdes? Në ç'proporcione janë? Më thuaj, të lutem, një çikë?»

— E reja? Pozitivja? — Të them të drejtën, u hutova pak nga pyetja e tij dhe dy-tri herë përsërita këto dy fjallë.

— E shikon, i dashur? — buzëqeshi ai i kënaqur. —

Eshtë punë e ngatërruar kjo. S'është si puna e kafesë, e bën ekspres apo allaturka, me shumë ose me pak. Këtij i thonë art. Të vjen koka vërdallë. Ptu, dreq çakmak! Më duket se m'u prish prapë. Ke ndonjë çikë benzinë?

— Jo.

Unë po përpinqesha të sillja ndër mend ç'kisha mësuar në shkollë për realizmin socialist, por nuk po më kujtohej si qëndronte puna e pozitives dhe negatives.

— Dëgjo, — i thashë, — unë jam kamerier dhe nuk i di ato rregullat tuaja, po sidoqoftë di të them një gjë: në qoftë se ti do të pikturoje një tablo të tillë dhe në qoftë se kjo tablo do të vendosej ja, mu këtu, në këtë kafe, atëherë askush nuk do të guxonte të vinte këtu për të festuar fejesa të tilla, të pleksura si pas zakoneve të vjetra. Apo s'është kështu?

— Mund të jetë kështu.

— Atëherë, në qoftë se pranojmë se është kështu, do të thotë se kjo tablo i shërben popullit dhe, në qoftë se piktura jote i shërben çështjes së popullit e të Partisë, ç'më duhen mua ato rregullat që keni mësuar ju në shkollë?

Piktori buzëqeshi dhe tundi kokën:

— Këtu gabon, i dashur. Edhe unë jam dakord me ty që, po të vihej një tablo e tillë në këtë kafe, nuk do të bëheshin më këtu festime fejesash të tilla të shëmtura, por kjo nuk është gjithçka. Kjo është ana utilitarë e çështjes. Për hir të kësaj ane praktike nuk mund të shkelim parimet.

— E ku shkelen parimet? — ngula këmbë unë me kokëfortësi.

— Parimet shkelen me të dyja këmbët, — vazhdoi ai. — Unë po të bëj një pyetje: Ç'përfqaqëson ai grumbull njerëzish që vjen e bën fejesa në kafen tuaj? Asgjë të rëndësishme në krahasim me jetën e vrullshme të qindra mijëra punonjësve në vendin tonë. Kurse ti mendon që unë ti vë ata në qendrën e veprës sime. E pse? Që në kafen tuaj të mos bëhen më fejesa

të tilla. Por duhet ta dish se arti është pasqyrë e gjith-anshme e jetës dhe nuk është si ajo tabela «Mos pë-shtyni përtokë» që vihet në ndonjë lokal.

Të them të drejtën, e ndieja që ai kishte të drejtë, megjithëse jo plotësisht. Më vinte inat me veten që nuk isha në gjendje t'i kundërshtoja asgjë nga ato që thoshte, sepse më dukej që edhe ai nuk e shpjegonte çdo gjë ashtu si duhej.

Diskutimin tonë e preu një grumbull klientësh që hynë bashkë tërë zëra dhe zhurmë. M'u dukën si shofërë.

— Kamerier, gjashtë dopio fernet!

Çova fernetat dhe u ktheva te banaku. Piktori kishte ikur. Ndoshita ai ka të drejtë, mendova për një çast. Ndoshita unë i zmadhoj gjérat, ngaqë jam i nxitar dhe gjaknxehtë. Si shumë vëmendje i kisha kushtuar kësaj punës së kafeve të fejesave. Ndoshita e gjithë kjo duhej părë më me gjakftohtësi. Ç'është e vërteta, përreth jeta vlonë me vrull. Mijëra të rinj e të reja dashuroheshin, pa pyetur për asgjë. E ç'u bë në qoftë se ca budallenjve u pëlqen akoma mblesëria? Mos vallë kjo do të pengojë socializmin? Pas pak në kafe do të kishte një vërshim të ri klientësh. Do të pinin kafenë e mëngjesit gazetarët e organeve qendrore. Ata gjithashtu tregonin shumë qyfyre. Pastaj punëtorët që e kanë turnin pasdite. Studentë që kanë dy orë bosh. Në krahasim me gjithë këtë masë njerëzish, ata të fejesave ishin një pakicë e parëndësishme. Pastaj, kohët e fundit sikur kishin filluar të rralloheshin pak. Ja, do të mbaronte sezoni i dimrit dhe ndoshita ato do të pakësoheshin fare. Pastaj, në fund të fundit, ç'më duhet mua? A nuk mjaftonin konferencat, shtypi dhe librat për të riedukuar njerëzit me mbeturina? Ndoshita kjo nuk ishte puna ime.

Në përgjithësi, ditët e fundit unë kisha një gjendje shpirtërore të qetë. Bile përgjegjësi më lavdëroi tërthorazi në mbledhjen e fundit, «Ka dhe ndonjë shok që në fillim pati disa koncepte të gabuara në lidhje me

shërbimin ndaj popullit, tha ai, por kolektivi e ndihmoi me vërejtjet e tij dhe tanj ky shok po përmirësos het.» Megjithëse përgjegjësi nuk e tha emrin, ishte e qartë si drita e diellit se ky shok isha unë.

Kështu pra, rebelimi im kundër zakonit ishte duke u shuar përfundimisht dhe atë ditë dhjetori, kur unë isha në një humor kaq të mirë, më pak se kurrë më shkonte ndër mend të grindeshë me dikë.

Humori im nuk u prish as aty nga ora njëmbëdhjetë, kur dikush lajmëroi me telefon për një fejesë. Po rregulloja ndenjëset dhe tryezat me qetësinë më të madhe. S'e kisha aspak mendjen në punën që po bëja, por isha gjithë merak si do të mbaronte pasdite ndeshja e «17 Nëntorit» me Shkodrën. Nuk e kisha mbaruar akoma rregullimin e tryezave, kur në kafe hyri si veri përgjegjësi.

— A lajmëruan për një fejesë? — pyeti banakier.

— Po. Ja, po rregullojmë vendet.

Ai u hodhi një sy shpejt e shpejt tryezave, më bëri një vërejtje për pozicionin e dy ndenjëseve dhe pastaj u fut në kuzhinë. Ishte i merakosur.

Unë i bëra një shenjë me sy banakieres, me kuptimin «ç'të ketë ky?», por ajo bëri sikur s'më kuptotoi.

Përgjegjësi nuk iku, siç bënte zakonisht, pasi i hidhte një sy gjendjes. Ai qëndroi te banaku i menduar dhe ndezi një cigare. Herë pas here vinte dorën tek aparati i ekspresit, sikur të kishte frikë se mos ai ftohej papritur.

Në orën dymbëdhjetë, te dera e kafes, u duk përmes avullit të xhamave një grumbull njerëzish që po bëheshin gati të hynin. Përgjegjësi u doli menjëherë përparrë dhe hapi derën.

— Urdhëroni, — tha, — urdhëroni, shoku Jani!

Njerëzit hynë njëri pas tjetrit, duke buzëqeshur dhe duke i vënë dorën te krahu shoku-shokut, për ta

futur para vetes. Tani e kuptova përse përgjegjësi ishte në telash. Shoku Jani punonte në Ministrinë e Tregtisë, ku, me sa duket, drejtonte një sektor të rëndësi-shëm. Unë e kisha njojur një muaj më parë, kur kishite ardhur për të pirë një kafe me një shok të tij. Ai më pyeti atëherë diçka për gramaturën e kafesë dhe, kur unë, krejt i habitur nga pyetja, ia tregova këtë gjë banakieres, ajo më shpjegoi se ai është shef në ministri dhe i di këto gjëra.

Ata zunë vend rrith e rrrotull tryezave. Ishin dhe vajza me djalin. Vajza e mbante kokën ulur, megjithëse dukej një vajzë e zakonshme kryeqytetase. Shokun Jani e vunë në krye të vendit. Ndërsa ata po zinin vendet, unë po vrisja mendjen të kuptoja se cilët ishin njerëzit e vajzës dhe cilët të djalit dhe ç'lidhje kishte shoku Jani me ta.

Përgjegjësi, i cili i kishte shoqëruar ata gjer te vendi, ma bëri me shenjë të afrohesha. Unë u afrova. Tani po i shikoja mirë. Shoku Jani ishte tepër indiferent. Me sa dukej, nuk kishte ndonjë lidhje të afërt farefisnore me të porsafejuarit. Pranë tij qe ulur një burrë i dobët me syze të mëdha, që fliste dhe bënte vazhdimisht gjeste tërë gëzim. Pastaj vinin ca gra të bëshme, ca burra të rinj me kostume të qepura bukur dhe nja dy djem të moshës sime. Ja dhe nusja. Ajo dukej shumë simpatike, me flokët e ndarë më dysh sipas modës, por e mbante kokën ulur dhe nuk e shikoja dot mirë. Kur unë bëra pyetjen e zakonshme «ç'urdhëroni?», ajo ngriti një sekondë kokën dhe unë u habita dhe u bëra gati ta përshëndetja, por ajo e uli prapë kokën.

— Ç'urdhëroni? — përsërita prapë pyetjen.

Unë atë vajzë e njihja. Në atë sekondë që ajo uli kokën, hodha sytë vetëtimthi në krah të saj. Djali ishte me një moshë të pjekur. Flokët sa kishin filluar t'i rralloheshin. Ca flokë të zinj të valëzuar lehtë, me një vijë të ndarë nga e majta, ashtu siç i mbajnë zakonisht brezi përpara nesh.

— Shkruaj; shtatë konjakë, katër likere, apo doni vermut? Prit.

Unë atë djalë e shihja për herë të parë. Kurse vajzën e njihja. Ajo e mbante kokën ulur dhe unë i kisha ngulur sytë me ngulm mbi flokët e saj të drejtë, me një ngjyrëgështenjë të celur, me një nuancë bronzi që herë dukej më shumë, herë më pak, sipas reflekseve të dritës.

— Atëherë dy likere, dy vermut.

Unë doja që ajo të ngrinte kokën. Jo për ta përshëndetur. Aspak. Dëshira për ta përshëndetur m'u zhduk menjëherë. Unë doja të dija përse ajo e bëri këtë gjë.

— Njëmbëdhjetë torta. Katër, pesë, gjashtë, gjashtë limonada dhe pesë lëng portokalli.

Vajza vazhdonte ta mbante kokën ulur. Njeriu i dobët me syze të mëdha po i zgjaste cigare shokut Jani. Vajza fshinte me gisht diçka të paqenë mbi syprinën e gjelbër prej plastmasi të tryezës. Ndjeva se njëri nga ata burrat e rinj më vështronte me vërejtje dhe i hoqa menjëherë sytë prej saj.

— Kafe për të gjithë? — përsërita automatikisht.

— Po. Katër me pak. Të tjerat të zakonshme. Jo. Pardon. Dy me shumë sheqer. Për rininë. Edhe ti e do me shumë? Tri, atëherë.

U largova.

— Pak më i gjallë, — më pëshpëriti përgjegjësi te banaku me një buzëqeshje artificiale, duke vënë njérën dorë te krahu im. — Dhe mos rri i vrenjtur.

Pa i kthyer atij përgjigje, i dhashë banakieres fletë e porosissë.

Kjo vajzë kishte qenë për herë të fundit në kafen tonë para dy javësh. Ajo vinte gjithmonë këtu me një djalë, student. Edhe herën e fundit ishte me të.

Gjatë gjithë kohës së shërbimit tim në kafe «Riviera», nga klientët e përhershëm këta të dy ishin më të këndshmit. Ata vinin zakonisht mëngjeseve, kur, siç duket, kishin pushim. Uleshin gjithmonë në anën e djathtë, në qoshen më të largët, me shpinë të kthyer

**nga salla, pér tē mos i parē njeri.** Aty seq pëshpëritnin kokë më kokë me njëri-tjetrin. Kur unë shkoja t'i pyesja çfarë do tē merrnin ata më përshëndetnin me buzëqeshje intime. Me këtë buzëqeshje ata pranonin se unë isha pér ta një nga njerëzit që dija në vija tē përgjithshme tē fshehtën e tyre. Ajo porosiste gjithmonë kasatë. Ai fërnet. Ai pinte vazhdimisht cigare. Ajo e vështronte si ai nxirrte tymin. Njëherë pashë rastësish se si ajo uli kokën dhe ai ia la ta thithte një herë cigaren e tij. Dukej që duheshin.

Herën e fundit, para dy javësh, porsa hynë, e kup-tova se kishte ndodhur diçka. Të dy ishin bërë qull nga shiu. Asaj i ishin bërë flokët si fitila tē gjatë. Ai më bëri një përshëndetje tē ftohtë dhe shkuan e u ulën tē dy në vendin e zakonshëm. Nuk i hoqën pardësytë. Kur unë shkova pér tē marrë porosinë, ajo e mbante kokën ulur, kurse ai pinte cigare dhe vështronte një cep tē tryezës. Nuk flisnin.

— Si gjithmonë, — tha ai pa ngritur sytë. Dukej që kishte ndodhur diçka. Edhe kur çova porosinë, gjendja ishte po ajo. Ajo dukej e zbehtë, e lodhur. Ai ishte prerë në fytyrë.

Pas një ore ai erdhi te banaku tē paguante, ndërsa ajo po dilte nga dera. Ai i shkoi pas. Unë shkova tē pastroja tryezën. Tavlla ishte mbushur plot bishta cigaresh. Asnjëherë nuk e besoja se një njeri mund tē pinte kaq cigare brenda një ore. Syprina e tryezës ishte bërë pis nga hiri, bloza dhe pikat e shiut që kishin kulluar prej flokëve tē saj. Siç dukej, ai i kishte shuar cigaret drejt e mbi tryezë. Ajo nuk e kishte prekur fare kasatën dhe tanë kasata kishte filluar tē shkri-hej, duke krijuar në pjatë një pellg tē vogël tē turbulent, ngjyrëbezhë.

E pastrova me leckë tryezën dhe, kur plastmasi i saj shkëlqeua përsëri si më parë, ndjeva diçka tē çuditshme në shpirt, ndjeva se diçka u fshi përgjithmonë.

Dhe vërtet, që nga ajo ditë ata nuk erdhën më. Sot ishte hera e parë që po e shikoja përsëri atë vajzë.

— Pak më i qeshur, — më tha prapë përgjegjësi, tek po e ndihmonte banakieren të vendoste në tabaka gotat e vogla me konjak, liker dhe vermut. — Ti je rini, si ka thënë ai, Çajupi? «Qeshu, rini, qeshu bota eshtë e jote».

«Ç'pykë!» mendova.

Me tabakanë në dorë u afrova te tryezat. Një nga gratë i thoshte asaj diçka dhe ajo buzëqeshte, me një buzëqeshje të copëtuar. Porsa më pa që u afrova, e uli përsëri kokën. Të tjerët bisedonin me njëritjetrin, dy nga dy, tre nga tre. E ndjeva se njëri nga ata burrat e rinj nuk m'i ndante sytë, ndërsa unë po vështroja gotat në tryezë. I hoqa sytë nga vajza e u përpoqa të isha i qetë.

— Cigare «Arbëria» keni? — pyeti burri i dobët me syze.

Unë pohova me kokë. Dikush i ndezi cigaren dhëndrit. Nga mënyra se si i jepte pak kokës prapa kur nxirretymin dhe si e vinte cigaren në buzë, dukej që nuk e pinte.

Ky me siguri i ka të gjitha punët në rregull, mendova. Punë të mirë në Tiranë, apartament të rregulluar, televizor «Orion», makinë larëse superautomatike «Candy», ndonjë rrogë nëntëqindlekshe. Kurse ai tjetri ka vetëm cigaret që ndez njérën pas tjetrës, treqind lekët e bursës së studentit.... Familja e saj i ka bërë hesapet mirë. Kushedi c'presion ka bërë mbi vajzën, gjersa e detyroi të heqë dorë nga dashuria.

Kur çova tortat, në tryezat kishte krisur muhabeti. Gratë kishin ndezur cigare. Ajo dukej sikur e kishte marrë veten. Dikush i ngaomonte të dy të porsafejuarit dhe ata buzëqeshnin. Ai e vështronte me embëlsi dhe ajo vazhdimisht fshinte me gisht syprinën e tryezës. Kur unë lëshova tortën përpara saj, ajo ngriti sytë për një çast fare të shkurtër dhe i uli përnjëherësh. Buzëqeshja iu pre. Ai burri i ri që nuk m'i ndante sytë, i tha diçka shokut të tij përbri dhe tani sytë e të

dyve, që më dukeshin mjافت dinakë, filluan të rrëshqit-nin me shpejtësi nga unë tek ajo dhe anasjelltas.

Burri i dobët seç thoshte me fjalë e me gjeste dhe ata që ishin pranë tij shqyheshin gazit. Shoku Jani gjithashtu qeshte, por e qeshura e tij ishte e përmبajtur dhe me pahir.

— E dini, shoku Jani, ç'na bëri Xhaferri në mbledhjen e këshillit teknik?

Unë, porsa vendosa tortën e fundit, u largova.

Te banaku përgjegjësi dhe banakierja që, siç duket, diçka kishin biseduar midis tyre, po më vështro-nin me ngulm. Kam shumë inat kur njerëzit, pasi kanë thënë diçka për ty, fillojnë e të ngulin sytë. Sidomos kur sytë e tyre s'të pëlqejnë. Unë isha gjithë nerva dhe përgjegjësi u mat të thoshte diçka, por pastaj ndërrroi mendje. Banakierja filloi të përgatiste limonadat dhe shurupet. Unë desha ta hiqja mendjen nga të gjitha këto. Radioja po jepte lajmet e brendshme. U përpoqa ta përqendroja vëmendjen në fjalët e spikerit. Po jepte diçka për elektrifikimin në një zonë të largët malore. Një kooperativë blegtoreale kishte ndërtuar një model të ri shtallash për lopët. Ishin shtuar vatrat e kulturës të rrethit të Fierit. Tani mund të ketë diçka për zakonet prapanike andej tutje nga Dukagjini apo Kelmendi. Bukur besa. Gazetarët dhe reporterët udhë-tojnë me qindra kilometra rrugë pa rrugë për të gjurmuar zakonet e këqija nëpër male dhe humnera. Kur-se këtu, ku ata pijnë kafenë çdo mëngjes, nuk shohin c'bëhet.

— Gati limonadat, — tha banakierja.

I vendosa gotat me limonadë dhe shurup në tabaka dhe i çova te tryezat e festës. Ky shërbim po më dukej shumë i gjatë. Mezi po prisja sa të mbaronte. Pas limonadave ishin kafetë dhe pastaj pagesa. Ora e kishte kaluar njëshin. Kafja pothuajse tani ishte bosh. Kamerierja tjetër rrinte prapa banakut e menduar. Herë pas here diçka i thoshte banakieres. Dy-tri herë do-li edhe Diri që nga kuzhina, për të parë nusen. Radioja jepte muzikë të lehtë. Hyri një burrë i trashë dhe piu

në këmbë një ujë me sifon. Tani avulli në xhamat e mëdhenj nuk e kishte më atë dendësinë e parë dhe midis të çarave të mëdha, që ishin hapur vende-vende, dukej udhëkryqi, kalimtarët me ombrella në duar, urbanët e kuq që e merrnin kthesën ngadalë dhe taksitë që shpejtonin drejt stacionit hekurudhor. Po e përqendroja vëmendjen në të gjitha këto, duke u përpjekur ta harroja atë çka bëhej brenda në kafe. Por kjo nuk vazhdoi gjatë.

— Ej, kamerier! — më thirrën dy-tri zëra andej nga tryezat.

— Po të thérresin, — tha banakierja.

— Pa shiko, c'kérkojnë, — tha përgjegjësi.

Duke i hedhur hapat me përtim, u afrova te tryezat.

— Ç'urdhéroni?

— Na i këmbe këto dy limonada me lëng portokalli, — tha njéri nga burrat.

Për një sekondë unë nuk fola.

— Po s'ka gjë, — thanë dy gratë, gotat e së cilave, me sa dukej, propozoheshin për t'u këmbyer. — S'ka gjë, po pimë limonadë.

— Pse? — nguli këmbë njeriu që foli i pari. — Provjeni lëngun e portokallit, gjersa ju pëlqen.

— Është i mrekullueshëm, — tha një tjetër.

— Atëherë na i këmbe këto dy limonada.

— Unë i solla siç i keni porositur, — thashë me ftohtësi. — Mund t'ju sjell dy lëng portokalli, por pa i këmbyer.

— C'domethënë kjo?

— Kjo domethënë që ju do t'i paguani.

E kuptova dhe vetë që e teaprova, por s'kisha ç'të bëja. Isha shumë nervoz. Po rrija në këmbë në një pozitë shumë të vështirë. E fejuara ngriti një herë sytë drejt meje dhe i hoqi përnjëherësh. Në vështrimin e saj kishte diçka midis frikës dhe lutjes. M'u duk se jo vetëm atyre dy burrave të rinj, por edhe një gruaje, dhe dikujt tjetër, u ra në sy ky vështrim i saj. Tani shumica e tyre nuk m'i ndanin sytë. Bile dhe shoku Jani.

— E mirë, mirë, — tha dikush, — i paguajmë.

— Dy lëng portokalli, — i thashë banakieres. Përgjegjësi u mat përsëri të më thoshte diçka, por nuk foli. Në sytë e tij kishte shqetësim.

Mua nuk më hiqeshin nga mendja sytë e vajzës së fejuar. Dreqi e mori, kjo vajzë më pëlqente. Me sa duket, ajo mua më kishte pëlqyer qysh atëherë kur vinte me atë tjetrin, por kjo ndjenjë kishte qenë atëherë kaq e fshehtë, saqë unë nuk ia kisha pohuar as vete, sepse ajo kishte një djalë dhe atë e donte, dhe ndjenja ime ishte aq e tymtë, saqë unë as që bëhesha xheloz për atë djalin student, përkundrazi më pëlqente që ata duheshin me njëri-tjetrin. Por tani që ajo ishte shkëputur kaq lehtë prej tij, tani që ajo i përkiste një tjetri, një të huaji fare, ndjenja ime u bë papritur e qartë, si ata xhamat kur pastrohen nga avulli.

Banakierja vuri gotat me lëng portokalli mbi banak dhe unë i vendosa në tabaka. Kur i çova, atje ishte bërë pothuaj heshtje. Duke lënë gotat në tryezë, këtë herë krejt padashur, ndoshta nga shkaku se doja ta bëja këtë punë sa më shpejt dhe të largohesha sa më parë andej, e përplasa pak njérën prej gotave dhe lengu i portokallit u derdh anash, mbi dörën time.

— More shok, ç'është kështu me ty? — tha njëra nga gratë.

Unë murmurita diçka nëpër dhëmbë dhe ndjeva se si mbi mua u ngulën shikimet e të gjithëve. E fejuara u zbeh. Në ato shikime kishte protestë, pakënaqësi dhe dyshim.

Duke u larguar, unë ndjeva prapa shpinës zërat e tyre. Ata seç thanë për shërbimin e keq, për sjelljen time me ta, sikur «të më kishin vrarë babanë» dhe diçka që unë s'e dëgjova, sepse isha larguar mjaft.

— C'ndodhi? — pyeti përgjegjësi, që përgjonte çdo gjë nga banaku.

— Asgjë, thashë.

— Pse je prishur në fytyrë?

Unë ngrita supet.

Në këtë kohë njëri nga ata dy burrat e rinj që më shikonin me dyshim, erdhi te banaku.

— Ju jeni përgjegjësi i kafes? — pyeti ai me zë të ulët përgjegjësin.

— Po.

— Ju lutem, një minutë.

Ata u tërhoqën të dy mënjanë dhe për disa minuta rresht seç dhanë e morën me njëri-tjetrin. Më në fund, ai burri iku, pa kthyer as kokën nga unë. E ndoqua me bisht të syrit. Shkoi e u ul në tryezë dhe filloj t'i thoshte diçka shokut të tij përbri. Tani vura re që edhe dhëndri m'i kishte ngulur sytë që nga larg. Ai ishte i ngrysur në fytyrë.

— Dëgjo, — më tha përgjegjësi me zë të ulët, — kam një fjalë.

Ne u tërhoqëm mënjanë që të mos dëgjonin banakierja e kamerierja, që për herë të parë e shikoja të bëhej kureshtare për diçka. Përgjegjësi m'i nguli sytë në mënyrë të bezdissħme.

— E njeh ti atë vajzë që po fejohet? — pyeti, pa m'i hequr sytë.

Unë s'u përgjigja.

— Po të pyes, — përsëriti ai. — E njeh këtë vajzë?

— Siç duket, po dyshojnë njerëzit e burrit, — thashë me ironi. Këtë zbulim e bëra në çast. Me siguri ata po dyshonin për mua. Me siguri ata do të kishin dëgjuar se kjo vajzë ka pasur marrëdhënie me ndonjë djalë dhe e kishin bërë veshin të shurdhër për këtë gjë, siç ndodh zakonisht në këto raste. Mirëpo tanë, duke parë sjelljen time të çuditshme, duke parë dhe qëndrimin e saj në tryezë, kanë kujtar ndoshta se ai djali jam unë, ose, të paktën, jam ndonjë shok i tij i ngushtë. Ç'komedi!

Përgjegjësi nuk e zgjati më. Ndërkaq banakierja po përgatiste kafetë dhe unë po mendoja se sa gjë e bezdissħme ishte për mua t'i çoja ato kafe tek ata njerëz, me të cilët isha armiqësuar pothuaj hapur. Nga kjo bezdi më shpëtoi përgjegjësi.

— Kafetë po i çoj vetë, — tha, kur banakierja i vendosi filxhanët në tabaka.

Unë e ndoqa me sy kur ai u afrua tek ata dhe kur filloi tē linte filxhanët mbi tryeza duke buzëqeshur. Pastaj ata filluan tē thoshin diçka. Flisnin pothuaj pérnjéherësh dhe nuk i dalloja dot fjalët. Kuptohej që ankoheshin pér mua, sepse dhëndri ngrinte kokën herë pas here dhe shikonte i ngrysur në drejtimin tim. Dëgjova vetém fjalën «vagabond» që u përsërit disa herë. Para se përgjegjësi tē largohej, shoku Jani i tha diçka përgjegjësit dhe pér çudinë time vura re që përgjegjësi e kundërshtoi.

Kur erdhi te banaku, përgjegjësi nxinte i téri në fytyrë. Mua nuk m'i hodhi as sytë.

— Lajmëroni njerëzit se, pas mbarimit tē orarit, do tē bëjmë mbledhjen e kolektivit, — i tha banaquieres.

— Qyqja, prapë mbledhje! — tha kamerierja tjetër.

— Unë e shkreta e kam çunin pa qejf.

Asnjeri nuk iu përgjigj.

Grupi i festuesve i pinë kafetë pothuaj në heshtje dhe menjéherë kërkuan tē paguanin. Edhe pér tē marrë paret shkoi përgjegjësi. Pastaj ata dolën grumbull, shumica me fytyra tē ngrysura, duke më hedhur mua shikime plot urejtje. Përgjegjësi i përçolli gjer te dera dhe vazhdimisht përsëriste: «Na falni, na falni!» Duke dalë, shoku Jani i tha përsëri diçka përgjegjësit. Rrëshqitazi dëgjova fjalët: «Mos e bëni tragjike, gjëra që ndodhin». Dhe përgjegjësi përsëri kundërshtoi.

Ata dolën dhe në kafe mbretëroi heshtja e plotë. S'pipëtinte asgjë. Papritur gjëmoi zëri i përgjegjësit.

— Mbledhje.

Kamerierja tjetër lëshoi një ofshamë. Nga kuzhina doli Diri me tetu Naja. Dy pastrueset e lanë punën, që porsa e kishin filluar dhe erdhën e qëndruan mënjanë. Përgjegjësi rrinte i zymtë, më i zymtë se kurrë. Banakierja gjithashtu. Vetë Diri ishte e çelur në fytyrë, por dhe ajo, kur e pa që tē gjithë qëndronin hije-

rëndë, mori një shprehje hutimi. Në sytë e teto Najes, që vështronin herë mua, herë përgjegjësin, pashë shenjat e para të dhemshurisë pér të dy.

Përgjegjësi foli. Ai foli me fjalë të rënda pér mua, por, pér çudi, tani që ndodhi gjithçka, unë isha mjart i qetë. Unë isha i qetë dhe fjalët e tij nuk ma prishnin gjakun si zakonisht. Ai më quajti arrogant, të pasjellshëm, pa respekt pér popullin. Ai parashtroi ankesat e popullit pér mua. Kur e pa që unë dëgjoja mjart gjakftohtë, përgjegjësi e shtoi dozën e kritikës. Ai bëri aluzion pér çështje morale, shfrytëzim të pozitës shtetërore (domethënë pozitës sime si kamerier), duke e vënë atë në shërbim të interesave personale. Ai më quajti mua çerdhe mbeturinash të së kaluarës dhe ndikimesh të sotme të huaja, njeri që përbuz popullin dhe punën fizike. Me një fjalë, gati sa s'më nxori agjent të borgjezisë në radhët e klasës punëtore.

Unë dëgjoja i qetë.

— Përveç kësaj, — vazhdoi përgjegjësi, — ka dhe gjëra të tjera. Këto sjellje te ky njeri nuk janë një gjë e rastit. Ato janë rrjedhim i lakrave që ka ai në kokë. Kam një sinjalizim, — këtu përgjegjësi i dha zërit të tij një tingull të veçantë, — se ky njeri, duke dëgjuar një ditë disa njerëz të thjeshtë të popullit, që po ngrinin dolli pér Partinë, nuk i pëlqeu kjo gjë dhe shfaqi hapur mospélqimin e tij.

— Kjo është shpifje, — thirra unë dhe i hodha sytë vetëtimthi banakieres. Ajo i hoqi sytë menjëherë. Banakierja s'më kishte pëlqyer kurrë, po në atë cast m'u duk gruaja më e shëmtuar në botë.

— Kjo është e vërtetë, — tha përgjegjësi dhe ktheu sytë nga banakierja.

— Shpifje e ndyrë, — përsërita. — Në goftë se dikush mendon se mund të përmirësojë biografinë me mënyra të tillë, gabohet rëndë.

U bë heshtje. Banakierja lëvizi dy-tri herë buzët e holla me nervozizëm, po nuk foli. Heshtja vazhdoi gjatë. Një kalimtar lëvizte kokën përjashta, te xhami,

duke u munduar të shikonte brenda. Ekspresi që po ftohej, ia dha një si pshërëtime të thellë.

— Qyqja, m'u bë vonë! — pëshpëriti me zë të ulët kamerierja tjetër.

— Kush e do fjalën? — tha përgjegjësi.

Fjalën nuk e kërkoi asnjeri.

— Folni, — tha përgjegjësi, — le të shfaqë secili pa drujtje mendimin e vet. Ç'thua ti, teto Naje?

Teto Naje u ngrit. Sytë i shkëlqenin plotësisht nga dhembshuria.

— I riu si veriu, mor bir, — tha ajo. — Mos ia vini re. Kushedi si e ka pasur hallin. Për zemrën, zemrën e ka llagar. Për të mirë përpinqet.

— Teto Naje, ç'janë këto që po flet, — ndërpren përgjegjësi. — Na thuaj konkretisht, si të duket ty sjellja e tij me klientët e sotëm? Si të duket ty fakti që ky përplasi gotat në tryezë dhe u foli me arrogancë klientëve?

— Edhe ti, mor bir, për të mirë e ke, — vazhdoi të sajën teto Naje, duke iu drejtuar përgjegjësit. — Ke hak që mërzitesh nganjëherë. Të zien koka nga gjithë ato shkresa e hesape. Po të gjitha do të shkojnë. Më e mira do të bëhet.

— Ç'janë këto oportunizma? — tha përgjegjësi me inat.

Teto Nafen e dokëndisi shumë kjo fjalë që kushe di ç'kuptim i dha në mendin e saj. Ajo na vështroi të gjithëve dhe papritur u ul.

— Kaq u bëra, një fjalë të tillë s'ma ka thënë njeri, — tha me zë të prekshëm dhe sytë gati-gati iu përlotën.

Pas saj foli banakierja. Ajo foli kundër meje me fjalë të hidhura, duke përsëritur pothuaj të gjitha ato që tha përgjegjësi. Punën e dollisë nuk e zuri ngoje. Në fund shfaqi mendimin se kolektivi i shëndoshë i kafe «Rivierës» nuk duhej të mbante në gjirin e tij një njeri si unë.

— Me leje? — tha Diri, kur mbaroi banakierja.

— Fol, — i tha përgjegjësi.

Diri u skuq në fytyrë.

— Unë nuk jam dakord pér tē marrë masë, — tha.  
— Të thém tē drejtën, pér muá nuk doli shumë e qartë pse ai ka bërë faj. Pérveç kësaj, mendoj se duhet tē kemi parasysh që kundër tij janë ankuar njerëz që vijnë e festojnë në kafen tonë fejesa tē bëra sipas za-konëve tē vjetra, pra elementë tē prapambetur tē shoqërisë. Pse duhet t'u japim kaq rëndësi fjalëve tē këtyre elementëve tē prapambetur?

— Mendoj se klientët e sotëm nuk ishin elementë tē prapambetur tē shoqërisë, — tha përgjegjësi me ironi. — Përkundrazi. Më lejo tē tē kujtoj, shoqja Diri, se midis tyre kishte njerëz që kryejnë funksione tē rëndësishme në aparatin shtetëror.

— Mund tē kryejnë funksione tē rëndësishme e megjithatë mund tē jenë fare mirë elementë tē prapambetur, — tha Diri me vendosmëri.

— Ah, ashtu mendoni ju?

— Po.

— E çuditshme, — tha përgjegjësi. — Kisha qejf tē ishte këtu shoku Jani, tē dëgjonte se si flasin ata që ai mbrojti pesë minuta më parë.

— Kam edhe diçka, — tha Diri dhe u ngrit përsëri.

— Nuk doli e qartë ajo çështja e dollisë.

Përgjegjësi vështroi banakieren.

— E sqaroj unë, — tha banakierja. Ajo filloj tē tregonte punën e dollisë, duke ndryshuar esencën e fjalëve tē mia. Këtë herë e humba krejtësisht gjakftoh-tësinë.

— Shpifje e ndyrë! — thirra prapë me zë tē lartë.

Ajo deshi tē vazhdonte. Unë e ndërpresa përsëri. Përgjegjësi deshi tē vendoste qetësinë. Atëherë unë fillova t'i shaja tē dy. Ata gjithashtu s'lanë gjë pa më thënë.

Në linat e sipër unë thashë se as që doja tē punoja në një lokal «që ka rënë në kompromis me feudalizmin». Përgjegjësi tha se do ta mbante mend edhe këtë akuzë tē re dhe tha se e kisha portën tē hapur që

tani. Unë thashë se iki që ç'ke me të dhe ai tha: «Udhë e mbarë, ja ku është dera.»

Folën dhe të tjerët me përjashtim të teto Najes që vazhdonte të rrinte jashtëzakonisht e fyter. Ata nuk ishin të mendimit që unë të largohesh nga puna, por unë kaq shumë zieja përbrenda, saqë, pa kuptuar dhe vetë, përsëritja vazhdimi isht: «Largo hem që ç'ke me të». Pas një «largo hem që ç'ke me të», përgjegjësi nxori nga dollapi librezën, time të punës dhe, ndërsa matundte përpara fytyrës, unë zgjata dorën papritur dhe ia rrëmbeva. Kështu që gjithçka u bë fakt i kryer.

Ishte ora katër e gjysmë, kur, pasi dorëzova parët e ditës, dola nga kafja. Po ngrysej. Në vitinat ishin ndezur dritat. Rrugët dhe trotuaret ishin plot me njërrëz. Qysh tani kishte filluar të ndihet atmosfera e Vittit të Ri. Shitet po ngjitnin në xhamat e magazinave qindra copa të vogla pambuku. Dyqanet e frutave ishin plot me portokalle.

I papunë. Papritur, kjo gjë m'u duk kaq e çuditshme, saqë unë pothuaj qesha me zë të lartë. Ishte diçka artificiale, e panatyrshme. Më dukej vetja si personazh filmash apo diçka që kishte lidhje me lajmet e faqes së katërt të «Zërit të popullit». Nuk kisha ndonjë shok të papunë dhe tani që po shkëdo rrugës midis njerëzve, më dukej se kisha një cilësi të rrallë dhe origjinale, që meritonte vëmendje. Mendova se ç'qyfyrë do të bënin me mua shokët. Për çudi, isha në qejf. I buzëqesha një gjimnazisteje. Edhe ajo më buzëqeshi. Tek udhëkryqi ia bëra që larg me dorë policit, dhe ai më nderoi duke vënë dorën te streha.

Befas ndjevauri si një i papunë i vërtetë. Kisha që në mëngjes që s'kisha vënë gjë në gojë. U futa në bar «Penza». Bari ishte plot. Prita sa u lirua një vend te banaku dhe porosita dy sanduiçë dhe një gotë birrë.

Radioja po jepte lajme të jashtme. Ishte vështirë të dëgjoje zërin e spikerit, sepse në bar kishte shumë zhurmë. Dëgjoheshin herë pas here fjalët «Çekoslova-ki» dhe «trupa sovjetike».

Dola nga bari dhe eca pa qëllim në bulevard. Megjithëse entuziazmi i papunësisë nuk më kishte rënë, mendova se, sidoqoftë, duhej bërë diçka. Ideja për të shkuar në Komitetin e Partisë, më tepër për ta sqaruar parimisht këtë çështje, sesa të ankohesha për përgjegjësin tim, më kishte kaluar në mendje disa herë gjatë ditës. Tani që ndërtesa e Komitetit të Partisë dukej atje përtej, me dritat e ndezura në të gjitha dritaret e mëdha, unë vura re se, pa kuptuar as vetë, isha drejtuar për atje.

1968

## KËSHTJELLA GRAKS

Në të gjitha gjendet turistike të këtij shteti evro-ballkanik gjendej emri i saj. Në të gjitha gjuhët: Castelo Grax. The Castell Grax. Le chateau Grax. Zamok Graks. Në kartpostale shumëngjyrëshe dukeshin kullat kërcënuese, të larta e të holla si gjilpëra. Portat e veshura me hekur. Bedenat në sfondin ereve.

— Shteti ynë është i vendosur të mos i nënshtronhet supershtetit fqinj, — më thoshte shoqëruesi im, ndërsa udhëtonim drejt së famshmes kështjellë Graks. — Historia ka ç'na mëson për këtë.

S'kishte gjë më të natyrshme sesa, duke iu afruar kështjellës Graks, të bisedoje për historinë.

Ajo u duk më në fund në horizont. S'ishte më pak madhështore se në kartpostalet. Ishte e rreptë dhe e bukur, e mprehtë, e kuqërrëmëtë, e qepur si me kthethra bronzi mbi shkëmbinjtë e thiktë.

— Kështjella Graks, — tha me krenari shoqëruesi. — E keni përpëra.

Zbritëm nga makina dhe, para se të ecnim drejt saj, po qëmpinim këmbët. Aty pranë dégjova një të fo-

lur tē huaj. Ishte pikërisht gjuha e supershtetit fqinj. Sytē e mi u takuan me ata tē shoqëruesit.

— Megjithëse... jemi tē kërcenuar prej tyre, ne jemi nē marrëdhënie tepér tē mira, — tha ai. — Më kuptoni, tepér paqësore.

Turistët nga supershteti po fotografonin kështjellën. Ata përkulnin mesin herë majtas, herë poshtë, herë djathtas, pér ta futur më mirë nē fokus pamjen. Shtrak-shtruk, dëgjoheshin aty-këtu shkrepjet e fotoaparateve. Shoqëruesi im më shikonte gëzueshëm, sikur tē thoshte: éshëtë më mirë kështu, apo jo?

U ngjitëm nē një rruginë tē pjerrët, që tē konte nē kështjellë. Hymë nga porta e rëndë metalike, kapërcyem oborrin e parë, tē dytë, u ngjitëm nëpër hajatet e jashtme, nëpër kullat e luftimit. Ciceroni i i kështjellës na shpjegonte: Këto janë dritaret e përgjimit tē armikut që mund tē vijë nga fusha lindore. Këto janë tē veriut. E kështu me radhë. Këto janë kullat e mbrojtjes së portës kryesore. Bedenat e luftimit, Kambana e alarmit. Kisha e brendshme.

Gjithçka ishte e ruajtur pér bukuri, dhe padashur, jo pa një ndjesi keqardhjeje, m'u kujtuan disa nga kështjellat tona gjysmë tē rrënuara nga luftrat, koha, tërmetet, ku turistët gjenin me vështirësi ndonjë pikë pér tē fotografuar. Kurse këtu, nē kështjellën Graks, mjaftron tē shkrepje aparatin kuturu, se diçka do tē kapte. Gjithçka ishte e madhërishme, hekur e gur përzier bashkë. Këtu janë sternat e ujë rezervë nē rast rrëthimi dhe prishjeje tē ujësjellësit, atje burgu pér trädhtarët, këtu porta që hapet nē rast kundërsulmaj, atje... cdo gjë ishte parashikuar. Gjithçka tē kujton te luftën, vdekjen, lavdinë...

Dhe unë prisja që tē dëgjoja më nē fund ngjarjet: nē filan vit u pagëzuan muret nē luftën e parë, nē filan kohë u rrëhua pér herë tē dytë, tē katërt, nē filan epokë armiqëtë desh e pushtuan... Unë prita sa prita dhe, megenëse ciceroni, i têrhequr, sic duket, nga detaje tē profesionit tē tij (ai po shpjegonte gërshetimet

e stilit barok me atë gotik në sallën e armëve), pra meqenëse ciceroni s'po kujtohej për ngjarjet reale, unë pyeta për to.

Sytë e tij mbetën. Ai më vështroi një copë herë, duke dyshuar se mos dëgjoi gabim, ose duke kujtuar se mos frëngjishtja ime e keqe po na ngatërronte. (Një frëngjishte e keqe është më e keqe se një armik, më kishte thënë një ditë më parë, sepse s'ka gjë më e keqe se prishja e bisedimeve midis dy palëve).

Ai më shikoi një copë herë dhe, kur unë i përsërita pyetjen, ai ia bëri:

— Ah, ju kuptova, e keni fjalën, për luftëra konkrete, ndeshje, — dhe ai bëri një shenjë me dy grushat e tij, sikur do t'i përplaste me njëri-tjetrin. — Ju kupova fare mirë. Por puna është se të tilla këtu s'ka, — vazhdoi duke treguar me dorë përreth. — Më kuptoni? Kjo kështjellë nuk është sulmuar asnjëherë.

— Ashtu??

Unë vështrova përsëri rrëth meje. Muret çoheshin përpjetë pa asnjë gjurmë zifti përsipër. E vdekur ishte kambana e alarmit, si gjuhë e një të pagoji.

— Është si një vajzë e re, e pakonsumuar, — tha shoqëruesi dhe, i kënaqur nga shakaja e tij, qeshi.

Mua m'u kujtuan kështjellat tonë plaka, të shuara përgjysmë nga faqja e dheut, nga rrëthimet e pafundme.

— Po kur armiqtë kanë ardhur, kur fusha është nxirë tejembanë prej tyre, ç'ka ndodhur? — pyeta.

Fytyra e tij u zymtua.

— Po, ka pasur raste kur ata kanë nxirë në horizont dhe janë bërë gati të nisnin marshimin por... — ai buzëqeshi, — nuk kanë arritur kurrë gjer këtu.

— Po si i keni zbrapsur?

— Me bisedime, — tha ai, duke bërë një shenjë me dorë, sikur përkëdhelte kreshtën e një bishe, — me bisedime.

Zëri i tij ishte nanuritës.

Ne vazhduam vizitën e kështjellës dhe gjithçka

ishte si më parë, portat ishin të pagoditura kurrë nga dashi i hekurt, muret të parrahura prej topave, dhomat e mbretit pa zgjim në mesnatë. Gjithçka ishte pa, pa, pa... Përpara gjithçkaje ishte një «ç» asgjësuese, që shfytyronte çdo gjë, që e zvogëlonë, e çonte drejt zeros gjithçka në këtë çkështjellë.

Përpara se të dilnim, bëra pyetjen e fundit:

— Përse u ndërtua kjo kështjellë, si të thuash, ç'kohë, ç'alarm e polli?

— Ç'kohë, ç'alarm? Quel temp, quel alarm? — përsëriti shoqëruesi. — Nuk ju kuptoj mirë, zotni. Asnjë kohë, asnje alarm. Atë e ndërtuan tregtarët e qytetit N. dhe ia dhuruan mbretit si kujtim për uljen e disa taksave, në vitin...

Ne dolëm. Ishim duke shkuar te makinat tonë, ku ndeshëm përsëri turistët e huaj. Fotoaparatet e tyre ia bënин shtrak-shtruk nga të gjitha anët. Sikur të ishte natë dhe ato të ishin me blice, pamja do të ishte e paharrueshme.

Ndërsa ecnim midis tyre, shoqëruesi prapë më vështroi gëzueshëm, sikur të më thoshte: a nuk është më mirë kjo shkrepje fotoaparatesh, sesa gjëmimi i topave? A nuk është më mirë që kështjellat të janë të paprekura dhe në këmbë, sesa të mbuluara me lavdi dhe rrënoja?

T'i thosha se pikërisht ngaqë janë harxhuar ato nga luftërat, ne qëndrojmë në këmbë, dhe, po të ishin ato të paciflosura, do të ishim të rrëzuar ne? Mirëpo ai, megjithëse i adhuronte bisedimet, nuk tha asgjë me zë, kështu që as unë s'kisha si t'i përgjigjesha. Vëtëm se, tek ecnim drejt makinave tonë, duke vazhduar dialogun e përfytyruar, unë i thosha: a mund t'a marrësh me mënd se çmund të jetë një komb-rrënojë?

1976

## TRENI DIMËROR I LINJES SË LARGËT

Kisha mbështetur ballin te xhami i trashë i dritares së vagonit dhe po vështroja përjashta hapësirat e shkreta të mbuluara me dëborë dhe terr. Ishte nata e dytë që treni ikte drejt Krimësë. Në gjysmëterr dukeshin aty-këtu në horizont drurë të zgërbunjur, që me afimin e trenit hidheshin sakaq mënjanë shinave, si kalorës të trembur. Tek vështroja me sy shfaqjen dhe zhdukjen e tyre, nuk e di pse, më vinin ndër mend copëza nga jeta ime. Po ato që më kujtoheshin, ishin aq të palidhura dhe pa vazhdimësi, saqë më dukej se në jetën time ishin ngjitur copëra të kushedi q'jetëve të tjera të panjohurish. Herë-herë pranë stacionesh të vogla, që jo vetëm unë, por me siguri askush në këtë tren s'uua dinte emrat, rrnim në errësirë, me nga një fener në dorë, njerëz të mbështjellë me xhupa të trashë. Mundohesha të dalloja fytyrat e tyre, por ato ishin aq shumë të mbështjella e të palëvizshme, saqë do të besoje më tepër se ishin figura prej dëbore, të harruara aty prej lodrave të ditës të fëmijëve, sesa njerëz të gjallë. Ne iknim e iknim përmes stepash të ngrira, ndërsa

fenerët shfaqeshin e zhdukeshin aty-këtu, sinjale të pakuptueshme, të mbetura nga net të vjetra në këtë hapësirë kontinentale, dhe mua më dukej sikur po vraponim drejt qendrës së natës.

Në xhep kisha një fletë-pushimi për shtëpinë e krijimit të shkrimtarëve në Jaltë, por pas tridhjetë orësh udhëtimi mua më dukej se Jalta nuk ishte më dhe në vend të saj, në vend të kaltërsisë dhe qelqit që përfontonte fjala Jaltë, ne s'do të gjenim veçse një fillim të ri stepash të hirta dhe të njëtrajtshme si këto.

Pas disa vjorstash drurët u dukën përsëri në horizont dhe mua më dukej sikur gjithë jetën time kisha ecur me një tren të tillë, përskaj të cilit shfaqen aty-këtu drurë të zgërbunjur, që hidhen mënjanë si kalorës të trembur.

Ui, ui, fishkëllente diku larg, përparrë, lokomotiva, që na tërhiqte për kushedi ku. Herë-herë isha në prag të dremitjes, por xhami mbi të cilin kisha mbështetur ballin më sillte në vete me tronditjen e tij. Gjatë çasteve të shkurtra të dremitjes klithma e lokomotivës më dëgjohej më pranë dhe si e llahtarisor. Ui, ui ç'ke, ç'ke moj lokomotivë e zezë... Uic, uic... manoviç... Ç'farë, çfarë... manoviç... vukmanoviç...

Shkunda kokën dhe pyetja u përsërit brenda meje e ftohtë dhe e prerë, si rënia e monedhës brenda aparatit telefonik: përse Vukmanoviç Tempoja kishte ardhur në Moskë? Klithma e lokomotivës, magjistricë ngulçonjëse stepash, qe larguar përsëri, pasi më kishte zgjuar. Përse Vukmanoviç Tempo... Unë e dija atë prej kohësh të vdekur, armik të vjetër të vendit tim, me emrin që e kisha bërë në shkollë në lëndën e historisë, bashkë me fantazma të tjera: viti 1948, Koçi Xoxe... Dhe ja, dy ditë përparrë se të nisësha për në Jaltë, një shok i kursit në Institutin Gorki, duke më ngulur sytë në një mënyrë kuptimplotë, më kishte thënë: a e di ti që Vukmanoviç Tempoja ka ardhur para një javë në Moskë?

Ndeza një cigare, sic isha i shtrirë përbysë mbi

krevat, dhe mbështeta prapë ballin te xhami i ftohtë. Uiq, ia bënte larg fisha e lokomotivës, duke shpërndarë emrin e fantazmës mbi shkretinë e stepave. Mua më dukej se ky tren nuk do të arrinte kurrë asgjëkund dhe se binarët do t'i ngatërroheshin kështu gjithmonë në gjirim e natës. Pastaj m'u duk se drurët që u shfaqën përsëri, ishin tamam kalorës të errët dhe, sa vente, në vrapim e sipër, ata i aviteshin gjithmonë e më te-për trenit, gjersa nisën të rendnin fare përbri tij, thuajse ngjitur. Jelet e tyre të akullta, kaltërore, rrjinin egërsisht xamat, madje m'u duk se po dëgjoja potkonjtë e tyre të mbytur dhe sakaj fjeta.

S'di ç'kohë ish, por më zgjoi ndalimi i trenit. Përjashta një llampë e ftohtë ndriçonte dëborën e rrallë, që binte përzier me shi mbi një platformë të lagët çimentoje. Do ta kemi kaluar Rusinë, mendova, dhe tani duhet të jemi në Ukrainë. Ose, edhe në qoftë se nuk e kemi kaluar, duhet të jemi diku midis Rusisë dhe Ukrainës, përderisa bie shi e dëborë bashkë. Treni u nis dhe gjumi po më zinte prapë, kur ndjeva derën e kuperë që u hap dhe hapat e dikujt që po hynte. Në ndriçimin e zbehtë të llampës së korridorit, për një çast të vetëm, i përgjumur siç isha, munda të dalloja një figurë të gjatë, të mbështjellë me mushama të zezë, që kullonte ujë.

— Ku ndodhemi? — pyeta me zë të ulët.

— Një qytetth i vogël tërë baltë, — u përgjigj nëpër hundë i panjohuri, duke lënë diku te këmbët valixhem e tij. Pastaj diçka fëshfëriti, siç duket ai u ngjit në krevatin e sipërm, në kupe ra prapë qetësia dhe përreth s'kishte asgjë tjetër veçse natë dhe kërkëllima rrotash të hekurta: *Malenkoje grjaznoje gorodishko* përsërita me vete fjalët e të panjohurit, ndërsa ndieja që përjashta afrimin e drurëve-kalorës, që nisën të rendnin përsëri përbri trenit, me atë trokëllimë të pambarim potkonjsh.

Kur u zgjova, treni vazhdonte të ecte me shpejtësi. Kishte gdhirë. Mëngjesi ishte i zymtë dhe qelli ishte

plot me ré. Ato ishin tē zeza e tē rënda dhe jo bardhoshe e tē lehta, si nē veri. Qe shumë herët, por unë vendosa që tē ngrihesha sepse më ishin mpirë kockat nga tē ndenjurit shtrirë. Ndërsa po vishesha, m'u kujtua i panjohuri i natës.

S'duhet tē bëj zhurmë, mendova dhe eca më maja tē këmbëve, por, kur u ngrita, pashë se krevati i sipërm ku ai kishte rënë mbrëmë, ishte bosh. As valixha e tij nuk ishte. Kushedi ku ka zbritur natën, thashë me vete, në ndonjë stacion pa emër, nga ata që kanë vetëm një shifër.

Ndeza një cigare dhe u shtriva përsëri i veshur, siç isha mbi kreyat, duke vënë jastëkun nën mjekër dhe duke vështruar përjashta xhamit. Jashtë shiu i rreptë rrihte me furi vagonët, dhe fishkëllima e lokomotivës mezi dëgjohej përmes tij. Aty-këtu izba tē hirta mënjanoheshin heshturazi fushës. M'u kujtua prapë, por vetëm pér disa sekonda, pasagjeri i natës që kushedi ku kishte zbritur, në ndonjë stacion tē vogël, tē ndonjë qytetthi tjetër me baltë, duke mbajtur në dorë valixhen, mbështjellë me atë mushama tē zezë, që kullonte ujë. Apo ndoshta nuk kishte shkuar aq larg, por kishte mbetur pranë shinave, duke zënë postin e vet, me fener në dorë, midis sfinksave të palëvizshëm, mbështjellë me xhup, në radhët e tē cilëve ndoshta bënte pjesë, në atë karakoll pa mbarim. E hoqa mendjen prej tij dhe pér një kohë tē gjatë i mbajta sytë mbi peizazhin e zhveshur. Tani ndihej që vërtet po i afroheshim Krimësë, sepse dëbora nuk ishte më e bardhë dhe e sigurt, si në veri, por qëndronte e zbehtë, pllanga-planga mbi tokën e zezë. Ui, ui... klithte herë-herë lokomotiva, sikur tē kujtonte udhën, por mua më dukej se nuk po shkonim as gjékund.

## SHËRBIMI I PARE

Daktilografistja zgjati kokën në derën që ata e kishin lënë gjysmë të hapur.

— Shoku Piro, — tha ajo, — të thërret kryeredaktori.

Piroja po u tregonte një shaka shokëve të tij. Ata ishin tre stazhierë, që akoma nuk kishin ndonjë zyrë të caktuar ku mund të punonin, kështu që zakonisht rrinin në paradhomën e korrektoreve, ose futeshin në ndonjë zyrë që mbetej bosh, kur gazetarët që punonin atje, iknin me shërbim. Atje prisnim t'u jepnin punë të ndryshme. Zakonisht u jepnin të përpunonin korrespondencia që vinin nga rrëthet. Por qëllonte shpesh që kryenin punë nga më të ndryshmet. Që nga koha që kishin hyrë si stazhierë në gazetë, ata jetonin në pritje. Ata e dinin se rruga për t'u bërë gazetar i mirë është e gjatë dhe e zorshme dhe ajo duhet të fillojë patjetër nga punët e vogla dhe të mërzitshme të korrrespondencës dhe informacionit, por megjithatë çdo ditë që kalonte, atyre u dukej shumë e gjatë dhe nuk u durohej gjersa më në fund t'u besonin detyrën e

parë serioze, p.sh. reportazhin e një ngjarjeje qoftë edhe të thjeshtë. Për artikujt problemorë dhe reportazhet e ngjarjeve të mëdha ose reportazhet e festave tani për tani as që ëndërronin. Megjithatë, kur afronin festa, ose ndodhnin ngjarje të rëndësishme, ata shikonin me zili se si niseshin drejt tyre gazetarët më të vjetër. Kishte diçka të veçantë në mënyrën se si ata vinin në redaksi, atë mëngjes që do të niseshin, si merrnin urdhrin e shërbimit, si përshëndeteshin me shokët, bile edhe në mënyrën se si e ngrinin jakën në çastin e ikjes. Pastaj zërat e tyre vinin nga larg në-përmjet receptorit të telefonit, pak të mbytur dhe të ngjirur, dhe kjo i bënte akoma më interesantë. Kurse stazhierët rrin pranë sobës ose vështronin nga dritarja qiellin e dimrit, duke pritur urdhra të vegjël përpunë të parëndësishme. Ata prisnin kur do të vinte ajo ditë që, duke hedhur një çantë në sup, të vraponin drejt stacionit të trenit ose në agjencinë e pasagjerëve për t'u nisur në shërbimin e parë. Kjo u dukej gati e pabesueshme.

— Mua? — ia bëri Piroja i habitur.

— Po, — përsëriti daktilografistja. — Te kryeredaktori, — dhe mbylli derën.

Dy të tjerët mbetën me gojë hapur.

— Ilk ç'pre?

Piroja qe hutuar. Po përse kryeredaktori? Ai nuk ishte marrë kurrë me ta. Shkëndijën e gëzimit që provoi në fillim, ia shoi një dyshim tjetër. Po sikur?... Ata ishin stazhierë dhe, të punosh si stazhier, do të thotë se je gjithmonë në provë. Po sikur?...

Ai trokiti me druatje dhe hyri. Kryeredaktori po fliste në telefon. Piroja qëndroi në këmbë përpara tryezës së tij. Kryeredaktori po fliste shumë gjatë në telefon. Piros iu duk sikur ai kishte harruar që e kishte thirrur.

Më në fund kryeredaktori e la receptorin.

— Dëgjo, — tha, — a je gati për t'u nisur menjëherë me shërbim?

— Po.

— Na duhet një shkrim për stallierin e njojur, brigadierin Gani Çenazi. Ka dëgjuar për të?

— Po.

— Ne kemi shkruar disa herë për të, — tha kryeredaktori. — Tani posa morëm një informacion se ai ka marrë një zotim të ri për prodhimin e mishit në kooperativën e vet. Ky është një zotim i paparë gjë më sot në vendin tonë. Ti mund të shkruash një portret të tij, pa përsëritur ato që kemi thënë herë tjeter. Në qoftë se je gati, merr urdhrin e shërbimit në administratë dhe nisu me trenin më të parë.

— Si urdhëron, shoku kryeredaktor, — tha Piroja dhe vrapoi të dilte.

— Dëgjo, — tha kryeredaktori, kur ai po kapte dorezën e derës, — unë të thashë të shkruash një portret, por ti mund ta bësh shkrimin si të duash. Më kupton? Si të të vijë më për mbarë.

— Si urdhëron, shoku kryeredaktor, — përsëriti Piroja dhe vrapoi nëpër korridor si i qëmendur.

Pas një ore ai ecte duke vërvshëllyer drejt stacionit të trenit. Duke lëvizur midis turmës së pasagjerëve, mendonte se, sidoqoftë, asnjëherë nuk e kishte përfytyruar sejeta e tij e vërtetë prej gazetari do të fillonte kaq papritur, në një rrugë ku dëgjohen vërvshëllima lokomotivash, midis pasagjerësh që imbanin në duar çanta, borsa dhe valixhe. Ai mendoi se ishte një gjë sa e bukur, aq dhe e pamundur të dije se ku udhëtonin dhe për se udhëtonin gjithë kjo mori një rëzish. Secili kishte udhën e tij dhe punën e tij, kurse ai, Piro Kallushi, po hidhte hapat e parë në rrugën e gazetarit të vërtetë. Ideja se njerëzit që e cernin e shtyhesin përbri tij as që e merrnin me mend se ky djalë me pamje të thjeshtë dhe më një çantë në dorë, si gjithë të tjerët, do të bëhej më vonë një gazetar i njojur (për këtë ai ishte i sigurtë), i jepte një kë-naqësi të madhe e të vazhdueshme, ashtu siç i jep kë-naqësi qdo njeriu e fshehta që ai mbart me vete, kur kjo e fshehtë është në dobi të tij. Ai ëndërronte të

bëhej gazetar i dëgjuar, emrin e të cilit lexuesit ta kërkonin me padurim, sa herë që të hapnin gazeten. E dinte se, për ' arritur këtë gjë, duhej shumë punë dhe mundim, shumë rrugë të vështira nëpër dimër e shi, numra të ftohtë hotelesh, shërbime të gjata dhe, pas gjithë këtyre, shumë vetmi gjatë mbrëmjeve, kur fletët e bardha mezi mbushen nga rreshtat.

Për të arritur në qytetin e vogël T., pranë të cilit ndodhej kooperativa blegtorale ku punonte Gani Çenazi, duhej marrë autobusi, pasi të zëriste nga treni në stacionin e parafundit. Ai mendonte të zinte një dhomë në hotelin e T. dhe pastaj, me ndonjë makinë të rastit ose, po të mos gjente makinë edhe me këmbë, të shkonte në kooperativë.

Ai arriti në T. në mbrëmje. Nuk kishte qenë asnjëherë këtu. Ky ishte një qytet fare i vogël, nga ato qytetet e mbledhura, ku zakonisht shtëpia e kulturës, hoteli dhe komiteti i partisë ndodhen në një rrugë, në rrugën e vetme kryesore. Megjithëse bënte ftohtë, (shumë më ftohtë se në Tiranë), në rrugë kishte njerëz që, me sa dulkej, bënин shëtitjen e mbrëmjes. Rrugët ishin të ndriçuara me neon dhe, veç kësaj, gjëja tjetër që i bëri përshtypje kur, pasi zuri vend në hotel, doli përsëri në rrugë, ishte pastërtia. Ai ishte vërtet një qytet shumë i pastër. Shtyllat e dritave ishin të lyera të gjitha me ngjyrë argjendi, vitrinat e dyqaneve të rregulluara bukur, dhe kudo, ndanë rrugës, kishte tabela «Mos pështyni përtokë» dhe kosha, të lyer gjithashtu me bojë váji ngjyrë argjendi. Përpara shtëpisë së kulturës ishin vendosur rresht ca stenda të ndriçuara pastër. Ngaqë s'kishte ku të vente, ai u afrua te stendat dhe nisi t'i shikonte me radhi. Në njérën prej tyre ishin vendosur fotografi nga shfaqjet e estradës amatore të qytetit, në tjetrën ishte afishuar programi favor i aktiviteteve të shtëpisë së kulturës. Ai u bë gati të lekontakte programin, kur sytë i shkuat te stenda e tretë, që ishte pak më tutje. Në krye të saj që shkruar me shkronja të kuqe: «Të mësojmë nga Gani

Çenazi». Piroja filloi të përpinte me sy që përbante kjo stendë, duke lluar nga fotografatë, që mbushnin pjesën kryesore të saj, gjer te një karton i bardhë, ku ishin shkruar me kujdes me bojë kine katër pikat e zotimit të Gani Çenazit. Ja, pra, ky ishte heroi i tij. Ai i buzëqeshët në një mënyrë të përbajtur nga fotografatë e shumta që prapa xhamit të stendës: Gani Çenazi me shokun Enver gjatë vizitës së fundit të Sekretarit të Parë të Partisë në qytetin T.; Gani Çenazi midis kooperativistëve; Gani Çenazi në stallë, Gani Çenazi në mbrëmje, duke lexuar materialet e Partisë.

Piroja qëndroi shumë kohë përpara stendës. Ai përipiqej të gjente diçka karakteristike në ftyrën e heroit të tij, në mënyrë që pastaj ta përshkruante sa më saktë. Por pamja e Gani Çenazit nuk kishte ndonjë gjë të vëçantë. Ky ishte një njeri më se i zakonshëm. Burrë rrreth të dyzetave, shtatmesatar, flokë pothuaj të rënë, ftyra gati e rrumbullakët me rrudha, sytë pa ndonjë shprehje të përqëndruar. Në disa nga fotografatë ai qe veshur me xhaketë kadife, në të tjerat me një bluzë që hapet përpara me zinxhir.

Duke u larguar, Piros i vajtën sytë te një afishe ngjitur në stendën e fundit: «Nesër, në orën 17, në sallën e shtëpisë së kulturës bëhet takimi i të rinjve të qytetit me shokun Gani Çenazi. Pas takimit ka film».

Duke ecur rrugës për në restorant, atij i zuri syri përsëri një karton të madh, ngjitur përpara portës. Nën shkronjat e kuqe: «Të mësojmë nga shoku Gani Çenazi» ishin shkruar me shkronja të mëdha zotimet e kooperativistit.

Ishte e qartë se në qytetin e vogël T. Gani Çenazi ishte heroi i ditës. Kjo qe e kuptueshme: tanë atë e njihet gjithë Shqipëria dhe ishte e natyrshme që qytetit T. i përkiste më tepër se kujtdo të krenohej me të.

Duke hyrë në restorant, Piroja u përpoq të merrete me mend se si e ndiente vallë veten Gani Çenazi kur zbriste në qytet, kur shkonte në mbledhje apo në kine-

ma dhe njerëzit kthenin kokën e i pëshpëritnin njëri-tjetrit: «Ky është Gani Çenazi, për të cilin kanë shkruar gjithë gazetat e Republikës». Kjo duhej të ishte një gjë shumë e bukur. Duke vërtitur në kokë këtë gjë për një kohë të gjatë, dalngadalë dhe pa kuptuar as vetë, ai e zëvendësoi Gani Çenazin me veten e tij dhe, përpara se ta zinte gjumi në hotel, mendoi se si ai do të bëhej më vonë një gazetar i njojur dhe, duke zbritur nga autobusi në agjencinë e ndonjë qyteti të vogël ku do të vente me shërbim, njerëzit do të thoshin pér të: ky është Piro Kallushi, artikujt dhe reportazhet e të cilit i botojnë të gjitha gazetat e Republikës.

Të nesërmen, që në mëngjes, hipi në kamionin e kooperativës, që transportonte qumësht dhe pas një çerek ore arriti atje. Kamioni ndaloj te baxhoja. Përpara se të shkonte nga stallat, ai i erdhi një copë herë vërdallë fshatit. Ishte hera e parë që shkonte një fshat në dimër. Ai kishte qenë fshatrave me brigadat kulturore gjatë kohës së aksioneve. Fshati, në dimër, iu duk krejt ndryshe. Ndryshe dukeshin rrugët, shtëpitë, mullarët. Frynte erë e ftohtë.

Kur arriti te stallat, ishte pak i tronditür. Gjatë rrugës e kishte përfytyruar disa herë takimin me Gani Çenazin dhe pak a shumë kishte skicuar në mendje pyetjet që do t'i drejtonte dhe ndonjë bisedë më të lirë që mund të hapte me të. Tani që arriti, e ndjeu se po i harronte të gjitha.

Ai pyeti një mjelëse, që takoi përpara stallës së parë, se ku mund ta gjente Gani Çenazin dhe, kur ajo i tha se po shkonte ta thërriste, ai i tha se nuk kishte nevojë dhe se do të shkonte vetë, mjaft që ajo t'i tregonte se ku ndodhej. Vajza buzëqeshi me druajtje. Piroja u fut në stallën që i tregoi ajo dhe, duke shkelur mbi çimenton e lagur, midis erës së rëndë të plerës, i harroi përfundimisht të gjitha pyetjet që kishte përgatitur.

Ja më në fund dhe Gani Çenazi. Duke u prezantuar me të, Piroja e ndjeu se ai nuk i bëri ndonjë përt-

shtypje heroit të shkrimit të tij të ardhshëm. Gani Çenazi tundi kokën dhe i dha dorën. Në jetë ai dukej akoma më i zakonshëm se në fotografi. Ja bluza e tij me zinxhir gjysmë të zbërthyer përpara, jaka e këmishës e arnuar pak nga e majta, flokët fare të rrallë. Ai nxori paqetën dhe ia zgjati gazetarit.

— Faleminderit, nuk e pi.

Gani Çenazi nxori çakmakun dhe e ndezi vetë.

Piroja bëri një përpjekje pér të kujtuar diçka nga ato që kishte përgatitur. Përse nuk i shkroi në bllok? Atij i qe dukur se do të bënte një përshtypje qesharake, në qoftë se nxirrte bllokun me pyetje përpara koooperativistit, po tan u pendua që nuk e kishte bërë këtë gjë.

— A u lodhe nga rruga? — pyeti Gani Çenazi.

— Po. Po.

— Rrugë e gjatë nga Tirana gjer këtu.

— Po. Ju si ia çoni me punë?

Ai ngriti supet dhe buzëqeshi.

Kushedi c'idiot po i dukem, mendoi Piroja.

— Ti, me sa shoh, je i ri në zanat, — tha Gani Çenazi.

— Po. Ky është shërbimi im i parë.

— Duket.

Me pyetjen e thjeshtë që i bëri, ai ia hoqi gjysmën e tronditjes. Piroja sikur u lehtësua.

— Ju sigurisht keni njojur shumë gazetarë, — tha ai, duke e marrë veten. — Për ju kanë shkruar kaq shumë.

— Kam njojur ca, — tha Gani Çenazi pa ndonjë entuziazëm. Në një rast tjetër Piros ky ton do t'i dukej një shenjë mendjemadhësie, por njeriu që kishte përpara, e përjashtonte një supozim të tillë.

Dalngadalë biseda e tyre u bë më e ngrohtë dhe më e natyrshme. I gjuar që e kapërceu çastin më të vështirë, Piroja u bë papritur shumë i gjallë dhe, me sa dukej, kjo gjë i pëlqeu Gani Çenazit. Atij i pëlqeu që gazetari nuk i drejtoi që në fillim pyetjet e zakon-

shme dhe do t'i pëlqente akoma më shumë kjo gjë, sikur ta dinte që gazetari i kishte harruar ato.

Piroja qëndroi në stallë gjer në drekë. Megjithëse nuk e pinte duhanin, ai ndezi dhe shuajti shumë cigare me heroin e tij. Ai e ndihmoi një copë herë Gani Çenazi për të rregulluar njëren nga lesat e prishura dhe kjo i afroi akoma më shumë.

— Se si je ti kështu, — tha me sinqueritet Gani Çenazi. — Djalë i mirë.

— A e di? — i tha Piroja gjithë gjësim, — unë kisha përgatitur shumë pyetje për ty, po i harrova të gjitha kur erdha këtu.

Gani Çenazi çeshi me zë.

— Kam njobur shumë gazetarë, — tha. Në tonin e tij kishte diçka të menduar.

— E si të janë dukur? — pyeti Piroja.

— Unë nuk thashë gjë, — ia bëri Gani Çenazi, — djem të mirë më janë dukur.

Piron e habiti toni me të cilin ai i tha këto fjalë. Dukej sikur prapa fjalëve të tij rrinte një «por» shumë i madh, që ai nuk donte ta thoshte. Kjo ishte e çuditshme. Ky njeri duhej të kishte për gazetarët ndjenjat më të mira. Ata e kishin bërë atë të njohur në të katër anët e Shqipërisë. Mos vallë ai donte më shumë... Piros kjo hamendje e fundit iu duk e neveritshme dhe e dëboi nga koka menjëherë.

— Djem të mirë janë, — përsëriti Gani Çenazi. — Por nganjëherë ne nuk jemi në rregull.

Piros iu duk se ai donte të thoshte diçka, por, siç dukej, iu kthye mendja dhe hapi një bisedë tjetër. Ata përsëri ndezën cigare dhe folën për shumë gjëra gjer në drekë. Piroja nuk mbajti asnje shënim. E futi dorën dy-tri herë në xhep për të nxjerrë bllokun, por nuk guxonte ta bënte këtë gjë. Atij i dukej se gjithë magjia e këtij mëngjesi të parë të jetës së tij prej gazetari do të prishej në çast, po të nxirrte bllokun. Dukej sikur blloku dhe Gani Çenazi nuk duhej të rrinin përballë njëri-tjetrit. Herë pas here Piroja pyeste veten: ku e

mësojnë njerëzit këtë thjeshtësi dhe si ka mundësi që njeriu të jetë kaq i natyrshëm në thjeshtësinë e tij?

Kur po ndaheshin, ai i tha Gani Çenazit:

— Do të të bëj dhe një pyetje të fundit, por mos merr për keq. Desha të di, çfarë ndien njeriu kur bëhet i njojur? Për shembull, ty tani të njeh gjithë Shqipëria. Çfarë përshtypje të bën kjo gjë? Ç'përshtypje të bën, kur hap gazetën dhe shikon në të emrin ose fotografinë tënde? Sigurisht që ti asgjë nuk ke bëre për lavdi, por sidoqoftë njeriu, kur bëhet i njojur, kur gazetat shkruajnë për të, duhet të provojë një ndjenjë të tillë, që...

— Jo, — tha ai papritur dhe për herë të parë në fytyrën e tij krejtësisht të zakonshme gazetari pa një shprehje të çuditshme.

Piroja u çudit. Gani Çenazi gjithë mëngjesin kishte qenë i qetë dhe asnjëherë nuk i kishte prerë fjalën.

— Ti kujton se unë e them këtë gjë se ashtu duhet? — tha Gani Çenazi. — Ose kujton se e them këtë gjë, se dua të tregohem i thjeshtë, ose, akoma më keq, se dua që ti ta shkruash këtë gjë në gazetë, dhe njerëzit të thonë: sa i thjeshtë na qenka ky Gani Çenazi! Jo.

Piroja e dëgjonte i hutuar.

— Ti do të më besosh, kur unë t'ë të tregoj një histori të vogël, — vazhdoi tjetri.

Ai i vuri dörën në sup gazetarit dhe ky i nguli sytë mbi jakën e arnuar të këmishës, që e kishte tani fare pranë.

— Para dhjetë vjetësh unë ndërtova i pari në Shqipëri një tip të ri stalle për viçat, — tha Gani Çenazi fare ngadalë. — Ti aherë ke qenë i vogël dhe me siguri nuk e mban menj se si kjo gjë bëri bujë kudo. Inicativa ime u bë kombëtare. Gazetat shkruanin për mua çdo ditë. Fotoreporterët vinin njëri pas tjetrit. Fotografitë e mia filluan të dukeshin kudo. Pastaj erdhën ata të Kinostudios dhe bënë një film dokumentar. Mua filluan të më stojnë në takime kombëtare, në konferen-

ca të ndryshme. Bile, kur shkova në Tiranë, fola dhe në radio. Në goftë se aherë do të kishte televizion, si tani, me siguri edhe atje do të dilja. Me një fjalë, u bëra papritur i njobur. Kjo gjë filloi të më pëlqente shumë. Më pëlqente që gazetat shkruanin për mua dhe që më lavdëronin nëpër konferenca. Që në mëngjes, porsa bleja gazetat, gjëja e parë që bëja, ishte të kërkova emrin apo fotografinë time. Kur i gjeja, i prisja me kujdes dhe i mblidhja në një album. Isha bërë si i dekur. Në stallat fillova të shkoja më rrallë. Punës nuk po ia varja. Unë kisha qenë gjithmonë një stallier i dalluar. Ishte hera e parë që më kapi një farë shkujdesjeje për punën. Shokët më kritikuin në mbledhjet e partisë. Dalngadalë buja e shtypit për mua filloi të shuhej. Kishte probleme të tjera, iniciativa të tjera. Tani, çdo herë që vinin gazetat dhe s'kishin gjë për mua, ndieja një mërzi. Megjithatë herë pas here shkruanin akoma. Unë isha vazhdimisht në pritje. Nuk e di si do të vente kjo punë, sikur të mos ndodhë diçka që u vuri pikën të gjithave. Më ngordhi një viç. Ishte dimër, ja, si tani. Viçi kishte qenë sëmurë dhe po të isha treguar më i kujdesshëm, ndoshta nuk do të kishte ngordhur. Mirëpo unë e kisha mendjen te lavdia. Në mesnatë më erди në shtëpi një nga vajzat e stallës duke qarë: — Kozi po vdes. U vesha dhe vravova në stallë. Viçi i sëmurë ishte shtrirë në brinjë. Kur u ula pranë tij dhe e përkëdhela në qafë disa herë, ai hapi sytë. Megjithëse ishte duke dhënë shpirt, më njobu. Ti nuk ke parë ndonjëherë sy viçi në çastin e vdekjes. Po t'i shikosh, nuk i harron dot kurrë. Ai më pa me pikëllim, sikur të më thoshte: «ike vëlla, ike, nëpër redak-sira» dhe i mylli përsëri. Pas dy orësh ngordhi. Unë vura kokën në duar dhe fillova të qaja si budalla. Ja, kështu.

Gani Çenazi nuk tregoi ç'ndodhi më tutje. Me sytë që i qenë skuqur pak, vështronte gazetarin e ri, i habitur që këtij të fundit i kishte bërë një përshtypje të jashtëzakonshme tregimi i tij.

Duke e mbajtur vazhdimisht për supesh, ai e çoi gazetarin te njëra nga të ndarat e stallës.

— Ja këtu unë mora një mësim të madh në jetë,  
— tha, duke treguar me gisht çimenton e lagët dhe të ftohtë.

Gazetari nuk i hiqte sytë andej. Ai ishte gjithashtu shumë i tronditur. Stallieri nuk e priste që gazetari të tronditej kaq shumë. Ndoshta sepse është i ri, mendoi.

Pastaj Gani Çenazi e përcollti gjer te hyrja e stallës dhe aty u ndanë.

Piroja u kthye mbasdite në T. përsëri me kamionin e qumështit. I mbështjellë fort me shall, rrinte ulur mbi spontin e kamionit (përpara shoferi kishte marrë një grua të sëmurë) dhe vështronte peizazhin dimëror. Toka ngjyrëkafë, vende-vende e kuqërrëmtë, po zinte një cipë të hollë ngrice.

Kur shkoi në dhomën e tij, në hotel, ai nxori një fletore nga çanta dhe për një kohë të gjatë ndenjë me laps në dorë mbi të. Ai donte të shkruante gjithçka. Donte të shkruante gjithçka, duke filluar nga vetja e vet. E dinte që kjo ishte diçka e pazakonshme për një gazetar, megjithatë e ndiente se duhej ta shkruante. Nuk mund të shkruante për të tjerat, pa shkruar më parë për të.

C'do të thoshin shokët, gazetarët e tjerë më të vjetër, kryeredaktori? Ky mendim i kaloi disi rrëshqitazi në kokë, por ai e dëboi. Mbështeti fletoren në gjunjë dhe filloi të shkruante frazën e parë: «Duke udhëtuar drejt qytetit të vogël T., ku duhej të bëja një shkrim për stallierin e njohur Gani Çenazi, unë, gjatë rrugës, mendoja se si në të ardhmen do të bëhesha një gazetar i njohur.» Ai u skuq gjer te veshët. Megjithatë vazhdoi.

## K E N G A

**P**erherë e më shpesh ai èndërronte vetëm një gjë: t'i ngrinin një këngë. Një këngë që të mund ta dëgjonte kur të binte mbrëmja në mal dhe në quell të kish-te ré.

Por kishin kaluar kaq vjet dhe atij askush nuk po i ngrinte këngë. Vallë asnijëherë, asnjeri nuk do të ngrejë një këngë pér mua? mendonte, megjithëse ishte ende i ri dhe një pjesë të jetës e kishte përpara.

Endrra pér një këngë i kishte lindur disa vjet më parë, ndërsa udhëtonte një natë vjeshte vetëm, midis maleve, pér në bajrakun e tij. Në të katër horizontet nata e shtonte lartësinë e frikshme të maleve dhe, tek ecte ashtu i vetëm, me pushkën në krah, atij nisi t'i dukej vetja i vogël nën peshën e errët të maleve të mëdha. Pikërisht atëherë, tekxa e ndiente shpirtin të dërrmuar nga vogëlsia e tij, dëgjoi një këngë diku larg. Një zë i zvargur, i thekshëm këndonte një këngë trimërie, diku në një kasolle, që e kishte mbuluar errësira. Era ndryshonte drejtimin e zërit, dhe ai nuk e kuptoi dot se në ç'anë këndohej kjo këngë, gjersa

ajo u shua dalngadalë dhe mbeti diku, prapa maleve, më e pakapshme dhe më e përjetshme se malet vetë. Dhe papritur atij i lindi ëndrra e tij e madhe: të këndohej emri i tij në një këngë, në një këngë të zvar-gur, tronditëse, në gjirin e zi të natës.

Që atëherë kishin kaluar vjete dhe jetë e tij kishte mbetur pa këngë. Është e vërtetë se këngët e reja në malësi ishin shumë të rralla, por megjithatë kishte të tilla, ashtu siç kishte edhe këngë për të gjallët. Vallë asnjeri nuk do të ngrejë një këngë përmua? mendonte ai dhe ngrysej çdo ditë e më tepër.

Një ditë, në pazarin e një qyteti të largët, vrau një njeri mu në mes të kafenesë. Ky njeri qe nga një familje, me të cilën fisi i tij ishte në gjak prej vjetësh. Atij s'i binte të merrte gjakun, sepse fisi i tij ishte i madh, dhe ai ishte më i largëti i njeriut që qe vrarë i fundit midis dy familjeve. Megjithatë rrezikoi kokën dhe vrau gjakësin mu në mes të kafenesë së një qyteti të largët. Por edhe pas kësaj asnjeri nuk i ngriti këngë. Mbrëmjeve të errëta ai priste më kot të dëgjonte këngën e tij. Mbrëmjet vimin e shkonin, të ftohta, të mërzitshme dhe memece.

Asnjëherë, asnjeri? mendonte i zbehtë, duke vësh-truar bashkëfshatarët e lodhur, që ktheheshin mbrëmjeve me nga një thes misër mbi kurriz nga vende të largëta. Domethënë asnjëherë, asnjeri.

— Kënga kushton shtrenjtë, — i kishte thënë një ditë një plak i bajrakut të tij. — Mos lakmo përkëngë, djalo, kënga lyp kokë.

S'më besohet, kishte thënë me vete, kaq shtrenjtë të paguhet një këngë? Por edhe sikur të jetë ashtu...

Një natë rrëmbeu një vajzë nga një bajrak tjetër dhe u martua me të. Nuk e donte atë vajzë, por e rrëmbeu që emri i tij të dëgjohej kudo. Por kaluan javët e muajt e dimrit, me dëborë dhe erë, dhe ai i shkonte ditët me gruan e tij të re, që e kishte kuptuar se ai nuk e donte dhe prapë këngë për të nuk kishte.

Ndoshtë kur të vijë pranvera, mendonte dhe në sy kishte një pikëllim të thellë. Në pranverë është më lehtë për të ngritur këngë.

Por pranvera erdhi dhe shkoi dhe në asnjë anë nuk u ndie ndonjë këngë për të. Ndoshata në verë, mendoi më vonë. Ahere netët do të jenë të ngrohta dhe njerëzit do të kenë më pak urë.

Por vera shkoi dhe sytë e tij u bënë më të thellë dhe më të ngrysur. Zogjtë, trumba-trumba, i braktisën bjeshkët, dhe nga verilindja vinin vazhdimesht retë e ngarkuara me shi. Era vërshëllente mbi atë boshllék të madh.

Një mbrëmje vjeshte grumbullin e dasmorëve që kishte marrë një nuse në një katundth të largët, e zuri shiu pranë një fshati të madh. Ndërsa po shpejtonin kuajt, ata panë të shtrirë përmbyss një njeri ndanë udhës. Pushkën e kishte ende krahaqafë dhe shiu i kishte qullur flokët dhe ia kishte shpëlarë gjakun e ngrirë. Një nga dasmorët e ktheu mbarë të vrarin, por asnjieri nuk e njohu. Dasmorët e lanë të vrarin në mes të udhës dhe nganë kuajt drejt fshatit të madh, ku duhej të kalonin natën në një han. Në han, ndërsa po pinin raki, njëri prej tyre, një plak i thatë, ngriti një këngë me lahutë, për një njeri të panjohur, të vrarë në mes të udhës, që dergjej në shi përmbyss.

Të nesërmënë mëngjes dasmorët u nisën përsëri drejt grykave të maleve të larta të mbuluara me ré, duke marrë këngën me vete.

## EVROPA E MBRETËRVE

I shpejt ora nëntë e mbrëmjes, kur hyra në dhomën e hotelit. E lashi valixhen pas derës, ndërsa çantën e dorës e hodha mbi krevat. Pas pak e ngrita çantën dhe e vura në tryezë, kurse valixhen e shtriva horizontalisht mbi një lloj froni prej druri, që, me sa duket, ishte bërë enkas për këtë gjë. Në minutat e mëpastajme bëra edhe disa lëvizje e gjeste të tjera, të cilat i bën me siguri çdo njeri i vetëm, që porsa ka mbërritur nga largi në një dhomë hoteli. Dihet si përfundojnë zakonisht këto lëvizje gjysmë-të pavetëdijshme: njëri i zhvilluar edhe një herë në katini e parë të hotelit, i këndshëm, i afrohet te nepunësi i shërbimit dhe, nga të gjitha pyetjet e mundshme, bën atë më të paravevojshmen. Të njëjtën gjë bëra dhe unë. Pas këtij rituali, u ngjita përsëri lart dhe po mbyllja derën pas vetes, kur dëgjova orën e kishës, fqinjë që ra nëntë herë. Në ndërgjegjen time u skicua vagëllimthi fakti që ndodhesha në një nga ato vendet e planetit, ku njerëzit akoma besojnë te Krishti dhe ku të thérresin «zotni». Po në atë çast, paralelisht me këtë mendim pak a shumë të përgjithshëm, më kaloi nepër kokë mendimi

konkret se duhej të haja darkë. Vesha përsëri pardësy-në dhe zbrita poshtë, këtë herë me lëvizje më të për- caktuara.

Në rrugë binte një shi i imët. Tetë muaj më parë kisha jetuar disa javë këtu, kështu që pak a shumë e njihja këtë rajon të Parisit. Ai ishte i rëndë, i ndri- çuar pak dhe aristokratik. Kalldrëmi i rrugës Sufren, i lagur nga shiu, ngjante si i çeliktë. Trotuaret ishin pothuaj të shkreta, dhe cijatja e gomave të makinave në rrugë e shtonte më shumë ndjenjën e shkretimit. Që larg xhamillëku i kafe Sufrenit dukej akoma i ndri- çuar, dhe unë shpejtova hapat për të arritur atje para mbylljes. Në këtë rajon kafet ku mund të haje darkë mbylleshin herët.

Brenda ishte ngrrohtë. Ishte po ai kamerier i ri, flokëkuq, i vitit të kaluar, i cili kishte zakonin që, në kohën që çonte porosinë, hapat e fundit drejt banakut i bënte duke rrëshqitur, si në patinazh.

Kur dola nga kafja, vazhdon të binte po ai shi i imët. Një copë herë qëndrova në udhëkryq duke qenë në mëdyshje, të kthehesha në hotel apo të shë- titja edhe pak. Ishte një shi kaq i imët, saqë nuk të ndihmonte të merrje asnjë vendim. Më në fund, pa vendosur ç'të bëja, kapërceva rrugën dhe eca drejt Fushës së Marsit, nëpër njérën prej rrugicave, shumica e të cilave mbanin emra gjeneralësh. Silueta e kullës Eifel, me projektorin rrötullues në majë, derdhite një heshtje hekuri mbi gjithë rajonin. Nuk më duheshim vëçse pak minuta ecje me këmbë për të arritur nën hekurat e saj.

Frynte erë e ftohtë. Fusha e Marsit ishte e zymtë, si gjithmonë në këtë orë, miqjithatë diku në mesin e saj kishte një ndriçim të bardhë, të pazakonshëm. Kujtova se mos po xhironin ndonjë skenë filmi dhe eca në atë drejtim. Kur u afrova dhe ca, dallova ca konstruksione të mëdha, në formë tribunash për festë që, me sa dukej, po i prishnin. Ca kalimtarë të rrallë kishin qëndruar mënjanë e po bënин sehir. Ishte

një shkulje madhështore. Dërrasa, mbajtëse metalike, frona binin me rrapiellimë në tokën e lagur nga shiu.

— Ç'është kjo? — pyeta me zë të ulët një nga kalimtarët.

— Mbretëresha Elisabetë, — tha ai, duke e shtremberuar qoshen e djathtë të buzës, për të mos e hequr cigaren nga goja.

Unë nuk kuptova asgjë, por nuk pyeta më, sepse e kisha të qartë që nga një gojë, e cila e pi cigaren pa e hequr nga buzët, nuk mund të presësh vëçse minimumin e informacionit. Veç kësaj, fytyra e të panjohurit ishte tepër e vrenjtur.

Konstruksionet metalike dhe prej druri vazhdonin të binin me zhurmë përdhe. Tribuna, (në qoftë se ato kishin qenë tribuna), dukeshin si të kafshuara për vdekje në shumë vende.

— Mbretëresha Elisabetë, — përsëriti i panjohuri përbri meje. Ktheva kokën dhe pashë se ai e kishte hedhur më në fund cigaren. Nuk kisha parë ndonjë fytyrë që mund të ndryshonte kaq shumë nga heqja e cigares. Ajo kishte tani një shprehje babaxhani. — Nuk i keni lexuar gazetat? — vazhdoi. — Mbretëresha e Anglisë erdhi dje në Paris, kurse sonte pikërisht këtu u bë një paradë me kuaj për nder të saj.

— Aha, — ia bëra unë.

— Paradë me kuaj, frone, opera komike, — tha ai, — të shqyshesh gazit.

Ai filloi të qeshte duke u kollitur, pastaj bëfas e preu të qeshurën dhe më vështroi.

— Apo ndoshta ti je riënshtetas i ndonjë mbretërie dhe të fyeva padashur? Më fal atëherë.

Unë desha t'i thosha se nuk isha aspak riënshtetas i ndonjë mbretëri, përkundrazi, përkundrazi, përkundrazi... Dhe, veç kësaj, desha të thosha se, para disa ditësh, në Danimarkë, kisha qenë në një hotel me perandorin Hirohito dhe, dhe... Mirëpo më duhej së paku një çerek minute për t'i formuluar në frëngjisht këto fjalë.

Në kohën që ktheva kokën pér t'i folur, pér fat tē keq, ai kishte ndezur një cigare tjetër, dhe ftyra e tij ishte egërsuar përsëri. Dukej sikur cigarja, e ngulur midis asaj ftyre, e sundonte atë si shkopi i një tirani.

Në këmbët tonë vazhdonin të rrokulliseshin dërrasa dhe frone të lagura. I panjohuri bëri befas një kthim të vrullshëm dhe iku duke sharë me gjysmën e gojës. Herë pas here përpara rrokopujës së dërrasave të shkulura ndalonin kalimtarë të rrallë.

— Çështë kjo? — pyeti dikush, që kishte qëndruar në këmbë përbri meje.

— Mbretëresha Elisabetë, — thashë pa e kthyer kokën. Ndjeva se ftyra e të panjohurit mbeti edhe disa sekonda e kthyer nga unë, duke pritur, siç duket ndonjë sqarim tjetër. Mirëpo në çast futa dorën në xhep dhe rrasha me shpejtësi në gojë një cigare. Pas pak u ktheva krahët tribunave të përgjysmuara dhe ika.

Nuk më vehej në hotell. Nëpër mend më kaloi ideja se që këndeje gjer në Shanz Elize nuk ishte më shumë se njëzet minuta ecje me këmbë (herën e kaluar e kisha bërë shpesh këtë rrugë), mirëpo vazhdonte të binte shi dhe unë nuk kisha çadër. Veç kësaj, në një orë të tillë Shanz Elizeja gjithashtu duhej të ishte e shkretë.

U nisa drejt hotelit duke ecur nëpër njérën prej rrugicave që mbanin emra gjeneralësh. Nga ngushtësia e trotuarit dhe ndriçimi i paktë i rrugës dukej se ky nuk do të kishte qenë ndonjë gjeneral tepër i lavdishëm.

Holli i hotelit ishte i qetë. Në një kënd dy-tre bujtës po shikorin televizorin. U ulë në një nga kanapetë dhe fillova të ndiqja mbarimin e një filmi. M'u kujtua se pas pak duhej të jepej emisioni i fundit i lajmeve. Skisha asnjë shenjë gjumi.

Lajmet e fundit filluan pak para mesnatës. Mbretëresha e Anglisë në Paris. Kamera rrëshqiti mbi ca

konstruksione të mëdha në formë tribunash. Fusha e Marsit. Paradë me kuaj për nder të mbretëreshës. Tribunat ishin plot me zyrtarë të lartë, duar që përshtendefnë dhe buzëqeshje. Tani atje gjithçka është shkallmuar dhe po laget në shi, mendova ngathtësisht. Lajmet ishin të gjata dhe të hollësishme. Në fund bulletini për kohën. Gjithë ditën mbi Paris kishte rënë shi i hollë. Të nesërmen do të ishte e njëjtë gjë.

U ngjita në dhomën time. Në Kopenhangë kisha fjetur në një hotel shumë më të mirë. Perandori japonez erdhi e u vendos, për çudi, pas tri ditësh në katin e tetë të po atij hoteli. Ne po pinim kafe në katin e parë, kur ai mbërriti nga aeroporti. Trupvogël, me një pamje pak të përvuajtur, ai ngjante më tepër me një arsimtar province, sesa me një perandor. Dy hapa pas vinte perandoresha. Telekronistët xhironin pa pushim. Në fytyrat e shumë njerëzve dukej pyetja: ç'e detyroj perandorin Hirohito të dalë nga vendi i tij për herë të parë pas dhjetëra vitesh? Pëshpëritej diçka që kishte lidhje me zhvleftësimin e dollarit dhe të jenit japonez. Në pamjen e jashtme dukej banale. Ishte një dhjetëpërqindësh, një 10-përqindësh fatal, që e bënte perandorin e vendit të Diellit të linte mënjanë madhështinë dhe të dilte nga mjegulla legjendare perandorake, që e mbështillte prej vitesh. Shfaqu, fantazmë...

Në qoftë se udhëton nëpër Danimarkë, ke apo s'ke lidhje me letërsinë, ideja e fantazmës mbretërore të ndjek herë pas here. Në çantë (atë e kisha hequr tanë nga tyreza dhe e kisha flakur mbi karrige) kisha disa shënimë për kështjellën Kronborg, apo kështjella e Hamletit, siç e quan gjithë bota. Ishte një kënaqësi të vërtetë ta vizitoje Elsinorin në një ditë vjeshte. Në qytetin e vogël ndihej sundimi i princit të pikëlluar. Hotel «Hamlet». Afishe: Viziton barin «Ofelia». Cigare «Princ».

Kështjella ishte e kuqërremptë. Rreth e rrotull ndiheshin arti dhe krimi. Kamali rrethues ku u mbyt Ofelia. Korridoret dhe shkallët e intrigave. Aparta-

menti i mbretëreshës me dritare nga deti. Perdja, prapa së cilës ishte fshehur Polloni. Ledhi ku u shfaq për herë të parë fantazma.

I kisha shënuar me hollësi të gjitha këto.

Në të vërtetë historia e Hamletit (apo Amleth-it), siç e kishte treguar kronisti danez Saxo, kishte ndodhur shumë larg që këndej, në pjesën veriore të Jutlandit, atje ku është duket sikur mbin mbi dunat e shkretëtirat. Mirëpo Shekspiri e konceptoi tragjedinë pikërisht në kështjellën Kronborg. Ai kishte ardhur këtu bashkë me trupën e teatrit «Globus», të cilën e kishte ftuar mbreti danez për të dhënë shfaqje në kështjellë. Nga gjithë anëtarët e trupës, ndoshta Uiljami ishte ai që kishte dietën e shërbimit më të vogël. Në ditët e mysafirillëkut ai do të jetë njojur rastësisht me kronikën e Saxos dhe atje, midis rrëmujës së prapaskenës, smirës dhe grindjeve banale të aktorëve, truri i tij, duke filluar të nxohej e të përshkënditej si një masë magme, kishte filluar të konceptonte dramën.

Megjithëse historia nuk kishte ndodhur këtu, Kronborgu ishte në të vërtetë kështjella e Hamletit. Në një farë mënyre ajo i ngjante një njerke të tij, por një njerke të gjallë, përderisa kështjella nënë s'dihej ku ishte, në brigjet e langëta të Jutlandit, e ngrënë nga erërat e Detit të Veriut, pranë dunave të vdekura.

Në shënimet që i kisha në çantë, kisha shkruar se isha kthyer për të dytën herë, në apartamentin e mbretëreshës. Ky qe një apartament i zyntë e gati i zhveshur, si të gjitha ambientet mesjetare. Në fund të dhomës me dritare nga deti kishte vërtet një perde dhe një si kamare të madhe, ku mund të fshihej fare mirë një njeri. Shoqëruesi danez më shpjegoi se mbretëresha rrinte shpeshi këtu e mërzitur, sepse mbreti vuante nga një sëmundje psikike. Në kamaren prapa perdes fshihej një nga ministrat, apo ndoshta vetë kryeministri, për të ruajtur mbretëreshën, kur atje vente për vizitë mbreti i sëmurë. Në shënimet e mia kisha shkruar: mos Shekspiri është bazuar mbi këtë

detaj për të krijuar skenën e vrasjes së Pollonit prapa perdes? U përpoqa të sqaroja këtë gjë me shoqërueshin danez por s'ishte e mundur. Në ndodheshim pikërisht në nënportalin ku duhej të ishte shfaqur fantazma, dhe frëngjishtja e pasaktë e të dyve bëhej edhe më fluide, për shkak të erës që na vërvhellente në veshë. Në të vërtetë unë desha t'i bëja atij një pyetje tjetër, më të drejtëpërdrejtë. Dhe do t'ia bëja atë, sikur të mos isha mysafir në këtë vend. Pyetja ishte: besoni ju, vërtet, në këto histori mbretërish?

Unë prej kohësh nuk besoja më në to. Kishin ndodhur krime, kishin ndodhur tmerre, kjo as që vihej në dyshim, por shkaqet e vërteta të tyre ishin mbuluar me kujdes. Kjo ishte histori e vjetër, që kishte filluar qysh me ikjen gjoja të Helenës një natë nga shtëpia e burrit-mbret për tek i dashuri — princ. Unë nuk besoja në ikjen e Helenës. Gjatë gjithë luftës së Trojës ajo me siguri ndodhej në Greqi, e fshehur në ndonjë fshat klimatik, duke pritur mbarimin e luftës. Gjithë dekorë lugato-xhindëror i mesjetës nuk ishte veçse një maskë për të mbuluar të vërtetën. Shfaquni me fytyrën e vërletë, fantazma! Këtë thirrje e kishte bërë Marks. Gjithë ato plagë të tmerrshme, po t'i shikoje me kujdes, nuk ishin gjë tjetër veçse të cara në formë llogarish, pika gjaku në formë zeroosh të shifrave. Fantazmat përpinqeshin të mbulonin shifrat. Ç'ishin në fund të fundit tri shtrigat — magjistica që iu shfaqën Makbethit? Në një teatër të Parisit, vitin që shkoi, tri magjisticat ishin jo plaka të veshura me zhele... por tri vajza të bukura me kostum bamje. Kurse për mua ato ishin, në radhë të parë, tri ekonomiste. Në kazanin e magjisë ato nuk hidhnin bretkosa, zhaspinj, gjuhën e një qeni, luspat e një përbindëshi, krahët e bufit të natës, dhëmbët e ujkut, mjekrën e cjapit, gishtin e një foshnje, veshkën e një çifuti, siç tregon kronika mesjetare, por tjetër gjë. Ato hidhnin në të llogaritë e taksave, gjendjen e thesarit, deficitin e tregtisë së jashtme, qarkullimin e monedhës, em-

bargon e naftës... Nga zierja e çorbës dilte pastaj para-shikimi i krimit të ardhshëm. Ishte ai dhjetëpërqindëshi fatal që e bënte perandorin e samurajëve të bujtte në një hotel prej xhami, mijëra kilometra larg vendit të vet. Përse kishte ardhur në Paris mbretëresha Elisabetë? Tregu i përbash... Mjaft, thashë me vete dhe u ngrita për të çmpirë këmbët. Po lëvizin mbretërit, mendova pas pak.

Një copë herë i rashë kryq e tërthor dhomës. Kishte kaluar mesnata, por prapë nuk më flihej. Ndërsa ecja nga dera drejt dritares, papritur zbulova se droma ime kishte ballkon. Mënjanova perden, gjeta do-rezën e derës së ballkonit, e shtyva derën me kujdes dhe dola. Ishte një ballkon i ngushtë me hekura, siç është shumica e ballkoneve të Parisit. Ishte shumë ftohtë, dhe lagështia e natës të hynte gjer në mushkëri. Që nga ballkoni dukej rruga e lagur dhe dera prej xhami e hotelit. Vështrova një copë herë poshtë dhe po bëhesha gati të hyja prapë brenda, kur pasqë një motoçikletë që ndaloj te dera e hotelit. Nga motoçikleta zbriti një oficer i policisë, i mbështjellë me mushama. Ishte ora një e natës. M'u kujtua se zakonisht në këtë orë policia e Parisit mblidhët nga të gjitha hotelet informacionin për bujtësit. Pas disa minutash oficeri doli dhe i hipi motoçikletës. Mushamaja e tij e zezë shndriste në shi. Ndërsa dy dritat e kuqe të sprasme të motoçikletës po humbnin larg, më shkoi nëpër mend se në çantën e tij me lëkurë të zezë, midis emrash të tjerë, ndodheshin të shënuara tanë emri im, profesioni, adresa e numri i pasaportës, fakti që kam grua dhe një vajzë të vogël. Të gjitha ato po vraponin tanë nën atë mushama, të zezë, diku larg, në thelli të qytetit të madh. Pas kësaj hapa derën e ballkonit dhe hyra brenda. Mendova se edhe e drejta e pagjumësisë ka një kufi dhe vendosa të shtrihesha paravësish se nuk doja të flija. Gjumi më afrohej herë-herë me atë hap të çuditshëm që nuk shkon as përrapa, as prapa dhe që mund të jetë vetëm e ecura e tij.

Ai më avitej në formë tribunash të lagura, që një dorë e padukshme i çmontonte vazhdimisht, duke mos i lënë asnijëherë të bashkoheshin. Megjithatë, aty midis mesnatës dhe mëngjesit, e kuptova që kisha fjetur, për vetë faktin që u zgjova. Ishte një nga ato lloj zgjimesh që duken sikur shkaktohen nga qetësia e thellë. Për një kohë të gjatë, krejtësisht i palëvizur, i mbajta sytë mbi refleksin e zbehtë të dritës, që binte mbi tavanin e dhomës. Pastaj, papritur, m'u duk se midis qetësisë dëgjova një si rënkim. Një pjesë e ndërgjegjes sime ishte akoma nën hijen e gjumit, dhe ajo që dëgjova, nuk më bëri asnijë përshtypje. Por, kur rënkim i përsërit për të tretën herë, u zgjova plotësisht. Në fillim kujtova se më bënë veshët dhe lëviza kokën në jastëk, duke zbuluar herë njërin vesh, herë tjetrin nga kontakti me të. Zhurma e largët në formë rënkim i përsërit. Kjo nuk ishte një zhurmë njerëzore, por as zhurmë sendesh. Drejtimi nga vinte dhe largësia e saj ishin gjithashtu të papercaktuara. Njëherë kujtova se mos ishte një shfryrje kaloriferësh, po zhurma kishte një ndërprerje ritmike që mund ta shkaktonte vetëm një mushkëri e gjallë. C'më duhet, mendova pas pak dhe u ktheva në brinjë duke zbuluar edhe veshin tjetër me kuvertë. Një copë herë qëndrova ashtu. Por pas një minute e hoqa kuvertën dhe mbajta vesh. Rënkim i përsërit. Më kishte qëlluar shpesh të dëgjoja rënkimë nga më të ndryshmet, por një rënkim të tillë, pa burim, që rinte si i varur në erë, llampadar i padukshëm nën këtë qiell të madh, nuk më kishte qëlluar të dëgjoja kurrë. Ndoshta vjen nga lodhja, mendova. Pastaj më shkoi ndër mend mendimi se kështu mund të fillonte fare mirë një roman policor, po kursesi qëndrimi im në Paris, dhe fjeta.

Sido që ta kalojë natën njeriu, gjendja e tij shpirtërore në mëngjes është gjithmonë më e mirë se ajo që duhej të ishte, po të konsiderohej fillimi i ditës si vazhdimi i natyrshëm i natës.

Unë nuk e ndieja veten të lodhur. Hëngra mën-gjes në hollin e hotelit dhe dola menjëherë në rrugë. Ishte një nga ato mëngjeset e vjeshtës që janë aq të lehta për t'u përshkruar, saqë mund t'u rekomandohen si ushtrime të para fillestareve në letërsi. Nuk binte më shi, por në gjithë hapësirën e lagësht ndihej një vallëzim i padukshëm piklash uji, të cilat mund t'i merrje ose si pluhur i mbetur nga shiu i shkuar, ose si farën e një shiu të ri.

Kanërceva rrugën «Sufren» dhe po ecia drejt kullës Eifel, maja e së cilës prekte miegullën. E ripro-dhuar në miliona conë emblemash, miniaturash heku-ri, nikeli, argjendi, bile dhe ari, e shitur me të gjitha emimet në të gjitha kioskat e Parisit. Gjithë ky konstruksion hekuri, i kthyer në simbol, nuk e kishte më forcën për të bërë përshtypie, ashtu sic nuk të bëjnë përshtypie shenjëzat në horizont.

Nën këmbët e kullës bleva një gazetë dhe, ndërsa po kanërceia urën e Jenës për të dalë në bregun e diathtë të Senës, i hodha një sy fages së parë: Bre-zhniewi arrin nesër në Paris. Nuk e kisha ditur një gjë të tillë. E futa gazetën në xhen për ta lexuar me qetësi në ndonië kafe dhe shpeitova hanat. Kisha nië ditë krejtësisht të lirë për të shëtitur. Nuk kisha bërë as-nië plan dhe kisha vendosur të shkoja nga të më mbushei. Përbalje meje ngrihei në një lartësi të butë pallati Shaio, në një nga sallat e të cilat, midis eksponateve të shumta muzeale, ishin edhe disa manikena të veshura me kostume nonullore shaiptare. Vitin që shkoi cdo mëngjes kur e bëja këtë rrugë, ai grup i vogël fshatarësh e fshataresh të vendit tim, me atë bukur paksa të hutuar dhe përtej realitetit, aë i iep gjithmonë ftyrave nierëzore materiali plastik i manike-nave, më dukej sikur më bënин me dorë që nga maja e kodrinës.

Në stolat e mëdhenj të ngulur në të dyja anët e rruginës që ngjitej drejt pallatit Shaio dhe Trokaderos, kishte gjethë të rëna: Parisi është një qytet që e

tregon vjeshtën. Ndryshe nga shumë qytete të mëdha, që e shtypin atë më betonin e tyre, Parisi nuk mund ta fshehë. Në qoftë se nuk e takon vjeshtën në njëqind metrat e parë të ecjes sate, në njëqind metrat e dytë do ta takosh me siguri.

Në stolat e mëdhenj të hekurt, si gjithmonë, ishin ulur aty-këtu, për t'u çlodhur nga ngjitja, kalimtarë me moshë paksa të thyer. Në qoftë se kalon përbri tyre, mjaftron që t'i ndalësh sytë dy-tri sekonda mbi ta dhe ata tundin kokën e të buzëqeshin me atë mënyrë familjare që krijohet nganjëherë në vendet publike midis të panjohurve, kur ka një motiv të përbashkët që i ndan ose i bashkon njerëzit. Siç e shikon. S'jemi më të rinx, thoshin sytë e të ulurve në stola. Ah, njëherë e ngjitja me një frymë Trokaderonë, kurse tani, siç e shihni dhe vetë... Ashtu ishtë, mosha bën të sajën, Orëuar. Orëuar, mësjë.

Po bëhesha gati të merrja rrugicën me stola, kur në një shtyllë hekuri më zunë svtë disa afishe të muzeut të artit modern. Vitin që shkoi isha nisur disa herë të shkoja te ky muze, as më tepër se ai ndodhej shumë afër, pothuaise fainj me vendin ku banoja. Por ishtë ndoshta pikërisht kjo afërsi që më bënte ta shtyja vizitën për ditën e nesërme, giersa më në fund ika pa e parë dot. Tani afishet laimëronin për ekspozimin e shumë veprave të tjera moderne.

Pa u menduar fare, ndërrova dreitimini dhe eca përbri Senës, në dreitim të muzeut. Ndërsa ecia, ma dha vërsëri nië dhembie e mprehtë koke. Kuitimi i turbullt i natës së mundimshme që kisha kaluar dhe sidomos i atij... i atij... rënkit... në qoftë se mund të cuhej kështu... kaluan rrëshqitazi në ndërgiegien time. Kisha hërë nië giumë kreitësisht të copëzuar gier ndaj të edhirë (nië antiroman nuk mund të kishte nië kompozicion më kaotik sesa ky giumë) dhe sa herë që isha zgiuar, e kisha dëgjuar atë rënkim. Duke hyrë në ndërtesën e madhe të muzeut, e hoqa mendjen prej natës së kaluar. Në tarracat e gjera të muzeut, midis

statujave dhe barelieveve klasike prej mermeri, ishin vendosur qindra eksponate moderniste. Tarracat ishin të pambuluara. Ishte ftohtë, dhe pikëzat e akullta që notonin në hapësirë, synonin përherë e më shumë drejt krijimit të një shiu. Tarracat ishin të shkreta. Tek-tuk ndonjë vizitor i rrallë, i mbështjellë me pardësy, kishte mbetur krejtësisht i humbur, një formë krejtësisht e huaj, gati armiqësore, midis skulpturave moderniste. Mua m'u duk se frynte një erë e akullt dhe ngrita jakén e pardësysë. Në të vërtetë nuk frynte erë. Ndjesinë e saj e krijonin format skulpturale. Ishte një shkretim i botës. Nga, të gjitha anët shfaqeshin ca forma vezake, në trajtë amebash, me një lëmim të përbindshëm. Ishin ca sipërfaqe rrëshqitëse, të ftohta akull, që të përftonin idenë e diçkaje idioteske. Këtë, më tepër se çdo gjë, e krijonte ndoshta ai lëmimi i tyre i padurueshëm, që i bënte ato të ngjasonin me ca forma trunore, por të një truri të pazhvilluar, pa asnje rrudhë cirkovolucionesh. Kjo ndjesi idiotësie ndërthurej me ndjesinë e shkrefimit, që e shkaktonte ndoshta ngjasimi i skulpturave me ca gurë të lëmuar nga erërat anוניתë të shkretëtirës. Në të vërtetë, e gjithë kjo dukej sikur i kishte rrënjet në një sipërfaqe të madhe Sahare, në kohërat tragjike, kur kjo sipërfaqe kishte filuar të ndahej nga jeta, burimet e saj shteronin, gjithçka thahej, vdiste. Dhe nuk mbetej veçse një erë e pambarim që lëmonte gurët, i lëmonte, i lëmonte papushim, gjer në humbjen totale të çdo rrudhe apo damari në to. Ishte një erë marrëzie, që dukej sikur përpinqej të lëmonte trurin e botës.

U mbështolla akoma më fort me pardësy dhe doja të vrapoja për të dalë sa më shpejt nga këto tarraca vdekjeje, ku më dukej se në çdo çast do të më binin flokët, sytë dhe gjithçka tjetër njerëzore që kishin gdhendur mijëvjeçarët mbi lëkurën time. Ik nga lëmimi, thashë me vete. Vrapo sa nuk është vonë. Por këmbët mezi lëviznin, sikur nën to të ishte vërtet mbretëria e rërës.

Kur dola nga muzeu, ndihesha i lodhur. Kisha ftohtë. Mbi qytet ishte po ai qiel i njëjësuar, i shtrirë uniformisht mbi gjithçka. Ndërsa ecja drejt Shanz Elizesë, tek vështroja fasadat e ndërtesave, ballkonet metalike, portalet, kupolat, gjithë ato gdhendje të stërholluara me bronz, hekur e gur, më shkoi ndër mend mendimi se a kishte ndonjë kundërvënie midis këtij dekoracioni të rëndë mesjetar dhe atij lëmimi ngjethës, prej të cilit porsa kisha dalë. S'kishte dyshim se i gjithë ky kaldrëm mbretëror që shtronte pjesën më të madhe të Evropës, ky ndryshk arkitektoral, këto emblema dhe kjo madhështi e rreme fantazmash kishin mbuluar me statizmin e tyre hijerëndë ato përqindjet e vogla, banale, që gjëllonin si krimba të pavdekshëm në themelet e gjithçkaje. Mirépo, në qoftë se këto gdhendje arkajke ishin përpjekur ta fshihnin të vërtetë, mos vallë ky lëmim e zbulonte atë?

Duke ecur gjithmonë e më shpejt, përpinqesha të merrja me mend se sa i zhgënjer do të dilte ai njeri, që do të besonte në një kundërvënie të tillë. Kjo do të ishte njëlloj sikur ky njeri, pasi të kishte ikur në panik duke u shpëtar putrave të luanëve që ngriheshin aty-këtu përpara portaleve të vjetra metalike, të kërkonte shpëtim në gjymtyrët e atyre giallesave të lëmuara të muzeut modern.

Që larg në Shanz Elize dukej një varg i pafund flamurësh të varur nëpër shtylla. Përse vjen vallë Brezhnjevi në Paris, thashë me vete. Trotuaret e gjera të Shanz Elizesë janë me siguri nga ato vende ku njerëzit lëvizin më ngadalë në këtë qytet. Vitrinat e gjera duket sikur derdhin nën këmbët e kalimtarëve një lëng viskoz, të tejdukshëm; që pengon, si në èndërr, ecjen e tyre. Në tarracat e mbyllura me xham të kafeneve, njerëzit, të ulur nëpër karrige fare ngjitur, si në kinema, vështronin rrugën.

Ja dhe një monark tjeter, mendova duke u ndalur përpara vitrinës së një magazine luksoze qilimash. Midis sixhadeve pronari i magazinës kishte vendosur

një fotografi të shahut dhe të shaheshës së Persisë. Shahu ishte me kostum të zi, tepër elegant, kurse ajo kishte një shikim paksa të pikëlluar. Vëtëtimthi (veçse me zbehtësinë e drithës së një qiriri) më shkoi nëpër mend dhoma e mbretëreshës, përballë Detit Verior, në kështjellën e Hamletit. Dhe po në atë çast e aq ngathësisht m'u kujtua se kisha lexuar disa herë, në disa revista, për ish-shaheshën persiane... në mos gaboja Soraja... të cilën ai, mbreti... e la, i detyruar nga parlamenti... ngaqë s'bënte fëmijë... dhe ajo iku në Evropë... ku u bë artiste filmash... dhe ai, mbreti... e kujtonte akoma me mall tanë... e të tjera e të tjera. Shtypi evropian dhe botëror ishte marrë për një kohë të gjatë, shumë më të gjatë, me këtë, bile një mbrëmje, nuk më kujtohet mirë ku, një shok imi kishte thënë: more, po si shumë po merret Evropa me një... shaheshë të lë-në nga burri.

Një copë herë eca ngadalë rrëzë trotuarit. Lëngu viskoz i vitrinave derdhej në këmbët e mia, trashej e trashej vazhdimesht. Ja, përsëri një magazinë qilimash. Dhe përsëri, midis sîxhadeve, fotografia e çiftit mbretë-tëror. Ngjitur me të një afishe: këto ditë në ish-kryeqytetin e lashtë persian, Persepolis, do të bëhet festimi i dëmijepesëqindvjetorit të themelimit të dinastisë më të vjetër perandorake të botës.

Ah, ja si qenka... ah, ja ku qenka... Në mendjen time po ndriçohej diçka. Shahu i Persisë, qilimat persianë, të gjitha llojet e qilimave, bile dhe ato prej najloni, bile dhe tapetet sintetike lidheshin në një farë mënyre në mendjen e njeriut, padashur, me emrin e Persisë dhe kështu... tregtarët e fuqishëm të qilimave... dinin ta shfrytëzonin fare bukur këtë shoqërim idesh... Kështu shpjegohej gjithë ajo bujë shumëvjeçare në shtyp për intimitetet e mbretëreshës, për pikëllimin shahor... Kurse, në të vërtetë, prapa tyre ishin çmimet e qilimave dhe të naftës, ai dhjetëpërqindëshi i mallkuar që e nisi për udhë të gjatë perandorin japonez. Duhej t'i kishte trutë të lëmuar, si ato format skulpturale të

muzeut të artit modern, që të mos e kuptoje disi këtë gjë.

Isha i sigurt se, pas një dite të lodhshme, do të flijë më në fund i qetë në dhomën time të hotelit. Por nuk ndodhi ashtu. Rënkimi i çuditshëm, të cilin po-thuajse e kisha harruar gjatë ditës, (bile kisha dyshuar në ekzistencën e tij), u dëgjua përsëri. Duhej të kishte kaluar mesnata, kur nuk di pse u zgjova dhe akoma me ndërgjegje të turbullt, gati instinktivisht, ngrita kokën nga jastëku dhe mbajta vesh. Qetësia e thellë derdhej në gropën e veshit tim si një grumbull i madh e i shurdhër qymyri që groposet në humbellë. Dhe tamam në kohën që koka ime, ashtu siç u ngrit e trullo-sur nga jastëku dhe po aq papritmas po binte përsëri ndoshta për të mos u zgjuar më gjer në mëngjes, tamam në atë kohë larg, shumë larg, njëlloj si një natë më parë, po aq impersonal, po aq i gjithkundshëm dhe njëkohësisht i asgjékundshëm, u dëgjua rënkimi.

Ashtu si natën e shkuar, provova gjithçka për të shpëtar prej tij, por ishte e pamundur. Ndërrimi i pozicionit të kokës, mbulimi me kuvertë, një shuk pambuku në vesh, futja e kokës midis dy jastëkëve, ndërrimi i pambukut, të gjitha këto nuk ishin veçse përpjekje të kota. Rënkimi një çast dukej sikur shuhej, por kjo ndodhë për shkak të zhurmës që bëja unë duke lëvizur në shtrat. Porsa pushoja lëvizjet, i padeformuar aspak nga fijet e pambukut dhe kuvertat, ai arrinte tek unë gjerryes si asnijëherë. Kjo vazhdoi gjer ndaj të gdhirë, kur zhurmat e para të ditës e mbytën më në fund. Unë vendosa të kërkova nga administrata e hotelit të më këmbente dhomën, megjithëse kjo nuk ishte një gjë e lehtë, sepse sezoni ishte shumë i ngarkuar me turistë.

Brezhnjevi duhej të kishte arritur në Paris, sepse, duke kaluar në mesditë përmes Trokaderosë, pashë një grumbull të madh policësh pranë barelievit të madh,

ngritur në shesh për kujtim të francezëve të rënë gjatë rezistencës. Një pjesë e qeveritarëve që vini në Paris, sidomos nga vendet lindore, zakonisht vendosnin kurora në këtë bareliev.

Në anën e majtë, në murin përbri barelievit, dikush kishte shkruar me bojë të zezë «La bas le nouveau tsar!»<sup>1)</sup> Ata i hodhën helm në vesh Stalinit, besomë mua, më kishte thënë njëherë një i dehur, një mesnatë, në trenin ekspres Moskë-Leningrad. Jashtë ishte një natë e ftohtë me hënë dhe ne kishim qëndruar kaq pranë dritares së vagonit, saqë fryma jonë e kishte veshur atë krejt. Pq përsë helm dhe përsë pikërisht në vesh? — e kisha pyetur unë, dhe ai, pasi më kishte vështruar gjatë, herë me dyshim, herë me zemërim, thua se pyetja ime ishte skandaloze, duke më treguar me dorë stepat që vraponin përjashta nëpër terr, më kishte thënë: eh, ju nuk mund ta nijhni Rusinë.

Kur mbërrita në hotel, m'u kujtua se duhej të kërkoja ndërrimin e dhomës. Ia thashë administratorit se doja mundësishët një dhomë në krahun tjetër të ndërtesës dhe, për çudi, ai u tregua tepër i gatshëm.

Pikërisht ky zotnia këtu dëshiron të njëjtën gjë, më tha, duke më treguar një burrë të gjatë, — domethënë të kundërtën... domethënë, në thelb, të njëjtën gjë... më falni, t'jua shpjegoj më qartë...

Administratori u kollit dhe u skuq pak.

— Ky zotnia dëshiron të vijë në krahun ku jeni ju aktualisht, kurse ju, në mos gaboj, doni të shkoni më krahun ku është ai, apo jo?

— Pikërisht.

— Qmimet e dhomave tuaja janë të barabarta, kështu që fare lehtë...

— Dhoma ime është mjaft e mirë — tha burri i gjatë, — por unë kam arsyë thjesht psikologjike...

— Edhe unë kam të njëjtat arsyë, i thashë.

---

1) (fr.) «Poshtë cari i ri!».

— Është mirë, kur ka mirëkuptim, — tha administratori. — Qëllojnë disa herë ca klientë...

— Thjesht psikologjike, — përsëriti burri i gjatë.

Kur të dëgjosh sonte atë rënkinin, do ta shikosh psikologjinë, thashë me vete.

Dhoma ime e re, megjithëse ishte njëloj si e para, m'u duk më e qetë. U ulë mbi krevat dhe u mbështeta mbi jastëk, pa u zhveshur, me duart nën zverk. Pa kup-tuar, më zuri gjumi. Kur u zgjova, ishte errur dhe unë provova atë ndjenjën e pakëndshme që të kap gjith-monë kur zgjohesh nga gjumi në kohën që përreth ka rënë nata. Këtë ndjenjë e provokon, me sa duket, fakti që në këtë rast nata duket sikur bie jashtë teje, në kohën që ti mungoje dhe, si e tillë, ajo ka diçka të huaj në raport me ty.

Duke zbritur si i trullo sur në katin e parë, desh u përplasa me atë burrim e gjatë, me të cilin kishim këmbyer dhomat. Ai gjithashtu i kishte sytë të fryrë nga gjumi, por, me gjithë fryrjen e tyre të pazakonshme, m'u duk sikur pér një sekondë kapa në to një bu-zëqeshje tinëzare.

Në katin e parë një grup klientësh të hotelit po shikonin televizorin. U ula në një kanape dhe drejtova sytë nga ekrani. Po jepeshin lajmet e mbrëmjes. Brezhnjevi kishte mbërritur vërtet në Paris, pak para mes-ditës. Reporteri kishte xhiruar mbërritjen e tij në aeroport dhe gjithë ceremoninë e pritjes. Kamera ndalej herë pas here si rastësisht mbi xhaketën e Brezhnjevit. Ajo ishte qepur deri-diku sipas modës, por atij nuk i shkonte. M'u kujtua shumë vite më parë, kur isha student, se si gjithë Moska diskutonte pér borsalinën e re të Hrushovit. Nganjëherë kamera tregonte të shoqen e Brezhnjevit, emrin e së cilës spikeri, të dy-tri herët që e përmendi, e shqiptoi në mënyra të ndryshme. Ishte një emër pak i vështirë, diçka midis Olimpiada Ivanovna apo Ana Olimpiadovna.

Pas lajmit pér mbërritjen e Brezhnjevit, televizio-

ni dha një reportazh nga Persepolisi ku, pas dy ditësh, do të hapeshin festat e mëdha të dymijepesëqind-vjetorit të dinastisë së shahëve. Mbeturinat e ish-kryeqytetit të lashtë, ca kolona të rralla të ngrëna nga erërat kontinentale, me atë shkretimin e tyre të kujtonin çuditërisht tarracat e ndërtesës fqinjë të muzeut të artit modern. Midis mbeturinave prej guri dhe mermeri ngriheshin çadrat, ku kishin filluar të bujtnin mbretër, sultani, presidentë, kryeministra, emirë, sheikë, perandorë, kalifë e të ftuar të tjerë nga gjithë kontinentet. Spikeri thoshte se Persia është sot një nga vendet më të varfra të botës megjithatë një gasti të tillë mbretërore është vështirë ta ketë shtruar gjer më sot ndonjë mbretëri apo republikë. Gosti mbretërore. Këto fjalë në ndërgjegjen time shoqëroheshin pothuajse gjithmonë nga fjalët: tryeza është plot. Në qdo gasti të tillë pritej të shfaqe gjithmonë dikush, mysafiri vonuar, fantazmë me pelerinën e përgjakur, që shkon e zë karrigen e të zotit të shtëpisë. Në Kremlin kishte kohë që shfaqe me siguri Stalini, jo i përgjakur, por me kapotën e lyer me baltë nga balta që i kishin hedhur pasardhësit.

Ah, ia bëri një grua përbri meje, duke parë mbërritjen e mbretërve. Sa bukur, sa bukur!

Ktheva kokën duke pritur të shihja ndonjë fytyrë aristokratike, me flokë të bardhë, nga ato lloj fytyrash që duket sikur mallin për kohën e shkuar e kanë të ngrirë në të gjitha rrudhat e tyre, mirëpo, për çudi, ajo ishte një grua e shëndoshë, me pamje energjike.

— Sa bukur, apo jo zotni? — përsëriti ajo, duke më prekur bërrylin. — Mjerë ne, francezët, që nuk kemi mbret.

— Unë s'jam francez.

Kujtova se kjo frazë do të më shpëtonte nga biseda e mëtejshme por ajo më futi më thellë në të. Gruaja, (ajo duhej të ishte rrëth të pesëdhjetave), porsa mori vesh që isha shqiptar, tundi kokën gjithë qortim.

— Ç'keni bërë, ç'keni bërë! — tha. — Kishit mbret

dhe e dëbuat. Dhe qfarë mbreti, me një emër shpendi i paskeni rënë së mirës me shkerm.

Unë mbajta gazin me zor...

— Ju vjen për të qeshur, — e shoh, — tha gruaja.  
— Por do t'i kujtoni ndonjëherë fjalët e mia. Do mbretër bota, biri im. Bashkimi Sovjetik kérkon mbret, por nuk e thotë. Franca janë pérse nuk gjen karar? Tregu i përbashkët, ekonomia, të gjitha janë profka. Gjithë puna eshtë se ajo kérkon mbret. Gjithë Evropa do që të kthehen mbretërit. Eshtë lehtë t'i dëbosh, por hajde gjeji pastaj...

Zëri i gruas u hollua pak nga mallëngjimi. Sytë e ngulur në ekran i kishte të përlotur.

— Janë rralluar, janë shpérndarë si zogjtë e korbit... — tha ajo gati duke qarë. — Shikojini si janë plakur. Do t'i kérkojmë, do të qajmë pér ta, por do të jetë vonë. S'do t'i gjejmë më, ah...

C'm'u desh që i fola kësaj budallaqeje, thashë me vete.

Pas pak u ngrita dhe dola. Pasi shëtitë ndonjë orë në këmbë, u futa në një kinema. Kur dola, koha ishte keqësuar përséri. Frynte një erë e lagësht, që bëhej akoma më e besdissihme, ngaqë e ndërronte drejtimin papritur. Po i afrohesha hotelit, duke ecur në një nga rrugicat me emra gjeneralësh rrëth Fushës së Marsit. Rrugica ishte kaq e pandriçuar dhe cérkat e ujit të hidheshin nga pllakat e trotuareve mbi pantallona në një mënyrë të tillë, saqë të shkonte nëpër mend se kjo rrugicë jo vetëm që nuk mund të mbante emrin e ndonjë gjenerali të lavdishëm, por ajo mbante me siguri emrin e ndonjë gjenerali që kishte pësuar disfatë.

Në katin e parë të hotelit përséri po shikonin televizor. Me sa dukej ishin lajmet e fundit. Në ekran kishte një xixëllimë gotash e kristalesh. Një darkë zyrtare... Pompidu, Brezhnev, Olimp... Tryeza eshtë plot.

U ula në një ndenjëse bosh dhe zura të shikoja. Rrëth tryezës së darkës të gjithë buzëqeshnin. Pamja e gostive të tilla në emisionet e lajmeve ishte e shpesh-

të. Disa herë më kishte shkuar nëpër mend gjithë historia e botës, duke filluar nga koha kur përfaqësuesit e një klani primitiv ftuan për të parën herë në shpellë përfaqësuesit e klanit fqinj, për të shqyer së bashku ndonjë kofshë mamuthi; ishte në një farë mënyre historia e darkave të tillë. Buzëqeshje, shandanë dhe ar gjend, dhe pastaj, të nesërmen, gjithmonë në çastin kur nuk priteshin, fillonin luftërat.

Pas lajmeve, i gëzuar se më priste një natë e qetë, u ngjita më në fund në dhomë. Ndërsa bëhesha gati të shtrihesha, e ndieja dhe vetë se, në mos në fytyrë, diku në qenien time kisha një buzëqeshje vetëkënaqësie, pak ironike, pak triumfuese, kundrejt kundërshtatit të panjohur që kishte lidhje me atë rënkin e dy netve të kaluara. Më në fund shpëtova prej teje, thashë gati me zë, duke u mbuluar gjithë gëzim me kuvartë. Dhe, si për t'ia bërë edhe më të plotë sfidën armikut të panjohur, pak kohë pasi u shtriva, ngrita kokën mbi jastëk dhe mbajta vesh trimërisht në natën e thellë. Isha gati të qeshja me zë përfitoren, por tamam në atë çast ai, rënkin, ashtu si ajo pika që, pasi është grumbulluar heshturazi nën çati, shkëputet e bie poshtë, u shkëput dikan nga strehët e natës. I mundur, e lëshova kokën mbi jastëk. Përpala kisha një tjetër natë pa gjumë.

Të nesërmen gjithë paraditen tek administrata e hotelit kishte vazhdimisht njerëz që kërkonin të këmbenin dhomat. Administratori, me një buzëqeshje të hidhur, të shoqëruar herë-herë me një ndjenjë alarmi që i shkaktonte kjo dëshirë e përgjithshme për zhvendosje, shfaqeje te tryeza e gjatë e mbuluar me regjistra.

— Më besoni, zotni, unë vetë nuk kam fjetur gjithë natën.

— Po ç'është në fund të fundit ky rënkim?

— Akoma s'është sqaruar. Kemi lajmëruar drejtorinë, bile edhe policinë dhe tani po presim.

- Si? Çfarë? — pyesnin ata që afroheshin më vonë.  
— S'dihet akoma asgjë. Ndoshata do ta zgjidhë policia.

Afër drekës një klient i shëndoshë hodhi çelësin me përbuzje përpara administratorit.

— Bëni, ju lutem, llogarinë time.

— Zotni, ndoshata sonte...

— Llogarinë! — përsëriti me një zë të akullt klienti. — Nuk kam ndër mend të banoj në një hotel me fantazma.

— Ndoshata nuk duhet tepruar, — kundërshtoi me zë të butë administratori, po fytyra e klientit ishte jashtëzakonisht e egërsuar.

Pas tij e braktisën hotelin edhe tre klientë të tjerë, por dy prej tyre u kthyen pas njëzet minutash me fytyra të skuqura.

— Në dy hotelet fqinjë dëgjohet gjithashtu, — thanë ata, duke iu marrë fryma. — Takuam në rrugë ca klientë të tyre, që po vinin këtu me valixhe në duar. Na jepni, ju lutem përsëri dhomat tonë.

Në gjithë katet e hotelit, në ashensorët e shërbimit, korridoret, shkallët ndihej një lëvizje dhe shqetësim i jashtëzakonshëm.

— Kam tridhjetë vjet që shërbej nëpër hotele, — më tha pastruesja e katit të katërt, — por një gjë e tillë s'më ka bërë vaki kurrë.

Ajo e kishte fytyrën të zverdhur.

Dola në rrugë me shpresë që të më pushonte dhembja e kokës. Një ndriçim i kursyer shfaqeji herë pas herë në horizontin e mytur me re. Pas tri ditësh me shi, ky ndriçim i paktë të jepte përshtypjen e një kohe të mirë. Kisha blerë një gazetë, së cilës i hidhja nga një sy në çdo udhëkryq, ndërsa prisja të ndizëj drita e gjelbër e semaforëve. Plikërisht në prag të festave madhështore gruaja e shahut të Persisë ishte mjaft e pikëlluar. Cilat mund të ishin vallë shkaqet intime të pikëllimit të saj? Ky ishte nëntitulli i dytë i artikullit.

Brezhnjevi ndodhej edhe sot në Paris. Çmimi i qilimave persianë...

Në rrugën Montenjë trotuaret ishin plot me gjethe të zverdhura. Ç'bëhet vallë tanë në hotel? — mendova. Këmbët më kishin ndalur vetveti përpara vitrinave të një magazine qilimash. Midis sixhadeve ishte fotografia e çiftit mbretëror. Shahesha ishte e pikëlluar. Po t'i shikoje me vëmendje ornamentet e qilimave persianë, ato dukej sikur përpinqeshin, por nuk arrinin kurrsesi të krijonin konfiguracionin e një buzëqeshjeje të madhe. Dicka i pengonte, i ndante elementët nga njëri-tjetri, duke i shpërndarë nëpër labirinte, larg, larg, për të mos u takuar kurrë. Por edhe sikur të mundeshin të bashkoheshin, të dukej sikur ato nuk do të arrinin të krijonin veçse një ngërdheshje të madhe, ose shumë-shumë një buzëqeshje çnjerëzore. Vite më parë kisha lexuar një reportazh të hollësishëm për punishment e qilimave persianë. Mijëra vajza, në mijëra ditë, në kondita të tmerrshme lidhnin një nga një nyyat e sixhadeve. Nga të gjitha dhembjet e botës, ishte e vështirë të gjeje një pikëllim kaq të shtrirë dhe që të shkelej kështu me këmbë nga të gjithë. Kurse shahesha kishte ca shkaqe intime. Ajo kishte humbur javën e fundit tre kilogramë peshë... Ajo...

Kur u kthëva në hotel, gjeta po atë gjallëri të parades, por ndihej menjëherë që asaj i mungonte një element: enigma. Ajo nuk ekzistonte më. Ishte gjetur burimi i rënkit. Nuk ishte as njeri i vrarë në ndonjë nga apartamentet përballë, as ndonjë vjedhës që kishte ngecur në brimën e ndonjë oxhaku dhe po hiqte shpirt me mushkëri të shtypura nga presioni i mureve dhe as fantazma (siç dyshohej në rrethet më të ulëta të hotelit). Ishte më e thjeshtë. Ishte një qen i sëmurë.

Një qen i sëmurë na shqetësoi të gjithëve, thoshin aty-këtu nëpër korridore. Një qen, e përfytyroni pak, ha, ha, ha. Të gjithë ishin të gëzuar që, më në fund, kishin përpara një natë të qetë. Erdhi mbrëmja dhe pastaj nata, por, megjithëse me fytyra të zbehta nga

pagjumësia, asnjë nuk shpejtonte të mbyllej për të fjetur në dhomën e vet. Të gjithë e shtynin orën e shumëpritur, ashtu siç ndodh shpesh me njerëzit që kanë dëshirë ta zgjatin pritjen e një çasti të lumtur.

Dyert e dhomave filluan të mbylleshin njëra pas tjetrës pak përpala mesnatës. Aty nga mesnata në hotel mbretëroi qetësia. Ajo ishte e plotë dhe gjumëndjellëse, por, për fat të keq, ajo nuk vazhdoi gjatë. Aty nga ora dymbëdhjetë e gjysmë, dyert, ashtu siç ishin mbyllur njëra pas tjetrës, po hapeshin tanë rresht, duke hedhur katrörë dritash të shqetësuara, në korridore. Ç'është, ç'është, si është e mundur? Ai dëgjohet përsëri. Ai rënkon prapë. Qeni.

Nga copërat e dialogjeve të korridoreve (ato, ca nga përgjumia, ca nga nervozizmi, ishin të paplota logjikisht, siç mund të jenë në përgjithësi dialogjet e njëre zve me pizhame në një korridor hoteli pas mesnate) mund të konstruktohej pak a shumë një mendim i tillë: vërtet ishte gjetur se rënkim i dilte nga gryka e një qeni të sëmurë (bile thoshin se drejtoria e përgjithshme, në bashkëpunim me policinë, kishte dërguar natën e kaluar një specialist për të incizuar rënkinin që nga larg me mjete ultramoderne, duke vërtetuar kësh-tu katërcipërisht se ai ishte një rënkim qeni), mirëpo pas kësaj njerëzit, të entuziazmuar nga gjetja, nuk menduan aspak se ç'duhej bërë konkretisht për të zhdukur rënkinin. Ata kujtuan, siç i ndodh shpesh, se gjetja e shkakut do të zhdukte vetveti edhe pasojën.

Hoteli ishte plot hapa, zëra dhe pëshpërima. Kupa u mbush, thoshte dikush, duke u ngjitur, kushedi pse, nga kati i tretë në të katërtin. Ka një kufi çdo gjë. Mos jemi vallë në mbretërinë e qenve?

Ngaqë s'dija ç'të bëja, zbrita në katin e parë, ku kishin hapur prapë televizorin. Ishte mbarimi i lajmeve të fundit. Në Persepolis kishte filluar festa. Nën një diell përvëlues, përpala mbeturinave të kolonave dhe të statujave të lashta po zhvillohej një paradë e jash-tëzakonshme ushtarake. Njësi ushtarësh, të veshur me

uniforma të një vjetërsie dymjepesëqindvjeçare e këndej, të armatosur me armë të po kësaj vjetërsie, me flamurë, emblema e helmeta të modeleve të të gjithë shekujve, po kalonin rresht përpara shahut dhe gruas së tij. Ishte si një paradë fantazmash. Duke u larguar, pasi thërrisin «Zahirshah» përpara tribunës, dukej sikur ata po shkonin përsëri të futeshin nën rratasat e rënda të varreve prej nga kishin dalë përkohësisht.

— Ja njësitet ushtarake që ka përshkruar Eskili në tragjedinë «Persët», komenton te spikeri i televizionit francez. «Tragjediani i madh i ka parë ata me sy, me këto mjekra dhe me këto përkrenare.»

— Nga kjo luftë nuk u kthyte gjallë askush, — më tha dikush përbri. — E keni lexuar «Persët?»

— Po.

— E dini si e quajnë këto ditë parizianët Perse-polisin? Pers e polis.<sup>1)</sup>

Unë qesha me zë të ulët.

Dy ditë përpara e kisha dëgjuar këtë nga një shkrimitar i ri francez, gjatë një darke në ambasadën tonë. Si mik i Shqipërisë, më tha ai, më bëhet qejfi që vendi juaj është ndoshta nga të vetmit që nuk ka dërguar përfaqësues në këtë komedi banale. Kjo riafirmon faktin që ju nuk i honepsni dot kompromiset e shëmtuara.

— Pers e polis, — përsëriti i panjohuri përbri meje.  
— E kanë gjetur bukur apo jo?

— Ju lutem, — tha një zë gruaje, që m'u duk si i njojur. Ishte monarkistja e shëndoshë, krejt e përpirë nga ekrani.

Pasi u ngjita në dhomën time, për një kohë të gjatë nuk më hiqej mendja nga parada persiane. Gjithë ato stile kostumesh, armësh, flamurësh, paradas, ma-

---

1) (fr.) — Persë dhe polici.

dhështish, frikërash, vdekjesh. Si janë përpjekur ta deformojnë këtë planet, mendova, disa duke dashur të vënë çallmën, të tjerët kryqin, të tjerët helmetën. Gjithë kjo propagandë shekullore kjo mori superstrukturash, këto stile, statuja, ceremonira, muzikë paradas, krishtësh, budash, mumje faraonësh, gjithë këto rrudha mermeri e bronzi, kjo barroko trush nga njëra anë, ose ky lëmim trush nga ana tjetër, nuk ishin gjë tjetër, veçse një ilaq i madh që ata hidhnin me shpejtësi, disa herë me panik, për të mbuluar të vërtetën.

Para disa vjetësh Malroja kishte dhënë urdhër, të kruhej Parisi, për tu shfaqur përsëri ngjyra e tij e vjetër, origjinale, që paskësh qenë më e çelët se gria e sotme. Parisi mund të kruhej me mjete speciale, më thoshte atëherë një shok imi, po si mund të gjerryhej gjithë Evropa, ky kaldrëm mbretëror që e mbulon tej-përtej si një gjoksore çeliku dhe pastaj, në qoftë se edhe kjo arrihet, si mund të gjerryhet zgjyra e brendshme e botës së vjetër, ajo arkitekturë shpirtrash, e krijuar mundimshëm gjatë shekujve. Filipi i Dytë qau kur u mbyt flota e Spanjës, po vallë, vetëm Filipi i Dytë qau? Më kujtoheshin shpesh këto vargje të Brehtit dhe fill pas tyre gjithmonë më vinte ndër mend Marksi. Ai ishte gjerryesi i vërtetë i botës së vjetër.

Ora e kishës fqinjë ra dy herë. Nëpër trupin e natës erdhi në atë udhën e tij të humbur rënkim i qenit. Dola në ballkon dhe e dëgjova për një kohë të gjatë, duke u përpjekur, ashtu si netët e tjera, të kuptoja se nga ç'drejtim vinte, por ishte e pamundur. Për një farë kohe truri im u boshatis, si në ato tarracat e muzeut, pastaj mbi atë shkretim unë thashë: ja pra, ndodhem në Paris. Ndodhesha vërtet në Paris, në një ballkon hoteli, duke vështruar përjashta natën vjesh-tore. Qyteti shtrihej i pafund në një prushitje të largët dritërash, dhe unë u rrëqetha pak, kur mendova se mbi këto kupola, portale e monumentale prej bronzi ngrihej një rënkim qeni, më i vjetër ndoshta se njerezimi.

Duke u dridhur nga të ftohtët, shkova në shtrat

dhe, ndërsa po mbulohesha me kuvertë, m'u kujtuan prapë ushtarët persianë. Ata me siguri janë shtrirë tani prapë nën rrasat e ftohta të varreve, dhe hëna ndrit përmbi ta, thashë me vete.

Po më afrohej gjumi.

Gjithë lagjja fliste për qenin e sëmurë. Kishin kaluar kaq ditë dhe prapëseprapë rënkim i nuk pushonte. Qeni nuk po gjendej. Ishte përcaktuar pak a shumë drejtimi nga vinte rënkim, por në asnjë mënyrë ndërtesa dhe aq më pak kati dhe apartamenti. Gjithë këto gjëra ndodhin në Paris, i thoshte një grua me zë të lartë shoqes së vet, vijnë e shkojnë zyrtarë të lartë, bëjnë ceremonira e pajtime midis shteteve, kurse ky qen vazhdon të rënkojë. Ah, ia bënte shoqja, është më se e tmerrshme. Të tjerë thoshin: a ka dijeni shqëria e mbrojtjes së qenve në Londër? Në fund të fundit, edhe ne mund të bëjmë diçka. Një mbledhje, një petition. Ndoshta qeni ka nevojë të shtrohet në psikiatri. Mos qeshni, zotni, një shoqes sime qeni i ra në depresion psikik. E kuruan gjatë. I ndërruan klimën. Zonjë, kam dëgjuar për qen të tërbuar, por jo për qen të çmendur. Përse ju duket çudi, mësjë? Më duket më tepër se çudi. E pra, të mos ju duket aspak. Ka kaq njerëz të çmendur përreth, bile nganjëherë i takojmë, bisedojmë me ta rrugës, përse të mos pranojmë se mund të çmendet edhe një qen? Ju lutem, pa aluzione, tha burri.

Gjithë ato ditë, sa herë që shikoja qen në veturat e njerëzve, thosha me vete: mos je ti që rënkon?

Ditët rriddhnin të zakonshme, dhe midis zhurmës së tyre të gjithë thoshin me vete, me siguri, se kotonish shqetësuar aq shumë një natë më parë nga një rënkim. Mirëpo vinte nata, ushtritë mbrojtëse të zhurmave largoheshin njëra pas tjetrës dhe në hapësirën e boshatisur, ngjethës e i pandryshuar, si përherë, gohej rënkim.

Ditët rriddhnin të zakonshme për Parisin. Brezh-

njevi porsa ishte larguar nga Franca. Kishin arritur një dy mbretër dhe tre presidentë të tjera. Flitej se Franca po ndërmjetësonte për bisedime midis SHBA dhe Vietnamit. Nga Persepولي po largoheshin mbretërit dhe perandorët. Gazetat botonin një variant tjetër të shkaqeve të pikëllimit të shaheshës. Çmimet e qilimave...

Dy ditë përpara se të largohesha nga Parisi, u fol se qeni po ngordhë. Nuk u mor vesh as edhe ndonjë hollësi tjetër. Bile, nuk u vërtetua nëse vërtet po ngordhë, apo po gatiteshin ta nxirrnin fshehurazi nga lagjia. Gjithçka mbeti anונית, e pashfaqur, sikur të mos kishte të bënte me botën reale, por me terrin e brendshëm njerëzor.

U nisa për në aeroportin Orli, në kohën që kishte rënë mbrëmja. Dritat ishin ndezur kudo. Në sheshin Konkord ato ishin të rrumbullakëta, pak të zbehta, të ngulura aty-këtu nëpër shtylla si mbi heshta metali-ke. Më shkoi nëpër mend se gati dy shekuj më parë, një mëngjes janari, në këtë shesh qe ngritur për herë të parë gjotina. Mbi një mijë e trëqind koka, me kokën e mbretit dhe të mbretëreshës së Francës në krye, kishin rënë njëra pas tjetrës te ky shesh. Mami e tmerrshme, ai i priste ato mbi pëqinjtë, e tij prej kall-drëmi. Ndërsa largohesha, duke kthyer edhe një herë kokën drejt sheshit, mendova se ndoshta nuk ishte rastësi as ajo rrumbullakësi e verdhë është as ai statizëm i poçave të dritave mbi shesh. Arkitekti, që ishte marrë më vonë me rregullimin e sheshit, me siguri kishte dashur që në dritat e tij të krijonte njëfarë requiem për kokat. U ktheva për herë të fundit dhe gati u binda se dritat mbi sheshin «Konkord» nuk ngjanin me asgjë tjetër, veçse me koka të verdha, të ngulura majë heshtave.

Në Orli, ndërsa ecja përmes njërsës prej sallave të pritjes, në një kioskë, midis titujve të shumtë të gazetave që shitësi i kishte ngulur me pineskë te vitrina, më zunë sytë emrin e Hirohitos. Pata përshtyp-

jen se takova një të njohur të vjetër, por nuk kisha kohë të bleja gazetën dhe nga titulli nuk arrita ta kup-toja ku ishte tani perandori. Ai, siç duket, lëvizte di-ku, përtej, anash, si një gjë që endet në erë dhe ti nuk e kupton afrohet apo largohe. Shfaqu, fantaz-më, përsërita automatikisht me vete.

Për shkak të rrëmbimeve të avionëve që ishin shpeshuar kohët e fundit, gjithë pasagjerëve iu bë kontroll për armë. Kontrolli ishte total. Nuk pinte ujë as pasaporta diplomatike dhe asnjë dokument tjetër. Ishte një polic flokëkuq, me fytyrë të gjatë, tërë preka dhe një vajzë simpatike. Të dy kishin nga një aparat, të ngjashëm me një stetoskop, që bënte një zhurmë monotone. Vajza, e cila kontrollonte femrat, nuk kish-te, siç dukej shumë përvojë, sepse polici herë pas here e afronte aparatin te revolveri i tij, për t'i treguar asaj se si ndryshonte zhurma e aparatit në kontakt me armën. Ishte hera e parë në jetën time që diçkush më kontrollonte, qoftë edhe me një aparat modern. Herë-herë zhurma e tij më ngjasonte me rënkimin e qenit.

Pas një çerek ore avioni i madh i Er Fransit u ngrit nga pista dhe, duke u anuar herë në njérën bri-një, herë në tjetrën, u drejtua për në thellësinë e errët të kontinentit.

1974

## TE SHTUNËN PASDITE

**P**o prisja autobusin pranë Bankës së Shtetit, kur pashë Anën. Ajo po vinte nga ana e Teatrit të Kukullave dhe në fillim nuk e njoha, sepse kishte ndërruar krehjen e flokëve dhe ishte nxirë nga dielli.

Çështë kjo vajzë që ecën tamam si Ana, mendova, kur befas vura re se ishte ajo.

Ana, — i fola tek e pashë që dō të më kalonte përbri pa më vënë re.

Ajo ndaloi si e trembur, siç duket, nuk e kishte mendjen në vend.

— Ç'kemi, Ana, — i thashë, — si ia çon?

— Mirë, — tha ajo përhumbshëm, duke hequr syzet e diellit, dhe unë u habita pak kur pashë sytë e saj. Ana kishte pasur sytë më të bukur në grupin tonë, ca sy të mëdhenj bojë hiri, me një vështrim të përqendruar, që të krijonte iluzione që në njohjen e parë dhe ti mund të rrije ndonjë natë pa gjumë, gjersa ta kuptoje se ajo ashtu e ka vështrimin dhe ti s'je i vetmi që të përket ai vështrim. Por këtë herë sytë e saj m'u dukën të lodhur dhe paksa të hutuar, siç nuk i kisha parë kurrë.

Re dhe ti, Ana, mendova vetëtimthi. Kaq kohë na mundove të gjithë e sidomos mua, por, siç duket, ke rënë edhe ti keq.

— Paske qenë në plazh, — i thashë, — ke marrë ngjyrë të bukur.

— Kam qenë, — tha ajo. — Po, kam qenë, — shtoi pas pak dhe dukej që s'e kishte mendjen aty.

— Më duket se pasnesër dalin emërimet!

Ç'ke këshfu, Ana? — mendova dhe e vështrova në sy. Edhe ajo më vështroi një copë herë në heshtje me një shikim të pakuptueshëm, që dukej sikur nuk binte plotësisht në sytë e mi, por shpërnduhej rrrotull meje.

— Dëgjo, — tha papritur dhe më kapi dorën. — Do të më ndihmosh për diçka, do të më shoqërosh në një vend?

— Mirë, — i thashë, — me kënaqësi.

Ajo më afroi fytyrën. Tani m'u duk se në sytë e saj kishte një dëshpërim të thellë.

— Ti ke qenë një shok i mirë me mua, — tha ajo, — megjithëse midis nesh nuk...

— S'ka nevojë, Ana, — thashë unë dhe buzëqesha hidhur, kurse në shpirt ndjeva papritur të mpiksur komb gjithë trishtimin e shpërndarë si mjegull në shumë ditë dhe mbrëmje të shkuara, kur ajo shoqërohej me Viktorin.

— Asgjë, Ana, — përsërita me zë të qetë dhe ula sytë.

— Do të më shoqërosh?

— Posi, — thashë.

— Eja të hipim, rrugës do të të tregoj si e kam hallin, — tha ajo dhe eci drejt autobusit të linjës Bankë-Kinostudio.

— Ku do të shkojmë? — e pyeta.

— Në spital.

Ah, Ana, mendova. Siç duket e paske pësuar.

Ajo hipit dhe unë, duke parë këmbët e saj të bukura dhe gjunjët që iu zbuluan pak, ndjeva një dhimbje akoma më të mprehtë në shpirt.

— Në spital kam një shoqe infermiere, — tha ajo,  
— besoj do të më ndihmojë.

— Përse? — i thashë me zë pothuajse të shuar.  
Ndoshta s'duhej t'ia kisha bërë pyetjen. Gjithçka ishte  
e qartë edhe pa përgjigjen e saj.

— Ah, unë akoma s'të kam treguar asgjë. Më fal.  
E kam humbur fare.

Viktor, mendova, i poshtër. Së paku të ishe tre-  
guar i kujdeshshëm me të.

Ne qëndruam në fund të autobusit, te xhamat e  
mëdhenj.

— Nuk i kam treguar asnjeriu, — tha ajo. — Ti je  
i pari që po ta them. Më dëgjon? — dhe më kapi për-  
séri dorën.

Natyrisht, thashë me vete dhe ula sytë. Po më  
bën favor. Që të më mundosh gjer në fund.

— Kam kaq ditë që torturohem, — vazhdoi ajo, —  
kaq ditë. Nuk desha të alarmoja asnjeri, megjithëse  
kisha kaq nevojë t'i tregoja dikujt. Dhe ja, papritur  
të takova ty. Më dëgjon?

— Të dëgjoj, — i thashë.

— Ti ke qenë shok i mirë. Ti do të më falësh në  
qoftë se të kam munduar, padashur. A?

— S'ishte faji yt, — thashë unë, — ndoshta ishte  
faji im.

— Ndoshta nuk ishte faji i askujt.

— Ndoshta. Sigurisht.

Ndoshta vërtet nuk është faji i askujt. Në këto  
raste faji zakonisht largohet, bëhet i pakapshëm, si re-  
të. Mua m'u kujtua dëbora që binte atë ditë, kur e për-  
colla për herë të parë Anën. Kishte vite pa rënë dëbo-  
rë në Tiranë dhe të gjithë qenë bërë si të qmendur, i  
madh e i vogël. Gjuanin me topa bore nga të gjitha  
anët. Sidomos e kishin pisk vajzat. Unë po dilja nga  
fakulteti dhe po e ndieja edhe vetë që po më zinin  
ethet e dëborës, kur dëgjova pas meje një frymëmarr-  
je të shpejtë dhe dikë që më kapi nga bërryli. Ktheva

kökën dhe pashë Anën, të skuqur në fytyrë, të goditur me topa bore, të bukur si asnijëherë. Më shoqëro gjer në shtëpi, tha ajo, e shikon si jam bërë? dhe më tundte flokët e lagur, plot thërrmija kristalesh. Filluam të ecnim të dy midis dehjes së përgjithshme. Na gjuanin në të gjitha udhëkryqet, dhe sa herë që fluturonin topat e dëborës, ajo ulte kokën për t'u mbrojtur pas supit tim. Kurse dëbora përplasej te supi, shpërthente, ngrinte në erë, duke e mbushur botën plot drithë kris taline. Goditni edhe më, thosha me vete në çdo udhëkryq. Në goditni të dy, të dy... Kështu u afrova me Anën. Mirëpo kaluan ca ditë dhe diçka nisi të ngekte midis nesh. Ajo bënte sikur s'e kujtonte atë ditë dhe mua kjo më dukej fye se. Në qoftë se ajo qe penduar për afërsinë e çastit, unë aq më pak kisha ndër mend t'ia kujtoja atë. Unë fillova gjithashtu të sillesha ftohtë. Po kjo ishte një ftohtësi nervoze. Nganjëherë diçka shkrinte midis nesh, njëri bënte një hap afrimi, por ndërkaq tjetri gjente rast për të marrë revansh për ftohtësinë e mëparshme. Dhe kështu erdhën njëra pas tjetrës kapriçio të kota, ngacmime, pusulla ironike, ndonjë ndriçim loti. Faj... me siguri ai ishte i të dyve.

— Ndoshfa, — thashë unë, duke mos e hequr dot mendjen nga fraza e saj e fundit për fajin.

— Çfarë? — ia bëri ajo.

Autobusi merrte një kthesë dhe ajo u mbajt te bërryli im. Po ku ishte dëbora mbi supet tonë, mbi flokët e saj dhe brenda mushkërive?... Gjithçka ishte e thatë në këtë autobus të mbushur plot, që po shpejtonte nëpër rrugën e spitalit. Vetëm sytë e Anës po përloteshin.

— E pra, a nuk të vjen keq t'i lësh të gjitha në këtë moshë? — ia bëri ajo, duke mbytur me zor një gulçim. — T'i lësh të gjitha, e përse? Për hiçgjë.

— Ana, ç'flet budallallëqe, — i thashë. — Mblidhe veten!

C'ka ndër mend të bëjë? mendova. C'ishte kjo «t'i lësh të gjitha...» Mos...

— Për hiçgjë, — vazhdoi ajo midis dënesës. — Për një gjëndër të vogël, fare të vogël.

Unë ia zura pamjen me shpinë, që njerëzit të mos e shikonin që po qante.

Një gjëndër, thashë me vete. Ja ç'na doli tani. Isha krejt i turbulluar. S'kisha dëgjuar ndonjëherë që bара të quhej gjëndër, me gjithë dëshirën për ta zvogëluar.

Viktor, i poshtër, thashë për herë të tretë, mund të mos e kishe bërë këtë gjë.

Ajo nisi të rrinte në leksione me Viktorin për inatim tim. Unë e dija këtë, e megjithatë nervozoheshha. Ky ishte një nervozizëm i fshehur pas një buzëqeshjeje të thatë, më i keqi i të gjithëve. Unë jo vetëm asaj, por edhe vetes ia fshihja një pjesë të ndjenjës sime për të. Përpinqesha t'ia mbushja mendjen vetes se nuk e doja Anën dhe angazhimi im mendor për të s'ishte veçse pasojë e një sedre të sëmurë mashkulli. Dihej që ndjenjat që sajoheshin nga një sedër e tillë, zhdukeshin menjëherë, porsa realizohej dashuria. Kështu që, ndërsa vuaja, unë përpinqesha t'ia mbushja mendjen vetes se e meritoja vuajtjen, se mirë ç'më bëhej, përderisa isha një egoist i tillë. Në fund të fundit, nga e gjithë kjo unë do të pastrohesha shpirtërisht. Mirëpo, në thellësi e ndieja se po i bëja hile vetes. Në të vërtetë, sa herë që mendoja për Anën, më ndodhëtë dicka e çuditshme: ndërsa për asnjë vajzë që njihja nuk më kishte shkuar mendja se mund të martohesha me të, Anën, përkundrazi, nuk mund ta përfytyroja veçse si gruan time të ardhshme. Përpinqesha ta shkulja këtë nga truri im, po s'ishte e mundur. Dhe kjo vërtetonë më së miri se unë e doja atë. Ajo dëborë nusërie e asaj dite sikur na kishte lidhur të dy.

Supet e saj dridheshin akoma, pothuajse ngjitur me supet e mia.

— Mjaft, — i thashë dy-tri herë me zë të ulët. — Ç'bën kështu, Ana?

— Një gjëndër e vogël, — përsëriti ajo.

- Çfarë thua, — e pyeta. — Ç'është kjo gjëndër...  
 — Po ti s'më pyete ç'kam, — tha ajo.  
 Unë kafshova buzën e poshtme.  
 — E mora me mend, Ana, s'ke ç'i bën.  
 Ajo ngriti sytë e përlotur.  
 — Si?!

Unë desha të hapja krahët, por s'ishte e mundur për shkak të dyndjes së njerëzve rrëth nesh.

— Gjëra që ndodhin, — thashë, duke u përpjekur të mos e vështroja në sy. — Po ti mos e merr kaq tragjikisht. Në fund të fundit...

Ajo më shikoi në një mënyrë të tillë, thua se unë isha i luajtur. Një gjëndër, përsërita me vete. Mos ajo e ka fjalën...

— Po si është puna, — thashë, — ç'është kjo gjëndër?

Pa i hequr sytë nga unë, ajo tregoi me dorë vendin ku mendonte se kishte gjëndrën dhe unë gati sa s'thirra: ah. Ja për se ishte fjala. Një çast u gëzova, se m'u duk që Ana u çlirua nga një bezdi e rëndë, dhe ajo, që nuk m'i hiqte sytë, e kapi, siç duket, gëzimin tim.

— Të duket zbatitëse? — tha dhe unë dallova një grimcë nga ajo ironia e parë, që ne e kishim harxhuar pa mëshirë njëri kundër tjetrit.

— Ti dyshoni për...  
 — Kancer, — tha ajo.  
 — Budallallëqe, — thashë unë, — unë kujtova se...  
 Hm, c'budallallëqe.

Isha akoma i lehtesar, megjithëse një re e zezë shqetësimi po më avitej.

— Jo, Ana. S'është e mundur, — i thashë. Po zëri im s'ishte më i sigurt, ashtu siç qe kur thirra «budallallëqe». Ndieja se si dyshimi po më pushtonte me shpejtësi. Më mirë të kishte qenë ai rreziku tjetër, mendova në çast.

— E sheh? — tha ajo. — E sheh, që u trondite edhe ti?

— Unë?... Hm. Po unë s'di ç'të bëj me ty, — i thirra me inat, saqë dy-tre veta kthyen kokën. — Të qesh me budallallëqet që thua, ti fyshesh; të rri serioz, dreqi e di ç'mendon.

— Mos e ngri zërin, — tha ajo. — Kushedi ç'kujtojnë njerëzit.

Unë fillova të inatosesha vërtet dhe kjo më lehtësoi disi. Autobusi po ngadalësonte përsëri shpejtësinë.

— Eshtë ashtu siç të thashë, — tha Ana me qetësi. — Unë jam e bindur. Megjithatë do të vizitohem njëherë. Sa të heq merakun e fundit, ose më mirë shpresën e fundit. E di se doktorët nuk të tregojnë të vërtetën, por unë do ta kuptoj menjëherë. S'është vështirë për ta kuptuar nga shikimet.

— Stacioni i spitalit, — thirri faturinoja.

Ne zbritëm. Unë isha gjithsesi i tronditur, dhe ajo e vuri re.

— Të vjen keq për mua? — tha duke hyrë në portën e spitalit.

— Ana, tani po flet si nëpër filma. Ti s'ke asgjë, mos u bëj maniakë.

Duhet ta fyej, mendova. Ashtu si atëherë. Madje më keq akoma, që të mos dyshojet.

— S'kam asgjë? — tha ajo nervoze. — Ti thua s'kam asgjë? Shiko këtu.

Ajo më tërhoqi në një qoshe dhe me dorën e saj më tregoi rrëzën e krahut ku ishte gjëndra.

Vdekja, mendova vetëtimthi; në atë gjëndër të vogël rrihte vdekja. Mjafton që ta ngacmojë pak dhe ajo do të tregonte kthethrat.

— E beson tan? — tha ajo duke ma hequr dorën, — a e beson?

— Jo. — thashë mekanikisht. — Aspak. Do të jetë ndonjë gjëndër e thjeshtë.

— Ti do të më japësh zemër, — tha ajo, — po ti vetë dukesh i tronditur. S'je kaq cinik sa kërkon të hiqesh.

— Nuk të dija kaq idiote, — i thashë, po fyerjet

nuk arrinin dot gjer tek ajo. Unë e ndieja se po më mbarohej edhë kjo armë dhe tjetër armë s'kisha.

Ne kishim arritur te porta e brendshme dhe tani ajo do të hynte.

— Do të më presësh? — tha ajo.

— Patjetër, Ana.

Ajo u nis me hapa të ngadaltë, pastaj qëndroi dhe u kthye përsëri nga unë.

— Do të të vijë keq për mua? — tha prapë me zë të butë dhe sytë iu veshën me një perde të hollë.

Unë desha t'i them diçka gjakftohtë, tallëse, çorientuese, por s'munda. Një komb më zuri grykën.

— Unë e di se ty do të vijë shumë keq, — tha ngadalë, — sepse ti je i mirë dhe pavarësisht se ne të dy... ne të dy...

— Çfarë ne të dy?

Ajo bëri me shenjë me dorë, si të thoshte «lëre tani», u kthye menjëherë dhe hyri brenda gáti me vrap.

Unë ngela një copë herë në këmbë krejt i ngurosur. Pastaj fillova të endesha ngadalë në oborr, ndanë ndërtesave të gjata, ku hynin e dilnin vazhdimit infirmieret. U ndala përpara gazetës së murit dhe nisa të lexoja mekanikisht pjesë nga artikujt: «...ne, punonjësit e shëndetësisë, të mobilizuar për realizimin e zotimeve, duhet të...»

Një djalë i ri me dorë të lidhur qe ulur pranë hyrjes së infirmierisë dhe këndonte me zë të ulët, duke i ngrënë fjalët nëpër dhëmbë. Unë dalloja vetëm dy rreشتë të këngës:

*Vjeshta gjethet u ndërron pemëvje,  
vjeshta vajzave u ndërron mbiemrat.*

Si kështu, Ana? mendova. Çfarë të të them kur të dalësh, si të të ngushëlloj? Vjeshta vajzat i marton, vjeshta vajzave u ndërron mbiemrat... Po a do të arrinte vallë Ana ta ndërronte mbiemrin e saj? Ky mendim më ra si çekan në kokë. Fillova të bluaja me ve-

te çfarë t'i thosha kur ajo të dilte, po mendimet i kisha shumë të shpërndara dhe nuk mund të sajoja dot asgjë. Mendimet e mia ishin si ato retë e bardha në qzell në një ditë të nxeh të vere, që duken sikur po mblidhen bashkë e po krijojnë një masë të ngjeshur dhe ti pret hijen e dëshiruar në çdo rast, por më kot sepse, ndërsa njëra prej tyre është afruar drejt grumbullit, një tjetër është shkëputur ndërkaq në mënyrë të pakuptueshme dhe ikën tutje duke ndërruar vazhdimit formë, gjersa tretet në horizont. Dhe kjo vazhdon kështu orë të tëra.

Një vit më parë, kur ne kishim dalë në miting për të pritur një personalitet afrikan, unë e gjeta Anën midis turmës dhe e kapa fort nga supet.

— C'bën kështu, u qmende? — më tha.

— Pothuajse, — i thashë.

Ajo më pa në fillim me inat, pastaj, siç dukej, e trembi shikimi im dhe sytë iu zbutën.

— Mos ke pirë?

— Jo.

— Po atëherë më thuaj ç'ke.

— Ti e di, — i thashë, — ti e di mirë, Ana.

Ajo buzëqeshi dhe filloi të ecte. Unë çaja njerëzit dhe ajo vinte pas meje dhe kjo ndodhi tamam në kohën kur makinat e delegacionit po mbërrinin nga Rruja e Durrësit. Ana kishte lule në duar. Unë ia rrëmbeva dhe i hodha me fuqi në makinen e hapur plot me zezakë. Pastaj e vura krahun mbi supet e Amës, por ajo i liroi supet dulke i lëvizur lehtë.

— Hiqini duart, — më tha dhe më tregoi me dorë një parullë që e mbante dikush para nesh. «Janki, hiqini duart nga Republika Domenikane». Qeshëm të dy.

E shoqërova deri afër shtëpisë dhe te shkallët e apartamentit desha ta përqafja, por ajo nuk më lejoi.

— Në qoftë se do të vazhdosh të sillesh kështu, nuk do të shoqërohem më kurrë me ty, — tha.

— Ndoshta të pëlqen ndonjë tjetër? — i thashë unë në kohën që po shtynte derën.

— Ndoshta, — tha ajo, — natën e mirë!

Qëndrova një grimë pa lëvizur përpara asaj dere apartamenti, që m'u duk e urrejtshme, me atë grinë e çelët të saj dhe me atë tabelë prej bronzi ku ishte shkruar «Familja Vuksani». Ndjeva një dëshirë të marrë të goditja në të, jo me grushtë ose me shkelma, por me kokë. Të goditja mu në mes të derës, mu te tabela prej bronzi një herë, dy herë, njëzet herë, saqë ai mbiemri Vuksani të mos lexohej dot më. Por unë s'bëra asgjë të tillë, vetëm shtrëngova dhëmbët dhe murmuri-ta: çdreqin ke, ç'dreqin ke, moj Ana?

Atëherë ajo s'kishë pasur akoma asgjë me Viktorin. Këtë e mora vesh më vonë nga vetë goja e tij, kur ai në një çast hapjeje zemrash më tregoi historinë e marrëdhënieve të tyre. Po kjo ndodhi më vonë. Para kësaj ne patëm edhe një periudhë tjetër afrimi. Kjo ndodhi pak kohë pas pushtimit të Çekoslovakisë prej BRSS, atëherë kur u shpall dalja e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës. Gjithë ditën radioja jepte deklaratën e qeverisë sonë dhe jehonën e saj brenda dhe jashtë vendit. Në Universitet bëheshin mitingje armatosnin. Këtë gjë e mora vesh së pari nga Ana.

— Thonë se ju, djemtë, do të merrni armë, — tha ajo.

— Po ju?

Ajo ngriti supet.

— Nuk e di. Ndoshta më vonë.

Sytë e saj ishin të ngrohtë, si në kohët e mira midis nesh. Edhe zëri. Edhe supet. Në vilat e ambasadeve të huaja, përgjatë Rrugës së Elbasanit kishte lëvizje makinash. Ne u kthyem në një rrugicë të qetë pranë ndërtesës së Radio Televizionit. Ja ambasada çekoslovakë, tha ajo. Kopshti i rrrethuar me kangjella të hekurta, garazhet, vetë ndërtesa, dukeshin si të pabauara.

Gjithë ato ditë, gjatë pushimeve të leksioneve, gjatë mitingjeve ne rrnim bashkë. E gjenim njëri-tjetrin lehtësisht, pa u munduar. Mbrëmjeve unë i ndiqja lajmet me hollësi, dhe të nesërmen i tregoja asaj kurresthitë e ndryshme. Ajo dëgjonte me interesim. I tregova për shembull, për atë aeroplalin e parë sovjetik që u ul në mënyrë krejt misterioze në aeroportin e Pragës në atë mesnatën fatale të pushtimit. Ai u ul në një nga pistat e largëta të aeroportit dhe mbeti atje. As dyert nuk hapeshin, as njerëz nuk zbrisnin prej tij. Siç u mor vesh më vonë, ai ishte korbi i parë, pas të cilit vinin trumbat e zeza.

Ana e dëgjonte çdo gjë me vëmëndje.

— A mund të na sulmonin edhe ne, si ndëshkim që dolëm nga Traktati?

— Mundet, — i thashë.

— Ç'gjë e neveritshme, — thoshte ajo. — Të del një shtet i largët, me të cilin ti prej kohësh s'dëshiron të kesh asnjë punë, dhe vetëm pse është më i madh se ti, të kërcënon me pushtim. Është për të luajtur nga mendtë, apo jo?

E merrja me mend se sa revoltuese i dukej kjo gjë Anës, asaj që nuk duronte dot shfaqjen më të vogël të brutalitetit të vagabondëve në rrugë, pale pastaj brutalitetin e shteteve.

Në ato ditë unë e shoqërova disa herë gjer në shtëpi, dhe ajo përherë e më pa ngut ngjitte shkallët, dhe akoma më pa ngut mbyllte derën e apartamentit, pasi më thoshte «natën e mirë». Mirëpo unë s'kisha më asnjë dëshirë goditjeje ndaj asaj dere, me asnjë mjet, e aq më pak me kokë.

Tani ne filluam të rrnim bashkë kudo: në mbledhje, në mbrëmje vallëzimi, gjatë leksioneve. Viktori bëhej pak nervoz, po ç'është e vërteta, e mbante veten. Në të vërtetë unë prisja më pak dinjitet nga ana e tij, por s'ishte ashtu. Fillova ta çmoja më tepër. S'thoshin kot se ne të dy ngjisnim në shumë gjëra. Në atë kohë unë u sëmura nga verdhëza.

Tara, tara... tara... tara... Djaloshi me dorë të li-dhur vazhdonte të këndonte nëpër dhëmbë.

Për të tretën herë ndalova përpara stendës ku ishin vënë fotografitë e punonjësve të dalluar, Ana po vononte. Nga dera e brendshme hynin e dilnin vazhdimisht njerëz.

Në atë drejtim, në thellësi të kopshtit ishte ndërtesa e spitalit infektiv, ku unë isha shtuar atëherë për dy muaj rresht. Kur dola nga spitali gjithë kurset e treta të fakultetit kishin shkuar në aksion. Akoma i verdhë nga sëmundja, unë kalova ca javë të mërzitshme në Tiranë. Shokët nuk i kisha parë prej shumë kohësh për shkak të ndalimit të vizitave në infektiv.

Pikërisht në aksion Ana ishte afruar përfundimisht me Viktorin. Këtë ma tregoi më vonë ai vetë, gjatë asaj hapjes së paharrueshme të zemrave, në një ditë-lindje. Kishim qëlluar ngjitur të dy në tryezë dhe pas dy gotave, filluam të zbértheheshim. Ishte një mbrëmje e ngrohtë, plot zagushi. Ne herë acaroheshim, herë ishim gati t'i falnim njëri-tjetrit gjithçka. Kampionë të altruizmit të dy, mezi e përballonim valën e vlijimeve që mund të bënim për njëri-tjetrin. Ti nuk e di se ç'jam në gjendje të bëj unë për shokun, domethënë për ty... Për ty unë... Por do ta marrësh vesh ndonjë ditë se kush është Viktori... Ai merrte frymë thellë, sytë i kishte të mjegulluar, unë nuk isha më pak i mallëngjyer. Ne ishim të dy si në një hamam të nxeh-të, ku po na merrej fryma nga avulli i fisnikërisë. Motivi i flijimit ishte kryesor, si në Kalanë e Rozafatit. Gjithsecili vuante kur mendonte se tjetri s'do të arrinte të kuptonte atë që ai mund të bënte për shokun. Dhe ishim të dy të singertë gjer në fund. Ai më po-hoi se kishte çaste që bëhej pakëz xheloz akoma ndaj meje, sepse Ana... (ai kishte guximin të mos i fshihte asgjë shokut)... pra Ana, gruaja e tij e ardhshme (ata do të fejoheshin vjeshtën e ardhshme)... tregonte akoma herë-herë simpati për mua. Është një lloj dashurie

e ngadaltë, më shpjegonte ai. Dashuri latente, kështu quhet, që harxhohet dalngadalë, pa shpërthyer kurrë, më kupton? Kur ti, pasi kishe dalë nga spitali, na dole përpala i verdhë si fantazma e Bankos, të kujtohet, ajo u trondit si asnjëherë tjetër. Dhe ai prapë nisi të shpjegonte se ç'ishte dashuria latente. Por ai nuk ishte nga ata burrecë meskinë, që e veçojnë gruan nga shokët, dhe veç kësaj, ai kishte besim tek Ana, po kryesorja ishte se ai kishte besim te shoku, domethënë tek unë, si të vetja. Ti s'e ke njohur akoma Viktorin, thoshte ai. Ti mund të vish në shtëpinë tonë kur të duash, dhe do të jesh i mirëpritur gjithmonë, si nga unë, dhe natyrisht nga Ana. Unë tundja kokën në shenjë mohimi. As ai, as Ana nuk e kuptionin se ç'isha gati të bëja unë për ta. Le të ishin të lumtur. Unë kurrë s'do t'u ngatërrokesha nëpër këmbë. Mua më mjaftonte vetëm që ata të ishin të lumtur, ai, dhe sidomos Ana. Kurse sa për në shtëpinë tuaj, po ta them singerisht, Viktor, atje nuk të vij. Dhe e thosha me gjithë mend. Nuk më pëlqente vetja të isha si një personazh i tretë: burri, gruaja dhe ai (domethënë unë), trekëndëshi i famshëm, si në romanet e realizmit borgjez. Të kthehesha, si të thuash, në... kategori estetike. Në asnjë mënyrë.

Ndërsa prisja që Ana të dilte, e solla edhe një herë nëpër mend atë mbrëmje të çmendur. Dhe befas, sikur të bëja një zbulim, gati sa s'thirra me zë të lartë: po ku është Viktori? Përse s'është me Anën?

Fillova të ecja prapë poshtë e përpjetë, nga hyrja e infermierisë te porta e brendshme. Mos ishin ndarë, mendova. Mos ai s'dinte asgjë? S'ishte e mundur ta kishte braktisur në fatkeqësi... Këtë s'mund ta bënte askush. E aq më pak ai.

Vazhdoja të ecja poshtë e përpjetë oborrit. Një makinë e ndihmës së shpejtë kaloi me ngut nëpër portën e madhe. Viktor, i poshtër, thashë një herë me vete, dhe në çast e kuptova se kjo ishte mbeturina e fundit e inatit të fillimit, kur kuptova se Ana kishte

mbetur shtatzënë. Kisha vënë re se edhe kur shkaqet zhdukeshin, shija e inatit vazhdonte.

Djaloshi me dorë të lidhur te dera e infermierisë vazhdonte të vërshëllente, pa u lodhur, pér të njëqind-tën herë motivin e tij. Unë e hoqa mendjen nga Viktori. Duhej menduar vetëm pér Anën, vetëm pér të, me densitet, me ngut, me alarm, ashtu si sirena e makinës së ndihmës së shpejtë. Në qoftë se ishte vërtet e sëmurë, siç dyshonte, e shumta i mbetej një vit jetë. Pastaj fillonin dhimbjet e tmerrshme dhe pas tyre mbarimi. Vjeshta gjethet u ndërron pemëve, vërshëllente djaloshi. E shumta një vit. Dhe asnje vjeshtë s'do t'i ndërronte mbiemrin Anës. Në sy më rrinte tabela e vogël prej bronzi, që desha ta dérrmoja atëherë me kokë: Ana Vuksani. Ana Vuksani. Vuksani gjithmonë.

S'kisha cigare dhe i kërkova dorëlidhurit. Ai më zgjati paketen, pa e ndërprerë vërshëllimën. Më vonë do të gjendet edhe shërimi i kancerit, mendova, por ç'e do, atëherë Ana s'do të jetë më.

E shumta një vit dhe Ana s'do të ishte më. Nuk mësohesha dot me këtë mendim. Ajo s'do të arrinte dot tridhjetëvjetorin e Çlirimt, përmbysjen e fashizmit në Spanjë, mbarimin e hidrocentralit të Fierzës, vitin 2000. Dhe atë vjeshtën e dasmës...

Së paku, ky vit të jetë një vit i vërtetë jete pér ty, mendova. Dalngadalë në mendjen time Viktori ishte larguar, ishte bërë i parëndësishëm, dhe mua më dukej se kisha mbetur i vetmi që duhej të ndërmerrja diçka pér Anën. Së paku ky vit të ishte i lumtur pér të. Djaloshi me dorë të lidhur vazhdonte të këndonte. Paik më parë desha t'i thërrisja miaft! sepse më dukej sikur kënga e tij ishte kundër Anës, kurse tanë desha t'i buzëqeshja. Këndo, dorëlidhur. Vjeshta do të vinte edhe pér Anën, në qoftë se ajo do të donte... Një mendim tallazitës avitej e avitej si një re e vogël e bardhë, që zmadhohej me shpejtësi gjersa mbuloi krejt qiellin tim. Do të bëja gjithçka pér Anën. Më tepër se

një bashkëshort. Më tepër se një dashnor. Do të bëja gjithçka që mund të bëhet në botë për njeriun e afërt, të dashur, pavarësisht se Ana nuk ishte «imja». Imja... Çishte ky përemër pronor i neveritshëm që përdorej në marrëdhëniet midis djemve dhe vajzave? Jam yti, je imja, përjetë jotja... Si në një pazar skllevërish.

Do të bëja gjithçka për Anën, shoqen time. Po çfarë? Të martoheshë?... Ky mendim më kaloi vetëtimthi, pa më habitur aspak, si diçka pa shumë rëndësi. Dëshira ime për të qenë përkrah Anës në këtë fatkeqësi ishte përtej martesës, diçka më e madhe dhe më sublime. Po unë edhe mund të martoheshë me të, po të dëshëronte ajo. Po kjo s'kishte ndonjë rëndësi kushedi çfarë. Unë isha gati të bëja për të shumë më tepër. Të bëja gjithçka, jashtë atyre «imja», «jotja», etj., etj.

Hapat e mi u bënë të gjatë dhe të hallakatur. Dy-tri gra nisën të më shihnin me dyshim. Mendimi pér martesën me Anën, rrinte diku anash, i druajtur, si një ylber. Viktori qe zvogëluar fare në mendimet e mia. Duhej menduar vetëm pér Anën, me ngut, me alarm, si në ndihmën e shpejtë. S'ishte puna që Ana, si gjithë vajzat, të arrinte ta ndërronte mbiemrin e saj në vjeshtë. Dhe as që të arrinte të lindte një fëmijë, në mënyrë që në botë të mbetej diçka prej saj. (Të gjitha këto më kaluan disa herë rrëmbimthi nëpér mend). Ato do të bëheshin po të donte ajo. Po s'ishte vetëm kjo. Jo, ishte diçka më e thellë, më e vërtetë, që mendimi im s'arrinte ta përcaktonte dot. Ne kishim qenë shokë kaq kohë. Unë e kisha dashur atë, kurse ajo jo (me përjashtim të asaj ngrrohtësisë së herëpashershme që Viktori e kishte quajtur «dashuri latente»). Pra unë isha tek ajo dhe ajo tek unë, ashtu siç ishim ne të dy te të tjerët. Duke ikur nga bota, ajo merrte me vete një pjesë të qenies sime, por linte në botë shumë më tepër se ç'merrte. Sepse tek unë ajo zinte më tepër vend se ç'zija unë tek ajo. Pra Ana ishte tek unë. Ana nuk do të vdiste në qoftë se unë... në qoftë se unë... Çfarë «në qoftë se unë»? pyeta veten. Ndër mend më erdhi

një nga ato ditët e daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, kur unë e përcillja atë gjer në shtëpi. Kisha dëshirë të dija si do të ishe ti në luftë, më tha ajo duke buzëqeshur në një mënyrë të tillë që është vështirë ta quash dinakërisht, sepse kjo është një fjalë tepër e rëndë pér atë lloj buzëqeshjeje vajzërore. Si do të isha unë në luftë... Shumë herë e kisha përsëritur me vete këtë pyetje të saj, pa e gjetur dot se ç'don'te të thoshte Ana me të. Pastaj e kisha hequr mendjen prej saj, duke e qetësuar veten me faktin që nganjëherë pyetjeve të thjeshta të vajzave është vështirë t'u japid përgjigje edhe një grumbull i tërë filozofësh. Si do të isha unë në luftë... Si do të isha unë pas ikjes së Anës... Dhe befas më shkrepit në kokë ideja se unë, Viktori, ne, të gjithë shokët dhe shoqet e saj, do të mbanim midis nesh Anën, të gjallë, të paprishur, në qoftë se do të ishim të denjë pér atë çka ajo kishte më të mirë, dhe që pas ikjes së saj, do ta linte te ne si në një urnë. Dhe kështu asgjë nuk do të humbte prej Anës.

Vazhdoja të ecja poshtë e lart oborrit dhe disa herë u ndala përparraga gazetës së murit duke lexuar pér të dhjetën herë titujt e artikujve. Kishte kaluar më tepër se një orë e gjysmë që kur Ana kishte hyrë benda. Dielli po perëndonte nga ana e bulevardit të madh, i kuq e i rrumbullakët, pa rreze, si i prerë nga një afishë e madhe. Djaloshi me krahun e thyer kishte ikur dhe njerëzit po rralloheshin përreth. Kurse unë vazhdoja të mendoja pér të. Shpenzoheshin miliona pér shpëtimin e monumenteve të vjetra kulturore. Përmbytjet e Nilit... sfinksat egjiptianë... gjithfarë komisionesh ndërkombëtare spekulimesh... shpërdorimesh... Kurse unë kisha pér detyrë të mendoja pér shpëtimin e Anës duke mos qenë as vëllai, as burri, as drejtori i saj dhe duke mos qenë në asnje komision. Do të bëhesha gati të mbaja një pjesë të asaj diçkaje të vogël e të mirë që ajo i kishte sjellë njerëzimit, sepse çdo njeri, sado i thjeshtë që të ishte, i sillte diçka të mirë ose të ke-

qe oqeanit njerëzor. Unë duhej të bëhesha gati... Po përse po vononte kaq? Këtë pyetje e bëra shurnë herë rresht.

Më në fund, tutje, midis pishave dallova bluzën bojë qelli të Anës që po avitej bashkë me një bluzë tjetër të bardhë.

U ktheva nga porta që të fshihja tronditjen dhe u mundova me forcë ta përqëndroja mendimin në një pikë. Kryesorja është që unë jam këtu, përsëritja me vete si i mpirë.

Tani ajo me siguri kishte kapërcyer portën e brendshme dhe po afrohej. Papritur dëgjova që më thirri. U ktheva si i goditur nga diçka e befasishme, dhe e pashë që po vraponte drejt meje, e qeshur, me sy të përlotur, duke u hedhur e duke ma bërë me dorë. Unë bëra dy hapa drejt saj dhe ajo më përqafoi e më puthi. Unë mbylla sytë dhe desha të mbështetja kokën në supin e saj, të pushoja pak se isha lodhur shumë; po përqafimi i saj qe i shkurtër.

— Shpëtova, — tha duke iu marrë fryma. — Ah, ç'ankth, ç'gëzim, shpëtova!

Njerëzit përreth kujtuan me siguri se ishte e fejuara ime ose, së paku motra, dhe buzëqeshën.

— Më tre go pra, — i thashë me zë të lodhur.

— Asgjë, më tha doktori, absolutisht asgjë. Një gjëndër e thjeshtë, ashtu siç the ti. Po të duash, më tha, operoje, po të duash lëre për më vonë. Një gjëndër e thjeshtë dhjamore. Në fillim nuk e besova, po kur më tha që ta operoj, menjëherë e besova. Bile mori në dorë edhe bisturinë. Ç'mjek i hatashëm. Kjo qe e gjitha. Sa e lumtur jam!

Ajo fliste dhe fliste pa pushim, dhe unë e vëشتroja në sy, gjysmë i habitur, gjysmë i ngazëllyer që kisha përpëra Anën e parë, ashtu siç e mbaja mend gjithmonë, në kohën kur nuk më zinte gjumi për të.

— Po ti, pse je kështu, s'di si të them... Nuk gjëzohesh për mua?

— Unë?... Nuk gëzohem pér ty?...

— Dale, dale, mos u fyej. S'e thashë me atë qëllim. Pastaj, mos ma vër re, jam si e marrosur nga gëzimi.

Ajo më kapi pér dore dhe ecëm drejt portës. Ndërsa po dilnim, ktheva dhe një herë kokën tek ajo hapësirë e oborrit midis infermierisë, gazetës së murit dhe drurit të mollës, ku unë kisha krijuar dhe kisha lënë po aty, midis tyre, projektin e pambaruar të shpëtimit të saj.

Autobusët e linjës ishin plot dhe ne qëndruam prapë në fund, atje ku xhamat janë të përkulur dhe objektet përtëj tyre duken të zgjatura e flurore. Në qytet ishin ndezur dritat e para. Dyqanet ushqimore, bufetë e vogla, mobileritë dërgonin reflekset e tyre mbi fyttyrën e saj. Sytë tanë takoheshin herë pas here dhe ajo më buzëqeshte me mirënjojhe.

Gjithçka që kisha menduar tek oborri i spitalit, më dukej tani e largët dhe naive. Vështroja përreth dhe mendoja: sikur ta dinin këta njerëz se ç'fantazira kisha pasur unë në kokë përparrë një ore. Sikur ta dinte Ana. Mirëpo, pér çudi, kujtimi i asaj vale sentimentale, megjithëse e kuptoja që ishte ashtu, nuk më shkaktonte ndonjë ndjesi turpi. Në një rast tjetër do të haja veten me dhëmbë, po tani ndihesha i qetë. Madje ndieja një gëzim të shtruar që kjo gjë kishte ndodhur. Në kujtesë përpiquej të më përvijohej subjekti i një filmi të huaj, që e kisha parë dikur, ku njerëzit përparrë vdekjes bëheshin si bisha, duke flakur bashkë me rrobat, mbeturinat e fundit të njerëzillëkut të tyre. Kurse unë me Anën... Po, më mirë që kjo kishte ndodhur, njëqind herë më mirë. Pa këtë mbasdite, diçka do t'i mungonte kujtimit tim pér Anën, dhe ndoshta, kujtit mit të saj pér mua.

*Ajo vazhdonte të më buzëqeshte qëtësisht, me mirënjojhe. Ndërsa autobusi i afrohej stacionit ku do të zbrisnim, unë e ndjeva se po afrohej pér ne të dy një çast i vështirë: ndarja. Ishte një çast që mund të shfa-*

qej banaliteti, nga ana ime ose nga ana e saj; për të vrarë gjithçka të mirë, që kishte përfuar midis nesh kjo mbasdite e rastësishme. Nuk e di, në qoftë se edhe ajo, qoftë edhe në mënyrë të pavetëdijshme, që shqetësuar për këtë por në çastin që ne zbritëm, në atë çast të vështirë, kur ne të dy do të viheshim përpara provës, për të kapërcyer mbeturinat e tregtarizmit borgjez, mirënjojen për shërbimin, shpërblimin për pritjen e gjatë, etj., ajo, në mënyrë krejt të natyrshme, tha:

— Dhe tani ç'do të bëjmë? Do të më përcjellësh ti apo të të përcjell unë?

Unë ngrita supet si për t'i thënë: si të duash dhe ajo më përçolli gjer te stacioni i Bankës së Shtetit, ku unë, disa orë më parë, kisha pritur autobusin për të shkuar te një shok.

Unë hipë dhe ajo qëndroi përjashta, duke pritur gjersa unë u ula në një ndenjëse pranë drifores. Ajo u afrua jashtë dhe vazhdoi të fliste me mua, si ata njërejzit kur përcjellin dikë në linjat e largëta. Pastaj autobusi, ajo ma bëri edhe një herë me dorë dhe nuk e pashë më. Mbështeta ballin te shpina e ndenjëses përpara meje dhe qëndrova ashtu disa sekonda, i lodhur dhe bosh njëkohësisht. Po kjo vazhdoi shumë pak kohë. Befas një valë e ngrohtë gjëzimi më mbështolli nga të gjitha anët, një dehje si atë ditë në dëborë, por më e gjerë e më e përgjithshme. Ishte gjëzimi që Ana ishte në botë, që rrugët, magazinat, shtëpitë ishin të mbushura me njerëz si ajo, të afta të jepnin gjëzime të bukurë dhe pikëllime akoma më të bukura. Që vinin vjeshtat dhe u ndërronin vajzave mbiemrat si gjethet, paçka se mbiemri i Anës nuk do të fluturonë për t'i lënë vendin mbiemrit tim, s'ka gjë, s'ka gjë. Kryesorja ishte që ajo jetonte dhe që ishte e lumtur. Dhe unë do të shkoja tek ata të dy, kur të martoheshin, jo si një i tretë... kategori estetike, por thjesht si mik, si njeri.

Autobusi ecte dhe pas ca çastesh, unë e kapa vëten duke vërvshëlyer melodinë e atij djalit me dorë të lidhur te dera e infermierisë.

## NE STUDIO, NE VJESHTË

Ai ktheu kokën papritur, sikur të dëgjonte një trokitje. Jo, ishte era në xhamat e studios. Megjithatë e la penelin dhe, sikur t'i bindej asaj thirrijeje, iu afroa xhamllékut. Jashtë ishte vjeshta me të gjitha ngjyrat dhe tekat e saj. Studioja ishte në katin e pestë dhe që andej dukej rruga kryesore, me magazinat, udhëkryqet dhe vendqëndrimet e autobusit në të dy krahët. Një pjesë e autobusëve urbanë që kalonin, kishin gjethë të rëna përsipër. Atyre që janë brenda as që u shkon ndër mend një gjë e tillë, mendoi ai. U mat t'u kthente shpinën xhamave, por në atë çast në shkallët e pallatit përballë pa një vajzë që po ngjitej me shpejtësi. Shkallët e pallatit përballë ishin një fushë e përhershme vrojtimi për të. Nëpër to hipnin e zbritnin gjithfarë njerëzish, me gjithfarë lëvizjesh, të qeta, të vrullshme, të rënduara nga mosha, të hareshme, tinëzare, nganjëherë komike. Pensionistët ngjiteshin ngadalë, duke mbajtur në duar rrjetën me bukë ose me shishet e qumështit; djemtë e gjimnazeve zbritnin si të çakërdisur, duke i kapërcyer shkallët katër e nga ka-

tér; mysafirët kishin një mënyrë të ecuri të veçantë, kurse nxënëset e shkollave të mesme, përpara se të ndaheshin, kthenin edhe një herë kokën, për t'i kujtarar njëra-tjetrës detyrat e matematikës.

Në katin e tretë, vajzës që po ngjitej, era i shpupuriti flokët rrëmbimthi dhe ajo, ndërsa përpiquej të shtronte flokët me njëren dorë, me tjetrën mbante fundin, që të mos i gufmohej. Ai u mat të kthehej te kavaleti, por iu duk se në fytyrën e vajzës pikasi një buzëqeshje. Midis erës dhe rrëmujës hollake të fijeve të flokëve apo buzëqeshje iu duk jo e zakonshme. S'ishte ndjesia e largësirës, që ka gjithmonë buzëqeshja e njeriut të vetëm, meqënëse lidhet përherë me një kujtim. Ishte diçka më e veçantë. Në katin e katërt, me gjithë furinë e erës, vajza e kishte ruajtur akoma atë buzëqeshje. Ajo ktheu shpinën për t'i rënë ziles, dhe ai nuk e pa më fytyrën e saj.

Ai u kthyte gjithashtu te kavaleti. Por, përpara se të merrte penelin, eci një copë herë poshtë e lart në-për studio. Ishte i gjatë, i hollë dhe, me gjithë moshën 71-vjeçare, hapat, ashtu si trupin, i kishte të gjatë dhe të lehtë. Nganjëherë i dukej se sikur studioja të kishte qenë e ngushtë, ai në vrullin e ecejakeve të tij, do të përplasej nga muret te xhamillëku, si ato fluturat e natës. Por studioja ishte e gjerë dhe ai e ndiente vreten lirshëm në të. Në të gjitha faqet e mureve ishin vendosur me dhjetëra tablo. Njerëzit që i vinin për vizitë, kishin përshtypjen se, pa ato tablo në mure, soba me qymyrguri do ta kishte vështirë ta ngrohte studion.

Ai mori një fletë dhe me dy-tri vija të lapsit u përpoq të fiksonte lëvizjen e vajzës për të mbrojtur flokët dhe fundin nga era. E kishte bërë me dhjetëra herë këtë gjë, me kalimtarët që shihte në rrugë, ose në shkallët e pallatit përballë. Dhe e kishte bërë me mijëra herë me njerëzit në përgjithësi.

Në një dollap të madh ishin stivuar njëra mbi

tjetrën me mijëra fletë të mbushura me skicime lëvizjesh. Shqiptari duke ecur, duke shkuar në dasmë, në luftë, në pritën e gjakmarries, kot. Shqiptari në valle, në gjëmë, në kthim. Lëvizje të furtunshme meshkujsh dhe lëvizje poetike grash. Reumatizmi madhështor në gjymtyrët e pleqve, statizmi i nuseve, luftëtari i plagosur duke çarë rrëthimin (kirurgu duhej ta kuptione menjëherë prej vizatimit, ku ishin plumbat dhe të niste në çast operimin), partizanët në barrikadë, refugjatët. Ishin mijëra që lëviznin nëpër mijëra drejtime, një det i tërë njerëzor, opingat, këpucët apo thjesht tabanet e zbathura të së cilëve bënin një rropamë të shurdhër.

Kishte gjysmë shekulli që e kishte nisur këtë pa-sion. Profesorët e huaj në akademinë e pikturës përkuleshin të habitur, disa të mrekulluar, disa mospërfillës mbi vizatimet e tij. Një grumbull malësorësh duke shkuar për në dasmë. Poshtë mbishkrimi: ç'u mbush mali plot me dushk, thotë nenia janë krushq. Ata kër-konin shpjegime: ç'janë këto vija të zeza, si mekanizma që vënë në lëvizje rrotat e lokomotivave? Janë tirq, shpjegonte ai, kështu i kanë rrobat malësorët tanë. Po ç'është kjo mënyrë të ecuri dhe ç'është ky mbishkrim këtu poshtë? Kështu ecin malësorët tanë dhe këto janë fjalët e një kënge. Po kjo është një ecje tjetërloj, thua se brënda trupit ata kanë zgavra ajri, që ua lehtësojnë mishin dhe kockat. Ndoshta kjo është tamam ashtu, shpjegonte ai, ata hanë shumë pak, zotni, po, po, kjo është e sigurt, ata kanë vërtet copëra ajri në stomaq.

Profesorët tundnin kokat. Sidoqoftë është një kurreshti e këndshme, i thoshin njëri-tjetrit. Dhe herën tjetër ndaleshin prapë te kavaleti i tij. E çuditshme, i thoshin, ç'është kjo fytirë e ngrrirë nuseje? Ju gjithçka e keni bërë në lëvizje në këtë tablo, vetëm nusen e keni mumifikuar. A s'është ajo që po martohet, a? Ç'është ky sfinks? Këtë e kam vështirë t'jua shpjegoj, thoshte ai. O, është gati e pamundur ta kuptoni.

Pas mbarimit të studimeve ai u kthyesh në atdhe. Ishte gjithë vulle, nganjëherë i dukej sikur po i merrshin mendtë nga planet krijuar. Por dalngadalë gjithçka filloi të fikej brenda tij. Vendi ishte shpallur ndërkaq mbretëri. Gjithçka kishte ndalur në vend. Madje atij i dukej se as retë s'lëviznin më, dhe bora ishte dhjamur e rënduar, dhe çdo gjë kishte ngrirë. Përreth kishte amulli, një pluhur dhe një vapë orienti dhe këngë të zvargura ahengxhinjsh. Sa herë që provonte të vizatonte, atij i mbërtheheshtin duart si nga një ngërç. Ato lëvizje njerëzore, me të cilat kishte mahnitur profesorët e tij, nuk i ngjallte dot më mbi letër. I vdisnin aty për aty. Thyheshtin gjunjët e malësorëve që niseshin për diku, plogështoheshin valltarët, çdo gjë vyshkej. Gjithçka ishte reumatizëm, nerv shiatik, paralizë. Lëvizte vetëm ai, ecte udhëve si i marrë, hynte në ndonjë kafene, dilte sakaq, ikte. Ç'është kështu, thoshte me vete.

Jepte vizatim në shkollën qytetëse. Askush nuk e dinte që ishte piktor. Disa e dinin thjesht bojaxhi, madje e kishin thirrur disa herë për të lyer ndonjë kanat shtëpie apo qepen dyqani. Një i njojur i vet, skulptor, që kishte mbaruar gjithash tu akademinë jashtë shtetit, kishte marrë më në fund një porosi: do të zbuluronte banjën e mbretit.

Nganjëherë, një koleg i tij, mësues letërsie, i thoshte kur e takonte: q'thotë arti? Kjo ishte një ditë me fat për të. Kjo pyetje e thjeshtë, që kolegut i që bërrë shprehi dhe që qëllonte t'ia bënte nganjëherë midis gogësimës, ishte për të atmosferë krijuar, mendim kritik, përkrahje morale, shtyp, bujë. Ringjallej një çast, mendonte të vravonte në shtëpi, të ngrinte kavaletin, të hapte tubetat e ngjyrave, të mbyllura prej kohësh, të... të... Por kalonte çasti i rrëmbimit dhe gjithçka ftohej brenda tij. Nganjëherë i dukej se mund të vizatonte vetëm kufoma.

Njëzet vjetë kështu.

Ai i që afruar prapë xhamillëkut të studios dhe po

vështronte përjashta. Prapë një autobus me gjethë, tha me vete. E mori me mend se si në stacionin e mëparshëm, përpëra se ta kishte ndalur autobusin, shoferi do ta kishte afruar atë më shumë se ç'duhej pranë ndonjë druri, dhe gjethet qenë shkundur me shumicë mbi të. Në dorë kishte fletën ku kishte vizatuar vajzën që mbronte flokët nga era. Lëvizja e saj ishte e përpiktë, por në fytyrë diçka i mungonte. Buzëqeshja e saj. E mbështeti letrën mbi xham dhe hoqi disa vijëza të shpejta. Ajo buzëqeshje, e lehtë, midis pleksjes së fijeve të holla të flokëve, që i merrte era. Ah, ja, ku ishte. Mos... Ai e largoi dorën, sikur të kishte frikë se edhe një vijëz e vetme do ta fikte buzëqeshjen. E lëshoi vizatimin mbi parapetin e xhamllëkut dhe iu afroa prapë kavaletit.

Nuk i harrohej ai nëntor i vitit 1944, kur për herë të parë, pas një kohe të gjatë, e hapi kavaletin. Në qendër të Tiranës vazhdonte akoma lufta përmarrjen e fortifikatave të fundit të gjermanëve. Ai kishte shkuar gjer pranë qendrës dhe kishte qëndruar e po ndiqte me sy një njësit të vogël partizanësh, që po bëhen shin gati përmes sulmuar fortinon prapa xhamisë së vjetër. Binte një shi i hollë bore. Partizanët kishin gjetur një makinë të shtrimit të rrugëve dhe bëhen shin gati t'a përdornin si autoblindë kundër fortinos. Përpëra timonit kishin vënë një rrangallë të hekurt, përtë mbrojtur timonierin nga plumbat. Ruli i rëndë i makinës nxinte në shi. Atij i që dukur se aty-këtu mbi rul kishte ca si njolla gjaku.

Qe kthyer në shtëpi, kishte hapur me vrull arkën e vjetër ku mbante furçat, letrat dhe tubetat e ngjyra-ve dhe po rrinte si i daldisur përpëra tyre. Kishte kohë që s'kishte vizatuar. Një si fikje e përshkoi gjithë trupin e tij, duke i dhënë shtrëngim në zemër. Ata partizanë që u nisen drejt fortinos, gjysmë të përkulur, duke u mbajtur pas makinës së shtrimit të asfaltit, timonieri i bërë njësh me timonin, ruli i rëndë me ato si njolla gjaku përsipër, të gjitha këto nuk i hiqe-

shin nga mendja. Dhe fill pas tyre pyetja: po sikur të mos... Dora, me një lëvizje të druajtur, mori lapsin dhe nisi të hiqte vijat e para. Balli iu mbulua me djersë. Gati-gati i dukej se eshirat e dorës lëshonin një kuisje, si ai mekanizmi i ndryshkur, i papërdorur prej kohësh. Që larg vinin gjëmimet e fundit të luftës. Atij i dukej se ishte vetëm dorë... Mos më lër... Dhe dora po i bindej. Shkrinte allçia që e kishte muruar për njëzet vjetë rresht, kripërat në kyçet e kockave, ngërci, paraliza. Gjithë ditën, gjersa u ngrys, ai vizatoi pa pushim. Ishin qindra etyde të së njëjtës temë: partizanët dhe fortinoja.

Ai muaj qe i paharruar për të. Pas vizatimeve provoi ngjyrat. Kishte rënë dëborë. Tubetat e ngjyrave ishin të hapura përpara tij: e bardha, e kaltra, e kuqja. Ngadalë, me dorën e kujdeshme, ai po i nxirrte nga morgu njëzetvjeçar. Po piktoronte dëborën mbi çatitë e Tiranës. Gjithë gjëzimin njerëzor, atë drithë të përgjithshme që ndeshej në çdo rrugë e në çdo shesh, u përhoq ta jepte në atë dëborë. Dhe bora i bindej. Rrëzohej nga qelli nëpër penelin e tij, shtrohej mbi çatira, ndriste e kaltëronte tejembanë.

Kështu kishin rrjedhur njëra pas tjetrës javët e para të ringjalljes së tij. I thanë të jepte marksizëm në gjimnazin e porsahapur. Nuk kishte lexuar asnje libër të Marksit, megjithatë hyri në klasë. Shumica e nxënësve ishin me armë në brez, një pjesë i kishin kokat të lidhura. Ai u tha: ju e dini më mirë se unë marksizmin. Ngrihuni e tregoni episode të luftës. Ata u ngriten e folën për batalionet dhe brigadat. Kur i erdhi radha atij të fliste, u tregoi se si kishte mundur të piktoronte partizanët dhe dëborën. Kjo kishte qenë ora e marksizmit.

Ai buzëqeshi, siç bënte gjithsaherë i kujtohej kjo. Njëherë, vite më vonë, kur një epror i tij, piktor edhe ai, i hoqi vërejtjen se kishte hyrë në zyrën e tij pa mbërthyer xhaketën, ai ia tregoi atë orë të dikurshme mësimi.

Në parapetin e studios ishte akoma e rrëzuar fleta me vajzën që buzëqeshte përmes erës. Ai e ngriti fletën dhe e futi në dollap, atje ku kishte mijëra të tjera. Nganjëherë nxirrte prej tyre motive për tablotë e tij. Por motivet ishin të shumta, kurse vitet që i mbeteshin për të piktuuar ishin të numëruara. I duheshin së paku njëzet vjet për të harxhuar një pjesë të tyre. Ai tundte kokën me hidhërim. Ajo humbje kohe prej njëzet vjetësh nganjëherë e mundonte gati fizikisht. I dukej vetja si një galeri e vjedhur, nga ato që tregonin lajmet e jashtme të TV. Mbret Zog, murmuriste me vete. Ti më vodhe mua njëzet vjet art.

Shtatëdhjetë e një vjeç, thoshte nganjëherë me vete. Shikonte duart e tij, sikur t'i pyeste: nuk do të më lini në baltë, a? Duhej të fitonte patjetër ato njëzet vjet të rinisë së tij. Duhej të nxirrte njëzet vjet rinie nga miniera e moshës së vonë të tij.

Era vjeshtore fërkohej lehtë pas xhamave të studios. Ai vështronë dollapin e madh, ku ishin stivosur njëra mbi tjetrën skicat dhe motivet e tij. Mijëra njërez që lëviznin, vallëzonin, ecnin, luftonin, dashurohen. Në të vërtetë ai ishte i gjithi atje. Kishte dalë nga vetja e vet, siç del njeriu nga shtëpia një ditë me diell, dhe kishte mbetur atje i humbur, i shpërndarë midis tyre. Ishte udhëtar nëpër xhadënë dimërore, krushk që shkon në dasmë, malësor që pret dikë në pritë, partizan mbi makinën e shtrimit të asfaltit, i vrarë që ka rënë përbysë në udhën e madhe, thjesht ecëtar nëpër ditë të pafundme...

Xhamat tingëllitën prapë, sikur vjeshta të trokiste në to. Ai mori penelin dhe filloj të pikturonte.

Mars, 1977.

## PAS MESIT TË NATEË

**A**ta po pinin duhan përpara dyqanit të kooperativës kur kaloi Suzana.

— Po vjen Suzi, — tha Leza, që e pa i pari.

Të tre burrat e prenë bisedën. Leza thithi fort cigaren dhe u mbështet më mirë te parvazi.

Suzana u mundua të ekte e qetë, por, siç dukej, shikimet e tyre e ngacmuan dhe ajo u bë nervoze. Tamam përpara dyqanit, i ra diçka nga dëra. Ajo u përkul ta merrte, po nuk e kapi menjëherë dhe u përkul prapë, më shumë. Për një çast të shkurtër, iu duk një pjesë e këmbëve të bardha, midis fundit të çorapëve dhe këmishës së hollë me dantellë. Në atë copë vend Leza kishte ngulur sytë e tij si i pirë. Po ai qe një çast shumë i shkurtër dhe ajo u largua shpejt me buzën e poshtme të varur nga inati dhe bezdia.

— Ta marrsha, — psherëtiu Leza.

Dy të tjerët qeshiën. Leza thithi cigaren.

— S'është e mundur që kjo femër të mos ia lozë bishtin, — tha Leza. — Ia patë dantellen në këmishë?

E çë pastaj?

— Gjersa mban këmishë të hollë me dantellë të ti-llë, do të thotë se e luan bishtin.

— Mbase në atë vendin nga ka ardhur ajo, kështu i mbajnë këmishët. Andej kooperativat janë të pasura dhe njerëzit të përparuar, jo si te ne.

— S'është e mundur, — nguli këmbë Leza. — Një grua që mban këmishë të tillë, me siguri e luan bish-tin.

— Eh, or Lezë. Tani njerëzit vishen më mirë, jo si dhjetë vjet më parë, kur porsa u çliruam.

— Po çorapët? — tha Leza. — I patë çorapët ngjyrë tjegulle të errët?

— Mua m'u dukën si çorapë të trikotazhit të Korçës.

— Çorapët ishin të Korçës, Leza. Tani të gjitha femrat e qytetit mbajnë të tillë, — tha tjetri.

— Po jo femrat tonë, — tha Leza.

— Po ndoshta në anët e saj kështu i mbajnë, ta thashë një herë.

— Lezës ia dogji gishtat cigarja. Një copë herë nuk folën. Leza pshëretiu.

— Thuaj më mirë, or babë, se ajo s'është për ne. Por bishtin, ama, e luan që ç'ke me të, — tha ai. — Kushedi, andej nga Tirana apo nga Laçi ka ndonjë dashnor. Me siguri ndonjë shef.

Shokët nuk iu përgjigjën. Ata hapën tjetër bisedë, po Lezës n'ik i hiqej nga mendja Suzana. Po binte mbrëmja. Përreth çdo gjë po errësohej. Dantella përmbi këmbën e bardhë i rrinte përpara syve vazhdimisht.

— Dreq o punë, — tha.

Suzana kishte ardhur nuse në fshatin e tyre tre muaj më parë. Të gjithë i çuditit nusja e Myfitit. Me siguri, i pari që u çudit ishte vetë Myfiti, burri i saj.

Ajo mbahej shumë pastër dhe vishej e krihej me kujdes. Nuse kaq e pastër dhe e kujdeshme s'ishte parë ndonjëherë në këtë fshat. Në fillim, kjo gjë i la pa gojë njerëzit dhe të gjithë e lavdëronin. Po pastaj,

te disa filluan dyshimet. Si shumë po e mbante vreten kjo nusja e Myfitit. Kaloi muaji i mjaltit dhe ajo përsëri vishej, lahej dhe krihej njëlloj si në fillim. Gratë thoshin se Myfiti ia kishte thënë copë dyshimin e tij, por ajo nuk kishte hequr dorë nga e saja. Sigurisht që ishin grindur dhe ndoshta grindeshin akoma.

— Ajo, me sa duket, nuk e do burrin, — tha Leza.  
— E tregon hapur.

— Ohu, fillove ti prapë me të. Natën e mirë, — tha njëri prej tyre.

— Natën e mirë, Lezë, — tha dhe tjetri.  
— Natën e mirë.

Leza qëndroi një copë herë në vend, pa ditur ç'të bënte, pastaj zuri të ikte i mërzitur.

Suzi, mendoi ai. Edhe emrin se si e ka ndryshe. Sikur të gërvishët një thikë e hollë e të djeg. Suzi!

Leza ishte njëzet e tetë vjeç, por akoma nuk ishte martuar. Jo se nuk gjente nuse, po nuk kishte dashur vetë. Leza ishte simpatik dhe në fshat e mbanin si donzhuan. Kishte pasur gjer tanë disa historira me femra. Po Leza nuk kënaqej kollaj. Tani ai e kishte mendjen te Suzi. Atij i pëlqente Suzi tek s'bëhet. Veç kësaj, ai nuk e kuptonte dhe trembej prej saj. Këto dy gjëra e bënин që ta dëshironte më shumë. Përveç kësaj, ishte i bindur që ajo nuk e donte burrin dhe që asaj i pëlqente dashuria. Që asaj i pëlqenin dashuritë, këtë gjë e dinte dhe bufi, mendonte Leza. Megjithatë, Suzana ishte shumë serioze dhe kjo i ngatërronte pak arsyetimet e Lezës. Ajo nuk i shikon te burrat në sy dhe s'kishte qejf të kalonte përpara tyre. Po atëherë përse kishte qejf të ishte aq e bukur dhe aq e pastër? Për kë? Për Myfitin? Bah.

Kishte dy javë që Lezës nuk i hiqej nga mendja Suzi. Tani nuk ia varte më as punës. Në mbledhjen e brigadës i kishin hequr vërejtje dy herë. Leza dëgjonte me vëmendje, por në sytë e tij të vegjël ndriçonte një dritë e sëmurë. Që nga ajo mbrëmje kur pa Suzanën të kalonte përpara dyqanit të kooperativës, ai

u bind se tē gjitha fjalët që thuheshin pér tē ishin tē vërteta.

Pa e bërë tē gjatë, ai vendosi ta provonte fatin e tij. Leza ishte i guximshëm. Ai vendosi t'i shkruante letër. Në qoftë se ajo nuk ia tregon letrën menjéherë Myfshit, burrit tē saj, do tē thotë se Leza fitoi. Leza harxhoi një ditë tē térë pér ta bërë atë letër. Atij i dukej se ajo do tē qeshte me tē gjitha frazat e tij. Pérse éshtë një gjë kaq e rëndë letra e dashurisë? thoshte ai me vete. Ai harxhoi një fletore tē térë. Më në fund, letra e tij doli mjaft e shkurtër. Më tepér se letër, kjo qe një pusullë: «Suzi, tē fle një natë me ty, pa le tē humb kokën. Leza». Në tē vërtetë, kjo pusullë shprehte në mënyrën më tē përbledhur tē gjitha fijet e ngatërruara tē mendimeve tē Lezës.

Pusullën ia çoi me një vajzë tē vogël dhe priti në rrugë. Ai ndiqte me sy hapat e vegjël tē vajzës. Vajza kaloi urën e drunjtë, që lidhte rruginën pérpara shtëpisë së Myfshit me rrugën kryesore tē fshatit, eci me vrap nëpér rrugicën e rrethuar me gardh nga tē dyja anët; shtyu portën dhe u fut në oborr. Lezës iu duk sikur atje qëndroi mjaft kohë. Pastaj, porta u hap dhe vajza e vogël rendi nëpér rruginë. Këmbët e saj gjëmuant mbi urën e drunjtë dhe ajo vrapoi drejt tij.

— E? — ia bëri Leza.

— Ia dhashë atë fletën, — tha vajza duke iu marrë fryma, — dhe teto Suzi tha që ti je budalla.

Leza u ngrys. Vajza e vogël iku me vrap, duke u hedhur térë gëzim.

Leza eci udhës, ndanë plepave, pa menduar asgjë. Cigaret i ishin mbaruar. Në kokë kishte një boshllék. Hodhi paketën bosh në hendek. Pastaj pështyu. Ca pula çukitnin me sqep ndanë udhës. Më tutje, te sheshi i fshatit kishte ndaluar një gaz shtatë vendësh, Leza u afrua.

— Kush ka ardhur me këtë makinë? — pyeti shoferin.

— Mysafirë, — tha shoferi.

Leza i nguli sytë targës.

— Ca mysafirë që do t'ju sjellin telashe, — tha shoferi dhe tregoi me kokë nga dera e vatrës së kulturës. Atje rrinin në këmbë tri vajza dhe një djalë. Vajzat ishin me pantallona. Në tokë ishin hedhur grumbull çantat e tyre dhe një valixhe e vogël.

— Inspektorë? — pyeti Leza.

Shoferi qeshi.

— Janë një ekip për prishjen e fejesave të mitura, — tha. — A keni fejesa të mitura në fshatin tuaj?

— Sa të duash, — tha Leza.

— Ata do të përpilen t'i prishin, — tha shoferi. Leza vështroi në drejtimin e të porsaardhurve.

— E, s'ta mbushin syrin? — e pyeti shoferi.

— Nuk thashë gjë.

Shoferi i zgjati një cigare.

Njëra nga vajzat erdhi duke rendur te makina.

— Më duket se më ka rënë krehri prapa sediles, — tha.

— Prit, se e gjejmë, — tha shoferi. Vajza përshëndeti me kokë Lezën. Edhe Leza e uli kokën por, siç dukej, e uli më tepër seç duhej, sepse vajza qeshi.

— Ja këto gocat do t'u nxjerrin telashe fanatikëve, — tha shoferi, duke i rënë vajzës në krahë. — Si të duket kjo punë?

— Për mua le t'i prishin të gjitha fejesat, — tha Leza. — Unë jam për ema... ema...

— Emancipimin, — tha vajza.

— Unë jam që të prishen të gjitha, — tha Leza. Ai i tha këto fjalë sinqerisht. Vetëm se i vinte keq që kjo punë nuk u bë më përpara. I vinte keq që këto ekipe nuk arritën ta ndalonin Myfitin që të merrte Suzanën e bukur për grua.

— Të lumtë, — tha shoferi, — qenike shok i mirë.

— Ju duhet të na ndihmoni në punën tonë, — i tha vajza. — Ne kemi një punë të vështirë, apo jo? Një copë herë Leza nuk foli. Ai vështroi vajzën me vëmendje.

— Ünë s'pérzihem në këto ngatërresa, — tha pa-pritur.

Shoferi dhe vajza u vështruan në sy. Leza i për-shëndeti dhe u largua.

Në të vërtetë, Leza e quante veten si një nga luf-tëtarët e vendosur për emancipimin e gruas. Në mble-dhjet që ishin bërë kohët e fundit për këtë gjë, ai kishte folur shumë herë. Por para dy javësh, atë e fyeu rëndë një plakë dhe ai nuk shkonte më në këto mble-dhje. Plaka ishte ngritur fill pas tij dhe kishte thë-në të nëntëdhjetënëntat për të. S'do mend, kishte thë-në ajo plakë, vagabondët si Leza këtë presin, të mos e marrë vesh qeni të zonë. Të harbojnë vajzat dhe ata të harbojnë me to. Këta janë si ujku që kërkon mje-gull.

Leza ecte udhës i mërzitur dhe prapë nisi të men-donte për Suzanën.

Kaluan disa ditë dhe nuk ndodhi asgjë. Myfiti e përshëndeste Lezën njëloj si më parë. Domethënë se ajo nuk i ka treguar, mendonte Leza gjithë gëzim sa herë që takonte Myfitin. Domethënë se unë pata të drejtë. Sigurisht pata të drejtë. Dhe s'ka se si të ndodhë ndryshe. Përderisa një grua vishet mirë, do të thotë se ajo grua pranon edhe letra dashurie. Dhe për-derisa pranon letra dashurie, pa i treguar burrit për to, do të thotë se pranon të bëjë edhe dashuri.

Leza ishte tërë qejf. Pa u menduar gjatë, ai i shkroi përséri Suzanës. Përséri nuk mori përgjigje prej saj. Dhe çdo gjë shkoi si më parë, me të vëtmin ndry-shim se, pas asaj dite, Suzana nuk u duk asgjékundi. Ajo nuk doli në punë dhe nuk erdhi as në mbledhje. Kjo gjë e shqetësoi pak Lezën, por ai u qetësua përséri kur takoi në rrugë Myfitin. Myfiti u tregua me të i përzemërt. Bile më i përzemërt se zakonisht.

Ato ditë fshati ishte i shqetësuar. Ekipi i prishjes së fejesave të mitura shkonte shtëpi më shtëpi. Tani,

kur i takonte në rrugë vajzat e ekipit, Leza ndalonte dhe bënte shaka me to.

Ishte e shtunë mbasdite. Leza doli nga vatra e kulturës, ku shkonte herë pas here të shfletonte revistat. Rrugës pa Myfitin bashkë me të vëllanë hipur mbi mushka.

— Njatjeta, Lezë, — i foli Myfiti.

— Njatjeta, — tha Leza, — për ku kështu?

— Na ka vdekë një kushëri në Laç. Po shkojmë sonte atje.

Leza vështroi një copë herë i menduar pluhurin që linin mushkat në udhë. Rruga midis plepave iu duk e bukur dhe njëkohësisht e trishtuar. Ai eci ngadalë nëpër të. Porsa kishin filluar të shkëputeshin nga degët fletët e para.

Nga mbrapa dëgjoi ca hapa të shpeshtë, të vegjël. Ktheu Kokën.

— Xhaxhi Leza, na këtë, — i tha një djalë i vogël duke i zgjatur një copë letër të palosur, — ma dha teto Suzana për ty.

Lezës i rrahu zemra ngadalë. E mori letrën dhe zemra i ngadalësoi akoma më shumë të rrahurat. E hapi. «Eja sonte në mesnatë. Burri ikën në Laç. Suzana».

Befas iu duk se e panë. Ktheu kokën. Pranë s'kishëtë asnjeri. Vetëm plepat e lartë bënin zhurmë me erën.

Mesnatë. Ishte i paaftë të mendonte asgjë. Trurin e kishte si të lodhur. Ç'quhet mesnatë? pyeti veten. Ora 12 ose ora 1. Në fakt është ora 12. Po sidoqoftë, mesnatë e vërtetë është ora 1.

Ora 1. Për një sekondë ai përfytyroi në mënyrë kaotike, si pamje të hedhura njëra mbi tjetrën, hapjen e portës, hyrjen në errësirë, këmishën e saj me dantella, gjithçka.

E pastër. Ai uli sytë mbi këmishën e tij. Duhet një këmishë tjeter, mendoi dhe u përmend papritur nga apatia. Futi dorën në xhep. Kishte 100 lekë. Dy-

qani i kooperativës akoma nuk ishte mbyllur. Leza pothuajse vrapoi.

— Një këmishë burrash, — i tha shitëses.

— Çfarë ngjyrë?

— Të bardhë.

Leza preku me dorë materialin e butë të këmi shës, ndërsa shitësja po i kthente kusurin.

— E grissht me shëndet, — i tha ajo.

— Çfarë? — pyeti papritur Leza, sikur u zgjua nga gjumi.

— E grissht me shëndet, — përsëriti vajza.

Ai i nguli sytë në mënyrë të pakuptueshme dhe iku pa thënë as falemnderit. Shitësja bëri një gjest me buzë sikur të thoshte «ç'blerës!»

Atë mbrëmje Leza u vërtit shumë herë rrëth e rrrotull fshatit. Më vonë, kur u mblodhën një nga një faktet, doli se asaj së shtune mbrëma Leza ishte takuar pothuaj nga dy-tri herë me të gjithë kooperativistët. Ai ecte kot udhëve dhe herë pas here kthente kokën nga shtëpia e veçuar e Myfitit. Shtëpia ishte krejtësisht e heshtur. Porta e jashtme e mbyllur. Oborri me pjergull i shkretë. Në rruginën dhe në urën e vogël prej druri binin fletë të vogla. Prapa asaj ure dhe porte ishte e fshehta e tij.

Leza nuk hëngri dot darkë. Natën ai u shtri si të gjithë dhe vuri duart nën zverk. Pinte cigare në errësirë dhe nuk mendonte asgjë të plotë. Mendimet e tij ishin copa-copa dhe të përgjysmuara.

Afër mesnatës, u ngrit me kujdes. Duke u mbajtur pas murit, u afrua te vendi ku ishte varur pushka e vëllait dhe e mori. Porta kërciti lehtë. Jashtë ndriçonte hëna. Ai kontrolloi fishekët dhe e vuri një në gojë të pushkës. Gardhiqet dhe rruginat dukeshin krejt ndryshe nën dritën e hënës së mesnatës. Ca fletë ndanë udhe shndrisnin si të lyera me flori. Tek ura e vogël prej druri ai eci duke përthyer gjunjët, që të mos dëgjoheshin hapat. Kaloi rruginën dhe qëndroi te porta. Porta ishte lënë e hapët. I hoqi siguresën dhe e

shtyu kanatin. Në oborr ishte errësirë nga pjergulla. Ai u afroa te dera e shtëpisë. Ktheu kokën pérreth. Heshtje e plotë. Trokiti fare lehtë. Nga brenda dëgjoi një zë të thellë, më tepër një psherëtimë.

— Ik, ik shpejt, more vesh?

— Ti vetë më ke thirrur, — zëri iu duk krejtësisht i huaj. Në atë çast, diku anash, nga muri, nga errësira gjëmoi një zë burri:

— Ku shkon?

Leza po atë sekondë, i shpejtë si një tigër, shtiu në atë drejtim, diku anash, nga muri, nga errësira.

Suzana prapa derës kafshonte duart. Ja, pra, fundi i atij ankthi të tmerrshëm. Një britmë. Një krismë pushke. Fill pas krismës një klithmë: «ah, më goditi». Për çudi, kjo nuk ishte klithma e Lezës, por e burrit të saj. Siç dukej Leza kishte shtirë i pari.

Në oborr shtinë përsëri. Suzana i bëri gishtat gjak. Ajo mezi qëndronë në këmbë. Kishte tri ditë pa gjumë dhe pa ngrënë. Tri ditë rresht ata ishin përpjekur ta detyronin t'i bënte një pusullë Lezës. Ajo nuk kishte pranuar. Myfiti e kishte rrahuur disa herë. «Po e mbron të dashurin, ë?» Ajo më kot ishte përpjekur t'u mbushte mendjen të shoqit dhe kunatit, se për pusullën e dytë të Lezës, që Myfiti ia kishte kapur fëmijës së vogël tek po e sillte, ajo nuk kishte asnë faj dhe se pusullën e parë (nga pusulla e dytë kuptohej që Leza kishte shkruar dhe një tjetër më pérpara) ajo nuk ia kishte treguar burrit, për të mos shkaktuar ndonjë sherr të kotë. Atyre nuk u qe mbushur mendja dhe fakti që ajo nuk e kishte treguar pusullën dhe aq më tepër që nuk kishte pranuar ta ftonte Lezën në shtëpi, i kishte shtuar dyshimet e tyre. «Një grua, që nuk tregon pusullën e dashurisë, e ka qejf dashurinë», thërriste nëpër shtëpi Myfiti me të vëllanë Bajramin. Më në fund, kur as kërcënimet, as rrahja nuk e detyruan dot Suzanën të shkruante pusullën, ata e

shkruan vetë, pa i thënë gjë asaj. Por ajo, nga përgatitjet e tyre, kuptoi çdo gjë. Kur pa se ata përhapën fjalë se do të shkonin në Laç, dhe nga ana tjetër, zunë pritë natën në oborr, ajo deshi të lajmëronte fshatin. Por ata e morën me të mirë, duke i thënë se nuk do t'i bën asnjë Lezës, vetëm do ta pështynin dhe do ta shanin, që tregohej i pandershëm dhe nuk respektonte miqësinë.

Suzana e kuptoi që e kishin gënjer. Në oborr dikush shtinte. Ajo hapi derën. Dikush shtinte duke ikur së prapthi. Me siguri Leza. Flaka e pushkës shndriti dy-tri herë në rruginë. Ndërkaq, vjehra ulërinte në oborr:

— Ah, ma goditën Myfitin. Korba, djali!

Në oborr u bë heshtje. Leza nuk po shtinte më. Diku anash dëgjoheshin zëra dhe hapa. Suzana vrapi te porta. Te rrugina dhe tek ura e drunjtë ndriçonte hëna.

Më në fund, ajo e pa Lezën. Këmisha e tij e bardhë ndrinte quditërisht nën hënë! Kishte rënë në gjunjë një hap para se të arrinte tek ura dhe po përkulej duke zgjatur duart përpara, sikur po bënte magji. Pushka i kishte rënë në tokë dhe po zgjatej më kot që ta arrinte. Duart e tij fërkonin pluhurin e udhës një pëllëmbë larg saj. Ndërkaq, vëllai i Myfitit doli nga prita dhe vrapi në rruginë. Leza ngriti sytë e ngrirë drejt njeriut që po afrohej dhe thirri me zë të ngjirur:

— Kam thyer gjunjët, mos më vritni.

Njeriu qëndroi. Ngriti pushkën dhe shtiu.

— Ah, — klithi Leza dhe koka i ra në pluhur. Rrugina me gardhiqet anash u anua dhe mbeti pezull, si e varur në erë. Drita e hënës, duke rënë mbi fletët, degët dhe gjembat e gardhit dukej sikur sajonte një dantellë të bardhë.

Ndërsa humbte ndjenjat, Lezën e shpoi si thikë për të fundit herë mendimi se ajo ishte vërtet një grua «e tillë», por që do, ai s'pati fat.

Ishite ora dy pasmesnate, kur tek ura e vogël prej druri, ku kishte rënë në një pozë të panatyrshme Leza, arriti makina e poliambulancës dhe një gaz i policisë.

Rreth e rrrotull vërtiteshin kooperativistët, burra, gra dhe tek-tuk fëmijë. Një anëtar i këshillit të fshatit, i hequr dhe me fytyrë të dëshpëruar, u thoshtë njerëzve të largoheshin.

Njëra nga vajzat e ekipit të prishjes së fejesave, ajo që kishte bërë disa herë shaka me Lezën, dënestë herë pas here. Të tjerat ishin bërë dyllë të verdha dhe qenë mbështjellë pas shokut të tyre. Ato nuk i hiqnin sytë nga trupi i Lezës i cili, nën dritat e forta të dy makinave, dukej akoma më i frikshëm me ato duar të zgjatura përpëra. Rrotull tij vërtiteshin mjeku dhe një polic.

— Skena të tillë, — murmuriti djali i ekipit, — kujt mund t'ia merrte mendja.

— Si ndodhi, vallë? A u sqarua? — pyeti njëra nga vajzat.

— Duket si e ngatërruar, — tha djali. — Po do të sqarohet. Kam frikë se kjo ngjarje do të na vësh-tirësojë punën.

— Pse? — pyetën vajzat me zë të dobët, por ai nuk u përgjigj.

Një polic po sillte te makina vëllanë e Myfitit. Ai përpiquej të mbahej krenar.

— Ec përpëra, — tha polici.

— Mos më shtyj, shoku polic. Unë mbrojta nderin, — tha ai.

Polici e shtyu përsëri.

— Mos shtyj. S'jam reaksionar. Mbrojta nderin e familjes.

— Të lumtë, Bajram — tha dikush nga turma. — Gjynah që e latë të gjallë atë bushtrën.

— Ah, ajo bushtra. Ajo bushtra i ka fajet të gjitha, — tha një plakë. — Sikur ta dinim. Që kur erdhë ajo në fshat, solli gjëmën me vete.

e verdhë dhe me sy të ngrirë vështronë gjithçka përreth.

— Ja, ajo, — u tha shoqeve njëra nga vajzat e ekipit.

Ato e vështronin si në ethe.

E futën Myfitin në makinën e ambulancës dhe po aty futën edhe Lezën.

— Ububu, dité e zezé, — ia bëri një grua plakë,  
— u vranë, u grinë për një copë femër.

Makina e ambulancës ndezi dritën e kuqe të urgjencës dhe u nis me shpejtësi në xhade. Gazi i policisë i ra pas.

1968

## BREZNIA E HANKONATËVE

### Kronikë familjare

#### I

Dy ditë përpara se Basri Hankoni të blente truallin ku do të ndërtonte shtëpinë, u bë gjyqi i tij me Jahja Toron për Arën e Mullenjave, siç quhej toka për të cilën ata kishin sherr të gjatë. Meqenëse nga tapitë e vjetra s'ishte e mundur të përcaktoheshin qartë kufijtë (një përrua, veç të tjerash, e kishte ngaterruar edhe më atë që kishte mbetur e pangaterruar prej tapive), gjyqi vendosi që çështja të zgjidhej me be. Sipas zakonit të vjetër, beja u bë në vend, pra në Arën e Mullenjave, në prani të kadiut të qytetit të Gjirokastrës, Abdulkadir efendiut, në mëngjesin e ditës së martë, 20 mars 1703. Basri Hankoni bëri be të rreme dhe e fitoi padinë. Ai, përpara se të vente kadiu me sekretarët e gjyqit, ngjeu shojet e këpucëve me baltë nga ara e vet, në kufi me Arën e Mullenjave, për të cilën bëhej sherri dhe, kur kadiu, që kishte qëndruar bashkë me sekretarët mu në mes të

Arës së Mullenjave, e ftoi të betohej mbi kuran, Basri Hankoni, pa ia bërë tër syri tha: «Beto hem mbi këtë kuran të shenjtë, se balta që është nën shojet e këpucëve të mia, është toka ime».

Dhe kështu, Ara e Mullenjave, tepër e vogël përnjë sherr kaq të gjatë, iu shtrua çifligut të vogël të Basriut. Kjo arë, si edhe vetë çifligjet e Basriut dhe të Jahja Toros dhe ngastrat e tjera përreth, kishte qenë timar i spahiut Sinan Bejogllu, dhënë me dekret mbretëror si shpërblim lufte, pas fushatës së Hungarisë. Sa ishte gjallë, timarliu Sinan ishte bërë i njohur në qytetin e Gjirokastrës për lëvizjet e shumta që pësonin një pjesë e tokave të timarit të tij. Dhe kjo ishte e kuptueshme, përderisa për çdo tapi të re spahiu fitonte taksën e tapisë, që ishte e barabartë me dhjetë pér qind të vlefshës së tokës. Dihej se në gjithë perandorinë e pafundme timarlinjtë e bënin një gjë të tillë, por ndoshta ishte e vështirë të gjeje një timarli si Sinan Bejogllui, që të kishte shkaktuar kaq shumë sherre me lëvizjet e pandërprrera të tokave të tij. Kaq e vërtetë ishte kjo, saqë pas vdekjes së tij, kur timari, po me dekret sulltanor, i kaloi spahiut shurdh Turhan, hero i luftës së Kërk-Kilisë, ishte pothuaj e pamundur të gjendeshin kufijtë e bashtinave dhe të çifligjeve të vogla, që gjendeshin brenda kufijve të timarit. Gjithçka ishte bërë lesh e li, saqë edhe kadilerët e Gjirokastrës, të dëgjuar në gjithë shtetin e madh osman për zotësinë e tyre, nuk qenë në gjendje të ftillonin punën. Tamam në këtë kohë Basri Hankoni përfitoi nga hutimi i përgjithshëm dhe ngriti gjyqin kundër fqinjëve të tij për Arën e Mullenjave, që e fitoi, siç dihet, me bë të rreme.

## II

Në të vërtetë asnjeri nuk e dinte se nga erdhi në qytetin e Gjirokastrës Basri Hankoni. Një mbiemër i tillë s'që dëgjuar kurrë më parë këtu. Disa thoshin se

ai zbriti nga Lunxhëria, të tjerë thoshin nga malet e Tepelenës. Po një gjë ishte e vërtetë: ky Hankon i parë nga diku zbriti dhe, duke zbritur ashtu si pérroi që sa vete trashet në fushë, edhe ai u trash me të arritur në Gjirokastër. Erdhi në fillim me ca thasë kripë, ngarkuar mbi një mushkë dhe kështu vazhdoi të vërtitej dy-tre vjet rresht. Shiste kripë nëpër stanet dimërore pranë qytetit, gjersa bleu një dyqan të vogël pranë Hanit të Vjetër. Fill pas kësaj, me fare pak të holla, bleu njërin krah të një shtëpie gjysmë të shembur në lagjen Palorto. E rregulloi njëfarësoj atë karakatinë, e cila një mëngjes u gdhi plot me zëra grash e kalamajsh. Ishte familja e tij, pér qenien e së cilës s'dinte asgjë askush dhe pér të cilën, ashtu si pér atë vetë, disa thoshin se zbriti nga Lunxhëria, disa nga malet e Tepelenës.

Katër vjet më vonë Basri Hankoni vendosi të bëhej çifçi, në timarin e Sinan Bejoglluit që ishte ngjitur me qytetin. Mori me tapi bashtinën e një të kristeri, në kufi me tokën e Jahja Toros, pér të zezën e këtij të fundit, dhe pér ca kohë, kras has punimit të tokës, vazhdoi të merej edhe me shitjen e kripës.

### III

Trualli që Basri Hankoni bleu pér ndërtimin e shtëpisë, fill pas fitimit të gjyqit, ishte i pjerrët, plot gurë të vegjël. Çdo njeri që e shikonte, pikëllëhej, por ai vetë ishte gjithë gëzim. Ja, mbi këtë pluhurishtë do të ngre një shtëpi me tri kate, thoshte ai. Shtëpinë e donte të madhe, me portë dyfishe, me bordume, me sterë, burg, me dhoma dimri, me dhomë të madhe të dasmave e kësolleve, me tri-katër oxhaqe etj.

Ai kujtoi se, duke i shtuar tokës së tij Arën e Mullenjave, do të ishte në gjëndje të përballonte shpenzimet e ndërtimit të shtëpisë, por nuk i doli ashtu. Njerëzit që e dinin punën e besë së rreme,

pëshpëritnin se Basri Hankoni s'do të bënte kurë prokopi me atë mall harram. Kurse ai vetë, që i ditnte të gjitha ç'pëshpëriteshin pér të, tundte kokën e thoshte: E di unë atë që po më merr shpirtin. S'është beja e rreme, jo, po tjetër gjë. Dhe kjo gjë ishte xhezaja. Basri Hankoni ishte musliman dhe, sipas Sheriatit, ishte i përjashtuar nga taksa e tokës, mirëpo e keqja ishte se toka e tij kishte qenë dikur e një të krishteri, pra ajo kishte qenë tokë me xheza. Sipas ligjeve, edhe kur toka ndërronte zot, taksa e dikurshme i mbetej si një mallkim. Dhe kjo taksë sa vinte rritej. Jo më kot shumë njerëz e përdornin fjalën xheza me kuptimin e fjalës mynxyrë, pa e ditur se ajo ishte thjesht fjala «taksë» e administratës shtetore.

Në të vërtetë Basri Hankoni do të ishte rrënuar krejt, në qoftë se nuk do të merrte Arën e Mullenjave. Megjithëse ishte sa një e treta e tokës së tij të mëparshme, ajo e mbajti gjallë, sepse ishte tokë pa xheza. Toka ime ma mori shpirtin, thoshte Basri, një njerkë na mban gjallë.

#### IV

Themelet e shtëpisë së Basri Hankonit mbetenë të hapura pér dy vjet rresht. Prej tyre dilnin herë pas here minj dhe akrepa. Le të dalin, thoshte ai. Të dalë e keqja.

Herë në dyqan, herë në çiflig ai punonte si një ka. Po xhezaja u ngrit përsëri në vitin 1709, dhe ai s'po i mblidhët dot paratë e ndërtimit. Nga një llogari që bëri, i doli se nga kripa fitonte diçka më shumë se nga toka dhe pér dy vjet rresht me përjashtim të Arës së Mullenjave që vazhdonte ta mbillte, pjesën tjetër të çifligut e braktisi. Spahiu Turhan ishte vërtetë shurdh, por merrte vesh çdo gjë dhe ligjet i dinte mirë. Vitin e tretë, në bázë të ligjit që ndalonte lénien djerr të tokës, ai i mori tapinë Basri

Hankonit, me përjashtim të Arës së Mullenjave, dhe ia dha një të krishteri nga lagjja Varosh. Kështu që çifligu u kthyesh përapë në bashtinë, dhe Basri Hankoni mbeti vetëm me Arën e Mullenjave.

Për çudi, içliruar nga barra e çifligut dhe vetëm me atë arë të vogël, që ishte e mbarë veç të tjerash, sepse ishte ndanë xhadesë së madhe, Basri Hankoni u mëkëmb përsëri.

## V

Ndërtimi i shtëpisë rifilloi në muajin prill. U pastruan themelet, u gërmua vendi i sterës dhe i kubeve të poshtme. Kurbani në themele u bë më 28 prill. Një dash i zi me dy palë brirë. Vjeshta i gjeti muret të dala nga dheu. Ai vit qe i mbarë për Basri Hankonin. Kriporet e mëdha të veriut, që ishin pronë e Valide Sulltanës, iu dhanë si sipërmarrje pashait të Beratit. Ky e zgjeroi shitjen e kripës në gjithë këtë pjesë të shtetit. Basri Hankoni fitoi pâre me grushte. Nuk vente pothuajse fare në Arën e Mullenjave. Dërgonte djemtë. Vetë merrej vetëm me kripën. S'ndahem dot nga ky hidhërim, thoshte gjysmë me shaka. Mushkat e tij çonin tanë kripën jo vetëm në stanet dimërore përreth Gjirokastrës, po gjer në Sarandë, bille nganjëherë edhe më larg, gjer në Janinë.

## VI

Ndërtimi i shtëpisë vazhdoi gjashtë vjet. Basri Hankoni shkonte ditë për ditë për të parë ustallarët. Qe trashur, mezi ecte. Megjithatë mbikëqyrte një përnjë qdo gjë: trarët, cilësinë e gëlqeres, rr拉斯at prej guri me të cilat do të mbulohej çatia, pragjet e dyerive.

Vitin e katërt ra kolera në Gjirokastër. Punimet u ndërprenë përmuaj me radhë. Nga shkaku i kolekës çmimi i gëlqeres u rrit katërfish. Çdo gjë spër-

katej me tē. Basri Hankoni priti sa ra përséri çmimi i gëlqeres pér tē vazhduar punimet.

Vitin e gjashtë u hodh çatia, u vendosën hekurat e dritareve, mokrat e gurta pér bluarjen e gru-rit, ullukët pér mbushjen e sterës me ujë, hambarët e zahiresë, porta e madhe me trarin-katara, që i vi-hej natën tejpërtej. Askush nuk i pa se si ata hynë në shtëpinë e re, ashtu siç nuk i kishin parë kur kishin zbritur nga Lunxhëria apo nga malet e Tepele-nës. Një mëngjes tē vjeshtës së dytë tē katër oxha-qet e shtëpisë së madhe lëshuan tym. U ndez zjarri te Hankonatët, thanë fqinjët afér e larg. Ishte hera e parë që i quanin më në fund Hankonatë.

## VII

Zahiretë e dimrit tē parë: djath 112 okë. Gjalpë 11 okë. Grurë 14 kv. Misër 2 kv. Vaj ulliri 6 teneqe. Ullinj 2 fuçi. Sheqer 2 kv. Trahaná 60 okë. Pastëрма 140 okë. Turshi 1 fuçi. Petëra, osa, fasule, bollgur 55 okë.

## VIII

Stera u mbush me ujë gjatë natës së parë tē dhjetorit. Shira kishin rënë edhe më parë, por ato kishin qenë me bubullima dhe vetëtima, dhe Hankonatët, si-pas zakonit tē vjetër, nuk kishin dashur që stera tē mbushej pér herë tē parë me ujë tē tillë plot shqetësim. Ata priten një shi tē shtruar, tē qetë dhe vetëm natën e parë tē dhjetorit, kur nisi vërtet një shi i tillë, ata bashkuan qyngjin mbushës tē sterës me ullukun kryesor, duke u lutur që jeta e breznive tē tyre tē rriddhite këndej e tutje shtruar e pa rrebesh, si ai shi.

## IX

Dhjetë vjetët e parë pas mbarimit të shtëpisë u martuan të pesë djemtë dhe vajza e vetme e Hankonatëve. Basri Hankoni vdiq fill pas dasmës së djaltë tretë. Ishte një dimër i ftohtë, me luftë. Lufta bëhej larg, në kufijtë veriorë të shtetit, dhe asnje nuk e dinte me siguri se ku pikërisht. Një pjesë e timarlinjve që u nisën në të, nuk u kthyen. Basri Hankoni u varros në varresat e vjetra muslimane. I vunë dy gurë, si të gjithëve, një te koça, një te këmbët, për t'i treguar se, sado që u rropat, u zgjat e u vërsul herë andej, herë këndej, si një tigër, vendi i tij në këtë botë s'ishte më i madh se ajo largësi toke midis dy gurëve.

Një javë pas tij vdiq nëna e tij plakë, dhe po atë dimër të dyja nuset e djemve të mëdhenj lindën djem. E veja e Basriut, Sabekua, ishte e sëmurë, dhe gjëzimet, në vend që ta qetësonin, e keqësonin më tepër. E panë shumë doktorë; njëri prej tyre kishte ardhur që nga Sofja, por nuk ia kuptuan dot sëmundjen. Thoshte se shikonte ëndrra të këqija. Kur njëri nga mjejkët i tha t'ia tregonte ëndrrat, ajo u përpoq sa u përpoq, por nuk i tha, veçse ca gjëra pa kuptim. E vëtmja gjë që pak a shumë merrej vesh, ishte ëndrra ku ajo shihte këpucët. E ngjyera me baltë të Basriut. Kuptohet që mjeku, i cili nuk e dinte historinë e besë së rreme, nuk mori vesh asgjë.

## X

Pas vdekjes së babait Hankonatët e rinj iu përveshën punës për zgjerimin e mallit. Atë mot doli rregullorja e re e shitjes së kripës, ku taksa e saj, nga një akçe për tri barrë kripë, që ishte, u rrit në një akçe e gjysmë. Kjo i mërziti në fillim ata, bile njëherë menduan ta braktisin dyqanin e kripës, por kujtuan amanetin e babait që, sidomos që të vinte puna, nga kri-

pa të mos ndaheshin dhe ashtu bënë. Arën e Mullenjave vazhduan ta punonin.

Bashkë me taksën e kripës u ra dhe një fatkeqësi, tjetër: motra e vetime u kthye nga burri. Bënë çmos që ta defyronin familjen e burrit ta merrte prapë, por ata s'u dhanë që s'u dhanë. Ca thoshin se mëria kishte lindur për shkak të pajës, të tjerë pëshpëritnin gjëra të tjera. Atëherë vëllezërit u përpoqën ta martonin rishtazi motrën, si pér inat të tyre. Por kjo s'ishte e lehtë. Familjet e vjetra të Gjirokastrës i shikonin me mosbesim këta të ardhur, që nguteshin pér qdo gjë. S'ishin mësuar kurrsesi me këtë ngutje. Allahu i kishte dhënë ecjes së ditëve një shpejtësi të caktuar, kurse këta Hankonatët dukej sikur donin ta ndryshonin atë shpejtësi. Kjo gjë s'i pëlqente kurrkujt. Bile i trembte pak.

Kthimi i vajzës nga burri e rrëzoi fare shëndetligën, nënën plakë. Më në fund, kadiu Abdulkadir, vejani shtatëdhjetedyvjeçar, që kishte bërë dikur gjyqin e Arës së Mullenjave, e kënkoi pér grua të kthyerën. Ia dhanë menjëherë. Kadiu ishte i ditur; librat në shtëpinë e tij zinin po aq vend, sa gjysma e zahireve te Hankonatët. Të gjithë u gjuan, por nënën plakë, Sabekon, gjëzimi, si zakonisht, e rrëzoi akoma më tepër se hidhërimi. E panë prapë njëri pas tjetrit mjekë të ardhur që nga Alaxhehisari, por s'ia gjetën dot sémundjën. E yshtën prapë te plaka Kadëne, i dhanë të pinte hashash, të hante mish iriqi, të pinte paparuna të ziera, por plaka s'u përmirësua. Në endërr shihte vazhdimisht këpucët e Basriut. Ecin, thoshte, ikin larg dhe s'i arrij dot.

Një nga mjekët tha se ato këpucë, në qoftë se kishte vërtet një palë këpucë të tillë, duhej të zhdukeshin nga faqja e dheut, pér të mos e tronditit të sëmurën. I kërkuan nëpër të gjitha skutat e shtëpisë së madhe, por nuk i gjetën dot. Siç duket, vejusha plakë i kishte fshehur.

Bashkë me valiun e ri erdhi dimër i madh. Tra-  
rët e çative kërcisinin si të gjallë nga ngrica. Valiun  
e parë thanë se e internuan në Kërk-Kilis. Shkaku  
s'dihej. Disa thoshin ngaqë ishte sjellë shumë i egër,  
të tjerë thoshin të kundërtën: ngaqë ishte sjellë shu-  
më i butë.

Valiu i ri meremetoi xhadenë e Janinës. Gjithë  
karvanarët u gjuan. Hankonatët blenë dy mushka të  
tjera përmbartjen e kripës. Po atë mot më i madhi  
i djemve, Hatibi, u nda nga vëllezërit. Nuk ndërtoi  
shtëpi të re, por ngriti një qoshk në krahun pérëndimor  
të shtëpisë, që edhe pa atë shtesë ishte e madhe.  
Nuk plasi ndonjë sherr përmdarjen e plackës, por më  
mirë do të që sherri, sesa ajo mëri e shurdhër, që  
mbushi muaj me radhë shtëpinë që poshtë nga stera,  
ku mbushej uji me kova e gjer lart, në dhomën e ka-  
fesë. Kjo e rrënoi fare edhe atë pak shëndet që i kishte  
mbetur vejushës plakë. U mbyll në dhomën e  
saj e s'dilte që s'dilte. Këtë herë s'pranonte as mje-  
këf. Atëherë, përm ta qetësuar, i thanë se vëllezërit u  
bashkuan prapë. Por kjo, siç dihej, e keqësoi më shumë.  
Vdiq në krye të tri ditëve. E lanë sipas zakonit.  
Thirrën vajtojcat përm ta qarë, ngaqë nuset s'dinin akoma  
të qanin siç duhej, dhe e varrosën përbri varrit  
të vjehrrës, të të shoqit dhe të një Hankonati të vogël,  
një foshnjë e djalit të dytë, që kishte vdekur një  
vit më parë, pa mbushur motin. Binte dëborë aq e  
dendur, saqë mezi i gjetën varret.

Tani Hankonatët kishin katër të vdekur në Vasilikua,  
siç quhej varreza e qytetit përm shkak të luleve  
me këtë emër, që kishin mbirë rrëth e rrotull kan-  
gjellave të saj. Por ato katër varre ishin akoma pak  
që ata të quheshin vendës.

## XII

Pas vdekjes së plakës Sabeko vellezërit u ndanë. Vetëm Arën e Mullenjave dhe dyqanin e kripës, i mbajtën të përbashkëta, si ortakë. Kjo bëri që edhe sherri, që u mahis pér një kohë të gjatë, të mos plaste asnjëherë. Dhëndri i tyre plak, kadiu Abdulkadir, bëri që gjithçka të zgjidhej urtë e butë, pa sherr.

Shtëpia u zmadhua edhe më. Në krahun verior ndërtuan nga dy dhoma secili nga dy vellezërit më të vegjël. Tani kalamajtë, që ishin rreth njëzet, humbisnin shpesh nëpër hajatet e ngrysura të shtëpisë.

Abdulkadiri vdiq me të rregulluar punët e kunteurve të tij. Kështu që motra Shano mbeti e ve. E kërkoi një ushtarak. Vellezërit u mblodhën, e pleqëruan punën dhe ia dhanë. Pak kohë më pas ai u nis pér në luftë me ushtrinë që shkoi pér të shtypur një rebelim në Shqipërinë Veriore. Thoshin se posta në ato anë s'punonte kurrë.

## XIII

Erdhi nga kryeqendra e sanxhakut urdhëresa e re me rregulloret e reja pér ziftin, vajgurin, kripën, matjen e mëndafshit si dhe pér peshoret. Erdhën gjithashtu taksat e reja të tregut. Pér çdo barrë ngarkese (fruta, oriz, mjaltë, gjalpë, djathë), 2 akçe. Nga qerrja e druve, dy dru. Nga barra e druve, një dru. E njëta gjë pér qerestenë. Pér katër berra të therrur, 1 akçe. Pér një kalë të shitur, nga blerësi e nga shitësi; vec e vec, nga 2 akçe. Taksa e vendit pér shitje në treg, pér gratë 1 akçe, pér burrat 2.

## XIV

Bashkë me dekoratat erdhi lajmi i vrasjes në luf-  
të të burrit të tretë të motrës Shano. U bë kësoll i

madh. Shanoja e mbajti zinë një mot. Në mars u martua përsëri. Këtë herë me një nëpunës dogane. Dy nga vëllezërit, i dyti dhe i fundit, s'deshën. S'dihet pse. E djegur siç qe për fëmijë ajo për herë të parë në jetë mbeti më në fund me barrë, me burrin e katërt. Polli një vajzë.

Në shtëpinë e Hankonatëve kishin lindur ndërkaq një dyzinë tjetër fëmijë. Kurse dyqani i kripës kishte mbetur po ai. Vetëm se i kishin shtuar një hajat nga ana e prapme, ku mund të ngarkoheshin mushkat.

## XV

Dekreti mbretëror për dhënien në sipërmarrje të kriporeve vonoi në vitin 1729. Shkaqet s'u morën vesh. Më në fund erdhi aty nga fundi i prillit. Më 8 maj, sipas zakonit, filloi puna në kriporet, por vonesa e dekretit i ngadalësoi mjaft karvanet e kripës. Fitimet ranë gjysmë për gjysmë. Hänkonatët nuk hodhën dot as gjysmën e zahiresë. Sikur të mos mjaftonte kjo, vdiq nga sëmundja që quhej «iriqi i zi», nusja e vëllait më të vogël. Ishte më e bëkura e të pesë nusseve të Hankonatëve. Mjekët e prenë me thikë dy herë. I hoqën në fillim gjysmën e gjirit të majtë, pastaj krejt gjirin, por kjo sikur e tërboi, edhe më keq «iriqin e zi.» Vdiq, e shkreta, në fund të vjeshtës së parë. Me shumë mundime. E varrosën pranë vjehrrit e vjehrrës.

Zija sikur i afroi prapë vëllezërit. U rrropatën si asnjëherë tjetër për të mbushur boshillëqet e kripës. Ara e Mullenjave, e mbarë si pérherë, dha misër të mirë. U duk se po e kâpërcenin njëfarsoj kohën e zisë ekonomike, kur ndodhi një e papritur tjetër: vëllai i tretë, Bardhushi, tha se do të shkonte për haxhillëk në Mekë. U përpinqën t'ia kthenin mendjen; s'qe punë që bëhej. Ra zija në shtëpi. Nusja e tij më gjithë fëmijët qanin ditë e natë. Po ai s'luate nga e tija.

Thoshin se një hoxhë, me të cilin rrinte shpesh kohët e fundit, ia kishte mbushur mendjen. U nis në mbarim të vjeshtës së tretë, në një ditë me erë, fill i vjetëm, nëpër xhadënë e Janinës.

## XVI

Vdiq sulltani. Shteti i gjithë ra në zi, që nga viset ku zjaja tregohet me petka të bardha e gjer këtu, ku ajo tregohet me petka të zeza. Emri i sultanit të ri erdhi shumë më vonë. U pëshpërit për një grusht shteti që desh plasi në kryeqytet dhe që veziri i madh e zbuloi në minutën e fundit.

Nga Bardhushi asnjë lajm. Burri i Shanos ra në burg për shpërdorime në doganë. E dënuan me njëqind e një. S'kishte shpresë të dilte i gjallë nga burgu. Shanoja u kthyë te vëllezërit bashkë me vajzën. Qëndroi aty tre muaj. Në krye të muajit të pestë e martuan për të pestën herë. Këtë herë burrin e mori më të vogël se veten. Për të vendosur përfundimisht, priten sa të kthehej vëllai i vogël, Kaskapani, nga Janina, ku kishte shkuar me karvanin e kripës. Kohët e fundit e çonin nëpër udhëtime, për të harruar mérzinë e vdekjes së gruas. Ai u kthy, por ishte krejt i hutuar. Ishte gati të thoshte «po» për çdo gjë, kështu që kuptohet ç'tha për martesën e së motrës. Për vete s'donte që s'donte të martohej. Thoshin se atje në Janinë kishte rënë në dashuri me një vajzë të re. Ai s'tregonte as gjë, por ata që i dinin shenjat e dashurisë, bënin be e rrufe se ishte dashuri dhe asgjë tjetër. Gjer tanë në qytetin tonë s'kishte pasur ndonjë rast dashurie. Mbaheshin mend katër rënje murtaje, shtatë kolera, pesë tërmete, por për dashuri as pleqtë s'dinin gjë dhe as kishin dëgjuar nga prindërit e tyre dhe këta nga të tyret e kështu me radhë.

## XVII

Vëllai i madh, Hatibi, u trash si i ati, kur iu afrua pleqëria. Ishte i ngrysur si ai dhe i bënte zap vëllezërit

e tjerë. Në dyqan dilte rrallë, por fjalë e tij s'bëhej dysh. Vëllai i dylë, Muqerremi, që e zëvendësonët në krye të punës, s'i ngjante fare nga pamja. Ishte i gjatë dhe flokëkuq, por edhe ai fjalët i kishte të pakta. Rinte gjithë ditën në dyqan, kurse me Arën e Mullenjave merrej kryesishë vëllai i katërt, Didini. Në kohën e të mbjellave, kur kishin mjaft punë me kripën dhe s'e ndihmonin dot Didinin, pajtonin një rrogëtar për një ose dy muaj.

Dyqanin e meremetuan dhe e zgjeruan pas motit të zisë. Përveç depos, ngjitur me të, hapën një banak tjetër. Çatinë ia hodhën të re. Veç kësaj, te hyrja vunë një tabë, ku ishte shkruar. «Hankonatë: skitje kripe me shumicë».

## XVIII

Vdiq Hatibi papritur. Një mëngjes me ngricë, nga qoshku perëndimor i shtëpisë u dëgjuan ulërimat e gruas së tij. Kishte vdekur gjatë natës pa u ndier fare. Kur e shoqja kishte dashur ta përmendte për të pirë kafenë e mëngjesit, kishte kohë që ai ishte ftohur krejt:

Kësollë u bë i madh. Erdhën edhe ata që dukej se s'do t'i sajdisnin kurrë Hankonatët. Siç ndodhë përherë me të ardhurit, vdekja ishte ajo që i afronte shkallë-shkallë më vendësit e mirëfilltë. Bashkë me Hatibin, Hankonatët kishin tanë në varrezat e qytetit nëntë varre (gjashtë të mëdhenj dhe tri varre foshnjash). S'ishin pak, por s'mund të thoshe se ishin shumë.

Dy javë pas vdekjes së Hatibit u mblodhën vëllezërit bashkë me Shanon në këshill dhe vendosën që, sipas zakonit, vëllai i vogël Kaskapani, të merrte për grua vejueshën e Hatabit. Thanë se ai s'donte që s'donte. Ajo gjithashu, po atë s'e pyeste kush. U hapën fjalë se ai që grindur tërë natën me vëllezërit, kishte qarë, kishte dashur të mbytej në sterë, por ata s'hoqën që s'hoqën dorë. Ajo natë në shtëpinë e Hankonatëve mbeti gojë më gojë. Dritat herë ndizeshin në qoshkun e perëndimit, herë në patet, he-

rë në anën veriore, ku kishin dhomat vëllezërit më të vegjël. Se si arritën tia mbushnin mendjen, allahu e di. Thonë se në fund ai kishte thënë: nusja ime e zezë me Hatibin përbri në varre, unë me nusen e tij në shtrat. Çështë ky fat kështu!

Gjithë atë javë pastaj ra një shtruar, që s'pu-shoi as ditën as natën. Tamam pas nëntë muajsh, sikur të kishte mbetur me barrë me dëshpërimin nën atë shi të shtruar, vejusha lindi një vajzë. E quajtën Roksanë, emëri i çuditshëm ky, i panjohur e i padëgjuar kurrë në këto anë. U pëshpërit se kështu quhej vajza me të cilën kishte rënë në dashuri Kaskapani, andej nga Janina.

## XIX

Erdhi ferman i lartë nga Stambolli për ndalimin e copëzimit të tokave të timareve. U rishikuan midis të tjerash një nga një tapitë e tokave të lëvizura të timarit të vjetër të Sinan Bejoglluit dhe, ashtu si herët e tjera, kadi-lérët u ngatërruan keq në to. Hapën gjithfarë librash e rregulloresh, por, sa më shumë që i hapnin ato, aq më tepër gjykimi u mjegullohej. Atëherë bënë si herët e tjera, i mbyllën të gjitha dhe i lanë punët ashtu siç ishin. Ndërkaj pesë gjyqe vazhdonin qysh prej njëzet e ca vjetësh dhe, siç dukej, s'kishin hije për të mbaruar. Sa për Arën e Mullenjave të Hankonatëve, ajo qëndronte jashtë sherrit.

Taksat e kripës u rritën përsëri. Veç kësaj, udhët ku lëviznin karvanet u bënë të pasigurta. Hankonatët i kalaun dy dimra shtrënguar. Hambarët e zahiresë ishin gjysmë, të boshatisur. Nga Bardhushi asnë lajm.

Ndërkaj u fejuan dy djemtë e Hatibit. Djali i tretë, që e kishin quajtur Basri për kujtim të gjyshit, ishte shëndetlig. E fejuan dhe vajzën e madhe të Muqerremit, në Dunavatin e sipërm. Vajza e Hatibit, Hatoja, ishte tepër e shëmtuar dhe nuk e kërkonte njeri. Fëmijët e djemve të tjerë ishin akoma të mitur. Sa për Shanon, ajo s'bëri

më fëmijë as me burrin e fundit. Pesë burra dhe mëz lindi një vajzë të vetme. Qëlloi barkngushtë. Pas vdekjes së burrit të pestë as u kthyte te vëllezërit, as u martua më. I hyri qejfi i gjyqeve. Në të vërtetë kishte gjyqe për ndonja njëqind vjet, duke filluar nga ngatërresat për pjesën që i përkiste nga shtëpia e burrit të dytë, Abdulkadirit, e gjer te testamenti i burrit të fundit, që ishte kundërshtuar prej fisit të tij. Herë fitonte, hërë humbiste, por sidooftë drejtonte goxha mall e gjë. Flitej se vajza e saj, Selma, qe e shëmtuar, si kushërrira e saj, Hatoja, por ajo ishte vajzë e vetme dhe kishin nisur ta kërkoni përgrua. Shanoja nuk ngutej.

## XX

Një e keqe e madhe ra mbi Hankonatët në çerekun e fundit të shekullit. Plasi lufta midis pashallëkut të Shkodrës dhe të Beratit për kriporet e veriut. As dekretet e sulltanit, as vezirët që u dërguan njëri pas tjetrit, nuk i pajtuan dot pashallarët e egërsuar. Më në fund Bushatllinjtë e Shkodrës pushtuan me forcë kriporet dhe u bënë sipërmarrës të tyre. Kështu që të gjithë karvanët e jugut u ndaluan. Hankonatët ranë në të zeza. Në fillim u fol se Valide Sultana do t'i ndëshkonte Bushatllinjtë dhe do të hapte prapë rrugët për në kriporet, por kjo s'doli e vërtetë. Ato u mbyllën. Kripa filloi të vinte tani që nga stepat e Karabogdanit. E sillnin karvanë ermenësh, që ishin më dinakë se cifutët, dhe që as pranuan të bisedonin për ndonjë marrëveshje me Hankonatët.

Dyqani i Hankonatëve u mbylli. Pritej rrënim i tyre me muaj e me javë. Ara e Mullenjave, sado e mbarë të ishte, s'i mbante dot. As ndihmat dhe borxhet që morën nga Shanoja, s'i nxorën dot nga halli. Shtëpia e madhe sikur ra në zi. Edhe kovat dukej sikur s'tringëllinin më. Hambarët e zahiresë ishin gjysmë të boshatisur. Binte miu e thyente kokën, sic thotë fjala e vjetër. U rrënuan Hankonatët, thoshin njerëzit, kaq e patën.

Por ata u mbajtën. I shpëtoi një gjë, që s'ia priste mendja askujt: vajguri. Thuhej se Kaskapanit i ra ndër mend të parit një gjë e tillë. Iu kujtua nga udhëtimet e tij me karvanët e kripës. Një mëngjes prilli u nisën të tre vëllezërit hipur mbi mushka, pa i thënë kujt se ku shkonin. Ditë të tëra munguan. Kur u kthyen, ishin të gëzuar! Nga shitës kripe qenë bërë shitës vajguri. Shtëpia e madhe u mbush prapë me zhurma.

Dyqanit i bënë ca meremetime të shpejta. Vendet e mbajtjes së kripës u prishën dhe atje u vendosën ca fuçi të mëdha, kapakët e hekurt të së cilave hapeshin me kërkëllimë. Peshoren e madhe që s'duhej më, e shitën. Tani në truallin rreth e rrotull dyqanit nuk zbardhnin më kokrrizat e kripës, por ca njolla të zeza, që herë dukeshin ngjyrë jargavani të errët, herë bojë ulliri. Nganjëherë s'dukeshin as ashtu as kështu, por kishin një shkëlqim të frikshëm, si prej botës tjetër; sidomos nën dritën e hënës.

Edhe tabelën te hyrja e dyqanit e ndërruan. Në vend të tabelës së vjetër, të ndryshkur nga koha, vunë një tabelë të re: «Hankonatë: Shitje vajguri me pakicë dhe me shumicë». Kuptohet se dyqanxhiu Caci, që ishte i vetmi shitës vajguri në Gjirokastër qysh prej kohëve që s'mbaheshin mend, u dëshpërua shumë. Por s'kishte ç'të bënte.

Tani Hankonatët filluan të mbanin erë vajguri. Dhe jo vetëm burrat, dhe djemtë që punonin në dyqan, por edhe shtëpia e tyre, kalamajtë, madje edhe nuset e tyre, që nuk dilnin kurrë përjashta.

## XXI

Erdhën taksat e reja nga kryeqyteti, por taksa e vajgurit nuk u ngrit. Mbarësia kishte hyrë në shtëpinë e Hankonatëve. Brenda vitit u bënë tri dasma njëra pas tjetrës. U martua vajza e madhe e Muqerremit si edhe të dy djemtë e Hatibit. Dasmat e djemve u bënë të mëdha dhe, si për të treguar se tani ata ishin mjeshtrit e vajgurit, nde-

zën aq shumë flakadaj, saqë gjithë rruga, prej Pazarit të vjetër, prej nga ishin nuset, e gjer në Hazmurat, u bë si ditë. U plagos me plumb në gosti, fare rastësish, vëllai i katërt, Didini.

Sa për vajzën e Muquerremit, ajo, ashtu si hallë Shanoja dikur, u martua me një ushtarak. Që të nesërmë e dasmës ai e mori me vete dhe iku me të në Pashaliman, ku shërbente prej vitesh, në garnizonin e bazës detare.

Me gjithë shpenzimet e dasmave, mirëqenia e Hankonatëve sa vente rritej. Ndryshe nga kripa, sasia e shitjes të së cilës dihej pothuajse çdo vit me saktësi, vajguri kishte brenda plot të papritura. Njerëzit, përvèç llambave të zakanshme të ndriçimit, gjithmonë e më tepër blinin llamba të mëdha, llambadhe, siç quheshin, për raste festash. Ato harxhonin shumë më tepër vajguri se llambat e zakanshme. Një llambadhe e tillë e një shtëpie të madhe harxhonte vajguri, pér një natë, sa harxhonin pér gjysmë viti idaretë e vogla (siç quheshin kandilat me vajguri) në shtëpitë e varfra. Veç kësaj; pas dasmave të djemve të Hatabit, shtëpitë e mëdha u duk sikur vunë inat me njëratjetren kush të ndizte sa më shumë flakadaj në dasma. Kështu që herë pas here qyteti bëhej ditë nga *mashallatë* (siç i quanin flakadajtë). Të zgjuar Hankonatët, thoshte imami Ali. I përdorën dasmat e djemve pér të bërë të njo-hur mallin e tyre.

## XXII

Edhe motrës Shano punët i venin mbroth. Nga gjithë ai lesharap gjyqesh herë fitonte një gjysmë shtëpie në një vend, herë humbiste një hamam në një vend tjeter. Por më shumë fitonte, se humbte. S'kishte asnjë shtëpi të vetën, por copa-copa. Kështu që ishte në të gjitha e s'ishte asgjékund. Kohët e fundit filloi të lëshonte me qira dhoma, bile dhe çerekë apo gjysma shtëpish. Ndoshta ishte i pari njeri në qytet që lëshonte shtëpi me qira. Vajzën, e saj, Selmanë, e kërkonin vazhdimisht pér grua. Por Shanoja

s'ngutej. Jam martuar pesë herë unë, thoshte, i di mirë këto gjëra. Pastaj, një dasmë kam përpara. Sa më vonë që ta bëj, aq më shumë do të më ndritë pleqerinë.

Si për të prishur syrin e keq, viti u mylli me një hidhërim. Vdiq vëllai i katërt, Didimi. Ishte më i qeti nga gjithë Hankonatët. Dhe ishte një çudi që pikërisht ai u plagos në dasmë. Pa atë plagë, do të jetonte gjatë. Se ishte vërtet shumë i qetë, jo vetëm midis Hankonatëve por midis të gjithëve. Në ethet e kripës e të vajgurit nuk u përzie fare. I kishin lënë të mbikëqyrte Arën e Mullenjave dhe me atë u mor ditë e natë, gjersa dha shpirt.

### **XXIII**

Pas vdekjes së Didinit u bënë ca zhvendosje brenda-përbrenda shtëpisë. Vejusha e tij, si edhe gruaja e Bardhushit të ikur në haxhillëk, u mblohdhën së bashku me fëmijël në krahu perëndimor, në dhomat ku më parë banonte Hatibi me të vetët, kurse Kaskapani zuri pothuajse krejt qoshkun e veriut. Vëllai i dytë, Muqerremi, mbeti aty ku ishte, kurse dhomat e dimrit që u çiruan nga zhvendosja, i morën djemtë e porsamartuar të Hatibit, nga një seclili. Për shkak të vejushës dhe të kalamajve të Didinit si dhetë fëmijëve dhe nuses së Bardhushit, që ishte po aq vejushë sa kunata, në mos më keq, se e mundonte pritja, krahu perëndimor i shtëpisë filloi të quhej qysh atëherë «Qoshku i jetimëve», emër ky që të zotët e shtëpisë u përpochen më kot t'ia hiqnin.

### **XXIV**

Të ardhurat e Hankonatëve shtoheshin çdo stinë. Vajguri s'ishte si gruri apo pambuku; bënte shi apo diell, vapë apo ngricë, ai buronte njëlloj. Dhe natë dhe terr kishte dhe do të kishte përherë dhe s'kishte asnje frikë se

ato mund tē mbaronin, këshlu që njerëzit do tē kërkonin pérherë vajguri pér ndriçim.

Mirëqenia e Hankonatëve qe rritur si asnjëherë tjetër. Zahiretë pér dimrin e vitit 1789 e tregonin më së miri këtë. Djathë 6 fuçi tē mëdha. Gjalpë 40 okë. Grurë 12 kv. Vaj ulliri 12 teneqe. Ullinj 4 fuçi. Sheqer 5 kv. Trahana 60 okë. Pastërmà 500 okë. Arra, bajame, lajthi 4 kv. Mjaltë 2 teneqe. Hurma hindi, rrush tē thatë Greqie, fëstëkë 3 kv. Petéra, osa, fasule, bollgur 130 okë.

## XXV

Valiu u ndërrua në fund tē vitit. E thirrën pér në kryeqytét dhe s'dihet ç'u bë me tē. Disa thanë se e interiuani, tē tjerë thanë tē kundërtën: i dhanë një post më tē lartë.

Valiu i ri erdhi në fillim tē marsit. Një nga rojat e tij solli, me sa duket, lajmin se sultanit tē gjermanëve i kishin prerë kokën atë vit, pér shkaqe që nuk diheshtin. Pranvera qe e ftohtë kallkan. Nga ca tregtarë që udhëtonin pér në Qipro, u mor vesh se jo sultanit tē gjermanëve, po sultanit frëng i kishin prerë kokën. Por edhe atyre pak mund t'u besohej. Pritej tē kalonte ndonjë tjetër e tē thoshte se s'i kishin prerë kokën sultanit tē Francës por atij tē Spanjës. Por një gjë ishte e vërtetë: diku, në vendin e madh që quhet Evropë, një mbreti i kishin prerë kokën.

## XXVI

Hankonatët bënin plane tē zgjeronin dyqanin (madje thoshin se pritej që tē vinte dhe një arkitekt enkas pér këtë punë), kur u ndodhi gjëma. Natën, duke u gdhirë 30 prilli, dyqani i tyre u dogj.

Zjarr si ky s'ishte parë ndonjëherë në qytet, një zjarr i egër, me hungërimë, sikur tē ishët një bishë. Tamam zjarr i huaj, prej vajguri. Ata që qenë përpjekur ta shuanin,

ishin larguar të tmerruar prej tij. Brenda pak kohe dyqani i madh qe kthyer në gërmadhë. Gjithë trualli përreth nxinte. Edhe gjurmën ai zjarr e kishte pasur të mynxyrshme.

Mall harram, thoshin njerëzit. Kuptohej që u kujtuan hollësira nga gjyqi i dikurshëm për Arën e Mullenjave, beja e rreme e Basri Hankonit etj. etj. Shumica thoshin se zjarri kishte rënë rastësisht, por kishte që dyshonin për Cacin; shitësin e vjetër të vajgurit, që Hankonatët pothuajse e kishin rrënuar ekonomikisht.

Me ftohjen e gërmadhave të dyqanit u ftohën dhe bisedat për të. Ra një shi që e bëri edhe më të pështirë pamjen e gërmadhës. Tamam gjëmë e zezë, siç i thonë fjalës.

Kripa ishte e ngadaltë, por qe e sigurt, thoshin më pleqtë. Kursë vajguri, ashtu siç të ngrinte lart shpejt e shpejt, akoma më shpejt të rroposte. S'e kishte lënë më kot amanetin' Basri Hankoni plak: mos iu ndani kripës, djem! Por ata s'e dëgjuan.

## XXVII.

Të mos i kishte ndihmuar Shanoja, Hankonatët do të katandiseshin të merrnin torbën e të dilnin për të lypur. Përveç Shanos iu gjet për ditë të zezë dhe Ara e Mullenjave, që ata prej vitesh pothuajse e kishin harruar, sidomos pas vdekjes së Didinit.

Nga shtatë gjyqet që Shanoja pati atë vit, gjithmonë për shkak të shtëpive, katër i fitoi, një e humbi dhe dy u shtynë për më vonë. Sa për Arën e Mullenjave, ajo, si pérherë, dha prodhim të mbarë. Së paku sa për bukën e kalamajve, thoshin ata. Djemptë e martuar të Hatibit, bashkë me vëllanë e vogël, Basri Hankonin e ri, gjithë ditën e kalonin tanë atje.

Më i madhi i Hankonatëve. Muquerremi, e kishte humbur fare. Ndoshita fjala do t'i dëgjohej akoma, si më plakut, por ai s'kishte përsë të fliste më. E kishte kyçur gojën si për gjithmonë. Fol, i-thoshte nganjëherë Shanoja, fol, të keqen motra, se s'është shenjë e mirë kur njeriu e kyç gojën

për së gjalli. Por ai s'fiste që s'fiste. Mbase nga ky shkak, edhe kur qëllonte që hapte gojën, i vinte një erë e rëndë, si erë dheu. Gjersa vdiq, i tha a s'i tha nja dyzet fjalë. E dërgove gjuhën në mortje, përpara se të shkojë vetë. Kështu e vajtoi Shanoja.

Tani më i madhi i shtëpisë mbeti Kaskapani. Por edhe ai mezi njihej. Pinte vazhdimisht, sa herë që e qerasnin dhe, kur dehej, zinte e fliste për atë kauren e huaj, me të cilën kishte rënë atëherë në dashuri. Pastaj zinte e numëronte vendet e ndryshme, pusin e Malilajve, kullën lindore të kështjellës, humnerën pas Pazarit të Vjetër, shkëmbin e zi, lumin, përroin e Çullos etj., ku do të kishte vrarë veten prej kohësh, sikur të mos kishte Roksanën e vogël, vajzën që e lindi me vejushën e Hatibit. Thoshin se ajo po bëhej e bukur si një yll.

## XXVIII

Në këto e sipër, tamam kur nuç e priste më askush, u kthye nga haxhillëku Bardhushi. Kthimi i tij zgjoi më shumë pikëllim, se gëzim. Ishte krejt i ndryshuar, saqë mezi njihej. Madje disa njerëz nisën të përshpëritin se nuk ishte ai. Thoshin se kështu ndodh në shkretëtirat arabike: rëra, tamam sikur të mbarsej me pamjen e njeriut, pjell dyzimin e tij. Njeriu qëllon që vdes andej humbëtirave, kurse dyzimi i tij vazhdon të endet dhe t'a kohë në botë.

Kështu thoshin njerëzit, por ndoshta, po të pyetej Bardhushi, ai ndoshta kishte akoma më shumë të drejtë të thoshte se nuk i njihte më. Hankonatët. I kishte lënë mirë e bukur e i kishte gjetur të rrënuar krejtësisht. Oxhakët e shtëpisë së madhe ishin të ftohtë. Natën e parë të mbërritjes së tij mezi gjetën ca dru për të ndezur oxhakun e dhomës së madhe. U mblohdhën të gjithë atje, me burra, gra e kalamaj, por as fjala s'lidhej, as gëzimi s'shkëndijonte gjékund. Ata shikonin të ardhurin, pastaj vështronin njëri-tjetrin. Gruaja e tij mezi mbante lotët. Pse s'pyet ku është Didini, ku është Muquerremi, ku janë të tjerët, i tha më në fund Shanoja. Ai ngriti sytë e shuar dhe

tha: gjersa nuk janë këtu; janë *atje*. Pastaj u fal një copë herë të gjatë përmbysh, murmuriti e murmuritit dhe kërkoi të shtrihej.

Të nesërmen shkoi në varreza. Hankonatët kishin tani atje katërmëdhjetë varre, dhe ai ndaloj te çdo varr. Pëshpëriti e u lut për secilin. Më shumë foli me ta, se me të gjallët.

Pas ca ditësh u hapën fjalë se kishte sjellë me vete një sëmundje lëkure të pashërueshme. Më mirë të mos qe kthyer, thoshte gruaja e tij. Pa të, isha së paku vëlushë. Tani nuk di ç'jam.

Në qytet filluan ta thërritnin Haxhi Bardhushi, sic thërritnin gjithë ata që kthëheshin nga haxhillëku.

## XXIX

Erdhën taksat e reja nga kryeqyteti, por Hankonatët për herë të parë nuk u interesuan më për to. S'kishin as ç'të shitnin, as ç'të blenin, Mushkat e kripës i kishin ksebër prej kohësh.

## XXX

Basri Hankoni, që i kishin vënë emrin e gjyshit, ishte më shëndetligu nga djemtë e Hatibit. Por mbas tamam ai shëndeti i tij i lig u bë shkak që për Hankonatët të hapej një rreze drite.

Dhe kjo ndodhi kështu: për shkak të shëndetit të dobët ai bënte një gjumë të keq, me shumë èndrra e makthe. Në muajin dhjetor se si i shkrepit dhe e dërgoi përshkrimin e njérës prej èndrave që kishte parë, në Tabir Saraj (Pallati i Èndrrave), në kryeqytetin e perandorisë, ku dërgoheshin èndrrat që shikonin shtetasit në të gjitha skajet e mbretërisë. Pas katër muajsh, për habinë e tij dhe të të gjithëve, i erdhi një përgëzim nga zyrat e Tabir Sarajit, ku i njoftohej se èndrra e tij,

pasi qe shqyrtuar prej komisionit përkatës, ishte gjetur tepër e vlefshme, sepse, në bazë të kuptimit të saj, qe zbuluar dhe parandaluar një komplot në qytetin Karagjymryk.

Basri Hankoni as që e dinte se ishte në botë ky qytet, pale pastaj të parandiente edhe një komplot që po bëhej në të. Megjithatë, për shkak të ëndrrës, që parashikoi një të keqe kundër qeverisë, Tabir Saraji i fuqishëm i dërgonte një rekomandim, për t'u pranuar në punë të shtetit. Me të në dorë Basri Hankoni e paraqit në hyqimet dhe pas ca kohësh, për gjëzimin e gjithëfisit, ai u emërua si nëpunës në gjykatore. Ishte Hankonati i parë që hynte me rrogë në punë të shtetit.

### XXXI

Hankonatët po mëkëmbeshin dalngadalë. Megjithëse ishin gjallë Haxhi Bardhushi e Kaskapani, gjithmonë e më tepër frenat e shtëpisë po i merrete nipi i vogël shëndetlig, Basri Hankoni. Shkak për këtë gjë ishte pa dyshim nëpunësia e tij.

Haxhi Bardhushi e Kaskapani ishin pothuajse të mënjanuar nga drejtimi i shtëpisë. I pari merrej gjithë ditën me lutje dhe në atë pak kohë që i tepronte nga lutjet, merrej me lyerjen e lëkurës me ca melhemra. Kurse Kaskapan pinte vazhdimi shëtit. Ditë, apo kthente gotën e tretë, niste të tregonte për kaurkën e dikurshme.

Ca nga rroga e Basri Hankonit, ca nga Ara e Mullenjave, me të cilën merreshin gjithë ditën vëllezërit e Basriut, dhe nipërit e tjerë, Hankonatët arritën të hidhënin gjysmën e zahiresë së vitit. Po kryesorja qe rroga. I shpëtoi Hankonatët një copë ëndërr, thoshin njerëzit. Shumë njerëz nisën të dërgonin ëndrrat që shikonin, ose që gjoja i shikonin, por që në të vërtetë i shpiknin, në kryeqytetin e shtetit. Por nga Tabir Saraji nuk vinte asnjë përgjigje. Qatipët që merreshin me hartimin e letrave, fituan në atë kohë mjaft para, gjersa njerëzit

u lodhën së dërguari èndrrat dhe hoqën dorë nga ajo punë.

Sa pér Basri Hankonin, ai thoshte se tani nuk e kujtonte mirë atë èndërr të bekuar. Ishte një shesh me pluhur, me ca letra të grisura tejembanë dhe ca brraka të braktisura pérreth. Kaq mbante mend ai.

Në atë kohë, si pér të gëzuar atë pak mëkëmbje, u martua njëri nga djemtë e Muqerremit, si edhe të dy vajzat jetime të Didinit. Ishin ca dasma të varfrë, as hija e dasmave të bujshme të djemve të Hatibit, por sidoqoftë ishin gëzim, pér të cilin kishte aq nevojë kohë e fundit fisi i Hankonatëve.

## XXXII

Në ditën e parë të pranverës erdhën papritur krrorët nga Stambolli bashkë me një të dërguar të vëçantë të sulltanit. Ata hynë në Gjirokastër në kohë të muzgut, kurse herët në mëngjes u hap lajmi se i kishin prerë kokën valiut dhe ia kishin marrë me vete në kryeqytet. Ca kohë qyteti mbeti pa vali.

Hankonatët u trembën nga ndryshimi i qeveritarit të vendit. Kujtuan se valiu i ri do t'i ndërronte nëpunësit. Por ai, megjithëse vonoi shumë gjersa të vinte (dhe zakonisht pér valinjtë që vononin të vinin, ashtu si pér një dënim kur vononte, bëheshin parashikime të këqija), pra, megjithëse valiu i ri mbërriti në fillim të vërës, nuk bëri asnjë ndryshim midis nëpunësve të vegjël apo të lartë, përvèç Sheme Turtullit, mbykëqyrësit të tregut, posti i të cilit mbeti ca kohë bosh gjersa në të u emërua prapë po Sheme Turtulli.

## XXXIII

Në vjeshtën e dytë plasi kryengritja në malësitë e pashallëkut fqinjë të Vlorës. Një javë rresht xhadeja në këmbët e qytetit u nxi nga ushtria që shkonte pér të

shtypur kryengritjen. Shkuan pothuaj krejt timarlinjtë e vendit me në krye valiun, dhe shumica nuk u kthyen.

Pas mbarimit të luftës, si për ta hidhëruar gëzimin e fitores së trupave mbretërore, ra një sëmundje e pa-njohur, që bëri kërdinë më keq se lufta. Nga porta e Hankonatëve dolën katër tabute.

Po atë dimër Basri Hankoni u martua. Kjo qe një martesë jo shumë e zakonshme dhe ja sepse: që kur Basri Hankoni u bë nëpunës, pra që kur hyri në bukë të qeverisë, siç thoshin, e kërkuan ta bënin dhëndër disa shtëpi, por xhaxhallarët dhe sidomos halla Shano, së cilës i dëgjohej fjala shumë më tepër se atyre dy shikretanëve, nuk nguteshin. Edhé vetë Basriu sikur s'kishte qejf. Ishte bërë i ngrysur nga punët e shumta dhe pritej të ngríhej në një post më të lartë.

Megjithatë koha e martesës po afrohej. Një ditë hallë Shanoja erdhi që pa gdhirë mirë te shtëpia e madhe e babait (kështu zakonisht vinin që pa gdhirë ata që shikonin ndonjë ëndërr të mirë, e sidomos të keq) dhe nuk doli që andej veç kur u err. Gjithë ditën u mbyll me të dy vëllezërit, Haxhi Bardhushin e Kaskapanin, në odën e madhe, për t'u këshilluar për diçka të rëndësishme. Të gjithë e kuptuan se ishte fjala për martesën e Basri Hankonit. Ishte një ditë me erë dhe shumica e oxhaqeve kthenin tymin. Aty në të kthyer të ditës thirrën në odën e madhe edhe Basriun vetë, siç duket për t'i thënë vendimin që kishin marrë. Vendimi ishte paksa i papritur, por jo fare i pazakonshëm. Martesat midis kushërinjve të parë, për shkak të moscopëtimit të pasurisë, nuk ishin të pazakonshme në Gjirokastër. Mbase në këtë rast qudinë e shkaktoi jo aq afëria e gjakut midis të vluarve, sesa shëmtimi i nusës, vajzës së Shanos. Megjithatë Hankonatët kishin arsye më tepër të gëzoheshin për këtë krushqi me hallën e madhe, sesa ajo vetë. Në fund të fundit, pavarësisht nga mëkëmbja e tyre e ngadalë dhe nëpunësia e Basriut, Shanoja kishte një pasuri që ua kalonte katër-ose pesëfish kamjes së tyre të përbashkët.

## XXXIV

Dasma e Basri Hankonit u bë në tetor. Kishte kohë që shtëpia e Hankonatëve s'kishte parë një hare të tillë. Të gjithëve iu kujtua martesa e vëllezërve më të mëdhenj të Basriut. Ishte pothuajse po ai bollék mishrash e bakllavash. Vetëm flakadajtë mungonin. Jo se kishin ndonjë shpenzim të madh, por, siç dukej qysh nga dje-gia e dyqanit Hankonatët vetveti kishin fituar një pri-re të keqe. jo vetëm kundër vajgurit, po kundër gjithçkaje që lidhej me të. S'ishte e rastit që qysh atëherë shtëpia e tyre e madhe ndriçohej më zbehtë se shtëpitë e tjera përreth, duke mos llogaritur shtëpitë e të skamurve.

Në dasmë, përvèç farefisit dhe krushqive të shumta, erdhën dhe ca zyrtarë, madje edhe vetë këshilltari i valiut për çështjet gjyqësore, Mafuz efendiu. Selmanë e kishin nisur e stolisur me shumë kujdes, por, nga gjithë ato pudra e kënara e pikëza floriri të ngjitura në faqe e ballë, ajo, në vend që të zbulukohej, qe shëmtuar më tepër.

## XXXV

Pas martesës së Basriut, ashtu siç pritej, fuqizimi ekonomik i Hankonatëve përparoi më me shpejtësi. Basriu e la dhomén e tij beqarore dhe bashkë me të shogjen u vendosën në katin e tretë të qoshkut verior, të cilin e liroi Kaškapani, se nuk i ngjitte dot shkallët. Këto ishin ca dhoma të gjera, me musandra të mëdha druri, që nuk i ngrohte dot asgjë gjatë dimrit.

Shtëpia e madhe po mbushte gati shekullin dhe prej kohësh kishte nevojë për meremetim. Hankonatët, për shkak të telashevë që kishin pasur, e kishin shtyrë nga viti në vit meremetimin. Mirépo pas martesës së Basri Hankonit ai nuk mund të shtyhej më. Balli i «Qoshkut të jetimëve» ishte shkalafitur vende-vende nga shiu dhe era, qenë dëmtuar rëndë strehet e anës jugore, tra-

rët qenë kalbur vende-vende dhe mund të këputeshin e të vrisnin njeri në rrugë. Kurse në qoshkun verior, pikërisht atje ku u vendos Basriu dhe ku një kat më poshtë banonte Kaskapani me të bijën, Roksanën, dukeshin gjurmët e para të rrënojës. Streha e çatisë, muri poshtë saj bashkë me dy dritare, që prej kohësh nuk hapeshin më, ngjanin si të prekura prej gërbulës, njëlloj si lë-kura e pashërueshme e Haxhi Bardhushit.

Pikërisht në këtë krah vunë së pari ustallarët përmeremetim.

## XXXVI

Në niuajin mars ra një dëborë e bukur. Ajo ishte akoma nabi çatira, kur e mbytën Roksanën. Sado që Hankonatët u përpoqën që e fshehta të mos dilte, ajo doli që doli. Roksana shtatëmbëdhjetëvjeçare nuk ra nga shkallët, siç hapën fjalë, por e mbytën vetë më duart e tyre, me juk. Kështu janë mbytur në Gjirokastër denbabaden vajzat që humbnin nderin. Dhe ajo, me sa duket, e kishte humbur nderin. U pëshpërit se një nga ustallarët e rinj, nga ata që punonin përmereemetimin e qoshkut verior të shtëpisë, e mori në qafë. Por Hankonatët vetë nuk thanë asgjë. Vetëm ndërprenë meremetimin e shtëpisë, por kjo nuk u kuptua pse u bë, nga hidhërimi i zisë, apo për të kequr qafe ustallarët.

Kur shkrua bora dhe strehët nisën të pikonin, Roksana e bukur qe në varr. Vajzë më të bukur s'mund të pjetllë një bark gruaje, thoshin ata që e kishin parë. Ishte si e largët dhe përherë si prapa një mjegulline, ashtu si emri, që ia kishte sjellë i ati nga larg. Ata që e kishin parë, kështu thoshin për të: dukej menjëherë që ishte si mysafire në këtë botë. Sapo e shihje, menjëherë thoshe me vete: e bukur, e bukur, por ç'e do, duket sikur diku e presin.

## **XXXVII**

Pas vdekjes së Roksanës Kaskapani ra fare. E vuri poshtë pijs, pér tē mos e ngritur kokën. Thuhej se nuk kishte marrë pjesë në mbytjen e së bijës, por, i dehur tapë, kishte vështruar tē tjerët se si po e vdisnin. Më vonë u folën shumë gjëra, por asnijëherë nuk u mor vesh me saktësi se cilët nga familjarët morën pjesë në mbytjen e Roksanës. Kurse pér fatzezën thanë se nuk bëri as gëk, as mëk, vetëm një herë thirri: baba. Në-nën s'e kërkoi.

Ajo klithmë, baba, që ai e përmendte sa herë që bëhej xurxull, e kërrusi Kaskapanin, gjersa e çoi edhe atë në atë jetë. E varrosën përbri saj. Më vonë, me kallimin e viteve, njerëzit, duke kujtar Kaskapanin, nisën ta ngatërronin historinë e dashurisë së rinisë së tij me një kaurkë tē huaj, me historinë e së bijës. Por mbasë pér këtë gjë u bë shkak emri i njëjtë, Roksanë, që trëgimitarët e përdornin si pér historinë e parë, si pér tē dytën, ashtu siç përdoret një gur i vjetër në një mur tē ri.

## **XXXVIII**

Në fund tē atij viti, që qolloi i zymtë pér Hankonatët, Basri Hankonit i lindi një djalë. Donin ta quanin Hatib, pér kujtim tē babait tē Basri Hankonit tē ri dhe tē djalit tē madh tē Basri Hankonit plak, por Shanoja nguli këmbë tē quhej Fatri, pra një emër me kuptimin e fatit tē ri. Ajo fluturonte nga gjëzimi. Hankonatët aq më tepër. Dhe kishin tē drejtë. Me këtë krushqi pasuria qe bërë e pandashme.

Shanoja ndërkaq i kishte shtuar mallit tē saj ca çerkekë shtëpish e ndonjë gjysmë dyqani apo një tē tretë hamami. Edhe kishte humbur nga rishikimi i ndonjë gjyqi, po më shumë kishte fituar.

Të gjithë ishin tē një mendimi se Hankonatët i ki-

shin punët në vijë. Kishin herë pas here ndonjë shqetësim, si për shembull dalja e një këngë që nisi të këndohej pjetoreve:

*Roksanë, e bukur Roksanë,  
Të mbytën me ca jorganë.*

Thoshin se e kishte ngritur muratori i ri. Por ajo s'e prishte dot rrjedhën e jetës.

### **XXXIX**

Dy dimra rresht bënë të ftohtë e të sertë, siç nuk mbahej mend. Ngrinë strehët e çative, dhe hejët vareshin poshtë si heshta ushtarësh. Pleqtë thoshin se kjo ndodhë ngaqë po afronte fundi i shekullit.

Në qendër të shtetit ishin bërë prapë turbullira, por çfarë dhe si s'e dinte askush.

Foshnjës së Basri Hankonit po i vononte gjuha. I prenë copa letrash me gërshtërë përpëra gojës, shuan qymyr në gotë uji, e çuan në teqenë e Baba Aliut, në Shpellën e xhindeve të mira, te plaka Hatixhe, po ai s'foli që s'foli. Pastaj e panë mjekë të dëgjuar, e çuan gjer në Janinë dhe bëheshin gati ta çonin gjer në Sofje, madje gjer në Stamboll, po të qe nevoja, por mjekët u thanë se e kishin kët që mundoheshin. I vogli kishte lindur i metë nga mendja. Hankonatët ranë në të zeza. Sidomos Shanoja. Ajo e ndiente veten gjithsesi fajtore për krushqinë. Në fund të fundit, asaj i kishte rënë së pari në mend një gjë e tillë. Mjekët kishin thënë se shkaku kryesor që djali kishte lindur i mangët, ishte afëria e gjakut.

Doli dhe një hall i ri: të bënte apo të mos bënte më fëmijë Basri Hankoni?

### **XL**

Pas vdekjes së Kaskapanit, më i madhi i Hankonëve dhe i vetmi nga brezi i vjetër kishte mbetur

Haxhi Bardhushi, por atij nuk ia varte kush. Ishte krejt i përpire pas lutjeve dhe melhemeve të lëkurës. Edhe djemtë e Hatibit, vëllezërit e mëdhenj të Basri Hankonit nuk ndiheshin në shtëpi. Merreshin me Arën e Mullenjave dhe pranonin kokulur komandën e vëllait të vogël, Basriut. As Hatoja, motra e madhe fatpadalë, nuk ndihej. Në fillim sikur u acarua me nusen e vogël, Selmanë, por pastaj shpejt i la udhë. Sa për të tjerët, djem e nuse, ata ishin si një grumbull vuvësh, që vërtiteshin heshturazi nga njëri skaj i shtëpisë së madhe në tjetrin.

## XLI

Në fund të beharit, para se të vinin taksat e reja, plasën nga të gjitha anët akrepët. Një gjë e tillë s'mbahej mend. Kishte ndodhur të dilnin akrepë me shumicë kur shembëj ndonjë shtëpi, ose kur ndërroheshin çatitë, por, që të buisnin në gjithë qytetin, kjo as qe parë, as qe dëgjuar.

Thanë se, ashtu si ngricat e dimrit, edhe kjo kishëtë lidhje me mbarimin e shekullit. Ky ishte behari i parafundit i tij.

## XLII

Sipas këshillës së mjekëve Basri Hankoni nuk bëri më fëmijë. Por kjo s'ia uli aspak rëndësinë gruas së tij, Selmasë. Ajo ishte nusja e vetme që dëgjohej në shtëpi. Kunatat rrinin sus përpara saj, duke përfshirë edhe kunatën e madhe. Haton. I vuri në fre Hankonatët e bija e Shanos, thoshin për Selmanë. Po mbasë kjo vinte edhe ngaqë nusja e re pothuajse s'kishte vjeherr. Vjehrra e saj, gruaja e mëparshme e Hatibit dhe më vonë e Kaskapanit, endej nëpër shtëpi si hije, sidomos pas vdekjes së Roksanës, të cilën të gjithë djemtë e saj e kishin pasur motër, por një motër tjetërloj,

si jo prej kësaj bote. Shanoja kalonte ditë të tëra në shtëpinë e madhe të babait: E këshillonte vajzën, fuste spica, por vetë rrinte gjoja mënjanë. Halla e madhe, kështu e thërrisinin të gjithë.

### XLIII

Në fund të vjeshtës u ngrit në post më të lartë Basri Hankoni. Nga kjo ai u bë edhe më i zyrtë. Një javë më pas vdiq Haxhi Bardhushi. Kohët e fundit kishte qenë fare si i lajthitur. Nuk mbante më këpucë, dilte zbathur nëpër qytet, shumë-shumë me nallane druri. Trak-truk gjëmonin kaldrëmet nga nallanet e tij. E ndiqnin pas kalamajtë. Kur vdiq, Hankonatët sikur u qetësuan.

Plakat që i lanë trupin, qenë lemerisur. Kishte pllanga e shenja të frikshme nga sëmundja. Pas varimit ia spërkatën me squfur e me gëlgjere dhomën ku kishte banuar i vetëm, por prapë në të nuk pranoi të banonte këndej e tutje njeri. Kështu mbeti e myllur qysh atëherë dhë nuک përdorej, veçse për të trembur kalamajtë: pusho, se do të të myllim në dhomën e Haxhi Bardhushit.

Mbi varr, siç e kishte lënë amanet, i vunë këtë mbishkrim të skalitur: «Këtu pushon nën dhë, robi i Allahut, grimca e grimcave të rërës së shikretëtirës, Haxhi Bardhush Hankoni. Qe në shumë vise dhe s'qe asgjékund, i verbër, ashtu si rëra që e lëviz era. Rahmet i pastë shpirti.»

### XLIV

Mbarimi i shekullit e mori me vete gjithë brezin e vjetër të Hankonatëve. La vetëm Shanon mbi dhë.

U priten tërmete, përmbytje, dalje uji të zi nga dheu, ekipse të diellit apo të hëndës etj., por asgjë nga këto nuk ndodhi në ditët që ishin si kufi midis shëku-

llit që po ikte dhe atij që po vinte. Ra vetëm një dëborë e qetë, rrëzëllonjëse që e mbuloi tejpërtej dheun. S'të besohej se kishte nisur qindvjeçari i ri.

Tani Hankonatët kishin në varrezën e vjetër të qytetit dyzet e dy varre. Dhe afërsisht po aq bëheshin si numër edhe të gjallët. Kështu që Hankonatët ishin tani si të ndarë përgjysmë, po aq mbi dhë sa nën dhë.

## XLV

Në vitin e dytë të shekullit të ri u përhap sëmundja e parasë. Kjo qe më keq se ethet e verdha, apo lia e zezë. Njerëzit ishin shëndoshë e mirë, por qe e sëmurë paraja. U dobësua, s'kishte fuqi blerëse. Kishte kohë që s'kishte rënë një sëmundje e tillë. Ishte e frikshme, sepse nuk i diheshin shkaqet. Thoshin se tregjet po shkretetoheshin anembanë perandorisë. Nga ç'anë vinte kjo flamë, nuk e kuptonte njeri. Flitej se kishte ca dijetarë kaurë apo çifutë, që i dinin sekretet e saj. Këta biçim doktorësh ishin të rrallë fort. Edhe emrin e kishin të pështirë: ekonomistë. (Kështu u thoshin veqilharxhëve në vendet e kaurit). Por në pashallëqet rrëth e rrotull s'ishte parë kurrë ndonjë prej tyre. Madje s'ishte parë në gjithë këtë krah të shtetit.

Ndërkaq shtrëngesa ekonomike bënte kërdinë kudo. Kishte plasur uria në pjesë të tëra të mbretërisë. U bënë lutje kudo, u shua qymyr, u therën kurbane etj. etj., por paraja s'shërohej që s'shërohej. Monedhat ishin njëloj si më parë, që nga lirat gjer te qindarkat. Por ç'e do, sëmundjen e kishin pérbrënda. Ishte më keq se murtaja.

## XLVI

Hankonatët e përballuan me vështirësi krizën. Mezi hodhën gjysmën e zahiresë së zakonshme për dimër.

Pakësuan kafenë, pakësuan gjalpin. Kalamajtë dhe grattë e hanin trahananë të pikuar vetëm me pak shëllirë.

Basri Hankonit iu rrit rroga, po paraja s'kishte vlerë. Duhej të jepte me grushte që të bleje një kile mish apo peshk. Erdhi fundi i botës, thoshini:

## XLVII

Plasi kryengritja në dy qytetet fqinjë. U nisen kundër saj timarlinjtë me valiun në krye, sipas urdhrit të dekretit mbretëror. Pa mbërritur mirë atje, morën urdhër të ktheheshin, nga frika e ndonjë turbullire brenda në qytetin tonë.

Ra dëborë më herët se çdo vit. Në pjesë të ndryshme të shtetit kishte turbullira. I zemëruar, sulltani i kishte prerë kokën vezirit të madh. Ai paskësh qenë fajtor për gjithë të ligat. Mirë ç'iu bë, qafirit, thanë të gjithë.

Karrocieri i një konsulli frëng që udhëtonte për në Janinë dhe që ndaloi të çlodhej pak në qytetin tonë, tha se gjithë Evropa ishte qmendur. Pritej një luftë e një kasaphanë që s'ishte parë kurre.

## XLVIII

U zu hëna në mesnatën e fundit të tatorit. Hënakun, që, siç e tregonte emri, e merrte rrogën vetëm përgjimin e hënës, e dha kushtrimin me vonesë, ngaqë e kishte zënë gjumi. Të mos qe plaka e Kokobabajve, që kishte katërmbehjetë vjet që s'flinte, kushtrimi s'do të qe dhënë fare dhe kushedi ç'hata do të ndodhë. Sa u dëgjuua kushtimi, u ngrit nga gjumi gjithë qyteti, me lutje e me daulle, gjersa e trembën lugatin dhe ai e liroi hënën. Hënakun e pushuan nga puna.

Po atë javë valiu dha dorëheqjen, s'dihet pse. Valiu i ri nuk vonoi, por ishte i egër si askush. Pa nisur

mirë nga puna, internoi gjysmën e nëpunësve. Midis tyre edhe Basri Hankonin. I çuan larg, në një ishuil të Greqisë.

Hankonatët mbetën keq, si atëherë pas gjëmës së vajgurit. Sapo filloj të merrte veten paraja, kur u ra në kokë kjo mynxyrë. Shtëpia e madhe u duk sikur u boshatis përgjysmë nga ikja e tij. Edhe kanatet, kur hapeshin, dukej sikur e qanin të zotin e shtëpisë. Askush nuk e ngrinte zërin. Vetëm belbëzimet e djalit idiot të Basriut e mbushnin shtëpinë tejpërtej.

Mjerë ata, ç'i gjeti, thoshin. I mbajti gjallë, si përherë, Ara e Mullenave.

## XLIX

Erdhën taksat e reja nga kryeqyteti, që i lanë të gjithë gojëhapur. Ndryshuar e bërë lëmsh, sidomos taksa e grurit, e kurorës, e qymyrit dhe e derrit. Me punët e Hankonatëve merrej tanë kryesisht Shanoja. Ngaqë i njihet gjyqet e gjyqtarët, ajo trokiste me radhë nëpër të gjithë, duke u bërë copë për të nxjerrë nga internimi dhëndrin dhe njëkohësisht nipin e saj..

Dhe më në fund ia doli mbanë. Basri Hankonin e kthyen nga Greqia. Siç u mor vesh më vonë, s'qenë as përcapjet zyrë më zyrë e as ryshfetet që e sosën punën, po tjetër gjë. Se kush e këshilloi Shanon; (ajo ndoshta u kujtua vetë), dhe i shkroi një letër Tabir Sarajit në kryeqytet. Fill pas kësaj doli fermani për lirimin e tij. Siç duket, Tabir Saraji i fuqishëm kishte ndërhyrë menjëherë. Qe gjetur èndrra e Basri Hankonit, thanë, atje ku mbahej, bashkë me miliona të tjera, dhe qe njoftuar qeveria. Madje në fermanin e lirimit qe vënë dhe numri i èndrrës.

Dukej si e pabesueshrme, por një èndërr i nxori prapë nga balta Hankonatët. Tani Basri Hankoni jo vetëm që nuk ishte në gjendje ta mbante mend atë èndërr, por dyshonte në e kishte parë vërtetë apo jo.

Pas kthimit nga internimi, në vend që të çelej, u

zymtua edhe më. E vunë në një punë më të flartë akoma, i ngritën rrögën edhe më, por ai nxinte. Mbashë kështu e donte edhe posti që mbante tani.

Shumë shpejt u harruan të ligat dhe te Hankonatët u kthyë jeta e parë. Ata që kishin thënë për ta: mjerë ç'i gjeti Hankonatët, tani thoshin: lum si ata. Sikur të mos ishin ato belbëzimet e idiotit, që mbushnin tejembanë shtëpinë, mbashë do të ishin krejt të lumtur. Por allahu nuk i jepte gjithë të mirat bashkë.

## L

Atë pranverë, përveç meremetimit të qoshkut vëror, që ishte ndërprerë qysh nga vdekja e Roksanës, u bë ndërrimi i një pjese të pullazit si edhe meremetimi i gjithë krahut perëndimor të shtëpisë. Gjatë ndërrimit të pullazit u prishën disa fole lejlekësh dhe me këtë rast u kujtua Haxhi Bardhushi i shkretë, që, ashtu si lejlekët, kishte shkuar gjer në Arabi e që kthyer për të vdekur në vend të vet. Roksanën e bukur s'e kujtoi kush.

Ca vite rodhën të qeta për Hankonatët. U bënë katër dasma rresht dhe po aq tabute dolën nga shtëpia. Qyshse Basri Hankoni u ngrit në postin shtetëror, ai deshi që Arën e Mullenjave ta jepnin këndeje e tutje me rentë. Dhe ashtu bënë. S'i ka hije shtëpisë sonë të mbajë erë kashte dhe bajge, kishte thënë ai. Dy nga nipërit i futi në punë të shtetit, një tjeter e çuan në shkollë. Basriu donte që Hankonatët të shkëputeshin dalngadalë nga e kaluara dhe të bëheshin këndeje e tutje një familje nëpunësish. Të jetonin më bukë të madhe, sic quhej rruga e qeverisë. Shanos nuk i mbushej mendja. Mos hiq dorë nga malli, thoshte ajo. Qeveritë ndërrohen si retë në qiel, malli qëndron.

Ajo vetë, e palodhur si edhe më parë, endej gjyq më gjyq. Fitonte dhe humbte, po më shumë fitonte. Dhe, ashtu si më parë, tamam qyqe, s'kishte asnë folë ku të mblidhej, përveç shtëpisë së vjetër, të babait.

## LII

Vendi i madh i Evropës që çmendur vërtet, siç kishte thënë karrocieri i atij konsullit freng. Flitej se rrëth njëzet mbretëri ishin hedhur në luftë kundër njëra-tjetrës, verbtazi, pa ditur as vetë pse. Qe bëre një mishmash e një katrahurë që nuk e merrte vesh qeni të zonë. Një shkurtabiq thoshin se i ngatërronte të gjitha. Një pasha freng, dy pëllëmbë mbi tokë, me emrin Napolon. Po edhe atij ia kishin bërë benë. Flitej se sultani ynë i madh rrinte mënjanë. Rrinte dhe vinte re se si përfyteshin xhuxhmaxhuxhët e Evropës. Pa kur të zgjaste dorën e t'i zgërlaqte në grusht ndonjë duzinë prej tyre e t'u thoshte: mjaft ju durova, qafirë, se ma prishët gjumin, atëherë do të bëhej q'do të bëhej. Po edhe sultani i madh kishte pasur telashe kohët e fundit. Atij që i bindej tërë bota e tërë qelli, flitej se nuk i bindej veziri fqinjë me ne, Ali Pashë Tepelena.

## LII

Selmaja, zonja e shtëpisë, bashkë me ikunatën e saj, Haton, me afrimin e pleqërisë, sa vente zbulu roheshin. Kishin qenë të shëmtuara të dyja në rini, por më vonë shëmtimin që mosha zakonisht e shton të njerëzit, tek ato e hoqi. S'thoshin kot të parët se çdo njeri vjen në këtë botë me pjesën e bukurisë së tij, por e keqja është se njerëzit e kërkojnë bukurinë jo në atë pjesë të jetës ku e ka caktuar allahu, por atje ku ajo s'është. Selmaja me Haton e kishin kuptuar që kishin lindur për pleqërinë.

Ato visheshin me sqimë, me rroba të zeza, që tregtarët i sillnin që nga Selaniku, lyenin flokët me këna dhe, kur shkonin mysafire nëpër krushq, e farefisni, nuk harronin kurrë të merrnin me vete një jevgë, që t'u mbante boçën me ndërrresat e natës. Ato ishin të gë-

zuara që bukuria u kishte ardhur vonë, atëherë kur  
është e parrezikshme.

Kunatat dhe nuset e tjera, qofshin të vjetrat që  
kishin pushuar së pjelli, qofshin ato që sapo kishin rë-  
në shtatzëna, nuk ndiheshin nëpër shtëpi.

### LIII

Në dimrin e egër kur u shpall jashtë ligjit veziri  
Janinës, një nga vëllezërit e Basriut ra i sëmure. Ishte një sëmundje tjetërloj, që s'i gjendej ilaqi.  
Rinte i pikëlluar, s'hapte gojë të fliste me njeri dhe  
s'thoshte ç'kishte. E panë njëri pas tjetrit shumë mje-  
kë, dhe asnjeri s'dha ndonjë ilaq për ta shëruar. Thanë  
vetëm që do të ishte mirë t'i vinin kangjella hekuri  
dritareve të dhomës së tij dhe, në përgjithësi, të mos  
e linin vetëm.

Më vonë u pëshpërit se fatziu kishte marrë pjesë,  
siç dukej, në mbytjen e Roksanës së bukur. Kaq kohë  
e kishte harruar dhe ja tanë, pas dyzet vjetësh, nisi  
t'i shfaqej vajza. Kjo e sëmuri. Nuk hidhte dot jorgan  
përsipër, i zinin frymën jastëkët, s'flinte dot në dy-  
shek. Siç dukej, të gjitha këto i kujtonin mbytjen e  
saj. Mjekut, që i ishte hapur, i kishte thënë se vajza  
nuk i shfaqej në ndonjë pamje të frikshme, përkun-  
ndrazi, i shfaqej e qeshur. Por kjo përk e lehtësonte  
aspak. Bile ishte më keq kështu, thoshte fatziu. Më keq.  
Dhe qante.

### LIV

Ali Pashë Tepelena u prish. E bëri hi zemërimi i  
sultanit të madh. U fol se emri i Shqipërisë do të  
zhdukej nga faqja e dheut. Do të shkulej, siç shkulet  
bari, dhe në vend të tij të mbillej një emër tjetër.  
Allah, ç'gjëra të lemerishme!

Basri Hankonit atë vit i ra dambllaja. Gjithë ai

njeri u kthye brenda disa javësh në një hiç. Rrinte në një nga dritaret e shtëpisë, që binte nga rruga dhe gjithë ditën bënte: blla, blla, blla. S'ishte e mundur tâ shkulnin andej. Kishte një maraz të madhe për të folur e për të dhënë urdhra dhe kjo, siç duket, e mundonte më shumë se çdo gjë. Nganjëherë përballë tij ulej i biri, idioti, dhe, ngaqë babai i dukej tanë më i afërt, niste dhe ai të bënte: blla, blla, blla, për t'iua përgjigjur, gjersa i damllosuri rrëmbente shkopin dhe e dëbonë.

## LV

Dambllaja e Basri Hankonit nuk ishte ndonjë hata e zëzë, siç u duk në fillim. Pensioni i tij ishte goxha i madh, dhe ai pension, bashkë me rrogat e dy niipave, si edhe me rentën e Arës së Mullenjave u mjaftonte Hankonatëve.

Tani gjithë shtëpinë e madhe e drejtonte Selma. Kuptohej që nëna e saj, Shanoja, apo halla e madhe, siç e thërritnin të gjithë, ishte atje si zonjë mbi zonja.

Hankonatët po i qeverisin gratë, thoshin për ta. Por kjo s'ishte ndonjë turp. Në jetën e gjithë shtëpive të vjetra gjirokastrite kishte pasur gjithmonë periudha kur kishin drejtuar gratë. Madje shpesh kishte qëlluar që pikërisht në këto periudha ato shtëpi të kishin pasur edhe kulmin e lulëzimit të tyre.

Për një kohë të gjatë jeta te Hankonatët rroddhi e qetë. Nën blla-blla-në monotone të Basri Hankonit shkonin javët, muajt dhe stinët. S'kishte vjeshtë pa dasmë dhe s'kishte dimër pa vdekje. Po ato ishin vdekje pa gjëmë. Njëra pas tjetrës e lanë këtë botë hallat plaka të Basriut, xhaxheshat e Selmasë.

Në dhomën e madhe me tavanë të gdhendura Selma-jë, halla e mëdhe, Shanoja dhe plaka të tjera që viniin për vizitë apo për mysafirrëk, rrufisnin ngadalë njëri pas tjetrit filxhanët e kafesë. Te Hankonatët kafeja të shkon në fund të zemrës, thoshin për ta. Filxhanët ishin

prej porcelani të shtrenjtë, të sjellë nga Ismiri, tabakaja akoma më e shtrenjtë, me një mbishkrim të Kurannit sipër saj, kurse kafeja, po nuk qe e Jemenit, s'pi hej në atë shtëpi. Midis dy kafeve gratë plaka kalonin dorë më dorë dylbitë e shtëpisë, një palë dylbi të vjetra, me këllëfë bojëkafe, që i kishte sjellë Kaskapani nga larg. Ato vështronin sa vështronin nga dritarja (kështu edhe quhej kjo pirje kafeje: kafe me dylbi), pastaj i linn dylbitë, pshëretin e dhe kujtonin kohërat e shkura, kryesisht vdekjet.

## LVI

Qyshse filluan të qeveriseshin prej grave, te Hankonatët u zgjua shija e luksit, sidomos e rrugave dhe xhevahireve. S'ishin as aq të pasur, sa t'i kishin në cdo gisht, por as aq të varfër, sa të mos i kishin së paku në njérën dorë.

Në shtëpi nisen të dukeshin takëme të shtrenjta, lugë e pirunë të argjendtë, dhe pasqyra prej bronzi. Atyre u dukej se, pa këto, një shtëpi e vjetër si e tyrrja do të ishte njëlloj si pa themele. Kishte ikur koha e Hankonatëve të parë, që e matnin fuqinë e shtëpisë sipas sasisë së zahiresë dimërore. Jo, ata ishin gati të hanin më pak, vetëm luksi të mos u mungonte. Dhe, në të vërtetë, Hankonatët kishin nisur të hanin më pak.

## LVII

Basri Hankoni vdiq fare qetësisht. Një mbasdite s'u ndie më ajo blla-blla-ja e tij e zakonshme dhe kjo ishte e gjitha. U bë kësoll i madh, por i ftohtë. Dëshpërimi qe harxhuar më parë, gjatë viteve të dambillasë. I biri i tij, idioti, vinte pas tabutit dhe herë pas here i thoshte: pse s'bën blla-blla? Por, kur e futën në dhë, sic duket, diçka kuptoi edhe ai, se ia plasi të qarit,

## LVIII

U ndërrua valiu. I vjetri u emërua në një vend të largët, (disa thanë se u burgos), i riu që erdhi një muaj më vonë, ishtë fare plak. Bëri ca ndryshime, por të pakta. As taksat që mbërritën në vjeshtë s'patën ndryshime. Pllakën mbi varrin e Basri Hankonit e gdhendi usta Vllasi. Ja fjalët: «Këtu prehet Basriu, nga dera e Hankonatëve, nëpunës i shtetit, i kategorisë së katërt, që e shpëtoi mbretërinë nga komploti i Karagjymrikut. I ndrittë shpirti».

## LIX

Shanoja i kishte kaluar të njëqindat, por mendjen e kishte qiqër. Madje, tamam atëherë kur të gjithë prisin që të rriddhët nga mendtë e kokës, ajo bëri një gjë të paparë ndonjëherë në shtëpinë e Hankonatëve: nisi të jepë para me fajde. Dha te Torajt, te Xarbajt, te Çanatët. Për të gjitha merrete dëftesë të rregullt, ku ishin shënuar afatet e kthimit, përqindjet e fajdesë etj.

Kjo gjë e gjallëroi edhe më plakën. Këmbët e mbanin, por sytë i qenë dobësuar. Bota i dukej gjithmonë si në mbrëmje. Dynja aksham, kështu thoshte. Por edhe ashtu, gjysmë e verbër siç qe, nuk hiqte dorë nga gjyqet. Porsa vinin ditët kur kishte gjyq, ngrihej më herët se zakonisht, vishej me rrobat më të shtrenjta, hidhëtë në kokë shifonin e zi dhe nisej.

Te Hankonatët vazhdontejeta e qetë, pa trazime. Hambarët e zahiresë nuk ishin aq të mbushur si dikur, por gjërat e luksit nuk mungonin. Edhe sëmundjet sikur po u vinin më të qeta: cërma, dhembja e kokës, trashja e kockave pas të gjashtëdhjetave. Cërmën e shëronin me njala të Janinës, dhembjen e kokës me qymyr të shuar në ujë.

Ndërkaq në odën e madhe të mysafirëve Selma-ja priste shoqet e saj. Të ulura në shiltetë e buta pranë

dritareve, ato pinin «kafenë me dylbi», pastaj flitnin pér kohën, pér vitet e shkuara, kryesisht pér vdekjet.

Në këtë kohë u kthye nga shkolla një nga nipa, Ebubeqiri. Ky ishte Hankonati i parë që mbaroi një shkollë të lartë. Shkollën e kishte bërë larg, në Stamboll. Kishte mësuar pér hesape, matematikë, siç i thoshin. Nuk njihej fare kur erdhi. Fytyrë tjetër, zakone të tjera, veshur allosoj. Kur zemërohej, shante në një gjuhë, kur pinte, këndonte në tjetër. Iku ky, thanë të gjithë. Ia prishi mendjen shkolla. E kishin pasur mirë Hankonatët që nuk e kishin dashur kurre shkollën.

Një muaj pasi erdhi, Ebubeqiri tha se Hankonatët ishin në rënie. Asnjë nuk i mori seriozisht fjalët e tij, përvëç plakës Shano. Ajo gjeti rastin një ditë, kur ai ishte në orë të mira, dhe e pyeti përsë mendonte se Hankonatët ishin në rënie. Ebubeqiri u zemërua, thirri, u inatos, shau në katër gjuhë, pastaj mori një shkumës dhe u përhoq t'ia tregonte pse. Shanoja s'kuptoi asgjë nga ato shifra, por se si i tha zemrë se stërnipi kishte të drejtë.

Tani ata të dy nisën të rrinin me orë të tëra bashkë. Gishtat e Ebubeqirit, pas bisedave me Shanon, ishin gjithmonë të zbardhur nga shkumësi. Po ia err dhe atë pak shikim që i ka mbetur, thoshin pér të, po e turulleps. Bisedat e tyre i kishin kapërcyer kufijtë e shtëpisë dhe i knin larg. Ai i shpjegonte asaj se përsë së-muret paraja dhe cilat janë shenjat e para të kësaj murtaje. Gjithmonë e më tepër ai i thoshte gjëra të çuditshme. I thoshte, pér shembull, se paraja nuk duhet mbajtur e fshehur në qypa nën tokë, se vdes. Shanoja kundërshtonte, i thoshte se nën tokë paraja është e sigurt, qoftë nga hajdutët, qoftë nga epshet e vetë njeriut që e ka. Ai inatosej, shfrynte, shante në shtatë a tetë gjuhë, pastaj ulej t'ia shpjegonte se nën tokë paraja s'merr frymë, ngrin, kurse, po ta nxjerrësh përashta, ta vësh në lëvizje, ajo gjallérohet, shtohet, si mushkat hergjelé. Shanoja s'kuptonte asgjë, por prapë e ndiente se stërnipi kishte të drejtë. Më në fund

ndodhi e pabesueshmja. Ebubeqiri ia mbushi mendjen Shanoš t'i vinte një pjesë të parave në ndërtimin e një mulliri, prej fitimeve të të cilit ajo do të merrte qđo vit pjesën e saj. E lajthiti plakën Ebubeqiri, thoshin të gjithë, e qmendi. Por një vit më vonë Shanoja jo vetëm s'u pendua për atë që bëri, por u bë ortak në një mulli tjetër dhe më vonë në ndërtimin e një hamami të madh grash.

## LX

U shpallën reformat e mëdha, Tanzimati, siç quhen, por u pritën kudo me turbullira. Lajmi i rënies së mur-tajës do të pritej mbasë më me qetësi. Gjihë sanxha-qet e Shqipërisë vluan si kazan.

Timaret u prishën me dekret. Filloi mbledhja e re-krutëve për të krijuar ushtrinë e përhershme, që do të zhëvendësonte timarlinjtë. Plasi vaji kudo. Nga Hankonatët u thirrën rekrutë tre djem. Thanë se për të kryer shërbimin ushtarak do t'i çonin larg, në rërat e Jemenit. Shtatë vjet rrësht. Ditën e përcjelljes te Hankonatët u bë një zi si në asnjë vdekje. Gjithë ato ditë pas ijkjes së djemve ishin si të trullosur. Kujtonin Haxhi Bârdhushin e shkretë, që kishte qenë në ato vise. Kujtonin të vdekurit e tjerë. Dhe për herë të parë pas shumë vitesh Hankonatët nuk blenë më kafe të Jemenit.

## LXI

Letra e parë nga Jemeni erdhi pas një viti. Ndërsa Ebubeqiri e lexonte, gratë qanin, ngashëreheshin. Sel-masë i ra të fikët dy herë.

Turbullirat kundër reformave sa vente rriteshin. Nga kalimi i herëpashershëm i ushtrive poshtë në xhade kuptohej që kishte kryengritje. Flitej për gjëra të tmerrshme. Tregonin se kishte prindër që, për të mos i

çuar djemtë ushtarë, i sakatonin vetë: u prisnin ndonjë gisht në dorën e djathjtë, ose i godisnin në gollgane që t'i bënin çalamanë.

Sikur të mos ishin hidhërimet e djemve ushtarë (helmi i Jemenit, thoshin plakat, kishte kohë që filxhanet e kafesë e kishin parathënë këtë gjëmë), pra sikur të mos qe ai dëshpërim, Hankonatët do të kishin ca vite të qeta. Shanoja vazhdonte të vinte para në sipërmarrje të ndryshme. Përveç dy mullinjve dhe hamamit, ajo u bë pjesëtare në një han përfshatarët. Thoshin për të se plaka nuk e kishte hallin aq shumë të fitimet, sesa te qejfi i gjyqeve të ardhshme, që mund të hapeshin me pjesëtarët e tjerë. Ebubeqiri e kishte siguruar se gjyqe do të kishte sa të donte. Zaten, një sipërmarrje e përbashkët ishte pothuajse krejt sherr dhe gjyq, ashtu si kastraveci që është pothuajse krejt ujë.

Ebubeqiri u martua tamam në kohën e turbullirave të Tanzimatit. Pas nëntë muajsh lindi një djalë. Donin ta quanin Didin, për kujtim të Didin Hankonit, të vrarë dikur në dasmë, por Shanoja nguli këmbë që ta quanin Basri, për të përtërirë emrin e nipit dhe dhëndrit të saj. Selmaja nuk donte, por nuk ia prishi s'ëmës. Këshfu që te Hankonatët u shfaq Basri Hankoni i tretë.

## LXII

Plasi turbullira brenda në qytet. U dogj një pjesë e pallatit të valiut, u hap burgu. Por erdhi me ngut ushtri e madhe nga Pashalimani dhe u vendos qetësia.

U ndërrua valiu. U hapën, krahas shkollës turke, shkolla latine dhe greke. Shkollë shqipe jo. Ebubeqiri tha se do ta conte djalin, kur të rritej, jo në shkollën turke, siç bënin muslimanët, por në atë latine, siç bënin katolikët. Ka lojtur nga mendja, thoshin ata që e dëgjonin.

## LXIII

Atë dimër te Hankonatët ndodhën tri vdekje rresht. Vdiq Ebubeqiri krejt papritur, në lulëzim të moshës. U ftoh një natë me shi, iu mbushën mushkëritë me ujë dhe për tri ditë iku nga kjo botë. E qanë si rrallë qahet robi. Me dyzet palë lot, siç i thonë fjalës. Sidomos Shanoja. Pas Ebubeqirit vdiq idioti. Edhe për të u bë kësoll, por ai s'ishte veçse një shkak për të kujtuar vdekjet e tjera. Më në fund, në të dalë të dimrit, vdiq Shanoja. Kishin filluar të besonin se zoti e kishte harruar mbi dhë. Zi më e madhe s'ishte parë ndonjëherë te Hankonatët. Vargu i kësolltarëve ishte i pafund. Kishte rënë dëborë dhe varreza e Vasilikoit zbardhëte tejembanë. Dëbora e thithë një pjesë të gulçimeve, por njerëzit i bënte si të dehur.

## LXIV

Plakat me mbishkrime u bënë gati pas një muaji, Në pllakën e idiotit ishte shkruar: «Allahu s'e la të thoshte veçse dy-tri fjalë në këtë botë. Ia ruajti të gjitha për tjetren. Rahmet».

## LXV

Si gjithmonë pas vdekjeve të bujshme, te Hankonatët u bënë zhvendosje brendapërbrenda shtëpisë. Edhe këtë herë në zhvendosjet u morën parassyh thyerja e moshës, reumatizmi, kujtimet e hidhura, si edhe ndonjë sherr gjysmë i fshehtë si thëngjilli.

Pas zhvendosjeve u bë meremetimi i krahut të djathtë të shtëpisë si edhe i strehës mbi portën e mëdhe. Një pjesë e kanateve të dritareve të ballit u vunë të reja. Shtëpia sikur u gjallërua nga të gjitha këto. Vetëm dhoma e Haxhi Bardhushit mbeti, si edhe më parë, e braktisur.

Selmaja, që i thoshin tani «halla e madhe», e drejtonte shtëpinë me dorë të hekurt. Ajo, sa vente, i ngjante s'ëmës. Në çastet e fundit, bashkë me defterin e fajdeve dhe të përqindjeve, ajo i kishte lënë amanet gjyqet, dhe Selmaja i kishte dhënë fjalën se do të ndiqte një për një të gjitha davatë e pambaruara. Dhe kështu bëri. Në fillim e nisi pa qejf, sa për të shpurre në vend porosinë e së vdekurës, por pastaj i hyri krimbi.

Kur, (ashtu siç e kishte parashikuar Ebubeqiri), nisën ngatërresarat e parë me sipërmarrësit e hamamit të grave. Selmasë iu mbushën sytë me lotë. Të ishe gjallë, moj nënë, kishte psherëtirë ajo, ashtu siç psherëtin njeriu, kur shikon të çelin degët e kumbullës në pranverën e parë, kur s'është më në botë ndonjë nga të dashurit.

## LXVI

Sipas zakonit të shtëpive të vjetra gjirokastrite, Hankonatët u vinin një pjese të fëmijëve emrat e stërgjyshërve e të gjyshërve. Kështu nuk ishte vetëm Basri Hankoni, emri i të cilit shfaqe për të tretën herë tek i biri i Ebubeqirit, por pothuajse gjithë brezi i vjetër i Hankonatëve i kishte emrat në jetë. Emrat përsëdyteshin e madje përsëtreteshin njëri pas jetrit dhe kështu s'pushonin së vërtituri nëpër shtëpi kalamajtë e vegjël me emrat e Kaskapanit, të Hatibit, Shanos, Didinit, gruas së Basri Hankonit të parë, Sabekos, Haxhi Bardhushit etj. Dukej sikur breznia e Hankonatëve vërtitej e vërtitej në të njëjtin vend dhe, ashtu si në lumin e turbullt, vorbulla nxirrte herë këtu, herë aty po ato trungje. Në të vërtetë ata ishin të ndryshëm dhe, po të ishin gjallë të vjetrit dhe të shikonin për shembull një Kaskapan të ngjallur e të urtë, në vend të Kaskapanit të dikurshëm që ishte si trëndafili i egër, apo një Haxhi Bardhush të ri që i pëlgente të vishej pas modës së Stambollit, në vend të Haxhi Bardhushit të nullane-

ve prej druri, ata do të mbeteshin me gojë hapur. Por kjo botë është rregulluar në atë mënyrë, që brezat njerezorë vijnë e ikin bashkë. Dhe shqyr që është kështu, ndryshe kushedi ç'gjëma do të ndodhnin.

Vetëm emri i Roksanës së bukur nuk u përsërith më. Si ylli që këputet e rrëshqet nëpër qiell, ai emër s'ngjiti dot te Hankonatët.

## LXVII

Ca kohë Hankonatët ranë në vështirësi ekonomike. Shkak pér këtë u bënë shpenzimet pér ca gjyqe të humbura. Veç kësaj, qiramarrësit nuk i paguanin në rregull qiratë pér ato gjysma dhomash e çerekë shtëpish, që Shanoja i kishte lënë të shpërndara tejembanë Gjirokastrës. Dhe s'ishte pér t'u çuditur. Pronësia mbi to qe kaq e përzier, saqë qiramarrësit gjenin shkaqe pér t'iuh shhangur pagesës. Jo më pak e vështirë ishte vjelja e fitimeve nga mullinjtë dhe nga hamami i grave. Selmaja nganjëherë psherëtinte: duhej mendja e Ebubeqirit pér të shkoqitur ato llogari të ngatërruara si prej djalli. Ajo e ndiente se po e gënjenin, por nuk e kuptonte si dhe pse. Kjo e hante përbrenda. Tani po kuptonte përsë Ebubeqiri e kishte lënë me amanet që ta çonin të birin në shkollën latine. Vetëm atje mësohenj një numrave. Mirëpo shkolla latine, si pér inat, u mbyll porsa Basri Hankonit të vogël, të birit të Ebubeqirit, i erdhë mosha e shkollës. U fol se do të hapej shkollë shqipe, por s'u bë gjë. Madje tamam pér shkak të hapjes së shkollës shqipe qenë bërë ca turbullira, qenë burgosur njerëz e qenë shpurë të lidhur në hekura gjer në Çanak Kala.

## LXVIII

Kishte vite që në shtëpinë e Hankonatëve nuk ndodhnin ngjarje të bujshme si dikur. Hankonatëve u është ftohur gjaku, thoshin pér ta. Kohërat e kripës e

të vajgurit, mashallatë e dasmave të djemve të Hati-bit, beja te Ara e Mullenjave, Roksana, aventurat e Kaskapanit e të Haxhi Bardhushit, ëndrra e Basri Hankonit, të gjitha këto dukej se kishin mbetur prapa dhe ishin si një qortim i heshtur për Hankonatët e rinj, që mbanin emrat e të parëve.

Edhe kur ndodhnin ngjarje, ato ishin të zvargura e të vakta. Njëra nga nuset, ajo e Didinit, nuk pilte dhe e çuan të flinte në teqenë e Beunit për katër ditë resht. U kthyesh krejt e ndryshuar dhe pas nëntë muajsh lindi një vajzë. Nga Jemeni u kthyesh vetëm njëri nga djemtë. Dy të tjerët vdiqën nga ethet e tropikut. Ishin Hankonatët e parë që i kishin varret larg, në një kontinent tjetër. E ndolli Haxhi Bardhushi atë udhë, thoshin. E goi emrin e Hankonatëve gjer atje. Do të ndodhte kjo mortje. Nusja e Didinit kërkoi prapë të vente në teqenë e Beunit, këtë herë me shpresë se do të bënte djalë. Shkoi e u kthyesh dhe pas nëntë muajsh lindi prapë vajzë. Djali që u kthyesh nga ushtria, Muqerrem qëhej, u përpooq të shpikte një alfabet sekret të familjes. Kohët e fundit ishin në modë në Gjirokastër alfabetet sekrete të familjeve të vjetra. Mirëpo tamam, në atë kohë u bë një gjullurdi e madhe tamam për shkak të një alfabeti shqip prej plumbi, që dikush e paskësh sjellë të ngarkuar mbi kurriz gjer këtu. Kishin ndodhur vrasje, burgime, kishte dalë një dekret i vegantë për dënimin e atyre që do t'u gjendej qoftë edhe një gërmë shqipe në shtëpi. Muqerremi e zhduku menjëherë alfabetin. Rreth e rrotull, afër e larg dëgjoheshin përherë e më shpesh fjalët «Shqipëri», «shqiptar», «Rilindje kombëtare», por Hankonatët s'para përziheshin në këto punë. Ata e dinin se prapa atyre fjalëye vinin gjithmonë prangat. S'kishin dashur asnijëherë të kishin ngatërresa me shtetin. Nusja e Didinit u nis për të treten herë në teqe. Këtë herë qëndroi më gjatë. Por prapë bëri vajzë. Djali i Ebubeqirit, Basri Hankoni, rrinte gjithë ditën mbi shkarravinat që kishte lënë i ati. Përpiqeshin ta zbavitnin me gjëra të tjera, por ai e kishte mendjen te numrat.

Tamam midis kësaj amullie ndodhi diçka e ngjashme me ato ngjarjet e forta e të bujshme të Hankonatëve të parë: dy pleq nga Çanalët, burrë e grua, mbytën veten me qymyr, natën e Vtit të Ri. Shkaku: s'kishin t'u kthenin Hankonatëve borxhin e dyfishuar nga fajdeja.

Megjithëse vdekja ndodhi jashtë shtëpisë, ajo i tronditi Hankonatët akoma më keq se një vdekje e brendshme. Gjer atëherë, kishte ndodhur ç'kishte ndodhur në familjen e tyre, çdo gjë kishte qenë brendapër-brenda mureve të shtëpisë. Kurse kjo, tamam ngaqë e kishte kapërcyer portën, shkaktoi në qytet një valë inati shurdhan kundër tyre. Veçanërisht e pati të vështirë Selmajë. Ashtu si Shanon, edhe atë po e harronte vdekja ta merrte. Po ky gjynah i ri e kërrusi më shumë, se Hankonatët e prenë dhënen e parave me fajde. Ata nuk ishin aq mirë ekonomikisht, por të jepnin përshtypjen se ishin akoma më keq, dhe këtë e bënin pér të ngjallur një farë mëshire te njerëzit.

## LXIX

Në këtë kohë plasi lufta me Rusinë. U thirr nën armë kuraja e vjetër e ushtarëve. Hankonatët përcollën Muqerremin, atë që kishte qenë në Jemen. U qulli pragu i shtëpisë nga lëtët, siç thanë. Lufta bëhej larg, në ca fusha që i quanin stepa, dhe lajmet mezi vinin. Nga Muqerremi as lajm, as letër. U bë paqe, u bë prapë luftë, kurse ai — hiç. Më në fund lufta mbaroi krejt. Ata që u kthyen, thoshin se nuk e kishin parë as të gjallë, as të vdekur. Do të ketë rënë rob, ose do të ketë humbur nëpër stepë, thoshin. Ishin ca stepa, që mjafton të ecje një copë herë nëpër to, dhe bëheshe si i dehur, këmbët të iknin vetvetiu dhe s'ktheheshe më pas, gjersa humbje. Hankonatët e prenë shpresën pér të. Por tamam kur e prenë shpresën, u erdhi një letër prej tij. Më mirë të mos u kishte ardhur. Ishte shkruar me alfabetin sekret të familjes. Jam i internuar

në fund të botës, shkruante. Këtij vendi ku jam i thonë Kolyma, ose Siberi, ububu. Është ftohtë, ububu. Ftohtë e kallkan, tamam prapa diellit. Jemeni ishte lule, o nënë. Këtu sulltanit i thonë car, ububu. Dita është e gjatë gjashtë muaj dhe nata gjashtë muaj, ububu. Qamëni mua të gjallë, mos më prisni. M.

Dhe ashtu bënë, e qanë të gjallë e nuk e pritën, dhe ai s'erdhi vërtet.

## LXX

Te Hankonatët erdhën ca vite të pikëlluara. Letra e Muqerremit sikur u solli që larg ftohtësirën. Renta e Arës së Mullenjave qe e ulët. Qiratë, ashtu si edhe më parë, mezi i mblidhnin. Nisën meremetimin e krahut të majtë të shtëpisë dhe e lanë përgjysmë, se kishte shumë shpenzime. U rrënuaj një pjesë e strehës së çatisë së qoshkut verior dhe donin ta meremetonin me ngut, por pastaj kaluan ca javë dhe sikur u mësuan me pamjen e saj. Fundja, strehë çatje është, thanë, s'prish ndonjë punë të madhe.

Jeta rridhete si me gjysmë zëri. Selmasë i qe dobësuar kujtesa. Ngatërronte njerëzit, ngjarjet, dhomat e shtëpisë. Basri Hankoni i ri rrinte gjithë ditën mbi një fletore të mbushur me numra. Bëhej luftë në Shqipërinë e Veriut. Kishin dalë dy armiq të rinj, aleatë të Rusisë, Mali i Zi dhe Sërbia. Donin të merrnin një copë të Shqipërisë. Tregonin se atje përrrenjtë rridhnin gjak.

## LXXI

Ra tërmët. Në lagjet e poshtme u prishën shumë shtëpi. Në të sipërmët jo. Shtëpia e Hankonatëve nuk pësoi gjë. Pati vetëm një plasaritje në katin e tretë. U gjëuan të gjithë. Mirëpo gjëzimi qe i shkurtër. Kur lëshuan kovat në sterë për të mbushur ujë, panë se ujë s'kishte më asnjë pikë. Qe çarë fundi i sterës. Sollën

ustallarë me ngut, dhe ata zbritën me litarë nën drithën e fenerëve. E gjetën vendin e çarë. Me këtë rast, përpara se të mbyllnin të çarën, vendosën ta pastronin sterën. Nxorën kova të tëra me llum. Herë pas here nxirrin lloj-lloj sendesh të hedhura në sterë: monedha metalike, kopsa, një kuti duhani prej bronzi. Pastaj nxorën kockat e një zogu; që kushedi si qe gjendur atje. Në fillim u tmerruan të gjithë: nga kishte flutuar ky zog, veçse nga thellësitë e xhehnemit. Mirëpo dikush tha se mund të kishte rënë nga qiejt mbi çatinë e shtëpisë dhe që andej ujërat e kishin shtyrë nëpër qyngje, gjersa e kishin hedhur në sterë. Njeriu thoste se i kishte qëlluar të shihte në ditët me shi se si binini mbi çatinë e Hankonatëve zogj të shurdhuar nga vetëtima.

Por ajo që i rrëqethi njerëzit më shumë se kockat e zogut, ishte nxjerrja e një palë këpucëve të vjetra. U mblodhën të gjithë rrëth tyre dhe, me fytyra të zverdhura dyllë, përpinqeshin të gjenin se të kujt mund të ishin ato këpucë dhe përsë ishin hedhur në fund të sterës. Papritur midis heshtjes së rëndë Selmaja tha: mos janë këpucët e gjyshit? E kishte fjalën për Basri Hankonin e dikurshëm. Selmaja s'mbante mend ç'ndodhë një orë më parë, por ngjarjet e vjetra i kujtohesin qartë. Për benë e rreme të Basri Hankonit në Arën e Mullenjave asaj i kishte treguar Shanoja. Shanoja i kishte treguar edhe për këpucët, që nëna e saj e ndjerë, Sabekojë, e shoqja e Basriut, për një kohë të gjatë i kishte fshehur s'dihej ku, nëpër mazgallat e shtëpisë. Ato këpucë s'ishin gjetur as pas vdekjes së saj. Dhe ja, tani qe zbuluar e vërteta: zonja plakë e Hankonatëve i kishte hedhur këpucët në sterë.

Nga shkaku i këpucëve u hapën kujtime të vjetra të familjes. Por veçanërisht u interesua për to Basri Hankoni i ri. Ai, si edhe më parë, gjithë ditën e ditës merrej me numra e me llogari. Të gjithë ishin të bindur se do të çmendej një ditë. Të tjerë besonin se pikërisht ai do ti ngrinte përsëri ekonomikisht Hankonatët. Flitej se në kohën që i tepronte nga numrat, shkru-

ante historinë e familjes. «Hankonatë denbabaden», kështu e kishte quajtur kronikën. Tamam pér këtë shkak u interesua aq shumë pér képucët e Basri Hankonit, shollët e ngjyera me baltë të së cilave kishin ndihmuar që Hankonatët të kryein krimin e tyre të parë: benë e rreme pér Arën e Mullenjave. Krim të dytë ai quante mbytjen e Roksanës. Dhe të tretin dhe më të rëndin vdekjen e Çanatëve pleq, pér shkak të fajdesë.

Kështu ishte Basri Hankoni, njeri i çuditshëm.

## LXXII

Vitet shkonin. Po afronte fundi i shekullit. Vdiq Selmaja, që e varrosën me kësoll të madh, si ata të njëhershmit. Shtëpia e madhe sa vente bëhej më e qetë. Vyshkeshin ngadalë nuset, duke hapur e duke mbyllur musandrat e mëdha, gjysmë të boshatisura.

Tani Hankonatët kishin në varrezzën e Vasilikoit rrëth shtatëdhjetë varre. Pra, shumica e tyre ishin nën tokë dhe pakica mbi tokë, ashtu si pemët drënja, që rrënjet i kanë më të shumta se kurorën. Kështu që prej kohësh ata quheshin vendës denbabaden.

Ata jetonin me rentën e Arës së Mullenjave, me një pension pér dy djemtë e vdekur në Jemen dhe një gjysmë pensioni pér djalin e tretur në Siberi, si, edhe me copëza qirash, nga godinat e shpërndara të Shanos. Ndoshta u bë shkak puna e vjeljes së qirave, që frenat e shtëpisë iu lanë në duar Basri Hankonit. Vetëm ai mund të shplekste atë që kishte qenë tepër e ngaterruar që në gjallje të Shanos e që ishte bërë lesh arapi pas vdekjes së saj. Brenda dy javësh, pér habinë e të gjithëve, Basri Hankoni shkoqiti hesapet, që kishte njëqind e njëzet vjet që qenë bërë lëmsh. Trashëgimtarët e qiramarrësve të shtëpive e çerekshtëpive, si dhe ata të mullinjve e të hamamit të grave u dëshpëruan. E humbën shpresën se do të fshiheshin këndej e tutje prapa katrahurës së hesapeve.

Por sqarimi i llogarive të pronës ishte për Basri Hankonin një punë më e lehtë se kapja e veshit.

Ai merrej me llogari të tjera, shumë më të thella e më të ngatëruara. Ia kishte kaluar të atit, Ebubeqirit. Veg kësaj, Ebubeqiri kishte bërë shkollë, kurse ky çdo gjë e kishte mësuar vetë. Ç'bënte vallë? pyesnin të gjithë. Disa thoshin se rrihte të përtérinte fuqinë e dikurshme të Hankonatëve. Madje, jo vetëm të Hankonatëve, po të gjithë shtetit të madh turk. Ata besonin vërtet se merrej me projektime reformash ekonomike për gjithë perandorinë. Kurse ca të tjerë ngulnin këmbë se ai s'merrej me asgjë të tillë. Sipas tyre, ai s'bënte gjë tjeter vegë testamentin e tij. Njerëzit kishin të drejtë të mbeteshin gojëhapët: q'ishte ky testament, har-timi i të cilit vazhdonte qysh prej tetëmbëdhjetë vjetësh?

Ja, kështu flitej për të.

## LXXXVIII

Basri Hankoni merrej vërtet me testamentin, dhe kjo u vërtetua menjëherë pas vdekjes së tij. Vdiq papritur, në moshën dyzetdyvjeçare, pak kohë përparrë mbarimit të shekullit. Testamentin ia gjetën në gjoks, të vulosur me dyllë të kuq, me vulën e vjetër të familjes.

## LXXXIV

Testamenti i Basri Hankonit, i cili u hap porsa u kthyen njerëzit nga varrimi i tij, i la pa mend Hankonatët. Dhe kjo ndodhi për arsyen e thjeshtë se ai nuk ishte testament i zakonshëm, por një *Vakëfname*, domethënë testament që falte gjithçka që Hankonatët e kishin ngritur me thonj e me djersë gjatë dyqind vjetëve, gjithçka për të cilën ata ishin përpjekur e rcb-tuar, me mund, djersë, dredhi, krim, llogari, etj. Gjithë mallin e gjënë, duke nisur nga Ara e Mullenjave e gjet te pjesa e sipërmarrjes në hamamin e grave, pra çdo

gjë, duke përfshirë edhe shtëpinë e vet, ai i linte vakëf.

Arsyjet shpjegoheshin në pjesën e parë të testamentit. Me dorë të tij Basri Hankoni kishte shkruar se, meqenëse kjo botë është e zhdukshme me gjithçka, se bota është vend mjerimi e jo gjëzimi, se qëndrimi në botë është i vështirë, se hapësira e saj është ngushticë, teprica e saj është mungesë dhe fitimi i saj është humbje, pra, meqenëse ç'ka ha njeriu, humb dhe ç'ka vesh, griset, kurse ç'ka fal nuk humb as griset, sepse hyn në kujtesë dhe kujtesa s'vdes kurrë, sepse shkarkohet si vetëtima nga truri në tru, pra, meqenëse njeriu duhet të mendojë vetëm për shpëtimin e shpirtit të tij, ai vendosi ta linte vakëf mallin e gjënë e Hankonatëve.

Në testament përshkruhej me hollësi vakëfi i ardhshëm: Ara e Mullenjave, krejt shtëpia e Hankonatëve, me gjithë oborrin, trualli i dyqaneve të djegura, katër shtëpi në lagjen Hazmurat, në të cilat Shanos i përkisnin dy të tretat, dy shtëpi në lagjen Varosh, në të cilat i përkiste gjysma; tri shtëpi në lagjen Dunavat i Sipërm, në të cilat i përkiste një e pesta, shtatë shtëpi të tjera në lagje të ndryshme, në të cilat i përkiste nga një pjesë e vogël, dhomë, hajat, gjysmë stere, madje vetëm porta, çezma, pranë Urës së Zerzebilit bashkë me rrrethojën prej guri, pesë dyqane në qendër të qytetit, në të cilat i përkiste pak më tepër se një e treta, krejt një dyqan në Pazar të Vjetër, gjysma e hamamit të Pashallit, muri rrethues i Hamamit të Kaurit, pjesëtaria 12% dhe 15%, në fitimet e mullinjve të Manalatit dhe të Xhemaliut, pjesëtaria në fitimet e hamamit të madh të grave, çezma te sheshi i Zemanit, katër rrënje mollë në kopshtin e një shtëpie në Gjobek.

Nga kjo pasuri e lënë vakëf, Basri Hankoni kërkonte të ngrihej një han i vogël ndanë xhadesë, dhjetë hapa larg urës. Në këtë han do të flinin e do të hanin falas të gjithë ata që do t'u binte udha andej, të vobektë a, të pasur, të huaj a vendës, shkollarë, pleq, dervishë, priftërinj, çifutë, heremitë etj. Ndanë hanit do të varrosej trupi i tij, me një pllakë të thjeshtë sipër, ku do të skalitej vetëm një fjalë: «Basriu». As fjalë të tjera,

as mbiemër, as datëlindje, as gjë. Plakat duhet që kishet një të thelluar sa për të vendosur një kandil, i cili duhet që rrinte ndezur ditë e natë, gjere në prishje të botës.

Nga vakinë i caktuhej një shumë paresh çdo pjesëtari të familjes së Hankonatëve, përsa kohë të ishte gjallë ai vetë dhe pas vdekjes së tij, birit a bijës së tij, birit të birit të këtij, e kështu me radhë, brez pas brezi e degë pas trungut, gjersë të mos mbetej kush e të shuhen fare barku i tij. Por shuma e pareve ishte caktuar jo për çdo vit apo për çdo stinë, po për çdo ditë të jetës së seçilit.

Basri Hankoni i kishte bërë tërë llogaritë që vakinë të qëndronte në këmbë në jetë të jetëve. Ishin përllogaritur me një saktësi të frikshme të gjitha mundësitë e shtimit të breznisë së Hankonatëve dhe për çdo mundësi kishte nga një rrugëzgjidhje, e cila lidhej me llogarinë e përgjithshme, pa prishur harmoninë e saj. Po kështu, ishin caktuar në një mënyrë të quditshme të gjitha shpenzimet përmajtjen e hanit dhe mirëmbajtjen e varrit, rroga e përditshme e hanxhiut, që do të ishte njëkohësisht kuzhinier, gjella që do të gatuhej çdo drekkë die gjella që do të gatuhej çdo darkë, shpenzimet përmeremetimet e herëpashershme, shpenzimet përvajin e kandilit mijëra vjet etj. etj. Të gjitha ishin parashikuar në atë testament dhe asgjë nuk ishte harruar. Dhe përllogaritjet nuk ishin bërë për dhjetëra apo qindra vjet, por përmijëra. Vetëm tanë e kuptuan Hankonatët përsë Basri Hankonit iu deshën tetëmbëdhjetë vjet rrësht përtakshkuar atë mynxyrë.

## LXXV

Gjëja e parë që u shkoi në mendje Hankonatëve ishte kundërshtimi i testamentit. Kjo ishte një gjë që pritej, përndryshe nga ai testament ata do të mbeteshin me gjith në gojë. Kundërshtimet e testamenteve ishin një gjë e zakonshme, por këtu ndryshonte pak puna:

Kishin tē bënин me një *vakëfname* dhe dihej që vakëfi mbrohej nga shteti dhe nga feja. Hankonatët u dësh-përuan, por nuk e lëshuan veten. Pajtuan avokatë tē zotë brenda në qytet (ndërsa mjekët Gjirokastra i thërriste nga larg, kadilerët e saj, përkundrazi, kërkoheshin që nga Adrianopoja, Sofja e madje, nganjëherë, që nga kryeqyteti), pra Hankonatët vunë avokatë tē zotë dhe i hynë davasë.

## LXXVI

Gjyqi për hedhjen poshtë tē testamentit të Basri Hankonit qe i zvargur e i pikëlluar. Ngadalë, njëri pas tjetrit, mblidheshin dëshmi tē vjetra e tē reja për tē vërtetuar se vakëflënësi kishte qenë i sëmurë nga mendja gjatë gjithë kohës që kishte hartuar testamentin. Avokatët kishin thënë se kjo ishte e vetmja mënyrë për ta hedhur poshtë *vakëfnamenë*. Ata përpinqeshin tē vërtetonin se në fisin e vjetër të Hankonatëve, krahas shëndetit dhe mençurisë qe shfaqur herë pas here edhe një dell marrëzie. Bašri Hankoni trashëgonte pikërisht këtë dell.

U turrën në gjyq pleq tē moçëm, që, duke bërë be mbi kuran, dëshmuani për tē birin idiot tē Selmasë e tē Basri Hankonit tē mëparshëm; u soll madje edhe mbi-shkrimi i varrit tē tij, që e vërtetonte farë mirë këtë gjë. Të tjerë pleq, akoma më tē moçëm, dëshmuani për një Hankonat tē brezit tē vjetër, njërin nga djemtë e Hatibit, që kishte vdekur pothuajse i qmendür nga tmerri i jorganëve. U mblodhën gjithashtu tē dhëna tē tjera përm'anira tē ndryshme, tuhafllëqe e sjellje gjithsesi tē çuditshme, që vërtetotonin tē njëjtën gjë: që në rrjedhën e fisit tē Hankonatëve gjarpëronte herë pas here damari i marrëzisë.

Mbarimi i shekullit i geti Hankonatët me këtë gjyq nëpër këmbë. Në qytet kishin ndodhur prapë turbullira. Djemtë e Topullarëve kishin dalë komitë në male. Qeveria i kërkonte kudo. Për kokën e secilit kishin vënë aq

para, sa ç'kishin harxhuar Hankonatët për zahirenë e kushëdi sa dimrave. Gjithë qyteti fliste për Topullarët, por Hankonatët, krejt të përpirë nga gjyqi i tyre, ishin bërë më të mbyllur se më parë.

## LXXVII

Erdhi muaji i fundit i shekullit që po mbaronte. Pastaj java e fundit. Hankonatët ishin të dhënë krejtësisht pas gjyqit. Dita e fundit midis dy shekujve ishte si e shurdhër, pa borë, madje pa rreshje. Vetëm herë pas here gjëmimi i ndonjë bubullime ndihej nëpër re, si gjëmimi i një kali në mesin e një ure.

## LXXIII

Gdhiu dita e parë e shekullit XX. Pastaj java e parë e tij. Pastaj stina e parë. Hankonatët vazhdonin gjyqin. Kishin shumë shpresa se do ta fitonin. Gjyqtarët ishin krejt të mahnitur nga llogaritë e pafundme të Basri Hankonit.

Vera kaloi me të, dhe vjeshta gjithashtu. Më në fund, aty nga fillimi i dhjetorit gjyqi mbaroi ashtu siç deshën ata: testamenti u hodh poshtë. Hankonatët ishin aq të lodhur nga ky gjyq, saqë nuk ishin në gjendje ta shijonin gëzimin. Gjyqtarët ishin si të hutuar. Flitej se, ndërsa hartonte vendimin përfundimtar të gjyqit, ku Basri Hankoni shpaljej i çmendur, njëri prej tyre kishte thënë: e megjithatë ky njeri ishte ndoshta mathematicieni më i madh i kohës sonë. Një dijetar i madh, por ç'e do, kishte shtuar ai, një matematicien për shpëtimin e shpirtit... pra kot.. fare kot...

Mars 1977

## **EMBLEMA E DIKURSHME**

1.

**A**na po krihej përpara një pasqyre të vogël, që e kishte mbështetur te pezuli i dritares. Mos u krih pranë pasqyrës kur ka vetëtima, i thoshte gjithmonë gjyshja, se pasqyra e thith vetëtimën.

E shkreta gjyshe, mendoi ajo. Me cepin e syrit vështroi jashtë shiun që po dendësohej. Shkarkimet e rrufeve sajonin në qìell ca si rrënëtë të shndritshme, të ngjashme me skemën e qarkullimit të gjakut që ishte varur në klasën e anatomisë. Ajo e hoqi pasqyrën nga dritarja, por vetë vazhdoi të vështronte shiun.

**D**o të lagen, mendoi për nxënësit. Ishte ora e mbarimit të mësimit dhe pas pak nxënësit e klasave që kishin nga gjashtë orë do të grumbulloheshin si zogjtë nën strehët e çatisë së shkollës, për të pritur pakësimin e shiut. Ana kishte dy vjet që, fill pas mbarimit të fakultetit, ishte emëruar mësuese në fshat, megjithatë ajo ndjesia që kishte provuar për nxënësit e vegjël fshatarë ditën e parë të shkollës, vazhdonte t'i mbetej e gjallë në shpirt njëlloj si atëherë. Kjo ishte një ndjenjë disi e paqartë, diçka midis dashurisë, mrekullimit dhe dhimburisë, që i përtërihej sa herë që shikonte kokat e tyre të vogla, shumica

me flokë të zbërdhulur, që asaj i dukeshin aq të butë e të mençem kur përkuleshin sipër bankave.

Do të lagen, mendoi ajo prapë, dhe pamundësia për të bërë diçka për të vegjlit e bëri të merrte frymë thellë.

Por shiu pushoi më shpejt se ç'pritej. Dhe, sikur të mos mjaftonte kjo, ai la pas vetes edhe një ylber, mes për mes qillit. Ana e merrte me mend se si nxënësit e vegjël vraponin tani drejt shtëpive, duke iu gjëzuar pamjes së ylberit.

Edhe për ylberin gjyshja thoshte diçka. Ana u përpooq të sillte ndër mend se çfarë, por te rruga kryesore, që i shkonte përbri kryesisë së kooperativës, ajo pa shqet e saj mësuese, që po vinin duke ecur me kujdes, përtiu shmangur pellgjeve të porsakrijuara nga shiu.

— E di? — tha Senka duke hyrë, — kanë ardhur ca gjeologë.

Për çdo të ardhur në fshat lajmin e parë e jepte patjetër Senka. E shëndoshë, me sy të lëvizshëm, ajo i gjëzohej si fëmijë çdo të ardhuri, qoftë ky plak, i ri, spërkatës pemësh apo ministër.

— Çfarë kërkojnë? — pyeti Ana.  
— Nuk e di. Ndoshta krom, ose ndoshta naftë. Tani janë në mensë. Ti ke ngrënë? — pyeti ajo Anën.

— Jo. Ju prisja ju.  
— Ejani, vajza, — tha Senka — se mos na ikin nga mensa.

Mensa e kooperativës, ku ato hanin zakonisht drekëن, ishte jo shumë larg, po rruga ishte mbushur me pellgje, që ato i kapërcenin duke qeshur e duke i thirrur njëratjetrës. Në mensë kishte plot njerëz.

— Ja ku janë, — tha Senka e para.  
Gjeologët kishin zënë një tryezë pranë xhamillëkut të madh. Ishin pesë veta. Midis tyre një vajzë.

— Mjaft e kthëve kokën, — i thanë Senkës shoqet.  
Vajza ishte me pantallona dhe kishte një profil të Hollë, të lëmuar.

— Simpatike, — ia bëri Senka, — po jo kushedi çfarë. Sytë e saj iu ngulën me admirim Anës, sikur ti

thoshin «ti je dhjetë herë më e mirë», por Ana kishte filluar të hante, pa e ngritur kokën nga pjata.

Ana ishte 23 vjeç dhe, përvèç që ishte më simpatikja midis tyre, ishte edhe më seriozja. Sa herë që në kooperativë vinin njerëz të huaj, sidomos kur midis tyre kishte ndonjë vajzë gazetare ose ndihmësoperatorë të TV-së, grupi i vogël i mësuesve kishte qejf të bënte krahasimin e së ardhurës me Anën. Anës vetë i dukej kjo gjë thjesht një çilimillëk, për të cilin nuk ia vlente barra qiranë as të shqetësoheshe, as ta merrje seriozisht. Mësuesve të fshatit u dukej gjithmonë se vajzat e ardhura me shërbim në fshat kishin pak qejf të shisnin mend, prandaj ato kënaqeshin kur vinin re se Ana e tyre ishte më e mirë se ato.

Te tryeza e gjeologëve u ul Kozmai, përgjegjësi i shtëpisë së kulturës. Ai ishte i shkathët, fytyrëkuq dhe kishte qejf të shoqëronte gjithë të ardhurit.

— Mak, — i pëshpëriti Senka, kur ai kaloi përbri për të shkuar te banaku i mensës. — Çfarë kërkojnë?

— Naftë, — tha Kozmai rëndë-rëndë.

— Prit pak, — tha Senka, — po ajo vajza...

Por Kozmai, krejt i përpirë nga kënaqësia që po rrinte me të ardhurit, nuk iu përgjigj fare.

— Ç'budalla! — ia bëri Senka.

Një copë herë mësueset hëngrën pa folur.

— Ai pa flokë është me siguri shefi i tyre, — tha Senka pas pak.

Shoqet qeshën. Qeshi edhe Ana.

— Po të shkon buka prapa krahëve për shkak të tyre, — tha ajo.

— Si ia bën ajo, e vetme midis tyre? — tha njëra nga vajzat.

— Ndoshta ndonjëri nga ata është i fejuari ose i shoqi i saj, — iu përgjigj tjetra. — Tani kjo është një gjë e zakonshme nëpër ekipet.

— Kush mund të jetë i fejuari? — i tha Senka. — Shefi me siguri jo. Mbeten tre të tjerët. Dy prej tyre janë të rinj, kurse i treti, megjithëse është me moshë të pjekur, duket si më simpatiku.

— Senka, mjaft, — ia bëri Ana. — S'të vjen turp që të mbeti koka andej?

Senka nuk foli dhe uli kokën mbi pjatë. + DK

Kozmai vente e vinte nga tryeza e gjeologëve te banaku i mensës. Pas pak tryeza e gjeologëve u mbush plot me pjata me kos buallice, për cilësinë e të cilit mburrej gjithë krahina.

Kur vajzat u ngritën për të ikur, Ana vështroi për herë të parë dhe të fundit nga tryeza e gjeologëve. Ajo, ndoshta, nuk do ta kishte kthyer kokën fare, për t'i treguar Senkës se një vajzë është e aftë ta përmbajë kureshtjen, edhe kur është mësuese fshati, por në çastin që po dilnin, ndjeu se nga tryeza e tyre po e shikonin. Ana hodhi vështrimin qetësisht andej, dhe sytë e saj u ndeshën pak më tepër se një sekondë me sytë e vajzës gjeologe dhe diçka më shumë me sytë e njërit prej gjeologëve.

Ajo, ndoshta, as vetë nuk e kuptoi se diçka i kishte bërë përshtypje në atë shikim. Por, kur përjashta Senka e tha më në fund mendimin se Ana ishte dhjetë herë më e mirë se gjeologia, Ana, për habinë e saj, u bë shumë nervoze. Ajo u bë më nervoze se zakonisht në kësi rastesh dhe, për shkak të nervozizmit të saj, që ashtu si çdo gjë tjetër shoqet ia respektonin, rrugën gjer te shtëpia ku flinin, vajzat e bënë pothuajse në heshtje.

## 2.

Duke dalë nga dyqani i kooperativës ku kishte shkuar për të blerë një sapun dhe një pastë dhëmbësh, Ana mendonte se sa gjë e kotë është në fshat që njeriu të ketë padurim për t'u njohur me dikë. Në fshat, edhe sikur të mos duash, edhe sikur t'i shmangesh me një mijë mënyra takimit, prapëseprapë ai do të ndodhë se s'bën. Ja, ishte e treta herë që brenda mbasditës Ana po shikonte grupin e vogël të gjeologëve. Një orë më parë ata i vërtiteshin gjithë habi kasolles-muze të fshatit. Pas pak tre prej tyre shëtitnin ngadalë nëpër rrugën me plepa anash, fundi i së cilës humbiste nëpër fushë. Vajza gjeologe

ekte midis tyre dhe nga larg të jepte përshtypjen se vërente heshturazi gjithçka. Brenda në dyqan Ana kishte parë gjeologun pa flokë, atë që Senka e kishte quajtur shef të ekipit.

Ana po ecte në udhëzën me bar të vyshkur, përskaj rrjetës së madhe që rrethonte fushën e volejbollit, kur vuri re se përpara saj kishte prapë njërin prej gjeologeve. Ai po vinte përballë saj, duke ecur ngadalë, si çdo njeri që porsa ka mbërritur në një vend të ri.

Ana uli fare pak kokën dhe vazhdoi të ecte e qetë. Fshatarët kishin zakonin e mirë që i thoshin «mirëdita» ose «mirëdreka» çdo të panjohuri, mirëpo Ana s'ishte vendase dhe ai mund ta keqkuptonte në qoftë se ajo... Vajzën e nxori nga sikleti vetë i panjohuri. Disa metra përpara se të kryqëzohej me të, ai mbajti këmbët dhe ia bëri asaj më të lehtë përshëndetjen.

— Ju jeni mjeke? — pyeti ai.

Ana qeshi.

— Dukem si mjeke? Jam mësuese.

— Ashtu? Ju pashë pak më parë në mensë. Unë jam gjeolog.

Ishte po ai shikim, që kishte mbajtur pak më shumë se ç'duhej vështrimin e saj në mensë.

— Çfarë kërkon? — pyeti ajo.

— Naftë, — tha ai.

Ishte pikërisht ajo ngjyrë e çelët e veçantë në sytë e tij që i bënte përshtypje. Një e çelët e rëndë, sikur të ishte metalike.

— Naftë, — përsëriti ai. Me njëren dorë preku rrjetën që rrethonte fushën sportive, dhe ky gjest familjariteti nga ana e tij do t'i dukej asaj jo modest, sikur fjalën «naftë» ai të mos e kishte shqiptuar në një mënyrë të veçantë. — Nafta është sot në rend të ditës, apo jo? — shtoi ai duke buzëqeshur.

Ana bëri «po» me kokë. Ajo u bë gati ta përshëndeste për tu larguar, por gjeologu ishte pak i papërqëndruar dhe nuk e kuptoi.

— Është vështirë, — tha ai, sikur t'i fliste vëvetes. — Është tepër vështirë.

Ajo s'dinte ç'të thoshte.

— Në kërkimin e naftës duhet të marrin pjesë të gjithë, — vazhdoi ai. — Jo vetëm ne, gjeologët.

Ana buzëqeshi.

— Po si éshtë e mundur?

Vetëtimthi asaj i shkoi ndër mend se po rrinte pak si gjatë me të vetëm për vetëm dhe aq më tepër në një udhëz pak të mënjanuar.

— Po ja, për shembull, edhe ju që jeni mësuese mund të na ndihmoni, edhe pleqtë e fshatit, edhe plakat qindvjeçare. A ka këtu plaka qindvjeçare?

— Ka, — tha Ana — ka njëqindenjëzetvjeçe.

— Të gjithë mund të ndihmojnë.

Ai e hoqi dorën nga rrjeta dhe e futi në xhepin e pantallonave. Kishte një kostum gri me katrорë fare të vegjël.

— Ju habiteni? — tha ai. — Do t'jua them ndonjë ditë se si. Do të shihemi me siguri prapë.

Ai përshëndeti me kokë, por Ana nuk kishte bërë as dy hapa kur dëgjoi prapë zërin e tij.

— Po si ju quajnë? Unë jam Bardhyl Krasta.

— Ana, — tha ajo. Sytë e saj, ashtu si në mensë, qëndruan pak më tepër se një sekondë në atë gri të rëndë të vështrimit të tij.

Ndërsa largohej prej tij, Ana i bëri hapat e parë me një lloj vrapi të molisur, pastaj dalngadalë iu ngadalësan fare dhe ajo eci mendueshëm ndanë rrjetës së fushës së volejbollit. Gjer në shtëpi rruga i mjaftoi për të sjellë ndër mend prapë fjalët e tij, ngjyrën e syve dhe gjithë pamjen e tij prej burri që i kishte kaluar të tridhjetat, por që mbante akoma një lidhje të sigurt me djalërinë.

### 3.

Gjer në mesin e tectorit në qìell fluturuan patat e egra, duke sajuar atë V-në e tyre të largët, të vetmen shkronjë që dinin qysh prej mijëra vjetësh.

Koha sa vente ftohej. Nga të bërët e ftonjve, pleqtë thoshin se dimri do të bënte i fortë. Gjeologët ikën papritur një mëngjes, ashtu siç erdhën. Një pjesë të veglave i morën me vete, kurse ato më të rëndat i lanë në shtëpinë e Miço Stronit. Kjo do të thoshte se do të ktheheshin përsëri.

Tetori ishte për kooperativën një muaj i ngarkuar. Në të gjithë sektorët bëheshin mbledhje të gjata për rritjen e rendimentit të grurit e të qumështit. Nga Komiteti i Partisë i Rrethit dhe nga Ministria e Bujqësisë vinin ekipe të njëpasnjëshme. Në shtëpinë e kulturës grupet artistike bëheshin gati për të konkuruar në festivalin e rrethit. Muzika s'pushonte gjer në mesnatë. Na shurdhuan, thoshte kryetari i kooperativës por s'ke ç'i bën. Kultura qenka me zhurmë.

Po afronin festat e mëdha të nëntorit, dhe Ana, bashkë me mësueset e tjera, ndihmonin për zbukurimin e sallës ku do të bëheshin mbledhjet, koncertet dhe mbrëmjet e vallëzimit.

Ditët ishin plot mjegull, dhe herë-herë mbi rrafsh-ultën e hapur niste të binte një shi i imët, nën të cilin vrapohej gëzueshëm.

C'tetor i bukur, thoshin fshatarët.

Anës, sa herë që kalonte pranë fushës së volejbollit, i kujtohej biseda me gjeologun, ose më mirë jo vetë biseda, por një përshtypje e mirë, mbetur prej saj. Ajo ishte e papërcaktuar, gati-gati e bërë njësh me gjethet e zverdhura që mbushnin udhëzën dhe që dukeshin aty si të përjetshme.

Ana nuk e kishte quar shpesh mendjen te gjeologu. Vetëm në mbrëmje, kur ato dëgjonin muzikë nga një radio-transistor dhe ajo, gjatë rrrotullimit të butonit, ndeshte në ndonjë stacion që fliste për krizën botërore të naftës, gishtat e saj vetvetiu e mbanin butonin aty.

#### 4.

Kriza e naftës kishte mbërthyer gjithë botën. Çmimet rritheshin çdo ditë në mënyrë katastrofike. Në të gjithë

tha intrigat e Lindjes së Mesme dhe në rrezikun e një lufte të re midis vendeve arabe dhe Izraelit kërkoheshin shkaqet e naftës.

Asnjëherë s'kishte ndodhur që një pjesë e shqetësimit botëror të mbështillej kështu rrëth një lëngu të zi, rezervat më të mëdha të të cilit ndodheshin nën Sahara.

Në ekranet e TV-ve dukeshin rrugët e Romës dhe të Amsterdamin të shkretuara nga makinat. Mbreti Fajzall i Arabisë Saudite, një nga kryevendet e naftës, qe vrarë aksidentalish nga nipi i tij i çmendur. Ndërsa lexonin lajmin, spikerët dukej sikur thoshin: duhet të jeni tepër budallenj që të besoni këtë aksident. Fytyra e sulltanit të vdekur, në ekranet e TV-ve dukej e frikshme.

## 5.

Ana e takoi Bardhyl Krastën atje ku s'e priste: në dasmë.

Stina e dasmave kishte qenë e lodhshme për mësueset, sepse dasmat atë vit kishin qenë të shpeshta dhe fshatarët i ftonin ato në të gjitha.

Ai iu duk asaj pak më i hequr dhe si i nxirë nga dielli.

Dasma, si çdo dasmë fshati, ishte e rrëmujs~~h~~me e plot nerv. Gjëja më e lehtë në të ishte të gjendeshe e mënjanuar me njeriun që të pëlqente.

Ana me Bardhyl Krastën u gjendën shumë shpejt përbri njëri-tjetrit.

— Si shkuau kërkimet? — pyeti ajo.

— Jo keq, — tha ai. Megjithëse buzëqeshte, vështrimi i tij kishte po atë peshë metalike, ashtu siç e kishte kujtuar ajo gjatë mungesës së tij. — Kjo është një zonë e re kërkimi dhe ka mjaft vështirësi.

Rrotull tyre, si një mur, ishin të gjitha zhurmat dhe lëvizjet e një dasme, por ato nuk i bezdisnin aspak, përkundrazi, Anës iu duk se pikërisht rrëmuja e dasmës

krijonte midis tyre një ndjenjë afërsie, që s'do të ishte në gjendje ta krijonte as parku më i veçuar.

— Këtu është mbledhur pothuajse gjithë fshati, — tha Ana. Ju më pyetët atë ditë për pleqtë. Ju kujtohet?

— Sigurisht që më kujtohet, — tha ai.

Asaj i pëlqente mënyra e prerë me të cilën ai i përgjigjet. Herë-herë pranë tyre dikush i binte dajres.

— Ajo plaka njëqindenjëzetvjeçare nuk ka ardhur, — tha Ana pas pak, kur iu duk se biseda e tyre po fikej.

Ai vështroi mizërinë e njerëzve dhe në sytë, midis vetullave, dukej sikur kishte përndritjen e një mendimi.

Midis një rrethi dasmorësh dy pleq të rreshkur po kërcenin një valle dyshe. Ishte një valle e vjetër, e ngadaltë pleqsh, ku mosha, dhembja e kockave dhe reumatizmi ishin marrë të gjitha parasysh. Pleqtë kërcenin me ca ftyra krejtësisht serioze, pa e vështruar fare njëri-tjetrin. Herë-herë ata ngjanin si dy rrënje të vjetra, të shkulura nga toka, që era po i sillte rëndshëm vërdallë në formë valleje.

— Pikërisht për kërkimet në këtë zonë kemi pasur diskutime të rrepta, — tha ai, sikur të vazhdonte një bisedë të lënë përgjysmë.

Sic duket, gjithë ditën e ka mendjen te nafta, mendoi Ana.

Ajo priti një copë herë gjersa ai foli përsëri. Por në rrëmujën e dasmës heshtja midis njerëzve ishte më e përballueshme se kudo.

— Shumë diskutime, — tha gjeologu. Ai ktheu kokën papritmas dhe ajo pa sytë e tij afër syve të saj, jo më shumë se njëzet-tridhjetë centimetra larg.

Pleqtë vazhdonin të kërcenin po aq hijerëndë si dhe më parë. Vende-vende vallja dukej si e ngrirë nga një ngërç, po kjo e bënte atë dhe më të vërtetë.

— Për të kërkuar naftën nuk mjaftojnë vetëm formulat që kemi mësuar nëpër shkolla apo akademira, — vazhdoi ai. — Përpara se të hapja librat, kërkimin

e naftës unë do ta filloja pikërisht nga këta pleq, — dhe ai tregoi me kokë valltarët.

Ana e vështroi gjëzueshëm me bisht të syrit.

— Ju e thatë këtë gjë edhe atë ditë, — tha ajo. Për një grimë sytë e saj u ngulën mbi të sikur të pyesnin «për ç'ditë bëhet fjalë?». Anës iu duk sikur edhe pak dhe do të skuqej. — Por unë nuk e kuptoj kurrsesi... — vazhdoi.

— Keni të drejtë, — tha ai, pa i hequr sytë nga pleqtë që kërcenin. — Keni të drejtë, — përsëriti pas pak, sikur të fliste me vete.

Sikur shpërqëndrimi i tij të vazhdonte edhe pak, Ana e ndiente se mund të fyhej lehtazi, por ai, sikur të gjente papritur fillim e mendimit, nisi të fliste me vrull. Ana e dëgjonte me vëmendje. Vetullat e saj ishin harkuar lehtë nga njëfarë habie.

Përreth zhurmat e dasmës mbështillnin butësisht gjithçka. Pleqtë e kishin mbaruar vallen. Një grup grash këndonte një këngë të vjetër:

*Vetullat e tua si akrep sahati  
Pse më rri e vrenjtur, pse s'të del inati...*

— Në qoftë se ti je gjeolog i naftës, — thoshte ai, — para së gjithash duhet të jesh i ndërgjegjshëm se po kërkon diçka që ka lidhje me jetën e popullit tënd. Si e tillë, s'mund të jetë jashtë vëmendjes së popullit. Po si ta gjesh një gjë të tillë?

Ajo bëri një lëvizje supesh si për të thënë: «pikërisht këtë s'e kuptoj unë».

Bardhyl Krasta buzëqeshi gati pa e vështruar Anën.

— Këtu është puna, — tha. Populli s'ka bërë traktate shkencore, ku të jenë regjistruar vëzhgimet e tij, megjithatë ai ka bërë vëzhgime mbi gjithçka. Asgjë s'i ka shpëtuar syrit të tij.

Ana pohoi me kokë.

*Hapi sytë e zes, të na sjellç beharë...,*  
yazhdonin të këndonin gratë. Kozmai pëpiqej t'i shqëronte me fizarmonikë.

— Por, në qoftë se s'ka bërë traktate shkencore, ai i ka lënë vëzhgimet e tij në gojëdhënët, këngët, madje edhe në përrallat, që mund të duken si gjëja më antishkencore, — vazhdoi gjeologu. — Ju dukem si fantazist?

— Jo, aspak, — tha Ana.

Vështrimi i saj kapi vetëtimthi sytë e Senkës, që po e vështronin që larg. Kushedi ku i vete mendja asaj, tha me vete.

— Në qoftë se në një gojëdhënë thuhet, për shembull, se ajo tokë ose ai pellg ishte i magjepsur nga shtrigat dhe atje digjej një flakë ditë e natë, dysho se mund të kesh rënë në gjurmët e një zone të vjetër nafte, ose gazi, — shpjegoi ai.

Kënga e shtruar grarishte, pasi mbushte tejpërtej shtëpinë, dukej sikur shtynte muret, thua se donte t'i hapte krejt.

— Ndryshe nga kromi ose hekuri, nafta i ka sinqerat e saj të dukshme si pishtarët në errësirë, — vazhdoi ai. — Megjithëse një shok më ka treguar se edhe pér zbulimin e një rezerve hekuri ka ndihmuar vëzhgimi popullor.

— Ashtu? — ia bëri Ana. Vështrimi i Senkës kishte filluar ta shqetësonë pak.

— Ishte një vend në Veri që quhej dikur Logu i Vetëtimave. Fushë djerr, pa pemë, pa kurrgjë e, megjithatë, vazhdimit në të binin rrufetë. U dyshua pér një rezervë minaral hekuri dhe ashtu doli vërtetë.

— E çuditshme, — tha Ana.

Midis dasmorëve asaj i zuri syri gjeologët e tjerë. Ajo vajza ishte midis tyre.

— Ja dhe shokët tuaj, — tha Ana duke i treguar me kokë.

Ai vështroi andej, por nuk tha asgjë.

Ana deshi ta pyeste pér vajzën gjeologe, por i erdhi zor.

Gjatë rrëmujës së dasmës ata u ndanë dhe u takuan disa herë. Natën vonë, kur bashkë me shoqet shkonin pér në dhomën e tyre, Anës i kujtoheshin co-

pa nga bisedat me tē. Ato notonin nē kujtesën e saj qetësish, pa ritëm, si ca degë tē hedhura rastësish nē ujë.

Nata ishte e ftohtë, me ca yje tē largëta, tepër tē vogla. Ai i kishte thënë se kishte ndër mend tē bisedonte me pleqtë e fshatit pér t'i pyetur ç'mbanin mend ata ose ç'kishin dëgjuar brez pas brezi pér rrëshqitjet e tokës, pér lëkundjet sizmike, ose pér ngjarjet pas tërmëteve. A kishte, pér shembull, ndonjë gojëdhënë ose përrallë ku tē thuhej; pas tërmëtit, një erë e rëndë mbyti dheun. Ky është gazi i naftës, i shpjegonte ai, dhe një gjeolog që kalon me mospërfillje pranë një fakti tē tillë, është ose idiot ose armik. Pikërisht, pér zonën ku ata ndodheshin kishte pasur mjaft debate: ka apo s'ka naftë. Sidomos debatet kishin qenë tē ashpra me grupin e sabotatorëve, përpara se ata tē demaskoheshin. Sabotatorët mbronin mendimin e vjetër tē specialistëve tē huaj që naftë s'ka. Tani duhej vërtetuar e kundërtë.

Të gjitha këto i përziheshin Anës nē kokë me këngët e grave, me zhurmat, dollitë, fizarmonikën e Kozmait dhe me vështrimet e Senkës. O, le tē mendojnë q'të duan, tha ajo me vete.

Para se tē flinte, nē mendje i rrinte një fushë e errët, e vjetër, nē shekullin e dymbëdhjetë ose akoma më larg, nē shekullin e shtatë, mbi tē cilën digjeshin ca zjarre tē largëta. Pastaj Logu i Vetëtimave, i ftohtë pamister, mbi tē cilin vetëtimat nguleshin si shigjeta tē kuqe mbi një hartë: këtu ke krom. Asaj iu kujtuan, kushti pse, lapsat e kuq, që drejtori i shkollës kishte zakon t'i mbante me shumicë mbi tryezë, dhe fjeti sakaq.

## 6.

Ana po kthehej nga stallat e kooperativës, ku kishte shkuar pér tē ndihmuar mjelëset, që tē zbuluronin këndin e kuq. Dita ishte e ftohtë, me një ajër tē tejdukshëm, që mund ta ndeshësh vetëm nē stinën e vjeshtës. Shyqyr që vesha çizmet, tha ajo dy tri herë me

vete. Ndërsa përshkonte truallin që ndante stallat nga rruga kryesore. Nga shirat e fundit rrrotull stallave ishte bërë llucë e madhe.

Tek ecte nëpër xhade, Ana ndihej e gjezuar. Nga tokat e punuara bojëkafe ngrihej një avull i lehtë, i ngjashëm me avullin që sajonte frymëmarrja e saj. Anës iu kujtua se pothuajse në shumë tregime që btoheshin pér fshatin në shtypin letrar, përmendej gjithmonë ky avull i tokës. Madje ajo kishte përshtypjen se nja dy-tri romane fillonin pikërisht me të dhe, po të mos kish-te jetuar këto dy vjetët e fundit në fshat, asaj do t'i dukej kjo gjë një përsëritje e mërzitshme. Mirëpo kishte ca kohë që Ana e ndiente se kjo frymëmarrje e lehtë e tokës hynte në gjërat që nuk i bëheshin kurrë të mërzitshme njeriut.

Aty-këtu ndanë xhadesë dukeshin lopë të racës hollandeze, bojëkafe edhe ato, si toka. Pllangat e bardha mbi lëkurën e tyre lodronin afër e larg. Ana kishte parandjenjën e diçkaje të mirë.

Ajo e takoi Bardhyl Krastën më tutje, pranë mullarëve të barit. Ai kishte qëndruar ndanë rrugës, me këmbë pak të hapura dhe pinte cigare.

— Mirëmëngjes! — tha ai. — Ç'kohë e bukur, apo jo?

— Mirëmëngjes! — u përgjigj Ana gjëzueshëm, — ç'po bënët këtu?

— Kot, — tha ai. — Po shëtisja.

Nga mullarët vinte një erë e mirë kashte të lagët. Kudo mbi fushë kishte zogj dhe Ana u habit si nuk i kishte vënë re më parë.

— Unë isha te stallat, — tha ajo. — Do të ktheheni në fshat?

— Po, — tha gjeologu. Dhe filloj të ecte përbri saj. S'ju kam parë kaq ditë, — tha pas pak.

— As unë.

Një copë rrugë e bënë pa folur. Ai fuste e nxirrte duart nga xhepat sikur të kërkonte diçka; dhe ajo ndjeu një lloj gjëzimi, sepse ky gjest iu duk tëpër i ri. Mirëpo

më tutje ai nxori vërtet diçka nga xhepat. Ishin një tufë fletësh.

— Kam këtu ca shënime, — tha, duke i tundur. — Ju kujtohet që ju kam thënë se dua të bisedoj me pleq-të e fshatit?

— Po, — tha Ana. Në mendjen e saj u skicuan rrufeshëm pesë vetëtima që zgjateshin drejt tokës si shigjetat mbi një hartë. — E çfarë? — ia bëri ajo. — Nuk jeni i kënaqur?

Ai tundi kryet:

— Përkundrazi, jam shumë i kënaqur.

— Po atëherë ç'keni? — deshi të thoshte ajo.

Ai mbajti këmbët.

— Lexojini vetë, — tha dhe i zgjati fletët. — Unë e kam shkrimin të kuptueshëm.

Ana i mori fletët; shkrimi ishte vërtet i kuptueshëm. Ata nisen të ecnin përsëri, fare ngadalë dhe gjatë ecjes Ana filloi të lexonte:

«Mbi lëvizjet e Tokës sipas teorisë së Valden-Mejerit. Mbi ndërrimin e shtratit të lumit N. Ndërrimi i fundit në mbarim të shekullit XIX. Patra Baltaj, 120 vjeçë, e mban mend lumin e vjetër. Patra Baltaj: E mbaj mend posa, isha e fejuar atëherë. Ishte lumi i gjallë, kishte ujë. Mos më lër të gënjej. Jam e sigurt si vdekja. Një shoqja ime, vajzë si unë, u mbyt në të. Pastaj, si e mori atë, lumi erdhi e u hollua, u fishk. Mos më lër të gënjej, se jam plakë. Pastaj lumi seç bëri me detin. Seç u morën vesh, s'e di. Kishin punët e tyre. Ndërrroi udhë e s'erdhë më këndej. Mos më lër të gënjej.

Miço Stroni, 81 vjeç, përsëri për lumin N.: Lumi ka ndërruar katër herë shtrat. Ti pyet pse? Shumë dijetarë janë përpjekur të shpjegojnë pse, po s'e kanë gjetur dot. Dhe kót vrasin mendjen. Dëgjomë mua plakun: asnjë lumë në botë nuk është ndërron shtratin kot. Duhet të ndodhë një gjëmë e madhe, një mynxyrë që lumi të ikë nga shtrati i vet, si njeriu nga shtëpia e vet. Lumi ynë kthehej sa në një krah në tjetrin, si njeriu që rrötullohet në gjumë. Dhe si të mos kish siklet, o bir.

Jeta jonë ishte mynxyrë e shkuar mynxyrës. Nga bejlerët e agallarët dhe ujët mori llaftarinë, pale pastaj njerëzit. Ja, kështu, o bir, mos e vra mendjen kot ta gjesh pse lëvizi lumi. Kjo është e s'ka tjetër».

Ana vazhdonte të lexonte, ndërsa përbri saj, si nga larg, vinin zhurmat e lëvizjeve të tij: nxjerrja nga xhepi i paketës së cigareve, gjëmimi i beftë i shkrepësës.

«Miti Kënetasi, 93 vjeç: Thonë se në zhukat dhe pellgjet e kënetës së kripur, vërtitej netve si zjarri i hedhur hobe shpirti i Hill Rrogozit, kur u ngrit lugat pas gjithë atyre alameteve që pa nga Xheladin beu. U vërtit, u vërtit herë më një anë të kënetës herë më tjetrën, gjersa u lodh e u shua.

Patra Baltaj: Mos më lër të gënjej se jam plakë. Jam shumë plakë. S'më njohin më kuajt. (I mban mend turqit, austriakët?) Posi, i mbaj mend. Ishin me gjuhë të tjera, me ca si vija jeshile. (A kërkonin gjë në tokë?) Kërkonin, posi. Sytë përdhe i mbanin gjithmonë. Mortjen kërkonin. Mos më lër të gënjej. Jam shumë plakë. As buka s'më hahet më. Dua vetëm kafe. (Po sovjetikët i mban mend?) Kruçofi? Ishte i shkurtër si helmi. Edhe ai si të tjerët qe: me gjuhë të tjera, me vija. (Pyetjes përujë të zi që del nga dheu apo pér gjak të zi bajlozash a kulçedrash). Gjak i zi rrodhi kur u vra në zhukat Xheladin beu. Dhe një erë e keqe si murtajë.

Trifon Janku, vjeç 69, ish-anëtar i Këshillit Nacionalçlirimtar, pér vdekjen e Xheladin beut: Xheladin beu erdhi nga fusha me treqind ballistë, rrëthoi fshatin. Ishte ditë me shi. Trokisinin derë më derë. Muarr gjithë anëtarët e këshillit. Na çuan në Bunacë, te zhukat. Ju jeni këshilltarë, na thanë, populli ju dëgjon. Hiqini njerëzit nga lufta. Nuk i heqim, ju thamë. Xheladin beu qëlloi i pari. Ra kryetari i këshillit. Pastaj automatiku punoi mbi të gjithë. Ishte tre-katër hapa larg. Ramë të gjithë. Jaka e kapotës më ra në fytyrë. Naum Kerrit i shtinë pér herë të dytë, kryetari ra përmbyss. Unë gjithashtu. Naumi ra në shpinë. Ai shau, i shtinë prapë».

Ana ngriti sytë nga letrat dhe vështroi gjeologun.

— Ç'tregim i tmerrshëm! — tha.

Ai nuk u përgjigj dhe vazhdoi të thithë cigaren. Ana lexoi më tutje.

«Muarrëm vendim të vrashim Xheladin beun. E zume bashkë me rojet. E çuam në Bunacë, te zhukat. E njeh këtë vend? — i thamë. Ishte dyllë i verdhë. Dhe koha ishte po ajo: pus. I hodhëm trupat në një gropë me llucë. Gjithë bejlerët u tèrbuan. Kérkonin çpagim. Gjaku i beut lahet nga shtatë vjeç e lart, tha bejleresha e ve. Filluan vrasjet e djegjet e fshatrave. Dhjetë vjet më parë gjaku i beut lahej më shtrenjtë: tre vjeç e lart, meshkujt. Pesëdhjetë vjet më parë akoma më shtrenjtë: një vjeç e lart, meshkuj e femra bashkë. Kurse më dyzetetrenë çmimi ra: një me një».

Këtu mbaronin shënimet: Ana ia zgjati atij. Ishte e tronditur dhe i dukej se kishte ftohtë. Ai hodhi ciganen dhe ndezi një tjeter.

— Siç e shikoni, kérkojal të dhëna për naftën dhe ndesha në luftën e klasave, — tha ai.

Ajo tundi kokën në shenjë pohimi. — Ajo është kudo, — tha ai, — dhe asgjë s'mund të jetë jashtë saj. As nafta.

Ata vazhdonin të écni nëpër xhade, ndanë tokave të lëruara. Herë-herë Ana vështronë rrëshqitazi ravigjëzimin e prerë të mollëzës së tij. Ndanë xhadesë, atje ku nuk shkelnin rrotat e makinave, kishte një shtresë gjethesh të rëna. Gjethet që kishin rënë ditët e fundit, dallohenë nga të vjetrat, që qenë nxirë e po kalbeshin.

— Më 1961, në fillimin e bllokadës, isha student në vitin e fundit dhe bëja stazhin si gjeolog pranë specialetëve çekë dhe sovjetikë.

Ndërsa fiste, ai vështronë drejt përpara dhe ajo ndjeu një dëshirë të vëtvetishme të mbështetej pas krahut të tij. — S'më harrohet ajo ditë e parë pas ikjes së tyre, kur morëm në dorëzim dokumentacionin që ata ishin të detyruar ta linin këtu. Në të gjitha dosjet dhe hartat kishte fletë të shqyera.

— C'gjë barbare! — tha Ana.

— Për ta ishte një gjë e zakonshme, — tha ai. — Ishte në logjikën e gjithçkaje që ata ndërmorën kundër nesh.

Ana vështron te shenjën që kishte lënë nikotina midis dy gishtave të tij, dhe dëshira për t'u mbështetur pas atij krahu erdhi e u shndërrua në një hapësirë të këndshme, që i qëndroi mu midis gjoksit, duke shtyrë lehtazi anash brinjët që po e pengonin.

Ana e ndiente se duhej t'i thoshte edhe ajo diçka. Gjatë gjithë kohës që po ecnin, kishte folur vetëm ai. (Në ndërgjegjen e Anës, shënimet që porsa kishte lexuar ishin shndërruar në fjalë të tij). Në të vërtetë, Ana duhej të thoshte diçka. Ajo jetonte këtu që prej dy vjetësh dhe duhej t'i ndihmonte çdokujt që interesohej për zonen rrëth e rrötull, e aq më tepër atij... aq më tepër atij.

— Këtu pranë, jo shumë larg prej këndejej, është një famulli e vjetër, — tha ajo akoma e pasigurt se po tregonte diçka për të qenë. Ai vështroi në drejtimin që tregoi ajo, në pjesën perëndimore të fushës, atje ku niste papritur një zonë gjysmë malore. — Para tridhjetë e ca vjetësh në atë famulli ka ndodhur një krim i tmerri.

— Ashtu? — ia bëri ai.

Të gjithë të ardhurve ua tregonin atë krim. Ishte kureshtia kryesore e zonës.

Ana vetë e kishte dëgjuar qysh në ditën e dytë të qëndrimit të saj dhe i qe ngjethur mishtë. Përveç vdekjes së frikshme, ai krim kishte brenda enigmën. Shkaku i krimit kishte mbetur krejtësisht i pashpjegueshëm. Vrasësit gjithashu. Thuheshin shumë gjëra, por të gjitha ishin hamendje.

— Pak e çuditshme, — ia bëri ai, kur Ana mbaroi së treguari.

— E tmerrshme, apo jo, — tha Ana, duke u përpjekur të kuptonte nga sytë e tij nëse i bëri apo jo përshtypjen e duhur.

— Po, — tha gjeologu. — Sigurisht që ngjarja është

e tmerrshme, aq më tepër që ka mbetur e pashpjeguese shme.

— Nuk éshtë larg që këndej, — tha Ana. — Jo më tepër se gjysmë orë më këmbë. — Ajo tregoi prapë me dorë në atë drejtë ku dukeshin kodrat. — Éshtë një vend i zymtë. Një humbëtirë e vërtetë.

Ai vështron te andej. Kodrinat shkëmbore gjysmë të zhveshura nisnin papritur. Në përvijimin e tyre të prerë, të dhëmbëzuar, kishte një lloj kërcënimi. Apodoshata atij iu duk kështu nga shkaku i tregimit të Anës.

Ata po i afroheshin qendërs së fshatit. Përbri tyre herë pas here kalonin qerre me rrota të larta, prej së cilave fshtarët përshëndesnin me zë të lartë.

— Do të doja të shikoja vendin ku ka ndodhur ngjarja, — tha ai pas pak. — A shkojmë ndonjë ditë bashkë?

— Me gjithë qejf, — u përgjigj Ana. Vetëtimthi në mendje i shkrepëtiu pyetja: ai donte të shkonte atje se e intrigoi vërtet ngjarja, apo se kishte dëshirë të shëtiste me të. Ajo filloi të fliste me atë lloj lehtësie, që éshtë i aftë tia japë bisedës vetëm gjëzimi.

— Famullia éshtë akoma atje. Éshtë shumë e vjetër, e shekullit të trembëdhjetë, ose katërmëdhjetë dhe vendi përreth éshtë aq i pikëlluar, saqë të krijon një angushti në shpir. Ju do ta shikoni vetë dhe do të më jepni të drejtë.

— Ndoshata pasnesër mbasdite do të jeni e lirë? — pyeti ai.

Ana u mendua një hop.

— Më duket se po, — tha. — Po, pasnesër kam vetëm katër orë mësim dhe mbasdite jam e lirë.

Ata e lanë të takoheshin rrëth orës tre, përbri fu-shës së volejbollit.

Pa arritur në qendrën e fshatit, ata panë që larg një grumbull njerëzish përballë shtëpisë së Miço Stronit. Kur u afrouan edhe pak, vunë re se njerëzit po bënin sehir. Nga një qerre me rrotat gjithë baltë, që kishte

ndalur pranë portës, po shkarkonin me kujdes një gjë të bardhë, vezulluese.

— Makinë larëse, — tha Ana, duke e kapur Bardhylin për bërryli. Zëri i saj ishte i ulët dhe vështrimi qe i tillë, sikur të shikonte një mrekulli.

Ai vështronte se si fshatarët i vinin rrotull makinës larëse, e vërenin me butësi, dhe buzëqeshjet e tyre pas-qyroheshin paksa të ndryshuara mbi sipërfaqen e emaluar të saj.

— Një fshatar që i blen gruas së vet makinë larëse, — tha Ana me zë të ulët. — E kuptioni se ç'do të thotë kjo pér një zonë të tillë, që ka qenë nga më të prapmbeturat e Shqipërisë?

Ai e shoqëroi gjer afér shkollës dhe ajo, duke përfituar ngaqë ecnin përbri dhe nuk ishte e detyruar ta vështronte në sy, i tha se akoma disa vjet më parë kishte fshatarë që mendonin se, t'i bleje gruas një makinë larëse, ishte njëlloj si ta shtyje atë të shndërrohej në një spitullane. Ajo e ndjeu se u skuq fare lehtë kur i tha ato fjalë dhe, ndërsa hynte në ndërtesën e shkollës, pasi u nda prej tij, mëndoi se sidoqoftë nuk ishte mirë që biseda e tyre u mbyll me to.

## 7.

Të shtunën Ana u kreh më gjatë se zakonisht përpara pasqyrës. Në kontakt me flokët, lëvizjet e duarve të saj bëheshin pérherë e më të ngadalta, thua se flokët u kalonin duarve, ashtu si edhe mendimeve të saj, një farë statizmi. Ana e ndiente se mendimet e saj kishin mbetur në një pikë dhe ajo s'bënte asnjë përpjekje për tu zgjuar nga kjo përgjumje e këndshme.

— Pér ku përgatitesh kështu? — tha Senka, që por-sa hyri.

Ana hoqi një karficë që e mbante midis dhëmbëve dhe i tha se do t'i tregonte njërit prej gjeologëve famullinë e vjetër.

— Aha, bia bëri Senka. Në sytë e saj, përveç kureshtjes, u lagëشتua një lloj pikëllimi.

Ana e përshëndeti dhe doli.

Jashtë nuk ishte ftohtë. Ndriçimi i mbasdites i bënte edhe më të largët plepat e zhveshur. Diku anash, si në një botë tjetër, binte boria e një makine. Ajo ishte e ulët, si pëllitje e një lope. Bardhyl Krasta vente e vinte ngadalë tek udhëza pranë fushës së volejbollit. Ai e pa që larg dhe qëndroi pa lëvizur.

— U vonova? — tha Ana.

— S'e besoj.

— Famullija nuk është larg, megjithëse nuk është dhe kaq afër.

Ajo u kujtua se po fliste gjëra që i kishte thënë një herë, megjithatë iu duk më mirë të thoshte gjëra të përsëritura, sesa të ecte në heshtje. Ai kishte në buzë një cigare, që asaj i dukej si e shuar. Herë pas here, përballë tyre, kalonin qerre me rrata të larta, gjithë baltë. Fshatarët i përshëndetnin prej tyre me zë të lartë, të kthjellët dhe, sa herë që ndodhët një gjë e tillë, asaj i lehtësohej njëfarë ankthi i lehtë, fare i lehtë, që ajo, pa e kuptuar as vetë, e kishte pasur gjithë atë mëngjes.

## 8.

Kur Ana u kthyte në mbrëmje te shoqet, nga fytyrat e tyre e kuptoi se ato kishin biseduar për të. Kjo dukej fare qartë nga sytë që ato i drejtonin herë në një faqe muri, herë në tjetrën, sikur atje të ishin shfaqur kushedi çlloj zhapinjsh.

Në të vërtetë, gjysmë orë përparal se të mbërrinte Ana, Kozmai i shtëpisë së kulturës, i cili porsa që kthyer nga qyteti me makinën e kryetarit të kooperativës, u kishte treguar vajzave, se e kishte parë Anën tek ecte përqafuar ndanë xhadesë me njërin prej gjeologëve. Mandej Kozmai tregonte se nën dritat e makinës, kishte

dalluar fare qartë jo vetëm krahun e Anës, mbështetur pas mesit të tij.

— C'është e vërteta, dukeshin bukur, — tha Kozmai. — Singerisht e them. Kishe qejf t'i shikoje. Kulturë, more vëlla.

Ai foli një copë herë, duke vështruar herë njëren mësuese, herë tjetrën.

— Po ju ç'keni kështu? — ia bëri ai.

Në të vërtetë ato s'thanë asgjë dhe Kozmai nuk e kuptoi se kjo vinte ngaqë s'kishin ç'të thoshin, apo se nuk donin të flisnin përpara tij. Ai foli një copë herë gjëra që s'kishin lidhje me Anën, tregoi se si ishte grindur në qytet me shefin e arsim-kulturës, si kishte parë një dyqan ca basketballistë të gjatë dhe se si, më fund, një shoku i tij i kishte thënë se së shpejti do të shiteshin motoçikleta të një tipi të ri. Duke e ndier se asgjë nga ato që tregoi nuk zgjoi as kureshtjen më të vogël të tyre, ai e përfundoi të folurën duke thënë parit, gati me pshërëtimë:

— Ra dhe Ana.

Megjithëse vajzat përséri nuk thanë asgjë, ai e ndjeu se me ato fjalë kishte shprehur atë që kishin ato në kokë. Madje atij iu duk se ato fjalë nuk i mendoi ai, por i pa të shkruara në sytë e tyre. 

Kishin qëndruar te rruga përpara shtëpisë ku ato flinin, dhe era e kashtës së lagur të një mullari të përgjysmuar dukej sikur sillte me vete që larg, të përziera në një mënyrë të papërsëritshme, gjëzim, pikëllim, dritë hëne dhe lagështirë vjeshte.

Hapat e Kozmait që po largohej bënин plaq-plaq nëpër pelljet e vogla. Në atë zhurmëri dukej sikur ai merrte me vete diçka nga shoqja e tyre. Ana, krenaria e tyre, më e pashmja, më seriozja, ajo që besonin se nuk do të binte kurrë në gabime...

Ato u futën në dhomë po mullari i lagët dërgonte gjer aty erën e tij, atë aromë të papërsëritshme, nën të cilën edhe lumturia, edhe pikëllimi ndiheshin më shumë dhe më shtruar.

Duke lëvizur butonin e radio-transistorit, dora e

Senkës, kërkonte muzikë. Por asgjékundi s'gjendej tamam ajo muzikë që kërkonin ato. Në një nga stacionet në një gjuhë neolatine, ato dëgjuan fjalët «kriza e naf...», por Senka lëvizi butonin me shpejtësi, madje me njëfarë nervozizmi.

Në atë kohë kishte hyrë Ana.

— Po ç'keni kështu, sikur ju janë mbytur gjemité, — tha ajo.

Papritur sytë e Senkës u rrëmbushën nga lotët. Ishin ca lotë të kthjellët, të lirshëm, të nevojshëm e të kotë njëkohësisht. Po na u mbyte ti, moj Ana, dukej sikur thoshte ajo. Ana, sikur ta kishte kuptuar ç'kishte tjetra në mendje, buzëqeshi.

#### 9.

Katër ditë më vonë Bardhyl Krasta u nis vetëm për në famullinë e vjetër. Ai e bëri rrugën me një shpejtësi të jashtëzakonshme, apo ndoshta iu duk kështu ngaqë gjithë rrugës iu vërtitinë në kokë gjithfarë mendimesh. Të gjitha ato lidheshin me krimin që kishte ndodhur atje. Gjithë ato ditë kishte vrarë mendjen për të, dhe të gjitha mendimet për Anën lidheshin në njëfarë mënyre me të.

Kur fusha mbeti prapa dhe ai nisi të ekte nëpër një rrugë me gurë të vegjël, që ngjitej midis kodrinave shkëmbore, sytë i shkuar rastësisht në këmbët e pantallonave, dhe, nga spërkatja e tyre me baltë, kuptoi që kishte ecur me një shkujdesje të pafalshme. Rruga dredhonte rrëzë shpateve të thikëta dhe nganjëherë, prej këtyre shpateve, pamja mbyllej në mënyrë të beftë, saqë të krijohej përshtypja se ndodheshe në një humbëtirë të largët. Nuk të besohej kurrsesi që vetëm disa kilometra larg ishte fusha e gjerë plot zhurmë dhe njërez.

Nga të dyja anët çoheshin bokërima të pikëlluara, plot gurë dhe shkëmbinj të vegjël, që dukej larë midis shegëve të egra. Zbardhimi i tyre ishte i shterpët, si çdo gjë përreth.

Mbeturinat e famullisë ngriheshin në një pllajë të mbuluar me kaçuba dhe guralecë të rrallë. Famullia ishte e shekult XIII. Forma primitive në trajtë romboide e pjesës së ruajtur të saj, me atë ndriçimin paksat të kuqërremtë përsipër, krijonte idenë e diçkaje të stërlashtë, shumë tepër se çmund të krijonte këtë ide një rrënojë gri. Edhe qetësisë ai ndriçim i jepte një thellësi të veçantë. Këtë gjë Bardhyl Krasta e kupto kur u kthye befas, sikur të dëgjonte pas vetes një zhurmë. Dreq, tha me vete. Ishte druri i vjetër i një arre, kurora e së cilës përkulej gjer pranë qemerit të gurtë të portës së famullisë. Në krahun e djathtë të portës ishte ngjitur një tabelë metalike, ku ishte shkruar me shkronja kapitale: «MONUMENT KULTURE. MBROHET NGA SHTETI». Ja, këtu, i kishte thënë Ana duke i treguar pragun prej guri, është gjetur i vrarë rojtari i famullisë.

Një copë herë Bardhyl Krasta qëndroi pa lëvizur. Pastaj, duke ecur me kujdes, sikur kufoma të ishte akoma aty dhe ai po mënjanohet që të mos e shkelte, kaloi nën qemer dhe hyri brenda. Muret i jepnin qetësisë një përmasë të re. Nga një e çarë e kubesë ndriçohet suvaja e vjetër, e shkalafitur vende-vende dhe rrasat e çrrëgulla me të cilat qe shtruar trualli. Në murin anësor ishte barelievi. Bardhyl Krasta u afrua dhe qëndroi përparrat tij. Në shpinë ndiente lagështirën e ftohtë. Ja pra, barelievi i famshëm, tha me vete. Për shkak të tij, me sa duket, ishte bërë dhe krimi. Tani që ishte vetëm, po i dukej ndryshe. Në përgjithësi, sot çdo gjë i dukej ndryshe në krahasim me katër ditë më parë, kur kishte qenë këtu bashkë me Anën. Siç dukej, prania e saj ia kishte lehtësuar gjithçka. Ai e kishte ndier këtë dhe, ndoshta, ky ishte edhe shkaku që ishte nisur të vinte i vetëm.

Barelievi nuk ishte i madh. Rreth nëntëdhjetë centimetra me tetëdhjetë. Pjesa e dëmtuar ishte në krahun e majtë. Ai e afroi kokën për të parë më mirë. Në mburojën e njërit prej të dy luftëtarëve që skulptori kishte gdhendur përbri njëri-tjetrit, ishte thërrmuar ose shkulur një copë pak më e madhe se grushti. Go-

ditja duhej të ishte bërë me një qysqi të mprehtë dhe prej një dore mjeshtri, sepse prerja ishte pak a shumë e rregullt. Ndoshta ishte bërë me po atë qysqi me të cilën është kryer edhe vrasja, mendoi ai. Dhe po në atë çast, për të qindtën herë, përsëriti pyetjen: po pse?

Ai ngriti kokën tek e cara e kubesë, pastaj vështroi me radhë muret, sikur të përpinqej të merrte me mend se nga ç'anë kishin hyrë brenda vrasësit ose vrasësi.

Qysh nga dita kur kishte qenë këtu me Anën, kishte menduar vazhdimisht për krimin. Në të vërtetë, kur Ana ia kishte përmendur për herë të parë, ai nuk kishte pasur ndonjë interesim kushedi çfarë për të. Madje ai kishte ardhur gjer te famullia jo për të parë vendin e krimit, por thjesht nga dëshira për të shëtitur me Anën. Mirëpo atje, porsa u gjet midis mbeturinave të famullisë, e ndjeu se, pavarësisht nga prania e Anës, po futej padashur në atmosferën e ngjarjes. Në mbrëmje nuk e zuri gjumi, gjer ndaj të gdhirë, u rrotullua në shtrat duke ndier se si pagjumësia e tij ndahej në mënyrë gati të barabartë midis Anës dhe ngjarjes që kishte ndodhur para tridhjetë e dy vjetësh. Enigma e saj e turbullonte. Sipas tregimit të Anës dhe të fshatarëve, barelievi ishte dëmtuar po atë natë që ishte vrarë rojtari i famullisë. Pra, krimi ishte bërë për shkak të barelievit. Mirëpo përsë? Barelievi nuk ishte vjedhur, as ishte shkatërruar krejt. Madje nuk dihej asgjë edhe për pjesën e dëmtuar: ishte shkulur dhe marrë me vete, apo thjesht ishte thërrmuar. Në qoftë se ishte shkulur për t'u marrë me vete, përsë mund të bëhej një gjë e tillë? Vërtet barelievi ishte i vjetër, mirëpo ç'vlerë mund të kishte vetëm një pjesë e tij sa një grusht? Kurse, po të pranohej hamendja e dytë, prishja për efekt thjesht dëmtimi, atëherë kjo ishte akoma më e pashpjegueshme.

Të gjitha këto pyetje Bardhyl Krastës po i ripërtëriheshin në kokë, ndërsa qëndronte pa lëvizur përpëra monumentit të vjetër. Ai nuk i hiqte sytë nga fytyrat

e ngrira të luftëtarëve, të cilat skulptori i kishte sajuar me goditje të kursyera të daltës. Ato dukeshin mospërfillëse. Pastaj, midis një çasti mpirjeje, befas, sikur të vinte drejt e nga vendi i démtuar, aty iu pérndrit në mendje pyetja; po q'ishte kjo pjesë e shkulur?

Afroi prapë kokën, madje zgjati dorën dhe, sikur të prekte një plagë preku me qisht gropëzën që kishte mbetur atje pas shkuljes. Ç'kishte pasur të gdhendur në atë vend? Kjo duhej të ishte fillimi i gjithçkaje. Prej saj mund të hidhej dritë se kush është vrasësi ose vrasësit dhe pastaj enigma kryesore: pér se u bë krimi.

Kur e ndjeu se lagështia po i hynte në palcë, u kthyte dhe doli pérjashta, duke mënjanuar prapë hapat te pragu i gurtë, sikur ta pengonte dikush.

Rrugës pér në fshat u pérpoq ta hiqte mendjen an-dej dhe ta çonte gjetkë, sidomos tek Ana.

## 10.

— Po kjo është e lehtë të gjendet — i tha Ana, kur ai i tregoi idenë se një nga kyçet e zgjidhjes së enigmës ishte gjetja e përshkrimit të pjesës së shkulur të barelievit. — Së paku, kështu besoj unë, — vazhdoi ajo.

— Gazetat e kohës kanë shkruar pér krimin dhe dissa copa të prera prej tyre ndodhen në muzeun e fshatit. Përveç kësaj, një pjesë e madhe e fshatarëve pleq e mbajnë mend me hollësi ngjarjen.

Ana ishte e kënaqur që me tregimin e saj kishte zgjuar më në fund kureshtjen e tij, megjithëse e ndiente se ndoshta në të ardhmen nuk do t'i pëlqente që ai të merrej me kaq pasion me ngjarjen e vjetër. Në fund të fundit, ata kishin aq shumë gjëra të tjera pér të folur midis tyre.

— Më ka mbetur mendja atje, — i tregoi ai. — Bile, shokët më kritikuani dje në mbledhjen e ekipit pér njëfarë hutimi.

— Hutimi...? — e ndërpree Ana.

— Po, — vazhdoi ai. — Megjithëse, pér mendimin

tim, qđo gjë qđ lidhet me historinë e një zone, ka gjithashtu lidhje me punën tonë. Unë ta kam thënë një ditë këtë gjë, apo jo?

— Po, — tha Ana.

Muzeu i fshatit ishte i vogël. Në mure qenë vendosur disa stenda me fotografi të vjetra dhe të kohës së luftës. Në një stendë tjetër ishte vendosur një hartë e madhe, ku qenë vizatuar të katër shtratet e lumit, bashkë me datat e përafërtë të braktisjes së tyre prej ujërave.

Ata i lexuan copat e prera të gazetave të vjetra që flisin për krimin, por njoftimet e tyre ishin të pakta dhe të turbullta. Krimi kishte ndodhur duke u gdhirë 29 tetori i 1943, në një natë me vetëtima. Rojtari i famullisë ishte gjetur i vrarë në shkallët e saj, goditur në kokë me një hekur të rëndë. Gjithashtu qe dëmtuar barelievi i shekullit XIV, për shkak të të cilët famullia e braktisur prej kohësh qe shpallur monument kulture. U dyshua se vrasja kishte lidhje me dëmtimin e barelievit, por nuk u gjet dot arsyja. Dyshimet ranë në fillim për një ekspeditë kërkimore të huaj, kombësia e së cilës nuk saktësohej, që po kalonte ditët e fundit në Shqipëri. Edhe për llojin e ekspeditës njoftimet e gazetarëve ishin të paqarta. Disa e quanin ekspeditë për kërkime sizmike, disa folkloristike. Në një lajm të mëvonshëm thuhej se dyshimet për ekspeditën u hodhën poshtë krejtësisht, sepse u vërtetua alibia e të katër anëtarëve të saj. Në të vërtetë asnjë gjë, sipas gazetave, nuk përligjte dyshimet për njerëzit e ekspeditës, përvëç fakti, që disa kohë më parë ata kishin fotografuar me shumë kujdes barelievin, që u dëmtua ose u shkul natën e vrasjes.

— Kurse për pjesën e shkulur nuk thuhet asgjë, — tha ai, duke i zgjatur asaj copën e fundit të gazetës.

Ana i mbajti një copë herë në duar ato copëra të zverdhura gazetash, në të cilat ndjenjën e vjetritimit e shtonte sidomos stilë i dikurshëm i të shkruarit, vëcanërisht titujt.

— Duhet të pyes fshatarët pleq, — tha ai. — Patjetër.

Në sytë e tij dukej haptas padurimi, dhe Ana provoi një pikëllim të lehtë. Ajo i la mbi tryezë copat e gazetave me një ndjenjë gati armiqësore për to.

— Çgazeta budallaqe! — ia bëri kur të dy dolën në rrugë.

Por ai nuk foli.

### 11.

Po atë mbasdite Bardhyl Krasta, pasi punoi një orë për sistemimin e disa të dhënave të mbledhura ditët e fundit, shkoi në klub për të pyetur se si mund të gjente kooperativistin plak Hill Mingën. I kishin thënë se ai ishte i pari që i kishte njobur të katër njerëzit e ekspeditës enigmatike, sepse i kishte mbartur mbi shpinë qysh ditën e parë të mbërritjes së tyre në Shqipëri. Gjeologu ishte habitur pak, por ata i kishin shpjeguar se për Hill Mingën kjo ishte një gjë e zakonshme; madje ajo ishte gjëja më e zakonshme për të, sepse me atë punë ai nxirrte në atë kohë bukën e gojës. Kështu gjeologu mësoi se për vite me radhë Hill Minga kishte punuar në skelën primitive të kënetës së kripur si hamall për zbarkimin e njerëzve. Skela ishte hapur nga Xheladin beu dhe përbëhej vetëm nga një bllok betoni, me dy-tri kanxha hekuri, në të cilat lidheshin barkat. Nga ky bllok betoni gjér në breg ishte një cekëtinë rrëth dyzet hapa, pesë a gjashtë pëllëmbë e thellë. Në për atë cektinë dimër e verë, në kohë të mirë e të keqë, Hill Minga, me dy tre hamej të tjerë, çonin e binin njerëzit nga barkat në breg. Rrugë automobilistike s'kishet dhe këneta ishte e vëtmja lidhje e kësaj zone me detin dhe qytetet. Udhëtarë të gjithfarshëm, qehallarë, taksambledhës, tregtarë shëtitës, nëpunës të shtetit, priftërinj, zonja që shkonin për mysfirillëk, hajdutë, heremitë, dervishë, endacakë, spiunë. Dhe të gjithë këta ka-

përcenin nga skela në breg ose nga bregu në skelë mbi shpinën e hamejve.

Bardhyl Krasta priste të shihte një njeri, në pamjen e të cilit të dukeshin gjurmët e shtatit apo të fuqisë së dikurshme. Mirëpo ai u habit kur në verandën e shtëpisë së ulët i doli përpara një plak fare i imët, i rrudhur këndshëm, si një fik i tharë. Ai kishte ca sy të zgjuar, që lëviznin sa andej-këndeje plot gjallëri.

— Çuditesh që jam i shkurtër? — tha plaku, sikur t'i kishte blerë mendjen të porsaardhurit. — I shkurtër kam qenë edhe ahere, po mua më pëlqenin më shumë se hamejtë e tjerë, sidomos zonjat. Më zgjidhnin mua, se nga të gjatët u merreshin mendtë.

Hill Minga qeshi me zë dhe ftoi mysafirin brenda. Biseda u gjallërua shpejt. Plaku kishte dëshirë të trengonte dhe fliste rrjedhshëm, si të gjithë pleqtë e kësaj zone.

— Thonë se njerëzit njihen nga sytë apo nga fjalët që flasin apo ku di unë. Jo, or bir, jo. Dëgjomë mua ti, më mirë se libri, apo syri, apo veshi, njerëzit i njeh kjo këtu, — dhe plaku i ra me dorë qafës së tij. — S'ka si qafa, o bir.

Bardhyl Krasta rrinte në një gjendje të vazhduese buzëqeshjeje.

— S'ka si qafa, — përsëriti tjetri. — Ajo s'gabon kurrë, kur e peshon njeriun mbi vete. Ja, unë kam hipur e kam zbritur nëpër barka me mijëra njerëz dhe fytyrat s'ua kam parë dhe emrat s'ua di, por, ama, të gjithë i mbaj mend. S'i mbaj mend as me sy, as me tru, po me këtë këtu, — dhe prapë i ra qafës.

Gjeologu deshi t'i merrte shënim fjalët e tij, por i vinte zor të nxirrte blokun dhe stilolapsin.

— E hipja njeriun mbi shpinë, ngrijë qafën dhe në çast ekuptoja ç'qe: i lig, frikacak, harbut, tinëzar apo fatzi. Ja, kështu, o bir. Sidomos me zonjat e kisha pisk. Mos ma zër ashtu gruan, qelbanik, ulërinin herë pas here agallarët. Po si ta mbaj, efendi, thosha unë. Po nuk

e zura kështu, më bije në ujë. Ishin ca gra të trasha, të pabesa.

Hill Minga vazhdonte të tregonte pér ca ditë dimri me lagështirë, buzë shkretisë së kënetës, dhe gjëologut nuk i durohej sa ta pyeste pér ekspeditën e huaj, mirëpo fshatari fliste aq bukur, saqë gjëologut i vinte keq ta ndërpriste. Ai thoshte se nga të gjithë hamejtë e skelës vetëm ai kishte mbetur gjallë. Të tjerët kishin vdekur. As skela nuk ishte më. Ujërat dhe rëra e kishin fshirë nga faqja e dheut.

— Vetëm kjo këtu s'harron, — tha plaku dhe pér të tretën herë i ra qafës. — Nganjëherë më vinte në majë të hundës, bëja sikur rrëshqisja dhe e lëshoja ndonjë, blumb, në ujë.

Gjeologu qeshi.

— Por s'dilte gjë nga kjo, — vazhdoi Hill Minga. — Vinte tjetri më i trashë dhe, hop, mbi qafë. Duheshin shembur të gjithë me rrënjen e me bina, siç bëri Partia.

Bardhyl Krasta e pyeti më në fund pér ekspeditën. Plaku picërroi sytë. Ca të huaj me kapuçone të zeza mbi kokë? I mbante mend, posa. Nga pamja dukeshin si prej qelqi, po ishin më të rëndë se c'dukeshin. Po, po, i mbante mend mirë. Ishte një ditë e mërzitshme, me një shi të imët kudo. Dhe ata ishin mbështjellë me mushama të gjata dhe me ata kapuçonët e zinj, që të ngjallnin angushti në shpir. Dhe ishin të ftohtë, sikur mbaje mbi qafë gjarpërinj.

Bardhyl Krasta po e përpinte me sy plakun.

— Kur u bë ajo vrasje dhe u dyshua se mos ata kishin gisht, unë, sapo i dëgjova, thashë me vete: ata e kanë bërë.

Hill Minga nxori kutinë e duhanit.

Po pse, — pyeti gjëologu me zë të ulët, gati me ankim, — pse mendove ashtu?

— Nuk e di, — tha plaku. — Ashtu mendoi kjo dhe jo unë, — dhe prapë i ra qafës.

Një copë herë ai u mor me dredhjen e cigares dhe tjetri nuk ia hiqte sytë.

— Ja kështu, — tha ai pas pak, — e besova menjëherë, por pastaj u vërtetua ajo... si i thonë asaj... ali-beu...

— Alibia.

— E pra, thonë se u bë alibi apo alibe, dhe puna u mbyll sakaq.

Hill Minga tundi kokën.

— Shumë gjëra kam parë e kam dëgjuar në jetë, po këtë s'e kam kuptuar dot. Vret e pret njeriu dhe mjafton një fjalë: alibe, apo alibi, siç e the ti, dhe çdo gjë mbyllët tëk-tëk.

Në një rast tjetër Bardhyl Krasta do të qeshte me gjithë zemër me fjalët e plakut, por ai e kishte mendjen gjetkë.

— Ja, më shpjego mua ti, që je me shkollë, se ç'është ajo fjalë, — vazhdoi plaku.

— Alibia? — pyeti gjeologu. — Eshtë një fjalë gjyqësore, që tregon se ti nuk ke qënë fare në vendin ku u bë vrasja apo vjedhja, kështu që s'ke asnjë faj.

— Ashtu? Hm, — ia bëri Hill Minga dhe nisi të tregonte se si kishte njerëz që kujtonin se kjo fjalë kishte lidhje me ndonjë Ali bej. Dhe në të vërtetë kishte jetuar një herë një bej i tillë në këto anë. Një bej i sertë, më i sertë se Xheladin beu, që i detyronte bujqit e tij t'i bënin ham-ham, kur i mungonin qentë e gjahut. Lopët e atij beut, me emrin Ali, çonte për të kullotur Hill Minga, kur qe çunak dymbëdhjetëvjeçar. Njëherë, në një ditë dimri, Ali beu që nga dritarja i hodhi Hillit të vogël një mexhite, pagën e tre muajve. Mexhitja ra në baltë dhe Hilli e ngriti dhe i fshiu baltën. Tani që ia fshive baltën, pyete mexhitën se mos ka ftohtë, i tha Ali beu që nga dritarja. Po si ta pyes, bej, iu përgjigj Hilli, që po dridhej vetë nga të ftohtët, ajo është pare, bej, ajo s'ka as ftohtë as ngrohtë. Ka, ka, i tha Ali beu. Ajo e çon bagëtinë në kullotë dhe jo ti. Ajo ka ftohtë dhe jo ti, zuzar.

— Ja, i tillë qe Ali beu, — tha plaku. — Kish kohë që s'ia kishim dëgjuar emrin, se ku e kish thyer qafën

andej nga Turqia apo nga Jemeni. Veç kur ndodhi një vrasje dhe të gjithë nisen të thonë atë fjalën e besdisur, al... al...

— Alibi.

— Unë, kur e dëgjova atëherë, thashë me vete: ungjall prapë Ali beu, o perëndi. U ngrit lugat. Se në atë kohë besonin në lugetër e xhinde. Kështu, o bir.

Vonë, kur Bardhyl Krasta doli nga shtëpia e Mingajve, mbi fushë ndriste hëna. Rrugën gjer te shtëpia e Miço Stronit ai e bëri fare ngadalë. Ajri ishte i palë-vizshëm, dëgjohej rrëzimi i gjetheve të thara të plepave ndanë udhës. Rrjeta e fushës së volejbollit dukej si e praruar. Ai mbajti këmbët dhe vështroi një copë herë pamjen e fushës, të cilën ndriçimi i hënës e bënte edhe më të pafundme. Afër e larg prushiteshin dritëzat e fshatrave e të fermave. Diku regëtinin ca sinjale të kuqe, që mund të ishin semaforë të ndonjë stacioni të vogël hekurudhor, apo maja vinçash.

Ai nisi të ecet përsëri. Ndiente një kënaqësi të thellë që mund të ecet i kredhur në mendime, në xhadënë midis plepave, dhe që s'kishte asnë frikë se xhadeja mund të mbaronte. E kishte provuar disa herë se, për të prishur një gjendje mendimtare të njeriut, nuk ka gjë më të aftë sesa një rruge e shkurtër, ose që pritet befasisht.

Tri qerre me nga një fener të vogël pas e lanë xhadënë dhe u futën diku në një udhë anësore. Fenerët e tyre u lëkundën për një kohë të gjatë tutje, atje ku drurët ngjanin si njerëz që kishin zënë pusi. Larg, nga ana e veriut, siluetat e kodrinave shkëmbore kishin përsipër një tis të ftohtë ngjyrë jargavani. Ai e ndiente përherë e më tepër se po dashurohej pas kësaj zone. Në diskutimet në mund të kishte apo mund të mos kishte naftë këtu, ai qe treguar aq i zjarrtë, saqë një nga inxhinierët i kishte thënë njëherë: edhe sikur të kishe lindur në atë vend, s'do të flisje me aq zjarr për të. Në të vërtetë ai qe i bindur se këtu kishte naftë. S'ishte vetëm pasioni për të hedhur poshtë me çdo kusht tezën

e vjetër të specialistëve çekë dhe sovjetikë, si dhe të grupit të sabotatorëve më vonë, të cilët kishin ngulur këmbë që në këtë zonë ishte më e besueshme të gjeje elefantë, sesa naftë. Është një bindje më e thellë që rivalizonte, madje kapërcente edhe mbi të dhënët shkencore, të cilat, c'është e vërteta, nuk kundërshtonin mundësinë e gjetjes së naftës në këtë vend.

Ai ishte i bindur se, që të kërkoje naftë ose diçka tjetër në një tokë, në radhë të parë duhej ta njihje atë mirë, të njihje gjithçka që kishte ajo mbi vete e nën vete, të merreshe vesh me të si me një qenie të gjallë. Nganjëherë, tek ecte fushës, atij i pëlqente të përsërishte dy vargje të një poeti të ri, që i kishte lexuar dikur:

*Ja sonda e naftës si Dantja*

*Në thellësira zbret*

Në të vërtetë nëntoka dhe mbitoka ishin të populluara me gjithfarë ngjarjesh e historish. Fantazma bejlerësh vërtiteshin heshturazi mbi kuaj gërdallë, njëloj si ata. Murgesha, kryqe, klithma tashmë pa zë, eshtra ngjarjesh të tretura qyshkur, kapuçonë të zinj, nën të cilët fytyrat nuk dallohen.

Të gjitha këto duhej të njiheshin, edhe pse mund të mos kishin lidhje me naftën, siç ishte rasti i krimit të famullisë. Ja, pikërisht ai krim atij s'i hiqej nga mendja. S'ishte kureshtja që e shtynte drejt tij, ishte diçka tjetër. Ai e ndiente se s'duhej të kishte boshllëqe në marrëveshjen e tij me këtë truall. Kurse ai krim ishte një pengesë. Dhe ai ishte i vendosur ta zhdukte pengesën.

Kur u kthyen mbrapsht, ai pa se në dhomën ku flinin mësueset e fshatit kishte dritë. I lodhur, ndjeu befas një dëshirë të madhe, gati të mundimshme, që të ishte me Anën. Dhe dëshira iu shfaq në formën e flokëve të saj, që ai, me përfytyrimin e tij, i mori me grushte dhe i mbështolli rrëth fytyrës si një maskë qetësimi.

Skajet e horizontit ishin plot me gjëmime moti. Dukej sikur shtabi i dimrit ishte ngritur pikërisht atje.

Megjithatë dimëron në tokë e jo në quell, thoshin pleqtë. Sipas tyre, sado që të bëhej rrëmujë atje lart, kërcënimet e qiellit shkonin shpejt, ashtu siç vinin. Toka ishte ajo që, kur niste të ftohej, ftohej ngadalë, por që pastaj, po të ngrinte një herë, nuk shkrinte kollaj, gjersa të vinte prilli. Dhe pleqtë, me sytë e zvogëluar nga ndriçimi i ditës, vështronin tokat e punuara. Por brymë s'kishte akoma asgjékund.

Nganjëherë kokrrizat e imëta të plehut kimik i ngaterronin pleqtë. Më shumë se me çdo gjë ato ngjasnonin me brymën. Gjeologët, pas një mungese prej katër ditësh, ishin kthyer përsëri. Në klubin e kooperativës disa nga pleqtë prisin Bardhyl Krastën për t'i treguar ndonjë hollësi që u ishte kujtuar nga ajo ngjarje e vjetër. Gjithë ato ditë, duke u përpjekur të sillnin ndër mend ndodhinë, kishin nxitur kujtesën e njëri-tjetrit, kishin kundërshtuar shpesh shoku-shokun, madje ishin ngrënë edhe me fjalë. Nga rrethi i pleqve që e mbanin mend, ngjarja kishte rizgjuar kureshtjen e të tjerrëve, që e kishin dëgjuar atë gojë pas goje mbrëmjeve, pranë oxhaqeve që porsa ishin ndezur. Ngjarja nisi të riprodrohej tanë përherë e më e gjallë. Si çdo bisedë që përkonte me ndezjen e parë të oxhaqeve, ajo kishte fat, sepse rrihej gjerë e gjatë. S'thoshin më kot se nata e dimrit edhe drutë, edhe bisedat i kërkon të gjata. Përvëc kësaj, fakti që inxhinieri i naftës qe interesuar në mënyrë të veçantë për atë krim, i jepte bisedës një ton gjithsesi serioz.

Në përgjithësi fshatarët ndienin njëfarë krenarie që në fushat e tyre po bëheshin kërkime nafte. Ata ëndërronin që të zbulohet naftë dhe, në qoftë se ajo do të zbulohet vërtet, do të kishin të drejtë të thoshin: ja ç'fusha të mrekullueshme ka kooperativa jonë; jo vetëm

lart në sipërfaqe japin 42 kuintalë grurë për hektar, por edhe poshtë, në thellësira, janë plot pasuri.

Kërkime nafte ishin bërë edhe njëherë tjetër, këtu e pesëmbëdhjetë vjet më parë, nga specialistë çekë dhe sovjetikë. Edhe atëherë fshatarët qenë gëzuar. Kooperativa ishte atëherë e dobët ekonomikisht, megjithatë ajo i kishte pritur specialistët shumë mirë. Por gëzimi i fshatarëve kishte qenë i shkurtër. S'ka naftë në këtë zonë, kishin thënë specialistët duke mbledhur veglat. Asnjë pikë.

Epo, s'ka, s'ka, kishte thënë Miço Stroni përmes pezmatimit të përgjithshëm. Nuk do qajmë tanë.

Dhe ja, pas pesëmbëdhjetë vjetësh gjeologët kishin ardhur prapë. Gëzimi i vjetër qe zgjuar përsëri. Ndryshe nga atëherë, në një mbledhje të shkurtër gjeologët njof-tuan gjithë fshatarët për kërkimet që do të bënin dhe kërkuan ndihmën e tyre, sidomos të pleqve.

Krimi i dikurshëm i famullisë s'kishte asnjë lidhje me naftën, por, meqenëse për të qe interesuar një njeri i naftës, ai mori përnjëherësh një peshë të veçantë. Veç kësaj, ajo ishte një ngjarje ngjethëse, për të cilën kishe ç'të tregoje.

Ndërsa pinte kafe me pleqtë në klub, që përtetë xhamave Bardhyl Krasta pa Anën që po kalonte në udhëzën përbri fushës së volejbollit. Xhamat ishin të veshur nga avulli dhe nga ky shkak e ecura e Anës dukej e lehtë, si e njerëzve të zbritur në hënë. Kjo duhej të ishte ndoshta e ecura e njeriut që e ka mendjen te njeriu tjetër, mendoi ai.

Ata u takuan pas një ore, në mesditë. Porsa e pa, Ana u shkëput nga shoqet dhe qëndroi me të. Që larg sytë e Senkës e ndiqnin me pikëllim. Plepat ndanë xhadesë dukeshin si të qelqtë. Ata e kuptuan se po shkonin drejt kodrinave, por, kushedi pse, sikur të kishin bërë një marrëveshje të heshtur, asnjë prej të dyve nuk e përmendi famullinë. Edhe kur mbërritën atje, prapë nuk thanë asgjë. Por famullia ishte përpëra tyre, me atë ngjyrën

prej trëndafili të zbehtë, që të vinte të besoje se ia kishte dhënë stina. Përballë qemerit prej guri, arra e vjetër, e shtrembër e gjithë gunga, ngjante si një plakë nga ato që vdekja i harron mbi dhe.

— Atje do ta kenë goditur, — tha ai, duke treguar me dorë vendin nën bareliev. Ajo nuk foli asgjë, por atij iu duk sikur tha: mjaft!

Ndoshta u bëra i mërzitshëm, tha ai me vete. Dhe vendosi të mos fliste më, por në atë çast ajo e kapi për bërryli.

— Shiko atje.

Te rrëza e murit ishte hedhur një paketë cigaresh bosh. Ai bëri dy hapa, u përkul dhe e ngriti paketen nga toka.

— Ja dhe dy bishta cigaresh, — tha ajo.

— Po, dikush ka qenë këtu.

Ana u mbështet te krahu i tij.

— Herën tjetër s'kishte asgjë të tillë, — tha ajo, pothuajse me pëshpërimë.

Ai nuk foli, vetëm shtyu me majën e këpucës bishstat e cigareve. Gropa midis barelievit dukej e frikshme.

— Të ikim që këndejej, — ia bëri ajo dhe e têrhoqi lehtë.

Ata dolën përjashta dhe një copë rrugë të gjatë e bënë pa folur. Ana e mbante për krahu si një e fejuar. Koka e saj ishte fare pranë kokës së tij, dhe ai përpinqej që tymi i cigares të mos i shkonte asaj.

— Sidoqoftë askush gjer më sot nuk e di se ç'ishte pjesa e shkulur e barelievit, — tha ai.

— Po, as gazetat nuk thoshin asgjë. Megjithatë unë përsëri kam shpresë se kjo është një gjë që mund të zbulohet. Ndoshta në muzeun e qytetit të afërm, ose në muzeun qendror në Tiranë.

Ana vazhdonte të fliste me zë të ulët, duke pulitur sytë, sa herë që tymi i cigares vinte në drejtim të saj.

— Kam një parandjenjë se gjithë enigma qëndron pikërisht te pjesa e shkulur, — tha ai.

Ana priti që ai të thoshte diçka tjetër për pjesën e shkular, por befas, duke ndërruar bisedë, me një zë që asaj iu duk se iu ngjir aty për aty, i tha se ishte i divorcuar. Në fillim ajo kujtoi se i bënë veshët, kaq i papritur ishte ndërrimi i bisedës së tij. Por jo, ai po thoshte tamam atë gjë; ishte i divorcuar dhe kishin një vajzë gjashtëvjeçe dhe... dhe... Ana një copë herë nuk dëgjoi. Ajo ndiente vetëm krahun e tij, që shtrëngohet pas krahut të saj, sikur të kishte frikë se ajo do ta hiqte.

Por Ana nuk e hoqi krahun. Dalngadalë asaj iu kthye vëmendja për të dëgjuar, megjithatë ajo që tre-gonte ai ishte e çrregullt, ashtu si edhe ecja e tyre. Në hapat e tij kishte një ngrirje, gati-gati një egërsi, dhe e ecura e saj i ndiqte me vështirësi ato hapa. Ai i tregoi se prishja e martesës kishte qenë e qetë, pa asnje sherr. Vajzen e shikonte një herë në javë. Ish-gruaja e tij që martuar rishtas me një nëpunës. Ai s'tha asnje fjalë të keqe për të. Kurse shkakun e ndarjes nuk e përmendi. Ndërsa Anës, pikërisht atje iu përqendrua vëmendja. Ajo priti që ai ta thoshte vetë dhe, kur nuk e tha, e pyeti fare ultaz.

— Po përse?

— Ah, përse? — ia bëri ai dhe, nga toni me të cilin i tha këto fjalë, Ana e ndjeu se shkaku nuk do të ishte i shëmtuar. — Ishte një gjë që vazhdonte prej vitesh. Një gjë që kishte filluar që në vajzërinë e saj e që në djalërinë time. Kishim mendime të ndryshme për jetën. Më kuptoni? Ne s'duhej të ishim martuar bashkë.

Anën befas e kapi frika se mos atij i shpëtonin fjalët «s'na puqeshin karakteret», për të cilat kishte dëgjuar mjaft anekdota kohët e fundit, por ai, po aq prerazi si në fillim, e ndëroi përsëri bisedën.

Që larg u dukën shtëpitë e fshatit. Në njérën nga çatitë dikush rregullonte një antenë. Ai pa orën. Po afronte ora e lajmeve.

**13.** Vazhdonte kriza botërore e naftës. Naftë kërkohej kudo. Me çdo çmim, qoftë edhe më gjak. Ç'turpëri, thoshte Miço Stroni përpara televizorit. Porsa ishte varrosur mbreti Fajzell i Arabisë Saudite. S'kish dashur varr. Si pjellë e vërtetë e shkretëtirës, e kish lënë amanet ta mbulonin me rërë më në mes të saj, pa emër e pa nishan.

**14.** Anën e lajmëruan se e kërkonte kryetari i kooperativës. U mbështoll me mushama për të mos u lagur dhe rrugën gjer te zyrat e kryesisë e bëri pothuajse me vrap.

Kryetari ishte vetëm më zyrë. Porsa hyri, Ana e kuptoi menjéherë që ai ishte i turbulluar.

— Mirëdita, — përshëndeti Ana me zë të tingullt. Kryetari s'dinte ku t'i conte sytë. Ai ishte rrëth të pesëdhjetave, i gjatë, i drejtë, me flokë të dredhur njyrë kashte, plot pikëza të kuqërrrema, që i përsëriteshin më gushë si një motiv. Sado që fytyra i nxinte, sytë i kishin mbetur të mjegulluar, sikur s'donin që s'donin të merrnin pjesë më tendosjen e përgjithshme të tij. Ana kishte pasur gjithmonë marrëdhënie shumë të mira me të.

— Si është puna? — pyeti ajo. Kryetari u turbullua edhe më. Ai vendosi e zhvendosi një copë herë dosjet që kishte mbi tryezë, shtyu më tutje telefonin, që lëshoi një «tring» ankimtar dhe më më fund ngriti kokën e u përhoq ta vështronë Anën më sy.

— Ti, Ana, besoj e ke kuptuar se unë... domethënë ne të gjithë... unë bashkë me shokët e tjera... gjithmonë këmi pasur një nderim të veçantë... apo jo...

— Po, — tha Ana, — e kam vënë re dhe ju falem nderit shumë.

Që kur kishte hyrë, ajo e kishte ndier se kryetari përgatitej të thoshte diçka serioze, por, për çudi, e gjithë kjo i dukej asaj gazmore dhe aspak hijerëndë.

— Ne gjithmonë të kemi pasur si vajzën tonë, — vazhdoi ai, — edhe në presidiume të kemi vënë, apo jo... edhe kur na kanë ardhur për vizitë në kooperativë marksistë-leninistë suedezi, bile dhe australianë... ne ty të kemi vënë për shoqërim, apo jo... sepse nga çdo pikë-pamje, qoftë politike... qoftë nga anët e tjera... ti je... ti ke qenë... gjithmonë shembull...

Ana e dëgjonte e qetë, pa ia hequr sytë kryetarit. Ai sa vente, turbullohej më tepër.

— Mirëpo unë desha të të them diçka, — vazhdoi pa e vështruar. — Ti mos ma merr për keq... Në të vërtetë këtë duhej të ta thoshte sekretari i partisë. Nau-mi, ... por ai m'u lut mua që të them... hm... ja, kështu... ti hiç mos ma merr për keq... edhe në qoftë se... sepse... fundi i fundit... gjithësecili...

— Nuk kuptoj, — tha Ana, tamam në çastin kur po-thuajse e ndjeu për se ishte fjala.

Kryetari e humbi krejtësisht. Në ballë i ndritën ca bulëza djerse. Ai vështronte cepat e tryezës dhe kushedi ç'do të bënte sikur në atë çast të mos binte telefoni. Ai e zhvati dorezën me vrull, jo sikur të ishte dorezë telefoni. Në anën tjetër të telit ishte, siç duket, përgjegjësi i stallave, sepse kryetari nisi të bërtiste diçka për rezervën dimërore të bagëtisë. Vagëllimthi Anës iu renditën në mendje mullarët, shpërndarë aty-këtu në fushë, me atë qetësinë dhe prarimin e tyre prej bari. Gjithsesi s'të shkonte ndër mend se për ta mund të bërtitej nëpër telefonat.

Kryetari u përpooq ta zgjaste sa më shumë bisedimin në telefon. Por më në fund vuri në vend dorezën. Ata u vështruan sy më sy dhe vështrimi i tij dukej sikur thoshte: s'më mjaftojnë telashet e kooperativës, rendimenti i grurit, nazet e lopëve holandeze, koka gdhë e Lamçe Kërrit, që mund të çmendë ministrin e jo mua

dhe ja, tani më duhet të merrem edhe me ty, o moj Anë.

— Po si është puna? — tha ajo me ëmbëlsi.

— Si është puna? — gati sa s'bërtiti ai, sikur ajo t'i kishte dhënë më në fund çelësin e bisedës. — Ja si është puna, — vazhdoi me vendosmëri. — Nuk është mirë që për ty, Ana... kohët e fundit njerëzit të flasin... për ty dhe për atë inxhinierin...

I lehtësuar që e nxori më në fund ç'kishte për të thënë, u mbështet tek ana e tryezës, duke pritur që turbullimi t'i kalonte tani Anës. Mirëpo vajza ishte fare e qetë. Një copë herë ajo e vështroi ngultazi, me një vështrim ku përzihej njëfarë kureshtjeje, dinakërie dhe përkëdhelie bashkë. Pastaj buzëqeshi.

— Po pastaj? — pyeti.

Kryetari e humbi përsëri.

— Si pastaj? — ia bëri ai. — Si pastaj, moj Anë.

Vajza afroi kokën si për t'ia parë më mirë sytë. Zëri i saj ishte i shtruar, qetësues.

— Po ju, kryetar, dy muaj më parë raportuat me gjëzim në Komitet të Partisë se në kooperativën tuaj pesë-dhjetë pér qind e martesave bëhen me dashuri. Apo jo?

— Hm. Po, — ia bëri ai.

— Atëherë, si është e mundur që shqetësoheni përmua?

— Për ty?... Po ti... ti je ndryshe, Ana. Ne me ty, siç e thashë dhe në fillim... mburreshim... të nxirrinim në presidium... hm.

— Mos vallë, pasi të dalësh në presidiume, duhet të heqësh dorë nga dashuria?

— Jo, xhanëm, s'them ashtu, se ja, Sofika e Vasil Kronit u shqep duke dalë në tabela nderi e në radio e në raporte dhe para dy javësh na u martua me dashuri. S'them ashtu, por, sidoqoftë ti je ndryshe, Ana. Më kupton... unë të them se të çmoj... bile të çmoj shumë ty që je një vajzë kaq serioze...

— Ju falem nderit, por unë mendoj se dashuria

s'është pér njerëzit joseriozë, — e ndërpreu ajo me bутësi. — Përkundrazi. Apo jo?

— E, xhanëm... s'them se s'është ashtu... por edhe ndonjë seriozitet kushedi çfarë s'besoj se është... nejse... po ti e di që unë s'jam konservator... por... mbase... kushedi...

Dosjet në tryezën e tij ishin bërë tanë rrëmuajë.

— Që t'i bie troç, unë inatin e kam tek ai, — thirri kryetari papritur, duke i ngulur sytë Anës me vendosmëri. Fytyra e tij ishte bërë krejt e kuqe. — Dhe ja ku ta them, në qoftë se ai qen bir qeni guxon e tallet me... unë... unë vetë... mos më thëngin...

Ana mënjanoi kokën mendueshëm. Në sytë e saj lotët krijuan befas një si retinë të dytë, të rrëshqitshme. Ajo zgjati dorën dhe e vuri mbi dorën e rreshkët të kryetarit.

— Po ne duhem, — tha me zë fare të ulët.

Kryetari uli kokën.

— Ç'më bëre, o Naum, — tha ngadalë.

Ana bashkë me kryetarin dolën nga zyra e tij pas një çerek ore. Ata ecën një copë herë përbri plepave, pastaj u ulën në klub të pinin një kafe.

Kur Ana doli nga klubi, përballë dyqanit të kooperativës u ndesh ballë pér ballë me vajzën gjeologe. Gjeologia e përshëndeti dhe të dyja mbajtën këmbët në të njëjtën kohë.

— S'na ka qëlluar të njihemi bashkë, — tha gjeologia. Ajo e kishte zërin të hollë e të pastër dhe kishte veshur një xhaketë lëkure, midis gézofit të së cilës qafa i dukej edhe më e hollë.

Ajo e shoqëroi Anën gjer te hyrja e shkollës, duke folur pér gjëra të rëndomta.

— Bardhyli është një njeri i mrekullueshëm, — tha papritur gjeologia, në kohën që po bëhej gati të ndahej me Anën.

Ana u skuq.

— Më falni, — tha tjetra, — në porsa u njohëm,

— Jo, asgjë, — ia bëri Ana.

— Përveç që është një specialist i shkëlqyer, është edhe një njeri i rrallë. Anës i erdhia përqafonte atë qafë të hollë e të lëmuar si prej porcelani.

15.

X Ndërtesa e muzeut të qytetit N. ishte e vjetër. Ajo kishte qenë dikur shtëpia e pashait të krahinës dhe në ditët me shi dukej akoma më e zymtë.

N. ishte një nga qytetet ku Bardhyl Krastës nuk i pëlqente të vente me shërbim, sidomos në dimër. Mirëpo atë ditë, nga padurimi pér të mbërritur sa më parë në të, i dukej se mikrobusi i tyre ekte shumë ngadalë.

Kur më në fund mbërriten, me të lënë çantat në hotel, ai vrapi i pér në muze.

Drejtori i muzeut ishte tepër i sjellshëm. Ai e shqëroi vetë të porsaardhurin nëpër sallat e ftohta, ku kishte vetëm tre-katër vizitorë. Bardhyl Krasta dëgjonte pa ndonjë vëmendje të madhe shpjegimet e tij. Gjatë gjithë kohës ai nuk mendonte veçse të gjente çastin e duhur pér t'i kërkuar shpjegime rreth barelievit të lashtë.

Kur, më në fund, iu duk se erdhia një çast i tillë, e ndërpreu drejtorin me zë të ulët.

— Më falni, desha të di, ju me siguri keni dëgjuar pér barelievin e famullisë së vjetër, të dëmtuar në vjesh-tën e vitit 1943 në rrethana krejtësisht misterioze.

Drejtori mbajti hapat.

— E di, — tha, — sigurisht që e di.

Bardhyl Krasta mori frysë i lehtësuar.

— Atje u bë edhe një vrasje.

— Po, po, — ia bëri gjeologu, — por unë desha të di, në radhë të parë, se c'përfaqësonte pjesa e shkatërruar, apo e shkulur e barelievit.

— A, po ajo dihet, — tha drejtori i muzeut, — ajo ishte emblema e vjetër e Muzakajve.

— Ashtu?

— Po, pikërisht në mburojën e njërit prej luftëtarëve të gdhendur në bareliev ishte emblema. Muzakajt qysh prej shekullit XIII ishin kryezotët e gjithë kësaj zone.

— E përsë ata e shkulën? — s'iudurua tjetrit të pyeste.

Drejtori i muzeut ngriti supet.

— Cilët ata?

— Ata që bënë edhe krimin, — tha Bardhyl Krasta. — Megjithëse ju keni të drejtë, askush nuk di asgjë se kush e bëri atë krim.

— Pikërisht, — tha drejtori i muzeut. — Ngjarja bëri atëherë bujë, por ajo mbeti krejtësisht e pashpjeguar.

— U fol për një ekspeditë të huaj, — tha gjeologu, — për ca njerëz me kapuçonë të zinj...

Drejtori i muzeut ia bëri «po» me kokë.

— Po, — tha pas pak. — U dyshua për një ekspeditë të huaj, por ndërkaq u vërtetua alibia e saj. Më kujtohet, atëherë isha nxënës në gjimnaz...

— Po a mund t'i interesonte asaj ekspedite prishja ose vjedhja e emblemës së Muzakajve? — pyeti Bardhyl Krasta.

Drejtori i muzeut përsëri ngriti supet.

— Nuk e di, — tha. — Ajo ishte një ekspeditë folklori, edhe emblema ndoshta mund t'i interesonte, megjithëse s'kishin pse të derdhnin gjak për të.

— Ju mendoni se thjesht e kanë shkatërruar, apo e kanë shkulur për ta marrë me vete?

Tjetri tundi kokën:

— S'mund të them asgjë, — tha. — E gjithë ngjarja ka mbetur enigmë.

— Po, enigmë, — pohoi Bardhyl Krasta, — nga kreunë fund.

Drejtori i muzeut e shoqëroi atë gjer te porta. Inxhineri e falënderoi për shpjegimet.

— Ku mund të gjendet vizatimi ose fotografia e emblemës? — pyeti ai.

— Besoj që në Muzeun Qendror në Tiranë gjendet me siguri, — tha drejtori, — ose në Arkivin e Shtetit.

Tjetri përshëndeti edhe një herë me dorë dhe iku.

Mbi qytet vazhdonte të binte një shi i ftohtë me pikat rralla. Megjithëse ishte mesditë, në disa nga vitrinat e dyqaneve ishin ndezur dritat. Ai papritur ndjeu lodhje dhe N. iu duk i mërzitshëm si edhe herën tjetër.

Shokët i gjeti në restorantin e hotelit.

— E? — pyeti njëri prej tyre.

— Ishte emblema e Muzakajve, — u përgjigj ai thate, duke hapur menunë.

— Ashtu?

Ai bëri «po» me kokë dhe vazhdoi të vështronte listën e gjellëve. Dukej menjëherë që nuk e kishte mendjen atje.

## 16.

Gjatë tri ditëve që qëndruan në N., Bardhyl Krasta, i dhënë pas punës kërkimore, mendoi shumë rrallë për çështjen e emblemës. Ndoshta shuarja e një pjese të kureshtjes ia uli paksa interesimin për ngjarjen e dikurshme. Kur ekipi i tyre u kthyte në fshat, ai kishte përshtypjen se edhe Ana do ta kishte harruar ngjarjen. Mirëpo ishte e kundërtta. Porsa u takuan, ajo e pyeti se a kishte qenë në muze. Ai i tregoi atëherë për emblemën.

— Çudi, — ia bëri ajo. — E përse duhej zhdukur ose vjedhur me çdo kusht ajo emblemë?

— Këtu është edhe enigma, — tha ai. — Unë kujtoja se gjetja e pjesës së shkultur do të hidhte dritë mbi çështjen, por ajo, me sa duket, s'jep asgjë. Kështu që kryesorja mbetet prapë gjetja e autorëve të krimtit. Ky është një rrëth i myllur, — vazhdoi ai, — dhe, të them të drejtën, mua filloj të më lodhë pak.

— Dukesh, — tha Ana. — Po ti a e di? Këto ditë që ju keni munguar, këtu kanë vluar bisedat për kërkimet tuaja të naftës si edhe për ngjarjen e famullisë.

— Ashtu?

— Sidomos mbrëmjeve, — tha Ana.

— Kjo është një gjë e mirë, — tha ai. — Të nxitësh mendimin popullor përpara fillimit të kërkimeve shkençore të kësaj natyre, ky është një parim.

— O, ata bisedojnë shumë, — tha ajo, — dhe me passion.

— Është e kuptueshme, Ana. Nafta te ne është më tepër se një çështje ekonomike.

— Nuk është keq t'i dëgjosh, — tha ajo. — Ata janë shumë mikpritës dhe një pjesë të mbrëmjeve mund t'i kalosh nëpër shtëpitë e tyre.

— Për këtë duhet të më ndihmosh ti, — tha ai. — Ti këtu, me sa shikoj unë, je si e shtëpisë.

## 17.

Atij i dukej se për vjeshtën e paharruar të vitit 1943 nuk mund të bisedohej vegse pranë zjarrit. Shumica e ngjarjeve ishin me djegie kasollesh e shtëpish me tym, me hi që e lag shiu në mëngjes, ndërsa njerëzit kërkojnë diçka midis gërmadhave. Bandat e Isa Toskës e të Xheladin beut bënин kërdinë kudo. Terrorit të tyre të bardhë njësitet guerrile i përgjigjeshin me terror të kuq. **Çifligu i Xheladin** beut u dogj fill pas varjes së dy vajzave ilegale. Pastaj njerëzit e Xheladin beut masakruan fisin e Naumajve, me gra e me fëmijë. Pas kësaj guerrilierët zunë robinjë të shoqen e beut, por e liruan menjëherë, me urdhër të Qarkorit të Partisë. Po atë ditë Xheladin beu u mori një tank gjermanëve dhe mësoi taniste vetë. Me atë tank fshiu nga faqja e dheut gjysmën e fshatit Kënetas, duke çarë si lubi kasollet prej balte. Fill pas kësaj guerrilierët e vranë dhe trupin i aq hodhën në një gropë pranë kënetës. Për t'i marrë gjakun beut, u bë marshim i madh i bandave të bashkuara të Isa Toskës e të Rexhep Vrenozit, që e shndërruan një pjesë të fshatit në kasaphanë. Ndeshja ishte e pamëshirshme. Qerret, të ngarkuara me të vdekur, përshkonin kryq e tërthor rrafshirën e shkretuar. Një pjesë e të vra-

rëve nuk njiheshin nga njollat prej balte. Përpara vdekjes njerëzit kishin dëshirë të flisnin, sidomos kur ndodheshin përballë palës kundërshtare. Midis ngulçeve të gjakut, që mbytnin gërmazet, bëheshin dialogje të ashpra, që nuk ishin bërë kurrë asgjékund.

Kjo vazhdoi rreth pesëdhjetë ditë. Pastaj një pjesë e bandave të bejlerëve u shpartalluan, kurse pjesa tjetër, bashkë me batalionet balliste, e braktisën zonën, për të marrë pjesë së bashku me gjermanët në Operacionin e Dimrit, në male. Rrafshira e gjerë, nga këneta e gjerë në kodrinat shkëmbore, mbeti për ca kohë si e shurdhër. Komanda gjermane vendosi postat e xhandardarmërisë së saj në disa pika, filluan të vijnë gazetat e kryeqytetit, u kthye dhespoti i manastirit, si edhe një pjesë e kryepleqve të fshatrave, që ishin bërë fir, të trembur nga përlleshjet. Mirëpo të gjithë ishin si të shushatur, dhe kryeplaku i fshatit Kënetas u dërgoi fjalë partizanëve se ai donte ta kishte mirë edhe me gjermanët, edhe me komunistët.

Pikërisht në atë kohë të shkurtër qetësie u rishfaqën njerëzit me kapuçonë të zinj. Ata kishin qenë këtu para disa muajsh, ishin vërtitur fshat më fshat, kishin bërë ca kërkime të cuditishme mbi dhë e nën dhë, kurse **mbeturinat e famullisë së moçme i kishin fotografuar** përditë me radhë, me kujdesin më të madh. Pastaj, porsa që afroar furtuna e përlleshjeve, qenë zhdukur si hije.

Ardhja e tyre e dytë nuk zëjoi më kureshtjen e fshatarëve. Gjithsecili kishte hallet e veta dhe s'ua kishin ngenë të huajve. Atyre vetë, dukej sikur u pëlgente kjo mospërfillje. Zaten kështu kishin qenë edhe herën tjetër, të druajtur, të paafroreshëm. Mirëpo, ndërsa ata vetë kishin qenë jashtë vëmendjes së fshatarëve, krimi që u bë pikërisht në prag të largimit të tyre, tronditi tërë fshatrat rreth e rrötull. Ishte disi e pakuptueshme, oë në atë kohë të ashpër, kur njerëzit rreth e përqark ishin të giakosur. kjo vrasje të bënte aq bujë në popull. Ishte, ndoshta, enigma që e rrethonte krimin. vetë ajo natë e paharrueshme me vetëtimë si asnjëherë tjetër, ose ndo-

shta pozicioni në të cilin qe rrëzuar viktima, përmbyss, me dy duart të hapura sipër pragut të gurtë. U lajmërua menjëherë policia, erdhën gjykatës-hetues që nga Tirana, kriminalistë, gazetarë. Vetëm atëherë u vu re se ishte dëmtuar barelievi shekullor. Kjo shkaktoi një humtim të përgjithshëm. Gjëja e parë që bënë hetuesit ishte kërkimi i sqarimeve për rojtarin e famullisë: mos kishte ndonjë armik personal, ndonjë gjakmarrje të vjetër. Por të gjithë dëshmuantë kundërtën: ai ishte një njeri pa njeri, një kosovar i ardhur në kohën e luftës së parë botërore, që jetonte i vetëm në një kënd të famullisë, me një rrogë të vogël që merrte nga shteti, si rojtar i saj.

Që ditën e parë të hetimeve vetveti u lidh vrasja e rojtarit me prishjen ose vjedhjen e një pjese të barelievit. Dyshimet s'kishin mbi kë të binin tjetër veçse mbi ekspeditën e huaj, e cila qe interesuar aq shumë për monumentin mesjetar. Aq më tepër që kohët e fundit shtypi kishte bërë zhurmë për vjedhjen e Butrintit dhe të Apollonisë së lashtë nga italianët. Menjëherë iu dha urdhër xhandarmërisë të ndalonte daljen nga Shqipëria të pjesëtarëve të ekspeditës. Mirëpo përgjegjësi i ekspeditës bëri menjëherë një deklaratë të shkurtër, fare gjakftohtë, ku siguronte organet gjyqësore, se ai dhe kolegët e tij ishin gati të vërtetonin katërcipërisht alibinë e tyre. Dhe me të vërtetë alibia u vërtetua. Pikërisht atë natë, të katër pjesëtarët e ekspeditës kishin trokitur në mbrëmje vonë në mullirin e usta Janinës. Ata kishin kërkuar një fener dhe nuk kishin pranuar të futeshin brenda për tu tharë. Usta Janina i kishte parë me sy që të katër, po ashtu edhe gruaja dhe fëmijët. Morën fenerin dhe ikën sic thanë vetë, në drejtim të Hanit të Haureve.

Kur tregimi vinte në këtë pikë, të gjithë bënин pveten: po ndoshta ndërkaq ata e kishin bërë krimin. Dhe fshatarët qeshnin: po a e di ti ku bie mulliri i usta Janinës? Ai është së paku gjashtë orë larg nga famullia dhe, sikur ata ta kishin bërë vërtet vrasjen, duhej ta kishin bërë atë në kohën e mbasditës, rrëth orës tre ose katër, për të qenë në mbrëmje vonë te mulliri. Kurse

rojtari atë mbrëmje ishte akoma i gjallë, sepse ndodhej në fshatin tonë, ku e kishin parë të gjithë dhe ku kishte zbritur si zakonisht për të blerë pak miell. Po mbasë ti do të thuash se nga mulliri i usta Janinës, në vend që të shkonin drejt Hanit të Haureve, siç thanë, ata mund të jenë kthyer mbrapsht me shpejtësi andej nga erdhën, për të bërë hatanë që kishin ndër mend? Ke të drejtë të mendosh kështu, po puna ishte se ata u panë vërtet në Hanin e Haureve aty pas mesnatës, tamam në kohën që ishte duke u bërë vrasja.

Sa për Hanin e Haureve, atje kam qenë vetë atë natë dhe i kam parë me sy, i shpjegonte për të tretën herë Miço Stroni gjeologut. Ishim bashkë me Miti Shqepën e Tod Kërrin. S'na zinte gjumi për qamet nga tartabiqct. Pastaj nisën ato vetëtimat, aman-aman. Qielli llapste sikur ta lëpinte një gjuhë viçi teipërtej. Binte shi. Kish kaluar mesnata, kur dëgjuam ca zëra që i thërrisin n që jashtë hanxhiut. Zërat ishin tjetërloj, gjysma shqip, gjysma fjalë të huaja. U ngritëm dhe dolëm në hajatina e jashtëm. I zoti i hanit po zbriste me fener në dorë. Nën dritën e vetëtimës i pamë që të katër. Kishin në kokë ata kapuçonët e zinj, që njiheshin një orë larg. Ishin të qullur, por në han nuk u futën, kërkuan vetëm një fener, se feneri i tyre qe thyer. Drita e fenerit u binte copa-copa e i bënte të frikshëm, si lugetër. Kuajt hingëllinin të trembur nga vetëtimat. Mua, të më dalin këta përpara natën, me ata kapuçonë mbi kokë, më shpëton ujët e hollë, tha Tod Kërrri. Më në fund, ikën nëpër shi. Ne ramë prapë, po gjumi s'na zinte. Dëgjohej hanxhiu që ngjitte shkallët me duar e me këmbë, duke i mallkuar. Ja, kështu. Kiji inat, po folju hakun: nuk e bënë ata vrasjen. Nga Hani i Haureve e gjer në famulli ishte një ditë udhë, kurse rojtari u gjet i vrarë qysh në mëngjes herët. Veç të kishin krahë e të fluturonin.

Kështu flisnin fshatarët pleq ndanë oxhakut. Gjeologu dëgjonte me vëmendje, pa i ndërprerë asnjëherë. Herë pas here sytë e tij ndeshnin me vështrimin e Anës. Nga rikujtimet e pleqve, Bardhyl Krasta bëri një saktë-

sim të rëndësishëm: vrasësit nuk e kishin shkulur copën e barelievit, por thjesht e kishin shkatërruar. Kjo vërtetohej nga një copë fitili gjysmë të djegur që hetuesit kishin gjetur në mëngjes. Siç duket, ata kishin dashur ta hidhnin në erë krejt famullinë, bashkë me barelievin, por dicka i kishte penguar, ndoshta lagia e dinamitit, ndoshta një gjë tjetër. Ata kishin vënë në veprim qysqinë, vetëm pasi u kishte dështuar hedhja në erë e famullisë. Pra, qëllimi i tyre s'kishte qenë kurssesi vjedhja, po shkatërrimi i barelievit. Në të vërtetë ata do të kishin dashur ta thyenin krejt, por kjo do të kërkonte një kohë të gjatë, kështu që ata u mjaftuan vetëm me prishjen e një cope të tij, pikërisht të copës që për ta duhej të zhdukej nga faqja e dheut. Natyrisht, të hutuar nga krimi, ata nuk e vranë fort mendjen se, me prishjen vetëm të emblemës, hidhnin një farë drite mbi saktësinë e shkakut të krimit. Mirëpo kjo dritë ishte tepër e zbehtë dhe rruga gjer tek e vërteta duhej të ishte kaq e largët, saqë ata nuk u shqetësuant fort për pengesat.

E megjithatë, edhe të ngutur e me duar me gjak, siç ishin, ata e bënë një maskim të fundit. U përpoqën ta prisnin copën e barelievit në mënyrë të rregullt, që të jepnin idenë e një shkuljeje, pra të një vjedhjeje të zakonshme të një monumenti kulturor dhe jo të një shkatërrimi. Kurse, në të vërtetë, ata do ta kenë thyer atë barbarisht dhe copërat do t'i kenë hedhur rrugës, duke iku, nëpër baltërat e kënetës.

Të gjitha këto Bardhyl Krasta ia thoshte Anës, dhe ajo, pasi e dëgjonte me vëmendje, e ndërpriste qetësisht:

— Po kush «ata»? Ti po flet sikur i di vrasësit.

Ai bënte një gjest padurimi.

— Ta zëmë se janë ata, dreqi e mori, kapuçonët e zinx. Në fund të fundit, për të vërtetuar dicka, mund të nisesh nga një hipotezë, ndryshe mendimi ngecet në vend. Pra, ta zëmë se janë ata, ashtu siç thotë Hill Minga, që i beson qafës së vet.

— Po alibia?

— Uf, alibia. Unë nuk i di mirë këto gjëra, po ma merr mendja që edhe alibitë duhet të kenë kundëralibilitë e veta. Kam për të pyetur ndonjë hetues. Kam një shok në Tiranë.

— Shih atje, — e ndërpren Ana, duke treguar një plep të lartë buzë xhadesë. — Një çerdhe lejleku.

Tani që plepi ishte zhveshur krejtësisht, çerdhja e lejlekut dukej tepër e madhe.

— Lejlekët duhet të kenë ikur, — tha Ana, — veç në ka mbetur ndonjë i sëmurë.

Ai vështronte majën e plepit, pa e hequr krahun nga supi i saj. Ishin larguar mjافت nga fshati. Edhe pak dhe fillonin bokërimat.

— Dimrin që shkoi, kalamajtë sollën një lejlek plak gjysmë të ngrirë, — vazhdoi Ana, por e ndjeu se ai nuk po e dëgjonte. — Ti e ke mendjen te kapuçonët e zinj? — e ngacmoi ajo.

Një copë herë qeshën dhe ngacmuani njëri-tjetrin, ajo duke e quajtur «kapuçons», ai «lejlekse».

Dita ishte e ftohtë, dhe, me gjithëse fushat ishin të zhveshura, në tërë shtrirjen e tyre dukej një mbeturinë prarimi, si gjurmët e një pasurie të fshirë tashmë.

Nën udhë, një fshatar i shkuar në moshë kishte ndaluar dhe diç po i bënte rrotës së qerres. Kur ata u afroan, ai i vështroi me ca sy të përqarë.

— Mirëdita, — tha Ana.

Fshatari nuk u përgjigj, vetëm vazhdoi t'i ndiqte me sytë e tij plot damarë të vegjël e të kuq që i jepnin vështrimit të tij një lloj mosbesimi. Ai ishte i dobët, me lëkurë të hollë, nën të cilën dalloheshin venat.

Kur ishin larguar mjافت, Ana u kthyte dhe pa se fshatari po i ndiqte me sy, me një mënyrë të tillë që asaj iu duk e keqe.

— Ç'vështrim, — tha Ana, po Bardhyli e kishte mendjen gjetkë.

— Ajo që më duket sidomos e pashpjegueshme, — tha ai, — është...

Ana mezi e mbajti të qeshurën.

— Përse qesh?

— Qesh me fjalët e tua «sidomos e pashpjegueshme». Në qoftë se e ke fjalën për krimin, unë mendoj se në të gjer tani ka vetëm gjëra të pashpjegueshme dhe asgjë të shpjegueshme.

— Ti ke të drejtë. Megjithatë edhe midis enigmave ka një shkallëzim.

— Ma thuaj atëherë, — i tha ajo, — çfarë të duket sidomos e pashpjegueshme. Të jap fjalën se nuk do të të ndërpres më.

Ai u mendua një copë herë.

— Në qoftë se bëjmë hamendjen se krimin e kryen pjesëtarët e ekspeditës, i pashpjegueshmës është sidomos serioziteti me të cilin ata organizuan alibinë. Ti i dëgjove vetë tregimet e fshatarëve për atë vjeshtë të përgjakshme. Krimet ishin sheshit. Atëherë përsë ata donin me çdo kusht që krimi i tyre të mbulohej? Aq më tepër që do të iknin përmes Evropës së shkrumbuar nga lufta dhe, veç kësaj, as emrat s'u diheshin, bile as kombësia.

— Po ndoshta kishin frikë se mund t'i arrestonin, — tha Ana. — Të kujtohet q'thanë pleqtë për urdhrin e ndalimit të tyre?

Ai qeshi.

— Ti beson vërtet se qeveria kukull e asaj kohe do të guxonë të arrestonte një grup ekspedite që bënte kërkime me lejen e gjermanëve? Sepse nuk mund të merrët me mend që ata nuk e kishin lejen, bile mbrojtjen e tyre.

— Ke të drejtë, — tha Ana.

— Nga kjo del një problem tjetër, akoma më i errët: c'raport kishte midis ekspeditës dhe gjermanëve?

Bardhyl Krasta fërkoi ballin me dorë sikur përgjigjen ta nxirrte që andej.

— Që ajo vepronë me lejen dhe nën mbrojtjen e tyre, kjo s'ka nevojë për vërtetim, por diçka tjetër është e paqartë: a ishte ekspedita në lidhje të drejtpërdrejtë me gjermanët?

— Sigurisht, — tha Ana. — Kjo as që mund të vihet në dyshim.

— Kurse unë pikërisht për këtë dyshoj.

— Po si është e mundur që dikush të guxonte të vepronte jashtë vullnetit të plotë të gjermanëve në truallin ku ata sundonin?

Ai e vështroi ngulțazi, po rrezja e shikimit nuk binte në sytë e saj, po diku më tutje.

— Në qoftë se ata do të vareshin prej autoriteteve gjermane, ose do të kishin lidhje të drejtpërdrejtë me to, atëherë nuk do të mundoheshin e nuk do të vinin kaq shumë vërdallë për të zhdukur një bareliev. Gjermanët shkatërronin, plaçkitnin, digjin e hidhnik në erë qytete të tëra shekullore pa u bërë fare merak ç'thoshte bota për ta dhe s'do të ngurronte asnje grimë për të zhdukur nga faqja e dheut jo një famulli të humbur të Shqipërisë, me një bareliev brenda, po tërë zonën përqark. Mjaftonte që ekspedita t'ua bënte një kërkesë të tillë. Mirëpo ajo deshi të bënte gjithçka me duart e veta. Pra, ajo e fshehu krimin, ose më mirë qëllimin e krimit edhe prej vetë gjermanëve.

— Sipas teje, as vetë autoritetet gjermane të pushtimit në Shqipëri nuk e dinin misionin e vërtetë të kapucionëve të zinj?

— Unë dyshoj se nuk e dinin.

— Po atëherë, kush e dinte? Ndoshata qendra, Berlini.

— Ndoshata. Por as kjo nuk është e sigurt. Ka mundësi që as qendra të mos e ketë ditur.

— O, — ia bëri Ana. — Sikur e teprove.

Ai qeshi:

— Aspak. Dhe ja pse: ky është një krim, apo një aksion, quaje si të duash, që dilte jashtë stilit të kohës. Më kuption ç'dua të them? Nuk di si ta shpjegoj, por unë e ndiej se pikërisht kjo gjë tregon se krimi kapërcente mbi kohërat, mbi gjendjen politike të çastit, administratën, qeveritë. Më kuption?

Ana bëri «jo» me kokë. Ai lëvizti duart me nervozizëm.

— Si të ta shpjegoj... dhe vetë e kam vështirë ta formuloj me fjalë mendimin... Ky krim, që ndodhte midis kaosit dhe gjakut të përgjithshëm, ndahej nga koha e vet... më kuption... kishte një lidhje me të ardhmen dhe kjo vërtetohet nga vetë fakti... nga vetë fakti... që ata nuk donin kurrsesi të linin kujtesë për të. Donin që gjithçka të harrohej, të harrohej...

Anës iu kujtua varri anonim i mbretit të Arabisë Saudite në shkretëtirë, siç e kishte parë në lajmet televizive.

— Po përse? — pyeti ajo.  
Ai hapi krahët.

— Përse?! Po pikërisht këtu qëndron një nga çelësat e enigmës.

— Kjo enigmë paska shumë çelësa, — tha Ana duke qeshur. — Më kujtohet e shkreta gjyshja ime, kështu vërtitej nëpër shtëpi me një grumbull çelësash, shumi ca të panevojshëm.

Ata mbajtën këmbët. Pa e ndier kishin arritur përrapa famullisë. Përreth ishte po ai shurdhim, që dukej sikur shtohej edhe më tepër nga zbardhëllimi i gurëve aty-këtu. Midis tyre, veç, si e varur në erë, ndihej një shushurimë. Druri shekullor i arrës dukej sikur merrte frymë mundimshëm në atë zbrazëti.

— Kjo arrë duhet të jetë shumë e vjetër, — tha Ana.

Ai po kapërcente pragun e famullisë dhe ajo i shkoi pas. Kishin ditë që s'kishin qenë atje. Pas gjithë atyre tregimeve që kishin dëgjuar për ngjarjen e dikurshme, asaj iu duk barelievi tjeterlloj. Njollat e lagështirës nëpër mur i qenë afruar heshturazi nga ana e djathë dhe nga poshtë... Befas Ana u drodh. Ashtu si edhe herën tjetër, e kapi Bardhylin nga bërryli.

— Çfarë? — ia bëri ai.

— Shiko atje, përsëri...

Ai ktheu kokën andej nga tregonin sytë e saj. Te qoshja e murit, në gjysmëterr, shkëlqente diçka metali-ke. Një thikë... jo... një kuti bosh.

Ai iu afrua dhe i ra me këmbë. Kutia lëshoi një tingull të hollë.

— Kuti konserve, — tha ai.

— Këtu dikush vjen, — tha Ana. — Të ikim që këndeja.

— Ja dhe një copë gazetë e grisur, — tha ai dhe u përkul ta merrte. Ndërsa rrotullonte copën e gazetës në duar për të kuptuar nga teksti vjetërsinë e saj, Ana rrinte mbështetur fort te supi i tij.

— Këtu flitet për Plenumin e fundit, — tha ai, — kjo do të thotë se gazeta është e re.

— Edhe një herë tjetër, të kujtohet? — tha Ana.

— Ajo paketa e cigareve.

Ai ngriti kokën dhe po vështronë përreth.

— Dëgjove një si zhurmë?

Ana ishte krejt e zbehtë.

— Po, — tha me zë të shuar. — Të ikim që këndeja.

Zhurma e lehtë u përsërit pas shpinës së tyre dhe ai u kthye me vrull.

— Mos shko, — tha ajo, por ai arriti të shkëputej prej saj dhe bëri disa hapa gjer te galeria gjysmë e shembur. Zhurma u përsërit, po këtë herë e largët, si në ikje.

— Ndonjë qen, — tha ai. — Po ti ç'ke kështu?

— Sa u tremba!

Ai qeshi dhe i përkëdheli flokët.

— Edhe sikur të jetë njeri, s'ka ndonjë gjë për tu trembur, — tha. — Të tilla humbëtira janë të preferuara nga endacakët.

— Vërtet?

— Gjatë kërkimeve gjeologjike na ka qëlluar të takojmë tuafë të vëtmuar.

Ata dolën përjashta dhe Ana nuk ia lëshonte krahun. Ndërsa largoheshin, ai ktheu kokën dy-tri herë nga famulla. Pas mureve gjysmë të shembura të galerisë vazhdoin ca shkurre të dendura, nëpër të cilat mund të ishte larguar qeni apo endacaku.

— Po sikur tē ishte ndonjë diversant? — tha Ana.  
Ai buzëqeshi.

— Ka kohë që ata janë zhdukur. Veç kësaj, asnë diversant s'do tē ishte kaq i pakujdeshëm, sa tē linte kutinë bosh tē konservës në vendin ku fshihej.

Sa më shumë që i afroheshin fushës, aq më tepër Ana çelej. Dukej menjëherë që ajo nuk donte më tē vinte në famulli.

Në një pjesë tē udhës ata, si gjithë tē dashuruarit, rikujtuan njohjen e tyre, atë ditë me shi në mensë, budallallëqet e Senkës, rruginën përbri fushës së volejbollit.

— Sidoqoftë, sikur tē mos më kishe folur për barelievin, ndoshta nuk do tē ishim afruar bashkë, — tha ai.

U vërtit nga u vërtit, biseda erdhi prapë atje.

— Kam dëgjuar shumë ngjarje tē rënda në jetë, — tha ai, — por nuk e di pse, kjo nuk më hiqet nga mendja. Ndoshta tē lodha edhe ty.

— Jo, — tha Ana. — Mua vetë më shkon mendja atje. I përfytyroj ata duke i rënë me qysqi barelievit, ndërsa i vrari jepte shpirt te pragu, pa kuptuar dot se ç'bénin.

— Ashtu është, — tha ai. — I vrari vdiq, pa e kuptuar dot se ç'bénin, kurse ne duhet ta gjejmë.

Ata ecnin nëpër udhën e fushës, mbi tē cilën dielli i kursyer vjeshtor ndalej kryesisht mbi mullarët, si mbi tē njohur tē vet.

— Ai ishte një krim me rëndësi kombëtare, — tha Bardhyl Krasta, — ndryshe populli nuk do tē tronditej aq prej tij. Më kupton ç'dua tē them? Populli, pavarësisht se nuk diti ta shpjegonte, e ndjeu me intuitë se krimi kishte lidhje me gjithë vendin.

— Po në ç'kuptim? — pyeti Ana.

— Pikërisht për këtë kam vrarë mendjen këto ditë, — tha ai duke i rënë me këmbë një guraleci. Dhe i shpjegoi se, në qoftë se do tē bëhej fjalë për një vjedhje si ato tē Butrintit apo tē Apolonisë, çështja do tē ishte më e thjeshtë. Por këtu ishte fjala për një zhdukje.

Dilte pyetja: përse do t'u interesonte vrasësve zhdukja e emblemës së Muzakajve në një bareliev? Shkaqet mund të ishin të shumta dhe mund të kishin të bënин me shumë gjëra, me historinë, me origjinën e vetë Muzakajve, me analet diplomatike, me kufijtë e domenit të Muzakajve, me kufijtë etnikë të vetë Shqipërisë. Një emblemë, vetvetiu, ka lidhje me të gjitha këto. Me as gjësimin e saj ata donin të zhduknin një dëshmi. Një dëshmi tepër të rëndësishme. Pra ata donin të bënин një përcudnim në histori. Me se mund të kishte lidhje ky përcudnim? Me origjinën e Muzakajve? Me sa dihej. kjo ishte një gjë e padiskutueshme për historianët. Asnjë hamendje për origjinë greke, sérbe apo latine të tyre nuk kishte. Aq më tepër që ekzistonte dhe një gjenealogji e famshme e familjes së tyre, e shkruar nga një pinjoll i fisit fill pas pushtimit turk. Veç kësaj, vështirë se mund të derdhej gjak për origjinën e Muzakajve, pesë shekuj pas zhdukjes së familjes së tyre. Të ishte për origjinën e Kastriotëve, pra të Skënderbeut, mund edhe të besohej.

— Kam lexuar pjesë nga gjenealogjia e Muzakajve, — tha Ana. — Vende-vende më është dukur tepër tragjike, sidomos pjesa ku përshkruhet dyndja e turqve. Dhe forcat tona, sa vente, shterronin, kurse të tyret, sa vente shtoheshin... Nuk e di pse më kanë mbetur ndër mend këta rreshta.

Po i afroheshin fshatit. Si zakonisht, kooperativis-tët i përshëndetnin që nga qerret e tyre. Si gjithë fshatarët, ata thoshin «mirëmbrëma», megjithëse ishte akoma mbasdite.

— Mbetet çështja e kufijve etnikë, — vazhdoi të fliste ai. — Emblemat kanë shpeshherë lidhje me to. — Mirëpo, edhe për këtë, atij nuk i besohej fort. Kishte disa arsy. E para, domeni i gjerë i Muzakajve gjendej në mes të Shqipërisë dhe nuk takonte me asnjë kufi të shteteve fqinjë, kështu që përjashtoheshin pretendimet truallsore të tyre. Veç kësaj, në kohën që ndodhi krimi, nuk ishte më viti 1913, kur kufijtë e Shqipërisë disku-

toheshin midis diplomatëve të fuqive të mëdha, në Londër, dhe nga komisioni ndërkombëtar kërkoheshin vërtetime dhe dëshmi për të përcaktuar vijën e tyre. Aq më tepër që më 1943 gjithë Ballkani ndodhej nën sundimin e Rajhut gjerman dhe kufijtë e shteteve ballkanike qepeshin e shqepeshin sipas tekave dhe interesave gjermane, që nuk pyesnin për asgjë. Madje, jo vetëm Ballkani, por krejt Evropa ishte në gjendjen e një njeriu të lidhur mbi tryezën e operacionit, të cilit kirurgë të egër i hiqnin apo i shtonin gjymtyrë, sipas qejfit të tyre.

— Jo, — vazhdoi ai, — s'është çështje kufijsh. Duhet të jetë diçka tjetër.

— Po, ndoshta, duhet parë njëherë vetë emblema, domethënë ndonjë fotografi apo vizatim i saj, — tha Ana.

— Sigurisht. E kam menduar dhe atë. Të shtunën, porsa të mbërrrij në Tiranë, gjëja e parë që do të bëj, do të jetë kërkimi i saj.

— Do të shkoni të shtunën?

— Po, duhet të çojmë të dhënat e para në laboratorin qendror të kërkimeve. Do të vish dhe ti?

— Ndoshta. Kam tri javë që s'kam qenë në shtëpi.

— Atëherë do të udhëtojmë bashkë, — tha ai. — Do të më ftosh në shtëpinë tënde?

— Pse jo?

Përtej rrugës u dukën shtëpitë e para të fshatit. Mollarët e vegjël në kopshtet e fshatarëve kishin në majë nga një si kësulë mushamaje, për të mos u futur ujët në qendrën e tyre.

— Kapuçonë të zinj, — tha Ana duke qeshur. — Një natë i kam parë në èndërr.

— Shumë njerëz duhet t'i kenë parë në èndërr me tmerr, — tha ai.

— Kurse ata kushedi ku janë tanë. Rrojnë vallë?

— Pse jo? Duhet të jenë rrëth gjashtëdhjetë, shtatëdhjetë vjeç.

— Sikur ta dinin ata... — tha Ana mendueshëm.

— Megjithëse... se si më duket, sikur po u biem në qafë

kot, kur mendoj se asnjë dëshmi nuk ka kundër tyre, përkundrazi të gjithë dëshmitë i kanë në favor...

— Po qafa e Hill Mingës? — tha ai duke i rënë me pëllëmbë qafës së vet, ashtu siç kishte bërë fshatari plak një javë më parë.

Të dy qeshën një copë herë me zë të lartë.

— Qafa e Hill Mingës, — vazhdoi ai, — nganjëherë populli ka ca vegla të pagabueshme si ajo.

— Shiko atje, — tha Ana, — prapë ai plaku me sy të përqarë.

Porsa ai u kthyte ta shikonte, plaku uli kokën te gardhi.

— Na ndjek vazhdimi shët me sy, — tha ajo, — ç'të ketë vallë?

Ai qeshi.

— Ti do të fillosh të tallesh, — ia bëri ajo, — por unë e kam seriozisht.

Dhjetë hapa më tutje ajo ndali një nga nxënësit e saj dhe e pyeti për plakun. Nxënësi i tha se ishte Stefan Haurja, që e kishte shtëpinë në fund të fshatit, atje ku fillonin tokat e pambukut. Që prapa gardhit me kallama, plaku, sikur ta ndiente se flisnin për të, nuk i hiqte sytë prej tyre.

Pranë shtëpisë ku banonin mësueset, dëgjohej muzikë. Ana papritur vuri dorën te goja.

— O, — ia bëri ajo, — më doli fare nga mendja. — Po Senka sot ka ditëlindjen.

Ajo vrapi drejt shtëpisë, duke trembur një gjel deti, qeskat e syve të të cilit ngjanin çuditërisht me ato të Stefan Haurjasit. Para se të shtynte derën, ajo ia bëri dhe një herë me dorë atij, pastaj u fut brenda.

## 18.

Përmes gjumit Anës iu duk se dëgjoi një zallahi të largët. U ngrit nga shtrati dhe u afroa te dritarja. Ako-ma s'kishte gdhirë mirë. Me pëllëmbën e dorës fshiu në

dy-tri vende avullin që kishin zënë xhamat gjatë natës, por jashtë nuk dukej ndonjë lëvizje. Pranë mensës, si zakonisht në këtë orë, ishin karrocat e qumështit, kuajt e së cilave turfullonin, siç turfullojnë kuajt në mëngjes herët. Karrocierët, me ca hapa të çapëlyer nga pesha e bidonëve, i shkarkonin ata mu përpëra hyrjes së mensës. Cipa e ngricës që kishin zënë pellgjet, kërciste nën gizmet e tyre të mëdha. Ana vuri veshin. Zallahia vinte që larg, nga zyrat e kryesisë së kooperativës.

— C'është, Ana? — ia bëri Senka përgjumshëm dhe u kthye sakaq në krahun tjetër.

Ana ndjeu të ftohtë dhe u largua nga xhamat. Zbar-dhëllimi i mëngjesit binte i ftohtë mbi kuvertat e vajzave, që flinin. Tryeza me shishet e verës, pjatat dhe një tortë e ngrënë përgjysmë në mes, ishte akoma e pangritur, ashtu siç kishte mbetur nga festimi i ditëlindjes së Senkës. Duke u përpjekur të mos bënte zhurmë, Ana filloi të hiqte njérën pas tjetrës pjatat dhe shishet. Më në fund ajo ktheu përbrys mbulesën, mbi të cilën kishte rënë një njollë vere, dhe midis tryezës la vetëm vazon me lule. Nga jashtë erdhë prapë një zhurmë.

Diçka po ndodh, tha me vete Ana dhe u afroa prapë te xhamat. Këtë herë zërat dëgjoheshin më qartë. Midis zhurmërisë veçoheshin ca si klithma të prera, diçka midis zërit njerëzor dhe britmës së patave.

Nga lëvizjet e Anës, njëra nga vajzat u zgjua.

— Ana, ç'ke kështu, që pa gdhirë? — pyeti ajo ankueshëm.

— Diçka po ndodh, — tha Ana me zë të ulët.

Njëra pas tjetrës vajzat u zgjuan dhe, ashtu të përgjumura siç ishin, me këmishat e natës prej fanellate që i tregonin më të vogla në moshë, u ngjiten te xhamat e dritäres.

Jashtë ndihej vërtet një shqetësim. Midis zërave dëgjoheshin tanë edhe hapa. Që pas një kanati që u hap duke kërcitur, dikush pyeti: c'është?

— Kanë kapur një njeri të dyshimtë, — u përgjigj një zë nga jashtë.

- Trifon, ti je?  
— Unë jam.  
— E ç'është ai njeri?  
— Dreqi e merr vesh.  
— E lajmëruan sekretarin e Partisë apo kryetarin?  
— Ja, tani shkuan ta zgjojnë.

Pas një ore, kur mësueset dolën për të shkuar në shkollë, grumbulli i njerëzve përparrë ndërtesës së kryesisë së kooperativës, akoma ishte atje. Vajzat shkuan të shikonin q'bëhej. Njerëzit rrinin në këmbë te hyrja, atje ku në stenda të kuqe, pranë afisheve të festave të nëntorit, ishin vendosur tabela me shifra të rendimenteve të grurit e të qumështit si edhe fotografi me pamje të ndryshme ngajeta në kooperativë. Një pjesë e njerëzve ishin brenda në korridor dhe herë-herë dilnin që andej me një shprehje të papërcaktuar në ftyrë. Njeriu i kapur ishte, siç dukej, brenda. E? — pyesnin ata që ishin përjashta. Ç'farë është? Të tjerët ngrinin su-pet: dreqi e di. Disa e kishin marrë çështjen shumë seriozisht, të tjerë gjysmë me të qeshur. Ata që vinin të fundit, pyesnin se ç'kishte ndodhur, dhe zërat u përgjigjeshin se kishin kapur një njeri të dyshimtë, natën, në arat e pambukut. Të tjerët thoshin se mund të ishte spiun, ose, së paku, sabotator, ca thoshin se ishte vjedhës kuajsh, aventurier, epileptik, i ikur nga çmendina e qytetit N.

Mësueset më në fund mundën të hynin në korridor. Atje ishte kryetari i kooperativës, sekretari i Partisë, Naumi, dhe të tjerë, të gjithë të grumbulluar rrëth diç-kaje që nuk dukej. Ato panë shpinën e mjekës së kooperativës, Nadires, që përkulej vazhdimisht dhe e kuptuan që njeriu i kapur ishte ulur, ose shtrirë drejt e në çimento.

— E? — ia bëri kryetari, kur mjekja ktheu kokën nga ai.

— S'di ç'të them, — tha ajo me zë të ulët. — Mund të jetë vërtet i sëmurë, mundet që bën vetë.

Kryetari i hapi pak njerëzit dhe u ul në bisht, përpara njeriut të kapur. Ftyra e tij ishte gjithë inat.

— Ç'je ti? — thirri ai. — Pizeveng, na prishe gjakun që pa gdhirë. Pak telashe kam në kokë. Fol, ç'je?

Njeriu i ulur drejt e në çimento vështronë me sy të çakërritur kryetarin. Ai ishte i zbehtë, me mjekër, veshur me një xhup të vjetër, gjitha arna. Në prehërmbante një torbë akoma më të vjetër, grykën e së cilës e shtrëngonte me dorën e djathtë.

— Do flasësh apo jo? — i thirri kryetari mu në turi. — Nuk më shpëton dot, more vesh? Ç'deshe të bëje natën tek ara e pambukut. Fol, kush të ka dërguar, Brezhnjevi po ai tjetri...

— Fordi, — ia bëri Kozmai me zë të ulët.

I kapuri vazhdonte të vështronë me sy të llahtarisur.

— Ç'e ke atë torbë? Nuk do të flasësh? Dale pa më sheh.

Me një lëvizje të vrullshme kryetari i rrëmbeu torbën nga duart. Njeriu lëshoi një klithmë tmerri, si atë që kishte dëgjuar Ana në mëngjes herët. Ai u hodh që ta merrte prapë, por dy-tri duar e mbajtën. Pastaj nisi të përplasej, të shkumbëzonte e të lëshonte klithma të shkurtra «blla» «blla» «blla».

— Jepja, o kryetar, — tha dikush, — jepja se s'durohet.

Kryetari e kishte hapur ndërkaq torbën dhe po nxirrte ç'kishte brenda. Të gjithë prisnin të shikonin kushedi çfarë, po s'kishte vec ca shishe bosh uji mineral, ca kavanoza dhe dy shishe arançate, nga ato të tipit të vjetër, me tapë porcelani, që mbyllët me tel. Kishe gjithashtu një copë bukë, një konservë, një çibuk bronzi të frikshëm dhe ca fletë të mbushura me shkarravina pa kuprim.

— Na, — tha kryetari, duke i hedhur torbën. Njeriu e rrëmbeu dhe e shtrëngoi pas trupit në një mënyrë të tillë, sikur do ta fuste midis brinjëve. — Me siguri është

i marrë, — tha kryetari dhe u kthye të ikte. Në zërin e tij kishte keqardhje.

Ai u fut në zyrë. Që pas derës gjysmë të hapur dëgjohej zëri i tij në telefon.

— Alo, policia e qytetit? Kemi këtu një njeri që s'merret vesh c'është? Si? Epo quaje si të duash, i dyshimtë, i padyshimtë. Mua vetë më duket se është i marrë. Lajmëroni njëherë andej nga çmendina, mos ka ikur ndonjë. Si? Po, po, këtu e mbajmë ne.

## 19.

Rreth orës 11 në sheshin përpëra kryesisë së kooperativës zbriti nga motoçikleta një hetues.

— Isha në kooperativën fqinjë për një rast shpërdomi, — i tha të parit njeri që takoi, Hill Mingës. — Më telefonuan nga qyteti të kthehem te ju për një rast të dyshimtë. Dini gjë ju?

Hill Minga tregoi me dorë nga ndërtesa e kryesisë.

— Atje e ke, — tha.

— Nga çmendina s'ka ikur njeri, — vazhdoi hetuesi.

— Kështu më thanë në telefon.

Hill Minga ngriti supet.

— S'të them gjë, o bir, — tha. — Kjo këtu s'më thotë gjë, — dhe i ra qafës me dorë.

Hetuesi e vështroi me sytë e tij gazmorë, sikur të thoshte: paskam gjetur kë të pyes, po ky duket vetë si i ikur nga çmendina.

Pas një çerek ore hetuesi u mbyll vetëm për vetëm me endacakun, në një nga zyrat e kooperativës. Njerëzit prisin me padurim se ç'do të ndodhë. Pas një ore hetuesi doli vetëm, por nuk tha gjë. Fytyrën e kishte të menduar dhe kérkoi t'i sillnin dy kafe.

Kureshtja u rrit akoma më shumë.

Kryetari i kooperativës doli dy tri-herë në korridor, por nga zyra ku qe mbyllur hetuesi, nuk dëgjohej as gëk as mëk.

— Ç'hetues, u thoshte kryetari njerëzve që takonte në korridor, — edhe peshqit sikur të merrte në pyetje, do të dëgjohej diçka.

Hetuesi doli aty afër drekës. Dukej pak i lodhur në fytyrë, por i qetë. Edhe në fytyrën e endacakut kishte njëfarë qetësie. Kur doli përjashta, u duk akoma më i zbehtë dhe kuptohej menjëherë që drita e dieillit i vriste sytë.

— S'është aspak i marrë, — i tha hetuesi kryetarit të kooperativës, që doli menjëherë nga zyra e tij.

— Po ç'është atëherë? Të lajmërojmë prapë policinë?

— S'ka nevojë, — tha hetuesi. — Ai do të vejë vetë atje, po të jetë nevoja. Lëreni të lirë.

Kryetari vështronte me habi herë hetuesin herë endacakun që rrinte përjashta si hu, nën shikimet e kurreshtarëve.

— Po atëherë t'i jipim ndonjë gjë, — i tha kryetari.

— Të them të drejtën më këputi shpirtin.

— Si të doni, — tha hetuesi, pa e vështruar. Dukej menjëherë që mendjen e kishte gjetkë. Sytë e tij të çelët ishin krejt rastësisht aty. — Është një rast i rrallë, — vazhdoi ai përhumbshëm.

Njerëzit u grumbulluan përreth për të dëgjuar ndonjë gjë, po hetuesi nuk tha gjë tjetër veçse përsëriti:

— Është një rast jashtëzakonisht i rrallë.

## 20.

Ajo që morën vesh për endacakun, ishte vërtet jo e zakonshme.

Veniamin Papa, 54 vjeç, i pamartuar, me profesion topograf, kishte lindur në një familje zanatçinjsh të vegjël, në Tiranë, në rrugën «Miss Durrhaim» nr. 16. Po në këtë rrugë, pothuajse ngjitur me shtëpinë e tyre përdhese, ishte shtëpia e madhe dykatëshe e Qorrmetave, pasanikë dhe pronarë tokash. Në vitin 1946 Qorrme-

metajt, megjithëse të shpronësuar nga pushteti, mba-heshin akoma mirë ngaqë nuk kishin kaluar nëpër asnje nga gjyqet e popullit, për shkak të mosbashkëpunimit me pushtuesit, gjë tepër e rrallë në rrethet e borgjezisë së lartë të Tiranës. Më 1946 Veniamin Papës, që ishte atëherë 22 vjeç, dhe ashtu si gjithë familja e tij kishte qëndruar mënjanë luftës, i dukeshin gratë dhe vajzat luksoze të Qorrmetajve po aq të paarritshme si edhe më parë. Kështu që atë mëngjes të paharruar, kur njëra prej vajzave, Marija, e thirri me një shenjë që nga dritarja e katit të dytë, atij iu duk se u shtremberua qelli e i derdhi mbi kokë yjet. Ti banon në këtë rrugë, i tha ajo, kur ai u ngjit lart dhe po rrinte krejt i hutuar në dhomën e saj, ku pasqyrat prej bronzi të praruar ia hidhnin shoqja-shoqes pamjen e tij prej guaku, sikur t'i thoshin njëra-tjetrës: shikoni këtë hutaq që zonjëza jonë kushedi pse e thirri që nga rruga. Të kam parë shpesh, megjithëse emrin s'ta di. Veniamin, tha ai, kështu më quajnë. Veniamin, përsëriti ajo. Emër i bukur Edhe vetë s'je i keq. Ai u skuq gjer te veshët. Veniamin, tha ajo me zë të embël, e kam kuptuar që të pël-qej. A je gati të bësh diçka përmua? Sytë e tyre mbeten të mbërthyer një copë herë mbi njëri-tjetrin. Më parë ai ishte gati të bënte gjithçka për të, por erdhia luftha, dhe ajo që ai ishte gati të bënte, sa vente zgogëlohej e aq më tepër tanë, dy vjet pas Çlirimt, kur sapo kishin nisur reformat e mëdha.

Ajo kuptoi gjithçka. Në ballë iu bë një rrudhë dhe ndoshta gjithë humbjen që kishte sjellë e do të sillte akoma koha për ta, atë humbje që ishte shpërndarë në mijëra ditë e në mijëra fakte, ajo e ndjeu të përmbledhur në formën e një goditjeje sëpate, mu në mes të ballit. Nuk tha asgjë, vetëm në heshtje, ngadalë, sikur të kryente një rit, iu afrua dhe e përkëdheli nga flokët. Djalë hallexhinjsh, ai pothuajse s'kishte pasur të bënte fare me femra. Dantellat e saj i ranë në kokë, jo sikur të ishin thurur me penj, por me zinxhire. Dhe kështu, në vrullin e pasionit, i mybytur midis atyre dan-

tellave, ai i premtoi se do të bënte ç'të kërkonte ajo. Pastaj, kur u qetësuan të dy, ai, me fytyrë të prerë (pasqyrat përsëri ia jepnin atë shoqja-shoqes, por tanë pa gëzim, përkundrazi me një ndriçim ogurzi), krejt i ngurosur, po priste të dëgjonte kërkeshën e saj. Priste ndonjë gjë të frikshme, atentat kundër ndonjë personaliteti komunist, hedhje bombe në ndonjë miting, shpërndarje traktesh etj., kurse ajo që kërkonte Maria ishte diçka tjetër. Ishte një kërkeshë që atij, në krahasim me ç'priste, iu duk e lehtë, paksa e çuditshme vërtet, po kurrsesi e rrezikshme. Për ty që je topograf, kjo është vëganërisht e lehtë, i shpjegonte ajo, përmes përkëdheljeve. Aq më tepër se ke punuar edhe në zyrat e kastërës. Dhe është fare, fare e lehtë, do vetëm pak shkathësi dhe pak guxim. Dhe si shpërblim (shpërblimin ajo ia tha me zë fare të ulët dhe, sa më tepër që ajo e ulte zërin, aq më i madh i dukej shpërbimi atij), pra, si shpërblim, përvèg trupit të saj, do të kishte dhe shumë, shumë gjëra të tjera.

Kështu ai nisi, ndoshta për herë të parë në rruzullin tokësor, një punë që s'kishte as traditë, madje as emër, në asnjë gjuhë të botës. Pra ishte viti 1946, ai vit që si tërmët, dridhëte rrafshirën e tokës, që po u ndahej fshatarëve. Po prisheshin sinoret e vjetra, kufijtë midis çifligjeve, shenjat, gurët, gardhet, gjithçka po rrënohej, shuhej, shkulej si nga një tufan. Të shpronësuarit merrnin vesh me pikëllim zhdukjen e shenjave mbitokësore në kufijtë e çifligjeve dhe po vrissnin mendjen se si t'i zëvendësonin ato me shenja nëntokësore, të padukshme. Sepse ata kishin shpresë se do të vinte një ditë që çifligjet do t'i merrnin përsëri. Po ku do t'i gjenin atëherë sinoret e zhdukura?... Do të plaste sherri, do të derdhej gjak... Prandaj duhej menduar qysh tanë, kur kujtesa që akoma e freskët, duheshin marrë masa që të zëvendësohej gjithçka me shenja të reja, të një lloji, tjetër, poshtë, thellë nën tokë, o më terr.

Kështu, pa qenë plotësisht i ndërgjegjshëm se ç'bën-te, ai u nis një ditë për në Shqipërinë e Mesme. Kishte

me vete një torbë, brenda së cilës kishte ca shishe dhe ca skica. Në shtëpi tha se do të shkonte në një aksion të madh të rinisë në Veri. Rrugës dy-tri herë i shkrepit i hidhte në ndonjë kanal ato shishe e skica të nëmura, që i ngjanin si radiografia e një kufome dhe të kthehej mbrapsht. Ose së paku, të gënjenje, të thoshte se shkoi dhe i futi nën dhe atje ku duhej.

Mirëpo, për të bërë të parën, nuk e linte kujtimi i asaj, kurse për të dytën kishte frikë. Tërthorazi Qorrmemetajt i kishin bërë kërcënimin se ata do të verifikonin punën e tij dhe, në qoftë se ai do të i mashtonte, do të detyroheshin ta denonconin.

Ai mbërriti në ish-çifligjet e Qorrmemetajve pas dyzet e tetë orësh. Ishin ca ditë pranvere të jashtëzakonshme. Kudo nëpër fshatra binin daullet e festës. Kishte nisur Reforma Agrare. Kudo flitej për tokën, tregohezin histori, ngjarje, vallëzohej për të. Ajo ishte kudo, gati-gati të besohej se ajo po ngrihej më këmbë me tërë shtatin e saj, për t'u përzier me qiejt. Thoshin se tokat po ua ndante fshatarëve vetë Enver Hoxha. Çdo ditë gdhinte me daulle dhe mbaronte me daulle... Kurse natën, pas zallahisë, heshturazi, si hije ugareve, shkonte ai. Hapte gropë me një shat të shkurtër, vendoste brenda shishe, i mbulonte prapë. Nganjëherë rrinte për një kohë të gjatë mbi skicat, ngatërhohej, mezi i gjente sinoret, mallkonte nëpër dhëmbë. Vetja i dukej i neverishëm, si hijenë, por i kujtohej Maria, në atë puhi dantellash, dhe merrte zemër.

Vendosja e shenjave të nëndheshme vazhdoi plot një muaj. Më në fund ajo torturë mbaroi dhe ai, me zemër të lehtesar, iku. Sipër tokës vazhdonte ndarja e tapive, bëhej festë, vallëzohej, por shenjëzat ishin tanë poshtë saj, në terr, në lagështi, më të tmerrshme se qdo minë lufte.

Qorrmemetajt e priten me gjësim, e falënderuan, i dhanë shpërbllimin e premtuar, duke i rikujtar dhe një herë mbajtjen e sekretit. Kurse ajo nuk iu dha më. I shmangej kur ai e kërkonte, thoshte se ishte e sëmurë.

Dukej e zbehtë në fytyrë, ndoshta ishte sëmurë vërtet.

Kaloi mjaft kohë, ai gjeti punë përsëri si topograf në ndërtimin e rrugëve. Pothuajse e kishte harruar atë ankth tokash, balte, gropash nëpër terr. Vetëm nganjëherë, kur ndiente erën e dheut, e kapte një angushti. Ai shtegtim i dukej tani i largët si në botën e përtejvarrit.

Mirëpo një ditë e kërkuan përsëri. Siç duket, Qorrmemetajt ua kishin rekomanduar miqve të tyre. Shpërblimi qe i majmë. Më i madh se i pari. U mendua sa u mendua, pastaj pranoi. Dhe kështu, pas shtegtimit të dytë, erdhi i treti, i katërti. Tani u mësua me to. Gjithçka ishte e ngjashme: tokat, fytyrat e të shpronësuarve kur jepnin porositë, skicat, hartat. Por shenja, shumica preferonin shishet, si më të thjeshtat e më të sigurtat, por kishte nga ata që donin copëra mermeri, thika të vjetra, gurë të shenjtë, medaljonë, lugë argjendi.

Ca kohë dukej sikur e harronin, pastaj kujtoheshin përsëri. Ishin gjithmonë fytyrai të panjohura, që e përcillnin te njëri-tjetri. Atij i dukej se kishte rënë në një kurth, nga i cili, edhe po të donte, s'dilte dot.

Veçanërisht u shtuan ofertat kur filloj kolektivizimi i tokave dhe krijimi i kooperativave të para. Kjo ishte një batërdi e re mbi ato pak sinore që kishin mbetur. Kanalizimet e mëdha, futja e mekanikës bujqësore, drenazhimi, kërkonin risistemimin e tokës. Gjithçka ndërronte formë. Pastaj filloj risistemimi i fshatrave, hapja e rrugëve automobilistike, traseja e hekurudhës. Të gjitha këto kërkonin sinore të reja të nëndheshme. Dhe ish-pronarët, të shtyrë nga një frikë gati bestyde, si në ethe, kërkonin të viheshin shenjat sa më shpejt, sa më shpejt.

Por ai e kishte gjithmonë e më vështirë. Tokat mezi njiheshin. Për ditë të tëra humbte orientimin. Vetëm përvoja e fituar nga shtegtimet e mëparshme e ndihmon-te për ta rigjetur. Nganjëherë vendoste të hiqte dorë, por s'kishte vullnet. Kjo është hera e fundit, thoshte me vete sa herë që nisej. I dukej vetja si i mënjanuar ngajeta, tamam lakuriq nate,

Nganjëherë, kur udhëtonte me tren dhe vështronte tokat e kooperativave nga të dy anët e trasesë, mendonte shenjat që kishte vënë thellë nën to. Ish-pronarët shpresonin se do të vinte një ditë që ato shenja do ta lëkundnin tokën si një çarçaf të madh. Dhe do të rrokulliseshin e do të shkundeshin prej saj gjithë këto kooperativa e ferma, me rrugët dhe shtëpitë e tyre, me kryesitë, pllakatet e ngjitura mureve, me shtëpitë e kulturës, antenat e TV-ve, pambukun, makinat shirëse, festivalet e amatorëve.

Ja ç'kriminel jam unë, thoshte ai, por në brendësi të ndërgjegjes ishte i qetë. Ishte i sigurt që kjo nuk do të ndodhë. Ato relike lugetërish do të kalbeshin nën tokë, pa dalë kurrë në drithë.

Herën tjetër nuk do të pranoj, thoshto me vete. Ofertat në të vërtetë po rralloheshin. Shumë ish-pronarë kishin vdekur, të tjerë s'merreshin më me sinoret, kishin humbur shpresën. Por kishte kokëfortë që rrinin çdo natë me orë të tëra mbi skicat e çifligjeve të tyre. Më 1956, pas kongresit XX të Bashkimit Sovjetik, pati prapë disa oferta. Pastaj prapë më 1961, kur filloi blokada. Më 1967, kur filloi mbyllja e kishave dhe e xhamive, pati porosi për disa nga ish-pronat e manastireve dhe të teqeve.

Disa herë e kishin kapur, por ai kishte shpëtuar lehtë, duke u shtirë herë si i sëmurë psikik, herë si heremit, apo evangjelist shitetës. Në shtëpi e dinin të së-murë vërtet. Tani nuk mendonte më të kthehej në jetën normale. Ishte shumë vonë, kishte frikë prej saj, ngaqë prej kohësh kishte humbur çdo lidhje me të. Ishte lidhur me një botë tjetër, atë të hijeve dhe, megjithëse nuk kishte më nevojë ekonomike (paret i kishte groposur aty-këtu nëpër fusha), ai rrinte e priste sinjale nga ajo botë.

Sinjalet ishin tepër të rralla këto dhjetë vjetët e fundit. Rasti i fundit ishte në të vërtetë një përsëritje. Dy vjet më parë, në kufijtë e tokave të kooperativës së tipit të lartë ishin bërë punime të rëndësishme tharjeje e

shkripëzimi në një truall kënetor. Kjo gjë i kishte shtyrrë trashëgimtarët e ish-pronararëve të kérkonin rivendosjen e disa sinorëve, të zhdukura me siguri gjatë punimeve.

Ai kishte tri javë që endej këndeja. Ditën, ashtu si edhe herën e parë, flinte në famullinë e vjetër, prapa bokërimave. Natën zbriste në fushë. I kishin mbetur përvëndëvetëm disa shenja të fundit, kur e kapën.

21.

Bardhyl Krasta e gjeti hetuesin në klub, duke i treguar kryetarit të kooperativës dhe sekretarit të Partisë, Naumit, hollësira nga rrëfimi i endacakut. Herë pas here ata të dy përplasmin gjuhën pas qzellës nga habia. Gjeologu u ul në tryezën e tyre, vuri dorën në mjekër dhe po dëgjonte.

— E çuditshme, — tha ai, kur hetuesi mbaroi së folur dhe nisi të pinte kafen e dytë. — Ndoshata ju e keni dëgjuar, para tridhjetë e ca vjetësh, pikërisht këtu ka ndodhur një krim i rëndë, që në njëfarë mënyre ngjan disi me këtë që treguat. E keni dëgjuar?

— Jo, — tha hetuesi. — S'kam shumë kohë që kam ardhur në N. dhe nuk mund të them se e njoh mirë zonën. Bardhyl Krasta, duke u përpjekur të ishte sa më i kursyer në fjalë, i tregoi për krimin dhe prishjen e barielivit.

Hetuesi tundi kokën në mënyrë mohuese.

— Nuk e di këtë gjë, — tha prapë, — s'e kam dëgjuar.

— Kurse mua m'u duk e çuditshme pikërisht një farë lidhjeje midis veprimeve të tyre, — tha gjeologu.

— Ndërsa ata u përpinqën të zhduknin një shenjë, ky bënte të kundërtën, përpiquej të rivendoste shenjat e zhdukura.

Hetuesi e dëgjonte gjeologun me buzëqeshje, por kuptohej menjëherë që mendjen e kishte akoma te rrëfimi i endacakut.

— A mund tē rifillojë hetimi pér një krim tē vjetër tridhjetetrevjeçar? — pyeti Bardhyl Krasta. — A nuk eshtë vonë?

— Pér tē zbuluar një krim, nuk eshtë kurrë vonë, — tha hetuesi. — Jo tridhjetetre, por treqindetridhjete-trevjeçar tē jetë një krim, eshtë detyrë tē zbulohet.

— Ju më pëlqeni, — tha Bardhyl Krasta. — Unë jam vetë inxhinier pér kërkimin e naftës dhe në punën time kam tē bëj shpesh me afate shekullore. Dua t'ju bëj edhe një pyetje, që ndoshta do t'ju duket naivë, por ju e kuptioni... unë s'marr vesh nga punët gjyqësore...

— Po ju dëgjoj, — tha hetuesi.

— Dua t'ju pyes diçka pér alibinë, — vazhdoi Bardhyl Krasta. — Një alibi a mund tē hidhet poshtë?

Hetuesi ngriti supet.

— Natyrisht, në qoftë se eshtë e pavërtetë. Domethënë në qoftë se nuk eshtë alibi.

— Hm, — Bardhyl Krasta u përtyp nëpër dhëmbë.

— Po si eshtë puna? — pyeti më në fund hetuesi. Tjetri nuk priste veç këtë fjalë, pér tē thënë disa hollësira tē ngjarjes. Hetuesi nisi ta ndiqte me vëmendje.

— Nga ato çaste që treguat, mua më duket se alibia e atyre kapuçonëve eshtë vështirë tē kundërshtohet, — tha ai, kur gjeologu mbaroi së foluri. — Pér tē vënë në dyshim alibinë e tyre, eshtë e domosdoshme që, së paku, tē dalë një dëshmitar që tē thotë se i ka parë ata pranë vendit tē krimtit. Pérndryshe... E shoh që jeni i pakë-naqr.

Gjeologu hapi krahët, si pér tē thënë: «ç'të bësh».

— Po ç'ju shtyn tē besoni se krimin e kanë bërë ata?

Bardhyl Krasta deshi tē thoshte: qafa e Hill Mingës, por nuk ishte i sigurt se hetuesi do ta kuptonte humorin e tij. Vec kësaj, duhej shpjeguar më parë historia e Hill Mingës. Nga mikrobusi që ishte gati pér t'u nisur në Tiranë, shokët i ranë borisë.

— Nejse, — tha ai më në fund, duke u ngritur. — Pér mua ishte një kënaqësi njojja me ju.

— Pér mua gjithashtu, — tha hetuesi, duke ia ngu-

lur sytë e qeshur. — Në qoftë se do të keni ndonjë nivojë, — vazhdoi ai, — ose thjesht, po t'ju bjerë udha në N., më telefononi të pimë një kafe bashkë.

— Me gjithë qejf, — tha gjeologu dhe i dha dorën — Mirupafshim, kryetar, mirupafshim shoku Naum.

— Mirupafshim! — i thanë ata.

22

Të nesërmen, në orën 11 të mëngjesit ai e priste Anën në kafe «Flora». Kishte zënë një vend në qoshen më të fundit të saj, pranë xhamave, prej nga dukej rruga dhe kalimtarët që shpejtonin në shi. Në trotuarin matanë, te vitrina e agjencisë ajrore, po ndërronin tabellat e orareve të avionëve.

Pa ngritur kokën, ai e ndjeu ecjen e saj midis ndnjëseve të ulëta.

— Mirdita, — tha ajo, — u vonova?

Ai i buzëqeshi dhe ajo u ul përballë tij. Duke parë lëvizjet e saj, rregullimin e fundit mbi gjunjë, ngritjen e kokës, buzëqeshjen e dytë, që është gjithmonë më e thellë se e para, ai mendonte për aftësinë që kishte Ana për të krijuar aty për aty, kudo që të ndodhej, një vatër ngrohësie dhe marrëveshjeje. Dhe kjo nuk ishte një ngrohtësi lodhëse, as një gjendje pasigurie, që kërkonte vazhdimi shëvendje, ushqim dhe që, në mungesën e parë të frazave, krijonte alarm midis të dashruarve. Përkundrazi, pamja e saj ishte qetësuese dhe vetëm kur ajo ikte, drejt peshimi i tij pësonte një farë lëkundje. Tani ai kishte kaq përvojë në jetë, sa të kuptonte se kjo ishte tamam dashuri.

Porositën kafe.

— Ishe në arkiv? — pyeti ajo.

Ai pohoi me kokë, por kuptohej menjëherë që ishte pak i zhgënjer.

— Nuk gjete gjë?

— Jo..., përkundrazi emblemat ishin aty të gjitha,

veçse, ashtu si edhe më parë, çdo gjë mbetet e pashpjegueshme.

— E shoh që prapë t'u mërzit pak, — tha ajo. — Po analizat në laborator për naftën si duken?

— Vazhdojnë, — tha ai. — Ka shumë shpresë. Unë jam pothuajse i sigurt se ajo është një zonë nafte.

Ndërsa pinin kafenë, midis bisedave të tjera, me ndërprerje, ai i tregoi për emblemat e kryezotëve të Shqipërisë para pushtimit turk. Ajo dëgjonte me shumë vëmendje. Për të ishte diçka e re, që nuk e kishin bërë as në lëndën e historisë. Para ardhjes së turqve Shqipëria ishte mbushur plot me flamurë, shenja, kështjella, kalorës, baronë, dukë, kryezotë, kontë. Dhe të gjithë këta kishin emblemat dhe vulat e tyre, me gjithfarë simbolesh: luanë të kurorëzuar, bedena, yje me pesë ose gjashtë cepa, zambakë, ujk me dhëmbë përashta, shqiponja dykrenare, shqiponja me një kokë, të kuqe, të zeza, të bardha, brirë dhie etj.

— Sa çudi, — tha Ana. — Po ajo, emblema e Muzakajve?

— Një emblemë tipike, e ngjashme me disa të tjera, — i shpjegoi ai. — Shqiponja e vjetër, me një yll në mes.

— Me një yll në mes? — ia bëri Ana, — Po nuk të duket pikërisht kjo gjë, një arsy... për ta zhdukur?

— E kuptoj ç'do të thuash, — tha ai, — por, do ta mendosh thellë, s'ka ndonjë logjikë...

— Po ja... ylli...

— E çfarë? — ia bëri ai. — Çfarë ndodh, në qoftë se ylli u zhduk në një barelie?

— Ke të drejtë, — tha Ana. — Në të vërtetë s'do të kishte asnjë kuptim.

Ata filluan të flisnin për gjëra të tjera dhe nuk e përmendën më barelein. Në këtë orë lokal i kafes ishte zakonisht i qetë. Aty-këtu njerëzit bisedonin me zë të ulët. Dëgjohej herë pas here shfryrja e aparatit të ekspresit. Ndihej një evë e mirë kafeje. Pa e ditur as vetë pse, Ana nisi të fliste për jetën e saj. Ai e dëgjon-

te gati me mallëngjim. Tek fliste, gishtat e Anës bënин ca si vija mbi syprinën e tryezës. Babai oficer artilerie. Nëna aktiviste. Një vëlla më i vogël. Në fillimin e bllokadës, atëherë kur ai bënte stazhin me specialistët çekë dhe sovjetikë, ajo ishte 8 vjeç. I mblodhën në sallën e madhe të shkollës. Drejtori tha: fëmijë, xh... xhi... Hrušovi u bë armik. Atij i mbeti në gojë fjala xhaxhi, që u përpoq ta zëvendësonë aty për aty. Disa kujtuan se tha xhuxhi dhe qeshën. Ai u skuq. Në mbarim të tetë-vjeçares një paratifo. Pastaj vitet e shkollës së mesme. Pak balet, pak basketboll. Pusulla e parë e një djali. Brigadat kulturore, pjesëmarrja në mylljen e kishave dhe të xhamive më 1967. Vitet e universitetit. Aksionet. Dashuria në vitin e dytë të fakultetit. Një operacion apendiciti më 1973. Vdekja e gjyshes më 1975. Pas diplomës ajo u emërua mësuese në fshat, ai shkoi për specializim, një vit në Kinë. Kur u kthyte, dukej tjetër njeri. Flokët i qenë rralluar. Por kryesorja s'ishte kjo. Ajo qau heshturazi dy ditë, pastaj ia tha hapur: diçka ishte thyer midis tyre. Ai dëgjoi në heshtje. Pastaj seç tha nëpër dhëmbë një proverbë të vjetër kinezë. U ndanë me dinjitet, si miq.

— Ja, kjo është e gjitha, — tha Ana, — ajo që mund të quhet «jeta ime».

— O, kjo s'është akoma jetë, — tha ai. — Është thjesht rini.

Sytë e saj ishin të njomur në një dritë të butë. Përreth ndihej po ajo erë e mirë kafeje.

### 23.

Gjatë ditëve që qëndroi në Tiranë, Bardhyl Krasta i kaloi pothuajse gjithë mëngjeset në laborator. Dy herë u takua me Anën në shtëpinë e tij, kurse kohën tjetër e kaloi me vajzën e vogël.

Ana u nis të martën me trenin e mëngjesit. Ai shkoi ta takonte në stacion dhe e përcollti gjer te dera e va-

gonit. Frynte një erë e lagesht dëbore. Vjedhurazi ai shikonte dy rrathët e lehtë mavi nën sytë e saj dhe kishte ndjesinë se lidhja e tyre do të ishte e gjatë, gjer në pambarim.

Treni u nis. Ana ia bëri me dorë që pas xhamit. Fishkëllimat e lokomotivës mbetën një copë herë në ajrin e lagësht.

Mbasditen e fundit, para se ekipi i tyre të nisej përsëri për në zonën e kërkimeve, ai e kaloi përsëri me vajzën e vogël. E coi në pasticeri, i tregoi në formë përralle prishjen e barelievit prej ca njerëzve të ligj dhe u kënaq shumë që midis «pse-ve» të pafundme të saj disa përkonin përafërsisht me «pse-të» e tij.

Kur gjeologët u kthyen përsëri në fshat, atje kishte rënë dëborë. Si të dehur nga gjëzimi i asaj, ata erdhën vërdallë një copë herë nëpër fshat. U vinte keq që dëbora ishte e butë dhe vende-vende kishte filluar të shkrinte.

Nga trualli rrotull stallave ku kishin nxjerrë lopët holandeze, ngrihej një avull i lehtë. Pllangat e bardha mbi lëkurën e lopëve ishin aq të ngjashme me pllangat e dëborës mbi tokën bojëkafe, saqë të vinte të besoje se bashkë me dëborën do të shkriheshin edhe ato. Dhe të vinte çudi se si ngeleshin aty, gjer në pranverë, madje edhe më pas.

Bardhyl Krastës i dukej se kishte bërë një marrëveshje të heshtur me vetveten që të mos merrej më me ngjarjen e bareliefit. E para, se ishte marrë pak si tepër, e dyta se tani kishin mjaft punë. Kërkimet kishin hyrë në një fazë vendimtare dhe koha ishte e çmuar për çdo gjeolog.

Mirëpo, për habinë e tij, në fshat vazhdonte biseda për ngjarjen e hershme. Ajo ishte po aq e vrullshme, si në netët e ndezjes së parë të zjarrit, në mos më tepër. Atë që mehej në mbrëmje, bashkë me ftohjen e vatrës, pleqtë e vazhdonin të nesërmen në klub, pranë filxhanit të kafesë.

Qe hapur fjala se Gjykata e Lartë e Tiranës do të dërgonte së shpejti njerëzit e saj për të rifilluar hetimet. Nuk dihej kush e solli këtë lajm. Një ditë, hetuesi që i kishte rënë rruga aty pranë, qe kthyer përsëri me motoçikletë kot, se për të pirë një kafe me Bardhyl Krastën dhe, ndoshta, kjo i kishte bërë njerëzit të besonin për rifillimin e hetimeve.

Ndërkaq nxënësit e klasës së fundit i quan një ditë në grup gjer te famullia e vjetër dhe, pasi u treguan me dy fjalë ngjarjen, ua dhanë atë si temë hartimi: «Si pri-sheshin monumentet e kulturës në regjimet antipopullore të së kaluarës».

Në gazetën lokale dikush me inicialet Z.T. batoi një shkrim për ngjarjen dhe s'kaluan shumë ditë, kur eks-kursionistët që erdhën me një autobus të «Albturizmit» nga N., pasi vizituau kooperativën, kérkuau të shikonin bareliefin e lashtë.

— Tani që e fillove këtë... s'di si ta quaj... baterdi, mos u hiq mënjanë, — i tha një ditë duke qeshur Ana Bardhyl Krastës, kur ai i pohoi se nuk kishte ndër mend të merrej më me enigmën e vjetër.

Ndërkaq Kozmai u ngjethte mishtë grave të fshatit duke u shpjeguar se si retina e syrit të njeriut ka aftësi që, në çastin para vdekjes, të fiksojë pamjen e fundit që sheh në jetë. Kështu që çdo viktimë e ka të ngrirë pamjen e vrasësit të vet në sy, dhe ky është shkaku që vrasësit me përvojë u nxjerrin sytë viktimate, për të zhdukur gjurmët e fundit.

Bardhyl Krasta i kishte thënë se kjo ishte ndoshta një fantazi, mejgithëse dramatikisht dukej, e fuqishme. Por Kozmai ngulte këmbë se ishte e vërtetë dhe se ai e kishte lexuar me sytë e tij në revistën «Nëntori», apo «Shëndeti i popullit», s'i kujtohej mirë.

Kurse në klubin e fshatit pleqtë ishin ndarë në dy grupe përsa i përket ngjarjes së famullisë. Një palë, me Miço Stronin në krye, ngulnin këmbë se vrasësit nuk mund të ishin kapuçonët e zinj, përderisa natën e krimtit ata ishin parë në Hanin e Haureve, kurse pala tjeter, me Hill Mingën në krye, besonin që vrasjen e

kishin bërë ata. Pleqtë e tjerë dëgjonin sa dëgjonin, pastaj bëheshin herë me një palë, herë me tjetren.

Vetëm një njeri nuk përzihej asnjëherë në bisedën për krimin e dikurshëm. Përkundrazi, sa herë që dikush e përmendte atë, ai gjente një shkak për t'u larguar. Ky njeri ishte Stefan Haurja.

24.

Të gjitha shenjat ishin se do të kishte naftë. Gjeologët ishin në vrullin më të madh të punës. Bardhyl Krasta mezi gjente pakëz kohë për të takuar Anën. Herë pas here ekipi lidhej me telefon me Tiranën për t'u konsultuar. Çdo gjë shkonte për mrekulli.

Të premtën mbasdite Bardhylit i dhimbte koka dhe, meqenëse Ana ishte e zënë me mbledhjen e prindërve, ai vendosi të bënte një shetitje në fushë, i vetëm. Me gjithëse bora kishte shkrirë pothuajse kudo, athëtima e saj ishte akoma në ajër. Pas futjes së borës në gji, toka dukej si më e re.

Ai ishte larguar mjaft kur e kuptoi se po drejtohej andej nga bokërimat. Nuk kishte qenë prej kohësh dhe ndoshta nuk do të vente më. Së shpejti ekipi do të zhvendosej më larg dhe kushedi kur do t'i binte rruga këndej. Sidoqoftë nuk duhej të ikte si hajdut. Kjo ishte ndoshta arsyja që, pa e kuptuar as vetë, këmbët e kishin drejtuar andej. Po vinte, si të thuash që të ndahej me diçka që i kishte turbulluar mendimin për shumë kohë.

Plloja përpara famullisë ishte po aq e zymtë si edhe më parë. Gurët e bardhë aty-këtu midis kaçubeve i shtomin asaj zymtie një ndjesi memeclli. Kurse përballë famullisë, pak si mënjanë, druri i arrës sundonte i vëtëm në atë boshllék të madh.

Ai kapërceu pragun dhe, ashtu si edhe herët e tjera, qëndroi përpara barelievit. Lagështira kishte sajuar mbi suvanë e vjetër të murit ca sì njolla dhe damarë. Iu kujtuan fjalët e Kozmait për retinën e syve të të vrarëve, dhe me vete tha: sidoqoftë ky mur e ka parë krimin.

Në atë çast dëgjoi një zhurmë të lehtë. Ndryshe nga hera e parë, kur kishte qenë me Anën, u rrëqeth. Qëndroi si i ngrirë në vend. Zhurma u përsërit, ashtu si edhe herën tjetër, nga e djathta e tij, te mbeturinat e galerisë.

— Kush je? — thirri ai.

Një çast s'u dëgjua asgjë, veç qetësisë që shtypte si një membranë veshët e tij. Pastaj iu duk se ndjeu hapa të lehtë që po largoheshin. Në mendje vetëtimthi i shkoi endacaku, paketa boshe e cigareve, kutia e konservës. Ishin po ata hapa si atë ditë.

— Kush je? — thirri prapë, dhe zëri i tij sikur e gjaliroi nga ngurosja. Vrapoi nëpër galerinë gjysmë të shembur. Endacaku s'është më këndej, mendoi. Pra, hapat ishin të tjetëkujt. Nga zhurma e ecjes së tij s'dëgjonte asgjë. Qëndroi prapë. Galeria më tutje ishte e pakalueshme. U hodh mënjanë midis shkurreve dhe doli në ajër të pastër. Iu duk se hapat i dëgjoi përsëri, këtë herë përjashta, të shoqëruara nga një gërvimë guralecësh. Muri i famullisë zgjatej edhe disa metra. Ikësi duhej të ishte tanë pas qoshes. Bardhyl Krasta bëri disa hapa përtej murit, pastaj qëndroi. S'dëgjohej asgjë. Ai bëri një hark, për t'i shmangur ndeshjes së papritur me të panjohurin edhe eci përpara. Hapat e tij bënин «kërr-kërr» mbi guralecët. Papritur e pa njeriun. Qëndronte ngjitur pas murit, sikur të donte të murohej brenda. Kur e pa që u zbulua, u shkëput nga muri dhe, me një lëvizje të beftë, me gjymtyrë pak të hapura, i doli ballas. Në dorë mbante një gur të madh.

Bardhyl Krasta mbeti. Ishte Stefan Haurja. Sytë e tij të përqarë dukeshin si të varur poshtë, në buzet kishte një si jargë inati.

— Ç'bën këtu? — tha Bardhyl Krasta.

Tjetri, para se të fliste, kërcëllitinofullat, sikur t'i provonte.

— Mos u afro se do të të thyej kokën.

Zëri i tij ishte i mprehtë, në dy-tri vende i ngjirur.

— Pa shih, pa shih, — ia bëri gjeologu. Ai akoma

s'po e merrte veten nga e papritura. Turbull e ndjeu se ndodhej në një pozitë gjysmë qesharake.

— Ti s'je në vete. Lëre atë gur.

— Mos u afro.

Vetëtimthi Bardhyl Krastës i shkoi nëpër mend se mos ishte ky që kishte bërë vrashjen tridhjetë vjet më parë dhe... tani... dhe tani... çfarë tani? — pyeti veten. Kishte nevojë të fitonte pak kohë.

— Në këtë moshë, — i tha, — s'të ka as hije.

— Pusho.

Stefan Haurja i mbante sytë poshtë dhe gjeologu e kuptoi se po i shikonte këmbët.

— S'të ka fare hije, — tha ai.

— Ik që këndej, — tha Stefan Haurja. Gjuha e tij i gatuante me zor fjalët. Pështyma e pengonte. — Sa erdhe ti, ngatërrove dynjanë. Ik nga fshati ynë, djall. Aha, ia bëri me vete gjeologu. Dicka përpinqej të merrte kuptim në mendjen e tij, po s'arrinte të mpiksej.

— Pse, — tha i qetë, — ç'punë të prish ty? Të vjen keq që kërkojmë naftë?

Sytë e tjeterit ishin si të skuqur nga rrufa. Nga çasti në çast dukej sikur do të rridhnin mbi faqe.

— Ti je djall me brirë. Largohu që këndej.

S'mund ta ketë bërë ky krimin, ariti të mendonte gjeologu. Nuk do ta vinte veten kaq hapur në dyshim.

Ai deshi të bënte edhe një hap tjeter, por Stefan Haurja iu hakërrua:

— Mos u afro.

— Mjaft, mjaft, — ia bëri gjeologu. — Të thashë, s'të kanë lezet këto. Siç duket, ke parë ndonjë film në televizor. Ja, po iki.

U kthyë vërtet dhe bëri ca hapa përpara. Ndërkaj kishte mendjen se mos tjetri e ndiqte. Me siguri është i marrë, ose psikopat, tha me vete. Vazhdoi të ecë dhe, duke ecur, mbante vesh. Nga një i marrë, sidoqoftë, duhej të ruhej.

Por Stefan Haurja nuk e ndoqi. Gjeologu u kthyë në fshat vetëm. Gjatë rrugës dy-tri herë tha me vete:

ç'të bëj me të? Nuk i dukej tepër serioze për ta treguar ngjarjen, por edhe ta linte në heshtje... Dreq o punë, mendoi.

25.

Të dielën në mëngjes ndodhi një ngjarje paksa e rrallë. Patra Baltaj, plaça 120-vjeçare, kishte ardhur gjer në qendër të kooperativës. Ajo vinte këtu përherë e më rrallë, vetëm në ngjarje të shënuara, ose në ndonjë vdekje me gjëmë. Ana nuk e kishte parë asnjëherë dhe nga tregimi i Bardhylit e përfytyronte pak ndryshe. Ishte e imët nga trupi. Njërin sy e kishte të veshur. Ngatërronte kohët. Kishte ardhur, ngaqë kishte marrë vesh se gjithë fshati fliste për ngjarjen e herësme. S'është shenjë e mirë kur kujtohet një vrasje e vjetër, kishte thënë ajo. Kjo do të thotë se i vdekuri kërkon shpagim.

Patra kishte marrë vesh se ishin ngrënë me fjalë djemtë (djem ajo quante pleqtë që kishin qenë të rinj kur ajo qe 70-80 vjeçë), pra ishin grindur për ca të huaj me festë të zeza. I mbante mënd edhe ajo. Vërtiteshin nëpër fusha si lanetë. I sillnin lajme lumi nga deti. I kthenin mendjen. (Nganjëherë Patra ngatërronte lumin me burrin e saj, që kishte emigruar në fund të shekullit të kaluar në Kanada e s'qe kthyer më).

Ajo kërkoi shpjegime se ku kishte mbetur puna. Dhe i shpjeguan se puna kishte mbetur këtu: një palë dyshonin se vrasjen e kishim bërë festezinjtë, por të tjerë thoshin se festezinjtë i kishin parë atë natë në Hanin e Haureve. Kështu që ishin larg. Po t'i kishte parë goftë edhe një sy i vetëm te famullia (goftë edhe një retinë, siç thoshte ai ngatërrestari, Kozmai), atëherë po, mund të thuhej se vrasësit qenë ata. Por te famullia e moçme, ti e di, gjyshe Patra, ç'humbëtirë është atje, s'kishte frymë të gjallë që t'i shikonte.

— S'kishte frymë të gjallë? Mos më lini të gënjej, po më duket se atje ka një dru arre, — tha ajo.

— Po, po, — u hodhën ata gjithë gëzim që ajo mbante mend arrën.

Një copë herë ajo vështroi rreth e qark, sipër koka të tyre, sikur të kërkonte të gjente drurin e arrës. Pastaj vështroi qiellin. Asnjë sy i gjallë, murmuriste me vete. Asnjë sy.

— Atë natë ka pasur vetëtima, apo jo? — tha pas pak. — Mos më lini të gënjej, se jam plakë, s'kam kohë të ndreq shpirtin. Arra është plakë, shumë plakë. Dhe kishte vetëtima.

— Po, — po, — thirrën ata. — Kishte vetëtima, si asnjëherë tjetër. Qielli llapste dhe kuajt hingëllinin të trembur.

— Kuajt tremben nga vetëtimat, — tha ajo. Deshi të shtonte dhe diçka tjetër, por e humbi fillin e mendimit. Iu kujtua kolera që kishte rënë në kohën e austriakëve, dasma e saj me flamurë, me mollë... filloj të fliste pér to.

— Ç'deshe të thoshe pér vetëtimat? — e pyeti Senka.

— Plaka e stërmocojmë e pa me habi, me syrin e saj tē vetëm.

— Po jua thashë njëherë, — tha. — Ju ankoheni se atje s'kishte njeri tē gjallë që t'i shikonte festezinjtë. Po ju harruat arrën, se kështu i harroni pleqtë.

— Jo, gjyshe Patra. Ne tē duam, ne...

Ajo u zemërua, por zemërimi i saj që i butë, si zëri i saj, dhe nuk bëri gjë tjetër, veçse i kthjelloi mendimin.

— Atëherë mos u ankonni, — tha. — Mos u ankonni më, po shkoni dhe çajeni drurin e arrës. Mos më lini tē gënjej, se jam shumë plakë; çajeni arrën, në qoftë se festezinjtë kanë qenë atje, ajo i ka parë. Se arra sheh në dritën e vetëtimës. Mos më lini tē gënjej, se jam plakë. Dhe atë që sheh arra, e mban mend më mirë se njeriu.

Njerëzit përreth saj dëgjonin gojëhapët.

Atë që ndodhi më pas për zbulimin e enigmës së krimit, gjeologët e dëgjuan më vonë copa-copa, me përmasa të mjegulluara, sikur të ishte pjesë e një legjende. Ata ndodheshin për kërkime në një zonë tjetër, dhe pjesën kryesore të ngjarjes Bardhyl Krasta e mori vesh nga Ana, në ditët kur vinte për ta takuar.

Ana i tregoi se, ndërsa një pjesë e njerëzve i morën fjalët e Patra Baltajt si pjellë të një fantazie të fundit të trurit të plakur, të tjerë, përkundrazi, thanë se ajo u kishte rikujtuar një të vërtetë të njojur. U pyetën ca zdrukthtarë të vjetër në N. dhe ata pohuan se është e vërtetë, ose, së paku, kështu kishin dëgjuar nga zdrukthtarë të tjerë më të vjetër, se druri i arrës ka vërtet cilësinë të fotografojë peizazhin që ka përparrë. Ky fotografim është i **ngadalshëm** dhe mund të **vazhdojë** me dhjetëra vite rrësht. Me një fjalë, ndërsa shkrepja e aparatit gjatë fotografimit zgjat një pjesë të sekondës, për drurin e arrës kjo shkrepje vazhdon 30 ose 40 vjet. Gjatë kësaj kohe pamja që arra ka përparrë, një copë kodër, një mullar, një mulli, ose thjesht një hapësirë e çelët apo zyntore, fiksohet, si në film, në trupin e saj. Dhe pastaj, kur nga druri i arrës nxirret rimesoja, mbi fletët e rimesos mund të shikosh aty-këtu, në formë siluetash të zbehta, ato që arra ka fotografuar. Kurse në rastet kur ka vetëtima, fotografimi ndodh shpejt, si me blic. Dhe zdrukthtarët pleq betoheshin se kishin parë më sytë e tyre mbi fletët e rimesove koka dhish, hije ujjqish, madje edhe hije njerëzish. **Pikërisht** këtë kishte pasur **parasysh** Patra Baltaj kur u kishte kujtuar **vetëtimat** dhe u kishte thënë të **çanin arrën e moçme** për të **gjetur** në të **fytyrat e vrasësve**.

Kozmai, që ngulte këmbë se kjo nuk ishte **veçse** një **variant** i asaj që kishte lexuar në revistën «**Ylli**» apo «**Radiopërhapja**» për retinën e syrit të viktimit, bëri një udhëtim të dytë në N., për të pyetur edhe një herë. Ai shkoi në kombinatin e përpunimit të drurit dhe pyeti dy anëtarë të këshillit teknik. Ata i pohuan se kjo

ishte diçka që qarkullonte vërtet midis punëtorëve të vjetër të drurit, por ata nuk mund të thoshin asgjë me saktësi. Përsa i përket përbërjes së drurit të arrës, ai është i pasur vërtet me lëndë kimike dhe nuk përjashtohet mundësia e një veprimi të shpejtë, nën ndikimin e dritës së vetëtimës...

Akoma më pranë legjendës ishte tregimi se si u pre një copë nga druri i arrës, si u mbart me qerren e Miço Stronit gjer në N., si në oborrin e kombinatit të drurit, një nëpunës i shkurtër vinte vërdallë për të gjetur një rimeso të mirë për dhomën e gjumit, se gruan e kishte shumë naziqe për çështje të rimesove etj. etj., dhe si pastaj, më në fund, druri shekullor u fut në makinën e prerjes, kurse ata rrinin përreth në një heshtje të zymtë. Ndërsa fletët e rimesos dilnin nga makina njëra pas tjetrës, dhe një punëtor u përkul mbi njérën prej tyre dhe e fshiu një copë herë me një leckë vaji, befas Miço Stroni ia bëri mbyturazi «ja, ja» dhe ata ndien një angushti në shpirt, ndërsa mbi rimeso po ravijëzoheshin zbehtë, sikur të mbinin në mjegull, ca si trekëndësha të errët... kapuçonët e zinj.

Kurse Stefan Haurja... Por, ah, te Stefan Haurja, ngatërröheshin të gjithë, madje dhe Ana, që kujdesej aq shumë për të qenë e saktë. S'kishte kaluar shumë kohë e, megjithatë, askush nuk ishte në gjendje të shpjegonte saktësisht kohën kur dyshimet ranë mbi Stefan Haurjen: përpara prerjes së arrës, apo pas. Ndoshta kjo vinte se për një farë kohe ai u dergj i sëmure në shtrat. Kishte ethe të ftohta, fliste përqart. Filloi të dilte me një thes të zi në kokë. Lojti nga mendja, thanë të gjithë, zaten ai gjysmë i lojtur qe. Mirëpo pikërisht atëherë ai zbuloi të fshehtën e krimit. Alibia e kapuçonëve të zinj ishte e sajuar. Nuk kishin qenë të katër kapuçonët e zinj atë natë me vetëtimë te muilliri i usta Janinës, as tek Hani i Haureve. Kishin qenë vetëm dy prej tyre, kurse dy të tjerët, pikërisht në atë kohë, po bënin, siç duket, vrasjen, te famullia e vjetër.

— Po ata ishin katër, — kundërshtoi për herë të

fundit Miço Stroni. — Ne i pamë me sy, unë, Miti Shqepa dhe Tod Kërra. Ja, me këta sy i pamë. Fol, more Miti, fol, more Todi.

— I pamë, për nder, që i pamë, — përsërisnin dy të tjerët.

— Një m... i keni parë, — klithi Stefan Haurja. — Keni parë vetëm dy prej tyre, se dy të tjerët ishim unë me Lolo Shtëmbarin, të veshur të dy tepkë si ata, me pelerina, me kapuçonë në kokë.

Dhe midis habisë së përgjithshme ai tregoi se si të huajt i kishin pajtuar ata të dy, duke u dhënë një shpërbim të vogël, si i kishin kërcënuar që të mos nxirrin sekretin se do t'i pinte e zeza nga të gjitha anët, nga qeveria shqiptare, nga gjermanët, nga fshati i tyre dhe, më në fund, nga vetë ata, kapuçonët e zinj, dora e të cilëve të gjente kudo që të fshiheshe. Dhe pastaj ishin takuar me ta atë natë të paharrueshme te bregu i kënetës. Atje u kishin dhënë të vishnin pelerina si ato të tyre, me kapuçonë, pér të mbuluar kokën. Pastaj ishin nisur dhe kishin udhëtuar gjithë natën, gjer ndaj të gdhirë, nëpër shi e vetëtima. Atë natë Stefan Haurja dhe Lolo Shtëmbari s'kuptonin asgjë se ç'bëhej. U dukeshin të huajt si të çmendur dhe dy-tri herë deshën t'ia mbathnin, por i mbajti frika nga kërcënimet e tyre. Vetëm më vonë, kur u dégjua vrasja, ata sikur nuanhatën diçka, po prapë gjithçka mbeti e turbullt dhe e pashpjegueshme edhe pér ata vetë. Tridhjetë e ca vjet Stefan Haurja e mbajti të fshehtën të kyçur në zemër. Lolo Shtëmbari vdiq më 1971, dhe Stefan Haurjes iu duk se pas vdekjes së tij e fshehta iu rëndua edhe më shumë në gjoks. I dukej se kishte gisht në vrasjen dhe, sa më shumë shkonin vite, aq më tepër vetëtimat e asaj nate i llapsnin, me një dritë të bardhë, të panatyrshme, mes pér mes trurit. Nganjëherë shkonte në famulli, vështronë barelivin e shkulur, pragun ku ishte gjetur rojtari i vrarë dhe ikte si i dalldisur.

Kur njerëzit rifilluan prapë hetimin e krimit, ai e kuptoi se do ta kishte vështirë ta mbante akoma të fshehtën. Dhe kështu filloi ta nxirrite dalngadalë...

Bardhyl Krasta dëgjonte mendueshëm ato që i tregonte Ana. Dy-tri herë edhe ai bëri pyetjen se në ç'kohë Stefan Haurja e zbuloi të vërtetën, por Ana s'mundi t'i përgjigjej dot.

— E di pse të pyes? — tha ai. — Se jam kureshtar të di atë punën e fotografimit të drurit të arrës. Të them të drejtën, edhe më besohet, edhe jo. E vërteta është se brenda drurëve, sidomos brenda drurit të arrës ka mjaft silueta, që mund të shpjegohen në gjithfare mënyrash. Ndaj më ka shkuar mendja se mos njerëzve u është dukur se i panë vërtet hijet e kapuçonëve të zinj mbi rimeso, pasi Stefan Haurja kishte zbuluar të fshehtën. Përndryshe, ka ndodhur e kundërta: Stefan Haurja, i tronditur nga atmosfera e kërkimit që sa vinte dendësohej, vendosi të flasë.

— Ka mundësi, ka mundësi, — thoshte Ana.

— Por s'ka rëndësi kjo, — tha ai. — S'ka rëndësi nëse i ka fotograuar apo jo kriminelët druri i arrës. Në fund të fundit, të vërtetën e nxorën njerëzit. Edhe sikur shkencërisht të mos vërtetohet se një dru arre mund të «shikojë e të mbajë mend», siç thotë plaka Patra, në thelb kjo është e vërtetë, përderisa në këtë rast, te druri shekullor i arrës populli ka gjetur një simbol të vetvetes. Asgjë s'i shpëton syrit të tij dhe ai është e vërmja dëshmi për gjithçka.

Ishtë dhjetor dhe ata shëtisnin në fushë të hapët. Qielli bëhej gati të borëtonte.

— Vetëm një gjë s'u zbulua që s'u zbulua, — tha ai.

— Përse e bënë atë krim.

Në zërin e tij kishte keqardhje.

— Kjo, me sa duket, s'ka për t'u marrë vesh kurrë, — tha Ana.

Era e dhjetorit fishkëllente ultazi mbi fushë.

27.

Shkaku i krimit doli në drithë në një mënyrë të thjeshtë, jo shumë kohë më pas. Dhe ja se si:

Midis një grupei ekskursionistësh që erdhën si zakonisht nga N. me një autobus të «Albturizmit», për të parë barelievin e mocëm, ndodhej një djalë i hollë, i gjatë, punonjës i Institutit të Historisë, që porsa ishte kthyer nga jashtë shtetit, ku kishte bërë hulumtime arkivale për mesjetën e hershme. Kur gidi shpjegoi me dy fjalë moshën e barelievit si edhe dëmtimin e tij, që ishte shoqëruar me një krim, hallësira të të cilit qenë zbuluar kohët e fundit, punonjësi i Institutit të Historisë bëri disa pyetje. Gidi u përgjigj, pa e shuar dot plotësisht kureshtien e tjetrit.

— Po ju a e dini se Muzakajt kanë pasur dy emblema? — tha ai.

Gidi ngriti supet.

— S'keni faj, — vazhdoi punonjësi i Institutit të Historisë. — Mos ma merrni për mendjemadhësi, por këtë nuk e di asnjeri. — Ai u skuq pak.

— E ju nga e dini? — pyeti një burrë i shëndoshë, që po përtvonte gështjenë të ziera.

Punonjësi i Institutit të Historisë u skuq edhe më.

— Porsa jam kthyer nga Venediku, ku isha për kërkime në arkivat e mesjetës. Atje e ndesha për herë të parë këtë gjë...

— Pa shih, pa shih...

Disa nga ekskursionistët që dëgjonin për herë të parë për krimin, deshën të dinin sa më shumë për emblemën e shkatërruar dhe e rrëthuan punonjësin e Institutit të Historisë.

— Ka mundësi që kjo të jetë pikërisht emblema e dytë, ose e fshehta, siç quhej, — tha ai. — Unë tani jam duke shkruar një studim, po s'jam i sigurt akoma nëse ka qenë pikërisht kjo këtu emblema e dytë.

— E si ishte ajo emblemë? — pyeti dikush.

— Një kronist italian, Giovani, e jep pëershkrimin e saj në një traktat të botuar në vitin 1510, — tha punonjësi i Institutit të Historisë. — Ai përmend atje disa emblema të kryezotëve të Shqipërisë, kurse për emblemën e dytë thotë se ajo, ndryshtë nga emblema e parë, përbëti shqiponjën e vjetër dykrenare të Muzakajve ka

dy rrëkeza, që, siç thonë, tregojnë burime nafte. *Duo rivuli qui naphtae fontibus indicio sunt.*

— Ah, pa shih, pa shih, — ia bëri prapë burri i shëndoshë.

— Në të vërtetë, unë erdha në këtë ekskursion vetëm për këtë gjë, — tha punonjësi i Institutit të Historisë.

Ana, me të marrë vesh ç'u bisedua midis ekskursionistëve, i shkroi Bardhylit. Ai ishte shumë i zënë dhe mundi të vinte vetëm pas dhjetë ditësh.

— Sikur ta dija, — tha ai porsa u takuan. — Kisha një parandjenjë se do të merria një letër të tillë prej teje.

— Kurse unë kujtoja se shkaku nuk do të zbulohet kurrë, — tha ajo. — Pra, shkaku paska qenë nafta, apo jo?

— Pa dyshim, — ia bëri ai, — pa asnë dyshim. Rrugës, kam menduar vazhdimisht për të. Kapuçonët e zinj s'kanë qenë as arkeologë, as folkloristë, por gjeologë nafte.

— Gjeologë nafte!

— Pikërisht. Mos të të vijë aspak çudi. Ata zbuluan që këtu kishte naftë, por, ndryshe nga gjeologët normalë, ata ishin jo nxjerrës, por varrmihës të naftës. Gjithë kujdesi i tyre ishte që të zhduknin çdo dëshmi të naftës. Ashtu si specialistët e huaj më pas, si grupi i sabotatorëve tanë vonë.

— Ç'kriminelë të neveritshëm!

— Emblema e Muzakajve ishte një nga dëshmitë e rralla, në mos e vëtmja, që vërtetonte burimet e naftës në këtë zonë. Duke e zhdukur atë, ata kujtuan se i fshinë gjurmët e naftës përjetë. — Ai tregoi me dorë fushën përreth. — Ashtu siç bëjnë pasanikët në prag të revolucionit, që groposin pasuritë nën tokë, duke pritur të kthehet prapë koha e tyre. Ishte viti 1943, një vit prag apo jo?

Ata ecnin nëpër fushë dhe herë pas here nga qerret fshatarët i përhëndesnin «mirëdita». Qielli ngjante me një xhamillëk të ftohtë, që dridhej lehtë nga era. Ai e

pyeste për të njohurit e tij, Hill Mingën, kryetarin, Nau-min, Patra Baltajn, Miço Stronin, Kozmanë, shoqet e saj. Të gjithë ishin mirë, të gjithë e kujtonin dhe u vinte keq që nuk ishte dhe ai në ditët e zbulimeve të mëdha. Tutje, në xhade, kalonte një kamion me armatura të pusëve të naftës.

— Ç'kombësi kishin vallë? — pyeti ajo.

Ai ngriti supet.

— Unë mbetem në mendimin e parë. Ata janë më të përgjithshëm se shtetet dhe administratat. Teknokratë, kozmopolitë, agjentë të shoqërive anonime ndërkontinentale. Kështu besoj.

— Anonime, — përsëriti Ana. — Të kujtohet varri i atij mbretit në rërën e Arabisë Saudite?

Ai qeshi, se iu kujtua vajza e tij e vogël.

— Me një fjalë, diçka e ngjashme me shoqëritë e sotme shumëkombëshe, — tha ai.

Ata kishin arritur te kodrinat. Edhe pak dhe përpara do t'u dilte famullia e vjetër. Gjer atje rrugën e bënë duke folur gëzueshëm për gjithfarë gjérash.

Arra e moçme, me gjurmët e prerjes në njëren anë, dukej si një e operuar plakë, që ka dalë për të marrë ajër në kopshtin e spitalit.

Ata hynë brënda dhe qëndruan disa sekonda përbalë barelievit. Vendi i shkulur në bariliev i kujtonte atij fletët e shkulura në dosjet e specialistëve çekë dhe so-vjetikë më 1961. Më vonë hartat e prishura të sabotatorëve. Ishte e njëjtë gjë.

Ata dolën përjashta dhe te pragu të dy mënjanuan këmbët, sikur kufoma të ishte akoma aty.

Jashtë arra plakë qindravjeçare dukej sikur merrte frymë ngadalë. Ata qëndruan për një kohë të gjatë përpëra saj, dhe secili më vete mendonte pak a shumë të njëjtën gjë. Ata mendonin se edhe pasqyrimi i tyre, sado i zbehtë, ishte atje, dhe po atje ishte gjithçka tjetër që lëvizte përreth dhe që ekzistonte. Sepse, dëshmi shekullore, siç ishte ajo, të kujtonte popullin që e kishte të shkruar gjithçka në trupin e vet.

# NÉPUNÉSI I PALLATIT TE ENDRAVE

## INTRODUSSI

Mi subjiciusse i legiis, ut mox. Nuditerat mea  
vix se cibis, deo, et omni libinjen e cruce, ne  
pantet e tyro et vino e noxiamate e obylime e bonum  
vite mihi libinje e obylime e tyro.

Pro taciti intermissione vobis knowne a fundit te jacte  
se pallitu, ut e a diligente solonisti te gryba, mi  
chrii fonsal e lekutu te eruges me aquila e cruce, ne te  
vertite. Menth che, nuper prie, eam exaltatio ad trans-

lum. Etiam si vobis datur iste exaltatio e subducere ple  
m e appudi te dilatetur, eandemque exaltationem per  
te lapus me horum regnorum. Dicitur hec eti i latere  
pene, quend eam non habet admodum e mala, nam e mala  
e. Prope greci et fabri sicut, indecum e quatu' seculis  
eche invenerunt dico, tunc horum me kirk' uero' vobis te ducere  
tunc non salutem.

Pro kirk' pugna debet eandemque. Non tunc de  
llevitio karissime te, vobis eti apud nos e. Easq' e' que  
mi aff' agnitione, inter omnia, uti libet e' tunc are  
tula.

1900 jumătate de secol. De la Măcin la Râmnicu Sărat, unde  
se întâlneau în mod normal cǎlărașii, se urmăreau obiecte  
de valoare și se aduceau mărfuri de la vînditori din  
Bucovina și din Moldova. În același secol se înmulțeau  
în Moldova și în Bucovina cǎlărașii care se aduceau la  
Bucovina.

În secolul al XVII-lea - prima oară -

în Moldova se înmulțeau cǎlărașii.

În secolul al XVIII-lea și începutul secolului XIX  
se înmulțeau cǎlărașii și în Moldova și în Bucovina. Totuși  
în secolul al XVIII-lea se înmulțeau mai mult cǎlărașii  
în Moldova. Când se înmulțeau cǎlărașii în Moldova,  
în Bucovina se înmulțeau cǎlărașii.

În secolul al XIX-lea - în secolul XIX  
se înmulțeau cǎlărașii în Moldova și în Bucovina.

## NEPUNESTI PĂTITATIT TE ENDRRAVE

în secolul al XIX-lea se înmulțeau cǎlărașii în Moldova și în Bucovina.

Așa căkălații se înmulțeau. Edineț păcădua  
pe lângă râul Valea lui Mihai. Cetățile românești  
se bazează pe râuri și pe grădini. Deasupra

acestei cǎlărașii, care se înmulțeau și preiau locurile unei  
vile, nu erau cǎlărașii români, ce se sădeau până la munte și  
se hrăneau cu fructe.

În secolul al XIX-lea cǎlărașii din Moldova și Bucovina  
se înmulțeau și se înmulțeau cǎlărașii români. Aceștia  
se aduceau la Bucovina și la Moldova și se înmulțeau  
în Moldova și în Bucovina. Aceștia se aduceau la Bucovina  
și la Moldova și se înmulțeau în Moldova și în Bucovina.

În secolul al XIX-lea se înmulțeau cǎlărașii români  
în Moldova și în Bucovina și se înmulțeau cǎlărașii români.

În secolul al XIX-lea se înmulțeau cǎlărașii români  
în Moldova și în Bucovina și se înmulțeau cǎlărașii români.  
În secolul al XIX-lea se înmulțeau cǎlărașii români  
în Moldova și în Bucovina și se înmulțeau cǎlărașii români.  
În secolul al XIX-lea se înmulțeau cǎlărașii români  
în Moldova și în Bucovina și se înmulțeau cǎlărașii români.  
În secolul al XIX-lea se înmulțeau cǎlărașii români  
în Moldova și în Bucovina și se înmulțeau cǎlărașii români.  
În secolul al XIX-lea se înmulțeau cǎlărașii români  
în Moldova și în Bucovina și se înmulțeau cǎlărașii români.

MENGJESI

Mëngjesi ishte i lagësht e me sqotë. Ndërtesar masive, që çoheshin drejt e mbi lëvizjen e rrugës, me portalet e tyre të rënda e me kanatet e myllura e bënin edhe më të hirtë fillimin e dites.

Ebu Qerimi mbërtheu edhe kopsën e fundit të jakës së palltos, atë që e shtrëngonte zakonisht te gryka, vështroi fenerët e hekurt të rrugës me sqotën e rrallë, që u vërtitej përreth dhe ndjeu prapë një drithëtirë në trup.

Rruja, si zakonisht në këtë orë, ishte e mbushur plot me nëpunës të dikastereve qendrore, që shpejtonin përtë kapur me kohë orarin zyrtar. Dy-tri herë atij i shkoi ndër mend se mos bëri gabim që nuk mori një karrocë. Rruja gjer në Tabir Saraj ishte më e gjatë se c'e kishte menduar dhe, veç kësaj, në këtë sqotë mund të rrëshqitje mbi kalldrëm.

Po kalonte përparrë Bankës Qendrore. Më tutje du-  
keshin karroca të shumta të mbuluara me brymë përparrë  
një ngrehine tjetër masive, që kushedi e ç'ministrie  
ishte.

Dikush pérpara tij rrëshqiti në trotuar. Ebu Qerimi e ndoqi me sy se si u mbajt me zor në çastin e fundit pér të mos rënë krejt, si u ngrit aty pér aty dhe, duke mallkuar nëpër dhëmbë e duke vështruar herë xhyben e lerosur, herë vendin ku rrëshqiti, iku pérpara si i ndërkryer. Kujdes, ia bëri me vete Ebu Qerimi, pa e ditur as vetë se kujt ia drejtoi atë fjalë, të panjohurit apo vetvetes.

Në të vërtetë s'kishte pérse të merakosej aq shumë. Jo vetëm që nuk kishte ndonjë orar të saktë pér t'u paraqitur, por nuk e dinte nëse ishte e detyrueshme të paraqitej në përgjithësi gjatë mëngjesit. Befas Ebu Qerimi u kujtua se nuk dinte asgjë pér oraret e Tabir Sarajit.

Ra një orë diku nga e majta, me një tingull të bronztë, si në punë të vet, larg në mjegull. Ebu Qerimi shpejtoi hapat. Jakën prej gëzofi e kishte ngritur prej kohësh, megjithatë dora e tij bëri lëvizjen e njohur të ngritjetë së saj. Në të vërtetë të ftohtët nuk e ndiente te qafa, por diku te brinjët. Futi dorën nën pallto, te xhepi i brendshëm pér të parë nëse e kishte aty fletën e rekomandimit.

Kalimtarët në rrugë pér një çast iu dukën më të rrailluar. Nëpunësit kanë mbërritur nëpër dikasteret e tyre, mendoi me alarm, por aty pér aty e qetësoi veten: në fund të fundit ai s'kishte punë me ta. Ai s'ishte akoma nëpunës.

Larg iu duk se dalloi njërin krahë të Tabir Sarajit. Kur u afrua dhe pak, e kuptoi se nuk kishte gabuar. Ish-te vërtet ai, me kupolat e zbehta, të lyera me një ngjyrë, që dikur duhej të kishte qenë e kaltër, ose, së paku, ngjyrë gurkali, dhe që tani mezi dallohej nga sqota. Kjo ishte një nga pjesët anësore të tij, kurse hyrja duhej të ishte nga rruga tjeter.

Ebu Qerimi i erdhi rrrotull një sheshi gjysmë të shkretë, ku ngrihej një xhami me minare quditërisht të hollë. Hyrja ishte vërtet nga rruga tjeter. Ngrehinës së madhe të dy krahët i humbisnin në sqotë, kurse pjesa e saj qëndrore ishte e tërhequr përbrenda, sikur të qe

zmbrapsur përpara diçkaje. Ebu Qerimi ndjeu ankthi t'i rritej me shpejtësi përbrenda tij. Një rresht i gjatë hyrjesh ngriheshin të barabarta përskaj njëra-tjetërës, por, kur Ebu Qerimi u afrua, pa se ato nuk ishin hyrje, por portale të mbyllura me kanate të lagura, të pahapura prej kohësh.

Ai eci për së gjati, duke ndjekur me bisht të syrit atë rresht portalesh të shkreta. Një njeri me xhybe se nga mbiu pranë tij.

— Ku është hyrja? — pyeti Ebu Qerimi.

Njeriu me xhybe tregoi me dorë drejtimin e djath-të. Mënga e xhybes së tij ishte aq e gjërë, saqë ajo nuk mori aspak pjesë në tregimin e krahut. O zot, akoma me këto veshje, mendoi Ebu Qerimi duke ecur në drejtimin që i dha ajo dorë e hollë midis asaj mënge të përbindshme. Pas një copë here ndjeu përsëri ca hapa përbri tij. Ishte prapë njeriu me xhybe.

— Këndeje, — tha ai, — hyrja për nëpunësit është këndeje.

Ebu Qerimit i erdhi mirë që tjetri e mori për nëpunës. Ai u gjend më në fund përpara hyrjes. Kanatet e portës dukeshin më të rënda se c'ishin. Ato ishin katër, të gjitha njëloj, me dorezat e rënda prej bronzi. Ebu Qerimi shtyu njëren prej tyre, që për çudi u hap, dhe hyri në një korridor të ftohtë, tavani jashtëzakonisht i lartë i të cilit e bënte të dukej si një fund grope. Nga të gjitha anët kishte dyer. Ebu Qerimi shtyu dyert me radhë, gjersë njëra prej tyre u hap dhe ai u gjend në një korridor tjetër, më pak të ftohtë. Prapa një xhamllëku ai pa më në fund njerëz. Ata rrinin kokë më kokë dhe duhej të ishin portierët, ose, së paku, nëpunës që shërbenin atje, sepse mbanin ca si uniforma me ngjyrë të kaltër të zbeh-të, të përafërt me ngjyrën e kupolave të pallatit. Madje Ebu Qerimit iu duk se mbi uniformat e tyre dalloj për një çast njolla të ngjashme me ato që i qe dukur se kishte dalluar që larg mbi kupolat e që ishin të shkaktuar ndoshta nga lagështia. Po ai nuk pati kohë t'i vërente mirë të gjitha këto, sepse njerëzit me uniformë e lanë

bisedën që ishin duke bërë dhe i ngritën sytë në mënyrë pyetëse. Ebu Qerimi hapi gojën pér t'i pëershëndetur, por kaq hapur dukej në sytë e tyre pakënaqësia që u kishtë ndërprerë bisedën. saqë ai, në vend që të thoshte «mirëmëngjes», shqiptoi emrin e nëpunësit tek i cili duhej të paraqitej.

— Aha, pér pranim në punë, — tha njëri prej tyre. — Kati i parë nga e djathta, dera njëmbëdhjetë.

Si çdo njeri që kapërcen pér herë të parë portën e një institucioni të rëndësishëm qeveritar e aq më tepër që vinte me zemër të ngrirë, me dyshimin që do ta pranonin apo jo në punë, Ebu Qerimit ia donte zemra të këmbente dy fjalë me njerëzit e parë që takonte atje, përpara se të shkonte më tej, mirëpo atyre kaq shumë s'u durohej ta nisnin prapë atë bisedën e tyre të mallkuar që ua kishtë ndërprerë, saqë ai u nis drejt korridorit të brendshëm, sikur ta shtynin pas.

— Ja, andej, nga e djathta, — dëgjoi pas vetes një zë. Pa kthyer kokën, eci andej dhe vetëm tronditja e ajo drithëtirë e ftohtë që ndiente në gjithë trupin nuk e liniñ ta ndiente veten të fyer.

Korridori ishte i gjatë dhe i zymtë. Dyert dilnin në të me dhjetëra, të larta dhe pa numra. Ai numëroi njëmbëdhjetë dyer dhe ndaloi. Përpara se të trokiste, do të donte të pyeste pér t'u siguruar edhe një herë nëse ishte vërtet ajo zyra e njeriut që kërkonte. Mirëpo në atë korridor të gjatë s'dukej frymë njeriu. Ebu Qerimi u mbush me frymë, zgjati dorën dhe trokiti fare lehtë. Nga brenda s'erdhi asnjë zë. Ai vështroi sa djathtas majtas, pastaj trokiti prapë, këtë herë më fort. Nga brenda përsëri s'erdhi asnjë përgjigje. Pas trokitjes së tretë ai e shtyu derën dhe, pér çudinë e tij, ajo u hap fare lehtë. I tmerruar, deshi ta mbyllte përsëri, madje zgjati krahun pér ta kapur kanatin që vazhdonte të hapej akoma me një krismë vajtuese, por në atë çast sytë e tij panë se dhoma ishte bosh. Një copë herë qëndroi në mëdyshje, të hynte apo të mos hynte në atë zyrë pa njeri. Nuk i kujtohej asnjë rregulllore apo udhëzim pér një rast të tillë. Dera

pushoi më në fund së kuisuri. Me sy të palëvizshëm ai vështronte ca stola të gjatë që ishin vendosur anash muvit, në atë zyrë të boshatisur. Qëndroi sa qëndroi te pragu, pastaj dora e preku fletën e rekomandimit në xhepin e brendshëm të palltos, mori guximin dhe hyri. Drejtë marrë, tha me vete. Ndër mend solli shtëpinë e tij të madhe në Rrugën Mbretërore, fisin e tij të fuqishëm që mblidhej shpesh pasdarkave në dhomën e madhe me oxhak, dhe me një lëvizje të papritur u ul në njërin nga stolat. Për fat të keq kujtimi i shtëpisë e la shpejt dhe ai ndjeu prapë ankthin e mëparshëm. Veshët i kapën një si zhurmë zérash që nuk kuptohej se nga vinin. Vështroi përreth dhe vuri re se brenda në dhomë ishte një derë tjetër. Zérat dukej sikur vihin që prapa saj. Një copë herë qëndroi, mbajti vesh, por zhurma ishte po aq e paqartë sa, në fillim. Tani gjithë vëmendja iu përqëndrua tek ajo derë, prapa së cilës atij iu duk se ishte ngrohtë.

Mbështeti duart në gjunjë dhe qëndroi gjatë ashtu, pa lëvizur. Sido që të ndodhët, tani ishte brenda në ndërtesën ku rrallëkujt i kishte qëlluar të hynte. Thoshin se edhe ministrat mund të hynin këtu vetëm me një leje të veçantë. Dy-tri herë ktheu kokën nga dera prej nga vinin zérat, por e ndiente se, edhe sikur të kalonin orë dhe ditë të tëra në pritje, ai nuk do të ngrihej për të shtyrë atë derë. Ai do të priste atje, i ulur në stolin e gjatë, duke bekuar fatin që kishte mundur të arrinte gjer në atë paradhomë. Nuk e kishte menduar se mund të ndodhë kështu, kaq thjesht. Megjithëse s'kishte qenë dhe aq thjesht. E pra, e qortoi veten aty për aty, një rruge nëpër sqotë, ca portale të myllura, portierët me uniforma ngjyrë gurkali, në vestibulin e shkretë, a s'ishte e thjeshtë e gjithë kjo?

Megjithatë, pa ditur pse, psherëtiu.

Në atë kohë dera u hap dhe Ebu Qerimi u ngrit në këmbë. Dikush zgjati kokën, e pa dhe u zhduk prapë, duke e lënë derën të hapur përgjysmë. Që brenda u dëgjuar zëri i tij.

— Në paradhomë është dikush.

Ebu Qerimi nuk e kuptoi sa zgjati koha e pritjes në këmbë. Dera kishte mbetur gjysmë e hapur, po prej an-dej nuk vinin më tanë zëra njerëzish, por vetëm një shtrak-shtruk i çuditshëm. Njeriu që doli më në fund prej saj, ishte trupshkurtër. Ai mbante në njëren dorë një grumbull shkresash, në të cilat Ebu Qerimit iu duk se shkarkohej për fat të mirë gjysma e vëmendjes së në-punësit. Ai e vështroi megjithatë në mënyrë pyetë-se. Ebu Qerimi ndjeu dëshirën t'i kërkonte në një-farë mënyre ndjesë që e kishte nxjerrë nga dhoma, që me siguri ishte e ngrohfë, por shikimi i shkurtanit ishte i tillë, saqë Ebu Qerimit nuk iu hap goja, por vetëm do-ra e tij, me një lëvizje të ngadalëtë, nxori nga xhepi fletërekondimin dhe ia zgjati. Tjetri zgjati dorën e deshi ta merrte, por në çast e tërhoqi atë, sikur fleta të ishte e ndezur. Ai afroi vetëm kokën, lexoi për dy-tri sekonda, pastaj e tërhoqi edhe kokën. Ebu Qerimit iu duk se në sytë e tjetrit pa një shkëndijë qesëndie.

— Eja pas meje, — tha nëpunësi dhe u drejtua nga dera e jashtme.

Ai doli i pari në korridor dhe Ebu Qerimi i shkoi pas. Një copë herë u përpooq të mbante mend rrugën nga po shkonin, në mënyrë që, kur të dilte, të mund të kujton-te daljen, por pastaj e pa që kjo punë, veç që ishte pa kuptim, qe edhe e pamundur.

Korridori ishte akoma më i gjatë se ç'i qe dukur në fillim. Ndriçimi i vinte i dobët nga ca korridore të tjera anësore, në njërin prej të cilëve ata u kthyen më në fund. Nëpunësi trokiti në një derë dhe hyri, duke e lënë kanatin të hapur për Ebu Qerimin. Ebu Qerimi ndenji një sekondë në mëdyshje, po tjetri i bëri shenjë ta ndiq-te dhe ai hyri në zyrë.

Përpara se të ndiente ngrohtësinë, Ebu Qerimi ndjeu aromën e zjarrit. Një mangall i madh prej bakri qe vendosur në mes të dhomës. Pas një tryeze druri rrinte një njeri me fytyrë të vrenjtur, tepër të gjatë. Ebu Qerimit

iu duk se jo vetëm kur hynë, por qysh më parë sytë e tij ishin të ngulur te dera, sikur t'i priste.

Njeriu i shkurtër, që tani Ebu Qerimit po i dukej i afërt, iu afrua tjetrit dhe diçka i pëshpëriti te veshi. Sytë e fytyrëgjatit vazhdonin të vështronin nga dera në një mënyrë të atillë, që të dukej se dikush trokiste atje vazhdimshit. Ai dëgjoi sa dëgjoi pëshpërimën e nëpunësit, pastaj diçka mërmëriti, pa lëvizur asgjë në fytyrë. Ebu Qerimit iu duk se asgjë s'do të bëhej, se fleta e rekomandimit dhe të gjitha ndërhyrjet e tjera ishin pa vlerë përpara atyre syve, që kushedi pse kishin lidhje vetëm me derën.

Tamam në atë kohë diçka i thanë. Dora e tij, duke u fërkuar në mënyrë armiqësore me astarin e palltos, nxori letrën e rekomandimit, por në çast sepse iu duk se lëvizja e tij e shtoi zymtësinë e atmosferës dhe vetëtimi mendoi se mos i kishte dëgjuar gabim, ndaj deshi ta fuste përsëri letrën në xhep, por dora e nëpunësit të shkurtër u zgjat pikërisht nga letra. Ebu Qerimit i erdhë zemra në vend dhe ia zgjati edhe më letrën, por gëzimi i tij qe i parakohshëm, sepse nëpunësi, ashtu si edhe herën e parë, nuk e preku atë. Dora e tij bëri vetëm një shenjë në ajër, si për të treguar rrugën nga duhej të lëvizte letra për të mbërritur atje ku duhej. Ebu Qerimi, krejt i hutuar, e kuptoi më në fund se letrën duhej t'ia jepte nëpunësit tjetër, që ishte padyshim shumë më i lartë se shoqëruesi i tij.

Për çudi nëpunësi i lartë e mori fletën dhe, duke i shkëputur sytë nga dera, (Ebu Qerimi e kishte humbur shpresën për diçka të tillë), nisi ta lexonte. Ndërsa ai lexonte, Ebu Qerimi nuk ia ndante sytë, me shpresë se do të parazbulonte diçka në fytyrën e tij, por në atë çast nisi të ndodhë diçka që Ebu Qerimit po i dukej e tmerrshme, madje më tepër se kaq, ishte një lloj llah-tare e shurdhër, e ngjashme me atë që shkaktohet zakonisht nga tërmetet. Në të vërtetë, edhe kjo kishte lidhje me lëkundjet; zyrtari me fytyrë të vrenjtur, ndërsa vazhdonte leximin, po ngrihej dalngadalë nga vendi. Ngritja e tij ishte kaq e ngadaltë dhe në mënyrë të një-

trajtshme, saqë ishte pikërisht kjo që e tmerroi Ebu Qerimin, ngaqë iu duk se kjo ngritje nuk do të mbaronte kurrë dhe se zyrtari i tmerrshëm, që kishte në dorë fatin e tij, mu aty në sytë e tij do të kthehej në një përbindësh. Ebu Qerimi ishte gati të thërriste «mjaft, nuk dua të hyj në punë, kthema atë letër, veç mos u ngre ashtu», por në atë çast ngritja e zyrtarit më në fund mbaroi.

Shtati i tij, për habinë e Ebu Qerimit, ishte mesatar. Ebu Qerimi mori frymë thellë, por lehtësimi i tij ishte i parakohshëm. Pas ngritjes, nëpunësi i lartë, në një mënyrë po aq të njëtrajtshme, nisi të zhvendosej nga vendi i tij. Ai po ecte nga tryeza për t'iu afruar mesit të dhomës. Nëpunësi që e kishte sjellë Ebu Qerimin, e dinte siç duket këtë gjë dhe ishte mënjanuar për ta lënë të kalonte. Këtë herë Ebu Qerimi ndjeu të lehtësohej vërtet. Ishte një ngritje e thjeshtë nga vendi e trupit të mpirë nga qëndrimi i gjatë, nga vuajtja prej hemorroideve apo nga cërma, kurse ai kishte vënë kujën me veten e vet. Vërtet nuk ishte mirë me nervat kohët e fundit.

Për herë të parë atë mëngjes sytë e Ebu Qerimit vështruan me guximin e tij të zakonshëm sytë e një njeriu tjetër. Zyrtari e kishte akoma letrën e rekomandimit në dorë. Ebu Qerimi priste që ai t'i thoshte: «kam dijeni për ty, do të pranohesh në punë», ose në mos kaq, së paku diçka shpresëdhënëse, një premtim për javët e ardhshme, apo stinët e ardhshme. Jo më kot kushérinjtë e tij të shumtë kishin dy muaj e ca që kishin bërë të gjitha përcapjet e nevojshme për përgatitjen e këtij takimi. Kurse ai, Ebu Qerimi, që lebetitur para kohe përparrë këtij nëpunësi të lartë, i cili ndoshta kishte më shumë nevojë ta mbante mirë me fisin e tij të fuqishëm, sesa vëtë Ebu Qerimi me të. Ndërsa e vështronte, Ebu Qerimi ndihej kaq i qetë, saqë një çast iu duk se lëkura e fytyrës së tij ishte e aftë të pillte madje edhe një buzëqeshje. Dhe ai do ta bënte me siguri një gjë të tillë, sikur të mos ndodhët diçka mizorisht e papritur. Në këmbë, për-

para tij, zyrtari i rëndësishëm e palosi me kujdes letrën e rekomandimit dhe, në kohën që Ebu Qerimi priste fjalën e tij të mirë, tjetri e grisi atë në katër copa. Ebu Qerimi u drodh. Ai hapi gojën, për të thënë diçka apo ndoshta thjesht për të përballuar nevojën për ajër, por, sikur të mos mjaftonte grisja e letrës, zyrtari bëri një hap drejt mangallit dhe i hodhi copat e saj në të. Një flakë e shpejtë lodruese kaloi një çast mbi prushin e përgjumur, që dukej si i thinjur nga shtresa e hirit, pastaj u shua, duke lënë pas letrën e shkrumbuar.

— Në Tabir Saraj nuk pranohen rekomandime, — tha zyrtari me një zë të tillë, që Ebu Qerimit i kujtoi tinguillin e orës së vëtmuar në mesnatë.

Ebu Qerimi kishte ngrirë në këmbë. Ai nuk e kuptonte se ç'duhej të bënte: të rrinte akoma aty, të ikte menjëherë, të protestonte, apo të kërkonte ndjesë. Sikur të kuptonte njëren prej ideve të tij, nëpunësi i shkurtër që e kishte shoqëruar, doli qetësisht nga zyra, duke e lënë Ebu Qerimin vetëm për vetëm me zyrtarin. Ata ishin tanë ballë për ballë në të dyja anët e mangallit. Por kjo nuk vazhdoi gjatë. Me po ato lëvizje të ngadalta me të cilat kishte ardhur gjer atje, në një kohë që Ebu Qerimit iu duk pambarimisht e gjatë, zyrtari u tërroq përsëri mbrapsht gjer në vendin e vet, pas tryezës, por nuk u ul. Ai vetëm u kollit lehtë si përpëra një fjalimi dhe, duke vështruar herë derën, herë Ebu Qerimin, tha:

— Në Tabir Saraj nuk pranohen rekomandime, sepse një gjë e tillë, domethënë rekomandimi, është në kundërshtim me thelbin e Tabir Sarajit.

Ebu Qerimi nuk kuptoi asgjë.

— Jo hyrja e ndikimeve të jashtme, por, përkundrazi, mbyllja e tyre, jo depërtimi, por izolimi, pra, jo rekomandimi, por mosrekondimi është një nga kriteret bazë të Tabir Sarajit. Megjithatë që sot ti pranohesh me punë në këtë pallat.

C'është kështu? tha me vete Ebu Qerimi. Sytë e tij, si për t'u siguruar edhe një herë, vështruan mbeturinat e fletës së shkrumbuar mbi përgjumjen e prushit plak.

— Po, ti qysh tani je i pranuar këtu, — përsëriti zyrtari, që, siç duket, e kishte kapur vështrimin e Ebu Qerimit.

Ai u mbush me frymë dhe, pasi mbështeti duart mbi tryezë (vetëm tani Ebu Qerimi vuri re se syprina e tryezës ishte plot me dosje), filloi të fliste:

— Tabir Saraji, ose Pallati i Ëndrrave, siç e quajnë në gjuhën e sotme, është një nga institucionet më të rëndësishme të shtetit tonë të madh perandorak.

Ai pushoi disa çaste, duke e vështruar Ebu Qerimin në një mënyrë të tillë, sikur të donte të merrte vesh se gjer në ç' shkallë ishte në gjendje i porsaardhuri të kuptonte fjalët e tij.

— Bota e ka njojur edhe më parë rëndësinë e ëndrrave dhe rolin që kanë luajtur ato në fatet e shteteve dhe të sundimtarëve, — vazhdoi ai. — Ti ndoshta ke dëgjuar për Orakullin e Delfit në Greqinë e vjetër, për ëndërrshpjeguesit e famshëm romakë, asyrë, persë, mongolë e të tjerë. Në librat e vjetër tregohen me radhë gjithçka që kanë bërë ata për paralajmërimin dhe parandalimin e fatkeqësive, ose për ato që s'kanë mundur të bëjnë, sepse nuk u kanë besuar, ose u kanë besuar tepër vonë, me një fjalë për gjithë ato ngjarje, sinjali për të cilat u dërgua më parë dhe rrjedha e të cilave ndryshoi apo nuk ndryshoi nga zërthimi i këtij sinjali. E gjithë kjo traditë ka qenë padyshim e rëndësishme, por ajo s'është veçse diçka e zbehtë në krahasim me funksionimin madhështor të Tabir Sarajit. Sepse, i pari në historinë e botës, shteti ynë perandorak e ngriti në një nivel të ri shpjegimin e ëndrrave, duke e zyrtarizuar atë.

Ebu Qerimi dëgjonte i mahnitur fjalët e nëpunësít të lartë. Ai akoma s'e kishte marrë veten nga gjithë ato që i kishin ndodhur atë mëngjes, dhe këto fraza, sa të rrjedhshme aq edhe të ngatërruara, binin tani mbi të si për të mbushur kupën.

— Jo ëndrra të vetmuara të njerëzve të veçantë, që për një arsy ose një tjetër shpalleshin të privilegjuar në këtë sferë dhe që kishin praktikisht monopolin e para-

thënies me anë të sinjaleve hyjnore, por Tabir Total-in, domethënë ëndrrat e gjithë shtetasve, pa përjashtim, vu-ri si detyrë të sistemonte e të shqyrtonte Pallati ynë i Ëndrrave, i krijuar me interesimin e drejtpërdrejtë të sultananit sovran. Kjo ishte një ndërmarrje madhështore, përpala së cilës gjithë orakujt e Delfit, apo kastat e profetëve e magëve të dikurshëm dukeshin të vegjël e qe-sharakë. Ideja e sovranit për krijimin e Tabir Totalit u mbështet në faktin që allahu e hedh ëndrrën sinjalizuese mbi globin tokësor në po atë mënyrë të shkujdesur, siç hedh ylberin apo rrufenë, apo afron befas një kometë, që kushedi nga ç'thellësira të mistershme të kozmosit e tërheq. Pra ai e hedh sinjalin e tij mbi glob, pa vënë re se ku bie ai sinjal, sepse nga largësia ku ai është, s'ka nge të merret me hollësira të tillë. Është detyra jonë të qëmtojmë se ku bie kjo ëndërr, ta gjejmë atë midis miliona e miliarda ëndrrave të tjera, ashtu siç mund të gjendet një margaritar midis një shkretëtire me rërë. Sepse një ëndërr e tillë, e rënë si një shkëndijë e humbur në njërin nga trutë e miliona njerëzve që flenë, mund të parandalojë fatkeqësinë e shtetit e të sovranit, të shman-gë luftën apo mortajën, të lindë ide të reja. Prandaj ky Pallat i Ëndrrave nuk është ëndërr, por një nga bazat e shtetit. Këtu, më mirë se nga çdo studim, procesverbal, raport inspektorësh, relacion policie apo guvernatorësh të pashallëqeve, kuptohet gjendja e vërtetë e perandorisë. Sepse në kontinentin e përnatshëm të gjumit gjendet drita dhe terri i njerëzimit, mjalti dhe helmi, madhështia dhe mjerimi i tij. Gjithçka që është e turbullt dhe e rrezikshme, apo që do të jetë e tillë pas disa vjetësh apo pas disa shekujsh, e jep shenjën e parë në ëndrrën e njeriut. Asnjë pasion apo mendim i mbrapshtë, rrebesch apo katastrofë, rebelim apo krim nuk është e mundur të mos dërgojë hijen e vet shumë kohë më parë se të shfa-qet ai vetë në botë. Ndaj porosia e padishahut sovran është e tillë që asnjë ëndërr, e parë goftë edhe në kufijtë më të largët të shtetit, goftë dhe në ditën më të kurr-fartë, goftë edhe nga robi më i humbur i allahut, të mos

mbetet jashtë shoshitjes së Tabir Sarajit. Kurse porosia tjetër akoma më e rëndësishme është që pasqyra e dalë si rrjedhim i mbledhjes, sistemimit e studimit të ëndrrave të ditës, të javës apo të muajit, të jetë e saktë dhe jo e përcudnuar. Për këtë, veç punës së madhe për përpunimin e materialit, një rëndësi të madhe ka myllja e plotë e Tabir Sarajit ndaj çdo ndikimi të jashtëm. Sepse pikërisht jashtë Tabir Sarajit ka forca të ndryshme, që për një arsy e ose një tjetër janë të interesuara të futin ndikimin e tyre këtu, në mënyrë që qëllimet, idetë apo mendimet e tyre të paraqiten pastaj gjoja si sinjale të shenja të hedhura nga allahu mbi trutë e fjetur njëzorë. Ndaj në Tabir Saraj nuk pranohen rekomandimet.

Padashur sytë e Ebu Qerimit e vështruan fletën e shkrumbuar të rekomandimit, që, e holluar edhe më, lëkundej tanë si hije mbi prushin e mangallit.

— Ti do të punosh në sektorin e seleksionimit, — vazhdoi zyrtari me po atë ton. — Ti mund ta nisje punën në sektorë më të parëndësishëm, ashtu siç nisin zakonisht fillestaret, por ti do të fillosh punën drejt e në seleksionim, sepse pëlqehesh prej nesh.

Rrëshqitazi njëri sy i Ebu Qerimit vështroi lodrimin e fletës së shkrumbuar, sikur t'i thoshte: akoma s'je zhdukur?

— Kërkesa e parë dhe kryesore që kërkohet prej teje, — vazhdoi tjetri, — është sekreti i plotë. Kurrë të mos harrosh se Tabir Saraji është një institucion krejtësisht i myllur.

Ai ngriti njérën nga duart prej tryezës dhe, duke mënjanuar njérin gjith prej të tjerëve, bëri një shenjë kërcënimi në ajër.

— Shumë njerëz e shumë rryma kanë dashur të infiltrjnë këtu, por Tabir Saraji s'ka rënë kurrë në grackë. I vëtmuar, ai qëndron midis zallahisë njerëzore, i vëçuar, jashtë korenenteve dhe grindjeve për pushtet, i myllur për këdo dhe i papërzier me askënd. Të gjitha ato që të thashë, mund t'i harrosh, por një gjë s'duhet të harrosh kurrë, biri im, porosinë për mbajtjen e sekretit.

Kjo s'është porosi. Ky është urdhri i madh i Tabin Sarajit. Dhe tani fillo nga puna, Në korridor do të pyesësh ku ndodhet sektori i seleksionimit. Sa të mbërrish ti, atje do të jenë lajmëruar për gjithçka. Me hair.

Ebu Qerimi e kishte kokën akoma të trullo sur kur doli në korridor. S'kishte asnjë frysme njeriu që ta pyeste se nga duhej të ekte për të mbërritur në Seleksionim, ndaj nisi të ekte kuturu. Në veshë kishte akoma copëra të fjalimit të nëpunësit të lartë. C'është kështu? tha dytri herë me vete dhe lëvizë kokën, sikur të donte të shkëputej prej tyre. Por ato, në vend që të shqiteshin, e ndiqnin pas me këmbëngulje. Madje në atë shkreti korridoresh, i dukej se ato, të përplasura e të shumëfishuara nëpër muret dhe kolonat, tingëllonin akoma më zyrtë. Ti do të fillosh punën drejt e në Seleksionim, sepse ti pëlqehesh prej nesh.

Ebu Qerimi, pa e ditur as vetë pse, shpejtoi hapat. Seleksi-onim, përsërisht me vete fjalën që tani, në vemi, i tingëlloi akoma më çuditshëm. Në thellësi të korridorit dalloj një siluetë, që nuk kuptohej mirë në ikte apo vinte drejt tij. Ebu Qerimi deshi t'i bënte zë, apo së paku t'i jepte një shenjë, por silueta ishte tepër larg. Atëherë shpejtoi hapat dhe ishte gati të vraponte, të thërriste, veç të arrinte atë njeri, që i dukej tani si i vërtmi shpëtimtar në atë korridor të pashpresë. Tek ekte kështu, gati me vrap, diku nga e majta dëgjoi një grumbull hapash të rëndë. Ngadalësoi ecjen dhe mbajti vesh. Hapat po vinin nga një galeri anësore që dilte në korridoren e madh. Zhurma e tyre ishte e rregullt dhe kërcënuese. Ebu Qerimi ktheu kokën dhe e pa grumbullin e njerezve që po ecnin të heshtur, me ca dosje të mëdha në duar. Kapakët e dosjeve kishin të njëjtën ngjyrë, të zbeh-të gurkali, si kupolat e ngrehinës dhe uniforma e portierëve.

— Ju lutem, a mund të më thoni, si mund të shkoj në Seleksionim? — pyeti me zë të druajtur Ebu Qerimi, kur grupi kaloi anash tij.

— Kthehu mbrapsht, andej nga ke ardhur, — i tha një zë pakëz i ngjirur. — Dukesh që je i ri.

Ebu Qerimi priti sa tjetri mbaroi një kollitje të gjatë, pér të dëgjuar se duhej të kthehej në korridorin e katërt në anën e djathtë, pér të gjetur shkallët që do ta ngjitnin në katin e dytë, ku duhej pastaj të pyeste përsëri.

— Falemnderit, zotni, — tha Ebu Qerimi.

— S'ka gjë, — tha i panjohuri. — Khu, khu, — dëgjoi Ebu Qerimi pas shpine kollitjen e tij dhe pas saj fjalët: më duket se jam ftohur keq.

Ebu Qerimit iu desh më tepër se një çerek ore pér të gjetur Seleksionimin. Atje ndërkaq e prisnin.

— Ju jeni Ebu Qerimi? — i tha njeriu i parë që takoi atje, pa e lënë atë të hapte gojën.

Ebu Qerimi bëri «po» me kokë.

— Ejani me mua, — tha tjetri, — shefi ju pret.

Ebu Qerimi eci i bindur pas tij. Ata kaluan nëpër ca salla që komunikonin me njëra-tjetrën, në tryezat e gjata të të cilave me dhjetëra njerëz rrinin të përkulur mbi dosje të hapura. Askush nuk tregoi as kureshtjen më të vogël pér Ebu Qerimin dhe shoqëruesin e tij, hapat e të cilëve tingëllonin shkoqur mbi dysheme.

Shefi rrinte pas një tryeze të gjatë, njëlloj si të tjerat, përparrë dy dosjeve. Njeriu që shoqëronte Ebu Qerimin, iu afrua dhe i tha diçka te veshi. Ebu Qerimi pati përshtypjen se shefi nuk dëgjoi asgjë. Sytë e tij vazhdonin të përpinin fletën e shkruar të dosjes, dhe një çast Ebu Qerimit iu duk se në anët e atyre syve mbërrinte si një dallgë e dobësuar pjesa anësore e një tmerri, qendra e të cilil duhej të ishte larg.

Ebu Qerimi priste që shoqëruesi i tij të përkulej prapë te veshi i shefit dhe t'i pëshpériste të njëjtën gjë, por tjetri s'kishte ndër mend ta bënte një gjë të tillë. Fare i qetë, ai priste që shefi të shkëputëj nga dosja.

Kjo vazhdoi gjatë. Herë-herë Ebu Qerimit i dukej

se shefi nuk do t'i ngrinte sytë kurrë nga ajo dosje dhe ata do të rrinin aty në këmbë me orë të tëra, ndoshta gjer në mbarimin e orarit zyrtar e ndoshta edhe më tepër. Përsëri ishte qetësi e thellë. Veç fëshfërimës së lehtë të fletëve që ktheheshin, s'dëgjohej asgjë. Ebu Qerimi vuri re ndërkaq se shefi nuk lexonte më, vështrimi i tij rrinte si i ngrirë pezull mbi dosjen, pa asnje fokus. Siç dukej, mendohej pér atë që kishte lexuar. Kjo vazhdoi po aq gjatë, sa leximi. Më në fund shefi fshiu sytë me duar, sikur të hiqte prej tyre një perde të fundit dhe i ngriti drejt Ebu Qerimit. Dallga e dobësuar e tmerrit ishte fashitur plotësisht në ta.

— Ti je i porsaardhuri?

Ebu Qerimi pohoi me kokë. Pa thënë asgjë, shefi ungri dhe eci përpëra, mes pér mes tryezave të gjata. Dy të tjerët i shkuan pas. Ata kaluan nëpër ca salla që Ebu Qerimit herë i dukeshin si sallat në të cilat kishte kaluar më parë, e herë si të tjera.

Vendin e tij të punës ai e dalloi që larg. Ishte një dosje e pahapur, pas së cilës nuk kishte asnjeri. Shefi ndaloi pranë saj dhe i tregoi me gisht një vend midis tryezës dhe karriges bosh.

— Ky është vendi yt i punës, — tha.

Ebu Qerimi vështroi dosjen e pahapur me kapakë të kaltëremë.

— Seleksionimi ka shumë salla si kjo, — tha shefi, duke bërë një lëvizje të gjerë me krahun e djathtë. — Ky është një nga sektorët më të rëndësishëm të Tabirit. Ekziston mendimi se gjoja thelbi i Tabir Sarajit është Interpretimi. Por kjo s'është e vërtetë. Interpretuesit hiqen si aristokracia e Tabirit. Ata na shikojnë me njëfarë nënçmimi, pér të mos thënë me përbuzje, ne seleksionuesit. Por duhet ta dish se krenaria e tyre është e kotë. Çdo njeri që ka dy para mend, e kupton menjëherë se pa ne, pa Seleksionimin, Interpretimi mbetet si mulliri pa ujë. Baza e punës së tyre varet nga ne. Baza e suksesit.

Shefi bëri një lëvizje me dorë.

— Nejse. Ti do të punosh vetë këtu dhe do ta kuptosh

mirë këtë gjë. Udhëzimet kryesore besoj se i ke marrë. Unë nuk do të të tregoj sot gjithë strukturën e punës, që mos të të rëndoj me gjëra të parakohshme qysh ditën e parë. Do të të tregoj vetëm aq sa mund të duhet në fillim. Të tjerat do t'i mësosh shkallë-shkallë. Kjo këtu është salsa e parë e Seleksionimit.

Shefi bëri prapë një lëvizje rrotulllore me dorë.

— Midis nesh ne e quajmë këtë me shaka Salla e Qiqrave, — vazhdoi ai, — sepse këtu bëhet spastrimi i parë i ëndrrave. Me një fjalë këtu nis gjithçka. Këtu...

Ai mbylli sytë përgjysmë si për të gjetur fillin e këputur të mendimit.

— Nejse, — ia bëri pas pak. — Që të jem i saktë, duhet të them se spastrimi i parë bëhet nga seksionet e bazës. Ato janë rrëth një mijë e nëntëqind në gjithë perandorinë dhe secili prej tyre ka nënsekcionet e veta, dhe të gjitha këto, përpala se t'i nisin ëndrrat për në qendër, u bëjnë një spastrim paraprak. Por ai është i pamjaftueshëm. Spastrimi i parë i vërtetë fillon këtu. Ashtu siç ndahet gruri nga egjira, ashtu ndahen këtu ëndrrat me vlerë nga ato pa vlerë. Pikërisht kjo ndarje, ky qërim përbën thelbin e Seleksionimit. Kupton?

Vështrimi i shefit sa vente gjallërohej. Fjalët që në fillim i gjente me sa duket me vështirësi, tanjë i vinin më tepër se ç'i duheshin për mendimet e tij, ndaj ai sa vente shpejtonte të folurën, si të donte t'i vinte në punë që të gjitha.

— Pikërisht ky është thelbi i punës sonë, — vazhdoi, — të qërohen prej dosjeve gjithë ëndrrat pa vlerë. E para, ëndrrat me motive private, që s'kanë asnje lidhje me shtetin. E dyta, ëndrrat e shkaktuara nga uria, mbingopja, të ftohtët, të nxehët, sëmundjet etj., me një fjalë, që kanë lidhje me mishin e njeriut. E treta, ëndrrat kallpe, domethënë ëndrrat që s'janë parë vërtet, por që janë stisur prej njerëzve pér arsyen karrierizmi, ose të sajuara nga gjenjeshtarët maniakë dhe provokatorët. Të tria këto kategori duhet të pastrohen nga dosjet tonë. Mirëpo kjo është një fjalë goje. Hm. S'është aq lehtë t'i

gjesh. Mundet që një ëndërr të të duket me karakter thjesht intim, osë e nxitur nga shkaqe banale, si uria apo reumatizmi, kur ajo ka në të vërtetë një lidhje të drejtpërdrejtë me çështjet e shtetit, më tepër se fjalimi i porsambajtur i ndonjë anëtari të qeverisë. Pra, për të ndier këtë gjë, duhet përvojë dhe pjekuri. Një gabim në gjykimin e ëndrrës dhe gjithçka shkon së prapthi, më kuption? Me një fjalë, puna jonë s'është aspak hmallëk, siç mund t'i duket dikujt.

Tonin e talljes së hidhur në zërin e tij e zëvendësoi prapë një e folur më e qetë, kur nisi t'i shpjegonte punën konkrete që do të bënte. Vetëm në sy i kishte mbetur akoma diçka nga tmerri i fillimit.

— Përveç kësaj sallë ka edhe të tjera, siç e pe vëtë, — vazhdoi ai. — Për të kuptuar më mirë punën që do të bësh, do të duhet që në fillim të kalosh një ditë ose dy në çdo sallë. Pasi ta bësh këtë, pra, pasi të fitosh një ide të përgjithshme se ç'është Seleksionimi, do të kthehesh prapë këtu, në Sallën e Qiqrave, dhe do të shikosh se puna do të vejë më mbarë. Por këtë do ta bësh javën që vjen. Kurse sot do të fillosh këtu.

Ai u zgjat mbi tryezë, afroi me njëren dorë dosjen dhe i hapi kapakët ngjyrë gurkali të zbehtë.

— Ja, kjo do të jetë dosja jote e parë. Janë një kontigjent ëndrrash të mbërritura në datën nëntëmbëdhjetë tator. Lexoji një për një me kujdes, kryesorja është të mos ngutesh. Kur dyshon, qoftë edhe një grimë, se ëndrra mund të mos jetë kallpe, lëre, mos u ngut ta heqësh. Pas teje është qëruesi, apo, siç i thonë sot, kontrollori tjetër. Ai do të ndreqë lëshimin tënd. Dhe pas tij vjen qëruesi tjetër, e kështu me radhë. Në të vërtetë e gjithë kjo sallë nuk merret veçse me këtë gjë. Hajde pra, me hair.

Ai e vështroi një grimë Ebu Qerimin, pastaj i ktheu shpinën dhe u largua. Ebu Qerimi mbeti një copë herë në këmbë, pastaj ngadalë, duke u përpjekur të mos bënte zhurmë, zhvendosi pak karrigen, u fut midis saj dhe tryezës dhe me po atë kujdes u ul.

Dosjen e hapur e kishte përpëra. Ja pra, qe përmbushur dëshira e tij dhe e fisit të tij. Ai tanë ishte i pranuar në Tabir Saraj, madje i ulur në një karrige, përpëra tryezës së punës, një nëpunës i vërtetë i pallatit misterioz.

U përkul edhe pak mbi dosjen, gjersa sytë e tij dalluan shkronjat dhe nisi t'i lexonte mengadalë. Në fletën e trashë ishin shënuar numri i dosjes dhe data. Më poshtë shënim: «U mor në dorëzim nga Sukrullahu. Përmban 63 ëndrra».

Me gisht të mpirë ktheu fletën. Ndryshe nga fleta e parë, e dyta ishte e mbushur me një tekst të dendur. Tre rreshtat e parë qenë nënvizuar me bojë jeshile dhe qëndronin pak të ndarë nga teksti tjetër. Ebu Qerimi lexoi: «Ëndërr e parë nga nëpunësi Jusuf, i zyrës postare të Alaxhehisarit, nënprefektura e Kërk-Kilisë, Pashallëku i Qystendilit, më 3 shtator të këtij viti, ndaj të gdhirë.»

Ebu Qerimi i shkëputi sytë nga teksti i nënvizuar. Më 3 shtator, mendoi si i mpirë. A ishte e mundur që kjo gjë të kishte ndodhur vërtet, që ai ishte tanë nëpunës i Tabir Sarajit, i ulur në karrigen e punës, duke lexuar ëndrrën e shtetasit Jusuf të zyrës postare të Alaxhehisarit, në nënprefekturën e Kërk-Kilisë, Pashallëku i Qystendilit, për të vendosur përfatim e saj, nëse ajo do të hidhej në koshin e plehrave apo do të hynte përpunim në mekanizmin e madhërishtëm të Tabirit?

Vala e gezimit i shkaktoi të ngjethura në shpinë. E uli kokën përsëri dhe nisi të lexonte tekstin: «Tri dhelpra të bardha, në minaren e xhamisë së nënprefekturës...»

Befas tringëllimi i një zileje e bëri të dridhej. Ai ngriti kokën sikur ta kishin goditur. Vështroi djathtas, majtas dhe mbeti gojëhapët. Gjithë ata njerëz, që gjér atëherë dukeshin si të bërë njësh me karrigjet, të vënë si në gjumë nga dosjet që kishin përpëra, tanë ishin shkëputur befasisht nga magjepsja, qenë ngritur në këmbë, bënin zhurmë, flisnin, lëviznin karrigjet, ndërsa tingulli i ziles vazhdonte të përshkonte tejpërtej sallat.

— Ç'është? — ia bëri Ebu Qerimi. — Ç'po ndodh?

— Pushimi i mëngjesit, — iu përgjigj fqinji i tij. (Ku kishte qenë gjer atëherë ky fqinj?) — Pushimi i mëngjesit, — përsëriti ai. — Ah, po ti qenke i ri, nuk i di akoma oraret. S'ka gjë, do t'i mësosh.

Nga të gjitha anët njerëzit ngriheshin, lëviznin midis tryezave të gjata drejt daljes. Ebu Qerimi deshi të vazhdonte leximin, por s'ishte e mundur. E shtyinin rığa të gjitha anët, i preknin karrigen. Megjithatë me njëfarë kokëfortësie ai e uli kokën mbi dosjen që tani e tërhiqte si magnet. «Tri dhelpa të bardha...» po ndërkakq ndjeu një zë mu te rrëza e veshit:

— Ka kafe atje poshtë, salep të ngrohtë, nuk është e mundur mos të të pëlqejë asgjë.

Ebu Qerimi nuk arriti t'ia shikonte fytyrën atij që i foli. Ai u ngrit nga karrigia, mbylli kapakun e dosjes dhe u drejtua si gjithë të tjerët drejt daljes.

Në korridorin e gjatë s'ishte nevoja të pyeste se ku duhej shkuar. Të gjithë ecnin në një drejtim. Nga galeritë anësore pérherë e më tepër dilnin njerëz, që i shtoheshin rrjedhës së korridorit kryesor. Ebu Qerimi u fut në rrjedhë. Supet e njerëzve e preknin nga të dyja anët. Ai po mahnitej nga numri i nëpunësve të Tabir Sarajit. Ishin me qindra, ndoshta me mijëra.

Zhurma e hapave u shtua sidomos nëpër shkallë. Pas zbritjes së parë u bë prapë një ecje e gjatë, pastaj pati një zbritje të re. Zhurma e hapave sa vente bëhej më e shurdhër. Dritaret sa vente zgogëlosheshin. Ebu Qerimi pati ndjesinë se po zbritnin në bodrumë. Tani njerëzit lëviznin pothuajse ngjitur me njëri-tjetrin. Përpara se të mbërrinin, u ndje era e kafes dhe era e këndshme e salipit. Kishte diçka të ngjashme me mëngjeset e shtëpisë së tyre të madhe. Ebu Qerimi ndjeu prapë një valë gëzimi. Ai pa që larg banakët e gjatë, pas të cilëve me dhjetëra banakierë jepnin filxhanët me kafe e taset e salepit, që akoma lëshonin avull. Ebu Qerimi e la veten të shtyhej drejt banakëve. Rreth e rrotull tij gumëzhinin

zëra, ndihej zhurma e rrufisjes së kafes apo të salepit, dëgjoheshin kollitje, gërgama të lehta të fytit, tringëllima të monedhave të vogla. Atij iu duk se një pjesë e njerëzve ishin me rrufë, apo ndoshta dukej kështu, nga që pas disa orësh heshtjeje të plotë gurmazet e nxirrnin zërin akoma të paqëruar mirë.

I vënë pa dashjen e tij në radhë, pranë njërit prej banakëve, Ebu Qerimi as shtyhej përpara, as tërhiqej pas. E ndiente se të tjerët e kalonin, zgjatnin duart si për kokës së tij për të marrë kafen apo për të dhënë parret, por ai s'kishte ndër mend të zemërohej aspak për një gjë të tillë. Në të vërtetë as i hahej, as i pihej. Rinte aty si i lëkundur nga dallgët, vetëm që të bënte edhe ai si gjithë të tjerët.

— Ti s'ke për të pirë gjë, siç e ke zënë, — dëgjoi një zë prapa supit. — Më lër mua të kaloj, së paku.

Ebu Qerimi u mënjanua menjëherë për të lënë njeriun të kalonte. Tjetri, ngaqë i bëri siç duket përshtypje gatishmëria e tij për t'i hapur udhë, ktheu kokën me kureshtje. Ishte një fytyrë e gjatë, e kuqërrëmtë, me ca mollëza të mëdha prej njeriu të mirë. Një grimë sytë e tij e panë Ebu Qerimin me vëmendje.

— Nëpunës i ri?

Ebu Qerimi bëri «po» me kokë.

— Dukesh menjëherë:

Ai përparoi edhe nja dy hapa drejt banakut dhe ktheu kokën pas nga Ebu Qerimi.

— Çfarë do të marrësh? Kafe? Salep?

Ebu Qerimi deshi t'i thoshte: «falemnderit, asgjë», por kjo sesi iu duk e pazakonshme. A nuk rrinte aty për të bërë si gjithë të tjerët e për të mos tërhequr vëmendjen e askujt?

— Kafe, — tha me zë të ulët, duke i lëvizur buzët në mënyrë të tillë, që tjetri të kuptonte fjalën.

Me njëren dorë Ebu Qerimi po kërkonte në xhepa monedha të vogla, po ndërkaq i porsanjohuri i kishte kthyer shpinën dhe kishte arritur banakun. Ndërsa rrin-

te në pritje, veshët e Ebu Qerimit kapnin padashur copëra nga bisedat e njerëzve rrëth e rrotull. Ato ishin të grimcuara si nga një mokër e madhe, po herë-herë, midis zallahisë, kapeshin fjalë, madje edhe fraza të tëra që mokra s'i kishte thërrmuar dot gjatë rrotullimit të saj e që do ta bënte këtë gjë me siguri në rrotullimin tjetër. Krejt i habitur, ai ua vinte veshin këtyre frazave. S'kishte asgjë në to nga puna në Tabir Saraj. Flitej për gjithçka të përditshme dhe banale, për të ftohtët në rrugë, cilësinë e kafes, garat e kuajve, llofarinë shtetërore, griffin që kishte rënë në kryeqytet, por asnjë fjalë për atë që bëhej në këtë ndërtësë. Do të besoje më tepër që këta njerëz punonin në zyrën e kadastrës, apo, kushedi, në një ministri tjetër, sesa të ishin nëpunës të Pallatit të famshëm të Ëndrrave, institucionit më misterioz të perandorisë.

Ebu Qerimi dalloi dashamirësin e tij të dilte nga radha e njerëzve, duke mbajtur me kujdes në duar dy filxhanë me kafe.

— Dreq, sa e bezdisshme është kjo radhë, — ia bëri ai dhe, pa ia dhënë akoma filxhanin e kafes Ebu Qerimit, eci përpara me po atë lëvizje të kujdeshshme, në kërkim të ndonjë tryeze të lirë, midis dhjetëra apo qindra tryeza të vendosura në bodrum. Ato ishin të zhveshura e pa ndenjëse dhe shërbënvet vetëm sa për të mbështetur bërrylat gjatë pirjes së kafes apo salepit, dhe sidomos për të lënë filxhanët dhe taset bosh.

Njeriu që mbante filxhanët e kafes, ndaloj më në fund te një tryezë boshe dhe i vuri filxhanët mbi syprinën e saj. Ebu Qerimi me druatje i zgjati monedhat e vogla, të cilat gjatë gjithë kohës i kishte shtrënguar në grusht. Tjetri bëri një shenjë mohimi me dorë.

— S'ka nevojë, — tha, — një gjë kaq e vogël.

— Po pse, — ia bëri Ebu Qerimi nëpër dhëmbë, — sidqoftë...

— Të kam qerasur, — tha tjetri, — ç'e zgjat për një gjë kaq të vogël.

— Falemnderit!

Ai zgjati dorën dhe mori filxhanin. Në dorën tjetër kishte akoma monedhat e vogla prej bakri.

— Kur je emëruar? — e pyeti tjetri.

— Sot,

— Vëtet? Urime! Epo, atëherë, paske hak që... — ai s'diti si ta mbaronte frazën dhe vuri filxhanin në buzë.

— Në ç'sektor? — pyeti pas pak.

— Në Seleksionim.

— Në Seleksionim? — ia bëri tjetri me habi. Fytyra e tij u çel edhe më. — Paske filluar shumë-shumë mirë. Zakonisht të rintjtë e fillojnë karrierën në Recepzion, madje edhe më poshtë, nga Kopisteria.

Papritur Ebu Qerimit iu zgjua dëshira të mësonte sa më shumë për Tabir Sarajin. Diçka u thye në frenimin e tij.

— Seleksionimi është një sektor i rëndësishëm, apo jo? — tha ai.

Tjetri e vështroi me vëmëndje.

— Po, tepër i rëndësishëm. Sidomos për një të ri...

— Cfarë?

— Desha të them, sidomos si fillim për një të ri, më kupton?

— Po në përgjithësi? Jo për një të ri, po në përgjithësi.

— Po... natyrisht... edhe në përgjithësi ai quhet një sektor mjaft serioz. S'mund të them i parëndësishëm. Madje tepër i rëndësishëm...

Tani ishte Ebu Qerimi që nuk ia hiqte sytë.

— Natyrisht që ka edhe sektorë më të rëndësishëm.

— Për shembull, Interpretimi? — pyeti Ebu Qerimi. Tjetri, krejt i habitur, e largoi filxhanin nga goja.

— Pa shih, pa shih, s'qenke ashtu si dukesh, — ia bëri duke buzëqeshur. — Paske mësuar mjaft gjëra qysh ditën e parë.

Ebu Qerimi deshi t'i përgjigjej edhe ai me buzëqeshje buzëqeshjes së tjetrit, por shpejt e kuptoi se dëshira e tij ishte një luks i parakohshëm. Lëkura e fytyrës së tij nuk ishte shkrirë akoma nga ngrirja e atij mëngjesi të jashtëzakonshëm.

— Sigurisht Interpretimi është thelbi i Tabir Sarajit, — tha tjetri.. — Ai është qendra nevralgjike, si të them, truri i tij, sepse atje merr kuptim gjithçka që bëjnë sektorët e tjerë, gjithë përgatitja, mundi...

Ebu Qerimi dëgjonte si në ethe.

— Ata quhen aristokratët e Tabirit?

Tjetri mblodhi buzët mendueshëm.

— Po, pikërisht. Në mos aristokratët, aty afër... Megjithëse...

— Çfarë?

— Mos kujto se mbi ta s'ka të tjerë.

— E kush janë të tjerët? — Ebu Qerimi po habitej edhe vetë me guximin e tij.

Bashkëfolësi e vështroi me qetësi.

— Tabir Saraji është gjithmonë më shumë se ç'duket, — tha.

Ebu Qerimi deshi ta pyeste se ç'kuptim kishte kjo, po frika se mos po e tepronte e frenoi.

— Veç Tabirit të zakonshëm është edhe Tabiri Sekret, — vazhdoi tjetri, — që merret me përpunimin eënrrave që njerëzit nuk i dërgojnë vetë, por që shteti, me anë të mjeteve dhe mënyrave të tij, i shtie në dorë. Besoj se e kupton që ky është një sektor jo më pak i rëndësi shëm se Interpretimi.

— Sigurisht, — ia bëri Ebu Qerimi, — megjithëse... — Çfarë?

— A nuk përfundojnë në Interpretim qoftë ëndrrat e ardhura vetë, qoftë ato të Tabir Sekretit?

— Po. Nga gjithë sektorët e tjerë që janë të dyzuar, domethënë që njëri ka të bëjë me Tabirin Legal, tjetti me Tabirin Sekret, vetëm Interpretimi ështëunik për

krejt Tabir Sarajin. Megjithatë kjo s'do të thotë se ai është më lart se Tabir Sekreti në përgjithësi.

— Po ndoshta s'është as më poshtë.

— Ndoshta, — tha tjetri. — Në të vërtetë ata të dy kanë një lloj rivaliteti.

— Me një fjalë, ata dy sektorë janë aristokratët e Tabirit.

Tjetri buzëqeshi.

— Meqë të pëlqen shumë kjo fjalë, ashtu është.

Ai rufisi edhe një herë filxhanin, megjithëse në të s'kishte më kafe.

— Por mos kujto se ata përbëjnë majën më të lartë, tha. — Edhe mbi ta ka të tjerë.

Ebu Qerimi ngriti sytë për të kuptuar nëse tjetri tallej, apo e kishte seriozisht.

— E ç'janë këta?

— Bashëndrrorët.

— Si?

— Bashëndrrorët, Sektori i Bash-Ëndrrës ose i Kryeëndrrës, siç i thonë kohët e fundit.

— Ç'është ky?

Tjetri e uli zérin.

— Ndoshta s'është mirë që bisedojmë kështu, — tha, megjithëse ti, ashtu si edhe unë, je njeri i brendshëm i Tabirit, veç kësaj, këto janë çështje të ndërtimit, administratës dhe këtu besoj se s'ka ndonjë sekret, a?

— Ashtu besoj edhe unë, — tha Ebu Qerimi.

Dëshira e tij për të mësuar qoftë edhe diçka tjetër, ishte e papërballueshme.

— Të lutem, më tre go edhe diçka, — i tha me zë të butë. — Unë, ashtu siç the ti, jam njeri i brendshëm këtu, nëna ime është nga familja e Qyprillinjve.

— Nga familja e Qyprillinjve?

Habia në fytyrën e bashkëfolësit nuk e çuditte Ebu Qerimin. Ai qe mësuar me të, sa herë që dikush merrte vesh përfisin e tij.

— Që kur më the se je caktuar të punosh drejt e në Seleksionim, e mora me mend që je nga ndonjë familje e afërt për shtetin, por, të them të drejtën, nuk më shkoi mendja kaq larg.

— Është nëna ime vajzë nga Qyprillinxjë, — saktësoi Ebu Qerimi, — unë kam tjetër mbiemër.

— S'ka rëndësi, — tha tjetri. — S'ka shumë rëndësi. Ebu Qerimi e vështroi me vëmendje.

— Si qe ajo puna e Bashëndrrës? — pyeti

Tjetri u mbush me frymë, por, sikur ta ndiente që gjithë ajo frymë ishte e tepërt për volumin e ulët të zërit që do të nxirrte, e shfryu një pjesë të saj jashtë, përpëra se të fillonte të fliste.

— Çdo të premte, ndoshta ke dëgjuar, nga mijëra e mijëra ëndrrat e mbërritura e të përpunuara këtu gjatë javës, zgjedhin njérën, atë më të rëndësishmen, që ia paraqesin sovranit me një ceremoni të thjeshtë, po tepër të lashtë. Kjo është Bashëndrra, apo Kryeëndrra, siç i thonë sot.

— Diçka kam dëgjuar, po fare turbull, si punë legjende, — tha Ebu Qerimi.

— E pra, ajo s'është legjendë, por e vërteta, dhe për të punojnë disa qindra veta, bashëndrrorët, apo kryeëndrrorët, siç quhen tani. — Disa sekonda ai e pa ngultazi Ebu Qerimin. — Në bashëndërr... — murmuriti pas pak, — kush mund ta marrë me mend se një e tillë, me sinjalizimin e rëndësishëm që jep, i-vlen nganjëherë sovranit më shumë se armata të tëra ushtarësh, apo se gjithë turma e diplomatëve të tij.

Ebu Qerimi dëgjonte gojëhapur.

— E kupton tani sa lart qëndrojnë bashëndrrorët në krahasim me të gjithë ne të tjerët?

C'mekanizëm gjigant, tha me vete Ebu Qerimi. Tabir Saraji ishte më të vërtetë më shumë se ç'dukej.

Ata nuk i sheh asgjékund, — vazhdoi tjetri. — Mëdje edhe vendin për pirjen e kafes e të salepit e kanë vec.

— Vec, — përsëriti Ebu Qerimi.

Tjetri hapi gojën të vazhdonte, por besas tingulli i një zileje, i njëjtë me atë që lajmëroi pushimin e mëngjesit, e preu në mes çdo gjë.

Ebu Qerimi nuk arriti të pyeste ç'ishte kjo zile, sepse gjithçka u bë e qartë përnjéherësh. Zilja s'kishte mbaruar akoma së rëni, kur gjithë ajo masë njerëzish kishte nisur të dyndej me shpejtësi drejt daljeve. Ata që s'kishtin arritur të pinin kafen apo salepin, e kthenin atë me një frymë, të tjerë, që sapo e kishin marrë te banaku dhe s'mund ta pinin se ishte tepër e nxehëtë, e linin mbi tryezë pa e pirë dhe iknin nga sytë këmbët. Bashkëfolësi i Ebu Qerimit e kishte lënë fjalën përgjysmë, e kishte për shëndetur me kokë atë dhe i kishët kthyer shpinën. Në çastin e fundit Ebu Qerimi bëri një lëvizje drejt tij, sikur ta ndalte, sikur ta pyeste për diçka të fundit, por ndërkaj e shtynë nga e majta, pastaj nga e djathta dhe ai e humbi tjetrin nga sytë.

Ndërsa dilte, duke ecur kuturu sipas rrjedhës, Ebu Qerimit iu kujtua se nuk e kishte pyetur as se si e kishte emrin. Së paku, ta kisha pyetur në ç'sektor punonoste, tha me vete me hidhërim. Pastaj e qetësoi veten me mendimin se kishte për ta gjetur të nesërmën përsëri gjatë pushimit të mëngjesit dhe kishin për të folur prapë bashkë.

Rrjedha e nëpunësve sa vente dobësohej dhe Ebu Qerimi më kot u përpooq të njinte ndonjë fytyrë nga ato që kishte parë në Seleksionim. Atij iu desh të pyeste dy herë, gjersa ta gjente vendin e punës. Hyri me hapa të kujdesshëm, duke u përpjekur të mos ndihej. Përreth po shuhej një zhurmë e fundit karrigesh. Njerëzit pothuajse kishin zënë vend të gjithë pas tryezave të gjata. Duke ecur me maja të këmbëve, Ebu Qerimi iu afrua vendit të tij, zhvendosi karrigen me kujdes dhe u ul në të. Ca çaste qëndroi pa lëvizur, pastaj uli sytë mbi dosje, lexoit fjalët: «Tri dhelpra të bardha në minaren e xhamisë së nënprefekturës...», por në çast e ngriti kokën përsëri, sikur ta kishin thirrur nga larg me një sinjal të çudit-

shëm, krejt të dobët, gati të përvajshëm, të ngjashëm me thirrjen për ndihmë, apo thjesht me një dënësë. C'është, c'është, pyeti brenda për brenda vetes gjithë qenia e tij. Pa ditur as vetë përsë, sytë i vajtën te dritaret e mëdha, që po i shikonte për herë të parë. Pas xhamave të tyre, si një gjë e njohur, po tepër e largët tashmë, ai pa sqotën. Ajo vërtitej jashtë hutueshëm, në mëngjesin që ishte gjithashtu i largët, si nga një jetë tjeter dhe që ndoshta ia kishte dërguar atë sinjal të fundit.

Me një ndjenjë të turbullt faji, ai i hoqi sytë andej  
dhe uli kokën mbi dosje, por, para se të niste përsëri le-  
ximin, psherëtiu thellë: O zoti perëndi!

Ishte e martë mbasdite. Donte akoma edhe një orë që tē mbaronte orari zyrtar. Ebu Qerimi ngriti kokën nga dosja dhe ferkoi sytë. Kishte një javë që kishte filluar punën dhe akoma nuk po mësohej dot me leximin e zgjatur. Fqinji i tij nga e djathha lëvizi në karrige, por pa e ndërprerë leximin. Në tryezën e gjatë dëgjohej herë pas here fëshfërima e fletëve që ktheheshin. Askush nuk e kishte ngritur kokën nga dosjet.

Ishte muaji nëntor. Dosjet sa vente bëheshin më të trasha. Ishte periudha e zakonshme e fluksit të ëndrrave. Kjo ishte një nga gjérat kryesore që kishte mësuar Ebu Qerimi gjatë javës së parë në punën e re. Ëndrra shikoheshin gjithmonë dhe ëndrra dërgoheshin gjithmonë, dhe kështu do të ishte në jetë të jetëve, por megjithatë kishte periudha që ato shtoheshin, ashtu siç kishte periudha që edhe pakësosheheshin. Tani ishte një periudhë vërshimi. Ato mbërrinin me dhjetëra mijëra nga të gjitha skajet e perandorisë në Tabir Saraj. Dhe kështu do të vazhdonte gjer në fund të vitit. Dosjet do të fryheshin e do

## SELEKSIONIMI

### II

të fryheshin pa pushim, bashkë me shtrëngimin e të ftohtit. Pastaj, pas Vtitit të ri do të kishte njëfarë pakësimi gjer në pranverë.

Me bisht të syrit, Ebu Qerimi vështroi edhe një herë fqinjin e tij të djathë, pastaj atë të majtin. Lexonin vallë vërtet, apo bënин sikur lexonin? Ai vuri dorën te tëmthi dhe i uli sytë mbi fletë, por, në vend të shkronjave, nuk shikonte veçse ca si miza, humbur në mjegull. Jo, s'është e mundur të lexohet më, tha me vete. Të gjithë ata që mbanin kokat ulur mbi dosje, me siguri nuk lexonin më, por shtireshin. Kjo ishte vërtet një punë skëterrë.

Me ballin të mbështetur në pëllëmbë të dorës, ai nisi të sillte ndër mend gjithçka që kishte dëgjuar atë javë nga nëpunësit e vjetër të Seleksionimit për baticat dhe zbaticat e ëndrrave, për shtimin ose pakësimin e tyre, që kishin lidhje me stinët, me sasinë e reshjeve, temperaturën, thatësirën apo lagështinë e ajrit. Veteranët e Seleksionimit i dinin mirë të gjitha këto. Ata dinin rolin që luante dëbora, erërat apo vetëtimat në shtimin e ëndrrave, siç dinin rolin e lëkundjeve të tokës, të zënies së hënës, apo të shfaqjes së kometave. Në Interpretim kishte me siguri mjeshtër të shquar të zërthimit të ëndrrave, dijetarë të vërtetë, të cilët, prapa pamjeve që për syrin e zakonshëm s'ishin veçse vizatime të marra të trurit, dinin të nxirrin kuptime të fshehta e të çuditshme. Megjithatë ujq të tillë të vjetër si veteranët e Seleksionimit, të cilët ishin në gjendje të parashikonin bollëkun apo shterpësinë e ëndrrave me po atë thjeshtësi që pleqtë e zakonshëm, nga dhimbjet e reumatizmit, parashikoni keqësimin e motit, nuk mund të kishte në asnjë sektor tjetër të Tabir Sarajit.

Ebu Qerimit iu kujtua befas i njohuri i tij i ditës së parë. Ku ishte vallë? Disa ditë rresht, gjatë pushimit të mëngjesit, e kishte kërkuar me sy midis turmës së nëpunësve, po nuk e kishte parë asgjékund. Ndoshta është sëmurë, tha me vete. Apo ndoshta ka shkuar me shërbim në ndonjë provincë të largët. Mundet që ishte një

nga inspektorët e Tabirit, nga ata që shumicën e kohës e kalojnë me shërbim, tutje-tëhu perandorisë, apo ndoshta ishte thjesht korrier.

Ebu Qerimi përfytyroi mijëra seksionet e Tabir Sarajit, të shpërndara anekënd hapësirës së pafundme të shtetit, ndërtesar e tyre të thjeshta, disa herë në formë barakash, brenda të cilave rrinë dy nëpunës akoma më të thjeshtë, hallexhinj, me rrögë të vogël, që i përkulen gjer në tokë korrierit më të thjeshtë të Tabirit, kur ai vinte për të marrë ëndrrat e mbledhura, që i bëheshin servilë, u mbahej goja përparrë tij, vetëm e vetëm se ai vinte nga qendra. Në humbëtirat e thella, në mëngjeset me shi apo baltë, drejt atyre seksioneve të trishtuara drejtosheshin nganjëherë që pa gdhirë banorët e nënprefekturës, për të dhënë ëndrrat e tyre. Pa trokitur te derë e seksionit, ata thërritnin që jashtë: Haxhi, e ke hapur?

Shumica nuk dinin shkrim, ndaj edhe vinin që herët, pa kaluar akoma nga mejhania, për të mos harruar ëndrrën. Ata e thoshin atë me gojë, ndërsa kopisti, me sy të përgjumur, duke mallkuar ëndrrën dhe të zotin e saj, shkruante në letër atë që dëgjonte. Eh, ishalla këtë herë kemi fat, pshërëtinte në mbarim të kopjimit i zoti i ëndrrës. Prej vitesh qarkullonin legjenda se një njeri i varfér nga një nënprefekturë e padëgjuar, me anë të ëndrrës së tij, paskësh shpëtuar shtetin nga një gjëmë e tmerrshme dhe, si shpërblim për këtë, ishte thirrur pastaj prej sovranit në kryeqytet, i cili e kishte futur në pallat e i kishte thënë: zgjidh ç'të duash prej thesareve të mia, madje edhe një nga mbesat e mia për grua etj., etj. Eh, ishalla, përsërishte njeriu dhe ikte nëpër udhën gjithë baltë, me siguri drejt mejhanës, ndërsa kopisti e ndiqte pas me një shikim ironik dhe, pa mbërritur tjetri te kthesa e rrugës, shënonë sipër fletës « pavlefshme ».

Megjithëse kishin udhëzim të prerë që të mos nisëshin nga paragjykimet dhe njohjet e njerëzve në vlerësimin e ëndrrave, nëpunësit e qendrave të vogla pikërisht në atë mënyrë e bënë spastrimin e parë të materialit.

Ata i njihnin mirë banorët e nënprefekturës dhe, pa kaperçyer mirë pragun, e dinin nëse njeriu ishte grykës, pijanec, gjenjeshtar apo vuante nga ulçera. Kjo kishte krijuar shpeshherë probleme, madje vite më parë ishte marrë vendimi për t'ua hequr seksioneve të drejtën e spastrimit të parë. Mirëpo pas kësaj sasia e ëndrrave të mbërritura në Seleksionim u rrit në mënyrë të tillë të përbindshme, saqë vendimi u annullua përsëri dhe pavarësisht nga të këqijat që mund të sillte spastrimi prej seksioneve, ai u pranua prapë si e vetmja zgjidhje e çështjes.

Mirëpo ëndërrparësit nuk dinin asgjë nga këto. Herë pas here ata pyesnin që nga jashtë: E, Haxhi, erdhi ndonjë përgjigje për atë éndrrën time? Jo, akoma s'ka ndonjë përgjigje, thoshte Haxhiu. Po ti je tepër i padurueshëm, Abdyl Kadir. Perandoria është e madhe dhe qendra, pavarësisht se punon ditë e natë, s'ka mundësi t'i shqyrtojë kaq shpejt gjithë mizëritë e ëndrrave që dërgohet atje. Eh, ke të drejtë, përgjigjej tjetri, duke hedhur sytë në horizont, andej ku sipas mendjes së tij duhej të ishte qendra. Ku i dimë ne punët e shtetit. Dhe ikte, duke hequr zvarrë nallanet e drunjta në udhën që conte në mejhane.

Të gjitha këto ia kishte treguar Ebu Qerimit një ditë më parë një inspektor i Tabirit, me të cilin kishin qëlluar të pinin bashkë kafen e mëngjesit. Inspektori porsa ishte kthyer nga një provincë tepër e mënjanuar aziatike dhe bëhej gati të nisej përsëri, po këtë herë në zonën evropiane të shtetit. Ebu Qerimi kishte mbetur gojë-hapur nga tregimi i inspektorit. A ishte e mundur që e gjithë kjo të kishte një fillim kaq banal? Por inspektori, sikur ta kishte kuptuar zhgënjin e tij, kishte shpejtuar t'i sqaronte se nuk ishte kudo kështu, se seksionet e Tabir Sarajit qëllonin të ishin ndërtesa solide, në qytete madhështore të Azisë e të Evropës, dhe ata që çonin éndrra atje, nuk ishin hallexhinq të paditur të provincës, po njerëz të lartë, të komplikuar, me grada, shkolla, akademira, me mendje të thellë e ambicie të mëdha. Inspektori kishte folur një copë herë të tërë për këtë gjë,

ndërsa Ebu Qerimi ndiente se si në ndërgjegjen e tij po rivendosej prapë pesha e rëndë e Tabir Sarajit. Inspektor i kishte nisur të tregonte diçka tjetër nga udhëtimet, po zilja e kishte ndërprerë tregimin e tij dhe tanë Ebu Qerimi po përpiquej t'i plotësonte me mend ato që tjetri i kishte lënë pa rrëfyer. Ai po mendonte popujt që shtriheshin në krahun lindor të shtetit dhe ata të krahut perëndimor, popujt që shikonin shumë ëndrra dhe ata që shikonin pak, popujt që i tregonin lehtë ëndrrat e tyre dhe ata që i tregonin me zor, siç ishin shqiptarët, (për shkak të origjinës së tij shqiptare Ebu Qerimi padashur regjistronte ndër mend gjithçka që thuhej për atë vend), për ëndrrat e popujve që ndodheshin në rebelim, të atyre mbi të cilët porsa ishin ushtruar masakrat e mëdha, të popujve që ndodheshin në periudha pagjumësie. Këta të fundit veçanërisht përbënin një shqetësim serioz përshtetin, sepse pas pagjumësisë gjithmonë pritej diçka e befasishme. Prandaj, kur Tabir Saraji sinjalizonte shenjat e para të pagjumësisë, shteti merrte masa të ngutshme për t'i dalë përpara së keqes. Ebu Qerimi e kishte vështruar gjithë habi bashkëfolësin kur i kishte zënë ngoje pagjumësinë e popujve. E di që të tingëllon e çuditshme, i kishte thënë tjetri, por duhet ta kuptosh këtë brenda logjikës së krahasimit. Një popull quhet që ka rënë në pagjumësi, kur sasia e gjumit të tij është pakësuar në mënyrë të konsiderueshme, në krahasim me periudhat normale të tij. Dhe për këtë gjë kush mund të sinjalizojë më saktësish se Tabir Saraji? Është e vërtetë, i kishte thënë Ebu Qerimi, është krejtësisht ashtu. Atij i qenë kujtar netët e tij pa gjumë kohët e fundit, por aty për aty kishte menduar se pagjumësia e një populli duhej të ishte diçka krejtësisht e ndryshme nga pagjumësia e një njeriu.

Me bisht të syrit nisi të vështronte përsëri herë djathtas, herë majtas. Të gjithë dukeleshin si të përpire nga dosjet, krejt të magjepsur mbi to, thuase ato s'ishin letra të shkruara, por mangaj, ku digjej një qymyr që të zinte. Ndoshta edhe unë dalngadalë do të bie në këtë

magjepsje, mendoi ai pikëllueshëm, dhe do të harroj botën dhe gjithçka.

Atë javë, ashtu siç e kishte urdhëruar shefi i tij, ai kishte qenë nga një gjysmë dite në se cilën prej sallave të Seleksionimit, pér t'u njojur me procesin e punës. Kishët qëndruar me orë të tëra në çdo sallë, përkrah ndonjë nëpunësi të vjetër, pér të fituar edhe ai përvojë dhe kur e kishte ndjekur më në fund tërë ciklin e punës, që lthyer dy ditë më parë te tryeza e tij, atje ku i kishin thënë të punonte ditën e parë të hyrjes në punë.

Nga shtegtimi sallë më sallë Ebu Qerimi kishte mësuar, në vija të përgjithshme, se si punonte Seleksionimi. Pas përpunimit në Sallën e Qigrave, sasia e ëndrrave të pavlefshme, e paketuar në grumbuj të mëdhenj, i dorëzohej Arkivit, ndërsa sasia e vlefshme i nënshtrohej një përpunimi të ri qysh nga e para. Ëndrrat ndaheshin në grupe sipas çështjeve me të cilat kishin lidhje: Siguri mi i perandorisë dhe i sovranit (komplotet, tradhtitë, kryengritjet); Politika e brendshme (kryesishët uniteti i perandorisë); Politika e jashtme (aleancat, luftërat); Jeta civile (vjedhjet e mëdha, abuzimet, zvetënim); Sinjalizime pér Bashëndrrën; Të ndryshme (varia).

Grupimi i ëndrrave në ndarjet dhe nëndarjet nuk ishte gjë e lehtë. Madje një kohë të gjatë qe diskutuar nëse duhej që me këtë punë të merrej Seleksionimi, apo ajo i përkiste kryesishët Interpretimit. Në të vërtetë, ajo do t'i lihej Interpretimit, sikur ai të mos ishte aq i ngarkuar. Më në fund qe arritur një zgjidhje pajtimi: vërtet grupimi i ëndrrave i qe lënë Seleksionimit, po kjo quhej një punë parapërgatitore, pra vetëm një projekt. Dhe në krye të çdo dosjeje me materiale të dorëzuara, nuk shkruhej: «Ëndrra që kanë lidhje me X çështje, por «Ëndrra që mund të kenë lidhje me X çështje». Veç kësaj, ndërsa mbante përgjegjësi të plotë pér ndarjen e ëndrrave në të vlefshme e të pavlefshme, pér grupimin e tyre Seleksionimi nuk mbante veçse një përgjegjësi morale. Kështu që në të vërtetë puna bazë e Seleksionimit ishte qërimi. Qërimi ishte thelbi i Seleksionimit,

ashtu si Interpretimi quhej thelbi i krejt Tabin Sarajit. Ekuptove tani që këtu janë portat ku hyn gjithçka, i kishte thënë shefi Ebu Qerimit, ditën e rikthimit të tij në vendin e parë të punës. Ti me siguri ke kujtar në fillim se, meqenëse në këtë proces fillon puna e Seleksionimit meqenëse ne të vendosëm këtu, ky është edhe më i parëndësishmi. Kurse tani besoj se e more vesh që ky është themeli i punës dhe ne asnjëherë nuk i vendosim fillestarët në të, por ty të vendosëm, sepse ti pëlqehesh prej nesh.

Ti pëlqehesh prej nesh. Ebu Qerimi e kishte përsëritur me vete me dhjetëra herë këtë frazë, sikur me anë të përsëritjes ai do t'i hynte asaj në thelb. Mirëpo ajo ishte e tillë, e mbyllur nga të gjitha anët, enigmatike, e lëmuar si një mur, ku nuk ke ku kapesh për ta kapëryer.

Ebu Qerimi ferkoi sytë përsëri. Deshi të rifillonte leximin, por s'ishte e mundur. Shkronjat i dukeshin të kuqërrëmta si nga një refleks zjarri apo gjaku.

Kishte hequr mënjanë rrëth dyzet èndrra të pavlefshme. Shumica i qenë duktur të shkaktuara nga hallet e përditshme, kurse një pjesë i qenë duktur kallpe, por s'ishte i sigurt, t'i lexonte edhe një herë? Në të vërtetë i kishte lexuar nja dy-tri herë secilën, po prapë s'ndihej i sigurt. Shefi i kishte thënë se, sa herë të dyshonte, duhej ta linte èndrrën për qëruesin e dytë, duke i vënë sipër një pikëpyetje, mirëpo ai e kishte bërë këtë për një numër të madh èndrrash. Në të vërtetë kishte nxjerrë si të pavlefshme shumë pak èndrra dhe, në qoftë se nuk do të spastronte as këto të dyzeta, atëherë shefi kishte të drejtë të thoshte me vete: Ebu Qerimi, për të qenë brenda, i kalon të gjitha èndrrat te qëruesit e tjerë. Mirëpo ai ishte qërues dhe si i tillë detyrë kryesore kishte të qéronte dhe jo të kalonte. Përndryshe, çdo të ndodhë sikur gjithë qëruesit, për të qenë brenda, të kalonin sa më shumë èndrra në Interpretim? Interpretimi do të bllokonte pranimin ose do të ankohej në drejtori. Drejtoria do të kërkonte shkaqet. Eh, ç'më gjeti, pshërëtiu me vete Ebu

Qerimi. Po, në fund të fundit, të dalë ku të dalë, mendoi dhe me njëfarë inati, me ngut, sikur të kishte frikë mos i kthehej mendja, shkroi në krye të katër-pesë fletëve fjalën «e pavlefshme» dhe poshtë saj nënshkrimin e tij. Ndërsa vazhdonte të shkruante mbi fletët e tjera atë fjalë, ndiente një gëzim hakmarrës për ata teveqelë të panjohur që, të sëmurë nga barku apo majasëlli, e kishin munduar atë dy ditë me èndrrat e tyre të marra, të cilat ndoshta as i kishin parë fare, por i kishin dëgjuar nga të tjerët. Idiotë, tyrylyfë, masctrues, shante me vete, ndërsa shkruante fjalën e dënimit mbi fletët e tjera. Megjithatë dora e tij sa vente bëhej më e ngadaltë, gjersa më në fund qëndroi pezull mbi fletën. Dale njëherë, tha me vete, ose kështu, si i çmendur. Nuk iu desh më tepër se nië minutë që vrullin e zemërimit t'ia zinin prapë dyshimet.

Në të vërtetë kjo s'ishte aq e thjeshtë, dhe nga ata teveqelë të panjohur mund të të gjente belaja. Nëpunësit e të gjithë sektorëve pa përjashtim, por sidomos ata të Seleksionimit, dridheshin nga fjala «verifikim». I kishin treguar se qëllonte shpesh që èndërrparësi, me të dëgjuar ndonjë ngjarje reale, dërgonte letër në Tabir Saraj, duke pretenduar profetizimin e ngjarjes me anë të èndrrës së tij. Atëherë kërkohet èndrra, gjendej me anë të numrit të regjistrimit të saj në Recepzion, nxirrej nga Arkivi dhe, në qoftë se ajo ishte vërtet ashtu, kërkoheshin fajtorët që ajo s'qe marrë parasysh. Fajtorë mund të ishin interpretuesit, që nuk e kishin zbërthyer drejt kuptimin e sinjalit, po mund të ishin seleksionuesit, që e kishin nxjerrë èndrrën të pavlefshme dhe në këtë rast faji i tyre quhej edhe më i rëndë, sepse gabimi i interpretuesit, që nuk arriti ta shpjegonte drejt sinjalin, ishte më i falshëm në krahasim me gabimin e seleksionuesit, që nuk gjeti në èndërr asnjë sinjal.

Punë e mallkuar, tha me vete Ebu Qerimi, i habitur edhe vetë nga ky çast rebelimi i ndërgjegjes së tij. Megjithatë në dreq të vente. Ai shkroi fjalën «e pavlefshme» mbi njérën nga fletët, por të tjetra përsëri u step.

Padashur, ngaqë s'dinte q'të bënte me atë fletë që i mbeti në ëndrrë, nisi të rilexonte tekstin e shkruar në të: «Një shesh i braktisur, pranë këmbës së një ure; një lloj dje rrine nga ato ku hedhin mbeturinat. Midis hedhurinave, pluhurit, copërave të thyera të lavamanëve një vegël e vjetër muzikore, e paparë ndonjëherë, që binte vetveti midis asaj shkretie, dhe një dem, i egërsuar, siç duket, prej tingullit të asaj vegle, shkrofëtinte te këmba e urës.»

Punë artistësh, tha me vete Ebu Qerimi, ndonjë muzikant i pakënaqur, i mbetur pa punë. Ai nisi të shënon-te fjalën «e pavlefshme» sipër fletës. Kishte shkruar vetëm «e pa», kur sytë i shkuani te rreshtat e parë që i kishte kapërcyer dhe ku shënohej emri i njeriut që kishte parë ëndrrën, data dhe profesioni i tij. Për çudi, i zoti i ëndrrës nuk ishte muzikant, po shitës lulelakrash, nga kryeqyteti. C'më polli, tha me vete Ebu Qerimi, pa i hequr sytë nga fleta. Të dilte një bakall i mallkuar dhe tē ngatërronte mendjen! Ishte dhe nga kryeqyteti dhe e kishte lehtë tē ankohej. Ebu Qerimi i shoi me kujdes gërmat e shkruara sipër fletës dhe e kaloi ëndrrën në tē vlefshmet. Idiot, murmuriti edhe një herë me vete, duke e vështruar për herë tē fundit me bisht tē syrit fletën e ëndrrës, siç vështrohet njeriu që i bëhet një favor pa e merituar. Ngjeu penën në bojë dhe, pa i lexuar përsë dyti, shkroi fjalën «e pavlefshme» mbi disa fletë tē tjera. Kur vrulli i zemërimit i ra, e frenoi prapë veten. I kishin mbetur akoma edhe tetë ëndrra, nga ato që në shikimin e parë i kishte nxjerrë si tē pavlefshme. I pa me qetësi, një nga një dhe, me përjashtim tē një rës që e kaloi në tē vlefshmet, tē tjerat i la aty ku ishin. Duhej tē ishe tepër i trashë që tē mos kuptoje në to sherret në familje, kapsllékun apo mungesën e grave.

Orari zyrtar s'po mbaronte që s'po mbaronte. Me gjithëse i dhimbni sytë, Ebu Qerimi tërroqi disa fletë nga dosja e ëndrrave tē papërpunuara dhe i vuri përparrë. Kishte përshtypjen se lodhej më shumë duke bërë sikur lexonte, sesa po tē lexonte vërtet. Zgjodhi ato flet-

të që kishin tekstet më të shkurtra dhe, pa e parë fare adresuesin lexoi njérën prej tyre: «Një mace e zezë kishte kapur në gojë hënën dhe po vraponte e ndjekur nga turma. Gjithë udhës nga ikte, dukeshin gjurmët e hënës së plagosur.»

Ja, kjo ishte vërtet një èndërr që ia viente barra qiranë të merreshe me të. Para se ta kalonte te të vlefshmet, Ebu Qerimi e lexoi edhe një herë. Ishte vërtet një èndërr serioze, me të cilën kishte qejf të merreshe. Ebu Qerimi mendoi se, sidoqoftë, puna e interpretuesve, pavarësisht se ishte tepër e vështirë dhe delikate, ishte e këndshme, sidomos kur kishe të bëje me èndrra të tillë. Atij vetë, megjithëse i lodhur, i lindi dëshira ta interpretonte èndrrën. Madje kjo gjë s'iu duk aspak e zorshme. Përderisa hëna ishte simbol i shtetit e i fesë, kuptohej që macja e zezë ishte një forcë armiqësore që vepronte kundër tyre. Një èndërr e tillë i ka të gjitha shanset për t'u shpallur kryeëndërr, mendoi Ebu Qerimi. Ai shikoi adresuesin. Ishte nga një qytet i largët i krahut evropian të shtetit. Andej edhe èndrrat vijnë më të bukura, mendoi Ebu Qerimi. Ai e lexoi atë për të tretën herë dhe iu duk akoma më e bukur dhe me kuptim. Një gjë e mirë ishte se èndrra, veç të tjerash, kishte edhe turmën, e cila me siguri do ta arrinte macen e zezë për t'a shkëputur hënën prej dhëmbëve. Me siguri ajo ka për të përfunduar ndonjë ditë si bashëndërr, tha ai me vete dhe e vërejti gati me buzëqeshje fletën e zakonshme ku që shkruar èndrra, si njeriu që sheh një vajzë tanë për tanë të zakonshme, por që ai e di se e pret fati i një prince-she.

Ebu Qerimi ndjeu për çudi një lehtësim. Ai mendoi të lexonte edhe dy-tri fletë të tjera, por i la përgjysmë, sepse nuk deshi të prishte përshtypjen e mirë të èndrrës me hënë. Ai ktheu kokën nga xhamat e mëdhenj, pas të cilëve po binte muzgu. Tani nuk donte të merrej më me asgjë. Donte vetëm që të mbaronte orari zyrtar. Megjithëse drita sa vente po dobësohej, kokat e njerëzve vazhdonin të rrinin të përkulura mbi dosje. Ai ishte gati

i sigurt se, edhe sikur të binte nata dhe terri i pérjetshëm, ato koka nuk do të ngriheshin që andej, pa rënë zilja e mbarimit të punës.

Më në fund ajo ra vërtet. Ebu Qerimi mblođhi me shpejtësi fletët. Nga të gjitha tryezat dëgjoheshin zhurmët e sirtarëve që hapeshin për t'u futur brenda dosjet. Ebu Qerimi e mbylli sirtarin e tij me çelës dhe, megjithëse ishte një nga të parët që doli nga salla, vetëm pas një cerek ore u gjend përjashta.

Në rrugë ishte ftohtë. Nëpunësit që dilnin me grumbuj të mëdhenj, shpërndaheshin në drejtime të ndryshme. Në trotuaret pérballë, ashtu si çdo mbrëmje, ishte grumbulluar një turmë sehirxhinjsh, që vështronin daljen e nëpunësve nga Pallati i Endrrave. Nga të gjitha institucionet e mëdha shtetërore, duke përfshire këtu edhe pallatin e Sheh-Ul-Islamit, edhe zyrat e Vezirit të Madh, Tabir Saraji ishte i vetmi që zgjonte kureshtinë e njerëzve gjer në atë shkallë, saqë qindra kalimtarë të ndalonin e të prisnin daljen e nëpunësve. Në heshtje, me jakat të ngritura nga të ftohtët, njerëzit vështronin nëpunësit misteriozë që merreshin me punën më enigmatike të shtetit, i ndiqnin me ca sy të shtangur, sikur të përpinqeshin të kërkonin mbi fytyrat e tyre gjurmët e endrrave dhe nuk largoheshin veçse kur portat e rënda të pallatit të madh mbylleshin me kërkëlimë.

Ebu Qerimi shpejtoi hapat. Fenerët e rrugëve nuk ishin ndezur akoma, por ata do të ndizeshin me siguri përpara se ai të arrinte te rruga e tij. Qyshse kishte filuar punën në Tabir, kishte një lloj frike nga rrugët e pandriçuara.

Rrugët ishin plot me kalimtarë. Aty-këtu kalonin me shpejtësi karroca me dritare të zëna me perde. Në to kishte me siguri hanëme të bukura, që shkonin në takime të fshehta, Ebu Qerimi psherëtiu.

Kur mbërriti te rruga e tij, fenerët ishin ndezur vërtet. Kjo ishte një rrugë e qetë, gjysmë luksoze, një pjesë e ndërtesave të së cilës ishin të rrethuara me kangojella të rënda hekuri. Gështenjapjekësit po bëheshin ga-

ti tē iknin. Disa kishin futur nē torba gështenjat, kau-shët bosh dhe qymyrin dhe, siç dukej, prisnin tē fto-heshin edhe pak mangajtē prej llamarine me vrima. Polici i rrugës e pëershëndeti me nderim Ebu Qerimin. Nga kafeneja e udhëkryqit po dilte i dehur tapë fqinji i tyre, oficeri nē lirim Beç beu. Ai ishte me dy shokë tē tjerë, tē cilëve u pëshpëriti diçka kur pa Ebu Qerimin. Kur kaloi përbri, Ebu Qerimi ndjeu sytë e tyre t'i nguleshin gjithë kureshtje dhe frikë. Ai shpejtoi hapat. Që larg pa se kishte dritë nē tē dy katet e shtëpisë. Do tē kenë ardhur mysafirë, tha me vete, megjithatë ndjeu një si dridhje. Kur u afrua dhe pak, pranë portës së shtëpisë pa karrocën me shenjën e Qyprillinjve, shkronjën «Q» tē gdhendur nē tē dy dyert dhe, nē vend që tē qetësohej, u shqetësua edhe më.

Portën ia hapi shërbyesja e vjetër e shtëpisë, Lokja.

— C'është? — ia bëri Ebu Qerimi, duke treguar me kokë dritat nē katin e dytë.

— Kanë ardhur dajat e tu.

— Ka ndodhur gjë?

— Asgjë. Kanë ardhur pér vizitë.

Ebu Qerimi mori frymë i lehtësuar. Ç'kam kështu, tha me vete, ndërsa ecte përmes oborrit drejt derës së brendshme. Gjithmonë i kishte qëlluar tē shqetësohej kur kthehej vonë dhe shikonte dritat tē ndezura anekënd shtëpisë, por asnjëherë nuk qe trondit tur si son te. Siç duket, puna e re, mendoi.

— Të kërkuan mbasdite dy shëkë tē tutë, — po i thoshte Lokja që vinte pas. — Më thanë tē shkosh t'i takosh nesër ose pasnesër nē atë...atë... si e quajnë tē mallkuarin, klob apo klab.

— Në klub.

— Hë, në klub.

— Po tē më kërkojnë prapë, thuaju që s'kam kohë tē lirë.

— Mirë, — tha shërbyesja.

Në korridor Ebu Qerimi ndjeu një erë tē mirë gjellësh. Para se tē hynte nē dhomën e miqye, qëndroi një

minutë në këmbë, pa e ditur as vetë pse. Më në fund hapi derën dhe hyri. Në dhomën e madhe, të shtruar anekënd me qilim, ndihej era e njohur e zjarrit. Kishin ardhur dy dajat e tij, i madhi bashkë me gruan, dhe i vogli. Ishin dhe dy kushërinj të tjerë, të dy zëvendësministra, që vinin shpesh. Ebu Qerimi i takoi me radhë.

— Dukesh i lodhur, — i tha daja i madh.

Ebu Qerimi ngriti supet, sikur t'i thoshte: «ç't'i bësh, punë». Ndihej menjëherë që, para se të vinte ai, ishte folur për punët e tij. Ebu Qerimi vështroi të ëmën, që rrinte me gjunjët mbledhur pranë njërit prej dy mangajve të mëdhenj prej bakri. Ajo i buzëqeshi fare lehtë dhe vetëm atëherë ai e ndjeu se u çlirua plotësisht nga ankthi. U ul në një qoshe të minderit duke pritur çastin që vëmendja të ikte më në fund prej tij. Dhe ajo iku vërtet pas disa çastesh.

Daja i madh vazhdoi të tregonte diçka, që Ebu Qerimi, me sa dukej, e kishte ndërprerë me hyrjen e tij. Ai ishte guvernator në një nga zonat më të largëta të perandorisë dhe, sa herë që vinte me punë në kryeqytet, sillte që andej plot rrëfime të ashpra, të cilat Ebu Qerimit i dukeshin të njëllojta me ato të herës tjetër. Gruaja e tij, e imët, me fytyrë të pakënaqur, dëgjonte me vëmendje ato që tregonte i shoqi dhe herë pas here vështronë të pranishmit sikur t'u thoshte: e shikoni ku jetojmë ne? Ajo ankohej gjithmonë nga klima e atjeshme, nga punët e shumta të të shoqit, dhe në fjalët e saj kishte një pakënaqësi të vazhdueshme ndaj kunatit të saj, vëllait të mesëm të të shoqit. Vezirit, siç e thërritin në gjithë njëriun që tani për tani kishte postin më të lartë shtetëror midis gjithë Qyprillinxve, ministër i Jashtëm, dhe i cili, sipas saj, nuk ishte interesuar sa duhej që vëllai i tij të kthehej më në fund në kryeqytet.

Daja i vogël dëgjonte me një buzëqeshje të shkujdesur vëllanë e madh. Ndërsa daja i madh i dukej Ebu Qerimit si një bronz i mbuluar pakëz nga pluhuri i ash-përsisë, fanatizmit dhe provincës, të voglin e donte përherë e më tepër. Biond, me sy të çelët, me ca mustaqë të

kuqërremta, me atë emër shqiptaro-gjerman, Kurt, për të thoshin se ishte trëndafili i egër i Qyprillinxve. Ndryshe nga vëllezërit e tjerë, nuk qe ngulur në asnjë post të rëndësishëm, përkundrazi përherë kishte hyrë në ca punë disi të çuditshme që i braktiste shpejt: në një institut të oqeanografisë, në arkitekturë, kurse kohët e fundit merrej me muzikë. Veç kësaj, nuk donte të martohej, luante golf me të birin e konsullit austriak, flitej se këmbente letra dashurie me ca hanëme misterioze, me një fjalë gjithçka e bënte tjetërlloj, tërheqëse, por pa dobi. Ebu Qerimi ëndërronte që ta imitonë, por e ndiente se s'do të arrinte dot. Krejt i qetësuar tani, ndërsa dëgjonte bisedën e dy dajave, Ebu Qerimi përfytyronte karrocën që rrinte përjashta e që i kishte sjellë ata, atë karrocë që, sa herë e shihte, ndiente gjëzim të përzier me tmerri, sepse me të kishin ardhur gjithmonë ose lajmet e mira ose tmerret.

Në shtëpinë e Qyprillinxve, ose në «Pallat», siç e quanin midis tyre gjithë njerëzit e fisit shtëpinë e Qyprillut kryesor, kishte disa karroca, por ato ishin të njëlllojta dhe për Ebu Qerimin ato ishin vetëm një, karroca e hareshme-fatale, me atë «Q» të gdhendur në dru, që sillte ose ylberet, ose zinë nga shtëpia kryesore në të gjitha shtëpitë e fisit të madh. Disa herë qe biseduar për atë shkronjën «Q», për ta zëvendësuar me «K» sipas shkrimit të emrit të Qyprillinxve në osmanishten zyrare, Köprülü, mirëpo ata s'kishin dashur kurrsesi një ndërrim të tillë dhe kishin ruajtur shkronjën «Q» dhe të gjitha shkronjat e tjera të emrit, sipas alfabetit të gjuhës shqipe.

— Domethënë hyre në Tabir Saraj, — iu drejtua Ebu Qerimit daja i madh, që e kishte mbaruar më në fund rrëfimin e vet. — E vendose më në fund.

— E vendosëm të gjithë bashkë, — tha nëna.

— Mirë bëtë, — tha daja i madh. — Punë e nderuar, punë e rëndësishme. Me hair!

— Ishalla, — tha nëna. — Të lumtë goja!

Në bisedë u përzien dy kushërinjtë e tjerë. Ndërsa

dëgjonte q'flitej, Ebu Qerimit iu kujtuan gjithë bisedat e pafundme për punën e tij përpara se të vendosej hyrja në Tabir. Një njeri i jashtëm, po t'i kishte dëgjuar ato, do të mbetej me gojë hapët: është e mundur që të diskutohej me kaq kujdes se në q'punë do të hynte një nip nga Qyprillinxh, nga familja e famshme që i kishte dhënë perandorisë, përvëç pesë kryeministrave, një numër të pafund ministrash, admiralësh, gjeneralësh, dy prej të cilëve kishin komanduar dy fushatat e Hungarisë, një tjetër fushatën e Polonisë dhe një i tretë pushtimin e Austrisë; e familjes që edhe tani, në zbehjen e saj, mbetej një nga shtyllat e perandorisë, që kishte hedhur e para idenë e riformimit të shtetit të madh, duke e kthyer në SHBO (Shtetet e Bashkuara Osmane), që e vëtmja pas familjes perandorake figuronte në La Rouss-in e Francës te shkronja «K» Köprülü — *grande famille albanaise dont cinq membres furent de 1656 à 1710, grands visirs de l'Empire Ottoman*, te porta e së cilës trokitin të druajtur funksionarë të lartë të shtetit për të kërkuar mbrojtje, karrierë apo ndërhyrje për mëshirë.

Kështu mund të dukej në vështrimin e parë, e habitshme dhe disi e pabesueshme, por, për ata që e dinin më thellë historinë e Qyprillinxh, nuk ishte aspak ash tu. Kishte rrëth katërqind vjet që familjes së madhe kryeministrale, krahas lavdisë së paparë, s'i ndahej fatkeqësia e paprerë. Kishte në të po aq dritë, sa edhe terr, po aq njerëz me poste të larta, ministra, guvernatorë, kryeministra, sa edhe të dënuar në burgje, me koka të prera, të humbur pa nam e pa nishan. Ne Qyprillinxh jemi si ata njerëzit që kanë çelur toka e jetojnë në këmbët e vullkanit Vezuv, thoshte gjysmë me të qeshur da ja i vogël, Kurti. Ashtu si Vezuvi që shpërthen herë-hë rë e djeg e shkrumbon ata që jetojnë në hijen e tij, ashtu edhe ne na godet herë pas here sovranit, nën hijen e të cilët rrojmë. Dhe ashtu si ata që jetojnë në këmbët e Vezuvit, me gjithë fatkeqësitë e herëpashershme të tij, pas qetësimit të vullkanit, prapë aty, në tokat pjellore, por të rrezikshme te këmbët e tij e ngrenë jetën, ashtu

edhe ne, me gjithë rrebeshet që na dërgon sovrani, prapë nën hijen e tij qëndrojmë e i shërbejmë besnikënisht.

Qysh nga fëmijëria Ebu Qerimi mbante mend ca ece-jake të shërbëtorëve që pa gdhirë nëpër shtëpinë e tyre të madhe, pëshpërimat nëpër dyer, tezet me fytura të llahtarisura që trokitnin te porta e jashtme, ditë të tëra me lajme të zymta, me pritje, me ankth, gjersa vinte që-tësimi me vajtimin e qetë të të dënuarit në ndonjë nga dhomat e mënjanuara dhe pastaj jeta që vazhdonte si edhe më parë, në pritje të një shkëlqimi të ri, ose të një zie të re. Sepse, siç thuhej, në familjen e Qyprillinjve burrat ose ngjiteshin në poste të larta, ose binin në fatkeqësi, rrugë të mesme s'kishte.

Shyqyr që ti, së paku, nuk e ke mbiemrin Qypri-lliu, i thoshte herë pas here e ëma Ebu Qerimit, pa i besuar edhe vetë ngushëllimit të saj. Ai ishte djale i vëtëm dhe ajo gjithë jetën e saj, qysh pas vdekjes së të shoqit, s'kishte bërë gjë tjetër, veçse kishte menduar si ta embronte Ebu Qerimin nga pjesa e keqe e fatalitetit të Qyprillinjve. Kjo e kishte bërë atë më të mëngjme, më autoritare dhe, për çudi, më të bukur. Një kohë të gjatë ajo, me veten e saj, kishte vendosur ta mbante Ebu Qerimin larg karrierës. Mirépo, kur djali u rrit dhe mbaroi shkollën, përherë e më tepër vendimi i saj dukej i pakuptimit. Në familjen e Qyprillinjve nuk njihezin të papunët; me dashje ose pa dashje duhej gjetur një post për Ebu Qerimin. Një post ku mundësítë për karrierë të ishin sa më të mëdha dhe mundësítë për të rënë në burg sa më të vogla. Në fis qe diskutuar gjatë për këtë, qenë sjellë e risjellë ndër mend diplomacia, ushtria, oborri, banka, ministritë, qenë shkoqitur një për një të mirat dhe të këqijat e tyre, mundësítë e ecjes përpëra dhe mundësítë e rrëzimit, ishte shqyrtuar një për një secili post, qe braktisur njëri që ishte dukur më i papërshtatshëm ose më i rrezikshëm për tjetrin, pastaj qe hequr dorë nga ky i dyti, për po ato arsy, ishte gjetur një i tretë, që në fillim qe dukur se ndryshonte nga dy të parët, por pastaj, në një shikim më të thellë, qe ardhur në

përfundimin se pikërisht ky post, i qetë në pamjen e jashtme, ishte më i rrezikshmi se të tjerët, atëherë qenë kthyer përsëri tek i pari, tek ai për të cilin kishin thënë në fillim «upupu, vetëm atje të mos vejë!» e kështu me radhë, gjersa më në fund nëna e Ebu Qerimit, e lodhur nga të gjitha këto, kishte thënë: le të vejë ku të dojë, asaj që është shkruar s'i shpëton dot. Në këtë e sipër, tamam kur po bëheshin gati ta linin zgjedhjen në dorën e vetë Ebu Qerimit, daja i mesëm, Veziri, që gjer atëherë s'që përzier në këtë punë, kishte shfaqur më në fund mendimin e vet. Ajo që propozoi ai, tingëlloi në fillim si e papritur, si diçka që duhej shoqëruar patjetër me një buzëqeshje, megjithëse buzëqeshja u tret shpejt në fytyrën e secilit, duke lënë në vend të saj një hutim. Pallati i Ëndrrave? Po si? Për ç'arsye? Pastaj dalngadalë, sa më shumë që e mendonin punën, aq më tepër ajo nisi tu dukej e natyrshme. Pse jo në Tabir Saraj? Ç'të keqë kishte? Madje jo vetëm që s'kishte të keqe, por, përkundrazi, ishte më mirë se në gjithë ato punët e tjera plot kurthe. Po vallë këtu a nuk kishte rreziqe? Natyrisht, natyrisht, po sidoqoftë janë rreziqe ëndrrash, një botë ëndrrash, më kuption, si ka thënë i vjetri kur u gjet pisk: bëje, o zot, ëndërr! Ashtu është. Dalngadalë ideja e ministrit e përpiu krejt nënën e Ebu Qerimit. Si nuk ishin kujtuar më parë? thoshte ajo. Tabiri i qe dukur asaj gjetja e vetme shpëtimtare për të birin. Përvëç që ishte një institucion që i jepte mundësi të pakufishme injeriu për të ecur përpara, nënën e Ebu Qerimit e tërhiqte sidomos karakteri i papërcaktuar, i mjegullit i tij. Realiteti atje dyzohej, shumë shpejt fillonte irealja, dhe pikërisht kjo mjegullinë i dukej asaj si mqedisi më i mirë pas së cilës Ebu Qerimi mund të fshihej gjatë kohës së rrebesheve.

Edhe të tjerët ishin të një mendjeje me të. Veç kësaj, thoshin ata, Veziri s'e kishte menduar kot këtë gjë. Kohët e fundit Tabir Saraji po luante gjithmonë e më tepër rol në punët e mëdha të shtetit, dhe Qyprillinxh, me prirjen e tyre të natyrshme për t'i parë pakëz me

ironi institucionet e vjetra, tradicionale, e kishin nën-vlefësuar pak Pallatin e Ëndrrave. Madje vite më parë flitej se qenë pikërisht Qyprillinxjtë, që, në mos arritën ta mbyllnin, e ulën në mënyrë të ndjeshme forcën e Tabir Sarajit. Mirëpo kohët e fundit sovrani e kishte ripërtirë fuqinë e dikurshme të tij.

Të gjitha këto Ebu Qerimi i kishte mësuar dalngadalë gjatë bisedave të gjata për punën e re. Natyrisht, kur thuhej se Qyprillinxjtë e kishin nën-vlefësuar pak Tabirin, kjo s'do të thoshte aspak se ata nuk kishin njërezit e vët atje. Ata prej kohësh do të kishin pushuar së qeni Qyprillinj, po të kryenin mendjelehtësira të tillë. Mirëpo, të dhënë siç duket pas organizmave të tjera të shtetit e sidomos me shpresë se mund të neutralizonin përsëri frymën e «Institucionit gërxho», siç e quanin me shaka midis tyre, ata kishin dobësuar vëmendjen ndaj tij. Pikërisht këtë gjë përpinqeshin me sa duket të riparonin tani. Ata kishin njërezit e tyre atje, që ishin me siguri me dhjetëra, por «ndryshe janë njërezit e gjakut tënd», i kishte thënë Veziri motrës së vet, nënës së Ebu Qerimit. Ai ishte pak nervoz, dhe ajo pati përshtypjen se ishte më i shqetësuar se ç'dukej për këtë gjë. Me siguri dinte diçka më tepër që asaj nuk ia kishte thënë.

Kjo kishte ndodhur dy ditë më parë se Ebu Qerimi të paraqitej në Tabir Saraj. Gjatë gjithë kësaj kohe emri i Ebu Qerimit dhe i Pallatit të Ëndrrave ishin të pandarë nga njëri-tjetri. Ja edhe tani ata ishin bashkë, dhe kjo e bënte të bezdisshme bisedën për Ebu Qerimin. Ai kishte shpresë se, kur të uleshin për të ngrënë darkë, biseda do të ndryshonte me siguri. Mirëpo, për fat, ajo ndryshoi më përpara. Në të vërtetë, vazhdoi të flitej për Tabir Sarajin, po prej bisedës qe shkëputur emri i Ebu Qerimit. Kjo gjë bënte që ai t'i ndiqte fjalët më me vëmendje.

— Sidoqoftë tani mund të thuhet se Tabir Saraji e ka rivendosur plotësisht autoritetin e dikurshëm, — tha njëri nga kushërinjtë.

— Kurse unë, pavarësisht se jam një Qyprilli, nuk

kam besuar kurrë se atij mund t'i lëkundet autoriteti kolaj, — përgjigjej daja i vogël, Kurti. — Ai nuk është vetëm një nga institucionet më të vjetra të shtetit; përmendimin tim, ai, pavarësisht nga emri i bukur që ka, është institucioni më i tmerrshëm.

— Ka edhe të tjera institacione të tmerrshme, — e kundërshtoi kushëriri.

Kurti buzëqeshi.

— Po tmerri i tyre është i zbuluar, — tha ai. — Tmerri i tyre nxin që tutje, kurse Tabir Saraji është tjetër gjë.

— E pse është i tmerrshëm, sipas teje, — ndërhyri nëna e Ebu Qerimit.

— O, jo në atë kuptim që mund ta marrësh ti, — tha Kurti, duke vështruar me bisht të syrit nga Ebu Qerimi.

— Unë e kisha për tjetër gjë. Përmendimin tim, midis gjithë mekanizmave të shtetit, Pallati i Endrrave është ai që qëndron më jashtë vullneteve njerëzore se gjithë të tjerët. Më kuptioni ç'dua të them? Ai është më impersonali i të gjithëve, më i verbri, më fatali, pra edhe më shtetërori.

— Kurse mua më duket se edhe ai, në njëfarë mënyre, mund të drejtohet, — u hodh kushëriri tjetër. Ai ishte pa flokë, me ca sy të zgjuar, po ku zgjuarsia shfaqej në një mënyrë të vlefçantë: sytë ishin gjysmë të shuar, thuase zgjuarsia i kishte lodhur, dhe ai ishte gati ta falte me gëzim një pjesë të saj.

— Kurse unë them se ai është institucioni i vetëm në shtetin tonë, nëpërmjet të cilët pjesa e errët e ndërgjegjes së gjithë shtetasve krijon një kontakt të drejt-përdrejtë me shtetin, — tha Kurti. Ai i vështroi të gjithë me radhë, si për të kuptuar se sa kishin arritur tek ata fjalët e tij. — Turmat e pafundme vërtet nuk qeverisin, — vazhdoi ai, — por kanë një mekanizëm, me anë të të cilët ndikojnë në të gjitha punët, aventurat dhe krimet e shtetit, dhe ky është Tabir Saraji.

— Do të thuash se të gjithë së bashku kanë një përgjegjësi për gjithçka që ndodh, një ndjenjë faj? — tha kushëriri.

— Po, — u përgjigj Kurti. — Në njëfarë mënyre po,  
— shtoi ai më vendosmëri.

Tjetri buzëqeshi, por, ngaqë sytë i kishtë gjysmë të  
mbyllur, nuk u duk veçse fundi i buzëqeshjes, si ndri-  
çimi në fundin e një dere.

— Pavarësisht nga të gjitha këto, për mua ai është  
institucioni më absurd i perandorisë, — tha ai.

— Do të ishte absurd në një botë logjike, — tha  
Kurti. — Kurse në botën tonë mua më duket më se nor-  
mal.

Kushëriri nisi të qeshte me zë, por, meqë guverna-  
tori mbajti një fytyrë të vrerët, ai e fiku dalngadalë të  
qeshurën.

— Kurse rrëth e rrotull flitet se janë më të thella  
punët, — u hodh kushëriri tjetër. — Asgjë s'është kurrë  
aq e thjeshtë sa ç'duket. Kush mund t'i dijë sot punët e  
vërteta të Orakullit të Delfit? Dosjet e tij kanë humbur,  
ose, që të jem më i saktë, janë zhdukur. Edhe emërimi  
i Ebu Qerimit s'ishte aq i thjeshtë.

Nëna e Ebu Qerimit, me sy të vëmendshëm jashtë  
mase, përpiquej të mos i shpëtonte asgjë.

— Lereni më mirë këtë bisedë, — ndërhyri guverna-  
tori.

Emërimi im s'ishte i thjeshtë? ia bëri me vete Ebu  
Qerimi dhe copëza-copëza iu renditen në kujtesë pjesë  
nga mëngjesi i parë i asaj dite, kur ai shkoi në Tabir,  
si krijeza më e humbur e botës, të gërshtuara me orët  
e fundit të mërzitshme të orarit zyrtar në Seleksionim.  
Kurse ai me siguri kujton se unë kam shkuar atje për  
të pushtuar Tabirin, tha me vete me qesëndi të hidhur.

— Lëreni tanë këtë bisedë, — tha për herë të dytë  
daja i madh.

Në atë kohë Lokja lajmëroi se darka ishte gati dhe  
ata u ngritën për të shkuar në dhomën e bukës.

Në tryezën e darkës gruaja e vëllait të madh të  
Qyprillinje nisi të tregonte diçka për zakonet e vende-

ve të provincës që drejtonte i shoqi, kur Kurti, pa shumë kujdes, i preu fjalën:

- Kam ftuar rapsodë nga Shqipëria, — tha ai.  
— Si? — thanë dy-tre zëra.

U kuptua menjëherë që ajo «si?» do të thoshte: «ç'tu kujtua një gjë e tillë? Përse? Ç'është ky trill i ri?»

— Pardje bisedoja me konsullin austriak, — vazhdoi ai, — dhe e dimi ç'më tha? Ju Qyprillinxh jeni sot familja e vetme aristokrate në Evropë dhe me siguri në botë, që keni një epos.

- Ah, — ia bëri njëri nga kushërinjtë, — e qartë.

— Ai e krahasoi eposin që këndohet për ne, me Nibelungen të gjermanëve dhe shtoi se, në qoftë se për një familje të madhe gjermane apo franceze do të këndohej qoftë dhe një e qindta e eposit që këndohet sot për ne në Ballkan, kjo do të trumbetohej si mburrja dhe mrekullia më e madhe për ta. Kurse ju Qyprillinxh mezi kujtoheni për këtë. Kështu më tha.

— E qartë, — përsëriti njëri nga kushërinjtë. — Veç një gjë nuk kuptoj: ti fole për rapsodë shqiptarë apo jo? Në qoftë se bëhet fjalë për eposin që dimë të gjithë, atëherë ç'hyjnë këtu rapsodët shqiptarë?

Kurt Qyprilliu e vështroi në sy, por nuk iu përgjigji. Biseda për eposin ishte e vjetër në familjen e Qyprillinxh, ashtu si serviset e shtrenjta, dhurata të dikurshme të sovranëve, që cdo brez Qyprillinxh i gjente për t'uа lënë brezit tjetër. Ebu Qerimi e kishte dëgjuar bisedën e eposit qysh në fëmijëri. Në fillim ai e kishte përfytyruar eposin si diçka të gjatë, midis dragoit dhe gjarprit, që rrinte larg në ca male me dëborë dhe në trupin e të cilit, si në trupin e qenieve përrallore, ishte ndryrë fati i familjes. Mirëpo, duke u rritur, dalngadalë e kishte kuptuar, megjithëse jo fort qartë, se ç'ishte ky epos. Në të vërtetë për Ebu Qerimin qe pak e vështirë të merrte me mend se si Qyprillinxh rronin e sundonin në kryeqytetin perandorak, ndërsa larg, në Ballkanin e çuditshëm, në provincën me emrin Bosnjë, këndohej një epos për ta. Akoma më e pakapshme ishte për mendjen e Ebu

Qerimit se përse ky epos nuk këndohej në vendlindjen e Qyprillinje, në Shqipëri, por në Bosnjë dhe, veç kësaj, ai nuk gjendej në gjuhën amtare të Qyprillinje, në shqipe, por në sérbishtë. Një herë në vit, gjatë muajit të ramazanit, vinin rapsodët që nga Bosnja. Ata bujtnin për disa ditë rresht te Qyprillintë, për të kënduar rapsoditë e tyre të gjata, të shoqëruara me një vegël muzikore që nxirrte një zë të pikëlluar. Ky ishte një zakon që vazhdonte qysh prej qindra vjetësh dhe që brezat e rinj të Qyprillinje nuk kishin guxuar ta braktisnin apo ta ndryshonin. Të mbledhur në dhomën e madhe të my-safirëve, ata dëgjonin zërin e zvargur të rapsodëve sllavë, prej fjalëve të cilëve nuk kuptionin asnjerën, përveç emrit Qyprilli, që ata e shqiptonin Çupriliq. Pastaj rapsodët merrnin shpërblimin e zakonshëm dhe iknin, duke lënë pas vetes një ndjesi boshllëku dhe enigmë, që për disa ditë rresht shkaktonte te të zotët e shtëpisë ca psherëtima pa shkak, të ngjashme me ato që shkakton ndryshimi i motit.

Megjithatë flitej se sovrani i kishte zili Qyprillintë pikërisht për atë epos. Për sovranin qenë hartuar e vazhdonin të hartoheshin me dhjetëra divane e vjersha të ndryshme nga poetët zyrtarë, mirëpo një epos si ai i Qyprillinje s'këndohej gjékund për të. Madje flitej se ishte pikërisht kjo zili një nga shkaqet kryesore përrufetë me të cilat sovrani godiste herë pas here Qyprillintë. Po pse nuk ia falim atë epos sulltanit-mbret dhe të shpëtujmë nga të këqijat? kishte thërrë njëherë Ebu Qerimi i vogël, pasi kishte dëgjuar pëshpërimat e të mëdhenjve. Pusho, Ebu Qerim, i kishte thënë nëna, eposi është diçka që nuk dhurohet, më kuption, s'është si unazat apo xhevahiret, është një gjë e tillë, që, edhe po të duash ta japësh, nuk e jep dot.

— Është njëlloj si Nibelungen, kështu më tha, — vazhdoi Kurti mendueshëm. — Gjithë këto ditë kam bërë me vete atë pyetje që është bërë shpesh në shtëpinë tonë. Përse sllavët kanë ngritur një epos për ne, kurse bashkatqitarët tanë, shqiptarët, në eposin e tyre heshtin?

— Kjo është e thjeshtë, — tha njëri nga kushërinjtë  
— ata heshtin, sepse kanë pritur diçka prej nesh.  
— Sipas teje ky është një qortim?  
— Merre si ta duash.  
— Për mua është e kuptueshme, — ndërhyri kushë-  
riri tjetër. — Është një keqkuptim i vjetër midis familjes  
sonë të Qyprillinje dhe shqiptarëve. Ata e kanë vështi-  
rë të kuptojnë përmasat perandorake të familjes sonë,  
ose, pér të thënë një fjalë më të saktë, këtë gjë s'e pér-  
fillin aspak. Ata janë mospërfillës pér atë që kanë bërë  
e vazhdojnë të bëjnë Qyprillinjtë pér tërë perandorinë e  
madhe, në gjirin e së cilës Shqipëria s'është veçse një  
pjesë. Ata duan të dinë vetëm ç'kemi bërë ne pér këtë  
pjesë, vetëm pér Shqipérinë. Ata kanë pritur vërtet diç-  
ka të veçantë prej nesh.

Ai hapi krahët, siç bëjnë njerëzit kur duan të tho-  
në: ja, kështu janë punët.

— Shqipérinë disa e quajnë fatkeqe, disa, përkundra-  
zi, me yll, — tha kushëriri tjetër. — Unë mendoj se ajo  
qëndron përtej të dyjave. Ajo ngjan, në njëfarë mënyre,  
me familjen tonë të Qyprillinje: mbi të kanë rënë edhe  
favoret e sulltanit sovran, por dhe rrebeshet e tij.

— Cilat kanë qenë më të mëdha? — pyeti Kurti. —  
Favoret apo rrebeshet?

— Është vështirë ta thuash, — u përgjigj kushëriri.  
— S'më harrohet një fjalë që më ka thënë një çifut: kur  
turqit suleshin drejt jush me heshta dhe shpata në duar,  
ju, shqiptarët, kujtuat me të drejtë se ata po vinin t'ju  
pushtonin, kurse ata nuk bënин gjë tjetër, veçse ju sill-  
nin dhuratë një perandori të tërë.

— Ha, ha, — qeshi Kurti.

Sytë e fikur të kushëririt u **duk sikur** dhanë shkël-  
qimin e tyre të fundit.

— Por, si çdo dhuratë e një të **qmenduri**, ajo u dorë-  
zua me **egërsi**, madje me gjak, — vazhdoi ai.

— Ha, ha, ha, — qeshi Kurti këtë herë më fort.

— Përse qesh? — u hodh vëllai i madh, guvernatori.

— Eshtë tamam ashtu siç ka thënë çifuti. Turqit e ndanë pushtetin me ne, ti e di këtë gjë po aq mirë sa unë.

— Natyrisht, — tha Kurti, — vetëm pesë kryeministrat e familjes sonë mjaftojnë ta vërtetojnë këtë gjë.

— Ata kanë qenë vetëm fillimi, — tha vëllai i madh, — Më vonë erdhën qindra funksionarë të lartë.

— Unë nuk qesha për këtë, — tha Kurti.

— Je shumë i llastuar, — tha vëllai i madh, i ngrysur. Sytë e Kurtit u ndezën përbrenda.

— Turqit na dhanë neve shqiptarëve atë që na mu ngonte, — vazhdoi kushëriri, për të tërhequr vëmendjen,

— hapësirat e mëdha.

— Por edhe ndërlikime të mëdha, — tha Kurti. — Jeta e një njeriu të vetëm koklavitet kur plikset me mekanizmin e pushtetit, pale pastaj drama e një populli të tërë.

— C'do të thotë kjo?

— A nuk thatë se turqit e ndanë pushtetin me ne?

— Sidoqoftë ata na dhanë përmasat tonë të vërteta,

— vazhdoi kushëriri. — Kurse ne i mallkuam për këtë gjë.

— Jo ne, ata, — ndërhyri guvernatori.

— Më fal, ata, shqiptarët e atjeshëm.

U bë një heshtje e nderë, midis së cilës Lokja solli pjatancat me ëmbëlsira.

— Ata do ta fitojnë ndonjë ditë pavarësinë vërtet, por do të humbin këto mundësi të mëdha, — vazhdoi kushëriri. — Do të humbin këtë hapësirë vigane ku fluturojnë si era, do të mbyllen në atë truallin e tyre të ngushtë, krahët do t'u pengohen e do t'u përplasen nga një mal në tjetrin, si shpendët që s'marrin dot fluturimin, do të vyshken, do të squllen e më në fund do të thonë: c'fituam kështu?! Atëherë do të ngrenë sytë të gjejnë prapë atë që humbën, por a do ta gjejnë valle përséri?

Gruaja e guvernatorit pshëritiu thellë: Askush nuk po i prekte ëmbëlsirat.

— Megjithatë tanë për tanë ata heshtin për ne, — tha Kurti.

— Një ditë do të na kuptojnë, — tha vëllai i madh.  
— Ne gjithashtu duhet t'i dëgjojmë ata, — tha Kurti.

ti.  
— Po ti vetë the se ata heshtin për ne.  
— Të dëgjojmë heshtjen e tyre, — tha Kurti.

Guvernatori qeshi me zë.

— I çuditshëm mbete, — tha përmes së qeshurës.  
— Të thashë, kryeqyteti të ka llastuar shumë. Një vit shërbim në ndonjë provincë të largët s'do të të bënte keq.

— Larg qoftë! — tha nëna e Ebu Qerimit nëpër dhëmbë.

E qeshura e guvernatorit e shkruacarimin e lehtë që u krijua përpara/pak kohe në tryezë dhe të gjithë zgjatën pirunët drejt pjatancës me émbëlsira.

— Unë i ftova rapsodët shqiptarë, — tha Kurti, — sepse desha të dëgjoja se për se flet eposi shqiptar. Kon-sulli austriak, që kishte lexuar pjesë të tij, më tha se rapsoditë shqiptare atij i qenë dukur shumë më të bu-kura se ato bosnjaket.

— Vërtet?

— Po, — tha Kurti. Sytë e tij u picërruan sikur t'i vriste ndriçimi i dëborës. — Atje flitet për ndjekje të hata-hume nëpër bjeshkë, për dyluftime, rrëmbime vajzash e grash, karvanë dasmorësh që udhëtojnë drejt dasmash të rrezi-kshme, krushq të ngrirë e të kthyer në gur sep-se kanë bërë faj gjatë ecjes, kuaj të dehur me verë, kreshnikë të verbuar tradhësht mbi kuaj gjithashtu të verbuar, që enden bjeshkëve si në ankth, qyqe që paralajmërojnë fatkeqësi, trokitje nate në konakë të çuditshëm, thirrje në dyluftim makabër e të vdekurit prej të gjallit, që i vërtitet mbi varr me dyqind qenë, rënkimet e këtij të fundit që s'ngrihet dot nga varri për t'u nde-shur me armikun, njerëz e hyjni, të përzier bashkë, që zemërohen, goditen, martohen me njëri-tjetrin, sokëlli-ma, luftëra, mallkime ngjethëse dhe, mbi të gjitha kë-to, një diell i ftohtë që më shumë ndrit se nxeh.

Ebu Qerimi dëgjonte si i mahnitur. Një mall i pa-

njohur, disi i çuditshëm, për atë borë të largët dimri, ku ai s'kishte qenë kurrë, e përshkoi gjithë qenien e tij.

— Ja, ky është eposi shqiptar ku ne s'jemi, — tha Kurti.

— O, ashtu siç na e shpjegove ti, vërtet është e vë-shtirë që ne të ishim gjékund aty, — tha njëri nga kushë-rinjtë. — Ai i ngjan një etheje tragjike.

— Kurse në eposin sllav jemi, — tha Kurti.

— A nuk është e mjaftueshme kjo? — tha kushërirri, me vështrim të fikur. — Ti vetë the se ne jemi familja e vetme në Evropë e ndoshta në botë, që kemi një epos në një popull. A s'të mjafton kjo? Ti do që të kemi epos në dy popuj?

— Ti pyete a s'më mjafton kjo, — tha Kurti, — dhe unë po të them: aspak.

Të dy kushërinjtë tundën kokat me dashamirësi. Edhe vëllai i madh buzëqeshi.

— I çuditshëm mbete, — tha, — gjithmonë po ai.

— Kur rapsodët të mbërrijnë, do t'ju ftoj të gjithë për t'i dëgjuar, — tha Kurti. — Vezirit s'i kam thënë akoma, po s'besoj se do të ketë ndonjë kundërshtim për bujtjen e tyre. Rruga e tyre do të jetë e largët dhe, veç kësaj, duhet të udhëtojnë duke i mbajtur veglat muzikore të fshehta. Por ia vlen barra qiranë.

Kurti vazhdoi të fliste me pasion. Ai foli prapë për raportin e familjes së tyre këtu me eposin e *atjeshëm* ballkanik, si për raporte të administratës dhe artit, të së përkohshmes me të përjetshmen, të mishit me shpirtin.

— Sidoqoftë, thua ç'thuat këtu, mos i fol gjékund tjetër këto, — tha vëllai i madh, fytyra e të cilat ishte ngrysur përsëri.

Në tryezë zotëroi për një çast heshtje, të cilën tringëllima e pirunëve të fundit mbi porcelanin e pjatave e bënte edhe më të nderë.

— Ti, nip, ke filluar të mos përzihesh më në asnje bisedë, — iu drejtua Ebu Qerimit guvernatori, për të prishur heshtjen. — Siç duket, je futur kokë e këmbë në botën e ëndrrave.

Ebu Qerimi e ndjeu që po skuqej. Vëmendja e të gjithëve po drejtohej prapë nga ai.

— Ti punon në Seleksionim, apo jo? — vazhdoi daja i madh. — Veziri pyeti dje pér ty. Ai tha se karriera e vërtetë në Pallatin e Ëndrrave fillon në Interpretim, sepse vetëm atje bëhet një punë e vërtetë krijuese dhe mund të shpërthejë zotësia personale e njeriut. Apo jo?

Ebu Qerimi ngriti supet, si pér të thënë se nuk kish-te qenë në dëshirën e tij zgjedhja e sektorit ku do të punonte. Por në sytë e dajës së madh iu duk se kapi një shkëndijë të fshehtë.

Megjithëse guvernatori i uli sytë shpejt mbi pjatë, ai ndriçim i pazakontë nuk i kishte shpëtuar as nënës së Ebu Qerimit. Gjithë vëmendje dhe alarm ajo nisi të ndiqte prapë bisedën pér Tabir Sarajin, në të cilën merrnin pjesë tanë të gjithë, përveç djalit të saj.

Përveç atij... që ishte mu në mes të Tabirit. Truri i saj punonte si në ethe. Mos vallë e kishte ruajtur djalin kaq kohë pér ta hedhur më në fund në një kafaz tigrash, që mbante një emër joshës, por që në të vërtetë s'ishte veç një mekanizëm i verbër fatal dhe mizor, siç e quajtën pak më parë?

Me bisht të syrit ajo shikonte profilin e hequr të të birit. Si do të orientohej vallë ai, Ebu Qerimi i saj, në atë kaos ëndrrash, në ato shtëllunga resh të gjumit, në-pér ankth, pranë sinoreve të vdekjes? Si e kishte lënë ajo të futej nëpër atë shkretëtirë?

Përreth biseda pér Tabir Sarajin vazhdonte, por Ebu Qerimi ndihej i lodhur dhe nuk e ndiqte më. Kurti me njërin prej kushërinjve po diskutonin nëse rifuzizimi i Rallatit të Ëndrrave tregonte krizën e tanishme të supershtetit otoman, apo ishte thjesht një rastësi, ndërsa guvernatori përsërise: lëreni tanë këtë bisedë.

Mysafirët u ngriten më në fund nga tryesa pér të pirë kafet në dhomën e miqve. Ata ikën vonë, aty nga mesnata. Ebu Qerimi u ngjit me hapa të ngadaltë në dhomën e vet, në katin e dytë. Nuk i flihej, po pér këtë nuk shqetësohej aspak. I kishin thënë se gjithë nëpuf-

nësit e rinj të Tabir Sarajit vuarin zakonisht nga pagju-mësia dy javët e para pas fillimit të punës. Pastaj gjumi u rikthehej.

Ai u shtri në shtrat dhe sytë i mbajti hapur një copë herë të gjatë. Gjithçka e mendonte qetësisht. Kjo ishte një pagjumësi pa vuajtje, e rregullt dhe e ftohtë. Dhe s'ishte vetëm pagjumësia e tij që kishte ndryshuar. Gjithçka tjetër e tij kishte pësuar një ndryshim. Ora e madhe e udhëkryqit ra dy pas mesnate. Ai mendonte se e shumta aty nga ora tre, tre e gjysmë gjumi do t'i vinte. Por edhe në qoftë se ai vinte, nga ç'dosje do t'i merrte vallë ëndrrat për atë natë?

Ky ishte mendimi i fundit i Ebu Qerimit përpëra se gjumi ta kapullonte plotësisht.

shumë më parë se ç'e priste, ende pa dhënë pranvera asnjë shenjë të ardhjes, (kurse ai kishte kujtuar se së paiku atë pranverë, madje dhe verën pas saj do ta kallonte në Seleksionim), pra shumë më parë se të ndihej stina e re, Ebu Qerimi kaloi në Interpretim.

### III

## INTERPRETIMI

Një ditë, pa rënë ende zilja e pushimit të mëngjesit, e lajmëruan të paraqitej në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme. Po përse? pyeti ai dhe në çast u pendua, ngaqë iu duk se dalloi një nënqeshje ironike në cepat e buzëve të lajmësit. Ishte e kuptueshme që për kësot gjérash s'pyetej kurrë në Tabir Saraj.

Duke ecur korridorit, në kokë i pështilleshin gjithfarë dyshimesh e hamendjesh. Mos kishte bërë vallë ndonjë gabim në punë? Mos ishte shkulur dikush që nga fundi i shtetit dhe po trokiste zyrë më zyrë e vezir më vezir për të kërkuar ëndrrën e tij të hedhur pa të drejtë në kosh? U përpoq të rikujtonte ëndrrat e ditëve të fudit, për të cilat kishte pasur lëkundje para se t'i selek-

siononte, po nuk i vinte ndermend asnëjëra. Po ndoshta nuk ishte kjo. Ndoshëta ishte diçka krejt tjetër, zaten kështu ndodhë gjithmonë: të thërresin për atë gjë që s'të ka shkuar mendja. Nxjerrje sekreti? Po ai pothuajse s'kishte takuar asnëjë shok që pas hyrjes në punë në Tabir Saraj. Ndërsa pyeste nëpër korridore se si shkohej gjer atje, përherë e më tepër i dukej se kishte qenë një herë në atë krah të Pallatit. Njëherë mendoi se ndoshta i dukej kështu ngaqë korridoret e ndërtësës ishin të ngjashme, po kur më në fund u gjend në dhomën me mangall, ku pas një tryze druri rrinte njeriu me fytyrë të gjatë, sytë e të cilit vështronin vazhdimisht derën, u bind se zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme kishin qenë pikërisht ato ku ai kishte trokitur ditën e parë të hyrjes së tij në Tabir Saraj. I dhënë pas punës, e kishte harruar krejt qenien e tyre, madje as tanë nuk e dinte se ç'funksion kryente në Pallatin e Endrrave njeriu me fytyrë të gjatë, që e pranoi atëherë në punë. Ishte njëri nga nëndrejtoret e shumtë, apo ishte ndoshta vetë drejtori i përgjithshëm?

Në këmbë, përpara tij, krejt i mpirë nga ankthi Ebu Qerimi priste që tjetri t'i fliste. Po sytë e zyrtarit vazhdonin të vështronin derën, në lartësinë e rezës dhe, me gjithëse Ebu Qerimi e dinte tashmë atë zakon të tij, një çast besoi se ai priste dikë tjetër përpara se t'i njoftonte atë gjë për të cilën e kishte thirrur. Po zyrtari më në fund i hoqi sytë nga dera.

— Ebu Qerim, — tha ai me zë fare të ulët.

Ebu Qerimit i ranë djersë të ftohta. S'dinte ç'të bënte, të thoshte urdhëro, këtu jam, apo një formulë tjetër mirësjelljeje, apo të priste në këmbë mandatën. Tani ishte i bindur se nuk e kishin thirrur veçse për të keq.

— Ebu Qerim, — përsëriti tjetri. — Siç të thashë ditën e parë të ardhjes sate këtu, ti pëlqehesh prej nesh.

O zot, ia bëri Ebu Qerimi me vete. Përsëri ajo frazë e frikshme, me të cilën ai kishte kujtuar se do të kishte punë vetëm ditën e parë të tij në Tabir.

— Ti pëlqehesh prej nesh, — vazhdoi zyrtari, — dhe prandaj që sot e tutje do të kalosh në Interpretim.

Ebu Qerimi ndjeu t'i buçtinin veshët. Sytë padashur i shkuan te mangalli në mes të dhomës, prushi i të cilit, mbuluar përgjysmë me hi, iu duk se kishte një nënqeshje cinike, si të njerëzve që nënqeshin me sy gjysmë të mbyllur. Ishte po ai prush që kishte djegur fletën e tij të rekondimit, në atë ditë të paharrueshme, dhe që tanjore gjante si i platur në mospërfillje.

— Ke të drejtë që nuk shfaq ndonjë shenjë gjëzimi, — dëgjoi Ebu Qerimi zërin e tjetrit dhe në çast mendoi: ç'po bëj kështu? Në të vërtetë nuk ndiente asnjë gjëzim, megjithatë duhej të bënte një falënderim, aq më tepër që kishte ardhur këtu gjithë ankth. Ai hapi gojën për të thënë diçka, po zëri i zyrtarit e ndërpreni. — Që nuk gjëzohesh, kjo tregon që e kupton mirë përgjegjësinë e punës së re. Interpretimi quhet me të drejtë truri i Tabirit dhe rroga atje është më e lartë, — por puna është më e vështirë. Disa herë do të të duhet të rrish me orar të zgjatur dhe, vëç kësaj, dhe kjo është kryesorja, përgjegjësia atje është më e madhe. Megjithatë duhet ta qëmosh favorin që të bëhet prej nesh. S'duhet ta harrosh se rroga për në majat e Tabir Sarajit kalon nëpër Interpretim.

Për herë të parë ai ia nguli sytë Ebu Qerimit, por jo në fytyrë, po diku te mesi i tij, atje ku duhej të ndodhej rezja, në qoftë se Ebu Qerimi do të ishte derë.

Rroga për në majat e Tabirit kalon nëpër Interpretim, përsëriti me vete frazën Ebu Qerimi. Ai po bëhej gati t'i thoshte se ai ndoshta nuk ishte i aftë për këtë punë kaq të vështirë, siç është zërthimi i èndrrave, kur tjetri, sikur t'ia kishte pikasur mendimin, i doli përpara.

— Interpretimi i èndrrave në Tabir Saraj është i vështirë. Madje tepër i vështirë. Ai s'ka të bëjë fare me shpjegimin banal që u bën èndrrave populli: gjarpri diçka e keqe, kurora diçka e mirë e të tjera si këto. As me librat vulgarë èndrrashpjegues, s'ka të bëjë. Interpretimi i Tabirit është më lart, shumë më lart se të gjitha këto.

Në të vepron një tjetër logjikë dhe të tjera simbole dhe ndërlidhje simbolesh.

Aq më tepër atëherë unë jam i paaftë për këtë punë, deshi të thoshte Ebu Qerimi. Duke kujtar se do të kishte të bënte me simbolet tradicionale, ai kishte pasur druajtje, pale pastaj me simbole të reja. Ai u mat më në fund të hapte gojën, po tjetri e ndërpree përsëri:

— Ti do të thuash, si do të mësosh t'i përdorësh çelësat e zërthimit. Mos ki frikë, biri im, do të mësosh, madje shumë shpejt. Kështu si ti, me druajtje dhe pa pasur besim te vetja e kanë filluar punën në fillim ata që më vonë janë bërë krenaria e Interpretimit. Dy javë, e shumta tri, do të t'ë mjaftojnë për t'i mësuar. Pastaj, — ai i bëri shenjë të afrohej, dhe Ebu Qerimi bëri një hap drejt tryezës, — për më shumë s'ke nevojë. Madje është e dëmshme të mësosh më tepër, sepse ka rrëzifik të kthehet në një zërthyes mekanik. Interpretimi është në radhë të parë punë krijuese. S'duhet tepruar me mësimin e shtampave dhe simboleve. Kryesorja është mësimi i ca parimeve si në algjebër. Madje edhe ato jo fort të ngrira, ndryshe s'do të kishte asnjë kuptim kjo punë. Interpretimi i madh fillon atje ku mbaron rutina. Ndërlidhjes së simboleve, asaj kushtoi vëmendjen kryesore. Dhe një këshillë tjetër të fundit: e gjithë puna në Tabir përbën një sekret të madh, por Interpretimi është sekret mbi sekret. Mos e harro këtë. Dhe tani nisu fill e në punën e re. Atje janë lajmëruar për ty. Me hair.

Ebu Qerimi doli duke shtyrë si i shastisur derën, që sytë e zyrtarit kishin nisur ta shikonin. Një copë herë ai eci korridoreve pa e pasur mendjen në vend, gjersa u kujtua se duhej të gjente Interpretimin. Korridoret ishin krejtësisht të boshatisura. Duhej të kishte kaluar pushimi i mëngjesit, në kohën që ai ndodhej te zyrtari i lartë, përndryshe s'kishte si të kuptohej një qetësi kaq e thellë. Ishte tamam qetësia e re pas pushimit. Ebu Qerimi eci shumë kohë, pa shpresë se do të takonte ndokënd për ta pyetur. Mirëpo përparrë s'i dilte askush. Herë i dukej se dëgjonte hapa diku përparrë, apo anash, në kthesë, por, sa arrinte atje, hapat dukej se humbisnin në tje-

tër vend, ndoshta një kat më lart, ndoshta më poshtë. E në qoftë se sillem kështu gjithë paraditen? mendoi me shqetësim. Do të thonë se qysh ditën e parë u paraqit me vonesë në punë. Shqetësimi sa vente rritej. Duhej ta kishte pyetur nëndrejtorin, drejtorin e përgjithshëm apo çfarë ishte ai, si shkohej atje.

Ebu Qerimi vazhdonte të ecte. Galeritë i dukeshin herë të njobura, herë të panjobura. Asnjë derë nuk dëgjohej të hapej asgjékund. Ai hipi një kat më lart, nëpër ca shkallë të gjera, pastaj zbriti prapë dhe pas pak zbriti edhe një kat tjetër. Kudo ishte e njëjta gjë: heshtje dhe boshësi. Ebu Qerimit iu duk se edhe pak dhe do të niste të thërriste. Tani duhej të ndodhej në ndonjë krah tepër të largët të ndërtesës, sepse kolonat mbajtëse të korridorit iu dukën si më të shtypura. Papritur, në çastin që bëhej gati të kthehej andej nga kishte ardhur, në këndin më të largët të korridorit, atje ku fillonte kthesa, iu duk se dalloi një njeri. Ebu Qerimi eci në atë drejtëm. Njeriu rrinte i palëvizur përpara një dere. Përpara se Ebu Qerimi të afrohej aq sa mund t'i fliste, njeriu i bëri shenjë të ndalonte. Ebu Qerimi qëndroi në vend.

— Ç'kérkon? — tha i panjoburi. — Këndej është e ndaluar të kalosh.

— Kérkoj Interpretimin, — u përgjigj Ebu Qerimi. — Kam një orë që vërtitem.

Njeriu e shikoi me dyshim.

— Ti punon në Interpretim dhe nuk e di si shkohet atje?

— Porsa u emërova me punë atje, — tha Ebu Qerimi.  
— Mirépo nuk e di ku ndodhet.

Tjetri vazhdoi ta shikonte me sy hetues.

— Kthehu andej nga ke ardhur, — tha më në fund ai, ec në korridorin kryesor gjer nën baxhën e madhe. Atje ngjitu një kat më lart dhe merr galerinë e djathtë. Interpretimin do ta kesh përballë.

— Falemnderit, — tha Ebu Qerimi dhe u kthye. Me vete përsëriste për të mos i harruar fjalët: korridori kry-

esor gjer nën baxhën e madhe, një kat më lart, galeria e djathë.

Ç'ishte ai njeri që e shpëtoi, mendonte Ebu Qerimi. Nga pamja dukej si rojë, po q'mund të ruante vallë në atë shurdhëri? Ky pallat ishte me të vërtetë plot misterë.

Që larg iu duk se dalloi ndriçimin e humbët, që lëshonte që nga kati i epërm baxha e madhe, në rrrotullamën ku këmbeheshin shkallët. Ebu Qerimi mori frymë i lehtësuar.

Kishte gati tri javë që Ebu Qerimi punonte në Interpretim. Dy javët e para ai qëndroi përbri mjeshtërve të vjetër, duke mësuar njërin pas tjetrit sekretet e zbërthimit të èndrrave, gjersa një ditë shefi e thirri e i tha:

— Tani mjaft mësove, Ebu Qerim. Që sot e tutje ti do të marrësh dosjen tënde.

— Kaq shpejt? — ia bëri Ebu Qerimi. — Po a jam unë në gjendje të punoj në mënyrë të pavarur?

Shefi buzëqeshi.

— Mos u druaj. Të gjithë kështu kanë filluar. Pastaj, mbikëqyrësin e sallës ja ku e ke. Për çdo gjë drejtohu tek ai.

Kishte katër ditë që Ebu Qerimi punonte me dosjen e tij. Koka, si asnë herë tjetër, i qe bërë lëmsh. Puna në Seleksionim, e cila i qe dukur më parë e lodhshme, tani që e kujtonte i ngjante si një lodër: S'e kishte mënduar kurrë se puna e Interpretimit do të ishte kaq tejet e skëterrshme.

I kishin dhënë një dosje që quhej e lehtë: «Jeta civile, zvetënimis», dhe ai nganjëherë mendonte: o zot, me një dosje të tillë dhe po më ikën mendja, po q'do të bëhet kur të më vënë përpëra dosjen me komplotet kundër shtetit?

Dosja ishte plot. Kishte lexuar rrëth gjashtëdhjetë èndrra dhe kishte hequr mënjanë rrëth njëzet, që i ishin dukur në fillim se mund t'i zbërhente njëfarësoj. Mirë-

po, kur u qe kthyer pér herë tē dytë, i qe dukur, pérkundrazi, se ato kishin qenë më tē vështirat. Atéherë nga grupi i tē gjashtëdhjetave kishte zgjedhur ca tē tjerë, tē cilat gjithashtu në fillim i qenë dukur si tē zbërthyeshme, por pas një ore ose dy i qenë mjegulluar mu pérpara syve, i qenë errësuar, zezuar, gjersa qenë kthyer në enigma tē vërteta.

E pamundur, kishte thirrur kushedi sa herë me vete. Unë do tē çmendem këtu. Kishte katér ditë dhe nuk kishte zbërthyer dot plotësish asnjë ëndërr. Sa herë që i dukej se po i sqarohej diçka, aty pér aty e kapte dyshimi, dhe ajo që i qe dukur pak më parë si e kuptimshme, tani i kthehej në tē pakuptimshme. Po kjo është çmenduri, e gjithë kjo punë, përsëriste duke zënë sytë me duar. Ankthi i gabimit tē mundshëm e ndiqte çdo çast. Kishte çaste kur ishte i bindur se në këtë punë mund tē bëheshin veç gabime dhe vetëm rastësish dikush mund tē qëllonte në shenjë.

Nganjëherë e kapte një ethe shqetësimi. S'kishte paraqitur ende asnjë ëndërr tē zbërthyer. Dhe përgjegjësit e tij mund tē mendonin se ai ishte ose tepér i paaftë ose tepér frikacak. Po ç'bënин tē tjerët, që i shikonte se si mbushnin fletë tē tëra me shkrimin e tyre? O zot, si dukeshin aq tē qetë?

E vërteta ishte se çdo zbërthyes kishte tē drejtë që nga dosja e tij tē hiqte mënjanë ato ëndrra që i dukeшин tē pashpjegueshme, tē cilat u jepeshin pastaj pér shpjegim zbërthyesve tē vështirësive, që ishin mjeshtrit e Interpretimit, mirëpo nuk ishte e mundur që tē kaloje në «Interpretim tē vështirë» shumicën e dosjes.

Ebu Qerimi fërkoi témhat si pér tē dëbuar që andej gjakun që dukej se i qe mbledhur e s'donte tē ikte. Simbolet i dyndeshin në kokë me dhjetëra: gjarpri me kolonën, tymi, nusja e çalë, dëbora. Ato lëviznin në një valle tē ethshme në kokën e tij, shtynin që andej përfytyrimet normale tē botës, përpinqeshin t'i zëvëndësonin ato me lëvizjet e tyre tē marra e pakuptim. Të dalë ku tē dëlë, po i jap njëfarë shpjegimi kësaj këtu, tha duke vënë

përpara njëren nga fletët. Hajde, me hair! Ëndrra ishte e një nxënësi të një shkolle fetare të kryeqytetit: Dy njerez kishin gjetur një ylber të vjetër, të rrëzuar. E kishin ngritur me zor në këmbë, i kishin fshirë pluhurin, njëri kishte nisur ta lyente rishtas me bojë, por ylberi s'ngjallej, që s'ngjallej. Pastaj të dy njerëzit e lëshuan dhe ikën me vrap.

Hm, ia bëri Ebu Qerimi, duke shtrënguar penën në dorë. Donte të niste të shkruante por i iku vrulli i guximit. Dhe ashtu bëri. Pa e menduar mirë, ose më mirë, duke e ndryshuar aty pér aty një shpjegim të parë pér ëndrrën, shkroi nën të: Paralajmërim pér... E ngriti në çast penën nga letra. Paralajmërim pér... Paralajmërim pér... O zot, po pér çfarë mund të paralajmërojë kjo kllapi, gati sa s'thirri me zë. Po kjo është kujë, po kjo është luajtje nga mendtë. I shoi fjalët «paralajmërim pér ...», dhe me tèrbim e shtyu fletën te grumbulli i ëndrrave të painter-pretueshme. Jo, më mirë ta dëbonin nga puna një orë e më parë, sesa të përzihej në këtë lajthitje. Mbështeti ballin në duar dhe qëndroi ashtu me sy gjysmë të mbyllur.

— Ebu Qerim, ç'ke? — dëgjoi pas pak zërin e hollë të mbikëqyrësit të sallës. — Të dhemb koka?

— Po, pak.

— Mos u mërzit, ashtu i ndodh në fillim kujtdo. A do ndonjë ndihmë?

Falemnderit. Pas pak do të vij vetë pér t'ju treguar ca shpjegime.

— Ashtu? Shumë mirë. Unë gjithë këto ditë kam pritur.

— S'kam dashur t'ju shqetësoj orë e pa kohë.

— O, as mos e mendo. Është detyra ime të të ndihmoj.

— Pas një ore, — tha Ebu Qerimi, — diçka do t'ju sjell patjetër, megjithëse...

— Çfarë megjithëse?

— Megjithëse s'jam fare i sigurt. Dhe ndoshta shpjegimet e mia janë fare të pasakta, pér të mos thënë budallallëqe.

Mbikëqyrësi buzëqeshi duke u larguar.

— Po pres, — thä.

Tani s'kam nga t'ia mbaj më, tha Ebu Qerimi me vete. Tani, dua s'dua, do të zbérthej dhe unë si gjithë të tjerët. Jepi, i tha vetes, të djalë ku të dalë, dhe kërkoi fletën e èndrrës me një grumbull burrash veshur me të zeza që kapércejnë një hendek, duke ikur pastaj tutje nëpër një fushë me dëborë. Kuptimi i èndrrës befas iu duk i qartë: një grup funksionarësh, pasi kanë kryer punë të dëmshme kundër shtetit, arrijnë të kapércejnë vështirësitë dhe të ecin nëpër fushën me dëborë, që simbolizon rrëzim qeverie.

E shkroi shpejt e shpejt këtë shpjegim, po nuk arriti ta mbyllte frazën e fundit, kur tha me vete: po ky qenka pothuajse komplot kundër shtetit. E lexoi dhe një herë shpjegimin dhe e pa se ashtu dilte vërtet: diçka e përafërt me një komplot. Kurse ai kishte dosjen e jetës civile dhe të zvetënimit. Duart iu thyen nga dëshpërimi dhe e la penën. Edhe një herë që iu duk se diçka po bënte, kishte dështuar. Po prit, i tha vetes. Mbasse s'është fare ashtu. Në fund të fundit zvetënimin një hap e ndante nga veprimi kundër shtetit, përderisa bëhet fjalë përfunksionarë. Veç kësaj, ah, sa i trashë që ishte, që s'e mendoi më parë, pra, veç kësaj, ndarja e dosjeve s'ishte veçse e përafërt dhe s'ishte e thënë aspak që në dosjen përfjetën civile të mos gjendeshin èndrra përfundët e larta të shtetit. Madje kaq herë u kishin thënë se ishte e lavdërueshme puna e atij nëpunësi të Tabirit që kërkon me guxim sijnale të rëndësishme edhe aty ku duket se nuk ka veç shenja të zakonshme. Po, po, i kujtohej fare mirë ky udhëzim. Madje flitej se edhe shumë *bashëndrra* kishin dalë nga dosjet e thjeshta.

Ebu Qerimi ndjeu të gjallërohej. Pa iu ftohur vrulli, mori njëren pas tjetrës katër èndrra që i kishte lexuar disa herë dhe aty përfundë aty po bëhej gati të tërhiqte fletën e èndrrës së pestë, kur diçka e pashpjegueshme e shtyu të kërkonte midis fletëve èndrrën e parë dhe të lexonte shpjegimin poshtë saj. Dyshimi e kapi menjëherë. Mos e kam gabim, mos nuk është kështu, përsëriti me vete.

Pas pak iu duk se ishte i sigurt që zërthimin e kishte bërë gabim. Balli iu mbush me djersë të ftohta dhe me sy krejt të mekur po vështronate ata rreshta që dorë e tij i kishte shkruar me aq gjallëri pak kohë më parë dhe që tanë i dukesin të huaj e armiqësorë. Ç'të bënte? Njëherë tha: në dreq të vejë, kush do t'i japë kaq rëndësi asaj midis dhjetëra mijëra èndrrave që përpunohen këtu, dhe u mat ta linte fletën ashtu siç që, po në çastin e fundit dora u tërhoq prapë. Po sikur dikush të hetonte gabimin? Aq më tepër që èndrra ishte kundër funksionarëve shtetërorë. Vec kësaj, në njëfarë mënyre ajo mund të merrej vesh në rrëthet zyrtare, dhe e keqja ishte se gjithkush mund ta merrte akuzën për veten apo për rrëthin e vet. Do të gërmoin kush ua kishte bërë atë zërthim dhe, kur ta merrnin vesh si që puna, do të thoshin: pa shih, pa shih, na paska hyrë në Tabir Saraj njëfarë Ebu Qerim; një zog pa pupla, i cili qysh në èndrrën e parë që zërtheu deshi të hidhte baltë kundër zyrtarëve të lartë. Kijeni në kujdes këtë gjarpër.

Ebu Qerimi e ngriti fletën me aq rrëmbim nga tryezë, sikur të trembej se dikush do të shikonte ç'kishte shkruar në të. Duhej të bënte diçka për ta ndrequr atë marrëzi sa nuk ishte vonë. Po ç'të bënte? Njëherë i shkoi nëpër mend ideja që ta zhdukte fare èndrrën, por aty për aty iu kujtua se çdo dosje kishte të shkruar në kapak numrin e èndrrave. Edhe kjo i duhej, të shkonte drejt e në burg si një keqbërës. Tjetër, mendoi, tjetër. Duhej bërë tjetër gjë. Ah, sikur të mos ishte ngutur dhe të mos kishte rrëmbyer penën si i çakërdisur, tanë do të mund t'i bënte një shpjegim fare tjetër èndrrës. Mirëpo e kishte kapur një lloj hovi djallëzor që e kishte shtyrë ta nxinte për të zezën e vet atë fletë. Dhe tanë gjithçka ishte djallosur. Po prit, tha me vete duke mos i hequr sytë nga shkrimi i vet, që i dukej iurrejtshëm, pa dale njëherë, ndoshta nuk ka marrë fund gjithçka. E kaloi fluturimthi tekstin me sy dhe prapë mendoi se diçka mund të bëhej ende. Kur e lexoi fletën për herë të

tretë, u habit se si nuk i kishte shkuar ndër mend më parë kjo gjë. Një lehtësi e papritur iu shpërnda nga tëmthat, poshtë nëpër fyt, drejt mushkërive. Në fund të fundit ndreqjet ishin gjëja më e zakonshme mbi një tekst. Ai do ta bënte me një mënyrë të tillë, saqë të mos merrej vesh asgjë. Do të dukej thjesht si një çështje saktësimi i frazës, shumë-shumë çështje stil. Mjaftonte të shtonte një folje tjetër. E lexoi kushtet për të satën herë frazën «një grup funksionarësh, pasi kanë kryer punë të dëmshme kundër shtetit...» dhe më në fund, me dorën që i dridhej, pas fjalës «kanë» shtoi fjalën «penguar» dhe rregulloi mënyrën e foljes «kryer». Fraza doli me kuptim krejt të kundërt: «një grup funksionarësh, pasi kanë penguar të kryhen punë kundër shtetit...» Ebu Qerimi e lexoi një herë, dy herë dhe gjithçka iu duk në rregull. Ndreqja nuk binte shumë në sy. Edhe po të binte, mund të merrej si një harresë gjatë shkrimit, që hartuesi e ka rregulluar pastaj që në leximin e parë. Ebu Qerimi mori frymë i lehtësuar. Ja dhe kjo punë ishte kryer më në fund. (Ebu Qerimi, pasi kreua punë kundër shtetit...) Ai vështroi përreth me tmerr. Po sikur dikush ta kishte pikasur? Marrëzira, tha me vete. Njeriu më i afërt që punonte përbri tij ishte aq larg, saqë as titullin e dosjes s'mund të shquante, pale pastaj shkrimin e tij. Sa mirë që shkrimin e kam të imët, mendoi pas pak dhe prapë mori frymë i lehtësuar. Tani mund të pushonte parkëz pas gjithë asaj tronditjeje. Punë dreqi ishte kjo.

Me bisht të syrit i hodhi një sy sallës. Njerëzit punonin të qetë, të zhytur mbi dosjet e tyre. As kërcitja e penave nuk dëgjohej. Tek-tuk ndonjëri linte tryezën e punës dhe me hapa të lehtë, duke u përpjekur të bënte sa më pak zhurmë, dilte nga dera. Me siguri zbrisnin poshtë në Arkiv, për t'u konsultuar me zërthime ëndrrash të ngjashme, të bëra më parë, disa herë në kohë të vjetra, nga shkoqitës të shquar. Zot i madh, pshërëtiu Ebu Qerimi duke vështruar ato dhjetëra koka të përkulura mbi dosjet.

Në ato dosje ishte gjumi i botës, ai oqean llahtari,

mbi humnerën e tē cilit ata përpinqeshin tē spikatnin ca shenjëza tē humbëta, ca sinjale. Tē mjerët ne, ia bëri me vete.

Mori tē lexonte ca fletë tē tjera, por e ndiente që nuk i punohej. Sytë i lexonin tekstet e ëndrrave, po vëmendjen s'e kishte aty. Ca ushtarë me ferekhe në fytyrë. Mijëra këpucë në një shesh dhe një tel sipër sheshit. Prapë dëborë, po këtë herë e futur në sepete tē mëdha bashkë me pajën e një... burri. Ç'tru i shkurdisur, mendoi Ebu Qerimi dhe befas, me një ndjenjë tē çuditshme, tē përafërt me ndjenjën e mallit, iu kujtua ëndrra e tij e parë në këtë pallat. Tri dhelpra tē bardha sipër xhamisë së nënprefekturës. Ëndërr e bukur, e pastër. Ku ndodhej vallë midis atij deti tē lemerishëm? Eh, ia bëri ai dhe afroi njérën nga fletët. Donte tē zbërt thente së paku edhe nja dy gjer në pushim, po zilja e pushimit ra më parë se ç'e mendonte dhe ai e mbylli dosjen.

Në bodrumet ku pihej kafja dhe salepi ishte po ajo gjalléri e zakonshme. Ishte i vetmi vend ku Ebu Qerimit i takonte tē këmbente ndonjë bisedë me njerëz tē njobur apo tē panjohur. Në Seleksionim kishte qëndruar pak, kështu që tē njoburit e atjeshëm kishin qenë tē rrallë dhe aq më rrallë i qëllonte t'i shihte në bufe. Por edhe kur i shihte, sesi i dukeshin, tē largët, tē një faze tē kapërcyer tē jetës së tij. Më mirë i pëlqente tē hapte bisedë me ndonjë tē panjohur, sesa me ata. Asnjë ditë tē gëzuar s'kishte pasur në Seleksionim dhe ndoshta ky ishte shkaku që i shmangej takimit me nëpunësit e tij. Në Interpretim ditët kishin qenë po aq tē mërzitshme e tē zymta, me përjashtim tē së sotmes, kur ai kishte arritur tē bënte më në fund diçka. Kjo ishte ndoshta arsyefa që, ndryshe nga herët e tjera, kur zakonisht zbriste në bufe me shpirtin vrer, sot ndi hej disi më i lehtë.

— Ku punon ti? — e pyeti me një ton tē shkujdesur njeriu përballë tē cilit gjeti një vend tē lirë në tryezën plot filxhanë e gota salepi tē boshatisura. Tjetri u tendos menjëherë si përpara një eprori.

— Në kopisteri, zotni, — u përgjigj.  
Ebu Qerimi s'kishte gabuar. Dukej menjëherë që ishte një nëpunës i ri, ashtu siç kishte qenë ai vetë para një muaji.

— Ke qenë sëmurë? — pyeti pasi rufisi kafen, i habitur dhe vetë nga siguria e tij, — Dukesh shumë i zbehtë.

— Jo, zotni, — u përgjigj tjetri, duke e lënë në çast gotën e salepit mbi tryezë. — Por... kemi shumë punë dhe...

— E qartë, — tha Ebu Qerimi me po atë ton të shkujdesur, që s'e kuptonte as vetë se nga i vinte. — Ndoshta është periudha kur ka vërshim èndrrash.

— Po, po, — ia bëri tjetri duke tundur me aq energji kokën, saqë Ebu Qerimit iu duk se edhe disa tundje të tillë dhe qafa e tij e hollë nuk do të duronte më, po do të thyhej.

— Po ju? — pyeti tjetri me druajtje.

— Në Interpretim.

Sytë e tjetrit u ndriçuan përbrenda, me atë lloj buzëqeshjeje që do të thotë: sikur ma ndjeu zemra.

— Pije salepin se do të ftohet, — tha Ebu Qerimi, kur e pa se tjetri nuk guxonate ta ngrinte më gotën nga tryeza.

— Është hera e parë që më qëllon të rri me një zotni nga të Interpretimit, — tha tjetri i trondititur. — Jam kaq i gëzuar!

Dy-tri herë ai e kapi gotën e salepit dhe prapë e la më vend, pa guxuar ta afronte te buzët.

— Ke shumë kohë që punon në Pallat?

— Dy muaj, zotni.

Për dy muaj ke arritur të bëhesh kockë e lëkurë, mendoi Ebu Qerimi. Si do të bëhej vallë ai vetë pas ca kohë?

— Kemi pasur shumë, shumë punë kohët e fundit, — tha tjetri, duke rrufitur më në fund salepin. — Çdo ditë kemi punuar me orar të zgjatur.

— Dukesh menjëherë, — tha Ebu Qerimi.

Tjetri buzëqeshi sikur të thoshte: a jam fajtor përkëtë?

— Pranë nesh kanë qëlluar dhomat e veçimit, — vazhdoi ai, — dhe, kur ka nevojë për kopistë, gjatë pyetjeve, na thërresin ne.

— Dhomat e veçimit? — pyeti Ebu Qerimi. — Ç'janë këto?

— Vallë nuk i dini? — ia bëri tjetri, dhe Ebu Qerimi u pendua në çast për pyetjen e tij.

— Nuk kam pasur ndonjëherë të bëj me to, — murmuriti ai, — megjithëse diçka kam dëgjuar.

— Janë pothuajse ngjitur me ne, — tha kopisti.

— Mos janë në atë krah të Pallatit ku ka rojë? — pyeti Ebu Qerimi.

— Pikërisht, — tha me gëzim tjetri. — Roja qëndron pikërisht përparrë dyerve të tyre. Pra ju paskeni qenë atje?

— Kam kaluar për një punë tjetër, — tha Ebu Qerimi:

— Dy hapa më tej janë zyrat tonë, ndaj edhe hetuesit kur kanë nevojë për kopistë, vijnë te ne. Oh, kjo është me të vërtetë një punë ferri. Kohët e fundit atje është një njeri që ka dyzet ditë që ndodhet në pyetje të paprerë.

— Ç'ka bërë? — pyeti Ebu Qerimi me një ton, që, për ta bërë sa më të shkujdeshëm, e shoqëroi me një gogësimë.

— Si ç'ka bërë? Ajo dihet ç'ka bërë, — tha tjetri, duke e vështruar me ngulm Ebu Qerimin. — Ai është një èndërrparës.

— Një èndërrparës, e pastaj?

— Në ato dhoma myllen vetëm èndërrparësit që, siç mund ta dini, Tabir Saraji e quan të nevojshme t'i thërresë për të dhënë shpjegime plotësuese rrëth èndrrës që kanë dërguar këtu.

— Aha, diçka kam dëgjuar, — tha Ebu Qerimi dhe deshi të gogësinte prapë, po ndërkaq në sytë e tjetrit pa ftohjen e parë të zjarrmisë.

— Ndoshta unë s'duhej të flitja për një gjë që ësh-

të sekret, ashtu si gjithçka tjetër këtu, por, ngaqë ju, siç thatë vetë, punoni në Interpretim, mendova se i dinë këto gjëra.

Ebu Qerimi qeshi.

— U pendove që fole? — tha ai. — Unë punoj vërtet në Interpretim, dhe unë di sekrete shumë më të rëndësishme se këto që më the ti.

— Natyrisht, natyrisht, — tha tjetri, që po i vinte fytyra në vend.

— Veç kësaj, — tha Ebu Qerimi, duke ulur zërin, — unë jam nga familja e Qyprillinxve, prandaj mos ki frikë se...

— O perëndi, — ia bëri kopisti, — sikur ma ndolli zemra... O zot i madh, c'fat për mua që denjuat të këmbeni dy fjalë.

— E si shkon puna e atij ëndërrparësit atje në dhomën e veçimit? — e ndërpren Ebu Qerimi. — Ecën? Ti je kopist aty, apo jo?

— Po, zotni, gjithë këto ditë kam punuar aty. Edhe këtu drejt e që andej erdha. Si shkon puna e tij? Po si të them? Gjer tani janë mbushur qindra faqe procesverbale. Kuptohet se e ka humbur fare, po nuk ka faj. Është një njeri i kurrfartë, nga një nënprefekturë e humbur e skajit lindor. As që ia ka marrë mendja se do të përfundonte në Tabir kur ka dërguar atë ëndrrën e tij.

— E c'paska aq të rëndësishme ajo ëndërr? — pyeti Ebu Qerimi.

Tjetri ngriti supet.

— As unë nuk e di. Në vështrimin e parë duket si e thjeshtë, po do të ketë diçka, gjersa i japid kaq rëndësi. Interpretimi thonë se e ka kthyer për sqarim. Dhe ja, ka kaq kohë dhe asgjë s'po sqarohet, madje po bëhet lëmsh më keq.

— Unë nuk e kuptoj, çfarë i kërkohet atij ëndërrparësit?

— Është vështirë ta them, zotni. As unë s'e kam shumë të qartë. I kërkohen ca saktësime të vogla, të çuditshme. Kuptohet që ai s'është në gjendje t'i japë. Ka

kaluar kaq kohë që e ka parë atë ëndërr. Veç kësaj, pas kaq ditësh i mbyllur këtu, është trulloSUR fare. Kuptohet që nga ajo ëndërr s'ka mbetur asgjë në kujtesën e tij.

— Vijnë shpesh të tillë? — pyeti Ebu Qerimi.

— S'e besoj. Dy-tre në vit, jo më tepër. Ndryshe njerëzit do të trembeshin dhe kjo do të pengonte dërgimin e ëndrrave.

— Natyrisht, E ç'do të bëhet tani me të?

— Do të vazhdojë të pyetet, gjersa, gjersa... — kopisti hapi krahët, — as unë s'e di gjer kur.

— Hm. E çuditshme, — ia bëri Ebu Qerimi. — Pra s'qenka lehtë të dërgosh ëndrra në Tabir Saraj. Një ditë mund të të vijë letërthirrje për t'u paraqitur.

Tjetri ndoshta do të thoshte diçka, po në atë kohë ruzilja e mbarimit të pushimit, dhe ata, pasi u përshëndetën, u ndanë.

Ndërsa ngjitte shkallët, Ebu Qerimit nuk i hiqeshin nga mendja ato që i tha kopisti. Ç'ishin vallë ato dhoma veçimi? Në vështrimin e parë dukej si diçka e marrë, krejt pa kuptim, po nuk duhej të ishte ashtu. Ky ishte pa dyshim një lloj burgimi. Po pse? Kuptohet që nga ajo ëndërr s'ka mbetur asgjë në kujtesën e tij, kishte thënë kopisti. Kjo duhej të ishte ndoshta arsyaja e vërtetë e burgimit të ëndrrparësit: që të harronte ëndrrën e tij. Marrje në pyetje sfilitëse ditë e natë, mbushje procesverbaleSH të pafundme, kërkime gjoja saktësimëSH për diçka që s'mund të jetë kurrë e saktë, siç është ëndrra, gjersa kjo e fundit të shpërbëhej e të humbte përfundimisht në kujtesën e ëndrrparësit. Me një fjalë një larje trush, mendoi Ebu Qerimi. Ose një çëndërr, në qoftë se mund të përdorej një fjalë e tillë, ashtu si përdoret fjala *zhvendosje si* e kundërt e *ven-dosjes* ose *çmëndje si* e kundërtë e *mendjes*. Sa më shumë që e mendonte, aq më tepër i dukej se ky ishte i vetmi shpjegim. Ishin, me sa duket, shkëndijime idesh të rrezikshme, që shtëtit, për një arsyje ose një tjetër, i duhej t'i veçonte, ashtu siç, veçohej mikrobi i murtajës, gjer në asgjësimin e tij.

Ebu Qerimi kishte ngjitur shkallët dhe po e cte në korridorin e gjatë përbri dhjetëra nëpunësve të tjerë, një pjesë të të cilëve e thithnin pa pushim dyert e hapura nga të dyja anët. Sa më shumë që u afrohej salave të Interpretimit, ai e ndiente se siguria e përkohshme që kishte provuar në bufe, ashtu si çdo siguri e lindur nga përulja e një tjetri, sa vente po e braktiste. Në vend të saj nisi të ndihej prapë shtrëngimi i ankthit, i ngadalshëm, i ritmuar, ndërsa ai po kthehej prapë në nëpunësin e kurrfartë, të humbur midis mekanizmit gjigant.

Që larg pa tryezën e tij të punës me dosjen sipër dhe ai eci që të zinte vend përbri saj si përbri bregut të gjumit të botës, prej territ të të cilit vinin stërkala të zeza e kërcënuesë, të dala prej kushedi q'thellësish. O zot, psherëtiu ai, mbromë, o zot i madh!

Koha ishte ftohur edhe më. Megjithëse sobat prej qeramike i ndiznin qysh herët në mëngjes me qymyrqur, sallat e Interpretimit të futmin drithmën. Nganjëherë qëllonte që Ebu Qerimi nuk e hiqte fare qyrkun. Nuk e kuptonte nga vinte gjithë ajo ftohtësi. S'e merr me mend? i kishte thënë një tip, me të cilin i kishte qëlluar të pinte kafe në bufe. Nga dosjet vjen kjo ciknë e ky acar. Gjithë të këqijat andej do të na vijnë, djalosh. Ebu Qerimi kishte bërë sikur s'kishte dëgjuar. E q'pret tjetër të vijë nga viset e gjumit? kishte vazhduar tjetri. Ato janë pothuajse njëlloj me viset e vdekjes. Mjerë në të mjerët, që punojmë me ato dosje! Ebu Qerimi kishte ikur pa thënë asgjë. Ndoshta ishte ndonjë provokator, kishte menduar më vonë. Përherë e më tppér po i mbushej mendja se Tabir Saraji ishte mbushur me gjithfarë tipash e të fshehtash.

C'nuk kishte dëgjuar ai gjatë kësaj kohe për Tabirin dhe atë që bëhej atje. Në pamjen e parë dukej sikur nëpunësit nuk flitnin për të, po kalonin ditët dhe nga një frazë e pëshpëritur te bufeja, nga një tjetër e dëgjuar rastësisht në korridor, te portat e daljes, apo te

tryeza e fqinjitet, dalngadalë dhe pa kuptuar sajoheshin mozaikë të plotë që nuk fshiheshin kollaj prej kujtesës. Kështu, për shembull, kishte zëra që thoshin se të parët e ëndrrave veç e veç prej njerëzve, nuk ishte veçse një fazë kalimtare e njerëzimit, dhe se do të vinte një kohë kur ëndrrat do ta humbnin këtë cilësi dhe, ashtu si gjestet apo veprimet e tjera të njeriut, do të bëheshin të dukshme edhe ato prej të tjerëve. Me një fjalë, ashtu si një bimë apo frut që për njëfarë periu-dhe rri nën tokë, gjersa i vjen koha për të dalë mbi siperfaqe, edhe ëndrra e njeriut tanë për tanë ishte brenda gjumit, po kjo s'do të thoshte se do të ishte gjithmonë kështu. Një ditë ajo do të dilte në dritën e dieillit, do të zinte vendin e saj midis mendimit, përvjoes dhe veprimit njerëzor dhe, do të ishte mirë apo keq një gjë e tillë, do të ndryshonte për të mirë apo për të keq bota prej saj, këtë një zot e dinte.

Të tjerë thoshin se Apokalipsi s'ishte gjë tjetër vecse dita kur ëndrrat do të dilnin prej burgut të gjumit, sepse ringjallja e të vdekurve, që prej njerëzve përfytyrohej në mënyrë banale dhe metafizike, nuk do të kryhej vecse në këtë formë. A nuk ishin ëndrrat mesazhet e tyre? thoshin ata. Kjo kërkësë e tyre shekullore, kjo lutje, gërgamë, protestë, quaje si të duash, do të merret një ditë parasysh.

Kishte të tjerë që, duke e pranuar këtë gjë, e shpjegonin në mënyrë krejt të kundërt. Dalja e ëndrrave jashtë, thoshin ata, në klimën e egër të botës, nuk do të jetë vecse tharja, vdekja e tyre. Kjo do të ishte ndarja e vërtetë me ankthet e të vdekurve, pra me të kaluarën, ndarje e cila prej disave quhej si fatkeqësi e prej të tjerëve si çlirim dhe si rinim i vërtetë i botës.

Të gjitha këto përsiatje e lodhnin mendjen e Ebu Qerimit. Më të padurueshme, megjithatë, ishin ato ditë të gjata e pa ngjyrë kur nuk flitej asgjë e nuk ndodhët asgjë, dhe ai ishte i detyruar të punonte i përkulur mbi dosjen, duke kaluar nga gjumi i dikujt në gjumin e tjetrit, si nëpër një mjegull, që herë-herë du-

kej sikur davaritej, por që në përgjithësi ishte e zymtë dhe gjithë trishtim.

Ishte e premte. Te bashëndrrorët ajo ditë duhej të kishte një gjallëri të veçantë. Ishte zgjedhur, me siguri, kryelëndrra dhe po përgatiteshin pér ta nisur pér në pallatin e sovranit.

Jashtë prej kohësh priste karroca me emblemën mbretërore dhe me rojat. Do të nisej bashëndrra, por edhe pas ikjes së saj në seksion do të kishte prapë gjallëri, gjendje të ndërë apo së paku kureshtje se si do të pritej ajo në pallat. Zakonisht jehona vinte të nesërmen: padishahu ishte i kënaqur prej saj, ose padishahu s'tha asgjë, dhe nganjëherë: padishahu mbeti i pakënaqur prej bashëndrrës. Por kjo ndodhë rrallë, shumë rrallë.

Ditët atje ishin, sidoqoftë, më të gjalla dhe rridhnin ndryshe. Java kalonte shpejt kur pritej e premtja. Kurse në seksionet e tjera gjithçka ishte e mërzitshmë, monotone dhe gri.

Kurse të gjithë ëndërrojnë të punojnë në Interpretim, mendoi Ebu Qerimi. Sikur ta dinin si zvarriseshin orët këtu! Dhe sikur të mos mjaftonte kjo, ai ankth i paprerë që rrinte pezull kudo (që kurse ishin ndezur sobat, Ebu Qerimit i dukej se ankthi kishte erën e qy-myrgurit).

Ebu Qerimi u përkul mbi dosje dhe vazhdoi leximin. Ia kishte marrë dorën njëfarësoj punës dhe tanizbërthimet i bënte mëne lehtësi. Edhe pak ditë dosja e tij e parë do të mbaronte. Në të kishin mbetur vetëm pak fletë. Lexoi ca ëndrra të mërzitshmë me ujë të pistë, të zi, me një këndes të sëmurë që kishte ngecur në llucë dhe një reumatizëm, që ndodhej jashtë trupit të dikujt në një darkë kaurësh. C'zgjyrë, tha me vete dhe e la penën. Dukej sikur llumi kishte mbetur pér në fund. Mendja i shkoi prapë te sallat e bashëndrrorëve, ashtu siç kujtohet, në një mjedis njerëzish të mërzitur shtëpia ku po bëhen përgatitjet e një dasme. Ato salla as që i kishte parë kurrë, madje nuk i dinte në ç'krah të pallatit binin, megjithatë ishte i si-

gurt se, ndryshe nga të tjerat, ato duhej të kishin dritare të mëdha gjer në tavan, prej nga hynte një ndriçim hijerëndë, që i bënte më fisnikë njerëzit dhe sendet.

Eh, ia bëri me vete Ebu Qerimi dhe ngriti prapë penën. U përpoq të punonte pa ndërprerje, gjersa rasilja e mbarimit të orarit zyrtar. I kishin mbetur edhe dy fletë që dosja të mbaronte. S'do të ishte keq t'i mbyllte edhe ato pér ta dorëzuar dosjen.

Nga të gjitha anët ndihej zhurma e njerëzve që po linin tryezat dhe ecnin drejt daljes. Pas pak, kur qetësia ra prapë, në sallë mbetën vetëm ata që kishin vendosur të punonin jashtë orarit. Ebu Qerimi e ndjeu se si boshësia që nëpunësit shkaktuan me ikjen e tyre po i futej brenda tij. Sa herë që kishte qëndruar jash-të orarit, Ebu Qerimi e kishte ndier këtë zbrasje, megjithatë s'kishte ç'të bënte. Ishte i këshillueshëm përtë gjithë qëndrimi herë pas here vullnetarisht jashtë orarit, përvèç rasteve të qëndrimit të detyruar. Do të bënte si të bënte edhe sonte. Duke mbytur fundin e një frymë-marrjeje tepër të gjatë, që në të vërtetë s'ishte veçse një psherëtimë, Ebu Qerimi nisi të lexonte njëren nga fletët. Hm, ia bëri ai pas rreshtit të parë, me habi. Ku e kishte parë një herë këtë èndërr? Një djerrinë me hedhurina pranë një ure dhe një vegël muzikore... Ebu Qerimi gati sa nuk lëshoi një thirrje çudile. Ishte hera e parë që takonte një èndërr që e kishte kaluar nëpër duar në Seleksionim. Ai u gëzua sikur të takonte një të njohur, ktheu kokën anash pér t'ia thënë ndokujt këtë rastisje, po njerëzit ishin tanë tepër të rrallë në sallë dhe më i afërti nuk ishte veçse dhjetë hapa larg.

Ebu Qerimi, ende i gjallëruar nga ngjarja e vogël, nisi ta lexonte tekstin e èndrrës, në fillim pa u përqendruar dot mirë, pastaj përherë e më me kujdes. Asnjë kuptim nuk nxirrte dot prej saj, megjithatë nuk u shqetësua. Shumë èndrra, në vështimin e parë, dukeshin kështu, pa kuptim, si ai muri i lëmuar ku s'kishe ku kapeshe, por mjaftonte një zbërthim i vogël i parë dhe èndrra papritur jepej. Ja edhe kësaj do t'ia

gjente kleçkën. Tani Ebu Qerimi kishte fituar njëfarë përvoje në këtë gjë. Djerrina me hedhurina, ura e moçme, vegla muzikore e panjohur dhe demi i egërre nuk bëhej kurrsesi. Kurse në një ëndërr raporti midis simboleve ishte zakonisht më i rënnga dy: urën me demin, veglën muzikore me djerri-nën, pastaj urën me veglën muzikore, djerrinët me demin, prapë demin me veglën muzikore. Dukej sikur dimuzikore dhe urë, mirëpo ai ishte i palogjikshëm: një një muzikë (dinakéri, fshehtësi, propagandë e vazhduteshme) do të prishë urën e vjetër. Sikur në vend të urës tjetër i shtetit, ëndrra mund të merrte kuptim, por ura s'përfaqësonte asgjë të tillë. Ajo zakonisht ishte simbol i bamirësisë që u bëhej njerëzve në përgjithësi, ashtu siç ishin çezmat, rrugët. Veç kësaj (Ebu Qerimi e lexoi edhe një herë tekstin), demi nuk i sulej aspak kësaj ure. Ai vërtitej nëpër djerrinë dhe kaq.

Ëndërr e marrë, tha me vete Ebu Qerimi. Gëzizimit që atë ëndërr e gjeti në dosjen e tij, ia zuri vendin një ndjenjë përqëmimi. Tani po i kujtohej se edhe atëherë, kur e kishte lexuar në Seleksionim, i qe dukur e pakuptimtë. Kur s'e kishte flakur në kosh qysh atëherë! Ebu Qerimi ngjeu penën me bojë dhe u mat të shkruante fjalën «*pazbérthyeshme*» sipas fletës, po dora i mbeti një çast pezull. Ta linte ta shikonte edhe një herë të nesërmen? Të këshillohej me mbikëqyrësin? Në të vërtetë, megjithëse këshillimi pranohej, ai nuk shihej me sy të mirë kur teprohej. Ebu Qerimi po bëhej nervoz. Ishte mirë që ta mbyllte atë dosje atë ditë, edhe kështu shumë e kishte mbajtur...

Ai mori ëndrrën tjetër të fundit, e zbërtheu shpejt e shpejt, pastaj iu kthye prapë ëndrrës së prapambetur. Ishte në mëdyshje, të shkruante apo jo sipër saj fjalën «*pazbérthyeshme*» dhe të dorëzonte dosjen e të ikte, kur

në sallë hyri shefi i Interpretimit. Një copë herë ai bisedoi kokë për kokë me mbikëqyrësin, pastaj hodhi sytë përreth sikur të numëronte ata që kishin mbetur, dhe prapë diçka i tha mbikëqyrësit.

— Ti, dhe ti, — u dëgjua zëri i mbikëqyrësit kur shefi u largua. Ebu Qerimi ktheu kokën, — dhe ju të dy atje. Dhe ti, Ebu Qerim, ju do të punoni sonte jashtë orarit. Shefi porsa më njoftoi për një dosje të ngutshme, zbërtimi i së cilës duhet të mbarojë sonte.

Askush nuk foli asnjë fjalë.

— Sa të sjellin dosjen, shkoni të merrni diçka në bufe, — vazhdoi mbikëqyrësi. — Ndoshata do të na duhet të qëndrojmë gjatë.

Njëri pas tjetrit, ata dolën nga salla. Nëpër korridore dëgjoheshin aty-këtu zhurmat e çelësave dhe të rezeve të dyerive. Po iknin të vonuarit e fundit.

Bufeja dukej e ngrysur në atë orë të vonë të mbasdites. Banakierët e pakët me fytyra të vrara, një pjesë e tryezave të hequra mënjanë për të bërë pastrim, të gjitha këto ta bënин shpirtin vrer. Ebu Qerimi porositi një gotë salep e një simite të vogël dhe shkoi e zuri vend në qoshen më të largët. S'donte ta bezdiste njeri. E piu ngadalë salëpin, duke kafshuar me zor simiten, pastaj, më hapa të ngadaltë, pa kthyer kokën as djathas as majtas, doli.

Një copë herë eci si i trallisur nëpër galerinë e pafund të katit të parë. S'qe ngrysur ende, po gjithçka po hirmosej. Nga baxha e madhe në kthesë rrëzohej ndriçimi i fundit i ditës. S'kishte pse të ngutej dhë mund të ecte gjer atje, për të mos u mbyllur para kohe në sallën e neveritshmë të punës. Tek-tuk dëgjohej kërcitja e ndonjë dere të fundit që mbyllej. Galeria ishte krejtësisht e shkretë dhe ai befas ndjeu njëfarë kënaqësie që mund të ecte i vetëm në atë zbrasje kolosalë, në fund të së cilës baxha e madhe lëshonte ndriçimin, i cili, edhe pa pluhurin e xhamave të saj, ishte i hirtë.

Ebu Qerimi kishte arritur gjer nën baxhë dhe, pasi ngriti kokën nën të si nën një humnerë, po bëhej gati të kthehej, kur iu duk se ndjeu një zhurmë në atë shurdhëri.

Ndaloi në vend dhe mbajti vesh. Dukej si zhurmë haphash që sa vente afrohej. Ndoshata janë mbikëqyrësit e portave, tha ai dhe u mat të ikte, por diçka e mbajti në vend. Tani zhurma ishte më afër, nëpër një korridor anësor, që kryqëzohej me galerinë kryesore. Ebu Qerimi u platin pas murit dhe priti se ç'do të ndodhë. O perëndi, ia bëri me vete kur në kryqëzim u duk një grumbull njerzish që mbanin mbi supe një arkivol të zi. Ata as që e vunë re dhe u zhdukën sakaq në vazhdimin e korridorit anësor. Ëndërrparësi nga provinca, tha me vete Ebu Qerimi, ndërsa hapat po humbin në largësi. Ai vështroi përreth. Ndodhej tamam pranë vendit ku atë fitë kishte parë rojën përpara dhomave të veçimit. O zot, kishte qenë, me siguri, ai.

Një brengë gjerryese, që sa vente rritej, e pushtoi të tèrin ndërsa po ngjitte shkallët. I kishte shkuar mendja disa herë tek ëndërrparësi fatkeq, por s'e kishte menduar asnijëherë se fati i tij mund të shkonte gjer këtu. Madje disa herë në bufe kishte kërkuar me sy mos e takonte prapë atë kopistin, për ta pyetur si u bë puna e atij ëndërrparësit, e kishin liruar më në fund apo e mbanin ende atje. Mirëpo ai, siç dukej, s'kishte mundur ta harronte dot plotësisht ëndrrën e vet. Ose ndoshata ishte e parashikuar që më parë që të gjithë të ftuarit e Tabir Sarajit të përfundonin kështu. Përbindësh, tha ai me vete, duke u habitur dhe vetë me mllefin e papritur. S'të mjaftojnë të tjerat, po na hëngërke dhe njerëz.

Mbi tryezë pa një dosje të re, që mbikëqyrësi e kishte vënë, me sa dukej, gjatë mungesës së tij. E shflettoi gati me urrejtje dhe pa se nuk kishte më shumë se pesë-gjashtë fletë. Ato duhej të përpunoheshin të gjitha atë mbrëmje. Në sallë qenë ndezur fenerët. Të ftohtët qe shtuar edhe më, ngaqë askush s'kishte hedhur qymyr në soba qysh nga paraditja. Ebu Qerimi mori ëndrrën e parë dhe, pa lexuar fillimin, pa se teksti i saj arrinte gjer në fund të fletës, madje, gjë tepër e rrallë, vijonte edhe në fletën tjetër. Ai e ktheu fletën për të parë se sa e gjatë paskësh qenë përbajt-

ja e kësaj èndrrre, kur pa se ajo s'mbaronte as në fletën e dytë, madje as në të tretën, gjersa, pér çudinë e tij më të madhe, pa se në të gjashtë fletët e dosjes nuk ishte veçse pérshkrimi i një èndrrre. S'i kishte rënë rasti kurrë të takonte një tekst kaq të gjatë. Duhet të jetë një èndërr e çuditëshme, mendoi dhe nisi t'i hidhëte një sy tekstit, pa vështruar fare shënimet pér emrin e èndërrparësit dhe adresën e tij. Do të kishte punë sonte me atë delir të gjatë, me siguri të padeshifrueshëm të kushedi ç'nate ankthi.

Èndrra ishte vërtet ashtu, delirante. Zakonisht deliret i jepeshin interpretuesve të shquar. Madje thuhej se kohë më parë si në Seleksionim ashtu dhe në Interpretim ato sistemoheshin në një dosje të veçantë, që ashtu edhe quhej, «Dosja e delireve». Mirëpo më vonë, pér arsyen jo fort të qarta (flitej se prirja që kjo dosje të quhej si dosja më e zgjedhur, ishte shkaku i vërtetë), ajo u prish, dhe qysh atëherë deliret shpërndaheshin, sipas pérmbajtjes, midis grupeve të èndrrave të tjera. Megjithatë, në ndarjen e punës, mbikëqyrësit e sallave kishin kujdes që ato të jepeshin gjithmonë pér zërthim te shkoqitësit më me përvojë. Ebu Qerimi nuk dinte si ta merrte dhënen e delirit atij: si një besim të tepruar të drejtuesve të Interpretimit pér aftësitë e tij, apo si një veprim dashakeq. Ai, ndërkaq, pérherë e më me ngut po lexonte tekstin. Èndrra dukej vërtet e jashtëzakonshme. Fillonte me ca pupacë që ecnin nëpër një stepë të plehëruar nga kufoma tigrash të sëmurë, vdekur në shekullin njëmbëdhjetë. Krejt faqen e parë të tekstit e zinte pérshkrimi i ecjes së pupacëve, të cilët, me sa dukej, çonin një shpifje kundër vullkanit Krtoh... rtoh... krt... (emri i tij i rrënohej vazhdimesht te shkarrëzima në pjesën perëndimore të tij), ndërsa sipër stepës ndriste një yll i çmendur. Pastaj deliranti, që ndodhej diku pranë, në përpjekjen pér t'u futur nën tokë, që ndeshur atje me një cep të një dite të ndritshme, krejt si brilant, të fshehur nga kushedi kush nën baltë, një ditë nga koha universale, e patretshme, e pathërrmueshme, e pakon-

sumueshme nga askush. Nga ndriçimi i cepit të ditës që u duk midis baltës, atij iu lëbyrën sytë dhe ashtu me sy të lëbyrur qe gjendur në ferr.

I çmendur, tha me vete Ebu Qerimi, krejt i lajthitur. Megjithatë vazhdoi leximin. Pjesën tjetër të tekstit e zinte përshkrimi i ferrit, një ferr tjetërloj, jo me njerëz, por me shtete të vdekura. Trupat e tyre shtriheshin të ngathët pranë njëri-tjetrit: perandorira, emiriate, republika, mbretëri konstitucionale, konfederata. Hm, ia bëri Ebu Qerimi, pa dale, pa dale. Ëndrra, veç të tjerash, ndryshe nga ç'iu duk në fillim, ishte e rrezikshme. Ai ktheu fletën për të parë emrin e dërguesit të guximshëm.» Ëndërr e parë në gjysmën e dytë të natës së 19 dhjetorit prej bujtësit X në Hanin e dy Robertëve (Pashallëku i Shqipërisë Qendrore).» Ah, paska shpëtar pëllumbi, mendoi ai jo pa një ndjenjë lehtësimi. Në mendje iu skicua vetëtimthi tabuti i veshur me stof të errët, që udhetonte tanë me siguri drejt varrezës së madhe të kryeqytetit. E paska ndier gracëkin dhe në çastin e fundit ka bërë fiuu, tha me vete. Zuri vend më mirë në karrige dhe vazhdoi leximin. Shtetet e vdekura dikur, të zbritura në skëterrë, nuk pësonin ndonjë dënim nga ata që zakonisht mendohej se hiqnin njerëzit. Veç kësaj ky ferr kishte një cilësi të veçantë, prej tij mund të dilje përsëri e të ktheheshe mbi tokë. Kështu, një ditë prej ditësh shtete të vdekura prej kohësh, që të gjithë i quanin kufoma, mund të ngriheshin dalngadalë e të shfaqeshin prapë mbi sipërfaqen e globit. Veçse për këtë, ashtu si aktorit që i bëhej grimi përpëra daljes në skenë me rolin e ri, edhe atyre u bëhen në rregullimet e nevojshme, u ndërrohej emri, shenjat e flamuret, kurse në thelb qenë po ata, të moçmit. Pa shih, pa shih, ia bëri Ebu Qerimi. I mësuar qysh nga fëmijnia me bisedat për shtetin dhe punët e tij, ai e kapi menjëherë se ku rihte ëndërr-parësi. Kuptohej menjëherë që ëndrra, me përjashtim të fillimit, ishte e shpikur. Çudi si e kishte kaluar Seleksionimi. Apo ndoshta, si një ëndërr provokuese, e kishin lëshuar me qëllim. Po me ç'qëllim vallë? Dhe

pse t'ia jepnin pikërisht atij? Aq më tepér kështu me ngut, jashtë orarit. Ebu Qerimi ndjeu një drithmë në shpinë. Sytë e tij vazhdonin ndérkaq të lexonin tekstin. Pashë shtetin e Timurlengut, që po e lyenin me bojë pér t'i mbuluar njollat e gjakut, ngaqë po bëhej gati të ngrihej përsëri lart. Pashë më tutje shtetin e Herodit, që po i bënин të njëjtën gjë dhe që, siç më thanë, ishte e treta herë që po dilte mbi dhé, që kushedi sa herë do të ngrihej prapë, pasi të dukej sikur do të rrëzohej.

Ebu Qerimi, me gishtat që i dridheshin, mbylli fletët. Provokimi ishte fare i qartë. Por ai nuk do të binte në atë kurth. Ai do të dinte t'u hidhte. Do të merrte penën e do të shkruante në fletën shoqéruese: Ëndërr e shpikur provokative kundër shtetit me këtë e atë qëllim, me këtë e atë nënëtekst. Pikërisht kështu do të shkruante. Shtetet e sotme, duke përfshirë këtu edhe Perandorinë Osmane, s'ishin gjë tjeter, sipas dellërguesit, veçse struktura të vjetra gjakatare, të varrosura nga koha e të ringjallura pastaj si fantazma.

Ebu Qerimit i pëlqeu ky formulim, madje ngriti penën pér ta shkruar aty pér aty, po në çast e kapi dyshimi. Po sikur t'i thoshin: nga i kap kaq mirë këto gjëra ti, Ebu Qerim? Ai e la penën në vend. S'duhej ta zbulonte kurrsesi veten gjer në këtë shkallë. Më mirë ta hartonte më thjesht shpjegimin e delirit. Ëndërr e shpikur, që mban erë provokimi, e quar me qëllim jo të mirë, gjë që provohet edhe nga dërgimi i saj pa emrin e parësit dhe pa adresën e tij.

Kështu do të shkruante, menjthatë s'kishte pse të ngutej. Nga të gjithë ata që kishin mbetur jashtë orarit, s'kishte ikur asnjë. Ebu Qerimi vështroi përreth. Drita e zbehtë e fenerëve e bënte edhe më të pikëlluar pamjen e sallës me nëpunësit e rrallë të shpërndarë aty-këtu. Të ftohtët sa vente shtohej. Të mos e kishte hequr më mirë qyrkun. Dhe sa duhej të qëndronin vallë atje? Vuri re se vetëm dy prej nëpunësve shkruanin. Të tjerët, ashtu si ai, kishin mbështetur kokën mbi duar dhe po mendoheshin. U kishin shpërndarë vallë ëndrra të zakonshme apo delire, si atij? Kishte mundësi që vetëm e

tija të ishte ashtu. Deliret qëllonin rrallë, si peshka qenët e rastësishëm në rrjetën plot peshq të zakonshëm. Megjithëse kishte mundësi që edhe të tjerët të ishin ashtu. Ajo ardhje e tyre me ngut, në atë orë të vonë të mbarimit të orarit... Dicëka duhej të kishte këtu Ebu Qerimi prapë u rrëqeth.

Njëri nga dy nëpunësit që po shkruanin, u ngrit më në fund, iu afrua mbikëqyrësit dhe, pasi i dorëzoi dasjen, iku. Ebu Qerimi kapi penën, po mendoi se kishte kohë dhe e la përsëri. Shkrimi i shpjegimit nuk do t'i kërkonte më shumë se një çerek ore kohë. Më mirë të frinte edhe pak. Gjithfarë mendimesh të zymta i lëvrinin në kokë.

Pas gjysmë ore u largua një tjetër nëpunës. Ebu Qerimi i ndiente këmbët akull dhe mendimi se edhe duart sa vente i ftoheshin dhe, po të rrinte edhe pak ashtu, kishte rrezik të mos përdorte dot penën, e bëri të dilte më në fund nga mpirja dhe të fillonte të shkruante. Gjatë kohës që shkruante, dëgjoi se dikush tjetër u largua, po nuk e ngriti kokën të shikonte se kush. Kur mbaroi së shkruari, pa se në sallë, përvet mbikëqyrësit, kishin mbetur edhe tre nëpunës të tjera. Do të pres të ikë edhe njëri pastaj do të ngrihem, tha më vete. Mendja, kushedi pse, i shkoi tek ajo bujtina me emrin e çuditshëm «Hani i dy Robertëve», në të cilin qe ngjizur apo qe shpikur ai delir. U përpoq të përfytyronte bujtësin me fytyrë të verdhë, që, në mëngjes herët, pasi e kishte hedhur zarfin e myllur në kutinë e postës të mbërrthyer ndoshta te dera e vjetër e hanit, qe larguar me një nënqeshje djallëzore në fytyrë.

Kërcitja e një karrigeje e shkëputi një çast Ebu Qerimin nga ato që mendonte. Kishte iku edhe një tjetër. Tani që kishin mbetur vetëm dy nëpunës, përvet Ebu Qerimit, atij iu duk se do të ishte më mirë që ai, si më i riu që ishte në punë, në mos i fundit, të ikte i parafundit. Dhe kështu, priti gjersa iku dhe një tjetër. Tani do të ngrihem, tha më në fund me vete, kur mbeti vërtet i parafundit. Ndoshta dhe mbikëqyrësi atë

priste, që ata që kishin mbetur të mbaronin punë sa më parë.

Ebu Qerimi u ngrit dhe mbylli dosjen. Duhej të ishte shumë vonë. Fytyra e mbikëqyrësit dukej po aq e vrarë sa edhe e të tjerëve. Ebu Qerimi iu afrua, i dha dosjen dhe me zë të ulët i tha: Natën e mirë!

— Natën e mirë, Ebu Qerim, — iu përgjigj mbikëqyrësi. — E di nga dilet? Në këtë orë të vonë të gjitha portat e Tabirit janë të mbyllura.

— Ashtu? — Ishte hera e parë që Ebu Qerimi e dëgjonte një gjë të tillë. — Po atëherë si dilet?

— Nga oborri i prapmë, — iu përgjigj mbikëqyrësi, — nga Reçepsioni. Me siguri që s'ke qenë ndonjëherë andej, por është lehtë të gjendet. Në këtë orë janë ndezur vetëm fenerët e korridoreve dhe të galerive që çojnë andej, kështu që, duke ndjekur fenerët e ndezur, mund ta gjesh lehtë rrugën.

— Falemnderit, — tha Ebu Qerimi.

Doli në korridor dhe pa se vërtet ishte ashtu: fenerët ishin të ndezur vetëm në njërin krah. Ai eci në atë drejtim duke i vënë veshin kumbimit të hapave të tij, që i dukej krejt i ndryshëm në atë vetmi. Po sikur të ngatérrohem, tha dy-tri herë me vete. Ndoshta do të kishte bërë mirë të dilte së bashku me ndonjë nëpunës tjetër që e dinte rrugën. Sa më tutje që ikte, aq më tepër e kapte një ndjenjë pasigurie. Nga korridori kryesor, gjithmonë duke ndjekur fenerët e ndezur, u kthyte në një kalim anësor dhe prapë doli në një galeri tepër të gjatë. Shkretëtirë kudo. Ndriçimi i zbeh-të i fenerëve humbte në largësi. Ai zbriti një palë shkallë dhe doli në një galeri tjetër të ngushtë të mbuluar me kube. Fenerët, megjithëse më të rrallë e më të zbehtë, vijonin tutje. Gjer kur kështu, tha me vete. Njëherë iu duk se të kthesa e galerisë përparrë do t'i dilte grumbulli i njerëzve me arkivolin e ëndërrparësit, që ndoshta s'kishin arritur të dilnin ende nga ngrehina e madhe dhe vërtiteshin akoma nepër korridoret e saj. Edhe pak po të vazhdojë kjo endje, do të loz nga mendja, tha me vete. Të qëndronte në vend, mbase kushedi,

vinte ndokush dhe i tregonte rrugën, apo të kthehej mbrapsht, drejt Interpretimit, për të dalë bashkë me të tjerët? Ky mendim i fundit iu duk më i logjikshëm, mirépo në çast e kapulloi dyshimi: po sikur të mos e gjente dot Interpretimin? Dreqi e dinte nëse këta fenerë të zbehtë të çonin vërtet atje ku duhej.

Ebu Qerimi vazhdonte të ecte. Gojën e ndiente të tharë, megjithëse përpinqej ta qetësonte veten. Në fund të fundit, edhe sikur të ngatérrohej vërtet, madje edhe sikur të mbetej gjithë natën këtu, s'ishte ndonjë hata e madhe. As në fushë as në pyll, por në pallat brenda ishte. Kështu mendonte, por e ndiente se një gjë e tillë ishte e lemerishme. Si do të gdhihej ai midis këtyre mureve, sallave është bodrumeve të mbushura mëndrra e delire të tmerrshme? Më mirë në fushën e ftohtë apo në pyllin me ujq, se këtu. Njëqind herë më mirë.

Ebu Qerimi shpejtoi hapat. Sa kohë kishte vallë që po ecte? Befas iu duk se dëgjoi një zallahi të largët. Mbajti këmbët. Ndoshja më ushtojnë veshët, tha me vete dhe vazhdoi udhën. Pas pak zhaurima u përsërit, këtë herë më e ndjeshme, megjithëse nuk kuptohej as-pak nga ç'drejtim vinte.

Duke ndjekur fenerët e ndezur, ai zbriti një palë shkallë të tjera dhe u gjend në një korridor tjetër, që duhej të ishte i katit të parë. Zhaurima humbi ca çaste, pastaj u ndie prapë, më e afërt. Ebu Qerimi, me veshë të ngritur, ecte me shpejtësi, nga frika se mos i humbte ajo zhurmë, që i dukej tanë e vëtmja shpresë. Dhe vërtet, ajo herë dobësohej, herë forcohej, po megjithatë s'shuhej. Madje një herë u ndie shumë afër, por pastaj u largua disi. Ebu Qerimi ecte pothuajse me vrap. Vështrimi i tij nuk i shqitej fundit të korridorit, ku dukej një katror i turbullt i ndriçuar së jashtmi. Zot i madh, u lut ai, ndoshja ajo është dalja e prapme.

Ishte vërtet ashtu. Ebu Qerimi u afrua dhe pak dhe u bind se ajo ishte një portë. Mori frymë thellë dhe gjymtyrët iu shkrehën në çast nga tendosja, saqë iu duk se po i merreshin këmbët. Ashtu, si duke u

valavitur, iu afrua portës, prej nga futej në korridor, bashkë me ajrin e ftohtë, zhaurima që e kishte dëgjuar qysh më parë. Pamja që iu shpalos brutalisht përpara syve, kur mbërriti te pragu i portës, ishte më se e habitshme: oborri i prapmë i Pallatit, i spërkatur me një dritë fenerësh krejt të ndryshme nga ajo e brendshmja, një dritë e shqetësuar, e zhveshur, që mjegulla diku e mekte, diku e acaronte edhe më, duke e llangosur mbi kalldrëmin e lagur, sipër të cilët shtjelleshin njerëz, kuaj e karroca, disa me fenerë të ndezur e disa jo, në një çrregullsi të plotë, do të besoje në një ankth. Gjithë këtë mjegullinë e bënин gati të tjetërjetshme ndriçimet e përthyera të fenerëve dhe sidomos hingëllimat e kuajve nëpër të.

Ebu Qerimi kishte mbetur si i gozhduar te porta, duke mos u besuar syve.

— C'është kjo? — pyeti dikë që po kalonte me një grumbull fshesash në duar.

Tjetri ktheu kokën me habi, po vuri re qyrkun e tij me shenjën e Tabirit qepur në të dhe iu bërgjigj me zë të njerëzishëm:

— Endërrçuesit, aga, a nuk i sheh?

Ishin vërtet ata, si nuk i kishte shkuar ndër mend? Ja ku ecnin me gozhupat e lëkurtë dhe me gjizmet gjithë baltë, kurse karrocat, me rrrotat e përbaltura dhe ato, e kishin që të gjitha emblemën e Tabirit te pupeja.

Vështrimi i Ebu Qerimit u ndal te një hajat i ndriçuar së brendshmi, në anën e djathtë të oborrit, në të cilin hynin e dilnin endërrçuesit. Atje duhej të ishte Recepzioni, për të cilin thuhej se punonte ditë e natë. Pa e ditur as vetë pse, duke ecur mbi kalldrëmin e lagur rrëshqitës, midis pështjellimit të njerëzve dhe karrocave, një pjesë e të cilave kërkonin të zinin vend, Ebu Qerimi iu afrua hajatit dhe u fut nën strehën e tij. Atje zallahia ishte edhe më e madhe se në oborr. Te ca banakë të gjatë, me dhjetëra endërrçues, që me sa dukej kishin imbaruar punë te sportelet e dorëzimit apo që prisnin t'u vinte radha, pinin salep e kafe, të

tjerë hanin simite me qofte, era e mirë e të cilave mbushtë hajatin.

Ebu Qerimi e la veten të shtyhej midis supeve brutale të njerëzve me gozhupa të lëkurtë, që vërtiteshin shkujdeshëm përreth, mbllaçiteshin, qeshnin dhe shanin me zë të lartë. Ja pra, këta ishin èndërrquesit e famshëm, të cilët qysh nga fëmijnia Ebu Qerimi i kishte përfytyruar si korrierë gjysmëqellorë që përshkoni udhët e perandorisë me karrocat e tyre të kaltra. Një pjesë e tyre kishin të llangosura me baltë jo vetëm çizmet, por edhe bërrylat e gozhupave, madje disa edhe shpinën, të njollosur ndoshta gjatë përpjekjeve për ngritjen e karrocës apo kalit të rrëzuar. Kurse në ftyrat e munduara dukeshin shenjat e lodhjes e të pagjumësisë. Edhe të folurën, ashtu si çdo gjë tjetër, e kishin krejt të ndryshme nga nëpunësit e brendshëm të Tabirit, të ashpër, disi të paturpshme, plot shprehje të forta, si ajo gjella me salcë dhe speca djegës. Krejt i hutuar midis asaj zallahie. Ebu Qerimi kishte nisur të dëgjonte copa të bisedave. Këtu mund të merrje vesh të rejet e gjithë perandorisë. Korrierët tregonin për peripécitë e udhës, sherset e tyre me nëpunësit kokëtrashë të provincave, me hanxhinitë pijanikë dhe me rojat e postave të kontrollit në xhadetë e pashallëqeve ku kishët turbullira.

Një zë i ngjirur tërhoqi vëmendjen e Ebu Qerimit dhe, pa kthyer kokën të shikonte atë që fliste, ai u përpoq të dëgjonte fjalët që thoshte. Kuajt s'më ecnin që s'më ecnin, tregonëtë njeriu. Hingëllinin në vend e shkumbëzonin, po s'bënин cap përrpara. Isha fare i vetëm në stepën në të dalë të Jenisheherit, një qytetth i humbur, ku mora një sasi të pakët èndrrash, gjithsej pesë, të mblehdhura këto gjatë gjithë muajit, merreni me mend ç'humbe-tirë ishte. Kështu pra, kuajt s'më ecnin. I zhëpa me kamxhik, ua gjakosa shpinat, por ata s'lëviznin nga vendi, ashtu siç ndodh kur kanë përrpara të vdekurin. Hodha një sy përreth. Stepë e shkretë, as varr as shenjë varri asgjékund. Ndërsa po vrisja mendjen ç'të bëja, befas më shkoi niendja te dosja e èndrrave që porsa kisha

marrë në Jenisheher. Mbase janë ato shkaku që kuajt s'lëvizin, mendova. Zaten gjumi dhe vdekja janë e njëjtë gjë. Pa e bërë të gjatë, hapa çantën dhe nxora dosjen e Jenisheherit. Zbrita nga karroca e lashë dosjen përjashta, në fushë, hipa prapë, u graha kuajve dhe ata ecën menjëherë. Djallo punë, thashë me vete, ajo qenkësh shkaku. Ndalova prapë, e ktheva karrocën te vendi ku lashë dosjen, por, porsa e futa atë në karrocë, kuajt ngecën përsëri në vend, shkumbëzonin e hingëllimin njëlloj si më parë. Ç'të bëja? Kisha mbartur mijëra ëndrra, por një gjë e tillë s'më kishte ndodhur kurrë. Vendosa të kthehesha në Jenisheher, pa dosjen. E lashë mu në mes të stepës dhe u ktheva. Atje filloi sherri me përgjegjësin e seksionit të Tabirit. Unë i thosha: s'kam si t'i marr ëndrrat e tua, eja të shikosh vetë kur ta fut dosjen në karrocë se si kuajt s'bëjnë cap më tutje, kurse ai kokëgdhë bërtiste: ka pesë javë që askush s'na i merr ëndrrat, kurse tani dashke të na i lësh edhe ti, do të ankohem, do t'i bëj letër Drejtorisë së Përgjithshme, vetë Sheh-ul-Islamit. Bëji letër e ankesë kujt të duash, i thashë, mua s'më ecin kuajt dhe s'mund të lë pa quar dosjet e tjera për shkak të pesë ëndrrave tuaja të zgjebosura. Kaq duhej që ai turispec të më vërsulej: po sigurisht ëndrrat tona kështu ju duken juve, se ju bëlqeijnë vetëm ëndrrat e hanëmeve dhe të artistëve të kryeqytetit, kurse tonat, helbete, ju duken si të pagdhendura. Po qeveria ka thënë se këto tonat janë ëndrrat e vërteta, se vijnë nga tabani i shtetit dhe jo nga ata spittulanët e përkëdhelur. E fol e fol ai qelbësirë, saqë m'i ngriti nervat dhe një zot e di si u mbajta e nuk e shtrova në kamxhik, që t'ia bëja shpinën më të butë se barkun. Vërtet s'e godita, por ama ç'nuk i thashë edhe unë. Isha bërë derr nga rruga dhe vonesa dhe gjeta rast të shfryja. E shava atë vetë, qytetthin e tij, atë nënprefekturë të ndyrë, që unë s'do ta quaja as lagje të një fshati, ku jetonin ca pijanikë e ca të rrjedhur nga trutë, që as ëndrrat s'i shikonin për të qenë, përderisa nga ëndrrat e tyre trembeshin dhe kuajt. Të

ishte për mua, vazhdova, pas kësaj do t'ia hiqja të drejtën Jenisheherit për t'ia shqyrtuar ëndrrat së paku për dhjetë vjet. Ai u tèrbua e po shkumbëzonte më tepër se kuajt e mi. Më tha se do të më raportonte për fjalët që thashë, por unë e kërcënova se, në rast se ai e bënte këtë, unë gjithashtu do ta raportoja për sharjet që bëri kundër Tabin Sarajit. Si? ulériu ai, unë shava Tabir Sarajin e shenjtë? Si guxon ta thuash këtë? E shave, i thosha unë, e quajte çerdhe hanëmesh e artistësh të përkëdhelur. Atëherë ai trutharë, nga tèrbimi, kaloi në lutje e qarje. Mos më merr më qafë, aga, thoshte, kam grua e fëmijë, mos e bëj këtë.

Të qeshura të shumëta i mbuluan një grimë fjalët e korrierit.

— E pastaj, ç'u bë pastaj? — pyeti dikush.

— Pastaj në këto e sipër erdhën nënprefekti dhe imami, që dikush i kishte lajmëruar për sherrin. Kur dëgjuan si ishte puna, filluan të kruanin kokën, sepse nuk dinin ç'vendim të merrnin. Të më detyronin të merrja dosjen, druheshin, le që kjo do të thoshte njëlloj sikur të më mbanin me forcë atje, sepse kuajt me atë dosje dihej që nuk do të udhëtonin. Të pranonin se ëndrrat e nënprefekturës së tyre ishin aq të mbrapshta, saqë pengonin lëvizjet e korrierëve, edhe këtë s'e bënin dot. Kurse për mua koha ishte e shtrenjtë. Kisha me vete më se një mijë ëndrra nga krahina të tjera, për vonesën e të cilave mund ta pësoja. Atëherë unë u thashë të vinin me mua gjer te fusha ku kisha lënë dosjen, që të shikonin me sytë e tyre çudinë. Pranuan' dhe kështu, të futur rras e plas në karrocë, shkuam gjer në të dalë të Jenisheherit. Dosja qe atje. E ngrita nga toka, u futa me të në karrocë, u rashë me kamxhik kuajve, ata nisën të shkumbëzonin e të hingëllinin në vend, sikur në karrocë të kishte hipur djalli vetë: E nxora dosjen nga karroca, ua lashë në dorë dhe kuajt u nisën revan. Thashë njëherë t'i lija ashtu me gojë hapur, me dosje në dorë dhe t'ia mbathja, por iu tremba ngatërresave dhe e ktheva karrocën. E shikoni, u thashë, ju mbush mendja tanë? Ata pëshpëritën «allah!» si gjysmë të lajthitur dhe s'dinin ç'të bënin. Ndërsa për-

piqeshim të gjenim një rrugëzgjidhje, përgjegjësit të seksionit, që i kishte hyrë frika në palcë, ngaqë i dukej se në këtë punë ai mund ta pësonë i pari ngaqë kishte lejuar të nisej për në Tabir një éndërr aq djallëzore, i ra ndërmend të nxirrte éndrrat nga dosja një nga një për të gjetur se cila ishte e keqja, në mënyrë që të mos e pësonin të tjerat për shkak të saj. U gëzuam të gjithë për këtë gjetje dhe, pa e bërë të gjatë, nisëm provën, duke hequr nga dosja herë një éndërr, herë një tjetër. Nuk qe e vështirë të gjendej éndrra e keqe. E hoqëm nga dosja atë murtajë dhe kështu vazhdova udhën.

— S'paskësh qenë éndërr ajo, po helm, — tha dikush.

— E ç'do të bëhet tani me të? — pyeti një tjetër, — Asnjë karrocë s'mund ta sjellë, apo jo.

— Kurrë mos e sjellshin, — tha zëngjiruri.

— Po ndoshta është një éndërr e rëndësishme, aq më tepër që është aq e jashtëzakonshme.

— Le të jetë si të dojë, — tha korrieri, — e florinjtë po të dojë le të jetë. Derisa kuajt s'pranojnë ta çojnë, do të thotë se ajo s'është éndërr por djall. Më kupton, djall me brirë është!

— Megjithatë...

— S'ka megjithatë, derisa kuajt nuk e sjellin, do të thotë se do të kalbet atje në atë Jenisheherin e mallkuar.

— S'është ashtu, — tha një korrier plak, — nuk e di si është tani, po më parë për raste të tilla përdoreshin éndërrçues këmbësorë.

— Ka pasur të tillë vërtet?

— Posi, — u përgjigj plaku. — Rastet kur kuajt nuk çonin éndrrat, megjithëse të rralla, kanë qenë të njobura. Ndaj dhe ishin këmbësorët. Ca rregulla të vjetra kanë qenë të mira.

— E sa kohë i duhet një korrieri këmbësor për ta sjellë éndrrën që andej?

— Varet nga largësia. Ma merr mendja se që nga Jenisheheri do t'i duhen nja një vit e gjysmë.

Dy-tre veta lëshuan vërvëllima habie.

— Mos t'ju vijë çudi aspak, — tha korrieri i vjetër.

— Qeveria e zë lepurin me qerre.

Ata nisën aty për aty një bisedë tjetër dhe Ebu Qerimi u shty më tutje. Kudo ishte po ajo e folur e rrëmujshme, te hyrjet e hajatit, midis tij dhe përpara sporteve të Recepsonit, ku korrierët sipas një radhe që Ebu Qerimi nuk e mori dot vesh se si mbahej, bënin dorëzimin e dosjeve. Njëri nga korrierët, për të cilin Ebu Qerimi dëgjoi të thoshin se e kishte humbur çantën me dosje, ngaqë kishte pirë në një han, rrinte mënjanë me sytë të kuq si gaca dhe pinte akoma, duke murmuritur.

Që jashtë nga oborri vinte zhaurima e paprerë e zërave, kërcitja mbi kalldrëm e rrotave të karrocave që porra mbërrinin nga larg, apo e atyre që largoreshin pas dorëzimit dhe një hingëllimë e herëpashershme kuajsh, që Ebu Qerimit i shtinin dridhmën në shpirt. Dhe kështu do të vazhdojë gjer në mëngjes, mendoi ai si i mpirë. Gjer në mëngjes, perëndi, përsëriti pas pak, ndërsa çante përmes asaj tollovie pér të ikur që andej.

#### IV

### DITA E PUSHIMIT

Dy-tri herë Ebu Qerimi u zgjua i llahtarisur nga ideja se po vonohej në orarin e punës. Dora e tij bëhej gati të flakte kuvertën, kur në atë çast trurin e mjegulluar nga gjumi e përshkonte mendimi se atë ditë kishte pushim dhe ai zhytej përsëri në atë gjysmëgjumë të mundimshëm. Ishte hera e parë, qysh pas hyrjes në punë në Pallatin e Ëndrrave, që i kishin dhënë një ditë pushim.

Më në fund hapi sytë. Pas perdeve të kadifejta ndriçimi i ditës arrinte i butë gjer në nënkrejsen e tij. Ebu Qerimi u shtriq një copë herë, pastaj hodhi kuvertën dhe u ngrit nga shtrati. Duhej të ishte vonë. Iu afrua pasqyrës dhe vështroi fytyrën e mbufatur nga gjumi. Kokën e ndiente të rëndë plumb. Askush s'do ta besonte se në ditën e tij të parë të pushimit do të ngrihej nga gjumi më i lodhur se mëngjeseve të tjera, kur shpejtonte të dilte në rrugët plot mjegull e lagështirë, për të mos u vonuar në orarin zyrtar.

Pasi lau fytyrën, iu duk se u freskua disi. Kishte përshtypjen se, po të përpinqej edhe pak, mund të kujtonte nja dy ëndrra të lehta që kishte parë aty ndaj të gdhirë.

Qyshse punonte në Tabir Saraj, shikonte ëndrra rrallë, thuase ato s'guxonin t'i vinin atij, që dinte me rrënje e me themel të fshehtat e tyre dhe që mund t'u thoshte: shkoni të génjeni ndonjë tjetër, jo mua.

Ndërsa zbriste shkallët, Ebu Qerimi ndjeu erën e mirë të kafes së pjekur dhe aromën e bukës së thekur. Nëna dhe Lokja e prisnin prej kohësh për të ngrënë mënjesin.

— Mirëmëngjes, — tha ai.

— Mirëmëngjes, — u përgjigjën ato duke e shikuar me dhimbsuri. A fjetë mirë? Dukesh i çlodhur.

Ai bëri «po» me kokë dhe u ul pranë mangallit me prush, përbri të cilit ishte afruar tryeza e ulët me servisin e çajit. Duke ikur çdo ditë herët e me ngut, gati e kishte harruar këtë orë të këndshme, kur përndritja e servisit të argjendtë të çajit, e prushit dhe e anëve prej baki të mangallit të vjetër të shtëpisë krijonin, bashkë me ndriçimin e kursyer të ditës, ndjesinë e një mëngjesi të përjetshëm e plot mall.

Ebu Qerimi hëngri ngadalë dhe pastaj piu kafen bashkë me nënën. Pasi e rufisi për herë të fundit, e ëma e përmbysi, si zakonisht, filxhanin në pjatë dhe Lokja u afrua për të lexuar në të fatin. Më parë kjo ishte ora kur thuhej ndonjë ëndërr që kishte parë njëri apo tjetri gjatë natës, por tani, qysh pas futjes së Ebu Qerimit në punë askush s'përmendte më gjëra të tillë. Kjo kishte ndodhur qysh në javën e parë të hyrjes së Ebu Qerimit në Tabir Saraj, kur një teze e tij, kishte ardhur tërë bujë e zhurmë për t'i rrëfyer atij ëndrrën që kishte parë një natë më parë. Tani si lum ne, tha ajo, e kemi çelësin e kuptimit të ëndrrave në fisin tonë dhe s'kemi nevojë të bredhim pas fallxheshave e arapkave. Ebu Qerimi qe zymtuar e egërsuar si kurrë ndonjëherë. Si guxonte ajo llafazane t'i sillte atij për shpjegim ato ëndrrat e saj budallaqë e pa vlerë? Për kë e merrte, vallë? Tezja kishte ngelur me gojë hapur, pastaj qe larguar e fyer dhe me vështirësi e kishin zbutur më vonë kushërirat e Ebu Qerimit.

Ebu Qerimi vështronte prushin e mangallit, që ngjantë si i urtësuar nën shtresën e bardhë të hirit.

— Sot éshtë kohë e mirë, — tha e ëma, — do të dalësh pak?

— Ashtu mendoj, — u përgjigj Ebu Qerimi.

— Diell nuk ka, po sidoqoftë të bën mirë të marrësh pak ajër.

Ebu Qerimi tundi kokën.

— Vërtet kam kohë që s'kam dalë, — tha.

Ai qëndroi dhe një copë herë pa folur, me sytë mbi mangall, pastaj u ngrit, veshi qyrkun dhe, si përshëndeti nënën, doli përjashta.

Koha ishte vërtet pa diell, siç kishte thënë nëna. Ai ngriti kokën si pér të kërkuar së paku gjurmët e tij në atë qìll bosh, zbratëzia e të cilët iu duk befas e padurueshme. Kishte kohë pa e parë qìllin mbi qytet në atë orë të ditës, ndaj iu duk çuditërisht i varfër, me ca re banale dhe zogj të rrallë, të mërzitshëm. Qyshse kishte hyrë në Tabir, e kishte bërë udhën mëngjeseve, zakonisht në kohë të keqe dhe tepër herët, me kokën të turbulluar nga pagjumësia dhe qe kthyer gati më të ngrysur, pothuajse pa vënë re asgjë nga lodhja. Kështu që sot po e shihte qytetin si njeriu që kthehet pas një mërgimi të shkurtër. Sytë e tij vështronin gati me habi më të majtë e më të djathët. Tani jo vetëm qìlli, po gjithçka tjetër, muret e ndërtesave, pullazet, karrocat dhe drurët e parqeve i dukeshin të zbërdhulët e pa shije. Ç'është kështu, tha ai me vete. Bota e tërë i dukej e çngjyrosur dhe e zbehtë si pas një lëngate.

Ebu Qerimi ndiente një akullsirë në gjoks, ndërsa këmbët, pasi e kishin nxjerrë trupin e tij nga rruga ku banonte, po e çonin drejt qendrës së qytetit. Trotuaret nga të dyja anët e udhës ishin plot njerëz, por lëvizjet e tyre ishin të ngrira, me një përpikmëri të keqe, dhe po aq të varfra në kërkëllitjen e tyre dukeshin karrocat dhe një kasnec i mjerë te Sheshi i Islamit, që dukej sikur po shpallte mërzinë e botës.

C'kishin pësuar kështu jeta, njerëzit, gjithçka. Atje... (Ebu Qerimi buzëqeshi përbrenda vetes si me një të fshehë të shenjtë) atje... në dosjet e tij, gjithçka ishte ndryshe,

aq e bukur dhe plot fantazi. Ngjyrat e reve pemët, bora, urat, tymtarët, zogjtë, çdo gjë ishte më e ndezur dhe më e gjallë. Dhe lëvizjet e sendeve e të njerëzve ishin më të lirshme, të rrëshqitshme e harmonioze, si vrapimi i dre-rëve nëpër mjegull, të papenguara në çdo hap nga ligjet e kohës e të hapësirës. Sa e mbërthyer në pranga, kopracë dhe tmerrësish e mërzitshme dukej kjo botë në krahasim me atë tjetrën, nëpunës i së cilës ai ishte.

Si i shastisur Ebu Qerimi vazhdonte të vështronët njerëzit, karrocat me kuaj dhe ndërtuesat. Çdo gjë ishte vërtet banale dhe varfërisht e pikëllueshme. Më mirë që, gjatë këtyre muajve që punonte atje, s'kishte dalë asgjë-kund dhe s'kishte takuar asnjeri nga bota e jashtme. Kjo ishte ndoshta dhe arsyja që nëpunësve të Pallatit të Ëndrrave u jepej leje shumë rrallë. Tani po e kuptonte se ajo leje as që i duhej fare. Dhe as që i duhej të dilte më në-për këtë qytet të përcudnuar.

Sytë e Ebu Qerimit vazhdonin të vështronin ftohtë përreth. Përherë e më tepër po bindej se kjo nuk ishte një ndjesi e rastit, dhe se bota e atjeshme, sado që ai shpesh bëhej nervoz me të, ishte shumë më e pranueshme për të se kjo këtu. S'e kishte menduar kurrë se do t'i zvirdhej aq shpejt, pas një mungese prej disa muajsh. Kishte dëgjuar për nëpunës të vjetër të Pallatit të Ëndrrave që ndaheshin për së gjalli ngajeta dhe që, kur ndonjëherë shfaqeshin rastësish në shoqëri, dukeshin si të pérhënur. Mos do të shndërrohej edhe ai, pas disa vjetësh, në një qenie të tillë? E çë pastaj, mendoi. Pa shiko ç'botë të bukur që do të braktiste! Njerëzit nën-qeshnin me ironi me nëpunësit e fantaksur, por nuk u shkonte mendja aspak se sa të zhveshur e mjeranë u dukeshin ata dhe jetë e tyre fantazistëve të Tabirit.

Ebu Qerimi kishte arritur më në fund përpëra kafenesë «Haxhilekët», ku vinte zakonisht të pinte kafen kur... ishte... (vetëtimthi truri i tij mënjanoi fjalët «gjallë», pastaj «zgjuar»). Pra kishte arritur përpëra kafenesë ku zakonisht pinte kafen kur ishte thjesht djalë i ri kryeqytetas, pa ndonjë punë. Shtyu derën dhe u fut brenda. Pa

vështruar askënd, eci drejt qoshes së majtë, ku i pëlqente të rinte zakonisht dhe u ul në një ndenjëse. I kishte pëlqyer kjo kafene sepse, ndryshe nga çajhanet e tipit të vjetër, minderet dhe shiltet ishin zëvendësuar nga ca frona të ulët, të veshur, me lëkurë, në të cilët rrihej këndshëm.

Kafexhiu iu duk Ebu Qerimit i hirtë në fytyrë.

— Ebu Qerimi? — ia bëri ai i habitur, duke u afruar me ibrikun e kafes në dorë. — Ku ke qenë kaq kohë? Kujtova se mos ishe sëmuri, sepse, të them të drejtën, s'de-sha ta besoja se je bërë myshteriu i tjetërkujt.

Ebu Qerimi e zëvendësoi mungesën e sqarimit me një buzëqeshje. Kafexhiu buzëqeshi gjithashtu dhe, duke afruar kokën, tha me zë të ulët:

— Po pastaj e mora vesh si qe puna... Kafen, si gjithmonë, me pak? — shtoi kur e pa se Ebu Qerimi u vrenjt.

— Po, kafen si gjithmonë, — pohoi Ebu Qerimi, pa e vështruar.

Ai u përpoq të mbyste një psherëtimë, duke ndjekur me sy currilin e kafes që derdhej në filxhanin e trashë. Pastaj, kur kafexhiu u largua, vështroi me kujdes përreth për të parë se a kishin ardhur myshterinjtë e zakonshëm. Ishin pothuajse të gjithë aty, hoxha i xhamisë fqinje me dy burra të gjatë që s'flitnin kurrë, pehlivani Ali, rrrethuar si pérherë nga një grup admiruesish, një tullac i shkurtër, i përkulur si gjithmonë mbi ca shkresa të vjetra, për të cilat kafexhiu jepte shpjegime të ndryshme që vare-shin nga gjendja e tij shpirtërore. Herë thoshte se ishin dorëshkrime të moçme që myshteriu i tij i ditur përpinqej t'i përkthente, herë dokumente të një gjyqi të dikur-shëm të humbur prej tij herë shkarravina të kota e pa kuptim, të gjendura në kushedi ç'sepet të mykur matufi.

Ja dhe të verbërit, tha me vete Ebu Qerimi. Ishin në vendin e tyre të zakonshëm, në të djathtë të banakut. Ç'më ka gjetur me ta, i kishte qarë hallin një ditë kafe-xhiu Ebu Qerimit. Në kafenenë time do të vinin me si-guri myshterinj të tjerë të zgjedhur, sikur ata, me atë pamje të frikshme, të mos vinin e të zinin, si për inat,

vendin më të dukshëm. Po s'kam ç't'u bëj, më ka zënë rrrota bishtin. Janë të mbrojtur prej shtetit dhe nuk i dëboj dot. Ebu Qerimi e kishte pyetur se q'do të thotë kjo «janë të mbrojtur prej shtetit» dhe atëherë «kafexhiu, që e priste këtë pyetje, i kishte treguar diçka që e kishte lënë gojëhapët Ebu Qerimin. Të verbërit që vinin në kafene, nuk ishin të verbër dosido, të bërë kështu nga sëmundja apo ndonjë goditje, as të plagosur në luftë. Të qenë të tillë, ai do t'i mirëpriste me gjithë qejf në kafenë e tij. Por ata ishin tjetër gjë dhe ishin verbuar për arsyen që njeriu e kishte vështirë ta gjente. Kafexhiu shpjegonte se ata më parë kishin qenë njerëz pa ndonjë cen, pra kishin qenë njerëz me sy, veçse sytë e tyre ishin jo si të gjithë njerëzve, por sy të ligj, dhe, siç mund ta dinte zoti Ebu Qerim, për të mbrojtur veten dhe shtetasit nga sy të tillë, shteti i mrekullueshëm osman kishte nxjerrë një dekret të veçantë. Sipas këtij dekreti, shtetasve me sy të lig u nxirreshin sytë dhe si shpërbllim përkëtë shteti u caktonte një pension të përjetshëm. E kuption tani përsë s'i dëboj dot nga kafeneja ime? E mbajnë veten më të madh përflijimin e syve. Kushedi si u duket vetja, pothuajse heronj.

Ebu Qerimi nuk e kishte ditur qenien e këtij dekreti dhe tregimi i kafexhiut, që me siguri i përsëritez qdo myshteriu të ri, i qe dukur atij pjellë e një truri të sëmurë. Mirëpo kishte pyetur më vonë përkëtë dhe i kishin thënë se kishte vërtet një dekret të tillë dhe se ai zbatohet në tërë perandorinë.

Për çudi edhe ata po i dukeshin sot Ebu Qerimit fare të pafrikshëm me atë cohën e zezë të lidhur shtrembër në ballë. Kishte parë ai atje lloj-lloj sysht që të ngjethnin mishtë edhe tani që i kujtonte, madhështorë e të llahtarshëm njëkohësisht, të dalë jo midis ballit njerëzor, po drejt e në brinjën e qiellit apo midis malit, të përzier nga njëherë me pikëllim hëne, që u ngrinte anëve, si ujëvarë prej dylli.

As ajo puna e kallëzimit të sykeqëve, që Ebu Qerimin e kishte lemerisur kur e kishte dëgjuar prej kafe-

xhiut, (letrat me kallëzime pér njerëzit me sy të keq mund të hidheshin në çdo kuti poste), as mbledhja një herë në muaj e komisionit shtetëror, i cili, pas kontrollit që u bënnte një pér një, vendoste se cilët prej fatkeqëve të arrestuar në bazë të kallëzimeve kishin me të vërtetë sy të ligj që duheshin nxjerrë, dhe as vetë nxjerrja e syve «pér të mirën e përgjithshme», siç thuhej në fjalimin tradicional që mbahej pérpara turmës së të porsaverbuarve, nuk e drithëronin më ashtu si më parë Ebu Qerimin. Nganjëherë mendonte se do të kalonin edhe disa vite dhe atij nuk do t'i bënin më asnje përshtypje as mrekullitë e as tmerret e kësaj bote, të cilat në fund të fundit s'ishin veçse ca kopje të zbehta të të atjeshmeve, që kishin mundur të kapërcenin kufirin që ndante atë botë nga kjo. Ferri dhe parajsa bashkë janë atje, thoshte ai me vete gjithsaherë dëgjonte fjalët: c'mrekulli, ose c'tmerr.

Dera e kafenesë u hap dhe nëpër të hynë ca nepunës të konsullatës së huaj, ndërtesa e së cilës qe përballë. Vazhdokan ta pinë kafen këtu, mendoi Ebu Qerimi. Te tryeza e pehlivanit u bë një grimë heshtje. Më parë edhe Ebu Qerimi e priste me njëfarë ngazëllimi hyrjen e të huajve dhe sytë e tij admironin fshehtazi veshjet e tyre evropiane, mirëpo sot, pér çudi, edhe ata iu dukën pa ndonjë mister.

Ishte ora e paradites, kur kafeneja kishte më shumë njerëz. Ebu Qerimi njoju nepunësit e «Bankës së Vakëfeve», që ndodhej njëzet hapa larg, pastaj hyri polici i udhëkryqit që, siç dukej, porsa e kishte lënë shërbimin dhe pas tij ca myshterinj të panjchur. Nga tryeza e pehlivanit dhe e admiruesve të tij u dëgjua një e qeshur me zë të ulët. Pse të mos qeshni, tha me vete Ebu Qerimi, pér ato mendjet tuaja firifiu bota është shesh me lule.

Aty pér aty, si një re e zezë, atij i pllakosi në kujtësë darka e së pardjeshmes te kushëriri i tij i fuqishëm, veziri. Kishte gati një vit pa e takuar dhe, kur pas kthimit nga puna te porta e shtëpisë pa karrocën e tij me «Q»-në e gdhendur, u drodh si zakonisht. Por akoma më shumë u habit kur nëna i tha se veziri e kishte dërguar karrocën pér të dhe se e priste në shtëpinë e tij.

Megjithëse e priti me përzemërsi, Ebu Qerimit Veziri iu duk i lodhur e i zymtë. Sytë i kishte të prerë si nga pagjumësia. Edhe të folurën e kishte plot ndërprerje, thuase pjesën më të madhe të asaj që duhej të fliste e gjelltiste për vete. Hallet e pushtetit, kishte menduar Ebu Qerimi. Tjetri e kishte pyetur për punën dhe Ebu Qerimi, në fillim me njëfarë ngathtësie, pastaj më lirshëm kishte nisur t'i tregonte për të, mirëpo, ndërsa fliste, kishte përshtypjen se veziri e dëgjonte pa e pasur mendjen aty. Më vonë Ebu Qerimi qe skuqur me vete kur kishte sjellë ndër mend atë çast, në të cilin kujtonte se po i rrëfente diçka kurioze vezirit, i cili, siç u kuptua më vonë, jo vetëm i dinte të gjitha ato, por dinte për Pallatin e Ëndrrave shumë më tepër se gjithë ata që punonin aty. Ai nisi të fliste për Tabir Sarajin ngadalë, me shumë ndërprerje, duke lënë shumë gjëra në mjegull, megjithatë, nga biseda e tij, Ebu Qerimi mësoi më shumë për Tabirin sesa nga gjithë koha e punës së tij atje.

Ishin vetëm të dy, gjë që s'kishte ndodhur asnjëherë tjetër, me filxhanët e kafes përpara, dhe Ebu Qerimi akoma s'e merrte dot me mend përse e kishte thirrur. Veziri fliste me zë të ulët, duke trazuar herë pas here prushin e mangallit, prania e të cilit në atë dhomë ndihej më shumë se ajo e Ebu Qerimit. Veziri foli diçka për marrëdhëni e Qyprillinje me Pallatin e Ëndrrave, marrëdhënie të cilat, gjatë qindra vjetësh, siç mund të kishte dëgjuar Ebu Qerimi, kishin qenë tepër të ngatërruara. Ai u mat të shtonte diçka tjetër, ndoshta për përpjekjen e dëshpëruar të Qyprillinje përf ta zhdukur Pallatin e Ëndrrave, gjë që Ebu Qerimi e kishte dëgjuar të përshpëritez edhe më parë, por, siç dukej, u pendua dhe për një kohë të gjatë dora e tij, duke e mbajtur mashën me nervozizëm, trazoi prushin e mangallit. Nuk është ndonjë sekret që vite më parë Tabir Saraji ndodhej nën ndikimin e bankave dhe të pronarëve të bronzit, kishte thënë ai, kurse kohët e fundit është afruar përsëri me grupin e Sheh-ul-Islamit. Do të thuash ti se ç'rëndësi ka kjo? Ka, madje shumë. S'thuhet më kot kohët e fundit se, kush ka në dorë Pallatin e Ëndrrave, ka çelësat e drejtimit të shtetit.

Ebu Qerimi diçka kishte dëgjuar edhe për këtë, por kurrë në një mënyrë kaq të prerë dhe aq më tepër nga një personalitet aq i lartë i qeverisë. Ai kishte mbetur me gojë hapët dhe, sikur të mos mjaftonte kjo, veziri e kishte pyetur; a e dinte ai se q'bëhej me mizërinë e ëndrrave që përpunoheshin në Tabir Saraj? Ebu Qerimi, i skuqur në fytyrë, kishte ngritur supet për t'i thënë «jo». Nga turpi ai ishte gati të hante veten me dhëmbë në atë çast. Ç'ishte e vërteta, një herë kishte pyetur veten: po q'bëhet me to, dhe aty për aty, në mënyrën më naivë, kishte besuar se, pasi u nxirrej *bashëndrra*, ashtu si bykut që i nxirret fara, sasia e panevojshme e ëndrrave paketojë dhe zbritej në arkiv. Porsa veziri ia bëri pyetjen, e ndjeu se ishte marrëzi të mendoje se gjithë ai mal ëndrrash hidhej kështu poshtë, pasi prodhonte lulen e rrallë, *bashëndrrën*. Veziri ia shpjegoi shkurt se nxjerrja e kryeëndrrës ishte njëra nga detyrat e bashëndrrorëve, detyrë pa dyshim kryesore, përderisa i jepte edhe emrin tërë sektorit. Megjithatë, përvèç asaj, bashëndrrorët kishin edhe detyrën e hartimit të sinjalizimeve për institucionet kryesore të shtetit si edhe të relacioneve dhe studimeve të tjera të fshehta për çështje të ndryshme, kryesisht të psikozave të kastave apo të popujve të shumtë të perandorisë.

Ebu Qerimi dëgjonte krejt i përpirë fjalët e tij. Natyrisht që bashëndrra mbeten pérherë një gjë kryesore, kishte nénvizuar tjetri, aq më tepër në çastet e tanishme, e aq më tepër kur është fjala për familjen tonë. Veziri e kishte vështruar gjatë Ebu Qerimin, si për t'u bindur se a e kuptonte ai se Qyprillinxjë kishin pasur punë pérherë jo me relacione dosido, po kryesisht me bashëndrra. A më merr vesh? i kishte thënë ai. Sytë i qenë veshur me një tis të errët xixellues. Te bashëndrra synojnë të gjithë... Fjalët e vezirit u bënë prapë të mjegullt, plot boshësira midis. Fliten shumë fjalë për to, vazhdoi ai, po nejse, s'dua që të them janë apo s'janë të vërteta, po të them vetëm se një bashëndërr është e aftë të parandjellë ndryshime të rëndësishme në jetën e shtetit. Në sytë e vezirit u shkar-

kua një ndriçim ironik. Një bashëndërr dha idenë për masakrën e madhe të krerëve të Shqipërisë në Manastir. E ke dëgjuar atë masakër? Dhe po një bashëndërr shkaktoi ndryshimin e politikës ndaj Napoleonit dhe rrëzimin e vezirit të madh Jusuf. Dhe sa raste të tjera... S'thonë kota se drejtori juaj, i thjeshtë në pamje e pa tituj, rivalizon për nga fuqia me ne, vezirët më të pushtetshëm.

Ai kishte buzëqeshur tërë hidhërim. Rivalizon, vazhdoi ngadalë, sepse ai ka fuqinë e tmerrshme të mungesës së faktit.

Ebu Qerimi nuk ia hiqte sytë gojës së kushërit. Fuqinë e tmerrshme të mungesës së faktit, përsëriti me vete krejt i mpirë, ndërsa veziri vazhdonte t'i shpjegonte se si nga Tabir Saraji s'kishte dalë dhe s'mund të dilte kurrë asnjë urdhër, po Tabiri s'kishte nevojë për to. Ai hidhte idetë, të cilat mekanizmi i tij i çuditshëm i vishte aty për aty me një fuqi ogurzezë, sepse ato ide nxirreshin, sipas tij, nga thellësitë e qamëshuara të shpirtit të përbashkët osman.

Sic të thashë, ne Qyprillintë kemi pasur të bëjmë shpesh me bashëndrrat. Fjalët e vezirit dilnin si me vërvshëllime nga buzët e shtrënguara të tij. Ato na kanë goditur shpesh... Ebu Qerimit iu kujtuan netët e pëshpërimave e të ankthit në shtëpinë e tij të madhe. Në përfytyrimin e tij bashëndrrat ishin shndërruar tanë në ca nepërka që kafshonin. Ai e ndiente se e folura e vezirit sa vente bëhej më e turbullt. Diçka zbulohet herë-herë miu shqetësimi të tij, por ai shpejtonte ta mbulonte prapë. Më parë duhej të kishe hyrë ti në Tabir Saraj, tha ai, por ndoshta edhe tanë s'është vonë... Biseda sa vente bëhej më e zymtë, gjithë ndërprerje dhe mëdyshje. Ebu Qerimi nuk e kuptonte q'kërkohet prej tij. Ndihej se veziri s'donte të hapej gjer në fund. O zot, ka të drejtë, mendonte Ebu Qerimi, është një burrë shteti, kurse unë një nëpunës i kurrfartë. Po i linte të kuptonte, po ia thoshte po-thuajse hapur se Ebu Qerimi s'kishte shkuar rastësisht atje. Ai duhej të bënte përpara, të arrinte të kuptonte

gjithë funksionimin e mekanizmit dhe kryesorja të hapte sytë kur të vinte çasti... Po për çfarë? Cili çast? deshi të pyesë Ebu Qerimi, por nuk guxoi. Gjithçka ishte mjegullore. Do të bisedojmë prapë, thoshte veziri, por ndihej që edhe ai ishte në mëdyshje, t'i hapej gjer në fund apo jo. I kthehej prapë bisedës së ndërprerë, hidhte dy-tri ndriçime në të, që përpiquej t'i shuan te sakaq.

Ke dëgjuar besoj se në periudha krize fuqia e Tabir Sarait ose bie ose shtohet edhe më. Tani është një kohë e tillë krize dhe, për fat të keq, Tabiri është në ngritje.

Ebu Qerimi prapë nuk guxoi të pyeste se për ç'krizë bëhej fjalë. Diçka i kishte zënë veshi për një projekt reformash të mëdha që kishte acaruar klerikët dhe kastën e ushtarakeve, por asgjë të saktë s'dinte përtë. Ndoshta Qyprilljinjtë ishin të përzier në këtë aksion.

Është kohë acarimi, kishte vazhduar veziri. Bashëndrra mund të godasë përsëri. Ebu Qerimi përpiquej të mos i shpëtonte asnjë hollësi e tjetrit. Tani veziri ia thoshte shkoqur që të hapte sytë. Ti duhet të kishe hyrë më parë atje, murmuriste nëpër dhëmbë. Po nejse, ky ishte gabimi im. Ndoshta edhe tani s'është vonë... Çështja është se cila botë e sundon tjetren, kishte vazhduar veziri pas një heshtjeje të gjatë. O zot, prapë e çoi bisedën larg, mendoi Ebu Qerimi. Dhe tamam atëherë kur u duk se po hapej. Disa mendojnë se bota e anktheve, e ëndrrave, me një fjalë bota juaj është ajo që drejton këtë botën tjetër këndeje, vazhdoi veziri. Kurse unë mendoj se gjithçka e drejton kjo bota këndeje. Edhe ëndrrat, edhe ankthet e deliret, në fund të fundit, është ajo që i zgjedh, për t'i ngjitur në sipërfaqe, si ajo kova që nxjerr ujë nga pusi i thellë. Më kuptove ç'desha të them? Është ajo që zgjedh në atë humnerë atë që i intereson.

Veziri ia afroi kokën edhe më Ebu Qerimit. Sytë e tij kishin një ndriçim të frikshëm ngjyrë squfuri. Flitet se bashëndrra ndonjëherë është kallpe, tha ai

me zë të ulët. Të ka shkuar ndonjëherë ndër mend një gjë e tillë?

Ebu Qerimi qe bërë akull nga tmerri. Bashëndrra kallpe?! Kurrë nuk ia kishte marrë mendja se një tru njerëzor do të guxonë ta mendonte një kob të tillë, pale pastaj të urdhëronte gojën për ta shprehur me fjalë. Veziri vazhdonte të shpjegonte se ç'flitej për bashëndrrën dhe dy-tri herë Ebu Qerimi tha me vete: o perëndi, po duket haptas që ai vetë mendon ashtu. Ebu Qerimi s'e kishte marë ende veten nga trallisja dhe zëri i vezirit i vinte si përmes zhurmës së një rrënoje. Pra, flitej se disa nga bashëndrrat ishin kallpe dhe fabrikoheshin në Tabir Saraj nga bashëndrrorët, sipas interesave të grupeve të fuqishme rivale në pushtet ose pas gjendjes shpirtërore të sovranit. Në mos kallpe tërësisht, të falsifikuara përgjysmë.

Ebu Qerimi ndiente një dëshirë të papërmbajtshme t'i binte në gjunjë vezirit duke iu lutur: lërmë të largohem që andej, kushëri, dajë, mos më merr më qafë. Por e dinte dhe vetë se kurrë s'do ta kërkonte këtë, edhe sikur të ishte i sigurt se ajo nëpunësi do t'ia conte kokën në satë.

Ajo thirravaje iu përsërit disa herë brenda gjoksit, ndërsa largohej nga shtëpia e vezirit, natën vonë. Karroca ecte nëpër rrugë me fenerë të shuar dhe Ebu Qerimit i dukej se, i ndryrë në atë karrocë të zezë me «Q» -në e damkosur anëve, si vulë fatale, qyqe e vemuar, ai kalëronte në kufijtë midis dy botëve, prej të cilave s'dihej se cila drejtonte tjetrën.

Duhej të hapte sytë kur të vinte çasti... Po ç'sinjal do të ishte ai dhe cili ëngjëll apo djall do ta sillte atë dhe si do ta gjente, kujt do t'i bëzante ai, përmes shtëllungave të mjegullës së Tabir Sarajit?

Të gjitha këto iu kujtuan Ebu Qerimit në kafene, ndërsa vërtiste në duar filxhanin bosh. Ankthi ia shtrëngonte zemrën edhe tanë pas disa ditësh. Diçka e shtynte të kthente kokën nga tryesa e admiruesve të pehlivanit Ali, të cilët kishin lënë bisedën dhe po e kundronin me ca sy hutaqë.

Ebu Qerimi u nervozua. Kafexhiu, me sa dukej, kishte arritur t'ua thoshte se ai punonte tani në Tabir Saraj. E dinte që ishte llafazan, por jo gjer në këtë shkallë. Por, në fund të fundit, në dreq të vente ai bashkë me kureshtarët e tjerë. Ai do të vinte apo s'do të vinte dy-tri herë në stinë në këtë kafene. Apo ndoshta më rrallë, në mos fare.

Me atrimin e kohës së drekës kafeneja po zbrazej. Kishin ikur diplomatët e huaj, kishin ikur edhe nëpunësit e bankës. U ngritën njëri pas tjetrit edhe admiruesit e pehlivanit, pasi i hodhën Ebu Qerimit nga një shikim të fundit të topitur. Vetëm të verbërit s'lëviznin nga tryeza e tyre dhe, ngaqë prej kohësh i kishin mbaruar bisedat, i mbanin qafat drejt, ashtu siç i mbajnë njerëzit që kanë një qejf të prishur apo një mllef ndaj gjithë botës. Ato koka të heshtura dukej sikur thoshin: mos vallë punët e shtetit shkokan më mbarë tani që sytë tanë, të cilët i paskëshin prishur punë atij, janë nxjerrë? Me c'dëgjojmë, bota ka mbetur siç ka qenë, në mos eshtë bërë më keq.

Ebu Qerimi pagoi më në fund paret, u ngrit dhe doli. Rrugën për në shtëpi e bëri ngadalë, duke u penduar që s'mori një llandon. Kishët mbërritur në rrugën ku banonte, kur dëgjoi pas ca zëra të ulët: «Ai punon tani në Tabir Saraj.» Bëri sikur s'dëgjoi dhe vazhdoi udhën duke e mbajtur kokën drejt. Gështenjapjekësi dhe polici i rrugës e përshëndetën me ndërim të veçantë. Me siguri e kishin marrë vesh ku punonte dhe tani në sytë e tyre kishte një hutim dhe ngrirje, thuase habiteshin që po e shihnin ende prej mishi dhe kockash atë që duhej të ishte tashmë gjysmë i avullt.

Te kafazi i një dritarëje të ndërtësës përballë shtëpisë së tij ai dalloj një siluetë. E dinte se aty banonin dy motra të bukura, për të cilat i pëlqente të binte në mendime, por sot edhe ai kafaz, përherë joshës, iu duk si i zbrazët.

Ja dhe mysafirllëku yt i parë në botën e të gjallëve po mbaron, i tha vetes ndërsa shtynte portën e

hekurt të oborrit. Një si frushullimë flatrash i shoqëronte ecjen, thuase trupit të tij po i ngjiteshin elementët e tejetshëm. Para ca netësh, te veziri, mendimi se mund të vdishtë e kishte bërë petë shpirtin e tij, kurse tani aq i bënte. Bota ishte aq e murme, saqë s'ia vlenë barra qiranë të pikëllloheshe për humbjen e saj.

Ebu Qerimi shtyu derën e brendshme dhe, pa kthyer as kokën për të parë ç'linte pas, hyri brenda. Nesër, mendoi duke përfytyruar sallat e ftohta, me dosjet përsipër tryezave, që e prisin. Nesër do të ishte prapë atje, në botën e çuditshme, ku koha, logjika e gjërave dhe gjithçka tjetër ecte krejtësisht ndryshe. Dhe në qoftë se do t'i jepnin prapë një ditë pushimi, as që kishte për të dalë më përjashta.

V

ARKIVI

Fill pas pushimit të mëngjesit Ebu Qerimit i thanë se e kërkonte mbikëqyrësi. Me hapa të ngadaltë, për të mos bërë zhurmë, ai iu afrua tryezës së tij, mbi të cilën njoju dosjen që e kishte dorëzuar atë mëngjes.

— Ebu Qerim, — i tha tjetri, — mendoj se ndoshta do të ishte mirë që për njérën nga këto ëndrra, — gishtat e mbikëqyrësit shfletuan me shpejtësi dosjen, — ja ku qenka, — ia bëri ai, kur e gjeti më në fund fletën që kërkonte, — pra mendoj që për njérën prej tyre dhe pikërisht për këtë, — ai e nxori fletën nga grumbulli, — të zbrisje në arkiv për t'u konsultuar me interpretimin që u është bërë ëndrrave të këtij lloji në të kaluarën.

Ebu Qerimi vështroi një copë herë fletën, poshtë së cilës ishte shkruar shpjegimi i ëndrrës sipas tij, pastaj ngriti sytë nga mbikëqyrësi.

— Ti vepro si të duash, — tha tjetri, — po mendimi im është që ta bëje një gjë të tillë. Mua kjo ëndërr më duket e rëndësishme dhe zakonisht në raste të

tilla është i këshillueshëm konsultimi me përvojën e vjetër.

— Pa dyshim, — tha Ebu Qerimi, — as që e vë në dyshim. Veçse...

— Ti s'ke qenë ndonjëherë në arkiv? — e ndërpren mbikëqyrësi.

Ebu Qerimi bëri «jo» me kokë. Mbikëqyrësi buzëqeshi.

— Është një gjë fare e thjeshtë, — tha. — Atje ka njerëz që janë posaçërisht për këtë punë. Do t'u thuash vetëm se e ç'natyre është ëndrra për të cilën kërkon të konsultohesh. Në këtë rast e ke fare të thjeshtë: ëndrrat e shikuara në prag ndeshjesh të përgjakshme janë të gjitha të grumbulluara në një vend. Unë jam i sigurt se një sy i hedhur mbi një pjesë të tyre do të ndihmojë për një zbërthim më të drejtë të kësaj këtu, — mbikëqyrësi trokiti me gisht mbi fletën.

— Pa dyshim, — tha Ebu Qerimi dhe zgjati dorën për të marrë fletën.

— Arkivi është poshtë, në bodrum, — tha mbikëqyrësi. — Pyet nëpër korridore dhe do ta gjesh rrugën lehtë.

Ebu Qerimi doli me hapa të kujdeshëm. Në korridor mori njëherë frymë thellë përpara se të vendoste se në ç'drejtim të duhej të nisej. Më në fund u kujtua se duhej të zbriste njëherë në katin e parë dhe pastaj që atje të niste Kërkimin.

Ashtu bëri. Iu desh gati gjysmë orë sa të gjendej më në fund në bodrumet e Pallatit. Po tanë? tha më vete Ebu Qerimi, kur u gjend i vetëm nëpër një galeri të ulët, të mbuluar me kube, muret e së cilës ndriçohej nga fenerë të zbehtë. Atij iu duk se dëgjoi ca hapa përbri dhe shpejtoi që të arrinte të panjohurin, por hapat e tjegrit u shpejtuanc gjithashtu. Ebu Qerimi ndaloi në vend dhe tjegri gjithashtu ndaloi. Atëherë ai e kuptoi se ata nuk ishin veçse hapat e tij. O zot, ia bëri me vete, përherë e njëjta histori në këtë pallat të

mallkuar. Ç'kushtonte të viheshin tabela të vogla për të treguar vendet? Tani po i dukej se galeria kishte formë rrëthore. Herë-herë ndiente kumbime hapash të largët, por ata mund të ishin jehona e jehonës së hapave të tij, ose hapa të njerëzve që ecnin në kate të tjera. Ebu Qerimi, për çudi, ndihej i qetë. Sido që të ndodhë, do të dilte që këndej ashtu siç kishte dalë edhe herët e tjera. Tani ishte mësuar me këto. Duke ecur, ai zbuloi se galeria rrëthore ndërpritej nga galeri të tjera, disa më të gjera, disa më të ngushta se ajo, por nuk guxoi të futej në asnjëren prej tyre për të mos u ngatërruar më keq. Po vij rrotull si kali në lëmë, tha me vete pas ndonjë gjysmë ore, kur iu duk se galeria rrëthore e solli përsëri në pikën nga qe nisur. Qëndroi një copë herë në vend, mori frymë thellë dhe nisi të ekte prapë më me energji. Këtë herë u kthye në galerinë e parë anësore që i doli përpara Dhe nuk gaboi. Si bëri disa hapa nëpër të, dalloj një portë në njërin mur të saj. Më tutje një portë tjetër. Ja ku qenkan, mendoi i lehtësuar, pa vendosur në cilën prej tyre të trokiste. Eci më tutje dhe kudo, në të dyja anët e mureve kishte dyer. Iu afrua njëres prej tyre, po prapë nuk trokiti. Ja, te kjo tjetra do të provoj, tha me vete, por aty për aty ndërroi mendje. Si do të hynte kështu, pa marrë vesh më parë se ku ndodhej? Më mirë të priste se ndoshta ndonjëra prej dyerive hapej vetë dhe që andej dilte dikush që të mund ta pyeste. Ebu Qerimi mbeti në këmbë, pa ditur q'të bënte. Po sikur të kalonte dikush dhe kur ta shikonte që rrinte ashtu më këmbë si hu t'i thoshte: po ti, q'bën këtu? Hej, bela, tha me vete dhe lëvizi pak. Gjithmonë e njëjta histori. Tani i dukej se qëkurse kishte hyrë në punë në këtë ndërtesë, s'bënte gjë tjetër veçse vërtitej nëpër korridoret e saj, pa gjetur dot atë që kërkonte. Në dreq të vejë, tha më në fund, të dalë ku të dalë dhe, pa e zgjatur më, trokiti në derën e parë që i doli përpara. E tërhoqi dorën aty për aty dhe, po të kishte mundësi të tërhiqte mbrapsht edhe trokit-

jen, do ta bënte, po ani ajo kishte kumbuar tejpërtej. Ebu Qerimi priti disa sekonda, po nga brenda s'u dégjua asnje zë. Ai trokiti për së dyti dhe lëvizi dorezën, po dera nuk u hap. Qenka e mbyllur, mendoi, që u mata e u stërmata përpëra saj. Eci më tutje dhe me kujdes të përgjysmuar trokiti në derën tjetër. Edhe ajo qe e mbyllur. Provoi dyert e tjera me radhë. Të gjitha ishin të mbyllura. Ç'është kështu, mendoi, mos nuk ishte Arkivi ky?

Njëfarë inati i brendshëm e bëri të ecte me shpejt dhe në ecje e sipër, me lëvizje të vrullshme, pa trokitur fare, me njëfarë mlefi, që s'dinte as vetë se nga i vinte, u mëshonte dorezave të hekurta. Kishte një dëshirë të marrë që t'i godiste me shkeln ato dyer memece. Dhe me siguri kështu do të ndodhët, sikur tamam atëherë kur s'e priste njëra nga dyert të mos hapej në një mënyrë të beftë nën shtytjen e tij. Vrulli i Ebu Qerimit ishte i tillë, saqë ai desh u rrëzua. Fluturimthi njëra dorë e tij u zgjat të kapte dorezën, për ta tërhequr mbërapsht, por ishte vonë. Dera qe hapur krejt dhe, sikur të mos mjaftonte kjo, një palë sy krejtësisht të befasuar nga njeriu që kishte shpërthyer ashtu papritmas, me atë ngarendje prej të ç'menduri në dhomën e tij, e vështronin ftohtë.

— Ç'është? — u dégjua një zë tjetër nga thellësia.

Sytë e ftohtë të njeriut e vështronin Ebu Qerimin në një mënyrë pyetëse.

— Më falni, — ia bëri Ebu Qerimi, duke bërë një hap prapa. — Më falni, ju lutem! — Balli i qe mbuluar me djersë të ftohta. — Ju kërkoj ndjesë!

— Aga Shahin, ç'është? — pyeti prapë zëri nga thellësia.

— Asgjë për t'u shqetësuar, — u përgjigj tjetri. — Ç'kérkon? — pyeti ai pa ia hequr sytë Ebu Qerimit.

Ebu Qerimi e kishte humbur fare dhe hapi gojën, pa ditur se ç'fjalë do të nxirrte. Për fat, dora i shkoi te xhepi ku kishte futur letrën.

— Unë erdha për t'u konsultuar me dosjet... siç

vijnë zakonisht... për një ëndërr. Po me sa duket pas-kam hyrë gabim te ju. Më falni, është herë e parë...

— Po ndoshta s'je gabim, — dëgjoi ai zërin e dytë, atë që në filim kishte ardhur që prapa ca raftesh, të cilat vetëm tani po i vinte re. Një ftyrë, që iu duk si e njojur, me ca sy të çelët buzëqeshës, u shfaq më në fund.

— Ju ... — ia bëri Ebu Qerimi me zë të ulët dhe në çast iu kujtua mëngjesi i tij i parë i paharrueshëm në bufenë e Tabir Sarajit, ku kishte njojur këtë njeri.

— Ju punoni këtu?

— Po, këtu punoj. Domethënë më mbajte mend, — tha tjetri, duke e vështruar me dashuri.

— Sigurisht. Megjithëse s'ju kam parë që atëherë.

— Unë të kam parë një ditë në dalje, po ti nuk më vure re, — tha tjetri.

— Ashtu? Kushedi si ka qëlluar. Unë me kënaqësi do të...

— Dukeshe i pikëlluar, — tha tjetri. — Si vete me punë?

— Mirë.

— Në Seleksionim, si gjithmonë?

— Jo, — tha Ebu Qerimi. — Tani punoj në Interpretim.

— Ashtu?! — u habit tjetri. — Paske ecur përpara shpejt. Urime! Më bëhet qejfi, singerist.

— Falemnderit, — tha Ebu Qerimi. — Po këtu, Arkivi është?

— Po Arkivi. Ti ke ardhur për një konsultim, apo jo?

Ebu Qerimi pohoi me kokë.

— Do të të ndihmoj unë.

Arkivist i digka i tha me zë të ulët shokut të vet, në sytë e të cilët ftohtësia ia la vendin një kureshtjeje të madhe.

— Në ç'sektor dëshiron të hulumtosh? — pyeti arkivist.

Ebu Qerimi ngriti supet,

— Ku ta di unë? Është hera e parë që zgres këtu.

— Atëherë po vij unë që të të ndihmoj, — tha arkivist.

— Do t'ju jem shumë mirënjojës, — tha Ebu Qerimi.

Arkivist doli i pari nga kthina dhe Ebu Qerimi e ndoqi pas.

— Ma merrte mendja se do të të takoja një ditë, — tha arkivist, ndërsa ecnin nëpër galeri.

— Në bufë s'ju kam parë asnijëherë, — tha Ebu Qerimi.

— E ku të më shikosh? Atje është një rrëmujë e tillë...

Hapat e tyre kumbonin me një ritëm të çrrëgullt.

— I gjithë ky është Arkivi? — pyeti Ebu Qerimi, duke bërë me kokë nga galeritë e shumta që kryqëzoheshin me njëra-tjetrën.

— Po, — tha arkivist. — Është një labirint i vërtetë, ku mund të humbasësh fare kollaj.

— Sa mirë që ju ndesha ju, — tha Ebu Qerimi, — përndryshe s'di as vetë se ç'do të bëja.

— Do të gjendej dikush që të të ndihmonte, — u përgjigj arkivist. Ai ecte përpara tij pa kthyer kokën dhe Ebu Qerimi i vente pas, i munduar që nuk po gjente dot ca fjalë të përshtatshme për t'i shprehur mirënjojen. — Do të gjendej vërtet dikush aë të të ndihmonte, — përsëriti arkivist, — por unë do të të tregoj krejt Arkivin.

— Ashtu? — ia bëri Ebu Qerimi. ndërsa një valë e re mirënjojjeje, me të vërtetë molisëse, po e përpinte. — Po ndoshta do të humbni kohën, — tha me zë të ulët, — ndoshta është e lodhshme për ju.

— Aspak, — ia preu tjetri. — Është kënaqësi përmua aë më jepet rasti të bëj në gjë kaq të vogël për një mikun tim.

Ebu Qerimi s'dinte ç'të thoshte.

— Në qoftë se Tabir Saraji është si një gjumë në krahasim me jetën, Arkivi është një gjumë edhe më

i rëndë midis Tabirit, — vazhdoi arkivist duke shtyrë një portë. — Me një fjalë, është si një gjumë brenda gjumit.

Ebu Qerimi hyri pas tij në një kthinë të gjatë e të ngushtë, muret e së cilës ishin mbuluar nga raftet të larta gjer në tavan.

— Ka dhjetëra kthina të tillë, — vazhdói arkivist, duke treguar me dorë nga raftet. — I shikon dosjet? Ato janë me mijëra, pér të mos thënë dhjetëra mijëra.

— Dhe të gjitha janë plot? — pyeti Ebu Qerimi.

— Natyrisht, — u përgjigj arkivist duke dalë. — Ne do të kalojmë në të gjitha kthinat dhe do t'i shikojmë.

Ata ecnin nëpër një galeri të ngushtë që Ebu Qerimit iu duk pak e pjerrët. Ca fenerë të largët, me siguri të galerive të tjera, apo të galerisë rrrotulluese, rrezëtinin dobët.

— Këtu është gjithçka, — tha arkivist, duke ngadalësuar hapat. — Më kupton ç'dua të them? Sikur rruzulli tokësor të zhdukej një ditë, me fjalë të tjera, sikur bota të përplasej me ndonjë kometë, të thërrmohej, të avullohej apo thjesht të rrokullisej në humnerë, pra sikur globi ynë të zhdukej pa nam e pa nishan, mjaftonte të mbetej ky bodrum, mbushur më dosje, pér të kuptuar ç'ka qenë kjo botë. — Arkivist ktheu kokën si pér të parë nëse kishin arritur në ndërgjegjen e tjetrit fjalët e tij. — Më kuptove ç'desha të thesha? Asnjë histori, enciklopèdi, libra të shenjtë apo libra të tjerë të mbledhur bashkë, gjithë akademitë, universitetet apo bibliotekat, nuk mund të jep dot të vërtetën e përbledhur të botës sonë, siç e jep ky Arkiv.

— Po a s'është pakëz e përcudnuar ajo? — guxoi të kundërshtonte Ebu Qerimi.

Profili i fytyrës së arkivistit e dha buzëqeshjen më ironike se q'mund ta jepte ndoshta ballë pér ballë fytyra e tij.

— Kush tha se ajo që shohim ne me sy hapur

nuk éshtë e përcudnuar dhe se përkundrazi kjo këtu  
éshtë pamja e vërtetë e gjërave? — Arkivist i ngadalë-  
soi hapat përpara një dere. — Ke dëgjuar pleqtë kur  
psherëtijnë: «Eh, dynja — éndërr»?

Ai e shtyu derën dhe hyri i pari. Kthina ishte  
jashtëzakonisht e gjatë dhe, ashtu si tjetra, i kishte raf-  
tet me dosje gjer në tavan. Madje një grumbull dos-  
jesh, ndoshta për mungesë vendi në rafte, qenë vënë  
drejt e në tokë. Dy njerëz seç bënин midis rafteve në  
thellësi.

— Për se ishte éndrra jote? — pyeti arkivist.

Ebu Qerimi preku me dorë fletën që e mbante të  
palosur në xhep.

— Një éndërr që parandillte shumë humbje jetësh  
në luftë.

— Ah, éshtë fjala për éndrrat e shikuara në prag  
kasaphanash të mëdha. Ato janë në një sektor tjetër,  
po mos ki merak, do të vemi edhe atje. Këta këtu, —  
arkivist tregoi me dorë raftet nga e majta, — janë  
«popujt e vrenjtur», kurse këta këndeje «popujt e çelur».

Ebu Qerimi deshi të pyeste: ç'do të thotë kjo, po  
nuk guxoi. Arkivist i cte midis rafteve dhe Ebu Qe-  
rimi i vente pas. Tjetri ndaloi përpara një rafti që  
kishte bërë bark nga pesha.

— Këtu éshtë kiambeti sipas popujve që e kanë dim-  
rin me erë shumë. — Ai preku me dorë raftin sikur ta  
shtynte më përbrenda, pastaj iu kthye Ebu Qerimit: —  
Nganjëherë interpretuesif që zgresin në arkiv, janë me-  
ndjemëdhenj dhe noprani. Ti më pëlqen se je shumë i  
sjellshëm dhe prandaj kam kënaqësi të t'i tregoj të  
gjitha.

— Ju falemnderit, — tha Ebu Qerimi.

Kthina e gjatë bashkohej me një tjetër nëpërmjet  
një dere fare të ulët. Një erë letre të vjetër, që sa  
vente bëhej më e ndjeshme, Ebu Qerimit i dukej se  
po i vështirësonte frymëmarrjen.

— Ngritja e të vdekurve, — tha arkivist, duke  
treguar me dorë një pjesë të raftit. Allah, ç'tmerre ka

këtu... Po nejse, shkojmë më tej. Kaosi: toka e qielli, të përzier bashkë, — vazhdoi të tregonte ai. — Gjithë këto raftet këtu. Jetëvdekja ose vdekjejeta, thuaje si ta duash. Projekte jetësh me zanafilla femërore. Me zanafilla mashkullore. Shkojmë më tutje. Ëndrrat erotike. E gjithë kjo kthinë dhe të tjera ngjitur me të janë të mbushura me to. Krizat ekonomike, zhvleftësimet e monedhës, renta e çifligjeve, bankat, falimentimet, të gjitha janë grumbulluar këtu. Ja dhe komplotet. Gru-shtet e shtetit, të shtypura që në vezë. Intrigat shtetërore.

Ebu Qerimit i dukej se zëri i arkivistit sa vente bëhej më i largët. Herë-herë, sidomos kur ecnin nëpër galeritë për të kaluar nga njëra kthinë në tjetrën, nuk i dallonte mirë fjalët. Kubeja i vishte ato me një jehonë të dridhshme.

— Tani... ni... ni do të shkojmë ...ojmë... ojmë... ëndrrat e robërisë ...isë ...isë ...isë ... ndrat ...isë.

Kuisjet e dyerve të kthinave e rrëqethnin gjer në palcë Ebu Qerimin.

— Ëndrrat e kohës së parë të robërisë, — tha arkivist, duke treguar raftet, — ose, si i quajnë edhe ndryshe, «ëndrrat e robërisë së parë», për t'i dalluar nga ato të mëvoqshmet, domethënë të robërisë së thellë. Në të vërfetë janë fare të ndryshme. Është si ajo puna e dashurisë së parë, që ndryshon nga të tjerat, he, he. Kurse që këndej e gjer në fund të kthinës janë dosjet e delireve të mëdha.

Deliret e mëdha, përsëriti me vete Ebu Qerimi, pa i hequr sytë nga raftet. Gjer kur do të vërtitej në këtë ferr?

— Dje këtu kanë hulumtuar bashëndrrorët gjer natën vonë, — tha arkivist duke ulur zërin. Dhe s'është për t'u çuditur, sepse këtu mund të gjesh hatarat më të mëdha, duke nisur nga ato që disa popuj kohët e fundit i quajnë «rilindje kombëtare» të tyre, më kupton, jo ringjallje e një të vdekuri, por e një kombi të tërë, e gjer në gjëra që as goja s't'i thotë dot. Nejse,

ikim më tutje. Ja dhe sektori që të duhet ty. Ëndrrat në vigjilje gjakderdhjesh, në mqs gaboj, apo jo?

— Po, — ia bëri Ebu Qerimi.

— Këtu i ke rresht dosjet e tyre. Në përgjithësi janë ëndrrat e para në natën para betejave të mëdha, madje një pjesë ndaj të gdhirë. Beteja e Kërç-Kilisë, Beteja e Bajazit Jelldremit me Timur Lengun. Dy fushatat e Hungarisë.

— Beteja e Kosovës është këtu? — pyeti me zë fare të ulët Ebu Qerimi.

Arkivist i ngriti qepallat.

— Ajo e vjetra, e vitit 1389, në mos gaboj, kundër gjithë Ballkanit të bashkuar?

— Pikërisht, — tha Ebu Qerimi.

— Me siguri këtu do të jetë. Prit pak.

Ai i ktheu shpinën Ebu Qerimit dhe u zhduk midis rafteve që mend rrëzoheshin nga pesha, për të gjetur, siç duket, nëpunësin që shërbente në atë kthinë. U kthye shumë shpejt bashkë me të.

— Këtu i ke rrëth shtatëqind ëndrrat e saj, të para në të gdhirë të ditës fatale, — tha arkivist, duke vështruar herë Ebu Qerimin, herë nëpunësin e sektorit, koka thatime e të cilit pohonte çdo fjalë të tij.

— Duhet të kenë qenë më shumë, por me siguri kanë humbur, — foli nëpunësi me një zë fare të hollë.

— Edhe ato që janë ruajtur, një pjesë janë gjysma-gjysma, ashtu siç mundën të shkruheshin shpejt e shpejt herët në mëngjes.

— Ashtu? — ia bëri Ebu Qerimi, pa e kontrolluar veten. Në shtëpi kishte dëgjuar shpesh të flitej për atë betejë tragjike.

— Edhe bashëndrra ashtu u zgjodh, më ngut, për t'ia çuar sulltanit në çadër, me të gdhirë dita, — vazhdoi nëpunësi.

— Arritën të zgjidhnin edhe bashëndrrën? — tha Ebu Qerimi, krejt i topitur.

— Pa dyshim. Si do të bëhej ndryshe?

— Është këtu ajo?

— Jo, atë e keni në kthinën e bashëndrrave, bashkë me të tjerat.

— Do të shkojmë edhe atje, mos ki merak, — tha arkivist.

— Unë mund t'ua them pak a shumë si qe ajo, — tha nëpunësi, me zë akoma më të këputur. — Natyrisht në qoftë se e dëshironi.

— Po, më intereson ta di, — tha Ebu Qerimi.

Arkivist e pa një grimë dhe uli qepallat me mirëkuptim. Natyrisht që të intereson ta dish, thoshte shikimi i tij. Ti je një Qyprilli.

— Një nga ushtarët kishte parë shokun e vet, vdekur para ca kohësh, që e ftoi me dorë që pas një ledhi. Ç'bëni ju andej, i tha, a nuk mërziteni atje, pse s'vini me ne, këndeja jemi të shumtët, — shpjegoi nëpunësi, me zérin që do të besoje se vinte vërtet nga bota tjetër. — Kjo do të thoshte se dita do të ishte tejet e përgjakshme, ashtu siç qe vërtet.

— O zot, s'ishte shaka, — ndërhyri arkivist. — Atje u thyte përjetë krejt Ballkani.

Ebu Qerimi vështronte herë njërin, herë tjetrin.

— Atë luftë akoma edhe sot, pas gati pesë shekujsh, ballkanasit e shohin në ëndërr shpesh, — tha nëpunësi.

— Një shok imi, që punon te «popujt e vrenjtur» ma ka thënë.

— Është e kuptueshme, — tha arkivist, pa ia hequr sytë Ebu Qerimit.

— Dëshironi të hapim dosjet? — pyeti nëpunësi.

— Jo tani, — tha arkivist. — Ne do të kthehem pas pak, apo jo? — iu kthyte ai Ebu Qerimit. Ta shikojmë njëherë krejt Arkivin, pastaj ti mund të kthehesë e të rrish këtu sa të duash.

— Mirë, — tha Ebu Qerimi.

Ata dolën prapë në galeri, ku zëri i arkivistit vinte i dyzuar nga jehona.

— Tani ...ni ...do të shohim ... oh... im...oh...,oh...,oh...,im... arkeoëndrrat ...ëndrrat ...osmane...,ane...

— Çfarë? — pyeti Ebu Qerimi kur hynë në një derë dhe arkivistit iu kthyte e folura normale.

— Endrrat e vjetra osmane, — u përgjigj tjetri. — Endrrat fillestare të themeluesve të perandorisë, ose arkeoëndrrat, siç quhen ndryshe.

— Vallë janë ruajtur? — pyeti Ebu Qerimi.

— Në njëfarë mënyre, — tha arkivist, — aq sa mund të ruhen muraleet e vjetra. Ja ku janë, ato dosjet atje.

Ebu Qerimi përshëndeti me kokë nëpunësin e hesh-tur, që u shfaq midis rafteve.

— Janë të pakta, ndaj edhe më të qmuara, — vazhdoi arkivist. — Çështë e vërteta, prej tyre mund të kuptosh fare pak, kaq të përgjysmuara kanë mbërritur gjer në kohën tonë. Megjithëse disa herë janë bërë restaurime në to, siç restaurohen afreskat e moçme, ato prapë ashtu kanë mbetur, ca pamje të shkëputura, pa lidhje. Megjithatë janë të shenjta, sepse kanë qenë gurët e themelit të shtetit. Tek ato vijnë e zbresin shpesh interpretuesit e sotëm për t'u konsultuar me zërthimet e tyre. Apo jo, Fuzuli? — iu drejtua ai në-punësit.

— Ashtu është, — tha nëpunësi. — Edhe mbrëmë gjer vonë kanë qenë.

— Nga sektori ynë? — pyeti Ebu Qerimi.

— Nga Bashëndrra. Atje punoni ju?

Ebu Qerimi u skuq.

— Jo, — tha, — unë punoj në Interpretim.

— Bashëndrrorët mbrëmë paskan qenë kudo, — tha arkivist, me një zë që Ebu Qerimit iu duk i me-ndueshëm.

— Falemnderit, Fuzuli, — i tha ai nëpunësit dhe doli i pari nga dera. — Prej këtyre arkeoëndrrave nje-riu është vështirë se merr gjë vesh, qofshin ato dhe të restauruara, — vazhdoi t'i thoshte arkivist Ebu Qerimit. — Kam parë disa prej tyre dhe më janë dukur krejt të çngjyrosura, si ata qilimat e vjetër, ku s'dallohet më asnjë figurë. Megjithatë interpretuesit rrinë me orë të tëra mbi to. — Arkivist qeshi me vete. — Po

unë e shpoj hundën, në qoftë se edhe ata marrin gjë vesh. Rrinë ashtu kot së koti, gjoja vrasin mendjen për kuptimet e fshehta të saj, kurse në të vërtetë mendja u shkon te telashet e shtëpisë, te rroga që s'u del, apo në kushedi q'halle të tjera. Ja më në fund edhe bashëndrrat.

Ebu Qerimi u drodh, sikur tjetri t'i kishte treguar një fole gjarpërjinjsh. Vegse ato helmin e kishin nxjerrë prej kohësh. Megjithatë, edhe ashtu, ishin të frikshme.

— Janë rrëth dyzet mijë gjithsej, — tha arkivist i dëshifruar aty për aty pshérëtiu: — Allah! — Ebu Qerimi pshérëtiu gjithashtu. — Dhe tani do të shikojmë ëndrrat e sovranëve, — vazhdoi tjetri.

Ebu Qerimi priste të futej në ndonjë kthinë të jashtëzakonshme, por ajo ishte njëlloj si të tjerat. Edhe raftet, dhe gjithçka tjetër, ishte njëlloj, me të vetmin ndryshim, se dosjet kishin përsipër nga një vulë mbretërore. Nën të ishin shënuar emrat e mbretërve. «Gjumi i sultani Muratit I», «Gjumi i sultani Bajazitit», «Gjumi i sultani Mehmetit II», «Gjumi i sultani Sulejmanit të madhnueshëm». E kështu me radhë.

— Këto dosje s'mund të hapen vegse me urdhër të sovranit, — tha arkivist me zë të ulët. — Kush e thyen rregullin, i shkon koka. — Dhe ai lëvizi pëllëmbën e shtrirë të dorës përparrë qafës së vet.

Pasi dolën që andej, ata kaluan nëpër kthinat e tjera, ku ishin ëndrrat e popujve gjaurë, ato të robërisë së thellë, ankthet që zinin përfshi tri kthina, halucinacionet, për të cilat për një kohë të gjatë ishte diskutuar nëse duhej të shqyrtoheshin apo jo nga Tahir Saraji, si edhe gjumi i të qëndururve, kthina e fundit e arkivit.

— Ja, tani ti ke pak a shumë një ide se q'është arkivi, — tha arkivist, ndërsa po dilnin nga kthina e fundit.

Ebu Qerimi e vështroi me ca sy sikur po kërkonte mëshirë. Ata u kthyen prapë te raftet ku ishte dosja e luftës së Kosovës dhe atje u ndanë.

— Kur të mbarosh punë, ec nëpër këtë galeri, gjer-

sa të dalësh në galerinë rrethore, — i tha arkivist. — Atje, në qdo drejtim që të ecësh, shkallët do të të dalin vetë përpara.

Nëpunësi i shërbimit i tha Ebu Qerimit të ulej në një tryezë të vogël dhe i vuri përpara dosjen. Me gishta të mpirë, Ebu Qerimi nisi të shfletonte letrat e vjetra të trasha, nga ato që s'përdorëshin më prej kohësh. Ato ishin pothuajse të gjitha të dëmtuara vendevende. Boja e shkrimit gjithashtu qe zbehur, shumë fjalë mezi lexoheshin. Ebu Qerimi ndjëu papritur një dhembje të mprehtë koke, sikur dikush ta kishte goditur me sëpatë. Sytë iu bënë miza-miza. I mylli një copë herë për të pushuar, pëstaj i hapi përsëri. Nisi të lexonte ngadalë, pa u përqendruar dot. Diçka ia largonte kuptimin e tekstit, ia bënte të dridhshëm, ashtu siç i kishte ndodhur me kumbimin e fjalëve të arkivistit, kur kishin kaluar nën kubetë e galerive. Megjithatë arriti ta detyronte veten të përqëndrohej. Gjuha ishte e vjetër, shumë fjalë s'i kuptonte sidomos renditja e tyre në fjali ishte e panatyrshme, si një lëvizje gaforresh. Por edhe me kaq duhej të ishte i kënaqur. Ishte hera e parë që lexonte tekste kaq të vjetra. Dhe s'ishte një vjetërsi dosido, por gati pesëshekullore. Dalngadalë, i shtyrë nga kënaqësia që diçka po kuptonte, Ebu Qerimi po shtyhej në lexim përherë e më me lehtësi. Shumica e ëndrrave ishin fare të shkurtra, gjithsej dy-tre rreshta. Kishte edhe me nga një rresht, kështu që leximi i dosjes s'ishte ndonjë gjë aq e tmerrshme, siç iu duk në fillim. Madje, sikur të mos ishte interpretimi poshtë tekstit, leximi do të ishte një punë disaorëshe.

Për çudi, Ebu Qerimi ndjeu t'i davaritej lodhja. Përherë e më tepër syri po i mësohej me atë stil shkronjash që s'përdorej prej kohësh. Madje edhe ajo renditje e panatyrshme e fjalëve tanë po e tërhiqte. Dalngadalë ata rreshta të kursyer, ashtu të dëmtuar e gjysma-gjysma siç ishin, po e thëthinin në botën e tyre. Fusha e Kosovës, në Shqipërinë Veriore, ku ai s'kishte qenë kurrë, po shpalosej ngadalshëm në përfyty-

rimin e tij, ashtu e ëndërrt dhe e paqëndrueshme, sic mund të jetë dekor i ngritur nga disa qindra tru të fjetur. Dhe sikur të mos mjaftonte kjo, ato pamje te mjegullta e pa kuptim të saj shoqëroheshin nga interpretimi, që i bënte edhe më të palëndëta. Megjithatë ai prodhim i përbashkët i atyre qindra truve të fjetur veç e vec, ndoshta për shkak të ankthit të përbashkët të ëndërrparësve, para gdhirjes së ditës fatale, apo ndoshta për arsyet e ankthit të njerëzve që qenë caktuar për regjistrimin shpejt e shpejt të ëndrrave, pra gjithë ajo tablo laramane kishte njëfarë uniteti të çuditshëm. Qysh më parë, në kohën që s'ishte qullur veçse nga vesa, në gjumin e ushtarëve, fusha kishte arritur të mbushej me pellgje të mëdha gjaku, që trashej e nxihej me thyerjen e ditës, ndërsa mbi pellgjet më të herët me rriddhnin currilat e gjakut të ri, me ngjyrë më të çelët, që errej dalngadalë, por megjithatë jo aq sa të mos dallohej nga gjaku më i vjetër. Pastaj mbarimi i luftës, në muzg, thyerja e ballkanasve dhe vrasja e sulltanit prej tyre, tamam në çastin që po i gjëzohej fitores. Dhe çadra ku e çuan trupin e sulltanit të vrarë, vdekjen e të cilit e mbajtën fshehur nga ushtria, dhe vezirët të mbledhur kokë më kokë, pastaj lajmësi që shkonte për të thirrur njërin nga të dy bijtë e sulltanit, Jakub Çelebiun. Eja, se të kërkon babai i lavdishëm. Ecja e primit drejt çadrës ku kujtonte se babai e kishte thirrur vërtet, hyrja në çadër dhe vrasja e tij me sëpatë, me gjakftohtësi, prej vezirëve, për të mos pasur luftë për pushtet midis të dy bijve...

Ebu Qerimi fërkoi sytë, si për të hequr që andej një napë. Si kishte qenë vallë e vërteta dhe a mund që kjo të merrej vesh kur themellet e saj fillonin në ëndërr? Aq më tepër që s'kishte një kufi midis ëndrrës dhe realitetit, por gjithçka në atë fushë, harta e saj, koha, faktet, dëshmitë qenë përzier bashkë. Shpirtrat e treqind mijë ballkanasve të bardhë përbënин një borë të pafundme, që vërtitej e vërtitej mbi tokë, në mundimet e fundit, për të braktisur këtë botë. Përse vraponte

sulltani i madh, si i përgjumur, mëdis asaj shtjelljeje të imarrë, sikur dëshironte të ikte bashkë me ta? Ku vete ashtu, padishah, përmendu, kishte thirrur në gjumë jeniceri Selim dhe, pasi qe zgjuar, kishte vrapuar të rrëfente ëndrrën e vet. Më tutje princi i përgjakur Jakub Çelebiu endej ngadalë fushës në formën e një kali oë i kishin rënë jelet. Dhe prapë pellgje gjaku, dhe vera, dhe dimri, dhe kohërat të përziera me njëra-tjetër, dhe ishte mbi atë fushë edhe shi, edhe diell, edhe borë e blerim, e lule, e shkreti dimri njëherësh. Dhe do të duhej të binte shi me javë të tëra, madje me muaj, pa e larë dot atë gjak, dhe pastaj do të duhej të zbardhë dëbora tejembanë, që të dukej se u mbulua më në fund ai makth. Por në pranverën tjetër, kur rrëkezat të rridhnin poshtë dëborës, ato do të merrnin me vete copëra gjaku të ngrirë. thuase dëbora do të qe me plagë. Dhe kështu, o allah, çdo mot, dhe kështu në dimër e në verë, nën erën dhe shiun e memectë, ajo fushë atje, në Shqipérinë Veriore... Ebu Qerimit iu kujtua papritur se atë natë ishte i ftuar për darkë te veziri, bashkë me nënën. Ishte darka tradicionale ku do të dëgjoheshin rapsodët e ardhur nga Ballkani. Me siguri, bashkë me bosnjakët do të ishin dhe rapsodët shqiptarë, të ftuar prej Kurtit.

Ebu Qerimi mbylli dosjet dhe u ngrit. Koka i dhembte nga leximi, apo ndoshta nga era e qymyrgurit që në bodrumë ndihej më shumë se në katet e sipërme. Ai përshëndeti me kokë nëpunësit e shërbimit dhe doli. Hapat e tij nisën të kumbonin vëtmueshëm nëpër galeri. Sa mund të ishte ora vallë? S'kishte asnijë ide. Atje lart mund të ishte kohë dreke, ashtu siç mund të ishte mbasdite, madje edhe mbrëmje. Një çast e kapi shqetësimi: po sikur t'i bëhej vonë për darkë? Pastaj prapë e qetësoi veten: S'mund të kishte rrjedhur koha kaq shpejt. Darka i dukej se qëndronte diku lart, në një botë tjetër, gati në re. Kurse nga të dvja anët çoheshin muret e shurdhëta të galerive, prapa të cilave në mijëra e mijëra dosje ishte gjumi i botës. Ebu Qe-

rimi i ndiente qepallat tē rēnduara. Ç'është kështu? ia bëri dy-tri herë me vete. Ç'ishte kjo përgjumje që po i moliste gjymtyrët? U rrëqeth prej tmerrit, por aty pér aty e qetësoi veten: ishte me siguri era e qymygruit që i jepte gjumë. Ne jemi tē shumtët këndeja. Ç'bën ti atje, o i vëtmuar, pse s'vjen me ne...

Ebu Qerimi shpejtoi hapat pér tē dalë sa më parë nē galerinë rrëthore, por ajo s'po dukej asgjékund. Sa më tutje që shkonte, aq më tepér i dukej se po ngatërhojej. Po sikur tē këpuatej e ta zinte gjumi nē një nga këto galeri tē shkreta? Qepallat prapë i ndiente tē rënda plumb. Ç'm'u desh që zbrita këtu, mendoi. Shpejtoi hapat edhe më, pastaj, nisi tē vraponë. Kumbimi i hapave tē shumëfishuar prej jehonës e lemerisi edhe më. Nuk do tē flë, thoshte me vete. Nuk bie nē kurthin tuaj.

Kushedi sa do tē vazhdonte ky vrap i gmendur, sikur nē një kryqëzim galerish tē mos i dilte pérpara një njeri.

— Ç'është? — pyeti tjetri me një zë jo tē qetë. — Ç'ka ndodhur?

— Asgjë, — tha Ebu Qerimi. — Ku është dalja?

— Je dyllë i verdhë nē fytyrë. A u mor vesh ç'po ndodh?

— Çfarë? — ia bëri Ebu Qerimi. — Unë po kërkoj daljen.

— Thashë se dije gjësенд. Fytyra tē është bërë baltë.

— Ndoshta nga era e qymyrit, — tha Ebu Qerimi.

— Kurse unë thashë se...

— Ku është dalja?

— Këndeja, — tha tjetri.

Ebu Qerimi donte t'i thoshte: po ti vëtë e ke fytyn si qiriri, përse tē bëri përshtypje imja, mirëpo ai s'deshi tē ndalej më asnjë grimë nē atë vend. Të dal sa

më parë që këndejej, o perëndi, rënkonte me vete. Të ngjitem nga ky pus.

Më në fund i dolën përpara shkallët dhe ai i ngjitti ato nga tre e nga katër. Kur u gjend në katin e parë, i merrej fryma. Iu duk se dëgjoi zhurmë. Ktheu këken pas dhe, për habinë e tij, pa një grumbull njerëzish me xhybe të gjata, që po largoheshin me shpejtësi në thellësi të korridorit.

Në katin e dytë u ndesh me një grumbull tjetër njerëzish me fytyra të zymta. Nga largësitë e galerive dëgjoheshin zhurma të tjera hapash. Ç'ishte vallë kjo lëvizje? pyeti ai me vete dhe i erdhi ndër mend njeriu që kishte takuar në galeritë e arkivit. Dukej sikur në Tabir Saraj diçka po ndodhë. Shpejtoi hapat për të arritur sa më parë në Interpretim. Hirrosja e xhamave të dritareve tregonte se dita po thyhej.

— Ku ishe? — i tha fqinji që punonte në një tryezë me të. — Ku humbe gjithë ditën?

— Në arkiv, — u përgjigj Ebu Qerimi.

Sytë e tjetrit ishin të hapur jashtë mase. Kishte një javë që e kishin sjellë të punonte përbri tij, dhe Ebu Qerimi ishte tashmë i bindur se pasioni kryesor i jetës së tjetrit ishin kureshtitë, sidomos ato politike, të thëna vesh më vesh, të ndaluara dhe të rrezikshme, madje rrezikshmëria ishte salca, që i bënte më të shijshme. Ishte me të vërtetë një çudi se si gjer atëherë ende nuk e kishte marrë vesh që Ebu Qerimi ishte një Qyprilli.

— Diçka po ndodh, — tha ai, duke u afruar i gjithi nga ana e majtë e Ebu Qerimit. — A nuk e ndien?

Ebu Qerimi ngriti supet.

— Në korridor kishte njëfarë lëvizjeje, tjetër gjë s'di, — u përgjigj.

— Tri herë e thirrën shefin tonë dhe të tri herët u kthyen me fytyrë të llahtarisor. Pak përpara porsa e thirrën për herë të katërt dhe ende s'është kthyer.

— Ç'të jetë vallë? — tha Ebu Qerimi.

— Ku ta dish? Çdo gjë mund të jetë, — tha tjetri.

Ebu Qerimi donte t'i thoshte për njeriun me fytyrë të trembur që kishte parë në arkiv, por kjo do të shkaktonte një valë të re pëshpërimash midis tyre. Atij i erdhën ndër mend fjalët e arkivistit për bashëndrrorët që kishin rrëmuar gjithë natën në arkiv. Ishte e qartë se diçka po ndodhë.

— Çdo gjë mund të ndodhë, — dëgjoi Ebu Qerimi pëshpërimën e fqinjit. Që të mos binte në sy, ai përpiquej të fliste pa e kthyer kokën nga Ebu Qerimi, duke shtremberuar vetëm cepin e gojës, si për t'i dhënë drejtimin rrjedhës së murmurinës. — Mund të ndodhë çdo gjë, — përsëriti, — që nga pushimet e nëpunësve nga puna e gjer në mbylljen e Pallatit

— Në mbylljen e Tabir Sarajit? — tha Ebu Qerimi.

— E pse jo? Një shqetësim i tillë... Kjo ecejakë e dyshimtë korridoresh... Unë kam vite që punoj në Tabir Saraj dhe ia di huqet atij... Dita e sotme s'më pëlqeu fare. Në një ditë të tillë mund të presësh çdo gjë...

— Ka ndodhur ndonjëherë që Tabiri të jetë mbyllur? — pyeti me zë të dridhur Ebu Qerimi.

— Hm, ç'pyetje, — ia bëri nëpër dhëmbë tjetri. — Po të vijë puna gjer atje, atëherë vaj halli... Po nejse, unë e kam parë atë në ditë të zeza, kur sovrani, me dekret të veçantë, ka ndërprerë marrjen parasysh të ëndrrave. Një gjë e tillë ndoq rrallë, shumë rrallë, më kupton? Merren parasysh vetëm ëndrrat e sovranit. Tabir Saraji atëherë bie me të vërtetë në zi. Ai i ngjan më tepër një gërmadhe ku nëpunësit enden si hije korridoresë. Çdo gjë duket sikur po shuhet, po jep shpirt. Të gjithë, me gjak të ngrirë, presin mbylljen e tij. Zaten, këtë gjendje zie, nga mbyllja, një fije e ndan.

Ebu Qerimi ndjeu ankthën t'i ngjitej nëpër trup nga zgavra e stomakut. Turbull po i kujtoheshin fjalët e vezirit. Mos vallë ky ishte ai çasti që ai e kishte përmendur në bisedë duke mos e bërë të qartë asnjëherë

gjer në fund? Fqinji vazhdonte të fliste, por ai s'e dëgjonte më. Tëmthat i buçitnin, mendimet po i bëheshin lëmsh... Në bisedat e pafundme për Tabir Sarajin, ash tu sikurse në bisedën e turbullt të vezirit, Ebu Qerimi kishte kuptuar se, sa më keq t'i kishte punët Pallati i Endrrave, aq më mirë ishte për Qyprillinjtë. Pra, rrjedhimisht, sa më e zezë të ishte kjo ditë për Tabirin, aq më i gjëzuar duhej të ndihej ai. Duhej të ndihej... Megjithatë s'ishte aspak kështu. Kjo pasiguri përreth s'i jepte asnjë gjësim, përkundrazi i drithëronte eshtat.

Ai i vuri veshin mumurimës së fqinjit, por prej asaj ishte vështirë të mërrte vesh ndonjë gjë. Dukej se tjetri fliste më tepër për vetveten, sesa për të. Iu kuj tua gjyshja e tij, kur e kishte pyetur njëherë: nëno, pse pshërëtin me zë të lartë? Që të bëhem dy, biro, i kishte thënë ajo, që të mos ndihem vetëm. Ebu Qerimi ndjeu dëshirë të pshërëtinte me zë, ashtu si gjyshja dikur. Ishin aq të vetmuar mbi ato tryeza të ftohta, sipër të cilave shpaloseshin pamje gjysmë të çmendura trush të huaj, pa asnjë lidhje me njëri tjetrin.

— Po pse? — e ndërpren Ebu Qerimi, me një zë fare të mekur, gurgullimën murmuritëse të tjetrit. — Pse vallë ndodh kjo?

— Pse ndodh kjo? — Ebu Qerimit iu duk se cepi i gojës së shtrembëruar të tjetrit, në vend të fjalëve, nisi drejt tij currilën e një kuzëqeshjeje të akullt. — O zot, si mund të bësh pyetjen «pse?» në këtë Pallat? — tha ai. — A mund të dihet kurrë «pse» -ja e gjërave këtu?

Ebu Qerimi pshërëtiu. Nga errësimi i plotë i xhamave të dritatereve kuptohej që përjashta kishte rënë plotësisht nata. Drita e fenerëve ndriçonte dobët ballet e njerëzve të përkultur mbi tryeza.

— Ja shefi, — dëgjoi Ebu Qerimi zërin e fqinjit, — u kthyesh!

Ebu Qerimi vështroi andej.

— S'më duket aq i prishur në fytyrë siç the ti, — tha me një fije zëri.

— Ashtu? — Tjetri heshti ca çaste. — E di që ke të drejtë? Edhe mua s'po më duket më ashtu. Ishalla ka ndonjë lajm të mirë.

Ebu Qerimi ndjeu kthethrat e ankthit në stomak.

— Madje më duket i gjuar, — tha.

— S'mund ta them atë, por sidoqoftë fytyrën e ka më të çelur.

— Sa të mbarojë kjo ditë, — tha Ebu Qerimi, pa i hequr sytë nga fytyra e shefit. Në sytë e tij iu duk se pa një ndriçim të ethshëm. Zot, mbrona! tha me vete.

— Dita do të mbarojë, po n'e a do të largohemi vallë? — tha fqinji.

— Si? — ia bëri Ebu Qerimi.

— Në ditë të tilla, ti e kupton edhe vetë, mund të gdhihemi këtu.

Ebu Qerimit iu kujtua darka dhe desh i tha: po unë jam i ftuar sonte te veziri. Sido që të jetë, do të kërkoj leje të iki. Dhe vërtet, a do të guxonin ta ndalonin atë të shkonte për darkë te kushërir i fuqishëm? Ebu Qerimi fërkoi ballin me dorë. Mos ndoshta të gjitha këto ishin marrëzira? Në fund të fundit, s'ishin vëçse dyshime të parakohshme, «ca njerëz në korridor», fytyra e shefit, që një herë ishte dukur e prishur dhe një herë e çelur. O zot, po si mund t'i besonte shenjave të tilla! Fqinji i tij ishte më të vërtetë i marrë që ia kishte ngjitur atë dyshim.

Zilja e mbarimit të orarit e bëri Ebu Qerimin të dridhej. U panë sy më sy me fqinjin dhe Ebu Qerimi aty për aty deshi t'ia përplaste në fytyrë: Idiot, më prishe gjakun kot së koti, kjo është një ditë e zakonshme si gjithë të tjerat, ja dhe zilja po bie në orën e caktuar si përherë, ç'pate që më kalle datën, o idiot.

Fqinji e mbylli i pari dosjen dhe, duke i hedhur një shikim, sikur të thoshte: ik sa më parë, nga sytë këmbët! u largua me shpejtësi. Ebu Qerimi doli pas tij.

Korridoret dhe shkallët ishin plot. Zhurma e hapave, e shurdhër, anonime, dukej se do të tradte nga themellet gjithë ndërtesën. Ebu Qerimi i futi hapat e tij në atë mori këmbësh me qetësimin që ndien njeriu i trembur kur fshihet midis turmës. Dy-tri herë iu duk se ky ishte një mbarim dite fare i zakonshëm dhe po aq herë iu duk se ishte krejt e kundërtë. Me bisht të syrit vështron te profilet e njerëzve, te mollëzat e të cilëve i dukej se gjente përndritjen e një etheje, prushi i së cilës ishte thellë kafkave të tyre. S'ishte thjesht ngazëllim, ishte më tepër një dridhje padurimi përpëra së panjohurës. Marrëzira, tha me vete pas pak, asgjë të tillë s'kishte në ato fytyra të mekura nga lodhja dhe përcartja e ëndrrave. Të gjitha s'ishin veçse pjellë e nervave të tij të dobësuara.

Pas daljes nga portat e jashtme ai qe shkëputur nga turma e nëpunësve dhe sa më tepër që largohej, aq më shumë i dukeshin pa kuptim dyshimet e tij. Më prishi gjakun ai maniak, tha dy-tri herë me vete. Ishte vërtet për të qeshur ajo që kishte ndodhur midis tyre.

Ebu Qerimi kërkonte me sy mos gjente ndonjë karrocë për ta bërë rrugën sa më shpejt. Kishte frikë mos vonohej në darkë. Dy-tri herë ngriti krahun për t'i dhënë shenjë karrocave të ndalonin, po karrocierët ose nuk e vinin re, ose s'kishin vend. Ebu Qerimi s'ishte nga ata që mund të ulërinte që nga trotuari. «Ej, karrocal». Pranonte më mirë ta bënte udhën më këmbë nëpër shi e dëborë, sesa të lëshonte britma të atilla. Shqyr që kalimtarët nëpër trotuare ishin më të rrallë se ditët e tjera, kështu që mund të ecte më shpejt se zakonisht. Në qoftë se rruga gjer në shtëpi do të ishte kështu, gjysmë e shkretë, atëherë do t'i mjaftonte koha plotësisht jo vetëm të ndërronte veshjen për darkën, por të bënte edhe një banjë.

I dhënë pas këtyre mendimeve, Ebu Qerimi po-thuajse e kishte harruar frikën e pakmëparshme, kur dikë, që as ai s'e kuptoi ç'ishte, një britmë e vogël habie, një shpejtim hapi, apo një pëshpërimë përbri, e bëri të

ngrinte kokën e të vështronte sheshin e udhëkryqit. Dy patrulla ushtarake rrinin mu në mes të tij, duke vështruar vëngër kalimtarët. Ç'të ishte vallë kjo? Ebu Qerimi nuk arriti të mendonte asgjë, kur sytë i zunë një patrullë tjetër më tutje dhe pastaj një tjetër. Rruga qenka plot me ushtarë, mendoi. Ankthi, prej të cilit i ishte dukur se qe çliruar më në fund duke dalë nga Pallati i Endrrave, po e ngërthente përsëri. Edhe kalimtarët e tjetër me bisht të syrit vështronin patrullat. Disa kthenin kokat pas, për t'i parë edhe një herë ndërsa largoheshin.

Ndoshta është një rastësi, tha me vete pas pak, kur nuk pa më asgjékund patrulla të tjera. Njerëzit hynin e dilnin nëpër pijetoret e vogla ndanë rruge dhe kurrikund nuk ndihej ndonjë shenjë alarmi. Ja dhe kafe-neja «Netët e Ramazanit», ku, si zakonisht, kishte muzikë. Me siguri ishte një rastësi, përsëriti me vete për të dhjetën herë. Zaten në atë shesh edhe një herë tjetër kishte parë patrulla ushtarake. Madje i kujtohej se bënин edhe kontroll. Po, po, ishte me siguri një rastësi. Aq më tepër që aty pranë ishte Banka Qendrore dhe, kushedi, ndonjë dyshim për vjedhje, ose paralajmërim...

Te Ministria e Financave Ebu Qerimit iu duk se rojat ishin shtuar, por s'pati guximin të kthente kokën për të vështruar më mirë. Fenerët ishin të zbehtë dhe ai murmuriti: «në dreq të venë», pa e ditur as vetë se kundër kujt shfryu ashtu. Drithëtira, që u përpoq ta largonte prej vetes, po e kapë përsëri. Kur u gjend përpara Pallatit të Sheh-ul-Islamit, u bind se asgjë nuk ishte rastësi dhe se diçka po ndodhë vërtet. Një grumbull i madh ushtarësh e policësh, gati një gjysmë batalioni, nxinin përpara kangjellave të hekurta. Diçka po ndodh, përsëriti me gjysmë zëri. Diçka... po ç'të jetë vallë? Komplot? Përpjekje për grusht shteti? Shtetrrethim? Deshi të shpejtonte hapat por s'mundte. Një pjesë e ankthit kishte zënë vend te gjunjët. Shpejt, përsëriste me vete, ik shpejt, por e ndiente se gjithçka ishte e kotë. I erdhi ndër mend darka dhe zakoni i moçmë, i

përmendur madje edhe në epos, se te Qyprillinxjë darrat nuk anuloheshin kurrë.

Te Ura e Gjysmëhënës pa përsëri ushtarë me kaska, por tani gjendja e tij ishte e tillë, që as mund të rëndohej, as mund të lehtësohej më. Ja rruga e tij, drurët e errët të gështenjave, dritëzat e katit të dytë të shtëpisë. Përpara portës dalloi që larg siluetën e karrocës dhe, kur u afrua edhe më, shqoi «Q»-në e gdhendur te dera e saj. Mori frysme disi i lehtësuar dhe hyri brenda.

## VI

### D A R K A

Ebu Qerimi nuk i tha asgjë së emës, për të mos e shqetësuar, megjithatë, kur pas një ore hipën të dy në karrocë për të shkuar te veziri, ai nuk u përmbjajt dot:

— Sot në Tabir Saraj ka pasur një farë shqetësimi.  
— Si? — ia bëri ajo, duke i kapur dorën. — C' shqetësim? Përse?

— S'mora dot vesh asgjë të saktë. Edhe në rrugë më zuri syri patrulla ushtarake.

Ai ndjeu dorën e saj të dridhej në të tijnë dhe në çast u pendua që i foli.

— Po mbasë s'është gjë, — tha. — Mbase të gjitha ato që pëshpëriteshin s'ishin veçse marrëzira.

— C' pëshpëriteshin? — pyeti ajo me një fije zëri.  
— Budallallëqe! — Ebu Qerimi u përpoq ta bënte sa më mospërfillës zërin. — Thuhej se sovrani ka kthyer mbrapsht bashëndrrën e djeshme. Po ndoshta kjo s'ishte

aspak e vërtetë. Ndoshta shkaku i turbullirës ishte tjetër gjë.

Midis heshtjes kërkëllima e rrrotave të karrocës dukej e padurueshme.

— Në qoftë se sovrani ka kthyer bashëndrrën, kjo s'është gjë e paktë, — tha nëna.

— Po të thashë, ndoshta s'është ajo.

— Aq më keq, atëherë. Do të jetë diçka tjetër, akoma më e rëndë.

S'duhej t'ia kisha thënë, mendoi Ebu Qerimi.

— E q'mund të ishte më e rëndë? — tha ai me po atë zë mospërfillës.

E ëma pshërëtiu.

— Kushedi?! Unë si di mirë ato punët tuaja atje. Po ti vetë më ke treguar për gabimet e mundshme në interpretim, për inspektimec e befta. Ebu Qerim, më thuaj të drejtën, ti vetë mos je futur në ndonjë ngatërrsë?

Ebu Qerimi u përpooq të qeshte.

— Unë? Unë as di gjë fare, të betohem. Sot gjithë ditën kam qenë poshtë në arkiv. Vetëm kur u ngjita lart mora vesh q'po ndodhëte.

Midis zhurmës së rrrotave ai ndjeu prapë pshërëtimën e saj dhe pastaj fjalët me gjysmë zëri: Zot, ruajna!

Pas xhamave të karrocës, në dritën e dobët të fenerëve, mezi shquanin në gjysmëterr ndërtësat e zymta nga të dy anët e rrugës, dhe ndonjë kalimtar i rrallë aty-këtu. E sikur darkë të jetë shtyrë për një natë tjetër? tha me vete Ebu Qerimi. Ky mendim nisi ta mundonte shpesh e më shpesh, sa më tepër që i afro-heshin pallatit të vezirit. Po kjo s'mund të ndodhë kurrsesi, i mbushte mendjen vetes, aq më tepër që kjo darkë kishte lidhje me eposin, pra me themelët e Qyprillinxve. Jo, kurrsesi s'mund të shtyhej. Në të vërtetë, ai vetë nuk arrinte të kuptonte dot nëse donte apo nuk donte që të shtyhej kjo darkë. Megjithatë, kur dalloj që larg fenerët e ndezur në portën e jashtme të pallatit, pastaj karrocat e mysafirëve ndanë trotuarit,

provoi një ndjesi lehtësimi. Iu duk se edhe e ëma pshëretiu e lehtësuar. Ja edhe rojat e vezirit te kangjellat e hekurta dhe pastaj gjithçka tjetër, si në mbrëmjet e zakonshme të darkave: shandanët e ndezur në të dy anët e udhëzës që çonte nga porta e jashtme te e bëndshmja, kryeshërbëtori plak te hyrja, një aromë e mirë gjellësh në brendësi. Ndihej menjëherë që shqetësimi i ditës që porsa kishte mbaruar, ishte i atij lloji, që nuk arrinte dot të depërtonte brenda pallateve.

Ebu Qerimi bashkë me të ëmën hynë në sallonin e madh të pritjes. Dy mangaj të mëdhenj argjendi, të vendosur midis, e kishin mbushur sallonin me aromën e mirë të zjarrit. Dukej sikur asgjë tjetër s'mund t'i shkonte më mirë ngjyrës së kuqe të errët të sixhadeve, si edhe zhurmërisë së lehtë të bisedës, sesa kjo aromë.

Ishin aty ca kushërinj të afërt, të gjithë me poste të larta, ca miq tradicionalë të familjes, një djalë i gjatë leshverdhë, i biri i konsullit austriak, me të cilin Kurt Qyprilliu fliste frëngjisht, dhe dy-tri të ftuar të tjerë që Ebu Qerimi nuk i njihët. Ai dëgjoi se si nëna pyeti me zë të ulët njërin nga shërbëtorët që servirte, se ku ishte veziri, dhe ai iu përgjigj se veziri ishte lart në dhomat e tij dhe së shpejti do të zbriste. Ebu Qerimi ndjeu një prehje në gjithë qenien. Ai ankth i ftohtë, që e kishte kapulluar gjatë gjithë atij mbarimi ditë, po i avullonte nga trupi si një lagështirë e mbrapshtë.

Shërbëtorët servirnin raki<sup>në</sup> gota të vogla argjendi Ebu Qerimi përpiquej që midis zhaurimës së bisedës të dëgjonte të folurën frëngjisht të dajë Kurtit me austriakun. Pas një gotë rakkie që e rrëkelleu me fund, ai ndjeu ta pushtonte një valë gëzimi. Pas një grime sytë e tij u takuan me vështrimin e së ëmës, dhe ai i hoqi sytë prej saj, ngaqë iu duk se ajo do t'i thoshte: ç'ishin ato marrëzira që më fole në karrocë?

Hyrja e vezirit në sallon e ngriu në çast atmosferën. Nuk ishte vetëm zymtia e fytyrës së tij, me të cilën shumica e njerëzve që ishin aty ishin mësuar, por

një fareë mungese e ndjeshme në atë fyttyrë, thuase i zoti i shtëpisë habitej që po i shikonte aty dhe po priste prej tyre t'i thoshin përse ishin mbledhur. Pasi i takoi, ai qëndroi në këmbë përpëra njërit prej mangajve, duke zgjatur sipër prushit të tij duart, thuase kishte ftohtë. Të prerat poshtë syve të tij iu dukën Ebu Qerimit më të thella se atëherë, në atë darkën e pa-harrueshme.

Kurt Qyprilliu, që, siç duket, e ndjeu se duhej ndërhyrë për të rivendosur klimën normale të paradarkës, i tha vëllait të madh diçka, që Ebu Qerimi s'e dëgjoi mirë, por që kishte të bënte, me sa dukej, me austriakun, sepse veziri iu përgjigj të dyve, dhe austriaku nisi të tundte kokën me respekt, ndërsa Kurti i përkthen-te fjalët e të vëllait. Kjo e lehtësoi disi gjendjen. Të ftuarit nisen të bisedonin prapë dy nga dy, në kohën që austriaku, me anë të Kurtit, po i thoshte diçka tjetër vezirit. Ebu Qerimi deshi të afrohej për të dëgjuar, por një kushëri i tij pa flokë, ai që kishte qenë për darkë në shtëpinë e tyre, ditën e parë të fyrjes së tij në Pallatin e Endrrave, e pyeti me zë të ulët:

— Si shkon puna jote në Tabir?

— Mirë, — u përgjigj Ebu Qerimi, ndërsa me cepat e buzëve sajoi atë shprehje, që zakonisht do të thotë «njëfarësoj».

— Ti tani punon në Interpretim?

Ebu Qerimi pohoi me kokë, ndërsa në sytë e kushtërit iu duk se pa një ndriçim ironik. Po atij aq i bënte. Ai e kishte mendjen te daja i tij i adhuruar, Kurti. Asnjëherë nuk i qe dukur aq i pashëm, me jakën e fortë të këmishës së bardhë, që i kalonte gjithë fyttyrës së tij një lodhje të bukur si prej dhëndri. Dhe vërtet, përherë e më tepër Ebu Qerimit po i dukej se qendra e asaj darke ishte pikërisht ai, Kurti, sajuesi i ftesës së çuditshme të rapsodëve shqiptarë. Ebu Qerimit nuk i durohej sa të dëgjonte më në fund motërzimin shqiptar të eposit, që kishte qenë gjer atëherë i panjohur, si ana e padukshme e Hënës.

Hyri një i ftuar, me sa duket, i fundit që prisnin, i cili kërkoj ndjesë për vonesën.

— Jashtë ka një farë shqetësimi, — tha ai. — Në rrugë bëhen kontrollle.

Sytë e disa prej të ftuarve kërkuan vështrimin e vezirit, por ato fjalë u duk sikur kaluan anash tij. Me siguri, ai e di çfarë po ndodh, mendoi Ebu Qerimi, ndryshe s'do të ishte kaq mospërfillës për fjalët e të vonuarit. As për Ebu Qerimin s'tregoi ndonjë vëmendje, thuase ajo darka e disa javëve më parë, me atë bisëdën e përcartë, të mos kishte qenë fare. Një orë më parë, në karrocë, Ebu Qerimi pati një farë mëdyshjeje: mos duhej vallë t'i tregonte vezirit atë që kishte ndodhur në Tabir Saraj? Mos kishte ardhur ai çasti që duhej të kishte mendjen? Mirëpo tani që po shikonte mospërfilljen e tjetrit, Ebu Qerimi e ndjeu veten të çliruar.

I qetë, ai vështronte figurat e sixhadesë së madhe persiane, dhuratë e sovranit për ditëlindjen e vezirit, më e madhja dhe më e bukura sixhade që kishte parë Ebu Qerimi në jetën e tij. Ajo ishte ndër të paktat gjëra që kishte ruajtur bukurinë e saj tani, kur, pas hyrjes në Pallatin e Endrrave, bota e tërë që vyshkur në sytë e Ebu Qerimit.

Ai i shkëputi sytë prej saj, kur ndjeu se përreth u bë heshtje. Po fliste veziri. Ai po u thoshte të ftuarve se pas pak ata do të dëgjonin rapsodët e ardhur nga Shqipëria dhe pastaj, gjatë darkës dhe pas darkës, sipas zakonit, do të dëgjonin rapsodët sllavë, që do të këndonin pjesë nga eposi i Qyprillinjve.

— Le të vijnë, — i tha veziri kryeshërbëtorit.

Ata hynë pas pak, mes heshtjes së thellë. Ishin tre, të veshur me rroba karakteristike, dy me moshë mesatarë, i treti më i ri, me veglat muzikore që i mbanin lehtësisht në duar. Gjithë vëmendja e Ebu Qerimit u përqendrua së pari në ato vegla, «lahuta», siç quhen, tepër të ngjashme me «guslat» e rapsodëve sllavë. Ebu Qerimi provoi të njëjtën habi, për të mos

thënë zhgënjim, që kishte provuar edhe kur kishte parë guslat sllave. Ngaqë kishte dëgjuar aq shumë të flitej për eposin e famshëm, ai kishte kujtuar se veglat muzikore me të cilat ai shoqërohej, do të ishin gjithsesi të jashtëzakonshme, të tilla, që rapsodët do t'i têrhiqnin me zor pas vetes, të rënda, madhështore e të lemerishme. Kurse gusla s'kishte qenë veçse një vegël e thjeshtë prej druri, që mbahej lehtësisht në dorë, dhe vetëm me një tel. Ishte krejtësisht e pabesueshme që atë epos vigan të stërlashtë ta risillte në jetë ai copë dru me atë tel përsipër. Tani që pa lahutën, zhgënjimi iu duk edhe më i madh. Qyshse kishte dëgjuar Kurtin të tregonte për motërzimin shqiptar të eposit, pa e ditur as vetë pse, kishte kujtuar se pamja e lahutës shqiptare do ta ndreqte atë prishje të përfytyrimit që kishte bërë gusla. Jo vetëm të stërmadhe e të rëndë, por gati-gati të stërpikur me gjak nga gjithë ato mizori të eposit e priste ta shihte ai lahutën. Kurse ajo ishte po aq e thjeshtë sa gusla, po ai dru me zgavrën në mes dhe me telin vetmitar sipër saj.

Rapsodët vazhdonin të rrinin në këmbë midis dy grupeve që u sajuan vetveti prej të ftuarve, nga të dy anët e tyre. Ata i kishin flokët të çelët dhe sytë po ashtu. Ishin ca sy që, më tepër se mospërfillës, qenë të atillë, që dukej sikur s'pranonin të futnin përbrenda pamjet që shikonin, por që kthenin mbrapsht çdo gjë.

Shërbëtorët u servirën rapsodëve raki në po ato gota si gjithë të ftuarve, por ata vetëm sa i prekën ato.

— Epo atëherë, mund të filloni, — tha shqip veziri.

Njëri prej rapsodëve u ul në stolin e vogël që ia solli kryeshërbëtori, e vuri lahutën mbi gjunjë dhe një copë herë qëndroi i heshtur, me sytë të ngulur mbi telin e saj. Pastaj dora e djathtë e tij ngriti harkun dhe preku telin me të. Tingujt e parë të veglës ishin të ulët e monotonë, me një si këmbëngulje për t'u kthyer te e njëjta pikë prej nga zunë fill. Ishin si një ankım i gjatë, tepër i gjatë, që të krijonte angushti në gjoks.

Ebu Qerimit iu duk se, po të vazhdonte edhe pak, ata të gjithë do të ndienin mungesë ajri. A nuk do t'i shoqëronin me fjalë ata tinguj gërryes? Kjo pyetje dukej sikur po shfaqeji në sytë e të gjithëve. Ata tinguj duhej të visheshin gjithsesi me diçka, përndryshe teli i lahitës do t'i cingriste gjersa t'i bënte plagë shpirtrat e tyre me atë cijatje të zgjatur.

Kur rapsodi më në fund hapi gojën të këndonte, Ebu Qerimi ndjeu një lehtësim. Por lehtësimi qe i shkurtër. Ashtu si tingulli, edhe zëri i rapsodit kishin diçka jonjerëzore. Dukej sikur me një operacion të veçantë nga ai zë qenë hequr gjithë intonacionet e përditshme, për të lënë në të vetëm të përjetshmet. Ishte një zë i tillë, prej të cilët kuptohej se gryka e njeriut dhe gryka e malit për një kohë të gjatë qenë marrë vesh për të zhdukur dallimet midis tyre. Dhe pas kësaj qenë marrë vesh edhe me zëra të tjerë gjithmonë e më të largët, duke mbërritur gjer në rënkimet e yjve. Veç kësaj, zëri bashkë me fjalët ishin të tillë, që dukej se mund të përdoreshin njëlloj si prej të gjallëve dhe prej të vdekurve, pra marrëveshja qe bërë edhe me ta, madje kjo e fundit ngjante si më e sukseshmjë.

Ebu Qerimi nuk i hiqte sytë nga teli i hollë i vemuar sipër zgavrës. Ishte ai tel që krijonte ankimin, dhe ishte zgavra poshtë tij që i përgjigjej, duke e shumëfishuar gjer në përmasa të frikshme atë ankën. Dhe befas Ebu Qerimit iu bë e qartë se ajo gropë ishte zgavra e shpirtit të kombit që ai i përkiste. Ankimi ngjitej që andej i thekshëm, shekullor. I kishte njohur qysh më parë copëra të atij ankimi, por vetëm tanë e dëgjonte të plotë atë. Zgavrën e lahitës Ebu Qerimi e kishte tanë mu në gjoksin e vet.

Vetëtimthi, e zbehtë, ashtu si qmund të vijë në kujtesë një ëndërr, i pëershkoi trurin ajo ëndrra, e parë prej një farë bakalli, për një vegël muzikore që binte te një truall i pluhurosur. Nuk mbante mend hollësirat e saj, mbante mend vetëm që njëherë kishte dashur ta hidhte në kosh, por pastaj e kishte kaluar. Ta-

ni befas iu duk se ajo vegël muzikore, e përshkruar në të, ngjante çuditërisht me lahutën.

Rapsodi vazhdonte të këndonte me po atë zë të thekshëm. Kurt Qyprilliu, me sytë e ndezur si në ethe, nuk ia ndante vështrimin. Herë-herë, me zë të ulët, ai i përkthente diçka, ndoshta vargjet austriakut, që dëgjonte me vëmendje. Veziri, me sytë e prerë, qeskat poshtë të cilave dukej sikur sa vente nxiheshin, rrinte me duar të kryqëzuara përpara. Ebu Qerimi kuptonte tek-tuk ndonjë varg të rapsodit. Shumica ishte e vështirë të merreshin vesh.

*T'ka zanë vorri, o, the besë të dhanë*

Duke lëvizur fare ngadalë, Ebu Qerimi iu afrua vendit ku rrinte daja i vogël me austriakun. Kurti përpiquej t'i përkthente pikërisht atë varg. Ebu Qerimi kuptonte diçka frëngjisht dhe u përpoq të dëgjonte.

— C'est très difficile à traduire — thoshte Kurti. — C'est presque impossible:

Diçka nga vargjet që arrinte të kuptonte, diçka nga përkthimi i Kurtit, Ebu Qerimi përpiquej të ndiqte tekstin e rapsodisë.

— Është i gjalli që i ka ardhur mbi varr armikut të vdekur dhe po i kërkon dyluftim, — i shpjegonte Kurti austriakut, — C'est macabre, n'est pas?

— C'est magnifique! — përgjigjej tjetri.

— I vdekuri vuani që s'ngrihet dot, përpëlitet, rënkon, — vazhdonte të shpjegonte Kurti.

Gjithçka është aq e qartë, o perëndi, tha me vete Ebu Qerimi. Gjithçka ishte e qartë tanë vërtet. Ajo zgavër lahute ishte tamam varri ku përpëlitez i vdekuri. Rënkimet e tij ngjiteshin që poshtë, rrëqethëse si asgjë tjetër.

— Dhe ja tanë qyqet, që paralajmërojnë fatkeqësi, — tha Kurti me zë të ulët.

Austriaku bënte «po» me kokë pas çdo fjale të tij.

— Eshtë kreshniku Zuk, që, i verbuar tradhtisht nga e éma dhe dashnori i saj, endet nëpër bjeshkën dimërore, mbi kalin e tij gjithashtu të verbuar.

— I, verbuar nga e éma! Mon Dieu! Po kjo eshtë tamam Orestiada! — tha austriaku. — Is das Orestiaden.

Ebu Qerimi që afruar tani fare pranë tyre, për të mos i shpëtuar asnjë fjalë. Kurt Qyprilliu hapi gojën për të vazhduar shpjegimin, por në atë cast diku jashtë u dëgjua një zhurmë e pazakonshme. Shumica e të ftuarve kthyen kokën, disa nga dera disa nga dritaret. Zhurma u përsërit, përzier me ca si britma të imprehta, pastaj midis saj u ndien trokitje të forta.

Ç'është, ç'po ndodh?» thanë disa nga të ftuarit. Rapsodi e preu këngën, duke e thelluar edhe më heshtjen. Trokitjet u ndien përsëri, këtë herë më të forta.

— O zot, ç'është kjo? — thirri dikush.

Të gjithë kthyen kokat nga veziri, fytyra e të cilit qe bërë papritur si një maskë e dylltë. U dëgjua hapja e një dere, një klithmë tjetër tepër e shkurtër, pastaj hapa të rëndë që po afroheshin. Të ftuarit rrinin të gjithë si të ngurosur, me sy të kthyer nga dyert. Ato u shtynë më në fund që jashtë vrullshëm, dhe te pragu u dhanë një grumbull njerëzish të armatosur. Dicka i mbajti ata te dera, ndosha dritat e sallonit, pamja e të ftuarve, apo një britmë që s'u kuptua prej çfytit doli. Vetëm njëri prej tyre eci përpëra dhe, me sytë që dukej sikur nuk i shihnin, duke kërkuar dicka, të cilën me sa duket nuk e gjeti, tha, pa vështruar askënd.

— Policia e sovranit.

Askush nuk u përgjigj.

— Veziri Qyprilli? — tha oficeri, që e gjeti, me sa dukej, më në fund atë që kërkonte. Ai bëri edhe dy hapa të tjerë drejt vezirit dhe u përkul thellë. — Shkel-qësi, kam një urdhër të sovranit për të kryer. Më lejoni ta përbush.

Oficeri shkuli prej gjoksit të tij një dekret që e

shpalosi sakaq pérpara vezirit. Në fytyrën e këtij të fundit ndryshimet qenë bërë të gjitha qysh më parë, kështu që tani dylli i maskës qe ngrirë përsëri.

Por pér oficerin ajo ngrirje mjaftonte si miratim.

— Dokumentet, — thirri ai, duke u kthyer befas nga të ftuarit, ndërsa me një lëvizje të kokës u dha shenjë njerëzve të tij të hynin në sallon. Ata ishin ndonjë gjysmë duzinë, të gjithë të armatosur, me shenjën e policisë së perandorit në jakë dhe në kaskë.

— Unë jam i huaj! — u dëgjua midis përshtjelli-mit të lehtë zëri i austriakut. Ebu Qerimi kërkonte më kot me sy të ëmën. Një zë i rreptë, megjithëse tepër i ulët pér atë rreptësi, përsëriste herë pas here: Këndeji! Këndeji!

Qe hapur një derë anësore e një salloni përbri, ku i shtynin një pjesë të ftuarve.

— Kurt Qyprilliu, — tha me zë të lartë një prej policëve, duke iu kthyer oficerit. — Ky këtu.

Oficeri eci drejt tij. Prangat i kishte nxjerrë nga xhepi pa mbërritur.

Ebu Qerimi pa se si me lëvizje të shpejta e të sigurta me njérën dorë oficeri ia bashkoi të dy duart Kurtit, kurse me tjetrën i vuri prangat. Kurti, pér çudi, nuk kundërshtoi, vetëm se vazhdoi t'i shikonte prangat me një farë habie. Ashtu si një pjesë e të ftuarve, Ebu Qerimi ktheu kokën nga veziri, pér të parë se si do ta ndalonte ai më në fund këtë qmenduri, që edhe kështu shumë kishte zgjatur. Por fytyra e vezirit vazhdonte të rrinte e palëvizhme. Çdokush tjetër mund të mendonte se ajo ngrirje e vezirit të fuqishëm pérpara dhunës që po i bëhej mu n'shtëpinë e vet, kishte si shkak frikën, por Ebu Qerimi e ndjeu menjëherë se ishte tjetër gjë. Ishte mekanizmi i vjetër i Qyprillinxve, që në çaste të tilla, të përsëritura dhjetëra e dhjetëra herë në familjen e tyre, të prodhonte maskën e ndarjes me realitetin. Kishte në të fatalizëm, mungesë dhe lodhje. Ebu Qerimit i er-

dhi të thërriste: Zgjohu, përmendu, vezir, dajë, nuk e sheh ç'po ndodh? Por sytë e vezirit, megjithëse, ashtu si sytë e të gjithëve, ndiqnin prangimin e Kurt Qypilliut, vështrimin e kishin si të piktuuar. Ndihej menjëherë që vështrimi i tij i vërtetë ishte larg, në ku-shedi ç'puse misterioze, prej nga vihej ndoshta në lë-vizje makina shtetërore që kishte prodhuar këtë fatke-qësi. O perëndi, ndoshta ai po mendon si ta ndalojë rnakinën, tha me vete Ebu Qerimi dhe iu afroa edhe më vezirit, si për t'u bindur në ishte tamam ashtu. Dhe ndoshta ngaqë iu afroa më shumë se ç'duhej, apo fare rastësisht, për një grimë sytë e vezirit ndeshën në vështrimin e tij. Në atë grimë të shkurtër, nëpër atë vështrim, që më shumë mund ta quaje si një shqy-erje të beftë në ballë, Ebu Qerimit iu duk se iu përndrit gjithë biseda e tij e turbullt, në atë darkën e pa-harrueshme, dhe befas krejt trurin e tij, me dhëmbje, si një shpim thike, e përshkoi mendimi se e gjithë kjo kishte lidhje pa dyshim me Pallatin e Endrrave, me atë vetë, Ebu Qerimin, dhe se Qyprillintë në diçka kishin vonuar...

Ebu Qerimi ndjeu dy duar që e shtynë brutalisht drejt derës së sallonit përbri. Në çastin që po dilte, i zunë sytë rapsodët, të mbetur ashtu si edhe më parë, të veçuar, midis turmës së të ftuarve.

— Ebu Qerim, — ndjeu ai zërin e ulët të së ëmës, kur u gjend në sallonin anësor. Piste të dëgjonte një klithmë ose një dënesë, por, për çudi, ai zë ishte disi i qetë. — Ç'bëhet andej?

Ai ngriti supet, pa u përgjigjur.

— E kisha mendjen të ti, — tha ajo me po atë zë të ulët. — Zot, ç'është kjo gjëmë!

Tani Ebu Qerimi vuri re se shumica e të ftuarve ndodheshin te ky sallon. Herë pas here dikush pyeste: — Ç'bëhet andej? Sa do të vazhdojë kjo?

— E morën Kurtin? — pyeti e éma.

— Më duket se po.

E mban vëten, mendoi ai. S'ishte më kot nga Qy-

prillinjtë. Megjithatë ishte krejt e bardhë në fytyrë.

Befas, prapa dyerve që ndanin dy sallonet, u dëgjuan klithma të thekshme, pastaj zhurmë dhe një rënkim.

Ashtu si një pjesë e të ftuarve, Ebu Qerimi deshi të bënte një hap drejt dyerve, por e ëma e mbajti për krahut.

Që matanë u dëgjuan përsëri britma dhe zhurma rrëzimi.

— Was ist los? — tha austriaku.

— Dyert janë të mbyllura.

Fytyrat e të gjithëve ishin të prera nga tmerri.

Ebu Qerimi ndiente gishtat e së emës të ngulur si kthethra në krahun e tij. Që matanë erdhi një klithmë tjetër gjerrëse, që u shua sakaq.

— Kush thirri? — tha dikush. — Ky zë ...

— Nuk ishte veziri.

Matanë u ndie një zhurmë tjetër rrëzimi dhe një «aah» i frikshëm.

— Zot i madh, q'po ndodh!

Ca çaste u bë heshtje. Pastaj midis saj dikush tha:

— Po masakrojnë rapsodët.

Ebu Qerimi zuri fytyrën me duar. Matanë dëgjoheshin zhurma gjimesh që largoheshin. Dikush lëvizte dorezat e dyerve.

— Hapeni, në keni perëndi!

Po dyert e sallonit nuk i hapte askush. U hap një derë tjetër, që nxirrte në një korridor të brendshëm. Dikush thoshte: Këndeja, dilni këndeja!

Të ftuarit dolën njëri pas tjetrit si hije, me përashtim të niërit që i kishte rënë të fikët. Korridori i ndriçuar dobët u mbush me hapa. Mos e vranë Kurtin? pyeste dikush. Jo, e morën me vete. Këndeja, zotërinj, thoshte një shërbëtor. Dalja është këndeja. Wo ist Kurt?

Rreshti i të ftuarve doli prapë në korridorin kryesor, përbri sallonit të madh, pas dyerve prej xhami opak të të cilit dukeshin ende ca silueta njerëzish. Me forcë, gati me brutalitet, Ebu Qerimi e shkëputi kra-

hun prej duarve të së ëmës dhe u afroa të shikonte ç'bëhej atje. Njëra nga dyert ishte e hapur gati një pëllëmbë dhe përmes së çarës ai pa një pjesë të sallonit krejtësisht të çrregulluar. Pastaj sytë e tij panë dy prej kufomave të rapsodëve të rënë pothuajse ngjitur me njëri-tjetrin. Kufoma e tretë ishte më tutje, pranë mangallit të përmbysur, me një pjesë të fytyrës të mbuluar nga hiri. Policë s'kishte, vetëm shërbëtorët shkelnin heshturazi mbi sixhadënë plot copëza xhamash të thyer. Përpara se të shihte vezirin, ai pa hijen e tij të palëvizshme në mur, dhe iu desh të shtynte vetëm një gisht derën, për ta parë atë vetë, në po atë qëndrim të ngrirë të mëparshëm. O zot, gjithçka ka ndodhur pérpara syve të tij, mendoi Ebu Qerimi. Sytë e vezirit kishin diçka të përbashkët më xhamat e thyer, të shpërndarë tejembanë sallonit.

Ebu Qerimi ndjeu krahun e së ëmës ta tërhiqte me këmbëngulje dhe nuk pati fuqi të kundërshtonte. I vinte për të vjellë.

Korridori ishte pothuajse i boshatisur. Nga dera kryesore, e lënë hapur, dukeshin dritëzat e karrocave, që po iknin njëra pas tjetrës.

— Ikën të gjithë, — tha nëna e Ebu Qerimit me zë të shuar. — Çdo të bëjmë ne?

Ai nuk u përgjigj.

Një nga shërbëtorët po shuanë llampadarët e mëdhenj. Pas dyerve jë sallonit të madh ishte po ajo rrëshqitje siluetash. Pas pak shërbëtorët nxorën kuformat e rapsodëve, duke i mbajtur nga krahët dhe këmbët. Fytyra e kufomës së tretë, gjysmë e hirnosur, dukej veçanërisht e frikshme. Nëna e Ebu Qerimit kishte kthyer kokën nga ana tjetër. Ai mezi e mbante të vjellët, megjithatë e ndiente së nuk largohej dot që andej. Një nga shërbëtorët doli i fundit, me veglat muzikore në duar. Pas pak shërbëtorët u kthyen.

— Ç'do të bëjmë? — pëshpëriti nëna e Ebu Qerimit.

Ai s'dinte ç't'i thoshte.

Dyert e sallonit ishin tani të hapura, dhe ata panë se si shërbëtorët po mblidhnin sixhadenë e madhe të përgjakur në shumë vende.

— Nuk mund të shoh më, — tha ajo. — Nuk mundem.

Në sallon gjithashtu po shuanin llampadarët. Ebu Qerimi kthente kokën herë në një anë, herë në tjetrën, pa qenë i aftë të ndërmerrte asgjë. Të ftuarit me siguri kishin ikur të gjithë. Ndoshta duhej të iknin edhe ata. Apo duhej të qëndronin, siç qëndrojnë të afërmit në fatkeqësi. Por edhe sikur të donin të iknin, s'kishin me çfarë. Shtëpia e tyre ishte larg dhe aq më tepër në një natë të tillë nuk ecej me këmbë. Kurse karrocë as që merrej me mend si mund të kërkohet.

Shumica e llampadarëve ishin shuar tani. Ndriçonin vetëm ca fenerë aty-këtu, te shkallët, në korridoret e brendshme. Shtëpia e madhe po mbushej me pëshpërima. Shërbëtorët e rrallë venin e vinin si hije me ca shandanë në duar, drita e verdhë e të cilëve hallakatej nëpër funde korridoresh.

— O zot! — ia bënte herë pas here nëna e Ebu Qerimit. — C'qe kjo gjëmë!

Njëra nga dyert kërciti dhe nga gjysmerrësira e sallonit të madh doli papritur veziri. Duke ecur me hapa të gjatë, si somnambul ai u ngjit përpjetë shkallëve me shpejtësi nëpër gjysmëterr.

— Veziri, — tha e ëma, duke i prekur dorën Ebu Qerimit. — E pe?

Pas pak që lart, duke i zbritur shkallët nga tre e nga katër, një nga shërbëtorët kaloi furishëm përbri tyre, doli përjashta me po atë vrull dhe pas një grime ata dëgjuan zhurmën e një karroce që po nisej diku.

Ebu Qerimi me të ëmën qëndruan një copë herë të gjatë në gjysmëterr, duke ndjekur me sy dritëzat e shandanëve që largoheshin herë në një drejtim, herë në tjetrin, nëpër skutat e shtëpisë së madhe. Po për ta s'u kujtua askush. Pa thënë asgjë, dolën nëpër derën gjysmë të hapur dhe ecën drejt portës së jashtme. Rojat,

ashlu si më parë, ishin afty, nga të dy anët e kanateve të hekurta. Ebu Qerimi mezi e kujtonte rrugën që çonte për në shtëpi, kurse e ëma as që e dinte fare, ngaqë gjithmonë e kishte bërë atë rrugë me karrocë.

Pas një ore ishin ende duke ecur, pa qenë të sigurt nëse po iknin vërtet në drejtim të shtëpisë së tyre, apo kishin humbur. Që larg u dëgjua rrapëllima e rrotave të një karroce që po afrohej me shpejtësi. Ata u mënjanuan te muri dhe, kur karroca kaloi përbri tyre, Ebu Qerimit iu duk se dalloi në gjysmëterr shkronjën «Q» të gdhendur sipër saj.

— M'u duk si karroca e vezirit, — tha me zë të ulët. — Ndoshta ishte ajo që u nis atëherë.

Nëna nuk u përgjigj. Ajo dridhej nga të ftohtët dhe nga lagështia e natës.

Pas njëfarë kohe ndeshën në një karrocë tjetër, që kaloi përskaj tyre po aq furishëm dhe, megjithëse rruga ishte fare e pandriçuar, Ebu Qerimit iu duk se prapë dalloi një «Q» sipër saj, madje ai zgjati dorën në terr, me shpresë se ajo do të ndalonte për t'i çuar ata gjer në shtëpi. Po karroca fluturoi përbri, duke humbur nëpër mjegull, dhe Ebu Qerimi i kuptoi se ishte një marrëzi të prisje ndihmë nga dikush në këtë natë ankthi të përshkruar tejembanë nga këto «Q» të gdhendura, që frushkullonin anash tyre si qyqe fatkeq-sish.

Ata mbërritën në shtëpi pas mesnatës. Lokja, sikur ta parandiente gjémën, nuk kishte fjetur. Me fjalë të rralla i thanë ç'kishte ndodhur, pastaj kërkuan t'u bënte nga një kafe për të mbledhur veten. Në mangall kishte ende pak prush, që Lokja e kishte mbuluar me hi për të ndezur zjarrin në mëngjes, si zakonisht, por ai ishte i pamjaftueshëm për t'u hequr drithmën e trupit.

Ebu Qerimi shkoi pastaj për t'u shtrirë në dhomën e tij, por ishte e pamundur të flinte. Kur u ngrit

ndaj tē gdhirë, i gjeti ato tē dyja ashtu siç i kishte lënë, kruspull mbi mangallin pothuajse tē shuar.

— Ku po bëhesh gati tē shkosh, Ebu Qerim? — tha e ēma me zë tē llahtarisor.

— Në punë, — u përgjigj ai, — ku tjetër?

— O zot, je në vete? — tha ajo. Në një ditë tē tillë...

Ajo bashkë me Loken u përpoqën t'i mbushnin mendjen që atë ditë, vetëm atë ditë tē mos dilte në atë punë tē mallkuar, tē thoshte se kishte qenë sémurë, tē gjente një arsyе ndoshta më tē rëndë pér mungesën, vetëm tē mos shkonte, gjithsesi, kurrsesi. Por atij s'i mbushej, që s'i mbushej mendja. Ato e lutën prapë, sidomos nëna, i puthi duart, ia njomi me lot, i tha se në një ditë tē tillë ndoshta Tabir Saraji as që ishte hapur fare, por, sa më shumë që ajo bënte ashtu, aq më tepér ai bëhej i padëgjueshëm. Më në fund arriti tē shkëputej prej saj dhe, duke mbyllur derën pas vetes, doli në rrugë.

Mëngjesi ishte i ftohtë, si rrallëherë. Ai eci me hapa tē shpejtë nëpér rrugën që, si zakonisht, ishte gati e shkretë në këtë orë tē hershme. Edhe ata kalimtarë tē rrallë që dukeshin aty-këtu, ngaqë i kishin fytyrat tē mbështjella me shall, ngjanin sikur ende po flinin. Ai e kishte kokën jo më pak tē mpirë se ata. Ende s'ishte në gjendje ta mblidhët veten nga ajo që kishte ndodhur. Ashtu si ato kafshëzat e detit që krijojnë rrotull vetes një re mbrojtëse, truri i tij kishte gjetur, me sa dukej, një mënyrë pér tē mos lënë tē afrohej mendimi i qartë. Herë-herë arrinte tē dyshonte nëse vërtet kishte ndodhur diçka. Ishin çaste tē shkurtra, kur i dukej se e gjitha s'kishte qenë vegse një delir, nga ata me tē cilët dosjet ishin plot atje në Tabir Saraj. Por e vërteta arrinte ta shponte si gjilpërë pér ca çaste, gjersa truri arrinte tē mpihej përsëri, që prapë, pas pushimit tē shkurtër, tē pësonte atë therje tē dhimbshme. E kishte vënë re se pér brenga tē kësaj natyre mëngjesi i parë fill pas zgjimit ishte veçanë-

risht i padurueshëm. Por ai ishte në një gjendje amorfë, as të fjetura, as të zgjuar. Dhe po ashtu i dukej botë përreth, muret me njolla lagëstie të ndërtesave, kallimtarët me fytyra të hirta, që bëheshin përherë e më të shpeshtë sa më tepër që ai i afrohej qendrës. Nuk ishte e vështirë të dalloje midis tyre nëpunësit e ministreve dhe të institucioneve qendrore, që shpejtonin hapat në një mënyrë të veçantë, të njëjësuar ndoshta nga i njëjtë orar zyrtar.

Ja dhe ushtarët e gardës përparrë Pallatit të Sheh – Ul – Islamit, madje më të shumtë se dje. Mbi kaskat e lagëta nga vesa e natës lodronin ca ndriçime të turbullta. Te udhëkryqi përparrë bankës gjithashtu kishte ushtarë. Me sa dukej, vazhdonte gjendja e jashtëzakonshme. Jo, asgjë s'kishte qenë delir. Dhe Kurti ndodhej në burg... në mos... Sixhadeja e përgjakur, që po e mbështillnin shërbëtorët, ngulmonte të mbulonte krejt mendimet e tij. Si mund të shkelte këndeje e tutje mbi një qilim, pa iu marrë mendtë. Shijen e të vjellit e kishte akoma në thelli si të gjuhës.

Pallati i Endrrave qenka i hapur, tha me vete, kur pa që larg hyrjet e tij. Te portat nëpunësit hynin në grumbuj të mëdhenj. Shumica ishin të panjohur me njëri-tjetrin, ndaj as nuk përshëndeteshin, pale të flitnë. As në korridorin përparrë Interpretimit s'ndeshi ndonjë të njothur. Po shyqyr, fqinji i tij ishte atje, te tryeza.

— E, — tha ai, porsa Ebu Qerimi zuri vend përbri.  
— Ke marrë gjë vesh?

— S'di gjë, — gënjeu Ebu Qerimi. — Porsa arrita. Ç'ka ndodhur?

— As unë s'di gjë të saktë, por ndihet menjëherë që diçka e rëndësishme ka ndodhur. I pe ushtarët në rrugë?

— Po. Edhe mbrëmë, edhe sot.

Fqinji, duke bërë sikur po merrej me dosjen, afroi kokën edhe më.

— Thuhet se diçka ka ndodhur me Qyprillinxjtë, megjithatë askush s'e di se çfarë.

Ebu Qerimi ndjeu zemrën t'i ngadalëson te rrähjet. Idiot, i tha ai vetes. Ti i di tē gjitha, përse tronditesh nga një gjysmë fjalë e tjeter? Megjithatë pyeti:  
— Çfarë?

Zëri i tij ishte i shuar, thuase ajo që kishte ndodhur do tē trupëzohej plotësisht, po tē pohohej nga dikush.

— S'di asgjë tē saktë. Është vetëm një pëshpërimë. Ndoshta është thashethem.

— Ndoshta, — tha Ebu Qerimi dhe u përkul mbi dosje, kurse me vete prapë përsëriti: idiot, ti beson se gjërat mund tē ndreqen kështu?

Sytë e tij nuk lexonin dot. Ishte një èndërr e marrë atje, që ai, dhjetë herë më i marrë se ajo, duhet t'i jepët një kuptim. Nëpunësit e tjerë qenë përkultur mbi dosjet e tyre. Dëgjohej herë-herë fëshfërima e fletëve që ktheheshin.

— Njëfarë shqetësimi ndihet përsëri sot, — pëshpëriti fqinji. — Diçka do tē ndodhë me siguri.

E ç'të ndodhë më tepër! mendoi Ebu Qerimi. Ç'iste pér t'u bërë, u bë.

— E ç'mund tē ndodhë? — tha ai me zë fare tē ulët.

— Kushedi, — tha fqinji. — Ndoshta në pushim do tē marrim vesh ndonjë gjë.

Ah, po, në pushim, mendoi Ebu Qerimi. Koka i rëndonte si plumb. Edhe pak dhe i dukej se do ta zinte gjumi mu aty, mbi dosjen e hapur, duke e lëshuar èndrrën drejt e në tē, tē freskët, si veza e porsapjellë. Marrëzira, tha dy-tri herë me vete, duke fërkuar ballin me dorë. Marrëzira dhe asgjë tjeter. Ndoshta do tē ishte më mirë tē mos ishte paraqitur fare në punë sot.

Asnjëherë pushimi nuk i qe dukur aq i shumëpëritur. Sytë po i mbylleshin përgjysmë mbi gjumin e tjeterit, tē përshkruar mbi fletën e dosjes. Edhe pak dhe

gjumët e tyre do të bashkoheshin në një, ashtu si bashkoheshin verbtazi fatet e njerëzve.

Zilja e pushimit e bëri të dridhej. Me hapa të ngathët eci pas vargut të njerëzve që zbritnin për në boddumet. Atje ishte po ajo zhurmë e zakonshme e çdo dite tjetër, sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Në të vërtetë, të tjerëve s'u kishte ndodhur gjë. Veshi i tij u përpinq të kapte gjësind nga ato që fliteshin, por ato s'kishin lidhje me ngjarjen. E ç'më duhen, në fund të fundit, mendoi. Ai ishte njeriu që dinte më tepër nga të gjithë ç'kishte ndodhur. Atëherë ç'i duheshtitë e tyre pa vlerë?

Piu një kafe dhe me hapa të ngadalshëm nisi të ngjitte shkallët. Përbri tij njerëzit vazhdonin të flitën për gjithfarë gjérash. Dy-tri herë iu duk se dëgjoi fjalët «shtetrrethim», «i pe mbrëmë rojat?», por ai iku më tutje, duke përsëritur me vete: ç'më duhet.

Ashtu kujtonte, se nuk kishte dëshirë të merrte vesh asgjë, madje as për kureshti, megjithatë, pasi zuri vend në tryezën e punës, e ndjeu se po priste me padurim kthimin e fqinjtit.

Ai u duk më në fund te dera. Që nga ecja kuptohej që kishte lajme.

— Një èndërr paskësh qenë shkaku i të gjithave, — pëshpëriti porsa u afrua.

— Shkaku i kujt? — pyeti Ebu Qerimi.

— Si i kujt? I fatkeqësisë që u ka rënë Qyprillinxve.

— Ashtu? Domethënë është e vërtetë?

— Po. Èshtë krejt e sigurt. Diçka e keqe ka ndodhur me ta. O zot, sikur ta dija! — Zaten ajo u duk që mbrëmë këtu...

— E ç'ishte ajo èndërr? — pyeti Ebu Qerimi.

— Një èndërr e çuditshme, e parë nga një shitës zarzavatesh. Hm, në pamjen e parë kështu duken gjithmonë gjëra të pafajshme, zarzavate, fusha me bar, kurse pastaj del që prapa tyre fshihet gjëma. Edhe ajo kështu që, një èndërr me një urë dhe me një fyell, apo violinë, apo nuk e di ç'vegël muzikore.

— Një urë, një vegël muzikore... — ia bëri Ebu Qerimi me gjysmë zëri. — E pastaj? Ç'kishte tjetër?  
— Edhe një kafshë që vërtitej, po kryesorja qe ura me violinën, më kupton?

Ebu Qerimi ndjeu gjoksin t'i shtypej si nga një panchë elefanti. Ishte pikërisht ajo, ëndrra e nëmur, që dy herë e kishte kaluar nëpër duar.

— Po ti ç'pate? — pyeti fqinji. — Më duket se nuk ndihesh mirë.

— Asgjë, — tha Ebu Qerimi. — Mbrëmë kam qenë sëmurë. Kam vjellë gjithë natën.

— Dukesh menjëherë. Kështu pra, ku e kisha fjalën?

— Te ajo ëndrra.

— E pra, ajo e paskësh dhënë sinjalin. Është zbërthyer kuptimi, i saj dhe ka dalë e qartë çdo gjë. Është lidhur fjala «urë» me emrin e Qyprillinx, më kenton, «urë» a nuk është «qypria», pra është bërë një lidhje e tillë dhe pastaj lëmshi është shqepur vetvetiu.

Ja pra ç'paskësh qenë. Ebu Qerimi ndjeu qzellën t'i thahej. Tani iu kujtua se më kot qe përpjekur atëherë të gjente një lidhje midis urës dhe demit të tërbuar, që përfaqëson pa dyshim forcën shkatërruese, dhe kështu e kishte kaluar ëndrrën në dosjen e të pazbërthyeshmeve. Tani që një tjetër e kishte zbërthyer, madje me kaq sukses, ndoshta do t'i kërkonin llogari përse e kishte bërë këtë gjë. Do të dvshonin se e kishte bërë me qëllim, për të humbur gjurmët, natyrisht përderisa ai vetë ce një Qyprilli dhe sado që ai, duke dashur të mbrohej, mund t'u përmendtë faktin se në Seleksionim ishte ai që, po të donte, mund ta zhdukte ëndrrën, me gjithatë e kishte kaluar në Interpretim, prapë druanë se të gjitha këto do të binin më një vesh shurdh.

— Veç kësaj ishte ajo violina, apo ku e di unë ç'vegël muzikore, — vazhdoi fqinji. — e cila paskësh lidhje me një epos, që këndohet në Ballkan për Qyprillintë. Po ti ç'pate? Prapë e ndien veten ligjsh?

Ebu Qerimi bëri «po» me kokë, pa mundur dot të fliste. Më tepër për të larguar vëmendjen e tjetrit sesa të dëgjonte, i bëri me shenjë të vazhdonte. Tani që tjetri përmendi eposin, iu zhduk çdo shpresë se e gjithë kjo mund të ishte frysht i fantazisë. Arrestimi i Kurtit, rapso-dët e masakruar, të gjitha tregonin se në mes ishte vërtet eposi dhe se ëndrra ishte bërë shkak për të gjitha. Tani ajo i dukej e qartë si drita e diellit: Qyprillinjtë (ura) me anë të eposit (veglës muzikore) ndërmerrnin një veprim kundër shtetit (demi i egërswar). Si nuk i kishte vajtuar ndër mend më parë kjo? E kishte pasur në dorë të shmanget fatkeqësinë dhe nuk kishte bërë asgjë. Darka me vezirin, paralajmërimet e tij të turbullta për gatish-mërinë s'kishin qenë kot, por ai qe treguar i paaftë për të kapur sinjalin, e kishte zënë gjumi mbi dosjet dhe fati i keq qe rrrokullisur mbi njerëzit e tij.

— Ndihesh më mirë tani? — pyeti fqinji.

— Po. Diçka më mirë.

— Shyqyr. Mos u bëj merak, do të të kalojë. Këshitu pra, ky epos paskësh qenë shkak i vjetër mosmarrëvesh-jesh midis Qyprillinjve dhe sovranit. Jo më kot dashamirësit e Qyprillinjve prej kohësh i paskan këshilluar të hiq-nin dorë prej eposit, mirëpo ata s'paskëshin pranuar, me-gjithëse jo një herë kanë pësuar fatkeqësi prej tij. Madje jo vetëm kaq. Sikur të mos mjaftoheshin me eposin sllav, paskëshin ftuar edhe rapsodët shqiptarë, më kuption, ku-ku, nëne! e paskan mihur vetë gropën nën vete. Pikërisht kjo gjë ka nxitur zemërimin e sovranit. Ai është pez-matuar shumë. Ka vendosur t'i japë fund kësaj historie një herë e përgjithmonë. Ka marrë vendim ta shkulë nga rrënjet atë epos të nëmür. Madje është caktuar me shpejtësi grupi i zyrtarëve që do të dërgohen me ngut enkas për këto punë në Ballkan, sidomos nër të zhdukur eposin shqiptar, sepse ai paska qenë bërrthama, prej nga është shpérndarë kjo farë e dëmshme.

— Ashtu? — ia bënte Ebu Qerimi herë pas here, kurse me vete thoshte: kur arriti t'i marrë vesh të gjitha këto?

— Ndihesh më mirë tani? — tha fqinji. — Të thashë

unë, do të kalojë. Ku e kisha fjalën? Hë, veç kësaj, nga kjo ngjarje pritet një acarim i marrëdhënieve me Austri-në, kurse, përkundrazi, një afrim me Rusinë. Mbrëmë, në pritet, ambasadori rus mezi e mbante gjëzimin.

Ebu Qerimit iu kujtua fytyra e tmerruar e djalit të konsullit austriak në darkë. O zot, të gjitha qenkan të vërteta, tha me vete. Megjithatë fqinjtit i pëshpëriti:

— E ç'punë ka Rusia me ato rapsodi të shkreta?

— Ç'punë ka Rusia? Hm, edhe unë e bëra këtë pyetje, por qenkan më të thella punët, pëllumbth. S'janë vetëm punë vjershash e ahengjesh, siç mund të duken në vështrimin e parë. Zaten, po të ishin ashtu, as që do të denjonte të merrej sovreni i madh me to. Pra, punët qenkan të thella shumë. Kanë lidhje me vendosje e zhvendosje popujsh në Ballkan, me raportin midis popullsisë sllave e josllave, siç janë shqiptarët, me një fjalë, kanë lidhje të drejtpërdrejtë me hartën e Ballkanit. Sepse eposi, siç ta thashë, këndohet në dy gjuhë: shqip dhe sllavisht, kështu që ka lidhje të drejtëpërdrejtë me çështje kufijsh etnikë brendapërbrenda perandorisë. Kështu thashë edhe unë në fillim: ç'hyn këtu Austria, e aq më tepër Rusia, por ja që hykëshin edhe njëra, edhe tjetra. Austria mbron popujt josllavë, Rusia, përkundrazi, baba Cari, siç e quajnë sllavët mbretin rus, ndërhyr vazhdimesh te sulltani ynë për gjendjen e sllavëve. Ka njerëzit e vet kudo, që e informojnë. Kurse ai epos paska lidhje pikërisht me marrëdhëniet e popujve të Ballkanit. Thonë se rapsodët shqiptarë i bënë copë e çikë atje te Qyprillinxh, bashkë me veglat e tyre muzikore. Ti prapë ndihesh keq?

Ebu Qerimi kishte mbyllur sytë përgjysmë.

— Mos ki merak. Do të kalojë. Kam vuajtur njëherë edhe unë nga kjo. Kështu janë punët, pëllumbth, përherë më të thella se ç'duken. Ne këtu kujtojmë se dimë diçka, kurse në të vërtetë nuk dimë veçse ca èndrra, ca mjegulla...

Ai vazhdoi të fliste edhe për njëfarë kohe, pastaj e folura e tij sa vente bëhej më e ulët, gjersa përfundoi në një pëshpërimë me vetvehten. Ebu Qerimit s'i hiqe-

shin nga mendja të gjitha ato që dëgjoi. Ah, sikur ta kishte zhdukur atë ëndërr qysh atëherë, në Seleksionim, si nepërkën që i shtypet koka sa është e vogël. Mirëpo ai e kishte lënë të ikte, të rrëshqiste dosje më dosje e seksion më seksion, duke u rritur e duke mbledhur helm, gjersa kishte përfunduar në kryeëndërr. Pendimi po e pickonte pa mëshirë në gjoks. Herë-herë përpinqej ta qetësonte veten: ndoshta ëndrra do të gjente rrugët për të arritur atje ku duhej, përderisa kaq klane të fuqishme, madje shtete të tëra qenë të interesuara përmbërritjen e saj. Veç kësaj, edhe sikur ëndrra të qe zhdukur vërtet, a nuk mund të... fabrikohej një tjetër? Veziri ia kishte thënë pothuajse hapur c'flitej për ëndrrat, madje kryeëndrrat e falsifikuara. Jo, më mirë që ai nuk qe përzier në këtë histori, njëqind herë më mirë. Mund të bëheshin hetime të imta më vonë, të gjendej që ai e kishte zhdukur dëshminë, dhe ndëshkimi (që edhe këshfu, për shkak të moszbërthimit të ëndrrës, e trempte) të binte i tmerrshëm jo vetëm mbi të, por mbi gjithë familjen. Kjo ishte ndoshta dhe arsyesa që veziri nuk i kishte dhënë udhëzime të qarta se ç'duhej të bënte. Sic dukej, edhe ai lëkundej, s'e dinte as vetë nëse ishte mirë apo keq të veprohej ashtu. Oh, rënroi me vete Ebu Qerimi. C'm'u desh mua kjo punë e mallkuar.

— Sot priten lavdërimet zyrtare, — dëgjoi Ebu Qerimi zërin e fqinjtit.

— Lavdërime? — Për çfarë?

— Si për çfarë? Për ëndrrën që u bë shkaktare e të gjithave. Sa i hutuar që je, Ebu Qerim. Për çfarë po flisnim gjer tanë?

— Ah, po, po... — ia bëri Ebu Qerimi.

— Po nejse, ke hak. Ti s'je mirë nga shëndeti sot. Nejse... Seleksionuesit u lavdëruan që në mëngjes. Me siguri janë lavdëruar edhe gjithë sektorët e tjerë, duke nisur nga Recepzioni, e ndoshta është nisur lavdërimi zyrtar bashkë me shpërbllimin edhe për atë shitësin e zarzavateve. Vetëm për një gjë po vraç mendjen e nuk arrij ta lëkuptoj dot: përsë Interpretimit po i vonon lavdërimi?

— Po i vonon?

— A nuk tē fola pér njëfarë alarmi që ndihej qysh nē mëngjes? Ja pra, me sa duket, ky qenka shkaku; vonesa e lavdërimit.

— E pse vallë? — pyeti Ebu Qerimi.

— Ku mund ta dish? — tha fqinji. — Kam një copë herë që po e vë re shefin. Është i shqetësuar. A s'të duket edhe ty ashtu?

— Po, — ia bëri Ebu Qerimi.

— Në tē vërtetë ka hak. Në goftë se është puna pér lavdërime, Interpretimi e meriton, përparrë tē gjithëve. Veç nē goftë se...

— Çfarë nē goftë se...

— Veç nē goftë se ka dhënë interpretim tē gabuar.

— Po atëherë si është e mundur që èndrra tē jetë riinterpretuar drejt? Pas Interpretimit s'ka tjetër sektor që tē merret me këtë punë. Bashëndrrorët merren vetëm me zgjedhje, apo jo?

— Ke tē drejtë, — tha fqinji, disi i habitur që Ebu Qerimi pati njëfarë gjallërimi. — Vërtet një gjë e tillë është vështirë tē mendohet. Por ama edhe vonesa e lavdërimit nuk shpjegohet kursesi.

Një copë herë tē dy u morën me dosjet. As njëri as tjetri nuk lexonin asgjë. Sikur ta dinte ai që unë jam nga Qyprillinx! mendonte Ebu Qerimi. Megjithëse një ditë, herët ose vonë, do ta mësonte, ashtu si shefi, që e dinte me siguri, megjithëse nuk jepte asnje shenjë, madje as sot, që fatkeqësia e Qyprillinjve ishte bisedë e ditës. Por sot ai ndoshta kishte hallet e veta. Më vonë me siguri do ta shikonin ndryshe, nē mes do ta hiqnin fare nga kjo punë.

— Shefin po e thérresin përsëri, — pëshpëriti fqinji. — Ai është bërë baltë nē fytyrë, e shikon?

— E shikoj? — tha Ebu Qerimi.

— E thashë unë. S'ishte shenjë e mirë kjo që s'po

vinte lavdërimi. Tani éshtë e qartë që lavdërim s'ka pér tē pasur, tani gjithë puna éshtë që tē mos ketë...

— Çfarë? — pyeti Ebu Qerimi me një fije zëri.

— Gjithë puna éshtë që tē mos ketë ndonjë dënim.

— A thua? Po pérse... pérse?

Një fije shprese nisi tē përpélitej dobët përbrenda Ebu Qerimit. Por ishte aq e zbehtë, saqë dukej se do tē likej në çast.

— Ku ta dish pérse, — u përgjigj fqinji. — Asgjë s'merret vesh.

Ndihej menjéherë që ai po bëhej nervoz. Ideja se diçka po ndodhë por që ai s'arrinte ta merrte vesh, ishte, siç duket, e papranueshme pér tē. Koka e tij kthehej me lëvizje tē padurueshme herë nga dera e brendshme nëpër tē cilën qe larguar shefi, herë nga dera që dilte në korridor.

— Diçka po ndodh. Kjo as që vihet në dyshim. E tmerrshme, e tmerrshme — murmuriste.

Kaq hapur e tregonte padurimin, saqë nuk kuptohej nëse ishte e tmerrshme ajo që po ndodhë, apo fakti që ai s'arrinte ta merrte dot vesh.

Asnjéherë Ebu Qerimi s'kishte dëshiruar kaq shumë që fjalët e fqinjit tē ishin tē vërteta. Ai, që ishte dre-dhur më parë nga çdo bisedë që fillonte me fjalët «e dégjuat, diçka po ndodh», tani lutej nga thellësia e shpirtit që diçka tē ndodhë vërtet. Në qoftë se lavdërimi pér èndrrën e mallkuar po vononte, në qoftë se, përkundrazi, pritej një dënim pér tē, do tē thoshte se diçka kishte ndryshuar orët e fundit... Ebu Qerimi e ndër-preu fillin e hamendjeve tē lumtura nga një frikë bes-tyde se, po t'i mendonte, do t'i prishte ato. Veç kësaj ishte kaq e pabesueshme një mrekulli e tillë.

— Po kjo tani bën «mu», duhet tē jesh i verbër që tē mos e shikosh, — murmuriti fqinji me një vërvshëlli-më në zë, gati me zemërim, sikur Ebu Qerimi tē ishte ai që kundërshtonte dyshimet e tij.

Aty-këtu nëpër tryeza njerëzit pëshpëritnin me një-

ri-tjetrin vërtet, kurse ata që punonin pranë dritareve, zgjatnin kokat pér të parë pérjashta. Siç duket, diçka nga ajo që po ndodhët kishte arritur të depërtonte gjer këtu.

Ebu Qerimit i erdhën ndër mend karrocat me «Q»-në përsipër, që endeshin si të çmendura nëpër natë dhe pérherë të parë besoi seriozisht se diçka kishte ndodhur vërtet. Veziri s'kishte qëndruar duarkryq. Ajo dalje e tij e furishme nga salloni, kur gjithçka kishte marrë fund, ngjitja si somnambul shkallëve, s'kishin qenë kot. Pastaj, karroca që u nis diku nëpër natë, karrocat e tjera që ai me të ëmën ndeshën nëpër terr dhe që shkonin ose kthehenin prej kushedi nga. O zot, sikur të ishte e vërtetë!

— Jo, s'mundem më, — tha fqinji përbri tij. — Do të shkoj të marr vesh ç'bëhet. Po më kërkuan, thuaj që kam zbritur në arkiv.

Pa e zgjatur më, me hapa të lehtë pér të mos térhequr vëmendjen, ai rrëshqiti si hije drejt daljes. Ndërsa e ndiqte me sy, Ebu Qerimi ndjeu një valë gëzimi. Së paku, së shpejti do të merrte vesh diçka.

Njëfarë kohe e kaloi me sytë mbi dosje, pa lexuar natyrisht asgjë. Padurimi pér të dëgjuar sa më shpejt të rejt gërshtetohej me një lloj kënaqësie që fqinji po vonohej, shenjë e sigurt kjo se lajmet do të ishin më të plota. Megjithatë Ebu Qerimi bënte një përpjekje mbinjerrëzore të brendshme pér të frenuar lindjen e një shprese më të madhe se ç'duhej. E ndiente se një zhgënjim i ri do ta dërrmonte krejt.

Tani jo vetëm ata që kishin tryezat pranë dritareve kthenin kokat pérherë e më dendur pér të shikuar pérjashta, por, gjë e pangjare kurrë në këtë sallë, nëpunës të tjerë, nga tryezat fqinje, u afroheshin dritareve pér të njëjtin qëllim. Me të vërtetë po ndodhët diçka e jashtëzakonshme. Sytë e Ebu Qerimit herë kthehesin nga dritaret, herë nga dera, prej nga priste të shfaqej fqinji i tij. Mos vallë sovrani e kishte kthyer bashëndrrën, ashtu si nusen e pandershme që e kthejnë në mëngjesin e nesërm?

Kurrsesi nuk donte të përkëdhelte shpresa të para-kohshme, por ajo që po ndodhët, ishte vërtet e papërfytyrueshme. Jo vetëm nga tryezat pranë dritareve, por

nga mesi i sallës, madje nga fundi i saj, njerëzit nisën të lëviznin. Po iu afrohesin dritareve ata që nuk guxonin të luanin kurrë nga vendi i tyre, që do të besojë se ishin pjesë e tryezave, që jo vetëm s'kishin menduar se mund të afrohesin te xhamat pér të vështruar përashta pér kureshtje, por që me siguri as që u vente ndër mend se salla e tyre kishte dritare.

Ebu Qerimit iu duk se gjithë trupi po i hante nga padurimi. Duroi sa duroi dhe pastaj edhe ai bëri atë që një orë përpara do t'i dukej e qmendur: eci mes pér mes sallës, pér t'i afrohesin njërsë prej dritareve të mëdha.

Zemra nuk do t'i rrihte më shqetësueshëm po t'i afrohej një humnere. Zaten ndriçimi i ditës që vinte pas xhamave, ishte i atij lloji. Aty-këtu nëpunësit, me bërryla të mbështetur mbi pezule, vështronin jashtë.

— C'është? — tha Ebu Qerimi me pëshpërimë.

Njëri nga ata që vështronte, ktheu kokën, e pa një grimë si me habi, pastaj i pëshpëriti:

— Atje poshtë, në oborr, a nuk e sheh?

Ebu Qerimi vështroi poshtë në drejtimin që tregonin sytë e tjetrit. Pér herë të parë po e merrte vesh që këto dritare binin në një nga oborret e brendshme të Pallatit të Endrrave. Në oborr kishte ushtarë. Që lart ata dukeshin të shtypur, por kaskat e tyre shndritnin çuditërisht.

— Ushtarë, — tha Ebu Qerimi.

Tjetri nuk iu përgjigj.

— Pse vallë? — tha Ebu Qerimi pas pak. Ktheu kokën dhe pa se tjetri kishte ikur.

Ebu Qerimi vështronte poshtë ushtarët që dukeshin si prej plumbi. Mendimet i kishte të mpira. Prapë iu kujtuan karrocat me «Q»-në e gdhendur sipër, të cilat përherë i sillnin në përfytyrim diçka nga qyqja, pikërisht pér shkak të shkronjës «Q», me të cilën fillonte fjala qyqe. Tani, ngaqë e kishte kokën të turbullt, i dukej gati normale që ato t'i vinin në kujtesë herë si karroca, herë si qyqe që fluturonin nëpër bunacë.

— C'është? — dëgjoi zërin e dikujt midis një frysëmarrjeje astmatike.

— Atje poshtë, në oborr, a nuk e sheh? — u përgjigj Ebu Qerimi.

Frymëmarrja e tjetrit dukej se do t'i vishte në çast xhamat e ngrirë. Ebu Qerimi s'e kuptoi sa qëndroi ashtu. Të ftohtët që vinte nga dritarja e solli në vete. U kthyesh me hapa të ngadaltë te vendi i tij. Fqinji ishte atje.

— Ku ishe? — pyeti ai. — Kam qëkur që të pres.

Ebu Qerimi bëri me kokë nga dritaret.

— Budallallëqe, — ia bëri tjetri. — C'mund të marrësh vesh që andej? Dëgjo këtu, kam lajme të hatashme: Thonë se gati gjysma e bashëndrrorëve është arres-tuar.

— A?

— Prit, ka edhe më. Flitet se arrestime do të ketë edhe në Interpretim. Duke nisur nga shefi.

Ebu Qerimi mezi u gëlltit.

— Oborri është plot me ushtarë, — murmuriti ai.

— Prit, ata janë për tjetër gjë. Flitet se do të arrestohen një pjesë e drejtuesve të Tabirit.

— O perëndi, po kjo q'do të thotë?

— Qyprillinxh e dhanë kundërgoditjen. Zaten, edhe pritej kjo.

— C'kundërgoditje? — belbëzoi Ebu Qerimi. — Si? Qysh? Kundër kujt?

— Prit, sa i padurueshëm që je. Tani do të t'i tregoj të gjitha. Vetëm afroje pak kokën. Ndryshe, do të pér-fundojmë edhe ne bashkë me ata. Tabir Saraji është i gjithi si në ethe. Mbrëmë natën, ose, më mirë, ndaj të gdhirë ka ndodhur diçka enigmatike.

Karrocat në formë qyqeje, mendoi Ebu Qerimi. Kishte edhe një zog që quhej kështu, «Kali i Qyqes».

— Pra, pasi pësuan goditjen, Qyprillinxh, siç duket, s'ndenjën duarkryq. Diçka kanë bërë gjatë natës, kanë ndërmarrë diçka të shpejtë, që as unë, as ti dhe asnjëri s'mund ta dijë, së paku tani për tani. Ndaj të gdhirë, me sa duket, kanë mundur të japin edhe ata goditjen e tyre. Por siç të thashë, e gjithë kjo është mbuluar me mister. Ka ndodhur një ndeshje, një këmbim goditjesh

e tmerrshme, por e shurdhër, në thellësitë, në themelet e shtetit. Prej saj ne kemi ndier vetëm lëkundjen e jashtme, ashtu siç ndodh në një tërmet, epiqendra e të cilit është shumë-shumë thellë. Pra, brenda natës paska ndodhur kjo përplasje e lemerishme midis dy grupesh kundërshtare, apo forcash ekuilibruese, merre si ta duash, brenda shtetit. Prej saj kryeqyteti është i gjithi si në ethe, dhe askush s'di asgjë të qartë, madje as ne që jemi këtu dhe ku zë fill ky mister.

Ebu Qerimit i erdhi të thoshte se edhe ai e kishte kluar dy herë nëpër duar atë ëndrrën e mallkuar, por iu desh të mendohej vetëm një grimë, që kjo t'i dukej një idiotësi.

— Ende pa gdhirë mirë janë parë karrocat e ambasadorëve që rendnin drejt Ministrisë së Jashtme, apo ktheshin që andej, — vazhdoi fqinji me një zë të njëtrajtshëm. — Por kjo s'ishte e gjitha. Janë përzier, thonë, në këtë histori bankat kryesore të perandorisë, si edhe sipërmarrjet e mëdha të minierave të bakrit. Madje janë hapur fjalë për zhvleftësimin e monedhës.

— Shih, shih! — ia bëri Ebu Qerimi.

— Kështu janë punët, krejt të ngatërruara dhe fare ndryshe nga ç'duken në sipërfaqe. Puse të thella e të stërthella. Kurse ne, siç të kam thënë edhe një ditë, s'dimë veç ca ëndrra, ca mjegulla...

Gjithë ajo ditë kaloi e shqetësuar në Pallatin e Ëndrrave. Pak pas mesditës shefi i Interpretimit u arrestua vërtet, si edhe një pjesë e drejtuesve të Tabirit. Gjithë mbasditen u priten arrestime të tjera. Por gjer në mbrëmje nuk ndodhi gjë.

Ebu Qerimi u kthye në shtëpi në një gjendje padurimi për t'i treguar nënës gjithçka. Ia tha me radhë të gjitha, i habitur paksa që nuk arrinte të zgjonte në sytë e saj gjëzimin e pritur.

Dërguan një njeri në shtëpinë e vezirit, me shpre-

së se do t'u sillte ndonjë lajm të mirë për Kurtin, por njeriu u kthyesh pa lajme.

Megjithëse ishte pa gjumë, Ebu Qerimi nuk arriti të flinte do. Një herë që iu duk se dremiti, u përmend në cast nga një zhurmë e largët. U ngrit, u afroa te dritarja, po nuk arrinte të kuptionte se ç'po ndodhte. Pastaj dalloi një kuqëlim të zbehtë në horizont dhe për një grimë mendoi: Mos po digjet Pallati i Ëndrrave? Por aty për aty e kuptoi se zjarri ishte në tjetër drejtim. Ra prapë në shtrat, ku u përpëlit një kohë të gjatë. S'ishte gdhirë ende mirë kur u ngrit, u rrua me kujdes dhe shumë më herët se zakonisht u bë gati për të shkuar në Tabir Saraj.

## VII

### AFRIMI I PRANVERËS

Ajo që ndodhi atë natë, nuk u mor vesh kurrë. Mjegulla vazhdoi të mbështillte jo vetëm hollësitë, por edhe thelbin e ngjarjes, madje, sa më tepër që kalonin ditët, aq më e dendur bëhej ajo.

Një javë të tërë në Pallatin e Endrrave vazhduan arrestimet. Goditja ra kryesisht mbi bashëndrrorët. Ata që i shpëtuan burgut, u hoqën megjithatë nga Bashëndrra dhe u çuan në Seleksionim, në Recepzion e disa në Kopisteri. Kurse nga Seleksionimi dhe Interpretimi, nisën të zgjidhnin njerëzit për të mbushur sallat e braktisura të sektorit të goditur. Ebu Qerimi ishte ndër të parët që u zgjodh për atje. Dy ditë më vonë, pa e mbledhur ende veten nga ky ndryshim, e thirrën në drejtori, (një pjesë e zyrave të së cilës arrestimet i kishin boshatisur gjithashtu), për t'i njoftuar emërimin e tij si shef i bashëndrrorëve.

Ebu Qerimi qe krejt i befasuar. Askujt nuk mund t'i shkonte ndër mend një kapërcim i tillë në karrierrë. Ndihej menjëherë se Qyprillintë përpinqeshin të fitonin kohën e humbur.

Megjithatë nga Kurti s'kishte asnë lajm. Veziri ishte vazhdimisht i zënë. Ebu Qerimi nuk arrinte ta kuptonte dot se si ai, që kishte mundur të trondiste themelet e shtetit, s'arrinte dot të lironte nga burgu vëllanë e vet. Por ndoshta s'ka arsyte të ngutet, mendonte Ebu Qerimi. Ndoshta e di se është më mirë kështu.

Ebu Qerimi vetë qe i mbetur në punë dhe nuk i mbetej shumë kohë për t'u menduar. Sektori duhej riorganizuar nga e para. Dosjet e pashqyrtuara zinin njëra-tjetrën. Kurse e premtja, dita e dërgimit të krye-ëndrrës te sovrali, vinte aq shpejt.

Ebu Qerimi ishte bërë më i zymtë dhe më i pa-afrueshmë. Megjithëse bënte një përpjekje mbinjerëzore për të mbetur ai që kishte qenë, e ndiente se në gjestet e tij, në të folurën, madje në mënyrën e ecjes, diçka po ndryshonte dalngadalë. Po merrte pamjen e njerëzve që nuk i kishte dashur më tepër në jetën e vet, atë të zyrtarëve të lartë.

Në të vërtetë, sa më tepër që kalonin ditët në punën e re, aq më shumë bëhej i ndërgjegjshëm se ç'post tē rëndësishëm zinte ai në Pallatin e Endrrave. Tani karroca e tij, me dyert dhe pupenë e ngjyer në të kaltër të zbehtë, e priste çdo ditë përjashta, dhe ai e ndiente se jo vetëm karroca, por vetë prania e tij shpërndante kudo rrëth e rrotull nderim, heshtje dhe frikë. I vinte të nënqeshte me ironi për këtë, sepse vërtet kishte qenë e papërfytyrueshme që pikërisht ai, që më shumë se kushdo qe munduar nga misteri dhe hija e rëndë që shpërndanin organizmat shtetërorë, tani ishte bërë vetë i tillë, që të shkaktonte frikë e mister. Po ndoshta ishte e natyrshme kjo, mendonte nganjëherë. Ndoshta pikërisht ngaqë kishte qenë më i ndjeshëm se të gjithë ndaj veprimit të tyre, kishte depozitar në vettvetë aq shumë hije misteri e frike, saqë tanë i rrëzatonte me shumicë përreth.

I zhytur në punë, ai nuk e kishte vërejtur se dim-

ri kishte nisur të zbutëj. Mekanizmi i Pallatit të Endrrave punonte me ritëm të plotë. Si një nga drejtuesit kryesorë të tij, Ebu Qerimi lexonte çdo mëngjes raportin e veçantë tepër sekret të ditës. Pas vrasjes së rapsodëve, në Shqipëri kishte pagjumësi të ndjeshme. Grafiku i gjumësisë së popujve të tjerë ndryshonte si pas ngjarjeve që kishin ndodhur në trojet e tyre, kurse për pagjumësinë e Shqipërisë po përgatitej një relacion i veçantë. Shtësi i zarzavateve, ai që kishte dërguar endrrën fatale, kishte ditë që mbahej në një nga dhomat e veçimit, për të dhënë shpjegimet e nevojshme. Procesverbal i tij kishte arritur qysh tanë mbi katërqind faqe. Në përgjithësi pritej një stinë me gjumë të shqetësuar dhe me përqindjen e rritur të delireve.

Ebu Qerimit i qe bërë zakon të fërkonte sytë një kohë të gjatë, sikur cipa që ata zinin gjatë leximit, mezi të shqitej.

Një mbasditë vonë, kur u kthye si zakonisht nga puna në shtëpi, pa fytyrën e Lokes, të bardhë si gëlqerja. Zbrazëtia e njojur, e vjetër e ankthit, e harruar paksa prej disa javësh, u krijua aty për aty midis stomakut dhe mushkërive.

— C'është? — tha me zë fare të ulët. — Kurti?

Lokja bëri «po» me kokë.

— Domethënë nuk e lirojnë, — murmuriti ai. —

Sa vjet?

Sytë, që nga njomja dukej sikur do të shpërbëhen, mbetën të mjerë mbi fytyrën e Lokes.

— Sa vjet burg, po të pyes, — tha Ebu Qerimi, por ajo prapë nuk u përgjigj. Vetëm sytë e saj vështronin po aq pa shpresë si më parë. Ai e kapi për supesh, e shkundi me egërsi, nisi të ngulçonte dhe vetë ndërsa po e kuptonte dalngadalë atë që kishte ndodhur. Kurti qe dënuar me vdekje. Lajmi i prerjes së kokës së tij porsa kishte mbërritur.

Me orë të tëra u mbyll në dhomën e vet, ndërsa nëna qante vetëm, në një dhomë të mënjanuar të katit

të dytë. Si është e mundur, thoshte herë pas here me vete. Si ishte vallë e mundur që tamam kur lirimi i tij dukej çështje ditësh, ai qe dënuar me vdekje, madje qe ekzekutuar me ngut. Ebu Qerimi shtrëngonte tëmthat me duar. Domethënë se kundërgoditja e Qyprillinxve, rifuqizimi i tyre, karriera e tij marramendëse nuk ishin vecse një iluzion, një provë dinake, e bërrë ndoshta me qëllim, për të provokuar një goditje të re. Po tani atij aq i bënte. Le të goditnin, madje sa më shpejt, sa më mizorisht, që të merrte fund njëherë e mirë kjo histori.

Në mëngjesin e ditës tjetër, dyllë i verdhë në fyttyrë, ai shkoi në Tabir Saraj me ndërgjegjen e plotë se do t'i njoftonin shkarkimin nga posti, për ta çuar prapë aty ku punonte më parë, në Interpretim, ndëشتë në Seleksionim. Mirëpo vartësit e tij e priten me të njëtin nderim si gjithmonë, madje ftyra e tij e verdhë i bënte ata edhe më të druajtur. Ndërsa i zgjatnin shkresat e ndryshme, ai përpiquej të hetonte se mos në sytë apo në fjalët e tyre kishte diçka prej loje dhe, kur u bind se s'kishte një gjë të tillë, u qetësua disi. Mirëpo qetësimi qe i shkurtër. Ideja se, edhe sikur të qe marrë vendimi për shkarkimin e tij, vartësit nuk mund ta dinin aq shpejt, ia ripërtëriu ankthin. Gjeti një shkak për të shkuar te drejtori i përgjithshëm dhe, kur i thanë se drejtori s'kishte vajtur atë ditë në punë, ngaqë ishte i sëmurë, kjo gati-gati iu duk si një pjesë e lojës.

Ankhi vazhdoi disa ditë, gjersa një mëngjes herët, (kishte vënë re se gjithçka ndodhë atëherë kur e prisje më pak), drejtori i përgjithshëm e thirri në zyrë. Më në fund, tha me vete, duke u ngritur. Për çudi nuk ndjeu tronditje. Më tepër ishte një shurdhëri, e ndërprerë nga hapat e tij nëpër korridor. Ftyra e drejtorit ishte solemne. Natyrisht, mendoi Ebu Qerimi, shkarkohet nga posti një Qyprilli. Në familjen e tyre edhe ngritja, edhe ulja e kishin brenda tyre solemnitetin. Ai nuk po i dëgjonte fjalët e drejtorit. Në fund

të fundit, as që i duhej. Donte të dilte sa më parë nga kjo zyrë, të shkonte në sektorin ku do ta caktonin, në Seleksionim, apo në Kopisteri dërengues qindra nëpunësve të panjohur. Njëherë deshi ta ndërpriste drejtorin. Përse s'po i binte shkurt, pa i rënë rrrotull, ai s'kishte nevojë për hyrje kaq të gjata. Mirëpo edhe drejtori kishte qejf, me sa duket, të luante me të si macja me miun. Kush mund ta dinte, ndoshta ishte i gjuar që po e hiqte qafe këtë pinjoll të Qyprillinje. Ndoshta kishte menduar se i rrezikonte edhe postin e tij. Madje sikur tha diçka pikërisht për këtë gjë. Ebu Qerimi rrudhi ballin. Ishte e mundur, vallë, që t'ia thoshte kaq hapur, kaq me cinizëm? Madje cinizmi po shkonte edhe më tej, saqë Ebu Qerimi s'po u besonte veshëve: drejtori po i thoshte «urime!». Pse të mos tallesh, tha ai me vete, dhe pak më pas mendoi: kjo është për të lojtur mendsh.

— Ebu Qerimi, ju nuk ndiheni mirë? — e pyeti drejtori me zë të butë.

— Unë ju dëgjoj, zotëri, — tha ftohtë Ebu Qerimi.

Tani ishte radha e drejtorit ta shikonte krejt i habitur. Ai buzëqeshi drojtur.

— Të them të drejtën, s'ma rrokte dot mendja se një lajm të tillë ju do ta prisnit kështu...

— Cfarë? — tha Ebu Qerimi me po atë ftohtësi. Drejtori hapi krahët.

— Natyrishët, është e drejta e seilit t'i presë në mënyrën e vet lajme të tillë, aq më tepër që ju, duke qenë nga familja e famshme kryeministrale...

— Ju mund t'i binit më shkurt gjithë kësaj, — tha Ebu Qerimi, duke ndier se balli po i mbulohej me djersë të ftohta.

Drejtori e vështronë me ca sy të shqyer.

— Më duket se u shpreha qartë, — tha ai me zë të ulët. — Dhe, të them të drejtën, nuk e kuptoj dot se si mund të ndodhë që të thërrës një njeri në zyrën time për t'i komunikuar...

Ebu Qerimit po i uturonin veshët. Ajo që dëgjon-

te, ishte gjithsesi e pabesueshme. Pjesë-pjesë, megjithëse me vështirësi, ajo arrinte të ngjiste në ndërgjegjen e tij. Ishin shqiptuar vërtet fjalët «emërim», «çemërim», «zëvendësim i drejtorit», «posti i drejtorit», por të gjitha këto ishin përdorur në një sens tjeter. Kishte gati një çerek ore që drejtori i përgjithshëm i Tabir Sarajit po i shpjegonte Ebu Qerimit se ai, pa u çemëruar nga posti i shefit të Bashëndrrës, po emërohej gjithashtu, dhe kjo me udhëzim të drejtpërdrejtë nga lart, zëvendësdrëjtor i parë i Pallatit të Ëndrrave, pra zëvendës i drejtpërdrejtë i atij, drejtorit të përgjithshëm, i cili, pér arsyen shëndetësore, që Ebu Qerimi i dinte mirë, do të mungonte shpesh në krye të punës.

Duke përsëritur ngadalshëm të gjitha këto me një mënyrë të tillë sikur t'i thoshte tjetrit se ç'kishte këtu pér t'u pritur me këmbë të para, drejtori i përgjithshëm vazhdonte ta vështronë Ebu Qerimin me habinë e mëparshme, midis së cilës ndihej tanë njëfarë dyshimi.

Ebu Qerimi fërkoi sytë dhe, pa e hequr dorën prej tyre, tha me zë të ulët:

— Më falni, ju lutem, unë sot vërtet s'e ndiej veten mirë. Më falni.

— S'ka gjë, s'ka gjë, Ebu Qerim, — tha drejtori. — Të them të drejtën, m'u duke pak i lodhur qysh në fillim. Duhet të kujdesesh pér veten, sidomos tanë që ke kaq shumë punë. Ja, unë vetë kam qenë i pakujdeshëm dhe tanë po i paguaj të gjitha. Urime edhe një herë! Urime nga zemra! Me hair.

Në ditët që erdhën më pas, Ebu Qerimi e kujtonte skenën te drejtori, me një vuajtje gati fizike. Punët e tij u shtuan edhe më tepër. Drejtori i përgjithshëm mungonte vërtet shpesh e më shpesh nga sëmundja dhe Ebu Qerimit i duhej me ditë të tëra ta zëvendësonë në zyrën e tij. I zhytur në punët e shumta, ai që bëre akoma më i zymtë. Mekanizmi gjigant që ai praktikisht e drejtonte, punonte ditë e natë. Vetëm

tani Ebu Qerimi arrinte tē kapte përmasat e vërteta tē Tabir Sarajit. Funksionarë tē lartë tē shtetit hynin me drujtje nē zyrën e tij. Vetë zëvendësministri i brendshëm, me tē cilin Ebu Qerimit i qëllonte tē kishte punë shpesh, tregohej i kujdeshëm që tē mos i priste kurrë fjalën. Në sytë e tij, ashtu si nē sytë e zyrtarëve tē tjerë tē lartë, midis buzëqeshjes së mirësjelljes kishte pérherë një pikë tē ngrirë. Prej asaj pike vinte pérherë e njëjta pyetje: a ka ndonjë èndërr pér ne? Sepse mund tē ishin tē fortë e tē nderuar nē jetë, me poste tē larta e lidhje tē fuqishme, por kjo s'mjaftonte aspak. Përveç asaj që ishin nē jetë, kishte rëndësi si ishin nē èndrrat e tē tjerëve, nē ç'karrroca misterioze ecnin atje, me ç'nishane apo shenja tē pakuptueshme përsipër.

Çdo mëngjes, kur i sillnin raportin e ditës së dje shme, Ebu Qerimi kishte përshtypjen se nē një farë mënyre kishte nē duar natën që porsa kishte mbaruar tē miliona njerëzve. Dhe ai që kishte nē duar terrin e njerëzve, kishte pa dyshim një nga pushtetet më të mëdha. Çdo ditë e më tepër Ebu Qerimi bëhej i ndërgjegjshëm pér këtë gjë.

Një ditë, ashtu papritur, u ngrit nga tryeza e punës dhe me hapa tē ngadaltë zbriti poshtë nē arkiv. Ishte po ajo erë e rëndë e qomyrgurit, si atëherë. Nëpunësit rrinin përpara tij si hije, tē gatshëm pér t'i shërbyer. Kërkoi dosjen e bashëndrrave tē muajve tē fundit dhe, kur ia sollën, pasi u tha nëpunësve ta linin tē qetë, nisi ta shfletonte ngadalë. Gishtat e tij pérherë e më tepër e jepnën tronditjen ndërsa kthen te fletët. Rrahjet e zemrës ishin tē ngadalta krejt. Në krye tē fletëve, nga e djathta, ishin datat dhe shënimet e tjera tē protokollimit. E premtja e fundit e dhjetorit. E para e janarit. E dyta e janarit. Ah, ja më nē fund ajo që kërkonte, kryeëndrra fatale që e kishte çuar dajën e tij nē varr, kurse atë nē postin e drejtuesit tē Tabirit. E lexoi me vështirësi, sikur sytë t'i kishte tē lidhur, me ca fasha tē bardha që e kalonin dritën copa-copa. Ishte tamam ajo èndrra e zarzavateshitësit

kryeqytetas, që ai e kishte kaluar dy herë nëpër duar dhe përafërsisht me atë zbërthim që ai e dinte: Ura — Qypria — Qyprillinjtë. Vegla muzikore — eposi shqiptar. Demi i kuqërrremtë, që, i nxitur prej saj, do të sulmonte shtetin. O zot, ia bëri ai me vete. I dinte fare mirë të gjitha këto, megjithatë, kur i pa të shkruara, u ngjeth i téri. E mbylli dosjen dhe u largua me po ata hapa të ngadalta.

Shumë të fshehta të lemerishme kishte mësuar qyshse ndodhej në krye të Tabirit, megjithatë enigmën e asaj nate, goditjen e Qyprillinjve dhe kundërgoditjen e tyre, nuk e kishte marrë dot vesh.

Në dhomat e veçimit vazhdonte pyetja e shitësit të zarzavateve. Procesverbali i tij i kishte kaluar të tetëqind faqet dhe endë ishte larg mbarimit. Një ditë e kërkoi t'ia sillnin dhe me orë të téra u mor me të. Ishte hera e parë që shikonte një procesverbal të tillë. Qindra faqet ishin të mbushura me gjithfarë hollësish të jetës së përditshme të shitësit të zarzavateve. Atje ishin shënuar të gjitha pa përjashtim: llojet e perimeve e të barishteve, luljakrat, specat, sallatat, lakrat, mbërritja e tyre, shkarkimi, freskia, firot e shkaktuara nga kalbja, koha e vyshkjes, grindja me furnizuesit për të gjitha këto, lëvizja e çmimeve, trillet e blerësve, bisedat e tyre, hallet shtëpiake që zbuloheshin nga ato, shtrëngesa ekonomike, sëmundjet e fshehta, sherret, krizat, krushqitë, gjithfarë thashethemesh të dëgjuara gjysma-gjysma, fraza pijanecësh të orëve të vona, fshesaxhînjsh, endacakësh, fjalë kalimtarësh të panjohur, të mbetura kushedi pse në ndërgjegje, dhe prapë moria e barishteve, e spinaqëve, shija e tyre në fillim apo në mbarim të stinës, spërkatja me ujë për t'u ruajtur freskinë, kokëtrashësia e fshatarëve që i sillnin, grindjet për çmimet, për firot, bulëzat e ujit, vesa sipër sallatës, që rriste megjithatë peshën, trillet e amvisave, bisedat, thashethemet, gjithçka që fillonte nga e para dhe që dukej sikur s'do të kishte fund kurrë.

Kur Ebu Qerimi e mbylli dosjen e trashë, iu duk

se porsa ishte shkëputur nga një arë e pafundme gjithë gjelbërim e vesë, midis së cilës kurrsesi nuk të besohej se kishte qenë fshehur një nepërË. Megjithatë krahas lodhjes nga procesverbali ai pati një ndjesi freskie dhe, për çudi, edhe njëfarë keqardhjeje për shitësin, i cili, me sa dukej, as që e kishte kuptuar se ç'kishte shkaktuar me ëndrrën e vet. Por, para se të vinte puna te zbërthimi i saj, së cilës do t'i kushtoeshin me siguri qindra fletë të tjera në procesverbal, dilte pyetja se a e kishte parë vërtet ai njeri atë Ëndërr. Por, në fund të fundit, as kjo s'kishte ndonjë rëndësi të madhe. C'kishte për t'u bërë, qe bërë, dhe tani asgjë s'kthehej më mbrapsh.

Në ditët e mëvonshme Ebu Qerimi as që u kujtua më pär zarzavateshitësin. Po afronte ndërrimi i stinëve, një periudhë plot tension pér Pallatin e Ëndrrave dhe atij s'i mbetej kohë pér vogëlsira. Relacionet vixin pérherë e më të ngjeshura me probleme që kërkonin zgjidhje. Pagjumësia e Shqipërisë vazhdonte me përmasa të papara ndonjëherë. Është e vërtetë që nuk ishte detyrë e Pallatit të Ëndrrave qëtësimi i saj, por megjithatë, pérderisa gjendja mbetej e acaruar, prej Pallatit të Ëndrrave kërkohet një përpunim sa më i përkryer i dosjeve të gjumit të saj, që sa vente bëhezin më të holla. Dhe se mos ishte vetëm kjo, disa ditë më parë drejtori i Bankës Qendrore Perandorake në një takim të gjatë me Ebu Qerimin i kishte shpjetuar rrezikun e ri të zhvleftësimit të monedhës, që mund t'i paraprinte një krize të re në ekonomi. Kjo do të thoshte që Pallati i Ëndrrave, pasi të merrte shënim pér këtë gjë, të ishte pak më i kujdeshëm pér ato Ëndrra që kishin të bënин me këtë motiv dhe që Ebu Qerimi, nga përvaja e tij e shkurtër në Seleksionim dhe Interpretim, e dinte se ishin me qindra në-pér dosje. Kurse organizma të tjerë të rëndësishëm të shtetit në mënyrë të tërthortë têrhiqnin vëmendjen pér gjallërimin e mjediseve të intelektualëve çifutë dhe armenë (o zot, mos kërkonin një masakër të re?),

për njëfarë prirjeje decentralizimi të pashallëqeve të mëdha ndaj qendrës, dhe sinjalizimi i përherershëm, tashmë i përsëritur qindra herë, për dobësimin e ndjenjave fetare te brezi i ri, sinjalizim që dihej se vinte prej Sheh-ul-Islamit.

I përpire nga të gjithë këto, Ebu Qerimi as që e vinte re afrimin e pranverës. Ajri qe ngrohur disi, lej-lekët po ktheheshin, por ai s'kishte parë ende asgjë.

Një mbasdite, pothuajse në atë korridor dhe pothuajse në atë orë si atëherë, ai pa një arkivol që po e nxirrnin heshturazi nga dhomat e vecimit. Shitësi i zarzavateve, mendoi pa kthyer kokën të pyeste, madje as të shikonte. Nën lëkundjet e karrocës iu kujtua edhe një herë pamja, por e hoqi mendjen sakaq andej. Nga xhamat e karrocës, nën ndriçimin e purpurt të fundit të ditës, dukej mugullimi i parë i barit në parqet ende të zhveshura.

Në shtëpi bisedohej për fejesën e tij. Kishte ardhur daja i tij i madh, guvernatori, që s'kishte qenë në kryeqytet qysh prej burgimit të Kurtit, bashkë me të shoqen dhe ca kushërinj të tjerë të afërt. Nëna i kishte sytë të avullt, thuase pranvera kishte mundur të arrinte gjer tek ajo. Ebu Qerimi dëgjonte në heshtje fjalët e tyre, pa e pasur mendjen atje. I befasuar, sikur po bënte një zbulim, ai po mendonte se ishte njëzet e tetë vjeç. Qyshse kishte hyrë në Pallatin e Endrrave, atje ku koha rridhte sipas ligjeve të tjera, ai pothuajse e kishte harruar moshën e vet.

Të inkurajuar nga heshtja e tij, ata nisën të flisnin më me gjallëri pér vajzën. Nëntëmbëdhjetë vjeçë, me flokë të verdhë, siç i pëlqenin atij... Ata e sillnin bisedën me shumë kujdes, si të kishin në duar një vazo kristali. Ebu Qerimi nuk tha as po, as jo. Në ditët e tjera, si pér të mos e prishur suksesin e arritur, ata nuk ia përmendën.

Përvëç dy darkave të shtruara pér dajën e madh, java kaloi e qetë në shtëpinë e tyre. Erdhi skalitësi i varreve të familjes, pér të treguar modelin e shkro-

njave si dhe të zbulurimeve prej bronzi që do të vi-heshin mbi varrin e Kurtit.

Gjithë javën tjetër Ebu Qerimi u kthye vonë në shtëpi. Sovrani kishte kërkuar një raport të gjerë për gjumin dheëndrrat në shkallë perandorie. Të gjithë sektorët e Tabirit punonin me orar të zgjatur. Drejtori i përgjithshëm ishte përsëri sëmurë dhe Ebu Qerimi i duhej ta përpilonte vetë tekstin përfundimtar të raportit.

Herë-herë koka i rëndohej mbi tryezën e punës, kishte çaste që shikonte me habi fletët e mbushura, si të mos ishin të tij. Ishte aty gjumi i zi i një prej perandorive më të mbëdhë të bëtës. Dyzet e ca kombësi, të gjitha besimet fetare, pothuajse krejt racat njerezore. Sikur raporti të ishte i përbotshëm, zor se atij do t'i shtonte ndonjë gjë të madhe gjumi i pjesës tjetër të njerëzimit. Pra, ishte pothuajse gjumi i tërë planetit, ai terr i frïkshëm pa anë e fund, prej humnerës së të cilët Ebu Qerimi përpinqej të nxirrte ca grimca të vërtetash. Perëndia e gjumit, i grekëve të vjetër, Hypnosi, s'kishte ditur më tepër se Ebu Qerimi për gjumin dheëndrrat. Madje kishte ditur më pak.

Ishte një mbasdite fund marsi kur e mbaroi më në fund raportin. E dha për ta kopjuar në kopisteri dhe, disi i lehtësuar, i hipi karrocës për të shkuar në shtëpinë e vet. Në karrocë rrinte zakonisht në thellësi të ndenjëses, në hije, ku sytë e kureshtarëve, me të cilët rruga që mbushur përherë, nuk e gjenin dot. Ashtu u ul edhe atë ditë, megjithatë pas një copë rruge e ndjeu se tërheqja e drithares ishte më e fortë se kurri. Diçka ishte atje prapa xhamit, që e joshte fuqishëm. Më në fund, kundër zakonit, e afroi kokën dhe nëpërmjet avullit të lehtë që sajoi frymëmarrja e tij mbi qelq, pa se po kalonin përskaj Parkut Qendor. Paskan çelur lulet e bajames, mendoi me mallëngjim. Deshi të tërhiqej në çast në thellësi të karrocës, ashtu siç kishtë bërë gjithmonë, sa herë që diçka e kishte ndjellur përjashta, por s'mundi të lëvizte dot. Çeljen

e motit, ngrohjen e reve dhe lejlekët, dhe dashurinë, ai i kishte ditur që ishin aty, dy hapa larg, por kishte bërë sikur s'i kishte parë, i trembur se mos ato e nxirrin nga magjepsja e Pallatit të Endrave. I qe dukur se ishte strehuar aty pikërisht pér t'u mbrojtur dhe, në çastin kur i joshur prej jetës do të dilte nga ai strehim, pra në çastin e tradhtisë, trullosja do të merrte fund dhe tamam atëherë ata do të vinin ta merrnin, kur era të frynte kundër Qyprillinjve, ja, në një fund mbasditeje të tillë, ashtu si Kurtin, ndoshta më qetësish, pér ta çuar atje prej nga nuk ktheħesh më.

Ai i mendoi të gjitha këto, megjithatë nuk e largoi fytyrën nga xhami i dritares. Një degë bajameje të lulëzuar do t'ia porositja qysh tanë skalitësit përvarrin tim, mendoi. Megjithëse me pëllëmbë të dorës e fshiu avullin mbi qelq, vështrimi i mbeti prapë i turbullt, plot përthyerje dhe rrezëllime. Atëherë e kuptoi se i kishte sytë me lot.



## PASQYRË E LENDËS

Sezoni dimëror i kafe «Rivierës» .....	3
Kështjella Graks .....	37
Treni dimëror i linjës së largët .....	41
Shërbimi i parë .....	45
Kënga .....	56
Evropa e mbretërve .....	59
Të shtunën pasdite .....	87
Në studio, në vjeshtë .....	106
Pas mesit të natës .....	113
Breznia e Hankonatëve .....	127
Emblema e dikurshme .....	183
Nëpunësi i Pallatit të Endrrave .....	269